HAZYR DERVISHI

POCAHONTAS POWHATAN

Roman

Botimet ShI "JAKOVA E"
2007

HAZYR DERVISHI

POCAHONTAS POWHATAN

◆ Roman ◆

BOTIMET SHI “JAKOVA E”
2007

botues: Shi “Jakova e”

korrektor: Autori

përkujdesja grafike: Rajmond Berisha & Sali Ymeri

kopertina: Rrezeart Galica

në kopertinë: Xhevdet Spahija, “Jakova e Jerusalemit” & “Rebelimi i Frojdit”

fotografia: Korab Basha

dizajni: Sali Ymeri

Botimet ShI “Jakova e”
№ 46
Tel. (0) 381 (0)390 324 942

“Sikur të kishe arritur në Massachussets para qonquist-adorëve spanjollë, vëllezërit e mi do të kishin shpëtuar pa u tredhur. Babai im, mbreti im, Powhatan do të kishte shpëtuar pa e parë vdekjen e vetvetës së vet të spermes Iroki. Këtë mundësi po e shoh sot në këtë qytet të Jakovës së Jerusalemit.

A s’u duket mjaft?

Dhe nga e pata fatin të vijë tek unë nëna e Zotit tim?! [43] (1, 24-47)

Ajo e lindi djalin e vet- të parëlindurin, e mbështolli në shpërgenj dhe e vendosi në grazhd, sepse në bujtinë nuk pati vend për ta. (2,1-25)

Ungjilli sipas Lukës

A s'u duket mjaft ?

Zoti e hodhi farën e vet në qiell-
U bënë engjëjt dhe djajtë
Prapë
Zoti e hodhi farën e vet në tokë-
U bënë njerëzit
Prapë
Zoti e hodhi farën e vet në mitrën e gruas-
U bë Jezusi
Prapë
Zoti e hodhi farën e vet në mitrën e Indigjenes
Iroki të Massachussettesit- Pocahontas
Powhatanit
U bë Amerika Biodemokratike

A s'u duket mjaft

Qumësht i tre qumështave – gjirit tim
Mishin Iroki përtej seksit
Unë - grishtarja e Irokit – qumësht
- Në orgazmë
Peniset, testiset shkoqur Irokit
Gjaku tehut të orgazmës prostitutë
Iroki im - o Iroki im
Nëpër të urisë – Kujë Trokiti
Në derë të ëndrrës – Klitorit
Ai-qumështrash : Misri,Bizoneshe –
U desh Gjirit tim qumështak – Iroki
Pubisit – në fund hyra unë në Mua
Penisi jashtëbiblik – orgazmë –
Dashuri, Iroki im, o Iroki im!

Himni Iroki i Pocahontas Powhatanit
të Massachussettsit

"A po vdes dikush? "- pyeti gjenerali amerikan

"Jo, ndodhi ajo tjetra"-u përgjigj Indigjenia Iroki e Massachusettsit,

"Atëherë pse po qan,e dashur?"

"Erdhen qonquistadorët e Sant Luisit, i dashur"

"Ti do të ngadhnjesh mbi qonquistadorët e Sant Luisit e dashur"

"Me Orgazëm, me Dashuri, me Seks, me Mitër, do të ngadhnjej mbi qonquistadorèt e Sant Luisit,i dashur"

"Atëherë pse qan e dashur?"

"Sepse unë, i dashur, ta mësova Orgazmën, ta mësova Dashurinë, ta mësova Seksin nëpërmes Qumështit të Misrit jashtëbiblik, nëpërmes Qumështit të Bizoneshës jashtëbiblike, nëpërmes Qumështit të gjirit tim prej Iroki jashtëbiblik.Ti, i dashur, vetëm ti, do të bëhësh shpëtimtar i botës. Do të biesh ndesh me Perënditë e Tyre, me traditat e Tyre,me Shtetet e Tyre"-i cicëroi Indigjenia Iroki-Pocahontas Powhatan e Massachusettsit.

"Më bëre, e dashura ime, më bëre"- i këndoi John Harkeri.

"Pas katër orësh, i dashur, në Takimin e Këshillit të Lartë të NATO-s do të biesh ndesh me qonquistadorët: Grüber Sontag, Lipman Smith, Kloth Durante, Xhanatan Shelton, të laboratorit të OSCE-së. Ata e zbuluan vaksinën antiorgazmë, antidashuri, antiseks.

Perënditë e tyre kanë etje"

"Po Qumështi i Gjirit tënd e dashur?"- i këndoi John Harkeri i Massachusettsit

Vigmë në kupë të qiellit.

Indigjenia e fisit Iroki të Massachusettsit-Pocahontas Powhatan, nga jashtë tendës së vet, e dëgjoi vigmën e hidhërimit Indigjen.

"Po i bëjnë rjepcë ndonjë robi të zënë në luftë"-mendoi ajo

Kuja, vaji, dënesja e grave, e fëmijëve, në një gjuhë tjetër, e tunduan kureshtjen e Indigjenes Pocahontas Powhatan.

U qas tek dera e tendës së vet. Atje jashtë pa diç të vagëllt. Ishte dimër i kallkant në Massachusettes.

Në zërin e të jatit, Powhatan, Tribus së fisit Iroki të Massachusettsit, e kuptoi se dikush do të vdesë sonte.

"Ju, qonquistadorët e sant Luisit, të katër djemtë e mi m'i shndërruat në eunukë. M'i tredhet. Ua vratë seksin. I bëtë shterpë për gjakun Iroki.

Të katër djemtë e mi kanë ikur në malin Atapikata. Ata kurrëmë nuk do të kthehen në këto tenda. Për fisin Iroki të katër djemtë e mi kanë mbetur eunukë, pa trashëgimtarë për jetë të jetës. Dhimbja e tendës sime do ta shembë qiellin mbi qonquistadorët e sant Luisit"- u bë drithërues, i përvajshëm, zëri i Tribus Iroki, Powhatan të Massachusettesit.

Për një çast, vetëm për një çast, u bë qetësi. Të gjithë e pritën shpalljen e vdekjes.

"Le të vdesin të gjithë këta anglezë qonquistadorë! Le ta shohim stërkalën e gjakut të tyre, të fëmijëve të tyrë, të grave të tyre, përpëlitshëm në borë!"- ua shpalli vdekjen Tribu i fisit Iroki të Massachusettsit

Pastaj u bë qetësi.

Kuja e grave dhe e fëmijëve e krisi qetësinë e qiellit të Massachusettesit deri tek zemra e vajzës Pocahontas, të bijës së tribus Powhatan të fisit Iroki.

U zgjua nga ëndrra indigjene.

Pocahontas Powhatan nëpër të çarën e derës e pa një burrë të sfilitur, të lidhur për shtyllë, midis një turme burrash, grash, fëmijësh. Ajo e pa edhe një foshnje të porsalindur në duart e ngrira të një gruaje. E kuptoi urdhrin e të jatit.

Ata njerëz të sfiliturë nëpër dimrin e Massachusettesit do të vdisnin këso nate.

Anglezi, i pandehur për qonquistador, i lidhur për shtyllë, iu drejtua Tribus Iroki të Massachusettsit:

"Si vdiset njeriu i uritur? Shpirti i të uriturit të vrarë do të vërdallet nëpër tendat tuaja. Do ta keni të pamundur ta deboni me tymin e zjarreve tuaja. Shpirti i të uriturit të vrarë do të ulurojë çdo natë nga mali Atapikata bashkë me dhimbjen e katër djemve tuaj. Nga atje do të zbresë në ëndrrat Iroki- mallkim i zotit,deri tek gjaku i fëmijëve tuaj. Ashtu ngadalë, për çdo natë, do t'ua vrasë gjumin fëmijëve tuaj. Do t'ua vrasë rriten ëndrrave Iroki"–ua shpalli ogurin anglezi i lidhur për shtyllën e vdekjes

Indigjeni Powhatan, i sëkëlldisur heshti. E ndjeu shenjën e ogurit nëpër tenda, pa e kuptuar asnjë fjalë të anglishtes së John Harkerit.

Pocahontas Powhatan, nëpër të çarën e derës ra në shikimin e uritur të anglezit.

Doli jashtë tendës.

Qielli i çarë i natës së Massachusettesit po katandisej t'i shërojë plagët.

Aty, para tendës së saj, u heshtën dy lloje krijesash,pa i kuptuar gjuhët e njëra-tjetrës. Në shikimin e burrit anglez, të lidhur për shtyllë, Pocahontas Powhatan, e gjakut Iroki të Massachusettsit, e pa pasionin përtej urisë së burrit.

Ajo ra në sytë e burrit të ftiguar. U kapërthyen shikimet e tyre nëpër agsholin e Dashurisë së re.Anglezi, i lidhur për shtyllë, e lëshoi vetveten e vet, i yshtur shikimit të saj. Qielli iu afrua mbi kokë sa ta zë me dorë. Ai e përbuzi jetën në lakmimin e këtij shikimi. Më mirë e lakmoi rjepcën Indigjene.

"Le të vdiset në këtë shikim!"

Pocahontas Powhatan qashtër e pa gjakimin e anglezit për të vdekur. Koka e tij iu lëvar në gjoks, e këputur nga qafa. E pavullnetshme për të jetuar më pas këtij shikimi.

Vajza Pocahontas iu drejtua të jatit Powhatan:

"O babai im, o mbreti im, ky dimër i egër paska zbritur deri tek zemra Jote, sa të mos e dallosh, sonte, mikun nga armiku! Druaju nga mallkimi, o babai im, o mbreti im! Në zemrat e fëmijëve të fëmijëve tuaj do të bie cegma e këtij dimri. Këta njerëz janë anglezë të varfër, të braktisur nga atdheu i tyre Angloirlanda. Janë të tjerë nga qonquistadorët e sant Luisit. "

Heshtja e dytë ra mbi heshtjen e parë.

Prijësi Indigjen, Powhatan, i fisit Iroki, e nxori shikimin e vetvetes së vet nga thellësia e helmatisur e hidhërimit. U katandis ta hedhë atë shikim kah mali Atapikata, kah katër djemtë e vet të humbur. Pastaj shikimi i molisur iu rrëzua para këmbëve të së bijës Pocahontas. Dora e rëndë plumb i rrëshqiti flokëve të vajzës së vet me droje se mos do ta lëndojë me hidhërimin e vuvët të zemrës së plasur.

E bija, Pocahontas, e ngriti shikimin deri tek guvat e errëta të syve të të jatit. Ai, Powhatan, Tribu i fisit Iroki të Massachusettsit, ende ishte aty, prapa errësimit të gjakut të prishur.

"O bija ime, o zemra e zemrës sime! Llurbat e penisëve e të testiseve të shkoqura nga midis shalëve të vëllezërve tu ende pikojnë gjak të freskët"- foli nga gjoksi i jati, Powhatan, me shikim të ngulitur në natën zezonë, prapë andej kah mali Atapikata.

"Shpirti i mikut të vrarë në tendën Iroki, me mallkim do t'ua ngacmojë plagët vëllezërve të mi. O ati im, o mbreti im"- e përgjëroi e bija.

Prijësi i fisit Iroki të Massachusettsit e bëri atë shenjën me dorën plumb të rëndë.

Ai e mëshiroi zemrën e Vajzës së vet.

Tashmë Pocahontas ishte plagua nga shikimi i anglezit.

Tre burra, Iroki, e zgjidhen anglezin e mërtisur duke e mbajtur pezull të mos binte i plandosur në tokë.

Pocahontas, e bija e prijësit Iroki, e zhbiroi të atin me shikim përgjërues.

Me shikim të ngulur në errësirën e natës zezonë, andej kah mali Atapikata, serish i jati deshi t'i thotë të bijës: "Në Sant Luis t'i tredhën të katër vëllezërit".

Në vend të këtyre fjalëve e dha atë shenjën përbuzëse të faljes. Deshi t'i thotë diç vajzës së vet. Fjala iu qull në gojë, iu ngjiz, as për ta gëlltitur as për ta pështyrë përtokë. I pluskuar brenda vetvetes së vet, ia dha atë shenjën e dytë, të bijës, atë shenjën përbuzëse të faljes. Këtë herë shenja qe edhe dëbuese.

Pa e mëtuar më të atin, Pocahontas Powhatani u ngrit në këmbë me shikimin përgjërues, mirënjohës. Iu fal fytyrë së mugët te të jatit. Me folë nuk foli.

I urdhëroi ata tre burrat prerazi: ”Futeni brenda atë anglez të mardhur!”

Ata, të tre burrat indigjenë, u mëdyshen se në cilën tendë ta këllasin atë anglezin e mërtisur.

“Futeni në tendën time! ”- urdhëroi sërish ajo.

U çtendos ajri para tendës së saj. Zunë të ngjallen pëshpëritjet, zërat, zhaurimat e hapave nëpër borën e cemtë. Gratë dhe fëmijët e anglezëve të lidhur për shtyllat e vdekjes u çtendosën. Mbi tendat Iroki ra tisi i paqjes.

Zemra e vajzës Pocahontas ngadhnjeu.

Pocahontas hyri në tendën e vet, për herë të parë, pluskueshëm. Këmbët askund t’i zinin tokën.

“Kaq grua e lehtë paskam qenë?!”- i tha zemrës së vet të trembur.

Anglezi, ende i mërtisur lodhjes, i shtrire sa gjerë e gjatë në lëkurën leshatake të Bizonit, gati u ngulfat, i rënduar nga ajri vapullues, i varur mbi gjoksin e tij. Ajo u ngut ta shpëtojë duke ia shpërthekuar rrobat dimërore. Deshi t’ia thajë gjoksin e djersitur. Me pëlhurën e mbrujtur në mullëzën e Bizoneshës, Pocahontas ia fërkoi gjoksin e zhuritur anglezit të kapitur. Ajo lektisi t’ia shohë sytë ende të mërtisur nga lodhja. Me ngulm e vazhdoi fërkimin e gjoksit të tij me atë copë pëlhurë të mbrujtur në mullëzën e Bizoneshës. Në sytë e anglezit të mërtisur e derdhi currilin e shikimit të vet të ndezur duke i bërë rrugë brerores së pasionit. Pocahontas u ndrojt ta prekë lëkurën e vezullimtë të anglezit. Mbase edhe qe shumë herët. Në sytë e anglezit ende vërtitej premtimi i vdekjes.

Ajo ia shpërlau gjoksin nga vdekja e premtuar. Ia mbushulloi me trandjen e zemrës femërore- me zemrën hutaqe të vajzës së lëshuar ujëvarë.

Anglezi u përmend nga vdekja e premtuar. U kthye në vetveten e vet gati të vdirë.

Nëpër ujëvarën e flokëve të saj, pisë të zeza, zbriti brerorja tunduese e pasionit të orgazmës së panjohur.

"Të ka zënë uria e fajkoit o anglez. Katërmbëdhjetë ditë ke bredhë nëpër dimrin e egër të Massachusettsit"- ajri i tendës u mbushullua me zërin pasionant të saj.

"Kaq e bukur të këtë qenë anglishtja!"- u orvat të bijë në vetveten e vet anglezi i mërtisur.

"Ushqimi i sontem do të të shpie rrugës së Seksit, rrugës së Orgazmës, rrugës së Dashurisë o anglez!"- ajri u mbush rristik me zanoret e anglishtes melodike.

Shikimi i saj rrëshqiti nëpër mishin e gjoksit të anglezit deri tek beli. E ndjeu thelllë se si mbufatej mishi mashkullor qe nga gjoksi duke zbritur kah barku.

Ajo i lakmoi të gjitha mishrat mashkullore të anglezit. U plandos pranë tij, në lëkurën gudulisëse të Bizonit. Dorën ia rrëshqiti nëpër gjoksin e tij leshtak. E zbriti, ngadalë, ledhatueshëm, deri kur i zu në rrobën e poshtme të anglezit. Provoi ta përvjedhtë dorën nën pantallonat e shtrënguar për trupin e djersitur.E frenoi vetveten për të marrë frymë.E tëra u shndërrua në fajkua pasioni, me sy të ngulitur nga qielli mbi prenë e mëshehur në gëmushë.

Mendja i bëri dallgë. E ndjeu qulljen e veshtullt midis vegëve. Ajo po bëhej grua pranë mishit mashkullor të anglezit, të cilit pak më parë i qe premtuar vdekja. E ndjeu veten, për herë të parë, lakuriq pranë mishit të ardhur të mashkullit.

"Duhet ngutur deri atje"- e urdhëroi vetveten e vet Pocahontas.

E ndjeu ngutshëm se mishi mashkullor i anglezit po mbufatej, po mbushullohej teptisshëm, më teptisshëm se ç'e kishte pritur ajo. E zhveshi drithërueshëm siç zhvolohet mashkulli i teptisur epshit.Dora i vajti deri ku fillojnë leshrat e seksit mashkullor. Mishi i burrit anglez u tendos hell përpjetë. U bë penis.

Amokshëm, ajo, Pocahontas, u rrotullua mbi anglezin e ndezur. Buzët i puthisi usujzisht në buzët e ethshme të tij. Tashmë ajo gati e bëri të tërin për vetveten e saj.

Jo ende.

Duke i shkoqur buzët nga buzët epshore të tij i pëshpëriti në veshin e majtë:

"Të ka zënë uria e fajkoit".

Anglezi vetëm sa arriti t'i pulitë sytë në shenjë miratimi.

"O anglez, para se të hash mish femre, Iroki të Massachusettsit, do të pishë qumësht jashtëbiblik. Ky qumësht do të jetë tjetër nga ai i Biblës se qonquistadorëve të Sant Luisit.

Tashmë ajo i mbushi të dyja duart: me dorën e majtë e shtrëngoi hellin e mishit mashkullor të anglezit drejt seksit të saj femëror, me dorën e djathtë ia hodhi në gojë Qumështin e parë jashtëbiblik. Qumështin e nxjerrë nga kokrra e Misrit të Massachusettsit.

Anglezi e gëlltiti Qumështin e parë jashtëbiblik. Pocahontas Powhatan duke ia shtrënguar me dorën e majtë hellin mashkullor, të bërë penis, i pëshpëriti anglezit në bulëz të veshit:

"Me shijen e këtij Qumështi në gojën tënde, me shijen e këtyre buzëve në buzët tua, me dorën time në hellin tënd mashkullor, të bërë penis, do t'i mohosh tri herë: Evropën e qonquistadorëve, Zotin e qonquistadorëve, Jezusin frikacak të qonquistadorëve të sant Luisit!"

Anglezi u rrek, kot, ta njohë vetveten e vet pas gllënjkës së parë të Qumështit jashtëbiblik. Puhiza magjepsëse e fjalëve të aj, rristik me zanore, ia bëri anglishten të panjohur ndonjë herë

më parë.

"Sonte, pikërisht sonte, me Vagjinën, me Klitoritin, me Orgazmën, do t'i shpall luftë Zotit hujnik të qonquistadorëve evropianë. Do t'i shpall luftë Jezusit të trisht, frikacak, të qonquistadorëve të Sant Luisit. Do t'u shpall luftë të gjithë bijve të

fishkur të Zotit evropian të qonquistadorëve. Këta fëmijë e qonquistadorëve të Sant Luisit, sonte po eksperimentojnë në laboratorin e OSCE-së kundër orgazmës, kundër seksit, kundër dashurisë, o anglez i paemër”-

“John Harkeri më quajnë”- mezi pëshpëriti nëpër zanorët qumështore të saj anglezi i mërtisur.

“Zoti i qonquistadorëve të Sant Luisit do të stepet para fëmijëve të mi të ngjizur në Mitrën e Orgazmës, në Mitrën e Dashurisë”- vazhdoi ajo.

“Ku jam tash? “mezi arriti tek vetvetja e vet anglezi.

“Sonte arrite në fund të Qumështit të parë jashtëbiblik. Arrite në fund të mohimit të parë.

“Çka mohova”- u krodh në magjepsjen e saj John Harkeri.

“E mohove Zotin hujnik, smirëzi, të qonquistadorëve evropianë të Sant Luisit”- i cicëroi ajo në bulëzën e veshit të majtë.

John Harkeri ra në grishjen e syve të saj, në pasionin e saj. Vrullshëm e zuri etja për Qumështin e Dytë. Ajo ia pa në buzë etjen. I ngërthyer në sytë e Indigjenes Iroki, ai e gëlltiti Qumështin e dytë jashtëbiblik të Bizoneshës së Massachusettsit.

U bë Mohimi i Dytë.

Helli mashkullor i John Harkerit, i bërë penis, i shtrënguar në dorën e majtë të saj, teptisi mbufatshëm nga Qumështi i Dytë jashtëbiblik i Bizoneshës së Massachusettsit.

Ajo, Pocahontas Powhatan, e fisit Iroki të Massachusettsit, e pikasi me qashtërsi behjen e çastit të madh.

Thimthin e mbufatur, të mugulluar teptisshëm, të gjirit të

vet të majtë, e futi në gojën eçtare të John Harkerit. Qiella u hap. John Harkeri, nëpër të çarën e Vagjinës së Qiellës, u përbirua drejt Orgazmës. Ajo, Pocahontas, bijë e fisit Iroki të Massachusettsit, e futi hellin mashkullor ne seksin e vetvetes së vet Iroki, thellë e më thelle.

John Harkeri fluturoi lartë nëpër të çarën- vagjinë të Qiellës. U përbirua nëpër Orgazmë. E derdhi vetveten e vet në Mitrën e vapullimtë të Pocahontas Powhatanit. Rrodhi brenda saj nëpër të gjitha pasionet e çelura: nëpër buzë, nëpër thimthat e gjinjve, nëpër Vagjinën e syrit, nëpër syrin e Vagjinës, nëpër Orgazmë, nëpër Dashuri. Ajo, e ndezur zjarr i gjallë pasioni, piku në gjoksin e tij, në hellin mashkullor të John Harkerit.

U bë Mohimi i Tretë.

2.

“Irokët e mi dinë të jetojnë pa pasë nevojë për asgjë.Vuajnë pa u ankuar. Vdesin duke kënduar. Babai im, Powhatani, Tribu i fisit Iroki të Massachusettsit, i dërgoi të katër vëllezërit e mi në Sant Luis t’ua mësojnë Biblën, t’ua mësojnë orgazmën, t’ua mësojnë Dashurinë, t’i mësojnë për të jetuar përtej asaj vdekjes aq çapraze. Babai im, mbreti im, gaboi, shumë gaboi. Ai Jezusi juaj, i Biblës suaj, na u ngja trim. Pastaj na premtoi, se vellëzërve të mitë bijve të Tribus Powhatan– Iroki të Massachusettsit, do t’ua mësojë orgazmën, Dashurinë.

Të katër vëllezërve të mi u ra bretku duke i lypur nëpër Biblën tuaj tri llojet e qumështave: Qumështin e Kokrrës së Misrit, Qumështin e Bizoneshës, Qumështin e Indigjenes Iroki të Massachusettsit.

Në Biblën Tuaj paskësh munguar misri.

Në Biblën Tuaj paskesh munguar bizonesha.

Në Biblën Tuaj paskesh munguar indigjenia.

“Në shikimin e Jezusit të Biblës breron qashtër trimëria”- u rrokullis pluskueshëm John Harkeri

“Ai Jezusi i Biblës suaj u tmerrua nga misionaret qonquistadorë edhe kur të katër vëllezërit e mi e përgjëruan duke vdekur urie nëpër Bibël. Të dyzetën ditë të heshtjes së Jezusit tuaj, të katër vëllezërit e mi vendosen të kthehen në Iroki të Massachusettsit. Misionarët Qonquistadorë ia bëhen në Sant Luis. Nga midis shalëve të të katër vellëzerve të mi të të katër bijve të Tribus Iroki- Powhatan, ua shkoqen mishin mashkullor. I tredhën. Ua hoqen testiset, penisët.

Përftueshëm, qonquistadorët e Sant Luisit, mbi kuajt e tyre të shpejtë, para tendës së tim eti- Powhatan, i sollën vëllezërit e mi të ndarë në dy lloje mishrash: në mishra të shkoqur mashkullorë dhe në mishra të fishkur eunukësh. Ashtu, të llurbët, i përplasën para tendës së tim eti testiset, penisët e shkoqur nga midis shalëve të vëllezërve të mi. Me shkathtësinë e kalorësve të prapët, qonquistadorët u zhdukën në natën e cemtë të Massachusettsit”- ra në heshtjen e orgazmës Pocahontas.

“Ata qonquistadorë a patën arsye më madhore kur i trodhën katër vëllezërit tuaj?”- foli përqart, pluskueshëm, mbi gjinjtë e saj, John Harkeri.

“Sepse ata,katër vëllezërit e mi,i thanë atij Jezuesit të Biblës suaj: “Në sytë e tuaj mësuam se seksi Iroki nga Massachusettsi qenka i mangët pa orgazëm, pa Dashuri. Ai çunaku juaj, Jezusi, shumë u frikësua nga jezuitët qonquistadorë. Spiunoi tek ata. Pastaj u foli tërthorazi vëllezërve të mi se atë Marinë– atë Marinë e tij të bukur, e përrallisën në kurvë”- rënkoi Pocahontas Powhatan, e mallëngjyer.

“Maria, ajo Maria e Jezusit paska qenë kurvë ?! ” – pluskoi për herë të parë mbi dyshimin e hidhur John Harkeri.

“Vëllezërit e mi, para se të shkonin në Sant Luis, e njihnin vetëm seksin biologjik të nevojës, të heshtjes, të riprodhimit të foshnjeve. E njihnin seksin pa orgazmë, seksin pa dashuri. Ata

i besuan shumë atij Jezusit tuaj frikacak. Ai ua ka borxh irokasve të mi Dashurinë, Orgazmën.

Jezuesi i juaj do te jetë frikësuar shumë nga plagët e kryqëzimit, aq sa u frikësuan vëllezërit e mi nga plagët e thella midis shalëve, të shkaktuara nga qonquistadorët jezuitë. Jezusi i juaj iku në qiell e, vëllezërit e mi ikën kah qiella, në malin Atapikata" - e mbushulloi ajrin e tendës ajo, Pocahontas e fisit Iroki të Massachusettsit.

John Harkeri ra në sytë e saj të pikëlluar. Për herë të parë e pa atë hapësirë madhështore të Massachusettesit të paanë, me horizont laryshishë të mahnitshme, kund të mëshehura në mjegullnajën tisore, e kund të grimosura agsholit mëngjesor, të shpalosura përgjumshëm në dashurinë e saj të vagëllt. Ajo, Pocahontas, u bë njësh me të, e shndërruar në vesë të mëngjesit, kudo nëpër ketë botë të paanë të Massachusettsit.

Erdhi zëri, flauri nëpër ajrin e virgjër të malit Atapikata.

Ajo, Pocahontas, e bija e Tribus Iroki të Massachusettsit, e njohu zërin e vëllezërve të vet të zhvatur mishit mashkullor midis shalëve: "Pronar të kësaj toke do të behën: Orgazma, Dashuria Seksi, Klitoriti. Kjo tokë e zbrazët do të bëhet djepi i një kombi të fuqishëm, të pelegrinuar nëpër Orgazëm, nëpër Dashuri, nëpër Seks, nëpër epshin e gruas e të burrit deri tek Demokracia e Biodemokratizuar me orgazëm,me klitorit,me vagjinë, duke e liruar shtetasin e kësaj toke nga zotat uzurpatorë, nga religjionet uzurpatore, nga morali uzurpator, nga atdheu uzurpator ... "

Ajri u mbushullua me qetësi të breroret, solemne, deri në pafundsi të horizontit laryshak.

John Harkeri e ndjeu grykës se vet ajrin vesak të hapësirës hepuese, grishjen e teptisëshme të eçtimit nëpër gjoksin e ledhatuar nga ajo.Pocahontasi mbushulloi gjjinjtë,Mitrën, Orgamën, Dashurinë, Seksin,Klitoritin, për zhdrivillimin e Shtatëmbëdhj-

etë minutave amerikane. Zbriti nëpër lëkurën e zhuritur të John Harkerit, gjarpërisht, nëpër leshrat e seksit mashkullor duke u bërë njësh me penisin e tij.

Vetemsa arriti, nga atje, t'i thotë John Harkerit: "Sonte do t'ia çatisin qonquistadorët e Sant Luisit; do t'ia behin, ashtu furishëm, për të t'i shkulë testiset dhe penisin, ashtu siç ua shkulën të katër vëllezërve të mi. E gjithë Evropa yte e ka dhënë kushtrimin kundër teje: "John Harkeri i mohoi të gjitha: e mohoi zotin, i mohoi të gjithë tempujt e Evropës, i mohoi shtetet, mbretëritë, i mohoi të gjitha kierarkitë ushtarake e civile, vetëm për një Klitorit Iroki të zbuluar në Massachusetts. John Harkeri, nëpërmes Klitoritit Iroki të Massachusettsit, hyri në shpirtin e Orgazmës,të Dashurisë, kundër të gjitha traditave evropiane"-i foli përngutshëm Pocahontas Powhatan, e bija e Tribus Iroki të Massachusettsit.

"Qonquistadorët misionarë, së pari duhet të arrijnë tek Mitra jote. Atje vetëm atje, mund ta vrasin seksin, orgazmën, dashurinë"- zvargshëm u rrokullis në vetveten e vet John Harkeri.

"Gjatë Shtatëmbëdhjetë minutave amerikane unë do të arratisem në malin Atapikata, tek vëllezërit e mi. Qonquistadorët i frikësohen atij mali.Atje janë zotat tonë"- e ngushëlloi ajo John Harkerin.

U bë heshtje në tendën e saj. Nëpër ajër shpërtheu aroma e Qumështit të Misrit, aroma e Qumështit të Bizoneshës, aroma e Qumështit Iroki të Pocahontas Powhatanit. Aroma dehëse e mullëzës së Bizoneshës, veshtullisht, u vërtit mbi seksin e zgjuar të John Harkerit. Eçtimi i tij e shtyri ta zë më gojë thimthin e gufuar të gjirit të saj. U ngut ta përbijë gjithë qumështin. Zu

të marrë frymë ngulçueshëm nga ngutia për të pirë qumësht.

Para se ajo ta zë rrugën e Shtatëmbëdhjetë minutave amerikane John Harkerit i erdhi jehu i kumtit: "Qonquistadorët jezuitë, të trandur nga kushtrimi evropian po vijnë drejt tendës së

Pocahontas Powhatanit për ta zënë rob të gjallë John Harkerin këtej klitoritit, këtej Orgazmës, këtej Dashurisë- para se ai të bie në Mitrën e Indigjenes Iroki"- e dëgjoi edhe ajo kumtin ogurzi të Santiago Peresit, në ballë të çetës së ndërkryer të qonquistadorëve jezuitë nga Sant Luisi, drejt Massachusettsit

Ajo e rrëshqiti përngutshëm dorën deri tek mishi mashkullor i John Harkerit për ta ntrashë edhe njëherë me lëng mullëze të Bizoneshës penisin e tij. Duke ia mbushur gojën me Qumështin e saj jashtëbiblik e tëhulli në seksin e vet femëror penisin e teptisur para se të nisej në malin Atapikata. I pëshpëriti në bulëzën e veshit,rrëmbyeshëm, ashtu siç depërtoi mishi i tendosur mashkullor deri tek Mitra e saj:"Vaksinimi masturbal kundër Klitoritit, kundër Orgazmës, kundër Dashurisë, kundër pjellës seksuale, ka filluar të bëhet masovikisht nëpër Evropë. Prandaj deri tek Shtatëmbëdhjetë minutat amerikane më duhet të arratisem në malin Atapikata"- u zvarg Pocahontas, e tëhullur mishit mashkullor të John Harkerit.

Ai, mbushulluar nga gjiri i Indigjenes Iroki të Massachusettsit, nëpër Shtatëmbëdhjetë minutat amerikane të mitrës së Pocahontasit, e ndjeu shndërrimin e vetvetes së vet. Veshtullia e kuqërremtë e Mitrës së saj mbushulloi nga të gjitha anët, nga thithjet dehëse të mishit në zanafillë. Ai zu të notonte në mitrën jashtëbiblike të Indigjenes Iroki të Massachusettsit.

U bë i vetvetes së vet të seksit, të orgazmës, të dashurisë, të Shtatëmbëdhjetë minutave amerikane.

Nga larg, nga botë tjetër, trokëllima e kuajve të qonquistadorëve të sant Luisit u katandis të hyjë në mitrën e Indigjenes Iroki Pocahontas.

Ishte bërë vonë.

Pocahontas u ngjit në malin Atapikata, tek Shtatëmbëdhjetë minutat amerikane.

Kontinenti latin i qonquistadorëve mbeti jasht mitrës.

3.

Furia e qonquistadorëve të sant Luisit arriti para tendave të Indigjenëve Iroki të Massachusettsit. Pa e zvogëluar hjedhën e duhisë i trumhasën tendat, me krejt çka kishin brenda, deri tek tenda e Indigjenes Pocahontas Powhatanit.Santiago Peresi,udhëheqësi i qonquistadorëve të sant Luisit, e frenoi kalin e hedhur në dy këmbët e prapme.

Qonquistadorët ndaluan në vend. U bë heshtje para tendës së saj.

Nga e çara e derës rrodhi në borë currili i dritës. E rriti shpresën e Santiago Peresit se ajo, Pocahontas Powhatan dhe ai, John Harkeri, gjendeshin ende brenda tendës.

I Ra ndesh qetësisë ogure. Santiago Peresi hyri në tendë. Lëkura e John Harkerit kishte mbetur lëmuq në tokë, e veshtullë nga tri lloje qumështash jashtëbiblikë.

"Kemi arritur shumë vonë"- u tha Santiago Peresi dy të tjerëve qonquistadorë.- "Futeni këtë lekurë prej Jenki në thes të errësuar plasmasti"- i urdhëroi ai.

Santiago Peresi, befas e ndjeu një si gudulisje shashtisëse midis shalësh. Tek ai u zgjua aq papritmas mishi mashkullor. Infektimi nga ajri i veshtullt, nga të tri llojet e qumështave, nga lëngu i mullëzës së Bizoneshës, nga aroma e seksit, nga lëkura e llurbët e John Harkerit,aty brenda tendës, arriti aq shpejt midis shalëve të Santiago Peresit e, edhe tek ata dy të tjerët. Santiago Peresi u fantaks, shtang. U çjerr deri në kupë të qiellës: "E padurueshme qenka teptisja e mishit mashkullor"

"Tradhti! Tradhti"- shpërtheu lukunisht ulërima liferante atje, para tendës së Pocahontas Powhatanit.

Qonquistadorët e Santiago Peresit shtinë me pushkë në barkun e tendës së Indigjenes Iroki. Kafshimet e pushkëve në barkun e fryrë të tendës shkaktuan plagë. Plumbat prushanikë, të helmët, depërtuan brenda. Nëpër ajrin veshtullor nga të tri llojet e qumështave, nga duhma e seksit, arriten deri tek zemra e Santiago Peresit.Ajrin e dogj flaka e plumbave prushanikë.Santiago Peresi dhe ata dy qonquistadorët tjerë ranë pa pikë shpirti. Tenda e Indigjenes Iroki mori flakë deri në qiell.

Qonquistadorët u sollën tri herë rreth tendës së kallur te Indigjenes Iroki duke ulëritur lukunisht: "E shpëtuam jugun latin të kontinentit, e shpëtuam nga seksi, nga Klitoriti, nga Orgazma,nga Dashuria. E shpëtuam Jezusin nga Orgazma, nga seksi.

Jenkitë le të zdervajën në gjakun e ndotur të mitrës së Indigjenes Iroki!"

Qielli i jugut latin të kontinentit u bë gri nga zemrimi i qonquistadorëve.

Zunë të bijnë shira juntash, revolucionesh.

4.

John Harkeri nëpër horizontin e purpurt të Shtatëmbëdhjetë minutave amerikane, brenda mitrës së Indigjenes Iroki, sikur e dëgjoi uturimën e lukunisë së qonquistadorëve të sant Luisit.

Uturima e qonquistadorëve të sant Luisit erdhi zvargëshëm duke u bërë uturimë e avionit ushtarak.

Avioni ushtarak u ngrit nga baza e Ohajos.

Qëndroi paksa në Kairo. Vetëmsa i mori disa ushtarakë. E vazhdoi fluturimin për në Siçili.

Në sediljen e avionit John Harkeri u kapërthye në shikimin e Indigjenes Iroki të Massachusettsit. Ajo i buzëqeshi duke i thënë: "Qonquistadorët latinë të sant Luisit ta dogjën atë lëkurën e masturbimit evropian. Mbase do të kishe dëshiruar të kthehesh serish ne të?"- u tall paksa Pocahontas Powhatan triumfalisht.- "Ti po kthehesh në Evropën e masturbimit pa atë lëkurën tënde të vjetër.Sonte, pikërisht sonte, në laboratorin fushor

të OSCE-së, u zbulua, me ndihmën e minjve eksperimentalë, vaksina e masturbimit. Vaksina ka dhënë rezulltat kundër Orgazmës, kundër Dashurisë Iroki të Massachusettsit.

Evropa i frikësohet, deri në çmendje, kthimit tënd nga Massachusettsi. Tashmë John Harkeri, i dëbuar nga Plimuthi i Anglioirlandës si një protestant i leckosur, i rebeluar kundër zotave të tyre, po kthehet nga Massachusettsi i mbrujtur në të tri mostrat e qumështit jashtëbiblik:i mbrujtur në Qumështin e Misrit, në Qumështin e Bizoneshës së Massachusettsit edhe në Qumështin e Indigjenes Iroki,të të bijës së kryeparit Indigjen, Powhatanit të pikëlluar.John Harkeri paskesh rënë në Orgazmën dhe në Dashurinë e Indigjenes Powhatan. Për këtë grua magjepsëse i paska mohuar të gjitha entitetet evropiane: shtetin, pushtetin, zotat evropianë, religjionet e tyre qonquistadore, të gjitha traditat e tyre. Sonte, John Harkeri po kthehet në Evropë me avion ushtarak për t'i prehur të gjitha ato çka i kanë tepruar Evropës."- vazhdoi ajo me një lloj feksimi në sy.

Të dytë u lëshuan në buzët e njëri-tjetrit; u bënë njësh. Ajo iu dorëzua vrullit të epshit pa mundur t'i kontrollojë duart e veta.

"Jemi në avion ushtarak" -i tha galdueshëm gjenerali, John Harkeri.

Pocahontas Powhatan iu vjerr në shikim plot gaz- e mugulluar nga lumturia. Heshti duke zbritur në fund të shikimit të tij. Motorët ngulmues të avionit ushtarak, të uritur, e përbinin ajrin e freskët të natës. Gumëzhima e tyre, si nga larg, vinte e njëtrajtshme bashkë me gjumin e dashurisë.

"Do të zbarkojmë në Siçili pikërisht në orën njëzet e katër të natës së sontme"- i foli gjenerali.

"Do te doja të mos sosej kurrë kjo natë e sontme"- gati u zhgreh në vajë ajo.

E dinte se gjenerali këtë herë do t'i fliste për gjëra ushtarake.

“Sonte e keni natën tuaj, gjeneral i dashur, për të zbarkuar në Siçili” - i tha ajo me kurajën e një gruaje sfiduese.

“Ashtu do të jetë. Evropa Masturbuese do të shpëtohet edhe këtë herë”- e zhbiroi shikimin e saj gjenerali.

“A do të arrijmë, gjeneral i dashur, t’i kryejmë sonte ato dy ndërhyrje kirurgjike në klinikën “Gemeli” te Romës”- e pyeti, më tepër me shikimin e saj depërtues.

“Gjithsesi”.

“Pse i keni zgjedhë ato dy gra, vetëm ato të dyja, për t’ua hapur mitrat”- e pyeti me kureshtje te çastit ajo.

“Në Izrael ka ndodhë diç kontinentale, gjenetike.

Rebeka e Alamekut nga Abbi i Galiles, vullnetarisht, për ta shpëtuar kodin hebraik - ia ofroi Mitrën e vet Rabi Jochanan ben Sakait”- e përfilli “kureshtjen” e Indigjenes Iroki të Massachusettsit.

“Rebeka e Alamekut a ia ofroi orgazmën Rabi Jochanan ben Sakai?” - grarisht e pyeti gjeneralin ajo, paksa me buzë në gaz.

“Të gjitha ia ofroi bujarisht:Klitoritin, Orgazmën, Dashurinë”- ia numroi, për të satën herë, gjenerali.

“Nga i mësoi Rebeka e Alamakut fshehtësitë e Orgazmës, të Dashurisë kur Evropa i lufton me aq ngulm?”- u shpreh Ajo.

“Rebeka e Alamekut e mësoi orgazmën nga Zatra Arameje”- e zgjati John Harkeri për ta eksituar kureshtjen e Indigjenes Iroki të Massachusettsit.

“Zatra Arameje e paska pasur të vetën orgazmën?”- e pyeti Pocahontas duke menduar se i ra në fund.

“Jo, edhe Zatra Arameje e mësoi. Atë ditë qëlloi, jo rastësisht, në shesh, kur Maria Magdalenë ra në ekstazë. Kur ra në sytë e Jezusit. Zatra Arameje e pa shikimin e kapërthyer brer-oresh të Jezusit. Jo vetëm e pa. Midis vegëve të Zatres Arameje bulëzoi mishi femëror, pastaj gufatja e seksit...” - vazhdoi

Jon Harkeri duke rënë thellë në shikimin e Indigjenes Iroki të Massachusettsit.

Gumëzhitja e motorëve te avionit ushtarak vazhdoi ta përtypë ajrin e freskët të natës. Ajo heshti. I duhej paksa gumëzhitja e njëtrajtshme e motorëve të avionit ushtarak për t'u rrokullisur në vetveten e vet: "Shikimi i Jezusit i ndezi shkëndijat e Orgazmës e të Dashurisë, të seksit, të klitoritit. I ndezi të gjitha ndalesat e shtetit evropian të qonquistadorëve. Jezusi, atë ditë e sot, mbet në ilegalitetin seksual të Marisë Magdalenë"- vazhdoi të rrokulliset në vetveten e saj Indigjenia Iroki e Massachusettsit.

"Po ti, e dashur, nga i mësove Orgazmën dhe Dashurinë?" - u engletis për yë satën herë gjenerali.

"I mësova pikërisht në shikimin e atij Jezusit të asaj Marisë"- ofshani ajo.

"E dashur, e ke takuar ndonjëherë Jezusin?"- e pyeti fëmijërisht John Harkeri.

"Po, e kam takuar. Në Biblën e sjellë nga Sant Luisi kishte shumë Jezus. Në shume faqet te librit ishte portreti i Jezusit me atë shikim të brerorët. Njeri nga vëllezërit e mi- Fajkoi i heshtur- ma mësoi leximin e Biblës. Në fillim Jezusi më shikoi shitueshëm. E frikësuar e mbyllja Biblën, krejt kot. Shikimi i Jezusit mbetej jashtë librit"- ankoi Indigjenia Iroki.

"Ti, e dashur, e njihje seksin ende pa e takuar Jezusin?"- ia prini John Harkeri.

"Ne, Indigjenet Iroki, të Massachusettsit e njihnim vetëm seksin biologjik, seksin e përtrirjes vagjinale, pa Orgazëm, pa Dashuri. Ne bënim seks njëherë në vit vetëmsa për prodhimin e foshnjave"- gati ankoi ajo.

"Ai Jezusi yt i Biblës së Sant Luisit e pat të lehtë me ty, e dashur: ti qe pagane.Tek Jezusi i Biblës së Sant Luisit e ke parë vetëm mashkullin e bukur"- gjenerali ia çeli rrugën.

“Një ditë të mugët dimri, e shtrirë në lëkurën e ngrohtë të bizonit, e ndjeva tundimin biologjik të seksit vjetor-të atij seksit të përtrirjes biologjike, të atij seksit indigjen pa orgazëm, pa dashuri.Më erdhi një mundim djersak në fund të barkut. Sy-të e pulitur më tradhtuan. Mbi vetën time e ndjeva një mbu-lojë-puhizë të lehtë, pluskuese. Dikush ra mbi mua. Kurrë ta marr vesh se kalova nëpër të çarën e qiellës Orgazmë. E shkëputa vetveten përtej seksit të vjetër indigjen. Dikush, ai që qe mbi vetën time, kaloi nëpër mitrën time të çelur. U bëra gjithçka në qiellën e Orgazmës.

Dikush më kishte zënë për këmbe deri sa e ndeva dhimbjen e largët. Trupi im mori formë pas pickimit të fortë në kofshën e djathtë.

“Të kesh turp! Më tha Nëna”-i foli gjeneralit Pocahontas.

“A hyri tjetër kush në tendë përveç nënës sate?”- e pyeti gjenerali.

“Jo”

“Nëna jote a e përmendi ndonjë emër?”- u ngut të pyesë edhe njëherë ai.

“Po e përmendi”

“Kend e përmendi?”- gati e diti John Harkeri.

“Atë, Jezusin e Biblës së Sant Luisit. Nëna ime nuk e tha krejt por kishte frikë nga qonquistadorët.Unë e kisha pasë qullë atë Bibël”- e pranoi Indigjenia Iroki.

“Nëna jote e diti se çka i ndodhi vajzës së vet?”

“Jo krejtësisht! Ajo mendoi se më kishte tunduar vetëm seksi vjetor; ai seksi i shtatzënisë, pa orgazëm, pa Dashuri. Ajo mendoi në atë çast se tundimi seksual pa spermë do të më mundojë. Më këllasi në ujë të ftohtë siç i këllasin pulat”- Pocahontas u ngjërua nga pikëllimi tisor në fytyrë.

John Harkeri u vesua, u bë pluskues në paanësinë e lakmueshme, të pangërthyeshme. U mbushullua mallë ngashërues. Ra në sytë e saj; u bë njësh me të. Erdhi tek vetvetja e vet posa e hetoi dorën e saj midis shalëve. Ajo paskesh rënë, me përftimin e orgazmës së parë, mbi Biblën e Sant Luisit.

"Në avionin ushtarak ndalohet bërja e Dashurisë"- gati i tha asaj pa e ditur së në cilën faqe të Biblës së Sant Luisit gjendej tashmë.

Pocahontas Powhatan u rrëmbye të flasë përqart: "Nëna ime më qortoi rendë se e paskam qullur Biblën, pikturën e Jezusit të Sant Luisit, gjatë amokut të orgazmës se parë. Në sytë e Jezusit të Sant Luisit e pashë lumturinë e gjallë të asaj Magdalenës Mari te Sant Luisit sa mezi e dëgjova zërin e nënës sime"- u egzaltua ajo duke rënë në buzët e zhuritura të John Harkerit.

5.

Seksi po e bën batërdinë nëpër Evropë. Gratë e Jezusit, të strehuara nëpër katakombet e Romës, po i kultivojnë në konspiracion të plotë Orgazmën dhe Dashurinë.

Atje në Jakovën e Jerusalemit ndodhi serish diç kontinentale. Sofia, e shoqja e Rainhard von Grainhelmit të tretë, trashëgimtarit të kurorës mbretërore të Bohemisë ra në orgazmën e rektorit Redalk san Heldikut.

"Edhe Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, nën përkujdesjen e konsiliumit të mjekëve amerikanë, do t'i hapet Mitra sonte në klinikën "Gemeli" të Romës?"- Pocahontas i solli në vetveten e vet buzët ushujzore të John Harkerit.

Duke i shkëputur buzët, tashmë të njomura në thimthin e gjirit, mezi të nxjerrë nga gjoksorja e saj, John Harkeri iu përgjigj në bebëzën e syrit: "Po, Sofia e Haçet Deletës do të operohet sonte, menjëherë pas Rebekes së Alamekut. Ajo ka ravguar midis femrës e mashkullit të vetvetes së vet evropiane, e mashtruar ujqërisht me hormone të ngatërruara antiorgazmë, antidashuri, antiseks".

“Krejt si ujku ynë i malit Atapikata. Po ti, i dashur, thua se Sofia e von Grainhelmit qenka shtatzënë, se sonte në klinikën “Gemeli” të Romës nga mitra e saj me ndërhyrje Cezareske do të nxjerrët foshnja?”- e pyeti Pocahontas me dëshirë për ta rindëgjuar vdirrjen e kësaj Sofie.

“Po, Sofia e Haçet Deletës ka mbetur shtatzënë, bile tashmë ka arritur në fund të Shtatëmbëdhjetë minutave të Jakovës se Jerusalemit të saj”- u përgjigj gjenerali, John Harker me një fije buzëqeshjeje në fytyrë.

E prirur lektisshëm për këtë bisedë Pocahontas Powhatan e zhbiroi edhe më: “I dashur, si i mugulluan Sofisë së Rainhard von Grainhelmit Orgazma, Dashuria, seksi, klitoriti?”

“Ndodhi atje në Berlin. Sofa u arratis nga teatri i Berlinit bashkë me Mefiston e Doktor Faustit. Shkuan deri në Galile, në fshatin Abbi për ta takuar Rabi Jochanan ben Sakain.Secili prej tyre deshi ta pyesë Rabinin për diçka. Sofia, sipas një pergamene të resur në shumë vende, e pyeti Rabi Jochanan ben Sakain në e kishte takuar ndonjëherë të vëllain e saj- Kostantinin. Mefistoja i Doktor Faustit e pyeti Rabinin në e dinte më të vështirë jetën në ferr apo në mishin e këlyshit të Kones së Danielit të Abbit të Galilesë.”- ndaloi John Harkeri me shikimin e ndezur.

Pocahontas Powhatan, e bija e Tribus Iroki të Massachusettsit heshti me gojë por jo me sy. Shikimi i lektisshëm i saj po ia zhbironte bebëzat e syve gjeneralit amerikan.

“Rabi Jochanan ben Sakai çka i tha Sofisë ?”- arriti ta pyesë ajo.

“Në pergamenën e klinikës “Gemeli” të Romës për gjendjen shëndetësore të nënës sate shënohet kjo diagnozë: Sanguin lacertae in Utero. A mund të ketë njeriu vëlla nën këtë diagnozë. E pyeti Rabi Sofinë”- u ngrys John Harkeri.

“Rabi Jochanan ben Sakai e përmendi fjalën “utero?”-e pyeti Pocahontas.

“Po! E përmendi”.

“Cili Rabi, cili mjek do të thoshte se e ëma e Sofisë mund të ketë mbetur shtatzënë me këtë diagnozë: “Sanguis lacertae in utero?”- u ndez Indigjenia Iroki.

“E kupton ti këtë diagnozë?”- i buzëqeshi gjenerali.

“Kjo diagnozë do të thotë: “gjak hardhuce në mitër”- shpjegoi ajo.

“Ti e dashur mendon se me këtë diagnozë shtatzënia behët e pamundshme?”- qeshi gjenerali.

“Jo vetëm e pamundshme por të çuditë pergamena. Përse dikush te ketë hedhë gjak hardhuce në mitrën e të ëmës së Sofisë kur në Evropë pjellin perënditë pa mitër. Zotat e Evropës edhe sot e gjithë ditën e tyre pjellin nga koka, nga brinja e majtë, nga pulpa e këmbës së majtë.Në të gjitha këto pjesë te trupit mungon mitra”- u nxeh Pocahontas Powhatani.

“Mbase Jochanan ben Sakai mund ta ketë lexuar keq pergamenën e resur në shumë vende”- mëdyshoi gjenerali amerikan. -“Rabi Jochanan ben Sakai, e dashur, posa ishte kthye nga Sidoni, pas refuzimit të Rahiles.Ajo grua e refuzoi kërkesën e Rabi Jochanan ben Sakait për t’ia dhënë mitrën, për ta shpëtuar nga dënimi i rëndë.”- vazhdoi gjenerali amerikan John Harkeri.

“Rahila nga Sidoni, atëherë gjendej jashtë seksit hebre, jashtë orgazmës, jashtë Dashurisë. Ç’i duhej Rabi Jochanan ben Sakait mitra e saj?”- u ndez Indigjenia Iroki e Massachusettsit.

“Rabi Jochanan ben Sakai, para se të takohej me Rahilen në Sidon, i njohu të gjitha: Seksin, Orgazmën, Dashurinë pasi ra ndesh me shikimin e ndezur të Zatres Aramejase. Atij i duhej vetëm një mitër”- e shpuri gati në fund të rrugës John Harkeri të dashurën e vet.

“Zatra Arameje e paskesh përhapur “sëmundjen” e Orgazmës nëpër shumë njerëz”- ironizoi ajo.

“Jo tek shumë njerëz”- ndërhyri John Harkeri.- “Zatra Arameje shkoi në Athinë. Atje deshi ta hapë shkollën e Orgazmës. Atje deshen ta shndërrojnë në prostitutë të masturbimit. Jezusi u frikësua, jo vetëm në Athinë - kudo nëpër Evropë. Edhe ajo Maria Magdalenë u shpall prostitutë e masturbimit, pa orgazmë, pa Dashuri”- vazhdoi gati i vdirë gjenerali amerikan.

“Jezusi paska qenë frikacak edhe në ketë anën tjetër-në Evropë. Të katër vëllezërit e mi në Sant Luis të cilët e njihnin vetëm seksin, pa Orgazëm, pa Dashuri, u mashtruan në shikimin e Jezusit në pikturat e Biblës së Sant Luisit. Kur vëllezërit e mi filluan t’i besojnë shikimit të Jezusit të Sant Luisit ia behenqonquistadorët. Ua zhvaten nga midis shalëve penisët dhe testiset. I tredhën.

Ashtu të llurbëta, plot gjak, kund të ngjizur e kund duke pikur, qonquistadorët e sant Luisit i sollën testiset dhe penisët para tendës së tim ati. Pastaj,pasi i përplasën llurbat e mishrave mashkullore të të bijve Iroki, menjëherë i pllakosën përtokë edhe vëllezërit e mi eunukë.

Qonquisadorët u larguan me po atë turr kuajsh”-u ngrys Pocahontas Powhatan.

“Ashtu ndodhi. Jezusi i qonquistadorëve, në Biblën e tyre të sant Luisit, e ka shikimin e mekur, shikimin prej varfanjaku revolucionar, plot urrejtje, shikimin e juntave ushtarake të tipit Macho Pancha të kontinentit latin. Qonquistadorët e vranë seksin e indigjenëve plançorë, Maja, ashtu siç bënë me vëllezërit tuaj Iroki. Atje në kontinentin latin, e dashura ime, sot e kësaj dite sundon shpirti i qonquistadorëve të tipit Macho Pancha” - foli John Harkeri me shikim të vendosur.

Indigjenia Iroki e Massachusettsit u përlot çurg faqeve. Jon Harkeri zbriti nga shikimi i vendosur prej burri deri tek sytë e mbushulluar të saj. Në buzë e ndjeu valukën e lotëve Iroki duke e dehur të tërin në avionin ushtarak sikur të mos e kishte prekur,

lehtë, në cep të krahut, stjuardesa. John Harkeri, mundimshëm, mezi doli nga lotët Iroki.

Stjuardesa, me shikim të grimosur i tha gjeneralit: "Zoti gjeneral me faks erdhi ky mesazh për Juve. Ju kërkoj ndjesë për shqetësim".

Gjenerali amerikan e zgjati dorën kah stjuardesa. Çka të marrë më parë? Letrën e ardhë nga faksi apo buzëqeshjen e vagëllt të stjuardesës.

Dora i mbeti pezull për një çast.

"Në këtë stjuardesë të bukur të jetë mbyllë vetëm masturbimi evropian? Kjo krijesë e brerorет të mos e njohë Seksin, Orgazmën, Dashurinë e një nate të vapullimit në tendë!"- u trand zëshëm John Harkeri duke e vrojtuar shikimin e vdirë të stjuardesës.

"Ti , i dashur, mund ta kesh tunduar mishin femëror tek kjo stjuardesë"- i foli Pocahontas me një fije qortimi.

"Po! Unë e pashë shikimin e vrevës evropiane në mishin e stjuardesës së bukur"- u çfajsua gjenerali amerikan.

"Ç'do të ndodhë pas pak çastesh me atë stjuardesë të bukur?"- e pyeti ajo, serish me qortim femëror.

"Shikimi i stjuardesës së bukur do të kërkojë shpëtim në urdhërin e Rabi Jochanan ben Sakait. Ajo stjuardesë do të bëhët grua me orgazëm e me mitër"-serish u çfajsua gjenerali John Harkeri.

"U lëmek stjuardesa e bukur midis masturbimit dhe seksit të zgjuar kah orgazma, kah dashuria. Unë e njoh këtë zgjim të agsholit femëror"- shpjegoi ajo.

"Do të thotë se tek stjuardesa e bukur ndodhi zgjimi i mishit femëror?"- e mburri veten Jon Harkori.

"Ajo "stjuardesë" evropiane u përvodh në avionin ushtarak tek aeroporti i Kajros. Ti, i dashur, bëre diversion në shikimin e saj, në mishin e saj"- e zbuloi diverzionin para John Harkerit.

“Ajo stjuardesë e bukur paska dezertuar, tashmë, nga masturbimi evropian. Ja njoha shikimin”- i foli gjenerali asaj duke e shtrënguar fort në parzëm.

“Po! Ajo “stjuardesë” hyri në avionin tonë ushtarak atje në aeroportin e Kairos si diversante e, tashmë u shndërrua në dezertore”- ofshani Indigjenia Iroki e Massachusettsit.

“Ti, e dashur, mbase dëshiron t’i uzurposh Orgazmën, Dashurinë... seksin, klitoritin, vetëm për vetveten tënde?”- e ngacmoi gjenerali.

“Jo, i dashur; unë dua të te ruaj vetëm ty. Të mos bishë në grackat e grackat grave spiune”- i foli ajo duke u thelluar në parzmën e tij.

“I ke mësuar, më tepër se ç’duhet, këto punët e shtetit dhe të grave”- e pergdheli gjenerali.

“Harrove ta lexosh letren e sjellë nga faksi i “stjuardesës” së bukur”- e nxiti ajo duke iu varë në qafë.

Sikur të mos i bëhej vonë, John Harkeri ra, këtë herë më gjatë, në buzët e saj, gati në teh të Orgazmës.

“Mos ashtu! E sheh si varavingen ushtarakët nëpër avion?- e përmendi Pocahontas.- “Ka qenë dashur të jesh në ballë të shtabit ushtarak të këtij avioni. Megjithatë oficeret e lartë, gjatë këtij udhëtimi, të kanë lejuar t’i kalosh disa çaste pranë të dashurës sate. Andaj të mos e teprojmë”- e këshilloi ajo plot gaz në sy.

Gjenerali amerikan, ende pa e rregulluar fytyrën e çakërdisur, e ngriti nga dyshemeja letren e stjuardesës së bukur. E shkapërderdhi shikimin ushtarak mbi të. E lexoi me një ngrysje të ngopur në fytyrë.

“Në orën katër të mëngjesit të ditës në vazhdim, do të behët takimi i Këshillit të lartë të Paktit Alantik në një qytet të çuditshëm, atje në Jakovën e Jerusalemit. Atje, në atë qytet, po bëhët lufta më e çuditshme e mitrave. Në këtë takim do të jenë të gji-

thë. Gjeneralët evropinë janë lajmëruar me nënshkrimin e sigluar të gjeneralit amerikan, John Harkerit. Shpjegimet tjera do t'u epen gjeneralëve të Paktit Veriatlantik në komandën amerikane pasi të keni zbarkuar në Siçili"

"Sa të ngjeshur i ke minutat i dashur"- iu vjerr në qafë Pocahontas.- "Po pse të përmendet ajo Jakova e Jerusalemit në këtë urdhëresë?"- e pyeti me shumë diskrecion.

"Në pergamenën e gjeneralit Titi të ushtrisë lindore të perandorisë romake është pleksur teksti i fshirë në shumë vende. Gjenerali roman, Titi, kur ai Jezusi yt i breroret nga Sant Luisi duhej t'i kishte mbushur plot shtatëdhjetë vjet, e rrethoi Jerusalemin për ta kallë në zjarr. Tribali i Madh i Jerusalemit vendosi të luftojë kundër Romës. Lufta duhet të bëhej skajsmerisht e pabarabartë. Kjo luftë do t'i vriste të gjithë hebrejt, të madh e të vogël.

Tribali i madh i Izraelit vendosi t'i hyjë kësaj lufte të pabarabartë. E vendosi vdekjen heroike të Izraelit.

Njeri prej rabinëve të Tribalit të madh e kundërshtoi këtë vdekje të Izraelit. Kundërshtimi i tij u mund nga rabinët e Tribalit të madh. Kryenëvete ky Rabi zgjodhi rrugë tjetër.

Rabi Jochanan ben Sakai u arratis këso nate nga Jerusalemi bashkë me nxënësit e vet të Sanhredinit. E mësyni tendën e gjeneralit roman, Titi, njëzet kilometra larg Jerusalemit.

Në pergamenën e gjeneralit Titi shënon vagëllt: "Nga shkretëtira e Sinajit, drejt Jerusalemit, u vërsul shtjella e vrevët myslimane me zërin e vuvët të zikrit: "Allah!Allah!".

Gjenerali roman, Titi u hodh në sulm drejt mureve të Jerus - alemit para se të arrijë shtjella myslimane me atë buçimën e vuvët nga barku: "Allah!Allah!". Kuajt e ushtrisë së gjeneralit roman nxorën shkumë nga goja.Ushtarët u ngulfaten nën parzmoret e çelikëta.Por muret e Jerusalemit të duken askund. Nëp-

ër shtjellën e vrevët e rroku amoku i vrapimit gjeneralin roman, Titi. Mësyni drejt mureve të Jerusalemit.

Në pergamenë diç serish u ngatërrua. U fshinë shkrimet gjatë amokut të gjeneralit Titi. Pastaj pergamena u restaurua.

Gjenerali askund t'i shohë muret e Jerusalemit derisa e kapercei ujin e ftohtë të lumit.Ndaloi. Qyteti po kallej.Flaka e lëpinte qiellën metalike. I nguliti tendat vetëm dhjetë kilometra larg qytetit të përflakur.

"Ushtarët e mi e dogjën Jerusalemin"- u ngazëllye gjenerali Titi.

Në këtë ngazëllim të gjeneralit roman, Titi, ia çatisi Rabi Jochanan ben Sakai bashkë me nxënësit e vet të Sanhredinit. Gjenerali e priti në tendën e vet ushtarake dhe i tha përngutshëm: "Pse u ngute Rabi? Nesër do të kisha ardhë unë në Jerusalem".

"Ky qytet i cili po kallet këso nate na qenka Jerusalemi?"- e pyeti Rabi Jochanan ben Sakai vetë gjeneralin.

"Po! Ky është Jerusalemi. Ushtarët e mi të papërmbajtur e dogjën ende pa e marrë urdhrin tim"- sikur e çfajsua gjenerali.

"Ky qytet, sipas tabelës, para hyrjes, qenkësh qytet tjetër, jo Jerusalemi"- Rabi Jochanan ben sakai e shkundulloi gjeneralin roman.

"Cili qytet na qenka ky?"- u zgurdullua gjenerali.

"Ky qytet është në cep të të gjitha perandorive evroaziatike" - ia shpjegoi Rabi.

"Si mund të rrijë në cep të perandorive një qytet kur perandoritë parreshtur e kafshojnë njera-tjetrën"-u rrembye gjenerali.

"Në pergamenën hebreje thotë kështu gjeneral"- shpjegoi Rabi.

"Si shkruan në përgamenën hebreje? Kush e kalli këtë qytet në mos jo ushtria e lavdishme e Romës?"- u skërmit gjenerali.

“Në pergamenën hebreje shkruan se këtë qytet e kalli gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi”- ia shpjegoi Rabi.

“Përse e dogj qytetin ai rusi Kutozov?- u ngut gjenerali.

“Rusi Kutozov po e lyp një mitër në këtë qytet” - i foli me një zë tjetër Rabi.

“Një mitër?

“Po! Një mitër”

“Për një mitër të digjet një qytet?”-u serit gjenerali Titi.

“Po!Për në mitër”

“Si quhet ky qytet?”

“Jakovë”

“Rabi, atëherë le të quhet Jakova e Jerusalemit!”-i tha mospërfillshëm gjenerali roman Rabi Jochanan ben Sakait.

Ashtu edhe mbeti në atë pergamenë të turbullt nga lagështia”-gjenerali amerikan,John Harkeri,ia shpjegoi Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatan nga Massachusettsi.

“Në këtë Jakovë të Jerusalemit po shkojmë sonte, i dashur?”- u zhgreh në pyetje Pocahontas.

“Po, e dashur”

“Atje do të mbahet takimi i paktit Veriatlantik?”

“Po, e dashur”

“Ende gjenerali Kutozov e djeg atë qytet ?”

“Po, e dashur”

“Për atë mitër?”

“Po, e dashur”

“Edhe Amerika do të përzihet në këtë mitër?”

“Po, e dashur. Ju e dini se ç’duhet bërë, sonte pas dy orësh në klinikën “Gemeli”të Romës”

“E di, i dashur. Në klinikën “Gemeli” të Romës do të çelet mitra hebreje e Rebekës së Alamekut. Pas një ore do të çelet mitra e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, të shoqes se Rainhard von Grainhelmit të tretë, trashëgimtarit t fronit mbretëror të Bohemisë”- u galdua Indigjenia iroki, Pocahontas Powhatani e Massachusettsit.

“Po, e dashur”

“Nga këto mitra, sonte atje te klinika”Gemeli”e Romës a do të mjaftojnë për gjithë Evropën: seks, orgazëm, dashuri?”

“Po, e dashur”

Pocahontas Powhatan ia shpërlau bebëzat e syve me shikimin e saj të veshtullt nga lotët. Me Himnin Iroki të Massachusettsit, arriti ta kthejë gjeneralin amerikan në vetveten e Amerikës. Ajo, vuvshëm, me mishin e mishit femëror, ia derdhi në zemër gjeneralit amerikan Himnin Iroki të Massachusettsit:

“Qumësht i tre qumështave- gjirit tim.
Mishin Iroki- përtej seksit
Unë- grishtarja e Irokit-
Qumësht në orgazëm
Penisët, testiset- shkoqur Irokit.
Gjaku- tehut të orgazmës prostitutë
Iroki im- o Iroki im.
Nëpër të urisë- kujë trokiti.
Në derë të ëndrrës- klitoriti.
U deh qumështash- Bizoneshe- Misri.
- Gjirit tim qumështak- Iroki.
Pubisit hyra unë në mua.
Penisi jashtëbibilik- orgazëm
- Dashuri.
Iroki im- o Iroki im.

6.

"Pse po qan e dashur?"- pyeti John Harkeri.

"Sepse unë i mbëltova në ty: Orgazmën, Dashurinë, seksin, përmes tre qumështave jashëtbiblikë:përmes Qumështit të Misrit, përmes Qumështit të Bizoneshës, përmes Qumështit te gjirit tim- të Indigjenes Iroki të Massachusettsit.

Pas katër orësh, në takimin e Këshillit të Lartë të NATO-s, do të biesh ndesh me zotat e masturbimit evropian. Ja shiko se ç'shkruan sonte në "New York Times" për atë vaksinën e zbuluar nga doktori Grüber Sontag në laboratorin e OSCE-së, të ngrehur përkohësisht.

Doktori Grüber, doktori Lipman Smith dhe doktori Kloth Durante e zbuluan në këtë laborator te OSCE-së vaksinën kun-

dër Orgazmës, kundër Dashurisë kundër seksit. Shikoje, i dashur se ç'shkruan në "New York Times": "Sonte gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, në atë farë qyteti te Jakovës së Jerusalemit zhbiroi nëpër mitrat e grave për ta zbuluar spermën e atij ushtarit të arratisur... Redalk san Heldikut"- ankoi Indigjenia Pocahontas

"Po ai gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, a do t'i hapë të gjitha mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit?"- e pyeti John Harkeri provokueshën të dashurën e vet, Pocahontas Powhatanin.

"Siç shkruan "New York Times"të gjitha mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit do t'i hapë ai gjenerali rus, derisa ta gjejë Mitrën e ngjizur të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, të shoqes së Rainhard von Grainhelmit të tretë, trashëgimtarit të kurorës mbretërorë të Bohemisë"- iu përgjigj Indigjenia Iroki e Massachusettsit provokimit të John Harkerit.

-"Ti, i dashuri im, e di më mirë se unë por, zemra ma thotë mua të ta them ty, siç thotë gazeta, se sonte, pikërisht sonte, kryeministri turk Turgut Kuturler e urdhëroi gjeneralin Gyner Jyllmaz, bashkë me ambasadorin e Austrisë në Stamboll, t'ia sjellë në Jakovën e Jerusalemit, atij gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit, llurbën e mishit mashkullor, testiset dhe penisin e rektorit të Jakovës së Jerusalemit- Redalk San Heldikut.

Siç e sheh, i dashuri im, në "New York Times" shkruan qartë se llurbat e testiseve dhe e penisit i duhen doktorit Makushev të gjeneralit rus, atje në Jakovën e Jerusalemit, për ta bërë testimin e spermës së rektorit. Se a ka mundur të mbesë shtatzënë nga këto testise Sofia e Jakovës së Jerusalemit atë natë ne tendën e Zatres Arameje.

Kjo Sofia me ngjet pikë për pikë në vetveten time kur mishi i mashkullit arriti deri tek Orgazma, deri tek Dashuria deri tek seksi. Qonquistadorët evropianë: doktori Grüber, doktori Lipman, doktor Kloth Durante e, mbi të gjithë Doktori Makushev,

më përngjajnë në qonquistadorët e Sant Luisit”-u revoltua Pocahontas Powhatan nga Iroki i Massachusettsit.

“Ke të drejtë, e dashura ime, vërtet janë të njëjtë kur sfidojnë kundër orgazmës, kundër dashurisë kundër seksit. Me të drejtë, e dashura ime, të brengosë deri tek loti në cepin e syrit tënd të bukur, ngjashmëria e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit me vetveten tënde. Ti i pate katër vëllezër e, i humbe. Qonquistadorët misionarë t’i shndërruan vëllezërit në mish të fishkur eunukësh. T’i tredhen. Sofia e Jakovës së Jerusalemit e lypi “vëllain” e saj përtej diagnozës së klinikës “Gemeli” të Romës. Në këtë diagnozë,për shëndetin e“Nënës”se saj pergamena shënon: “Sanguis lacertae in utero”- shpjegoi gjenerali amerikan duke ia puthur të dy sytë Indigjenes Iroki.

“Me këtë diagnozë privohet përfundimisht shtatzënia”-u përgjigj, e përlotur, Pocahontas.

“E vërtetë, e dashur”

“E diti këtë degjenerim shtatzënie Rabi Jochanan ben Sakai, kur Sofisë, atje tek shkretëtira e Negevit, ia tha diagnozën e klinikës “Gemeli”. Kjo diagnozë tregon prishje te kodit gjenetik. Rabi Jochanan ben Sakai ka qenë dashur t’ia shpjegojë Sofisë”- ankoi dënesshëm Pocahontas.

“Rabi Jochanan ben Sakai, e dashur, e zgjodhi rrugën tjetër, krejt tjetër, për Sofinë . E zgjodhi rrugën e jetës duke e nxjerrë përgjithmonë nga lajthimi i përrallës evropiane. E mori me vete Sofinë, përgjatë shkretëtirës së Negevit, nëpër shtjellën e vrevët myslimane e cila erdhi aq papritur nga Sinaji: “Allah!Allah!” dhe e shpuri deri tek tenda e Zatres Arameje.

“Hyr brenda në tendë- i tha. - “Shtriju mbi shtatin lakuriq të ushtarit të arratisur! Bjer mbi shtatin e rektorit të Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldikut deri sa t’i ndjesh në veten tende:orgazmën,dashurinë,seksin përmes mishit të tij mashkulor.Pastaj rruga të shpie vetë andej kah shpëtimi- “i foli John Harkeri duke ia ledhatuar sytë e përlotur Indigjenes Pocahontas.

Kur Sofia e kthei shikimin kah Rabi Jochanan ben Sakai, ai ishte bërë i vagëllt, pastaj i vdirë. Tashmë po e bënte rrugën e Shtatëmbëdhjetë minutave hebreje të Izraelit"- Ai tashme po rrugëtisej nëpër mitrën e Rebekës së Alamekut".

"A hyri Sofia në tendën e Zatres Arameje "- ngulmoi ta pyesë Pocahontas të dashurin e vet John Harkerin.

"Po! Pasi e qortoi sërish Rabi Jochanan ben Sakai: "Hyr në tendën e Zatres së Aramejeve! Shtriju mbi penisin e ushtarit të arratisur, të rektorit të Jakovës së Jerusalemit! Mësoje ç'është Orgazma, ç'është Dashuria ç'është seksi! Tashmë je bërë grua me klitorit te ndezur. Mos e bjerr kohën pas Diagnozës boshe "Sanguis lacertae in utero" të klinikes "Gemeli" të Romës! Mos e bjerr kohën kot pas "Nënës" sate!"- e urdhëroi Rabi Jochanan ben Sakai"- ia shpjegoi për të dytën herë John Harkeri Indigjenes Iroki të Massachusettsit.

-"Sofia e Jakovës së Jerusalemit hyri në tendën e Zatres Arameje. Ra mbi penisin e ushtarit të arratisur Radalk san Heldikut. Mishi i tij mashkullor hyri, hell i nxehtë në mishin e saj femëror deri tek Orgazma, deri tek Dashuria nëpër seksin e mitrës"-ia gudulisi hundën John Harkeri të dashurës së vet Pocahontas Powhatan.

"Sonte, pas dy orësh në klinikën "Gemeli" të Romës, Rebeka e Alamekut prej fshati Abbi të Galiles dhe Sofia Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Grainhelmit të Bohemisë, nga ndërhyrjet cezareske të konsiliumit mjeksor amerikan në mitrat e tyre do t'i lindin foshnjat e para vagjinale, të Orgazmës, të Dashurisë, të seksit po shkruajnë pergamenat nëpër Evropë.

Në çastin e parë të jetës foshnjave do t'u hedhen në gojë nga tri pika Qumësht jashtëbiblik. Do t'u hedhet qumësht misri, qumësht jashtëbiblik bizoneshe,qumësht jashtëbiblik të gjirit Iroki nga Massachusettsi.

Do t'i sfidojmë, do t'i mundim qonquistadorët e Sant Luisit evropian. Për këtë, i dashur, unë erdha tek klinika "Gemeli" e

Romës. Pas katër orësh, vetëm pas katër orësh, ti, i dashuri im, në takimin e Këshillit të lartë të NATO-s me këto tri lloje të qumështave nga Massachusettsi do ta sfidosh, do ta mundësh vaksinën antiorgazëm, antidashuri, antiseks, të qonquistadorëve: Grüber Sontag, Kloth Durant, Lipman Smith të laboratorit të OSCE-së.”- shpërtheu entuziazshëm Pocahontas Powhatan, Iroki nga Massachusettsi.

“Laj duart, e dashur! E sheh se i ke bërë me mitrat atyre dy grave. U bëre mamia e foshnjave të para të orgazmës, të Dashurisë të seksit në Evropë.

I sfidove. I munde qonquistadoret e Sant Luisit”- e përfundoi John Harkeri duke ia gudulisur hundën Pocahontas Powhatanit.

U bë errësirë në avionin ushtarak.

Ra alarmi.

Tri llojet e Qumështit jashtëbiblikë të Massachusettsit po zbarkonin në Siçili.

Evropa e ngrysur, u mpi në tre mishrat e fishkur të perëndive të etura.

7.

Tri here u mat te bije shi mbi tendën e gjeneralit roman Titi, komandantit të përgjithshëm të krahut lindor të ushtrisë perandorake të Romës,kur i thanë se Rabi Jochanan ben Sakai, Rektori i dy universiteteve të Izraelit, po lyp audiencë përngutshëm në atë kohë të vonë të natës.

"Në këtë kohë të natës të lypë audiencë Rektori i dy universiteteve te Izraelit"- u serit gjenerali i ushtrisë romane, Titi.

"Po zotëri, pikërisht ai"- u përgjigj ordinanca.

"Atëherë i thua le të hyje"-urdhëroi gjenerali Titi.

Hyri një burrë i gjate, thatanik, me energji brerore në sy. Ishte i lodhur nga rrugëtimi. Në rroba i dallohej qartë pluhuri i hkretëtirës së Negevit. Ishte Rektori i dy universiteteve te Izra -

elit-Rabi Jechan ben Sakai.

“Hirësi do t`u ketë tunduar çështje madhore të merrni rrugë në këtë kohë nate deri tek kjo tendë e varfër”- i tha gjenerali, Titi duke u ngritur në këmbë.

“Po eminenca juaj!Shtjella e vrevët e Sinajit u paska hedhë kaq larg nga Jerusalemi. Më është dashur të bëj rrugë gjysmën e botës për të arritur deri në këtë tendë të nderuar”- u përgjigj plot reverancë Rabi Jochanan ben Sakai.

“Rrugë e pabesë hirësi. Ushtarët e mi të rrëmbyer nga afshi i luftës e dogjën Jerusalemin ende pa e marrë urdhrin zyrtar”- deshi të çfajsohet gjenerali.

“Sikur ta kishin djegur ushtarët Tuaj Jerusalemin do te kishte qenë më mire se ç`e gjet atë qytet”- Rabi Jochanan ben Sakai e befasoi gjeneralin roman.

“E patë flakën e qytetit të kallur hirësia juaj”-e pyeti gjenerali.

“Për juve, gjeneralët, mjafton te kallet një qytet. Ju gjeneral i nderuar e keni gabuar qytetin. Jerusalemi është humbur ne shtjellën vrevët të Sinajit nën buçimën e vuvët myslimane: “Allah!Allah!”- ankoi lektisshëm Rabi Jochanan ben Sakai.

“Atëherë cili qytet na qenka ky i përflakuri përtej lumit”- shashtisshëm e pyeti gjenerali.

“Në tabelën shënjuese tek hyrja e qytetit shënon qarte në të dy gjuhet: “Jakova”. Unë vetëm njërin emër arrita ta lexoj. Atë emrin e dytë, të shkruare në një gjuhë tjetër, e pata të pamundur.”- u përgjigj Rabi Jochanan ben Sakai.

“Po cili e dogj këtë qytet në mos jo ushtria ime!?- u rrëmbye gjenerali roman, Titi.

“Gjeneral i nderuar këtë qytet të Jakovës, ende po e kallë gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi”- Rabi e befasoi gjeneralin roman.

“Ç`kërkon ky gjenerali rus në këtë qytet?- paksa i nevrikosur, e pyeti Rabi Jochanan ben Sakain gjenerali roman.

“E lyp Mitrën e një gruaje.”- u përgjigj Rabi.

“Cila grua do të jetë aq noprane sa të kallet një qytet vetëm për të?”- nxitoi paksa me ironi gjenerali roman.

“Po! Bile shumë është noprane. Ajo grua arriti deri në tokën e Aramejeve, deri tek tenda e Zatres Arameje. Brenda tendës ra mbi mishin e teptisur mashkullor të Redalk San Heldikut, Rektorit të këtij qyteti. Ky rektor ishte arratisur nga ushtria osmane”- shpjegoi Rabi Jochanan ben Sakai.

“Kësaj gruaje i paska ndodhë, siç po shkruajnë pergamenat njëjt me atë Pocahontasin Iroki të Massachusettsit”- u tremb gjenerali roman.

“Pikpërpikë, eminencë”-u përgjigj pavullnetshëm Rabi.

“Mund ta kemi lexuar nëpër gazeta, hirësi se edhe ajo Sofia e atij gjermanit Rainhard do të ketë mbetur shtatzënë me orgazëm me seks, me dashuri në atë tendën e mallkuar të asaj Zatres Arameje”- u tendos paksa gjenerali, Titi.

“E kam lexuar”.

“Po ju Rabi i nderuar a keni zgjedhë ndonjë rrugë për vetveten tuaj?”- hyri drejtë ne çështje gjenerali roman, Titi.

“E kame zgjedhë, eminenca juaj”- u përgjigj ndrojtshëm Rabi Jochanan ben Sakai.

“Mbase keni zgjedhë rrugë tjetër nga se ç`e zgjodhën Rabinët e Tribalit të Madh të Izraelit?”- iu rrek asaj rruge gjenerali Titi.

“Po, eminenca juaj! Vërtete kam zgjedh rrugë tjetër nga ajo e Rabinëve te Tribalit te Madh. Pikërisht edhe për atë çështje, mezi e kam kapur, në çastin e fundit, këtë tendë tuajën të nderuar”- e zvargu zërin Rabi Jochanan ben Sakai.

“Pse u ngutet Rabi i nderuar?Nesër, qe menatë, do t`ja kisha çatisur atje në Jerusalem”- u rrëmbye gjenerali roman, Titi.

“Nesër, eminenca juaj, do te bëhej vonë, tepër vonë. Secilit prej nesh i është bërë e pamundur ta gjejë Jerusalemin e sharruar thellë në atë shtjellën e vrevët nga Sinaji me atë buçimën e vuvët myslimane: “Allah!Allah!”- e përmendi Rabi nga ajo krenaria fodulle gjeneralin roman Titi.

“Po ju e patë sonte Jerusalemin se si e kallën ushtarët e mi të rrëmbyer nga lavdia e fitores?”- ra përsëri në lajthim gjenerali.

“Ju, eminencë sërish po e ngatërroni Jerusalemin me Jakovën e gjeneralit rus Ivan Vasiljeviq Kutozovit”- e trandi duke u përpjekur ta sjellë ne vete gjeneralin.

“Sidoqoftë le të mbetet Jakova e Jerusalemit”- nguli këmbë gjenerali me krenarinë e atavizmit ushtarak.

Rabi Jochanan ben Sakai heshti. Gjenerali roman ishte zënë midis këtyre dy qyteteve, midis kësaj katrahure të shtjellës së vrevët myslimane.

Edhe gjenerali heshti për një çast, aqsa iu desh ta rregullojë zërin në oktavën diplomatike, siç i shkonte, sipas rregullës ushtarake një gjenerali të lavdishëm të perandorisë së Romës.

“Ju Rabi i nderuar, rektor i dy universiteteve të Izraelit, e keni marrë mundimin te vini, sonte, në këtë kohë të pabesë, nëpër këto rrugë të mbushura me prita kusarësh, nëpër këtë vend të paligje, për të arritur deri tek kjo tendë e varfër e një gjenerali të përvuajtur të perandorisë së Romës. Diç e madhe u ka tunduar ta veni kokën në trastë nëpër këto rrugë të befta pabesise. Ne, Rabi i hirësuar, sonte do të jemi në shërbimin tuaj për cilëndo rrugë që ju do ta konsideroni favor për vete”- i prini gjenerali roman duke pasur kujdes zërin e vet diplomatik.

“Gjeneral i nderuar i perandorisë së lavdishme të Romës , shpëtimtare të botës, pikërisht për atë çështje time të varfër ia kam çatisë në tendën tuaj të nderuar. Rahila e Ahabit nga Sidra e Sidonit me refuzoi përbuzshëm. Ndodhi ajo tjetra. Rebeka e

Alamekut nga fshati Abbi i Galilesë doli me favorin e zemrës se vet. Vendosi të ma dhurojë mitrën e saj të mbushulluar jetë të brerorët”- ndodhi të flasë Rabi Jochanan ben Sakai me zërin e rregulluar midis diplomacisë dhe intimitetit të dy miqve.

Gjenerali roman, Titi e pranoi favorin e Rabi Jochanan ben Sakait. Ai heshti duke e mëtuar Rabinin ta vazhdojë diskursin e zënë. Rabi e kuptoi se gjenerali vendosi të tregohet kalorës i favoreve të grave e të të varfërve.

Priti paksa. Ajri i tendës se gjeneralit duhej pritur derisa të mbushullohet me dramacitet. E dinte se vaktësia qiellzën e gojës e mashtron.Gjeneralët kudo qofshin, lektisin për dramacitet. Ai ua kujton luftën,fitoret,lavditë,rreziqet, pa të cilat gjeneralët as e marrin me mend jetën. Ajri i tendës së gjeneralit po i bënte favore Rabinit. Andaj duhej nuhatur me vëmendje; duhej pritur çastin e shpërthimit. Rabi e nuhati në ajrin e tendës atë favorin në krenarinë ushtarake të gjeneralit. Ra në heshtjen më dramatike të njeriut të përvuajtur. Tashmë Rabis po i printe favori i Rebekes së Alamekut, favori i një gruaje të re, një gruaje të fuqishme.

Ajri i tendës u mbushullua dramcitet deri në padurueshmeri për gjeneralin roman, Titi. Aty edhe po priste me durim Rabi Jochanan ben Sakai.

“Hirësia juaj, Rabi i nderuar, me gjasë e keni zgjedhë rrugën më të palavdishme. A s’ju duket edhe juve, Rabi i nderuar, se Mitra e gruas së re, siç e tregojnë atë Rebeken e Alamekut, është rrugë e padenjë për Rektorin e dy universiteteve të Izraelit?”- shpërtheu dramatikisht gjenerali roman, ashtu edhe siç e priste Rabi Jochanan ben Sakai.

“Gjeneral i nderuar, lavdi e perandorisë së Romës, rrugën e Mitrës jo se e zgjodha unë për vetveten time. Atë rrugë ma caktoi Tribali i Madh i Jerusalemit. Ai Tribal për mua, Rektorin e dy universiteteve te Izraelit, e caktoi mitrën e Kones së Danielit, të birit të Sebastianit në vendin Abbi të Galiles. E caktoi

për dënimin më poshtërues”- ra në përgjërimin e heshtur, dramatik, Rabi Jochanan ben Sakai.

Gjenerali roman, Titi, e mbushulloi krenarinë e ushtarakut të vetvetes së vet. I duhej kjo mbushëllimë për t`ia dhënë favoret më të larta, më kalorësiake, Rabinit të përdëlluar. Sërish u bë heshtje dramatike në ajrin e tendës së gjeneralit roman.

“Përse Tribali i Madh i Izraelit e zgjodhi mitrën e Kones së Danielit, të birit të Sebastianit, për rektorin e dy universiteteve të Izraelit?”- aktroi gjenerali roman sikur të mos e dinte.

“Pikërisht pse unë, sonte, e zura rrugën e cila të shpie deri tek kjo tendë, o gjeneral i lavdisë së Romës”- sërish ra në përgjërim dramatik Rabi Jochanan ben Sakai.

“Sigurisht Tribali i nderuar i Izraelit rrugën tuaj deri tek kjo tendë e e varfër e ka shpallë rrugë të tradhtisë, rrugë te mohimit”- gjithnjë gjenerali i printe Rabi Jochanan ben Sakait; ia hapte rrugën e bisedës.

“E keni goditur mu në te, me syrin e mpreht të gjeneralit strateg. Për ta dëshmuar para jush kam ardhë. Kam hequr dorë nga të gjitha favoret Izraelite: nga titulli i Rektorit të të dy universiteteve të Izraelit, nga hierarkia ushtarake, nga tempujt, nga të gjitha privilegjet izraelite. Kam ardhë deri tek kjo tendë e nderuar, tek ju gjeneral i lavdishëm,t’i përgjërohem Romës perandorake, titullit Tuaj të lartë ushtarak, të ma jepni liçencën për hapjen e një universiteti Hebre ne Diasporë,kudo jashtë Izraelit”- ra në fashitje Rabi Jochanan ben Sakai pas mundimit për ta thënë gjithë atë diskurs panigjerik.

Gjenerali Roman, Titi, u mvrejt, u sikletis, i krekosur, duke u përpjekur ta aktrojë sa më bindshëm njeriun e rënë në vorbullën e brengës.

Për një çast Rabi Jochanan ben Sakai u tremb nga mvrejtja e gjeneralit roman. Vendosi të heshtë. Çdo fjalë tjetër do ta dëmtonte diskursin e tij, të thënë me aq mund.

“Rabi i hirësuar, Ju mund ta keni lexuar pergamenën “The New York Times” se ç`bëri gjenerali John Harkeri me atë Indigjenen Iroki te Massachusettsitt?”- e pyeti gjenerali roman.

“Po, e kam lexuar emineca juaj”-u përgjigj prerazi Rabi.

“Edhe ai gjenerali, John Harkeri, e mohoi të gjithë trashëgiminë evropiane vetëm për një Orgazëm, për një Dashuri, për një klitorit, për një sy vagjine të Massachusettsit. Punë e padenjë për një gjeneral” - njëmendësia e hidhërimit, këtë herë ra në fytyrën e gjeneralit roman.

Rabi Jochanan ben Sakai të gjitha i paskesh shqyrtuar më parë;atij i duhej një universitet diku në Diasporë. I duhej ta shpëtojë Kodin hebre; të mos vdiste në Shtjellën vuvët myslimane “Allah! Allah!”; të mos vdiste nën Shtjellën e vrevë të antisionizmit evropian.

“Sërish e ke zgjedhë rrugën e Jakobit- Izrael për ta themeluar universitetin tënd hebre ne Diasporë?” - e ndërroi bisedën me hijeshi diplomatike gjenerali.

Rabi Jochanan ben Sakai u gëzua nga kjo ndërresë kaheje e bisedës.

Pjesa më e vështirë qenkesh berë. Vetë pyetja e gjeneralit, sado diplomatike, e arsyetoi pandehjen e Rabi Jochanan ben Sakait.

“Këtë herë kam vendosur t’i bije rrugës tjetër. Andej kah rruga e Jakobit-Izrael ka rënë shtjellë e një perëndie hidhërake hamite, e rrezikshme edhe për Romën tënde perandorake. Këtë herë kam vendosur të vej drejtë Evropës derisa t’i dert “Shtatëmbëdhjetë minutat” hebreje në Mitrën e Rebekes së Alamekut”- u përgjigj ekuivokisht Rabi.

“A mendoni t’i arrini Orgazmën, Dashurinë, seksin, rrugës deri tek Mitra e Rebekes së Alamekut siç bëri ai gjenerali shtiak, John Harkeri, nëpër vagjinën e asaj Indigjenes Iroki të Massachusettsit?”- serish u rrëmbye gjenerali evropian, këtë herë i fyer në krenarinë ushtarake.

“Gjeneral i nderuar, mua më kanë mbetur vetëm dy rrugë: ose të varroseem i gjallë në mitrën e kudres se Danielit ose të dertem në mitrën e Rebekes së Alamekut gjatë Shtatëmbëdhjetë minutave hebreje”- ankoi Rabi Jochanan ben Sakai.

“Juve, Rabi i nderuar, Ju ka dënuar Tribali i Madh i Izraelit për tradhti? Ju ka dënuar fyeshëm të tëhulleni në mitrën së konës së Danielit. Dhe juve ky dënim ju fyen?”-u ngut gjenerali.

“Po gjeneral i nderuar, bile edhe më shumë”.

“Atëherë, Rabi i nderuar, përse i shmangeni luftës kundër Romës ju dhe nxënësit Tuaj të Sanhredinit?”- e provokoi gjenerali roman.

“Është tepër e qarte gjeneral i nderuar. Në të dy mënyrat e propozuara nga ju Izraeli do ta humbë luftën, do ta humbë, natyrisht, edhe Kodin gjenetik”- e shpalosi mendimin Rabi Jochanan ben Sakai.

“Sa do të zgjasin Shtatëmbëdhjetë minutat hebreje o Rabi i hirësuar?”- e pyeti gjenerali roman, këtë herë pa diplomaci.

“Këto Shtatëmbëdhjetë minutat hebreje,o gjeneral i nderuar, për juve do të zgjasin, as me pak as më shumë se, rrumbullakë Njëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë vjet”-Rabi Jochanan ben Sakai e habiti gjeneralin me ketë njehsim kohe.

“Me sa dëgjova unë, ju i përmendët Shtatëmbëdhjetë minutat hebreje?”-u rrokullis ne vetvete gjenerali.

“Po gjeneral i nderuar. Sakt e keni dëgjuar”.

“Si e llogaritni kohën ju hebrejt? Për vete Shtatëmbëdhjetë minuta, për Romën Njëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë vjet”- e pyeti gjenerali, ketë herë pa e kuptuar këtë llogaritje kohe.

“Shtatëmbëdhjetë minutat” hebreje zgjasin derisa unë, Rabi Jochanan ben Sakai, Rektori i dy universiteteve të Izraelit, të arrij nëpër syrin e vagjinës së Rebekes së Alamekut deri tek orgazma, deri tek Dashuria në Mitrën e saj”- ia shpjegoi Rabi.

“Si do ta quani, ndryshe, këtë rrugë?”- insistoi gjenerali roman.

“Kjo rrugë do të quhet dertja e Kodit hebre në orgazëm, në dashuri tek mitra e Rebekes së Alamekut”- e zbërtheu Rabi Jochanan ben Sakai.

“Atëherë, Rabi i nderuar, ne te dy po jetuakemi në dy kohë, krejt të ndryshme me njëra- tjetrën”- e humbi paksa toruan gjenerali roman.

“E saktë gjeneral i nderuar”.

“Kaq shumë vite të Romës zgjatka fekondimi hebre në mitrën e Rebekes së Alamekut”- u zhgënjye gjenerali roman nga ky numërim vitesh.- “Pastaj Ju, Rabi i nderuar, siç shkruan në pergamenë, në fund të Shtatëmbëdhjetë minutave te Orgazmës Suaj, prisni t’u nxjerrë nga mitra e Rebekes së Alamekut gjenerali amerikan, John Harkeri?”- u prirë gjenerali si për ta pyetur Rabi Jochanan ben Sakain.

Ajri dramatik i tendës u shtendos në një heshtje te plogët. Rabi e ndjeu këtë plogëti romane. Si duket gjenerali filloi t’i numrojë vitet jashtë vullnetit të Rabinit. Ai kishte vite të zdervaja nëpër pergamena ndërsa Rabi e maste kohën me shpejtësinë e Orgazmës hebreje,të orgazmës amerikane.Rabi deshi t’i shmanget përgjigjes mbi John Harkerin. Duhej gjetur një përgjigje tepër diplomatike.

“Gjeneral i nderuar nëpër gazeta shkruan çka t’ia dojë zogu i qejfit çdo gazetari ters”- iu duk më e mira përgjigje Rabinit.

“E keni bërë ndonjëherë më parë atë rrugë të orgazmës tuaj hebreje?”- pyeti papritmas gjenerali me ndjenjën e nxënësit të vonuar.

Rabi Jochanan ben Sakai u bë sikur u turpërua të flasë. Heshti diskretshëm për ta veneruar gjenerali.I dha të kuptojë se biseda po merrte kahe të gabuar.Heshtja hyri midis tyre me përvjedhje diplomatike. Gjenerali e pikasi gjendjen.

“Rabi i nderuar,ç`nevojë do të keni ju për një liçencë të vonuar kaq vite nëpër pergamenat e Romës kur ju po udhëtueki me shpejtësinë e orgazmës”- gjenerali e preku fundin e bisedës. - “Pastaj ai gjenerali Juaj, John Harkeri bashkë me atë Indigjenen Irokit të Massachusettsit do të zbarkojnë sonte në Siçili. Edhe ata të dy udhëtojnë me shpejtsinë e Orgazmës, me shpejtësinë e Dashurisë së Shtatëmbëdhjetë minutave amerikane”- u vërejt një lloj fyerjeje në zërin e gjeneralit.

Rabi Jochanan ben Sakai e kuptoi se gjenerali Titi i kishte lexuar të gjitha të dhënat nëpër dosjet pergamena të shtatmadhorisë së tij por prej natës së zbarkimit të John Harkerit në Siçili ishte larg Njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet. Po aq larg do të qe edhe Rabi Jochanan ben Sakai sikur të mos kishte udhëtuar me shpejtësinë e Orgazmës hebreje nëpër syrin e vagjinës së Rebekes së Alamekut.

Atë natë kur doli ose,kur u arratis nga Jerusalemi drejt tendës se gjeneralit roman, qe nata e dytë e shtatorit kur Jezusi duhej t’i kishte vetëm shtatëdhjetë vjet.Po atë natë Tribali i Madh i Jerusalemit e dënoi Rabi Jochanan ben Sakain me varrosje për së gjalli në mitrën e Kones së Danielit. Urdhri u bë i qartë, i zbatueshëm: mitra e Kones së Danielit do të hapej në klinikën “Gemeli” të Romës sikur të qe fjala për një grua, e jo për një kafshë.

Rabi Jochanan ben Sakai e kuptoi se duhej shkuar deri në fund të bisedës me gjeneralin roman. E ndjeu qartë se Shtatëmbëdhjetë minutat e Orgazmës hebreje po soseshin. Duhej ngutur.

“Gjeneral i lavdishëm i Romës perandorake, natën e dytë të shtatorit, kur Jezusi i mbushi shtatëdhjetë vjet ne të dy e patëm te njëjtën moshë, të njëjtën kohë. Unë u arratisa nga Jerusalemi drejt tendës suaj të nderuar për liçencën e universitetit hebre në Diasporë. Ma patet aprovuar apo do të ma aprovoni e keni dik-

und turbull të shkruar në pergamenë. Edhe sonte më duhet ajo liçencë”- i ra në fund bisedës.

Gjenerali ra në fund të një ëndrre të turbullt, ra në një pergamenë të resur nëpër shumë vende. Nga atje thellë, zvargshëm, iu drejtua Rabi Jochanan ben Sakait:

“Sonte me avionin e orës dy pas mesnate udhëto për në Romë. Liçencën për universitetin hebre në Diasporë e ke gati qe atë natën e dytë të shtatorit të vitit Shtatëdhjetë. Është shënuar në pergamenë”.

U ndanë tek dera e tendës.Gjenerali mbeti në kohën e zdervajë nëpër pergamenat e resura e,Jochanan ben Sakai po udhëtonte nëpër orgazmën e Rebekes së Alamekut.

Ende pa u përshëndetur tek dera e tendës, gjenerali dhe Rabini i panë dritat e makinave duke e kaluar lumin e Jakovës së Jerusalemit. Gjenerali roman përngutshëm iu drejtua Rabinit:

“Rabi i hirësuar, Delegacioni i Tribalit të Madh të Izraelit ka kërkuar audiencë,sonte tek unë.Ja ku u shfaqen dritat e makinave të Delegacionit të Tribalit. Veçsa po e kalojnë lumin. Ne do të përshëndetemi këtu. Paç fat të mbarë në Romë!”

Gjenerali roman dhe Rabi Jochanan ben Sakai u shkëputën nga njëri-tjetri. Secili u rrokullis në vetveten e vet , në kohën e vet, në shpejtësinë e vet.

Zjarri flakadan ende me gjuhën e përdalë po e lëpinte qiellin metalik të Jakovës se Jerusalemit.

“A mund të jenë të sakta të gjitha te dhënat e Rabi Jochanan ben Sakait se e paskam gabuar Jerusalemin duke e bërë njësh me ketë qytet të Jakovës?

A mund të dalë e vërtetë se një gjeneral i Romës perandorake ta këtë bashkuar, të këtë bërë aleancë me një gjeneral rus, në një zjarr të Jakovës së Jerusalemit?”-i foli vetvetes së vet.

Gjenerali roman, Titi, u fut në tendë.

8.

Sipas protokollit, gjeneralit roman të krahut lindor të ushtrisë perandorake,ia sollën listën me emrat e tre anëtarëve të delegacionit të Tribalit të Madh të Izraelit.Ishin ata të tre: Rabi Shalomë ben Kaifa, prokuratori i parë i Senatit të të dy universiteteve të Izraelit, Absalem ben Heten, administrator i përgjithshëm i te dy univerziteteve.Në fund, Jakobi i urtë, interpretatori besnik i Toros dhe redaktor i të dy bibliotekave të universiteteve të Izraelit.

Qenë emra të njohur për gjeneralin roman; të rëndë në ndërgjegjen e tij.

Sekretari hyri rrëmbimthi në kabinetin e gjeneralit Titi. I tregoi se Delegacioni i Tribali të Madh të Jerusalemit po e priste në rezidencën e shtabit ushtarak.

Në rezidencën e shtabit, gjenerali vërejti se ajri qenkësh rënduar. Të gjitha mobilet e drunjta qenë lakuar nën peshën e atij ajri.

U përshëndetën midis tyre përtej protokolit. Në rrobën e Rabi Shalomë ben Kaifës ende po i kapej pluhuri i shkretëtirës. Shihej qartë se kishin udhëtuar gjatë, shumë gjatë nëpër rërë. Në fytyrat e tyre shihej koha e pjekur,e harruar në furrën e nxehtë të shkretëtirës së Negevit.

"Shumë larg na nxjerri rruga gjeneral i nderuar. Kemi udhëtuar gjatë për të arritur deri tek tenda Juaj e nderuar"- çeli kuvend Rabi Shalomë Kaifa me një zë të ngjirur, të tharë nga koha e pjekur dhe nga pluhuri i shkretëtirës.

"Shtjella e vrevët myslimane na i ngatërroi paksa rrugët drejt Jerusalemit.Pse e morët mundimin të vini deri tek kjo tendë e varfër? Rabi i nderuar, nesër unë do të kisha ardhë në Jerusalem. Atje ka qenë duhur të më prisni"-foli dykuptimshëm gjenerali roman.

"Ne të pritem gjeneral i nderuar sepse kishim vendosur të të prisnim"- po aq dykuptimisht iu përgjigj Rabi ben Kaifa.

"Mbase unë jam vonuar por ushtria ime, e rrëmbyer nga lavdia e betejave gjithmonë të fituara, u lëshua mbi Jerusalem. Dhe, sipas flakës, e cila duket nga këtej, më bëhet se ushtarët e mi mund ta kenë tejkaluar detyrën sipas rregullave të luftës"- u përpoq të dukej i sjellshëm gjenerali roman.

"Ushtria juaj, gjeneral i nderuar, kurrë të arrijë në Jersualem. Ajo ushtri e rënë në amokun e vuvët të orgazmës së atij Rabi Jochanan ben Sakait, kaloi e përhumbur pranë mureve të Jerusalemit, drejt shkretëtirës"-e dëshpëroi gjeneralin zëri i ngjirur i Rabi Shalomë ben Kaifës.

"Rabi i nderuar, ju ende doni të thoni se ushtria romane kaloi pranë mureve të Jerusalemit, ashtu e vuvët, e mbytur në orgazmën e Rabi Jochanan ben Sakait, pa e sulmuar Jerusal-

emin. Rabi i nderuar, po patët sy paksa, pa pluhur shkretëtire, shikojeni flakën e Jerusalemit! Mund ta shihni edhe nga këtu. Nga kjo tendë ka vetëm dhjetë kilometra larg Jerusalemit"- u rrëmbye gjenerali roman, Titi.

"Ju gaboni, gjeneral i lavdishëm. Po qe se ju duhet fama e huaj, ja ku e keni në këtë qytet, të cilin, ju, e merrni për Jerusalem. Po qe se ju duhet fama e gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit, atëherë ja ku e keni në këtë qytet të Jakovës"- i foli mjaft rëndë Rabi Shalomë ben Kaifa.

"Po qe se ky qytet, të cilin e kalli ushtria e gjeneralit Titi, na qenka Jakova, qytet krejt tjetër nga Jerusalemi, atëherë përse ju, Rabi i nderuar, e morët mundimin të ja çatisni në këtë tendë të varfër? Doni ta shpëtoni një qytet tjetër nga Jerusalemi? "- e pyeti gjenerali me mllef të dukshëm në zë.

"Ne kemi ardhë të të përgjërojmë vetëm për një gjë: të mos e pranosh kërkesën e Rabi Jochanan ben Sakait; të mos e pranoni as ju gjeneral, as Roma, zbatimin e një universiteti në Diasporë,jashtë Izraelit.Të mos e bojkotoni, gjeneral i nderuar, dënimin meritor të shpallur mbi kokën e Rabi Jochanan ben Sakait!"- foli prerazi Rabi Shalomë ben Kaifa me zërin e ngjirur, të pjekur nëpër shkretëtirë.

"Cili qenka dënimi i Tribalit të Madh të Jerusalemit mbi kokën e Rabi Jochanan ben Sakait?"- pyeti gjenerali, i shtirur sikur te mos dinte.

"Ju gjeneral i nderuar do ta mësoni, po të mos ua ketë përmendur ai Rabi i arratisur nga Jerusalemi, se dënimi mbi kokën e tij godet:Jochanan ben Sakai, rektori i dy univrsiteteve të Izraelit për tradhti ndaj atdheut të vet denohet nga Tribali i Madh i Jerusalemit të varroset i gjallë në mitrën e kones së Danielit, të birit të Sebastianit, në fshatin Abbi të Galiles" - e shpalli dënimin Rabi Shalomë ben Kaifa.

"Dënimi qenka fort i padenjë për rangun e një rabini. Ç`mund të gabojë një Rabi, siç është Rabi Jochanan ben Sakai,

për ta merituar këtë dënim të rëndë”-sërish gjenerali roman e ruajti të drejtën e rezervuar për vetveten sikur të mos dinte asgjë për këtë dënim.

Gjenerali e parashikoi zemërimin e Rabi Shalomë ben Kaifës.E parashikoi edhe mundësinë e daljes nga protokolli shtetëror i Romës.E pa teptisjen e Rabi Shalomë ben Kaifës, ngulmin e tij për ta marrë aprovimin e Romës, veçanërisht për ta zbatuar dënimin mbi kokën e Rabi jochanan ben Sakain.

E shikoi sekretarin e vet të heshtur, për aq kohë sa mund të bëhet kjo punë në këso rrethanash. U kuptuan midis tyre se duhej bërë kompromis me delegacionin e Tribalit të Madh të Jerusalemit. Gjenerali e paralajmëroi me shikim të mos reagojë në ndonjë çast të pavolitshëm.

“Juve, gjeneral i nderuar, mund të mos ua ketë thënë ai, Rabi Jochanan ben Sakai, se dënimin vërtet është i rëndë. Ai, Rabi Jochanan ben Sakai, ka urdhëtuar në Sidra të Sidonit tek e përshenjtruara Rahila e Ahabit t’ia lypur Mitrën e saj, vetëm e vetëm për të shpëtuar nga mitra e kones së Danielit…”- po fliste me pezëm të helmët Rabi Shalomë ben Kaifa kur i ndërhyri gjenerali:

“Po Rahila e shenjtëruar a ia dha Mitrën prej gruaje Ben Sakaiti?”

“Jo, gjeneral i nderuar, ajo e refuzoi dinjitetshëm”- u ngut poaq Rabi ben Kaifa.

“Ajo e kishte dëgjuar gjëmën shkundulluese në gjithë Izraelin: Rabi Jochanan ben Sakait e kishte blasfemuar Izraelin në tendën e gjeneralit roman, Titi duke e lypë një universitet hebre në diasporë”- i shkrepi fjalët Rabi Shalomë ben Kaifa.

U bë heshtje në tendë. Ajri i rënduar i lakoi edhe më të gjitha orenditë e rezidencës së gjeneralit roman. Nëpër ajër zbriti elektrizimi i konfliktit. Gjenerali ia hodhi një shikim teatral sekretarit të vet, një shikim qortues për ta parë të gjithë. Deshi

të thotë ende pa folë se ai, gjenerali vetë, të mos kishte dijeni për blasfeminë e Rabi Jochanan ben Sakait.

Abselem ben Heten, administrator i përgjithshëm i të dy universiteteve të Izraelit u tremb nga fjalët e Rabi Shalomë ben Kaifës. Kishte ardhë çasti të ndërhyje në bisedën e acaruar:

“Gjeneral i nderuar, audienca në tendën Tuaj na nderon sonte.Kjo tendë e Romës së lavdishme pret e përcjellë delegacione të ndryshme nga e gjithë perandoria edhe, më larg. Të gjitha delegacionet,për shkaqe teknike,mund të mos i pritni vetëm ju gjeneral, atë punë mund ta bëjë edhe personeli tjetër, i autorizuar për ketë gjë. Në shikimin Tuaj të nderuar u pa të mos e keni pritur në audiencë të rregulltë protokollare Rabi Jochanan ben Sakain. Atë mund ta ketë pritur ndokush i nivelit të ulet e,jo Ju zoti gjeneral”-i çeli rrugë, gjeneralit roman, administratori i përgjithshëm i të dy universiteteve të Izraelit, Abselem ben Heten në mënyrë diplomatike për ta mohuar takimin me Rabi Jochanan ben Sakain. Gjenerali e peshoi për një çast propozimin e tërthort të kryeadministratorit. E shikoi sekretarin e vet për ta marrë aprovimin e tij.

Gjatë diskursit të kryeadministratorit edhe Rabi Shalomë ben Kaifa e kishte ravizuar në kokën e vet kuvendin e mëtutjeshëm. Mbase temperamenti e kishte zbuluar për një çast tepër gufues.

Edhe,i shuar paksa nga zemërimi,e kuptoi rrugën e propozuar nga kryeadministratori Abselem ben Heten.

"Gjeneral i nderuar, gjërat shpeshherë ndodhin edhe pa dijeninë tonë, veçanërisht kur janë të padenja për rangun zyrtar"- e këputi shkurt kuvendin Rabi Shalomë ben Kaifa duke iu dhënë me kuptua të gjithëve se kuvendi e kishte marrë të mbarën drejt kompromisit.

“Po ç’mund të bëjë Roma për këtë çështje Tuajën Rabi i nderuar?” - pyeti solemnisht, në mënyrë përgjithësuese, gjen-

erali, pa iu drejtuar në mënyrë të veçantë ndokujt nga delegacioni i Tribalit të Madh.

"Roma e lavdishme, siç e përgjërojmë ne, duhet t'i refuzojë të dy kërkesat e Rabi Jochanan ben Sakait: kërkesën për themelimin e universitetit hebre në Diasporë dhe, kërkesën për ndërhyrjen kirurgjike në mitrën e Rebekes së Alamekut tek klinika "Gemeli" e vet Romës – decidivisht e rrahu çdo fjalë të veten Rabi Shalomë ben Kaifa.

U bë heshtje. Këtë herë u dëgjuan cijatjet e mobileve nën peshën e rëndë të ajrit në rezidencën e gjeneralit roman.

Gjenerali e pa të arsyeshme, t'i shmanget përgjigjes duke i rënë tërthorazi.

"Besoj se do të më kuptoni. Roma, jo nga kureshtja por nga detyra perandorake, po denjoi të merret me këtë çështje, gjithsesi duhet ta dijë se si hyri në pergamenën tuaj kjo Rebeka e Alamekut. Kush është kjo Rebeka e Alamekut dhe përse duhet të operohet në klinikën e Romës "Gemeli?"- pyeti gjenerali me një timbër diplomatik.

Anëtarët e delegacionit të Tribalit të Madh të Izraelit u shikuan ndër vete. Ata si duket e zgjodhën më të volitshmin për të folë. Kjo u vërtetua menjëherë.

"Gjeneral i nderuar, Rebeka e Alamekut, një grua e bukur nga Abbi i Galiles, si gjithë Izraeli kishte dëgjuar për blasfeminë e Rabi Jochanan ben Sakait,mikut tim të deridjeshëm. Rebeka kishte dëgjuar edhe për dënimin e Tribalit të Madh mbi kokën e Rabi Jochanan ben Sakait.Ajo paskesh dëgjuar edhe për refuzimin e Rahiles së Ahabit nga Sidra e Sidonit për t'ia dhënë mitrën e saj Rabi Jochanan ben Sakait. E nxitur nga Zatra Arameje, Rebeka vajti deri tek steli i kones së Danielit"- këputi kuvendin si qëllimisht Jakobi i urtë interpretatori i Toros, Redaktori i të dy bibliotekave të universiteteve të Izraelit.

Ajri në rezidencën e gjeneralit u çtendos paksa. Kuvendi mbeti havarda; gjithkund ngapak,askund krejt. Secili e pati vës-

htirë ta zë ndonjë fill për çelje kuvendi. Gjenerali vendosi t'i bëjë dum kësaj heshtjeje:

"Mos i bëri ndonjë të keqe Rebeka e Alamekut asaj kones së Danielit?"- gjenerali iu drejtua Jakobit të urtë.

Jakobi i urtë sërish heshti derisa e mori miratimin e shikimit të Rabi Shalomë ben Kaifës.

"Jo, gjeneral i nderuar.Ajo kishte shkuar në mision të caktuar. Atë e kishte bindur Zatra Arameje të shkojë tek steli i kones së Danielit. Rebeka e pa atë kone të varfër, kutërbuese rëndë, padurueshëm.Ia shikoi sytë e dergjur,te ndotur nga zglubët"- ndërhyri Jakobi i urtë.

"Vetëm kur e pa këtë kafshë të mjerë, të ndotur kafshërisht, Rebeka e Alamekut e peshoi dënimin e Tribalit te Madh të Jerusalemit mbi kokën e Rabi Jachanan ben Sakait:

"A mund të gjallojë njeriu në mitrën e kësaj kafshe të ndotur!?"- u çjerr Rebeka.

Në fund të kësaj çjerrjeje Rebeka e Alamekut e dëgjoj zërin e Zatrës Arameje: "Vetëm Mitra jote do ta shpëtojë Izraelin e Rabi Jochanan ben Sakait.Do ta shpëtojë kodin e Izraelit."-përfundoi Jakobi i urtë duke e trembur nga ajri i tendës atë barrë të rëndë mbi orenditë e lakuara.

Orenditë e rezidencës së gjeneralit u liruan nga pasha e ajrit të rëndë.U drejtuan.Nëpër ajrin e tendës u zhdaravit hutesa.Jakobi i urtë e sabotoi kuvendin. Kjo u pa qartë.

Rabi Shalomë ben Kaifa u përmend nga letargjia e diskursit të Jakobit të urtë. U rrek ta gjejë rrugën më diplomatike.

"Gjeneral i nderuar, ai Rabi Jochanan ben Sakai mohoi çdo gjë të Izraelit: tempujt, religjionin, hierarkinë shtetërore, vetëm për një Orgazëm të premtuar nga ajo Rebeka e Alamekut"- foli Rabi Shalomë ben Kaifa plot pezëm për dezertimin e Rabi Jochanan ben Sakait.

"Jo! Rabi Jochanan ben Sakai dezertoi krejt për tjetër gjë.

Ai u frikësua të hyjë në luftë me Romën perandorike. Mitrën e Rebekës së Alamekut e pranoi vetëm pse lektisi të shpëtojë nga mitra e kones së ndotur të Danielit"- e zbuloi sekretin Jakobi i urtë.

Rabi Shalomë ben Kaifa kur e pa se gjenerali roman e pranoi si të vërtetë të pranueshme kuvendin e Jakobit të urtë i ra ndesh, haptazi gjeneralit roman

"Gjeneral i lavdishëm para shtatëdhjetë vjetësh Roma e vrau atë Jezusin e fantaksur vetëm për ta shpëtuar ushtrinë e vet nga orgazma kolektive. Edhe sot Roma detyrohet ta mbrojë veten nga orgazma e llojit të Rabi Jochanan ben Sakait. Ushtria jote gjeneral,sonte kaloi,e fantaksur, përanash mureve të Jerusalemit drejt shkretëtires.Ushtrinë Tuaj e zuri sëmundja.Dhe gjeneral tashmë, sonte, nga tenda e juaj e shikoni flakën e një qyteti tjetër, lavdinë e një gjenerali tjetër. Pas katër orësh, pikërisht pas katër orësh, do të shohësh se ç'do t'u flasë ai gjenerali amerikan i NATO-s,John Harkeri i Indigjenes Iroki të Massachuesttsit" -u sëkëlldis Rabi Shalomë ben Kaifa.

"Rabi i nderuar, në cilën pergamenë shkruan se Roma e paskesh dënuar atë Jezusin Tuaj.Ju vetë e keni dënuar,mbase e keni ditur se ai do ta infektojë Izraelin me orgazëm"-u mundua ta ruajë qetësinë diplomatike gjenerali roman.

"Pergamenën zyrtare e ka shkruar vetë Roma. Atë pergamenën tonë hebreje e ka asgjësuar sepse binte ndesh me pergamenën zyrtare të Romës. Pas katër orësh do ta keni përpara të pamundurën, të gjitha pergamenat, në mbledhjen e këshillit të lartë të NATO-s. Ai, John Harkeri, gjenerali amerikan, sonte po zbarkon ne Siçilinë Tuaj bashkë me atë Pocahontas Powhatanin, Iroki të Massachusettsit. Ai po ua sjell në Evropë më tepër se Orgazmën, edhe atë Dashurinë e seksit indigjen. Edhe po i vratë të gjithë Jezusët do ta keni të kotë"- u sëkëlldis Rabi Shalomë Kaifa.

Gjenerali roman e konsideroi të përfunduar kuvendin dhe të tillë e shpalli. Me një reverancë të ruajtur zorshëm ju drejtua Rabi Shalomë Kaifës:

"Hirësi, Roma ende e ruan të drejtën e shqyrtimit të kërkesës së Rabi Jochanan ben Sakait. Ai sonte me avionin e orës dy të pasmesnatës do të udhëtojë për në Romë, pikërisht në klinikën"Gemeli".Me vete i ka edhe nxënësit e Sanhredinit bashkë me librat e tyre. Po deshët udhëtoni me këtë avion. Atje në Romë, para Këshillit të lartë shpaloseni pergamenën Tuaj" - gjenerali roman sikur e shpalli të përfunduar audiencën.

Rabi Shalomë ben Kaifa e kuptoi se gjenerali po ngutej ta përfundojë audiencën ndaj u hodh curril përpjetë

"Gjeneral i nderuar po shihet qartë se doni ta mbyllni këtë audiencë. Tribali i Madh i Izraelit ka vendosur ta dënojë Rabi Jochanan ben Sakain. Gjykimi i vulosur zyrtarisht në pergamenë e thekson prerazi llojin e dënimit: varrosje për Jochanan ben Sakain në Mitrën e kones së Danielit. Rabi Jochanan ben Sakai do të shartohet në këlyshin e pestë të kones së Danielit. Ajo kone ka mbetur shtatzënë me qenin e Sebuhit, fqiut të Danielit"- u ngut në formulim Rabi Shalomë ben Kaifa.

"Sa Sakramente të shartimit i ka Tradita hebraike?"- iu drejtua gjenerali.

"Sakramentet hebraike të rjepimit fillojnë nga prerja e thonjve, prerja e flokëve, rrethprerja, e deri tek shartimi"- i numëroi disa sosh Rabi Shalomë ben Kaifa.

"Atëherë,Rabi i hirësuar,Tribali i Madh i Izraelit paska vendosur ta shartojë kodin e vet gjenetik?"- e ngacmoi gjenerali.

"Gjenerali i lavdishëm, Rabi Jochanan ben Sakai do të shartohet sonte në këlyshin e pestë të kones së Danielit. Këshilli i lartë i Tribalit të Madh të Izraelit përkrye të këtij Delegacioni ia paraqet Romës perandorake kërkesën me të cilin i sugjerohet se ndërhyrja kirurgjike në mitrën e kones së Danielit ku do të

shartohet Rabi Jochanan ben Sakai në këlyshin e pestë, të bëhet në Klinikën "Gemeli" të Romës. Gjatë gjithë operacionit do të jetë i pranishëm Delegacioni prej tre anëtarësh i caktuar nga Tribal i Madh i Izraelit për ta verifikuar gjëndjen"- solemnisht e shpalli Rabi Shalomë ben Kaifa.

"Ju Rabi i hirësuar, dashkët ta bëni klonimin e vetvetes së Izraelit në këlyshin e pestë të kones së Danielit"- Gjenerali e përmendi, ironikisht, nga letargjija e mënisë Rabi Shalomë ben Kaifën.

Rabi Shalomë ben Kaifa, sikur të mos kishte folë gjenerali roman, e vazhdoi deklarimin e vet.

"Koneja shtatzënë e Danielit qenka dërguar në aeroport. Edhe ajo sonte do të udhëtojë për në kliniken "Gemeli" të Romës"-pyeti Kaifa

"Në klinikën "Gemeli" të Romës ka vetëm pacientë –njerëz. Aty ndalohet operimi i kafshëve"- ironizoi gjenerali.

Rabi Shalomë ben Kaifa u bë sikur të mos e kishte dëgjuar ironinë e gjeneralit roman. Ai u ngrit i pari duke e konsideruar audiencën të përfunduar.

Gjenerali vetëm sa arriti t'i thotë:

"Rabi i hirësuar, dokumentet i keni të gatshme për në Romë. Paqit fat në të gjitha klinikat?" - ia tha në mënyrë të përgjithësuar.

Zhurma e helikopterit para tendës e dha kumtin e nisjes për tek aeroporti. Gjenerali roman dhe Rabi Shalomë ben Kaifa u ndanë tek dera e tendës pa i dëgjuar fjalët e njëri-tjetrit nga vërtëllima e elisës së helikopterit.

Gjenerali roman përmes radiovalëve të frekuencës ushtarake e urdhëroi pilotin e helikopterit t'i shmangët këndit të avionëve të NATO-s mbi qytetin e Jakovës së Jerusalemit. Qyteti nxirrte gjithnjë gulçime të flakës duke e skuqur barkun e tendës së gjeneralit të ushtrisë lindore të perandorisë së Romës.

9.

Posta ushtarake,jashtë rregullës,i arriti gjeneralit Titi në atë orë të pazakontë të natës. Edhe po mos të shkruante në plikon e protokollit: “Shumë urgjent” kuptohej vetvetiu ngutshmëria e gjendjes.

Pasi nënshkroi në librin e pranimit u përshëndetën me kolonelin e NATO-s. Stafi i lartë i Komandës së paktit Veriatlantik,i udhëhequr nga koloneli Riçmond, siç iu prezantua gjeneralit prurësi i zarfit, ia solli postën ushtarake me aq urgjencë, në atë kohë të natës, një gjenerali të perandorisë romane i cili pret të hyjë në Jerusalem këtu e njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet.

Koloneli Riçmond e nderoi gjeneralin roman Titi.

Fjalët qenë të pakta. Përshëndetja e shkurtër.

Natës i ngutej Njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet.

Gjenerali roman i ushtrisë lindore u ngut, ende pa y kthye në tendë, ta hapë plikon e portotkalltë.

Midis shenjave autoritare, të mbrojtura të NATO-s, e lexoi, pa frymë, tekstin e shkurtër, autoritar:

"Në orën katër të natës së sontme, të fillimditës së dymbëdhjetë të qershorit të Ditës së premte, tek zyra e OSCE-së në Jakovën e Jerusalemit Këshilli i lartë i Paktit NATO, urgjenisht Tubohet.

Rendi i çështjeve caktohet brenda Takimit.

Komanda e krahut jugor e paktit NATO, me qendrën në Napoli, u cakton Juve-gjeneralin Titi,komandant i krahut lindor të ushtrisë së perandorisë së Romës të jeni i pranishëm me tërë stafin Tuaj, me të gjitha ingerancat ushtarake të gradës Tuaj, të jeni i pranishëm në zyrën e OSCE- së në këtë qytet të Jakovës së Jerusalemit.

Komandanti i përgjithshëm i NATO-s, gjenerali John Wiliem Harkeri.

"Vërtet natës së sontme po i ngutet marramenthi me atë shpejtsinë e asaj Orgazmës amerikane të Indigjenes Iroki për njëmijë e nëtëqind e njëzet e nëntë vjet"- ia tha me krenari të ligjshme vetvetes gjenerali roman, Titi.

Kishte njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet duke e pritur këtë pergamenë me këtë heraldikë të flakuar në ar.

“Ai, Rabi Shalomë ben Kaifa, me aq kryeneçësi ngulmonte se ushtria ime e ka huqur Jerusalemin. Ja, me këtë dokument të NATO-s, më këtë heraldikë të praruar në ar shkruan aq autoritetshëm:“Jakova e Jerusalemit”. Pra jam tek vendi i duhur në këtë natë të marramendët nga ngutia njëmijënëntëqindnjëzetenëntë vjeçare” – sërish ra në vetveten e vet gjenerali roman.

Ai, gjenerali roman, do të kishte pushua në vetveten e vet po mos ta kishte trembë ordinanca, poaq ngutshëm duke e njoftuar se Rebeka e Alamekut nga Abbi i Galiles urgjentisht po lyp audiencë.

“Paskam hyre në zonën e Shtatëmbëdhjetë minutavetë Orgazmës hebreje”- mendoi vetimthi duke e marrë kartëvizitën e Rebekes së Alamekut.

“Futeni Brenda!”- i tha ordinancës së vet.

Rebeka e Alamekut po qëndronte në këmbë, me vellon tisore mbi fytyrë, gracioze. Atë grua të mistershme e kishin futur në kabinetin e punës së gjeneralit. Aty frymonte ajri me intim i gjeneralit. Ajo ishte e tendosur. Në sytë e saj të mbuluar nga velloja tisore vrujoi për një çast krenaria e femrës së bukur, provokuese,e një gruaje të parfumosur në atë kohë të ligë nate.

“Në këtë kohë nate burrat ligështohen para grave të bukura”-i pati hije gjeneralit ku ia tha Rebekes së Alamekut.

“Unë ia thash këto fjalë kësaj gruaje!”- u vertëllit në vetvete gjenerali;e patë të vështirë ta njohë vetveten e vet.

“Gjeneral i nderuar mos u frikësoni nga vetvetja e juaj ushtarake! Sonte është Nata e gjeneralëve edhe u desht të udhëtohet me shpejtsinë e Orgazmës hebreje, jo me shpejtsinë e Romës. M’u deshen njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet për të arritur deri tek Ju”-u mbush ajri i tendës me zërin e saj të ngrohtë.

Krenaria e Njëmijëenëntëqindenjëzetenëntë vjeçare e gjeneralit roman Titi u lakua nën ngrohtësinë e zërit të Rebekes së Alamekut.

“E di gjeneral i nderuar se detyra më ka shty të kërkoj audiencë të ngutshme në këtë kohë nate se, me vete e kam sjellë çastin e ligështimit të mashkullit. Mos u frikësoni për shëndetin po qe se ndjeni ndonjë gjendje të panjohur në mishin Tuaj”-Rebeka e kthei vrik te vetvetja e vet gjeneralin Titi

Rezidenca e gjeneralit u moleps nën pushtetin e saj. Ajo qëndroi gracioze, mbi vullnetin e gjeneralit të nemitur. Providenca e gruas së flijuar e tundoi të çelë kuvend.

“Zonjë e nderuar do të Ju ketë tunduar një çështje madhore të udhëtoni njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vite nëpër rrugën e pabesë, plot gracka kusarësh të të gjitha llojeve, midis Jerusalemit dhe këtij qyteti të Jakovës për të arritur deri tek kjo tendë e varfër”- e tundoi gjenerali

“Gjeneral i lavdisë perandorake, mendja Juaj e ndritur e sheh rrugën e gjatë deri tek kjo tendë e nderuar. Deri tek kjo tendë e Juaj e nderuar unë kam arritur me shpejtsinë e Orgazmës hebreje. Sonte, në Natën e gjeneralëve, kjo Orgazëm do t’u bëjë sfidë të gjitha luftërave të fituara e të humbura të gjeneralëve, të hyjnive, të shteteve, të religjioneve”- i foli nga epërsia gjysmë e ndriçuar Rebeka e Alamekut.

“Zonjë e nderuar, a keni ardhë të ma shpallni fitoren e kësaj Orgazme e cila do të më detyrojë ta nënshkruajë kapitullimin apo, mbase ju ka tunduar ndonjë hall tjetër?”- e pyeti drithërueshëm gjenerali Titi.

“Gjeneral i lavdisë romane, në tendën Tuaj të nderuar erdhi dikur Rabi Jochanan ben Sakai”- ndaloi Rebeka e Alamekut.

“Po, zonjë e nderuar, hirësia e Tij, Rabi Jochanan ben Sakai ishte në tendën time të varfër”- u përgjigj gjenerali duke u rrekë ta përmbajë vetveten e vet brenda trellit diplomatik.

Rebeka e Alamekut duke qëndruar në këmbë e pikasi se gjenerali Titi ishte në buzë të humbjes së torruas. Andaj vendosi të ecën tehut të rrezikshëm midis pohimit e të mohimit të gruas së bukur.

“Ai, Rabi Jochanan ben Sakai, e kërkoi nga Roma liçencën për ta hapur një universitet hebre në Diasporë”- i foli paksa qortueshëm Rebeka e Alamekut.- “E dini ju gjeneral i nderuar se Rabi Jochanan ben Sakai refuzoi të hyjë në luftë me Romën?”- vazhdoi ajo.

“Zonjë e nderuar, Rabi Jochanan ben Sakai i shpalli në këtë tendë të varfër kërkesat e veta. Ai, sonte bashkë me nxënësit e vet të Sanhredinit do të udhëtojë për në Romë me avionin e orës dy pas mesit të natës”- u tfillua gjenerali i cili e dinte se Rebeka e Alamekut i ka të gjitha informatat për Rabi Jochanan ben Sakain.

“Gjeneral i zëshëm kam udhëtuar njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet midis Jerusalemit dhe kësaj Jakove deri tek tenda e Juaj e nderuar.Të gjitha gjërat sonte kanë hyrë në Shtatëmbëdhjetë minutat e veta hebreje edhe rruga ime për në Romë”- i foli tërthorazi gjeneralit.

“Po deshët zonjë e nderuar mund të udhëtoni me avionin e orës dy të natës së sontme”- i foli gjenerali.

“Zoti gjeneral me po të njëjtin avion do të udhëtojë edhe delegacioni i Tribalit të Madh të Izraelit”- sikur ankoi Rebeka e Alamekut.

“Po deshët ju, Zonjë e nderuar, mund të mos takoheni as të mos shiheni me delegacionin e Tribalit të Madh. Në avion ka kthina të ndara për delegacione të ndryshme”- e ngushëlloi gjenerali.

“Zoti gjeneral unë dëshiroj t’i shoh e të më shohin ata të delegacionit të Tribalit të Madh. Dua të udhëtoj me tretmanin e stjuardesës”- e shpalli kërkesën e vet Rebeka e Alamekut.

Gjenerali ra në heshtje. Hezitoi për një çast, mbase më tepër për elokuencë kundrejt një gruaje të bukur në atë kohë të rrezikshme nate. Ata të dy e kuptuan njëri-tjetrin ende pa e thënë atë, brenda Shtatëmbëdhjetë minutave. Rebeka e Alame-

kut duke e parë elokuencën e tepruar të gjeneralit u detyrua sërish të çelë kuvend.

"Rahila nga Sidra e Sidonit e dëboi me përbuzje Rabi Jochanan ben Sakain kur ai zbriti në Sidon për t'ia lypë mitrën e saj të fishkur. Ajo e shpalli mohues të Izraelit, renegat, tradhtar, vetëm për t'i hyrë në huj Tribalit të Madh të Jerusalemit. Mbase mitra e fishkur e Rahiles së Ahabit do të dalë shterpë për ta mëkuar Rabi Jochanan ben Sakain e denuar të shartohet në këlyshin e pestë të kones së Danielit"- vazhdoi Rebeka duke e parë se gjenerali e pati të vështirë ta përmendë mitrën në prani të gruas së bukur.

Gjenerali roman qashtërisht heshti sërish pa mundur të bëjë dum në hapjen e kuvendit. Frikësohej të mos binte harbut në sytë e Rebekes së bukur.

"Shtatëmbëdhjetë minutat" e NATO-s e nxitën Rebeken të nismëtojë kuvend duke u përpjekur t'i shmanget sëmbimit të gjeneralit në mishin e poshtëm të gruas:

"Zoti gjeneral, kam vendosur vullnetarisht t'ia dhuroj Mitrën time Rabi Jochanan ben Sakait vetëm për ta shpëtuar nga dënimi i Tribalit të Madh të Izraelit. Dua ta shpëtoj Rabi Jochanan ben Sakain nga varrosja poshtëruese në mitrën e Kones së Danielit.Unë dhe Koneja e Danielit do të udhëtojmë sonte për në Romë. Në Klinikën "Gemeli" të Romës, tek salla e operacionit me numër dy do të hapet Mitra e Kones së Danielit në prani të Delegacionit të Tribalit të Madh të Izraelit. Në sallën tjetër me numër katër do të hapet Mitra ime. Gjeneral i nderuar e përgjëroj Romën hirplotë ta shpëtojë kodin gjenetik të Izraelit nga vetvetja e vet izraelit. Tribali i Madh e dënoi Izraelin përtej vdekjes së vetvetes: vendosi të hyjë në luftë kundër Romës së fuqishme. Rabi Jochanan ben Sakai e kundërshtoi këtë luftë të pabarabartë. Ky Tribal e dënoi Rabi Jochanan ben Sakain, për tradhti ndaj atdheut, të klonohet në Këlyshin e pestë të Kones së Danielit.Vendimi i parë i Tribalit të Madh barazohet me

vdekjen e sigurtë në luftë të pabarabartë kundër Romës. E dyta del edhe më e vështirë : klonimi i Kodit gjenetik të hebreut në Kafshë.

E përgjëroj Romën hirplotë:në çastin kur të hapen të dy mitrat:mitra e Kones së Danielit dhe mitra ime Konsiliumi i mjekëve të vendosë në favor të njeriut. Në vend se të klonohet Rabi Jochanan ben Sakai në mitrën e Kones të vendoset në mitrën time"- zëri i Rebekes e mbushi ajrin e tendës me malcim femëror.

Gjenerali roman, tashmë brenda zonës së Shtatëmbëdhjetë minutave të Orgazmës hebreje,pas heshtjes elokuente çeli kuvend.

"Zonjë e nderuar, ju me aq mirësjellje po e kërkoni ndihmën e Romës por siç shkruajnë pergamenat, sonte në klinikën "Gemeli" të Romës do të punojë konsiliumi i mjekëve amerikanë të gjeneralit John Harkerit të asaj Indigje-nës Iroki, Pocahontas Powhatanit"- gati sa psherëtini gjenerali roman.

"Sonte gjeneral i lavdishëm është nata e Shtatëmbëdhjetë minutave të kodeve. Rabi Jochanan ben Sakai ka marrë vendim të qashtër ta shpëtojë kodin gjenetik të Izraelit, ta ruajë të konservuar në Diasporë, jashtë Izraelit nëpër Evropë"- e shpalli Rebeka

"Zonjë e nderuar ju duhet të keni aftësi shtatzënie për t'u bërë kjo ndërhyrje kirurgjike"- e mëtoi gjenerali vetëm sa për të thënë diç.

"Po"

"Mbase do të çertifinoheni"- vetëm sa bërbëliti gjenerali.

"Mbase"

"Sa do të zgjasë shtatzënia e Juaj, zonjë e nderuar?"- tashmë gjenerali e hetoi vetveten se kishte rënë fodull nga mendja.

"Kjo është çështje e tjetërkujt zoti gjeneral.Ju,këtu e njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet keni qenë i varrosur para mur-

eve të këtij qyteti. Koha e Juaj romane ka ndaluar për kaq vite nëpër pergamena të resura vjetersie. Ndaj është e natyrshme të mos i kuptoni përparësitë e sotme të medicinës”- i foli Rebeka e Alamekut me një zë të mpleksur midis qortimit e mëshirimit.

Gjenerali e ndjeu veten në pozitë të fyer nga një grua aq kryelartë, aq e pamëshirshme për ta realizuar qëllimin e vet ngulmues. Heshti, edhe pse në mënyrë jodiplomatike. Rebeka e kuptoi fyerjen e tij dhe vendosi ta godasë edhe një herë.

“Para një gjysmë ore Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Rainhard von Grainhelmit të tretë, trashëgimtarit të kurorës mbretërore të Bohemisë më lajmëroi se e paska parë në ekran zbarkimin e gjeneralit amerikan në Siçilinë Tuaj”-e sëmboi Rebeka sedrën e gjeneralit roman.

“Atëherë pse ju, zonjë e nderuar, sonte i përgjëroheni Romës kur në klinikën“Gemeli”do t’ju operojë konsiliumi i mjekëve amerikanë?”- e pyeti gjenerali me zë të dyshimtë.

“Po”- ngulmoi Rebeka- “Sepse unë gjakoj ta shpëtoj kodin gjenetik të Izraelit nga inati i vetvetes së vet Izraelit. Në pergamenë shkruan se Rabi Jochanan ben Sakai ka bërë marrëveshje me Ju gjeneral dhe me Romën. Gjenerali amerikan e lupë këtë pergamenë.”- drithërueshëm i foli Rebeka sikur gjenerali roman ta paskesh pranuar aleancën me të.

“Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Grainhelmit të Bohemisë përse u sorollat bashkë me atë Jakobin e urtë nëpër Galile deri tek fshati Abbi?”- e zbuloi qëllimisht informatën gjenerali.

Rebeka, e shkundulluar nga sëmbimi i mishit të poshtëm të gruas së bërë, e kuptoi se ku po rrahte gjenerali roman.

“Jakobi i urtë gjatë kohës së ravgimit nëpër shkretëtirë me Sofinë e Jakovës së Jerusalemit ishte vetëm njëri i lidhur me vegimin e vet. Nuk kishte rrezik mashkulli. Jakobi i urtë edhe në këtë orë të natës është i privuar nga mishi mashkullor”- e zhbëri aludimin e gjeneralit.

Të dy heshtën. Rebeka me sëmbimin e mishit femëror prej gruaje të ardhur iu frikësua kohës së ligë të natës. U detyrua ta mbulojë friken e vet me kuvend.

"Sofia e Jakovës së Jerusalemit arriti deri në Galile për t'u takuar me Ju, gjeneral i nderuar".

"Përse do të takohej me mua Sofia e Jakovës së Jerusalemit?" - u shtir gjenerali.

"Do t'jua thotë ajo vetë pas pak çastesh"- qëllimisht u bë Rebeka sikur rastësisht e zbuloi këtë informatë.

U bë heshtje e paktit të pranuar.

"Zonjë e nderuar, a ka mundësi të besojë Evropa se Rabi Jochanan ben Sakai është shartuar në këlyshin e pestë të Kones së Danielit? Sa herë të dojë Evropa ta poshtërojë Izraelin do ta shfaqë në teatrin e Berlinit atë dramën "Fausti". Mefiston, atë djallin hebre, në aktin e dytë të dramës "Fausti", karshi të gjithë spektatorëve, regjisori do ta nxjerrë nga barku i një Koneje. Mbase nga barku i kones së Danielit nga Abbi i Galiles"- foli gjenerali me një zë të vuvët sikur të qe tjetër njeri.

"I urrej ato zonja të pispillosura të Evropës në teatrin e Berlinit. Sa herë përsëritët dalja e Mefistos nga barku i Kones së Danielit në atë dramën e ndotur "Fausti", ato me përbuzje të pështirosur i mbulojnë hundët e pudrosura me faculeta të shpëlara me ujë kolonjë"- ankoi Rebeka e Alamakut.

"Kot t'i urreni ato zonja të pispillosura të Evropës të engletisura nëpër teatrot evropiane? Ju, zonjë e nderuar, sonte po e sfidoni në betejë singulare atë Konen e Danielit edhe këtu në këtë tendë të varfër edhe në atë dramën e ndotur të titulluar "Fausti". A mos të vie keq për atë kone të mjerë? Asaj çdo mbrëmje, në teatrin e Berlinit, sipas ritualit të dramës "Fausti", do t'i hapet mitra për ta nxjerrë Mefiston e dënuar qysh në rininë e hershme të Evës. A mos të vie keq për ato zonja të pispillosura të teatrit të Berlinit kur do t'u huq mitra e kones së

Danielit dhe drama “Fausti” të dështojë qysh në aktin e dytë?”- e pyeti gjenerali me një galdim të dyshimtë në zërin e tij.

Rebeken e zuri mendimi i frikshëm se tek gjenerali mos paskesh ndodhë zgjimi i mishit mashkullor.

“Më ngjanë në një ngulm ogur drama “Fausti” e teatrit të Berlinit. Sikur këlyshi i pestë i kones së Danielit i katriset Rabi Jochanan ben Sakait me mëtesën e binjakëzimit, për ta klonuar kodin hebre në kod të kafshës.Sikur Evropa e zonjave të engletisuara ndjen kënaqësi kur e poshtëron Izraelin e Rabi Jochanan ben Sakait dhe shtiret se e çmon Izraelin e Tribalit të Rabinëve të vetëvrarë”- u rrëmbye Rebeka e Alamekut.

“Zonje e nderuar, ju sonte në zonën e Shtatëmbëdhjetë minutave të Orgazmës hebreje po e shpëtoni Kodin gjenetik të Izraelit”- e ngushëlloi gjenerali roman duke ia zgjatur dokumentet e udhëtimit për në Romë.

Rebeka e Alamekut mëdyshoi mu në midis të mishit prej gruaje.

“A po e shpëtoj Izraelin e Rabi Jochanan ben Sakait? A i mposhta ato gratë e pispillosura të teatrit të Berlinit?”- u rrokullis në vetveten e vet Rebeka e Alamekut.

Gjenerali Titi po priste me dokumentet e udhëtimit në dorë. E njohu mburrjen e Rebekes së Alamekut për Izraelin e futur në Mitrën e saj. Në hejzën e mburrjes, para se t’i merr dokumentet e udhëtimit, u prirë i gjithë mishi femëror i gruas së ardhur kah gjenerali.

“Gjatë kohës së anestezisë së plotë a mund të ndodhë ndonjë spekulim në Mitër?Në Klinikën “Gemeli” do të jetë i pranishëm delegacioni i Tribalit të Madh të Jerusalemit.Ai Delegacion mund ta korruptojë ekipin e mjekëve po qe se rastësisht vonohet ekipi i mjekëve amerikanë?Helbete,luftë i thonë kësaj” - mezi e ngjalli zërin e vetvetes së vet Rebeka e Alamekut.

“Dokumentet e Rabi Jochanan ben Sakait kanë udhëtuar me postë diplomatike për në Romë”- e siguroi gjenerali.

Gjenerali roman vullnetshëm e zuri rrugën e konspiracionit. Kishte njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet fushimi kundr - ruall këtij qyteti të Jakovës së Jerusalemit. Në fillim të ngulitjes në këtë fushë e patë shumë afër qytetin; mund t'ia dallonte dritaret e shtëpive. Me kohë qyteti zu të largohej çdo pranverë bashkë me shkrirjen e borës.

Padiktueshëm doli përtej lumit të Erenikut.

"Ju, zonjë e nderuar, lektisni ta kuptoni pse Roma e miratoi pergamenën e Rabi Jochanan ben Sakait për ta themeluar universitetin në diasporë, jashtë Izraelit?"- e pyeti gjenerali sikur kjo çështje të kishte përfunduar.

"Po"

"Prapë lektisni ta kuptoni pse Roma e pranoi pergamenën tuaj?"

"Po"

"Prapë lektisni ta kuptoni pse Roma u hamend rreth pergamenës së Tribalit të Madh te Jerusalemit?"- gjenerali roman i zbuloi të tri sekretet.

"Po"

I ndezur gjakrash, gjenerali Titi e zuri për dore Rebeken. Dokumentet e udhëtimit ia futi në gjirin e saj të çelur-alabastër. Me sy e me duar e tërhoqi para derës së tendës. Nga qyteti i Jakovës së Jerusalemit duhma e nxehtë e zjarrit u përplas për fytyrat e tyre. Zhaurima mbytëse e zjarrit erdhi nga qyteti i nemitur në vdekjen e vet. Shkulmat e flakës shkëputeshin nga mishi i qytetit, të azdisura msyenin drejt qiellës së skuqur metalike.Kutërbimi i rëndë i mishit të djegur e kapërcente Erenikun drejt tendës së gjeneralit Titi. Rebeka e zgurdulluar sysh e vrojtoi qiellën e shkrire metalike të shkrirë mbi qytetin e Jakovës së Jerusalemit.

"Ende në këtë qytet të Jakovës së Jerusalemit ka frikë nga vdekja. Ushtarët e mi, të rrëmbyer nga afshi i lavdisë së fitores

e sulmuan këtë qytet duke e shndërruar në prush të gjallë. Ky zjarr është vullneti i Tribalit të Madh të Jerusalemit. Ai Tribal e zgjodhi vullnetarisht vdekjen e vetvetes së vet Izraelit"- çfryni gjenerali roman.

"Gjenerali i lavdishëm,ushtria juaj, e ndezur nga afshi i luftës e paska djegur ketë qytet pa urdhërin Tuaj?"-e provokoi Rebeka.

"Jerusalemi do të sulmohej nesër sipas planit ushtarak. Ndodhi ajo shtjellë e vrevët nga Sinaji me zë të vuvët prej myslimanësh:"Allah!Allah!" Ushtarët e mi, të rrëmbyer nga amoku i luftës e sulmuan Jerusalemin pa komandë ushtarake. Po dënohet kokëfortësia e Rabinëve të Tribalit të Madh të Jerusalemit. Deri nesër në mëngjes në Jerusalem do të shuhet jeta. Dhe serish le të thotë ai Rabi Shalomë ben Kaifa se ushtria ime kaloi e vuvët përanash mureve të qytetit drejt shkretëtirës"- u rrëmbye gjenerali roman Titi.

Rebeka e Alamekut e shikoi për herë të parë gjatë këtij takimi, me vëmendje, gjeneralin në fytyrën e skuqur nga flaka e zjarrit llamburitës. Fytyra pergamenë e gjeneralit Titi ishte bërë kohë e ngurosur.Humbëtira e kohës pergamenë po e shihte rrënimin e Jakovës së Jerusalemit.Djerset e ballit i rrëshqitën teposhtë pergamenës së fytyrës duke resur shumëçka nëpër historinë e saj. Shprehja e fytyrës së gjeneralit u çaprapikua.

"Rabi Jochanan ben Sakai u arratis nga zjarri i Jakovës së Jerusalemit të vet drejt atyre Shtatëmbëdhjetë minutave të gjeneralit amerikan,John Harkeri të indigjenes Iroki.Ai Rabi e zgjodhi rrugën më qyqare të jetës. Shkoi deri në zgripc të varroset i gjallë në mitrën e kones së Danielit. Gati ra edhe në thyerjen e kodit të gjenetikes së hebrenjve: të jetojë në mitrën e kafshës"- sikur u rrenua gjenerali i resur nga shumëçka nëpër fytyrën e vet pergamenë.

Rebekës së Alamekut iu bë se kishte arritur çasti për ta çelë kuvendin e fundit me gjeneralin roman i cili, sa po vinte e po

errej fytyrës pergamenë.

"Gjeneral i luftërave të fituara, lejoje shërbëtoren tënde të varfër të gabojë sipas natyrës së ligë femërore.

Pse ushtria e Juaj e lavdishme e sulmon Jakovën e Jerusalemit duke i tunduar të veprojnë paradokset biologjike; të bëhen shemra mitrat e kafshëve me mitrat e grave? Rabi Jochanan ben Sakain e shpieni buzë katrahurës midis këtyre dy mitrave, gati për t'u varrosur për së gjalli në mitrën e Kones së Danielit?"- mbeti pa fryme Rebeka e Alamekut.

Gjenerali shtangoi me shikim te kallur nga zjarri i Jakovës se Jerusalemit sikur e kishte pritur këtë pyetje të saj. Nëpër fytyrë i ra disa herë, kryqetërthor, heshtja pergamenë.

Rebeka e pa qartë se si po resej pergamena e fytyrës së gjeneralit. Nga larg, i zvargur, i erdhi zëri i gjeneralit pergam-enë:

"Pse të vdiset kot? Pse të jetohet kot?

Pse të vdiset me vlerë? Pse të jetohet me vlere?

Brenda Shtatëmbëdhjetë minutave të Orgazmës hebreje le të merren vesh te klinika"Gemeli" midis tyre Tribali i Madh i Izraelit dhe Rabi Jochanan ben Sakai, Rebeka dhe koneja e Danielit."

Gjenerali Titi ra në pergamenë.

"Zonjë e nderuar, helikopteri ushtarak do t'u shpie deri në aeroport. Keni kohë edhe një orë e gjysmë për ta zënë avionin" - i foli Rebekes një person i panjohur ushtarak.

10.

"Zonjë e nderuar, Sofi e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Rainhard von Grainhelmit të tretë, trashëgimtarit të kurorës mbretërore të Bohemisë, nga teatri i Berlinit deri në Galile Jeni arratisur me slitë ruse të grahur nga një muzhik. Brenda slitës je mbyllur me personin më të urrejtur në Evropë. Jeni arratisur, zonjë e nderuar me Mefiston. Në aktin e dytë të dramës "Fausti"e ke nxitur Mefiston ta braktisë skenën duke i lenë spektatorët të dëshiruar. Zonjat e larta i zhgënjeve.

Për rrembim të protagonistit nga drama "Fausti" akuzoheni për atentat në personalitete shtetërore. Teatri shtetëror i Berlinit është goditur rëndë.

* *
*

"Shkëlqesia juaj, gjenerali po ju pret për audiencën Tuaj të rezervuar, ashtu siç jeni me rrobat e udhëtimit"- i foli ordinanca e gjeneralit roman Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, prince-

shës së Bohemisë, të shoqes së Rainhard von Grainhelmit të Tretë, Trashëgimtarit të Kurorës mbretrore të Bohemisë duke ia lëshuar një shikim diskret nga velloja e deri poshtë tek këmbët, mbase për shkaqe sigurie.

Sofia e Haçet Deletës e ndjeu shikimin e ordinancës nën rroba.

Në rezidencën e gjeneralit ajri po kotej, ende i dehur nga aroma e Rebekes së Alamekut.Sofia e njohu aromën e saj. Shkarazi e kishte takuar në Abbi të Galilesë.

"Rebeka e paska sosë audiencën në ketë rezidencë?"- e pyeti ordinancën e gjeneralit.

"Jo hirësi, ajo qe në kabinetin e punës së gjeneralit. Vetem doli nga kjo anë"- u përgjigj ordinanca me diskrecion ushtarak.

Nëpër aromën e Rebekes së Alamekut ia çatisi gjenerali roman. Vinte pak i zvetënuar; nga fytyra i hequr, i pagjumë! Në fytyrën pergamenë të gjeneralit, Sofia e Jakovës së Jerusalemit e hetoi lumturinë e tij të mbetur nga Rebeka e Alamekut.

Gjenerali gati e theu protokollin e audiencës së rezervuar për një grua të gjakut mbretëror,siç ishte Sofia e Jakovës së Jerusalemit.

"Jam frikësuar për vdekje se sonte, në këtë audiencë mos po më paraqitet Sofia e Jakovës së Jerusalemit e natës së tetëmbëdhjetë të prillit të njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjet e njëshit"- i foli gjenerali me një zë miqësor, të guximshëm.

"Gjeneral i shkëlqyer atë natë shianike të prillit, për të cilën e keni fjalën, ishte ora tetëmbëdhjetë e mbrëmjes"-Sofia e plotësoi paq me buzëqeshje hirplotë siç bëjnë miqtë e vjetër.

"Në kartëvizitën e paraqitur për audiencë, shkëlqesisë suaj i mungon shenja identifikuese se cilën Sofi kam nderin ta takoj sonte në këtë tendë të varfër"- vazhdoi gjenerali shtruar sikur të kishte kohë të tepruar.

Sofia e nuhati se, përveç në ajrin e dehur, kudo nëpër tendën e gjeneralit, në sy, në zë, në mishin e tij, kishte mbetur aroma e Rebekes së Alamekut.

"Ajo ende po mbretëron me pushtetin e saj në këtë tendë"- e kapërdini mendimin Sofia.

Kur një grua e parfumosur me shije e ndesh në dhomën e një burri të ri aromën e gruas tjetër te pakmëparshme, e ndjen sëmbimin hidhërak në shtatë mishrat e vet femëror.

"Rebeka e Alamekut do ta ketë zgjuar mëkatin e mishit mashkullor në ketë gjeneral eunuk prej pergamene të resur. Rebeka e Alamekut është takuar tashmë në Jude me shikimin tundues të Zatres nga Arameja"- u rrëqeth në vetvete Sofia.

Gjenerali, nën rrobën e trashë ushtarake e ndjeu sëmbimin e shikimit të Sofisë. Me përpjekje të mundimshme prej diplomati iu qas asaj për t'ia marrë dorën e ofruar me aq delikatesë. Dorën e saj e shpuri tek buzët me reverancë të hijëshm. Ajo e ndjeu ngrohtësinë e buzëve të gjeneralit në dorën e vet delikate, edhe pse ende i mbante dorashkat gati tisore prej tyli. Buzët ushujzore të gjeneralit depërtuan nëpër dorashkat rrjetore deri në lëkuren e freskët të Sofisë.

U pa qartë. Gjenerali e kishte tepruar paksa me një, apo dy gota verë të rrokullisura përngutshëm midis aromave shemrake të të dy grave të fuqishme. Duke e mbajtur dorën e Sofisë, gati të rrëmbyer me dorën e vet të djersitur, gjenerali e shpuri atë tek divani i denjë vetëm për një mbretëreshë, siç ishte edhe vetë ajo.Ajo,me hire te ardhura prej gruaje te bërë, qëndroi në këmbë pranë divanit duke e mëtuar gjeneralin roman të çelë kuvend.

"Zonjë e nderuar, keni bërë rrugë të gjatë nëpër këtë natë të pabesë për të arritur në këtë tendë të varfër. Gjenerali i varfër i krahut lindor të ushtrisë perandorake të Romës, mbetet në shërbim të vullnetit Tuaj sovran"-gati u mallëngjye gjenerali roman.

“Gjeneral i lavdisë së arrirë në të katër anët e botës, kjo zonjë e varfër, këtu para jush, ishte e tunduar ta bëjë gjithë ketë rrugë sfilitëse për të arritur deri tek kjo tendë e lartësuar, të cilën e xhelozojnë shume gjeneralë të lavdishëm dhe zonja të hirëshme të Evropës”- çeli kuvend plot reverancë Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Grainhelmit të Bohemisë.

“Mbase të gjithë burrat më të shquar të Evropës e dinë sonte itinerarin e rrugëtimit Tuaj, Zonjë e hirësuar”- i tha me dy kuptime ledhatuese.

“Në këto informata të varfra, të shkruara në pergamena sekrete shkruan,krejt varfërisht se Ju gjeneral ngadhnjimtar gjendeni ende i ngulitur para mureve të Jerusalemit”- ankoi Sofia.

“Është pergamenë e shkruar me mjeshtri diplomatike, mbase edhe me saktësi pedante”- u përgjigj gjenerali roman, Titi.

“U pa kjo punë, gjeneral i nderuar. Gjatë gjithë rrugës nëpër Galile më udhëhoqi Jakobi i urtë deri tek fshati Abbi i të dy shemrave. Rebeka më shpuri tek shemra e vet, tek Koneja e Danielit, në mitrën e së cilës, sipas dënimit të Tribalit të Madh të Izraelit, duhej të varrosej i gjallë Rabi Jochanan ben Sakai. Edhe Koneja e Danielit ishte përgatitur për atë. Kur e pa Rebekën e shikoi me sy të një shemre. Koneja ishte shtatzënë. Ndjehej krenare se njëri nga këlyshët e saj– ai këlyshi i pestë do të klonohet në Rabi Jochanan ben Sakain. A mos është pak për Konen e Danielit të bëhet nënë e Rektorit të të dy universiteteve të Izraelit? Të bëhët nënë e tërë Izraelit?”- i foli gjeneralit Sofia e Haçet Deletës ende duke qëndruar në këmbë pranë divanit.

Në zërin e saj shemra e lënduar dykuptimshëm foli.

“Mbase ai, Jakobi i urtë ua ka ngatërruar qëllimisht rrugën nëpër Galile?”- dykuptimisht e pyeti gjenerali.

“Jo gjeneral i nderuar. Jakobi i urtë a mos kishte nevojë ta bëjë atë ngatërrim rrugësh? A mos kishte rrezik mashkulli në të?”- u fye paksa në sedër Sofia.

“Po i bëri mendja dum burrit të ri? Helbete njerëz jemi”-foli gjenerali me një vijëzim te hollë buzëqeshjeje.

“Më detyroni t’ua them gjeneral i nderuar. Jakobi i urtë edhe në çastin kur po flasim ne,është eunuk,ashtu siç ishit edhe Ju gjeneral para se ta keni takuar shikimin e Rebekes se Alamekut. Ju gjeneral eunuk i pergamenës, këtu e njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet, po qëndroni midis Jerusalemit edhe këtij qyteti të Jakovës pa e ndjerë për asnjë çast tundimin e mishit femëror as tundimin e zhanglës se mishit tuaj të fishkur midis shalash”- vetëtoi shikimi i Sofisë.

Gjenerali heshti; u bë esëll nga furia mbretërore e Sofisë.

“Jakobi i urtë ngulmoi të mos i bie ndesh tundimit të Rebekës. Rebeka e tunduar nga shikimi i Zatres së Aramejeve e kishte zbuluar mishin e femëres midis vegëve të veta. Andaj Jakobi i urtë, i frikësuar, priti në të hyrë të fshatit Abbi. E kurseu vetën nga tundimi i të gjitha llojeve të mishrave mëkatarë”-serish u pa se zemërimi superior po ziente në sytë e Sofisë.

Gjenerali e kuptoi se e humbi davanë.

Sofia e kuptoi superioritetin e vet mbi gjeneralin.

“Po ju përgjëroj gjeneral i nderuar se Roma ngadhnjimtare duhet ta heq embargon dymijëvjeçare mbi dokumentet e Teutës së parë të Ilirikut Albanik. Ta hiqni embargon nga diagnoza e saj shëndetësore të lëshuar nga klinika “Gemeli” e Romës. Poashtu edhe Austria, qe sonte, do ta heq embargon mbi dokumentet shëndetësor të nënës sime, Teutës, Frojdit të Vjenës.

“Ju, zonjë e lartë doni të bëni për Ilirikun Tuaj Albanik atë që po e bën Rebeka e Alamekut për Izraelin e saj?”-sikur e ndaloi mendimin gjenerali.

Sofia e hetoi ngurimin e tij.

“Gjeneral i nderuar, pas dy orësh, sonte, në takimin e Këshillit të Lartë të NATO-s,gjenerali amerikan,John Harker bashkë më Indigjenen, Pocahontas Powhatan, nga Massachusettsi do

t'i kenë në tavolinë të dy diagnozat e nënës sime: atë të klinikës "Gemeli" dhe atë të Klinikës "Mercoledi" të Sigmund Frojdit"- vazhdoi Sofia e Haçet Deletës.

"Ju zonjë e nderuar paske arritur në këtë tendë me shpejtësinë e Orgazmës amerikane. E dini hirësi se mbi personën tuaj është vënë fletarresti"- e kërcënoi gjenerali me zë të fishkur, aspak bindës.

"Po, e di".

"Nga teatri i Berlinit deri në Galile jeni arratisur, Zonjë e nderuar, me slitë ruse, te vozitur nga një muzhik rus. Brenda slitës jeni mbyllur me personin më të urrejtur në Evropë. Qe në aktin e dytë të dramës "Fausti", Ju, Zonjë e nderuar, e keni nxitur Mefiston ta braktisë skenën duke e shkaktuar dëshpërimin e aq zonjave të shquara të Evropës"-gjenerali u përpoq ta trembë Sofinë.

"Gjeneral i nderuar, zonjat e Evropës janë dëshpëruar për mungesën e Mefistos në aktin e dytë të dramës "Faustit" aqsa pikllohen konkubinat e haremit të sulltanit për eunukun. Puna e Mefistos në teatrin e Berlinit paskesh qenë të dalë çdo mbrëmje nga barku i fishkur i Kones së Danielit. Detyra e tij paskesh qenë ta mburrë impotencën e burrave gjermanë të zverdhur nga pudrosja grarishte. Mefistoja, i akuzuar se e zgjoi epshin e doktor Faustit të katandisur pleqërisht në librat e një filozofie kukudhe gjermane, duhej ta mbante mbi supe barrën e gjithë përbuzjes evropiane për hebrejtë"-u ngrit Sofia e Jakovës së Jerusalemit mbi krekosjen e gjeneralit roman.

Gjeniali roman, Titi, vazhdoi të bëhet esëll nga furia mbretërore e Sofisë.

"Kjo grua mund të marrë informata të gabuara nga gjenerali austriak Herman von Urlih. Në takimin e Këshillit të Lartë të NATO-S mund të rrjedhin gjithfarë intrigash. Sipas pergamenës sekrete, gjenerali amerikan, John Harkeri bashkë me atë

Indigjenen e Masaçusestsit po zhbirojnë diç në mishrat e ndryshuar të Rabi Jochanan ben Sakait dhe të rektorit të Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldikut, ”- u rrokullis në vetveten e vet gjenerali Titi.

“Zonjë e respektuar,Ju gjithsesi sonte do të ktheni tek gjenerali austriak,Herman von Urlih.Tenda e tij nga këtu është vetëm pesëmbëdhjetë kilometra. Rruga e mbushur me plot të paprritura për një zonjë të shquar e detyron njeriun të Ju marrë në mbrojtje. Helikopteri ushtarak do t’ju shpie deri atje”-gjenerali roman dëshpërueshëm i ra ndesh furisë mbretërore të Sofisë.

“Gjeneral i nderuar, mbrojtja e juaj më nderon në mënyrë të veçantë. Para se të kthej atje tek gjenerali austriak, Herman von Urlih, Ju kisha përgjëruar ta shpalosni pergamenën e klinikës “Gemeli” të Romës ta shihni diagnozën mbi shëndetin e nënës sime, Teutës së parë, të shoqes së Haçet Deletës së Dytë të Ilirikut Albanik se a qe shtatzënë apo beronjë”- ngulmoi Sofia me superioritetin e arrirë mbi gjeneralin.

“Ju, Zonjë e nderuar,po e mëshehni datën e kësaj vizite në klinikën “Gemeli” të Romës. Mbase edhe mund ta gaboni kohën kur është vizituar nëna Juaj, Teuta e Haçet Deletës, në këtë klinikë”- foli gjenerali vetëm për ta plotësuar vendin e vet të dialogut.

“Gjeneral i nderuar, qysh nga teatri i Berlinit udhëtova deri në Galile. Pastaj udhëtova deri para mureve të Jerusalemit, me slitë ruse, siç thoni Ju. Nga atje erdha deri në tendën Tuaj për ta lexuar pergamenën e klinikës“Gemeli”të Romës në qe shtatzënë Nëna ime-Teuta e Haçet Deletës. Kjo diagnozë paskesh qenë në pergamenat e arkivit Tuaj ushtarak”–e ngjiri, qëllimisht, zërin Sofia e Haçet Deletës.

“Ju, Zonjë e nderuar, keni zbritur deri në Galile e Jude për ta takuar atë Rabi Jechanan ben Sakain, ta pyesnit në e kishte takuar ndonjëherë vëllain tuaj - Kostantinin e Haçet Deletës”-

ia prini gjenerali për ta bërë me dije se kishte informata të bollshme për udhëtimin e saj.

"E pata ndërmend t'ua thoja pakë më vonë, gjeneral i nderuar sikur të mos i frikohesha sedrës suaj prej gjenerali. Zbrita tek tenda Juaj, pak çaste pasi ushtria romane, e rrëmbyer nga amoku i mistershëm i asaj shtjellës së vrevët nga Sinaji me atë buçimën e vuvët myslimane:"Allah! Allah!",i ra përanash Jerusalemit të rrethuar duke u përhumbur drejt shkretëtirës"- vazhdoi furia mbretërore e Sofisë.

"Edhe ju zonjë deshët të thoni se mos ushtria ime romane u frikësua nga ajo buçimë ogurzezë myslimane duke u arratisur pa e sulmuar Jerusalemin. Përse e shprehni këtë dyshim fatzi kur përpara jush e keni Jerusalemin e përflakur?" - u rrëmbye gjenerali.

"Do t'u kenë kështilluar edhe të tjerët, para meje, gjeneral. Mos e lakmoni famën e gjeneralit tjetër!"- me timbër përbuzës, prej së larti e ndrydhi Sofia e Jakovës së Jerusal-emit.

"Edhe ju, si ata të tjerët doni të thoni se këtë qytet e kalli gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi?" – u përgaz gjenerali Titi

Sofia e Jakovës së Jerusalemit e heshti gjeneralin me shikimin e saj të shtjelluar përnjëherë me të gjitha përhijesimet e frikshme të gruas së fuqishme, të trandur brenda vetvetes së vet të vërshyer.

Gjenerali Roman vendosi të heshtë para kësaj shtjelle fërtomë në sytë e Sofisë së Haçet Deletës. Te fundi duhej bërë diçka, pa fjalë.

Nga syza e tavolinës portative e nxori një pliko ngjyrë portokalli. E mbajti për një çast në dorë sikur mëdyshoi: t'ia japë asaj apo ta kthejë serish në syzën e tavolinës. Pasi u bind se e mëkoi mjaft krenarinë e vet prej gjenerali, ia zgjati plikon Sofisë.

Ajo e zgjati dorën, e shndërruar në falenderim. I ndalohej ta hapë plikon derisa të arrijë në tendën e gjeneralit austriak, Harman von Urlih. E peshoi me dorë plikon e portokalltë. Mbi te ishte shkruar me kaligrafi të kujdesshme, si në pergamenë: "Raporti mjekësor i Konsiliumit të mjekëve të klinikës "Gemeli" të Romës mbi gjendjen shëndetësore të Teutës së Haçet Deletës, mbretëreshës së parë të Ilirikut Albanik të, bërë ditën e tretë të shtatorit…të vitit 168 me rastin e vizitës mbretërore të Lartmadhërisë së Saj në Romë".

Doli e kotë ta pyesë gjë tjetër gjeneralin roman. Të gjitha gjasat i thoshin vetëm ta falënderojë.

"Gjeneral i nderuar, çdo falënderim i persones sime do të jetë i varfër, ashtu siç është e varfër, e përvuajtur, vetë e zonja e kësaj mirënjohjeje. Çdo Zonjë, sado respekt të ketë për vetveten e vet, do të ndjehej e varfër për ta shprehur admirimin për personin Tuaj, prej gjenerali të lavdishëm"- iu kthye rrëmbyeshëm Sofia duke e humbur toruan për një çast.

Gjenerali u shtir sikur u mallëngjye duke e dhënë shenjën se audienca përfundoi.Të dytë ndaluan tek derë e tendës, me shikim kah Jakova e Jerusalemit të përflakur. Kështu e shikoi edhe në kohën e Rebekes së Alamekut. U mallëngjye: i njëjti qytet, e njëjta flakë drejt qiellit metalik. Më kryesorja aty qe një grua e re, e bukur,mbretëreshë.Ai e ndjente në mishin e zgjuar mashkullor se ç'do të thotë gruaja e re, edhe pse ende ishte larg mundësisë së orgazmës.

Iu kthye, plot mallëngjim Sofisë:

"Me ç'tretman do të udhëtoni, sonte, për në Romë?"

"Do të orvatem të udhëtoj me tretmanin e stjuardesës"- u përgjigj ajo sikur lypi një ndihmë nga gjenerali.

"Mos po bëhen shumë stjuardesa në avionin e orës dy të natës së sontme?"- ankoi gjenerali duke e veneruar flakën e qytetit të djegur.-"Megjithëkëtë Ju,sonte,duhet të arrini në klin-

ikën “Gemeli” të Romës.Mikeja juaj- Rebeka e Alamekut sonte në klinikën “Gemeli” do të operohet; do t’i hapet Mitra. Brenda Mitrës do të shartohet Rabi Jochanan ben Sakai. Izraeli do të shpëtohet nga inati i vetvetes së vet, do të shpëtohet nga poshtërimi evropian”- i foli gjenerali me shikim të tretur nëpër ajrin e nxehtë mbi Jakoven e Jerusalemit.

Sofia e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik heshti. Shpuzat, ende të nxehta, të arrira nga qyteti, ranë para këmbëve të tyre. Të gjallët po katandisen të ikin nga Jakova e Jerusalemit. Njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet gjenerali roman, Titi, priti para mureve të Jakovës së Jerusalemit për këtë zjarr. Gjenerali i trumhasur, sipas rregullës së luftës, priti kaq vite para mureve të Jakovës së Jerusalemit t’ia çatisë fitorja e lavdishme e, jo t’ia vjedhë lavdinë një gjeneral i mynxyrshëm i Rusisë, si Ivan Vasiljeviq Kutozovi.

Ky Rabi velet, Jochanan ben Sakai, me hilen e Orgazmës hebreje e zvarriti fitoren romane mbi Jerusalem deri sa e bëri Jakovë të Jerusalemit. Vetem ky Rabi në tërë Izraelin diti t’ i thotë këto fjalë në tendën e gjeneralit Titi natën e tretë të shtatorit të vitit shtatëdhjetë:

“Tribali i Madh i Izraelit ka vendosur të vdesë në luftë regulare kundër Romës.Unë, Rektori i të dy universitetve të Izraelit, Rabi Jochanan ben Sakai, e mohoj inatin e Tribalit të Madh, i mohoj tempujt e tij, i mohoj titujt e tij ushtarakë, e mohoj fenë e tij. E përgjëroj Romën të ma miratojë liçencën e një universiteti hebre në Diasporë - jashtë Izraelit”.

Sofia e Haçet Deletës e ndjeu nën rroba tundimin e mendimit të gjeneralit roman. E ndjeu në mishin e vet prej gruaje të re, sikur të mos pritej pa i thënë gjeneralit:

“Ilirikut Albanik të Haçet Deletës, gjeneral i nderuar, po edhe të tërë Evropës i ka munguar një vizionar siç qe Rabi Jochanan ben Sakai, Rektori i dy universiteteve të Izraelit. Ju gjeneral e keni të drejtën legjitime të keni shpresuar gjatë një-

mijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet t'u vijë në tendën tuaj të nderuar Redalk San Heldiku, rektori i Jakovës së Jerusalemit krejt sikurse Rabi Jochanan ben Sakai; të mohojë çdo gjë të çmendur të Ilirikut Dardan; të kërkojë themelimin e një universiteti në Diasporë, jashtë Ilirikut. Ju gjeneral i nderuar me të drejtë të ligjshme keni lektisur njëmijë e nëntëqind e njëzetë e nëntë vjet, krejt sipas rregullës së Rabi Jochanan ben Sakait të Jerusalemit, të vijë Mohuesi i Jakovës së Jerusalemit, mohuesi vizionar. Me këtë lektisje i keni mbrujtur së bashku këto dy qytete në: Jakova e Jerusalemit"- vuvshëm i foli Sofia sikur i foli me mishin e saj femëror.

"Ai, rektori i universitetit të Jakovës së Jerusalemit Redalk San Heldiku, besoj të mos ketë ardhë tek tendë sepse Tribali i Madh i Ilirikut arketip ndërkyeshëm hyri në luftë me Romën. Vullnetarisht e asgjasoi vetveten. Nuk u gjet vizionar i kalibrit të Rabi Jochanan ben Sakait ta shpëtojë këtëfarë Iliriku. Ky cep i Ilirikut Dardan,i quajtur Jakovë e Jerusalemit,mbeti mish gaull, i mbyllur në guacën e pushtimeve të njëpasnjëshme; mbeti mish gaulli i paçelur, i pakontaminuar nga liria mashtrimtare, nga mburrja e vetvetes së vet.Mbeti mish arketip, i mbyllur në guacë.

Zonjë e nderuar, vetëm kur çelet guaca atëherë mishi arketip, i pambrojtur nga vetvetja, prishet, stërkeqet, e prishë kodin e vet"- e zgjati monologun në vetveten e vet të vuvët gjenerali roman duke e arsyetuar "gabimin" e ngatërrimit të qyteteve Jakovë me Jerusalem.

"Gjeneral i nderuar pikërisht për këtë unë erdha deri tek tenda Juaj, në fillim të Shtatëmbëdhjetë minutave të Orgazmës amerikane të Pocahontas Powhatanit, sonte në fund të njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjetëve Tuaj para këtyre mureve të Jakovës së Jerusalemit"- zvargshim, nga larg i foli Sofia e Haçet Deletës.

Vitet e gjata të ngathtësisë romane, ndesh Shtatëmbëdhjetë

minutave të Orgazmës hebreje të Rabi Jochanan ben Sakait, e tunduan gjeneralin roman të flasë brenda vetvetes së vet pergamenës së ngadaltë:

"Zonjë e nderuar, Rabi Jochanan ben Sakai kur e pa çmendurinë e Tribalit të Madh të Jerusalemit për të vdekur, për ta asgjësuar vetveten vullnetarisht në luftë të pabarabartë kundër Romës së fuqishme, e mori mishin e vetvetes së vet e të nxënësve të Sanhredinit, e i futi në Mitrën e Rebekes së Alamekut. U mbyll hermetikisht në Universitetin hebre në Diasporë për t'u ruajtur nga vetvetja e vet izraelite deri tek Shtatëmbëdhjetë minutat amerikane te Pocahontas Powhatanit të Massachusettsit.

Ndërsa Ju Zonjë e nderuar, vajtët kot deri në Galile e në Jude, tek Rabi Jochanan ben Sakai për ta pyetur nëse Ju, pikërisht Ju, a do të keni pasë vëlla; a do të ketë qenë shtatzënë nëna juaj- Teuta e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik. Kishit për ç'ka ta pyesni tjetër gjë Rabin. Bile t'ja ofronit mitrën Tuaj për një vizionar nga Jakova e Jerusalemit.

A doni të bëni siç bëri Rebeka e Alamekut?

Hiç më larg se pas një ore të kësonate do ta merrni vesh në tendën e gjeneralit austriak, Herman von Urlihut, fodullëkun e nënës suaj."- zvargia e zërit të gjeneralit roman posa shkonte duke u bërë gjithnjë më e largët nëpër ngathtësinë e pergamenës.

"Gjeneral i ndriçimit mbi lavdinë e jetës, arratisja ime bashkë me Mefiston nga teatri i Berlinit; arritja deri në Galile, zbritja deri në Jude më këllasin midis mençurisë e aventurës, midis heroizmës dhe mendjes së gruas, midis ëndrrës e zhgandrrës. Berlini, Londra, Bohemia, e gjithë Evropa, kanë shpallë fletarreste mbi personen time.Po më lypin midis Animës dhe Animusit të atij Frojdit halabak, të vetarratisur nga Gjermania e vet e shkalluar mendjeje.Arratisja e Mefistos nga akti i dytë i dramës "Fausti"e ngulfati Gjermaninë e Evropës dhe Evropën e Gjer-

manisë për ta zhgarkuar fajin mbi supet e Rabi Jochanan ben Sakait, mbi Mitrën e Rebekes së Alamekut, mbi Jakobin e urtë, mbi Sofinë e Jakovës së Jerusalemit, të shoqes së Grainhelmit të Bohemisë. Për ta shpëtuar vetveten e vet nga vizioni i Rabi Jochanan ben Skait Gjermania e doktor Faustit e rinovoi Holokaustin në Aushvic“ - Sofia e Haçet Deletës së Ilirikut sa po vinte duke dalë dallgë nga vetvetja e vet.

“Të gjitha do t’ja thoni gjeneralit austriak, Herman Von Urlihut. Në arkivin e tij ushtarak gjenden të dhënat laboratorike mbi gjendjen shëndetësore të nënës suaj, Teutës së Haçet Deletës së Ilirikut Albanik.Ai gjeneral rrah gjoks se me psikometrinë e Sigmund Frojdit midis endrrës dhe zhgandrrës, midis Animes dhe Animusit,midis vagjinës dhe penisit.Se midis Jush, Zonjë e nderuar,e vëllait Tuaj, Konstantinit të Haçet Deletës, është matur saktësisht sasia e Masturbimit të Ilirikut Abanik” - gjenerali roman gjithnjë fundosej në mishin e fishkur të pergamenës Njëmijenëntëqindenjëzetenëntë vjeçare.

“Mbase në tendën e gjeneralit austriak mund të jetë edhe vetë ai Sigmundi i Vjenës. Ai mund të më tregojë, po deshi, pse në nëntorin e njëzetetetë shianik të vitit njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë e çeli mishin gaull të nënës sime Teutë, nga e nxori atë llurbën e veshtullt të Shqipërisë së Albanikut Ilirik të mbrujtur me shtatë gjakra hardhuce. Vetëm sa e çeli Sigmundi i Vjenës këtë mish gaull të Ilirikur Albanik duke e lënë ashtu të hapur kundruall pandemisë së masturbimeve evroaziatike e ballkanike. E la në titërr të diellit për t’u prishur mishi i llurbët. U bë më keq se ç’kishte menduar Tribali i madh për vetveten e Izraelit. Askujt, bile as Sigmundit të Vjenës nuk i shkoi nga mendja, siç i shkoi Rabi Jochanan ben Sakait, ta ruajë mishin e Ilirikut Albanik në diasporë”- u mundua Sofia e Haçet Deletës të nxjerrë diç nga gjenerali roman.

“Ju, zonjë e lartë mendoni se Rabi Jochanan ben Sakai e shpëtoi kodin hebre të Izraelit”- mezi e pyeti gjenerali.

“Po, zotëri”

“Ju mendoni, zonjë e nderuar, se gjenerali Harker i Massachusettsit e shpëtoi kodin e mbarë njerëzimit? Dhe se sonte për atë gjë vjen në klinikën “Gemeli” të Romës?”-regetueshëm pyeti gjenerali.

“Po, zotëri”

“Kjo gjë shihet. Shihet mendja e grave të orgazmës”-shteroi gjenerali roman.

Papritur Sofia u tremb. Një një zë i ngulfatur, i qullur nga lagështia e djersëve të gjeneralit u mundua ta bëjë vetveten e tij. Ai e zuri për dore, gati për ta mbajtur pezull.

“Zonjë e nderuar, mbase jeni lodhur sonte nga udhëtimi i gjatë prej Bohemisë tek teatri i Berlinit duke zbritur deri në Galile e në Jude, deri tek fshati Abbi i të dy shemrave: të Rebekes së Alamekut dhe të Kones së Danielit. Ju Zonjë e nderuar a kaluat perafër mureve të Jerusalemit? E patë flakën e qytetit të kallur nga furia e ushtrisë sime të tunduar prej lavdisë së fitoreve nëpër të gjitha betejat?”- gjenerali i shndërruar në pergamenën e amokut e mëtoi Sofinë t’i përgjigjet.

Një vravashkë shkëndijash si luzmë blete hidhërake, e shkëputur nga zjarri i Jakovës së Jerusalemit, arriti deri tek tenda e gjeneralit duke i renë disa shpuza në dorë Sofisë . Ajo e tërhoqi dorën ngacmueshëm kah vetvetja e vet.

“A ta dogji dorën ajo vravashkë zharritëse?”- e pyeti gjenerali pergamenë.

“Po”.

“Atëherë ju zonjë jeni duke e parë me sy tuaj të bukur zjarrin e Jerusalemit të kallur nga ushtria ime e lavdishme.Jeni duke jetuar me mish e me shpirt në Jerusalem. Po ju tundon zjarri i tij i shkaktuar nga ushtria e lavdishme romane”- ra në galdim gjenerali.

“Nga ju erdhi kaq papritmas ky vrull, gjeneral krenar?”- e pyeti me dhimbje Sofia.-“Jakovën e Jerusalemit Tuaj, gjeneral i

magjepsur, e dogj gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi”- sikur foli në grykën e botës tjetër Sofia.

“Edhe ju zonjë e nderuar flisni njejt me Delegacionin e Knesetit të Madh të Izraelit. Ç’rëndësi ka cili qytet është, Jakova apo Jerusalemi? Qenësore del, mbi të gjitha, furia ngulmuese e ushtrisë sime të lavdishme për t’i pushtuar qytetet armike të Romës”- gjenerali roman po mbyllej në pergamenë i shkalluar.

“Gjeneral i nderuar, ju vazhdimisht sikur po e harroni atë gjeneralin tjetër rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovin, po e harroni Tribalin e Madh të Jerusalemit, po e harroni vetveten Tuaj të Evropës!

Ne të tre: Rebeka e Alamekut, Rabi Jochanan ben Sakai dhe unë jemi duke udhëtuar me vrullin e Orgazmës të Shtatëmbëdhjetë minutave të Indigjenes Iroki të Massachusettsit. Më duhet të ta them edhe njëherë se Rabi Jochanan ben Sakai don të mbyllët në Diasporë bashkë me nxënësit e tij të Sanhredinit deri tek Shtatëmbëdhjetë minutat amerikane të Pocahontas Powhatanit të Massachusettsit.

Ne të tre lektisim të shpëtojmë nga Roma, nga vetvetja izraelite, të shpëtojmë nga vetvetja e Ilirikut të Albanikut sovjetik, nga vetvetja e Evropës.”-gati i pëshpëriti gjeneralit-pergamenë .

“Atëherë Rabi Jochanan ben Sakai do të hyjë, sipas viteve hebraikë, në Mitrën e Rebekes së Alamekut nëpërmes asaj Orgazmës amerikane të Pocahontas Powhatanit të Massachusettsit?Edhe ai Redalk san Heldiku,rektori i Jakovës së Jerusalemit e paska gjetë një mitër gruaje të këtyre Shtatëmbëdhjetë minutave hardalle?”- sarkastikisht çfryni gjenerali roman.

“Po, bile pak më shumë se Orgazma e seksit”-e përplasi veten Sofia.

Gjenerali roman e kuptoi pezmin e Sofisë. Ajo kishte mbetur midis hezitimit në e kishte pasur ndonjëherë vëlla atë Kostantinin e përrallës së sigmundit të Vjenës dhe në kishte mbetur

shtatëzënë në tendën e Zatres arameje. E kishte shpupluar mishin e fishkur të tërë Galiles e të Judes, fundekrye, për ta takuar atë Rektorin e iniversitetit të Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldikun, siç shkruan pergamena e resur në shumë vende. Tek dera e Jakovës së Jerusalemit e paskesh ndaluar frika nga gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi. Paskesh ngurruar të hyjë në qytet.

"A do të masturbojnë evropianët edhe pas atyre Shtatëmbëdhjetë minutave amerikane të Pocahontas Powhatanit, të asaj Indigjenes Iroki të Massachusettsit?"- e pyeti pa fije turpi gjenerali roman.

Sofia më nuk pati turp nga një pergamenë.

"Mbase do ta mësojnë joshjen e vagjinës, të Klitoritit, të Orgazmës e, mbi të gjitha, joshjen e Dashurisë"- iu përgjigj pa ngurrim gjeneralit- pergamenë, të perënduar në vetveten e vet.

"Këto fjalë mund t'ja thoni gjeneralit austriak, Herman von Urlihut kur të arrini tek ai, gjashtëmbëdhjetë kilometra nga këtej. Ai është mjek me profesion. Përveç kësaj rrah gjoks se e di ç'është seksi. Ai thotë se është aq i moderuar sa i paska shkuar për dore të bëjë seks me atë Sofi Löhne, të shoqen e Arçidukës se Habsburgëve- Franc Ferdinandit, një natë në kështjellën "Summer of" të Vjenës para se të niset treni perandorak për në Sarajevë"- ironizoi qartë gjenerali roman gjithnjë duke rënë në pergamenë.

"Nga kush e zbuloi seksin ai gjenerali Herman von Urlihu? Si mund ta ushtrojë detyrën e gjeneralit njeriu i cili na ditka se ç'është seksi? Kjo del më shumë se tradhti ndaj shtetit ndaj moralit, ndaj fesë, ndaj zotit"- u rrëmbye Sofia e mllefosur për embargon e vënë mbi diagnozën e Teutës së Haçet Deletës, të shkruara në të dy klinikat: në klinikën "Gemeli"të Romës dhe në klinikën "Mercoledi"të Vjenës.

Gjenerali- pergamenë, Titi, e kishte të njohur mllefin e Sofisë. Iu bë se erdhi çasti për t'ia thënë:

“Edhe pse gjenerali austriak është mjek i diplomuar, i ndalohet rreptësisht të vejë dorë mbi këtë dosje të kompletuar nga konsiliumi i mjekëve të klinikës “Gemeli”të Romës. Konsiliumi i mjekëve të klinikës“Mercoledi”të Vjenës kur e çeli Mitrën e Teutës së Haçet Deletës ditën e njëzet e tetë të nëntorit shianik të vitit njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë veproi i pavarur nga diagnoza e klinikës “Gemeli”të Romës”- foli gjenerali- pergamenë, Titi, duke i rënë në të mllefit të Sofisë.

“Po qe se diagnozat e të dy klinikave evropiane: e “Gemelit” të Romës, dhe e “Mercoledi” të Vjenës ndryshojnë njëra – tjetrës mos mendoni Ju zotëri se do të ndryshojë qëndrimi i Pocahontas Powhatanit Indigjenes Iroki të Massachusettsit. Ndaj në dosjen tuaj të mbyllur në këtë zarf mund t’i jepni kumt të gabuar gjeneralit Herman von Urlihut?”- insistoi gjithnjë e më larg Sofia.

Ajo tashmë po bisedonte m një pergamenë.

“Mos harroni zonjë e nderuar, se Haçet Deleta, babai Juaj, mbreti Juaj ishte masturbuesi më i madh në Ilirikum evropian. Ai Rektori i universitetit, Redalk san Heldiku, bile siç mund të restaurohet nëpër pergamena të përqarta, u arrestua tek tenda e Zatres nga vetë Haçet Deleta-babai Juaj.”- më shumë u duk shkrimi se fjala në gjeneralin- pergamenë, Titi.

“Do të thotë, sipas pergamenës Suaj, gjeneral i nderuar, Haçet Deleta - babai im, paska masturbuar, njësoj sikur mbretërit e tjerë evropianë”- e ngacmuar u hodh Sofia.

“Po, ka masturbuar. Bile edhe më shumë se mbretërit e tjerë evropianë. Kjo do të shihet sonte. Konsiliumi i mjekëve amerikanë me ultralaparaskopi, pavarësisht nga diagnozat evropiane, do ta ekzaminojë, sonte, gjendjen e saj shëndëtësorë”- sikur u ngarrua gjenerali- pergamenë.

“Sonte?”

“Po, sonte”

“Tash është ora një pas mesnate!”- u ngut Sofia.

“Po, aq është”

“Gjeneral i nderuar, lavdia e gjeneralit rus, Ivan Vasiljevi Kutozovit, mbi këtë qytet të kallur, flaka e zjarrit, ua kanë ngatërruar mendjen Tuaj të ndritur.

Në të gjitha pergamenat, mbase edhe në pergamenën Tuaj të arkivit ushtarak, shkruan se Teuta e parë e Haçet Deletës së dytë, natën e njëzet e tetë të qershorit të vitit njëmijë e nëntëqind e katërmbëdhjetë pati dhimbje të padurueshme fundit të barkut. Atë natë Teuta e Haçet Deletës qe vendosur në dhomën numër shtatë të hotelit “Onix” të Sarajevës. Pasi e kontrolloi mjeku ushtarak Zöltan Petöff e kthyen për në Vjenë me po atë tren perandorak me të cilin kishte arritur nga Vjena. Prej nga, sonte, Teuta e Haçet Deletës në klinikën “Gemeli” kur dihet se atë ditë qershori i humbi çdo gjurmë?”-e shulustrisi Sofia gjeneralin- përgamenë, Titi.

11.

Ajo e shikoi gjeneralin Titi, gati të shndërruar në pergamenë të rysur nëpër shumë vende, të shndërruar në një tekst të palexueshëm.Ishte rrezik një shkëndi, sado e vogël për ta zhbiruar atë pergamenë.

"Pyete gjeneralin austriak, Herman von Urlihun. Ai ishte atë natë në hotelin "Onix" të Sarajevës. Përveç kësaj gjenerali e kishte bërë rrugën prej Vjenës deri në Sarajevë me Teutën e Haçet Deletes në një kupe të trenit perandorak tok me Sofinë Löhne dhe Arçidukën Franc Ferdinandin- trashëgimtarin e fronit perandorak të Austrisë. Ai do të të tregojë, po deshi"- u çfajsua gjenerali- pergamenë

"Ju gjeneral i nderuar sikur dyshoni në diagnozat e të dy klinikave evropiane?"-lakmoi ta pyesë gjeneralin-pergamenë ende pa u nda nga njëri-tjetri.

“Vetëm metoda ultralaparaskopike amerikane do ta sqarojë, zonjë e nderuar, nëse ju keni pasur vëlla ndonjëherë, nëse Teuta e Haçet Deletes,e shoqja e masturbuesit më të shquar të Ilirikut të Albanikut sovjtik, do të ketë qenë shtatzënë nën diagnozën “Sanguis lacertae in utero”- gjithnjë e më larg foli gjenerali pergamenë.

Sofia e dëgjoi, të përgjysmuar, diagnozën e Teutës së Haçet Deletës, gjendjen shëndetësore të Nënës së vet.

A mundet një grua të mbetet shtatzënë me këtë diagnozë? Gjenerali Titi i tregoi tërthorazi se Herman von Urlihu qenkesh me profesion mjek; mbase në tendën e tij mund ta takoje edhe vet Sigmundin e klinikës “Mercoledi” të Vjenës. Por asaj i mbeti peng në zemër kuvendi i gjeneralit Titi. Si qenka e mundur një gjeneral roman të flasë me aq respekt shkencor për një ekip mjekesh amerikanë në Romë?!

Tashmë po fliste pergamena.

“Ju gjeneral i nderuar flisni për një ekip mjekësh amerikanë duke e anashkaluar se ai ekip vjen në Romë me ushtrinë amerikane.Mbase u është shterë gjaku roman prej gjenerali sa ta pranoni pushtuesin e Romës, pushtuesin e atdheut Tuaj, me kaq gjakftohtësi?”- e provokoi sedrën e gjeneralit- pergamenë.

“Zonjë e nderuar, unë ju flas nga pergamena e perandorisë së Romës. Edhe Rabi Jochanan ben Sakai, edhe Rebeka e Alamekut, edhe Delegacioni i Knesetit të Madh të Izraelit, edhe Ju, zonjë e nderuar edhe Nëna juaj- Teuta e Haçet Deletes, ja mësyni Romës perandorake për hallet tuaja. Po Ju, zonjë e nderuar, e dini se edhe Jezusi ia mësyni Romës. Të gjithë. Derisa Jezusi ra në duar të qonquistadorëve evropianë, Roma qe bërë qendër e shikimit të qashtër të Tij.Kur Jezusi i qonquistadorëve evropianë e ndërroi shikimin e qashtër në shikim frikacaku, hidhëraku, pushtuesi, në shikim macho pancha të kontinentit latin, e zgjoi urrejtjen e Pocahontas Powhatanit, asaj Indigjenes Iroki të Massachusettsit e cila sonte po zbarkon me ushtri amerikane në

Siçili për ta restauruar Jezusin e qonquistadorëve evropianë, për t'ia kthyer botës Jezusin ekologjik. Evropës i mungoi një vizionar i rangut të Rabi Jochanan ben Sakait ndaj sonte ia çatisë Indigjenia Iroki e gjeneralit të Massachusettsit"- sikur po e restauronte vetveten e vet gjenerali- pergamenë.

Sofia e Haçet Deletës e heshti vetveten e vet, e frikësuar se mund të marrë flake gjenerali- pergamenë.

"Sonte do të jeni pranë mikes Suaj, Rebekes së Alamekut në klinikën "Gemeli"të Romës. Ajo domosdoshëm e ndjenë personin Tuaj pranë vetvetes së vet. Atje do ta mësoni të panjohurën e popujve edhe, të popullit tënd të ndarë në dy kode gjenetike"- me zë miqësor i sugjeroi gjenerali duke ia lëshuar në dorë një zarf të vogël.

Sofia ngurroi ndonëse gjenerali qe i vendosur. Ai e njohu dëlirin e ngurrimit të saj. Vet gjenerali e ndjeu ligështimin e vetvetes së vet. Mbase e ndjeu në vete mallin për Rebeken. U tremb në mos Sofia e kishte ndjerë praninë e Rebekes në rrethana të caktuara,të dyshimta,kujtimesh.E ndjeu se zemra i qenka bërë lakmitare pa e hetuar se brenda saj e paskan rysur mishin e zgjuar të Seksit, Klitoritit, Orgazmës. Nga pergamena po bëhej njeri.

"Gjeneral i nderuar, Rebeka e Alamekut u paska thënë se domosdo duhet të jem sonte pranë saj në klinikën "Gemeli" kur ajo të operohet?"- me një zë intim Sofia e zgjoi gjeneralin.

"Rebeka i ka bërë gati për Ju të gjitha: bexhin e stjuardesës, uniformën e stjuardesës dhe uniformën e infermieres; kuptohet të gjitha dokumentet e udhëtimit dhe biletën e aeroplanit"- në zërin e gjeneralit sikur e hetoi një fije të konspiracionit. - "Në avionin e orës dy e gjysmë të natës së sotme për në Romë, ju zonjë e nderuar do ta takoni Rebeken, poashtu më rrobën e stjuardesës, do ta takoni Rabi Jochanan ben Sakain, do ta takoni Delegacionin e Knesetit të Madh të Jerusalemit. Secili sosh, sonte, udhëton për punët e veta. Mos iu afro Rebekes se mund

të dyshojë Shërbimi informativ.Mund të komunikoni vetëm me shikime diskrete. Do të jeni pranë saj në klinikën "Gemeli" kur në Mitër do t'i shartohet Rabi Jochanan ben Sakai. Kur t'i shartohet në mitër i gjithë Izraeli. Do ta shihni mrekullinë e kodimit gjenetik të një populli në Mitrën e një gruaje. Do të shihni se si Rebeka e Alamekut nga Abbi i Galilesë së epërme e shpëton kodin gjenetik të Izraelit nga mitra e Kones së Danielit. Do të shihni se si Rebeka e shpëton Izraelin nga inati i vetvetes izraelite; e shpëton nga vetasgjësimi i inatit të Knesetit të Madh të Jerusalemit"- mori flake gjenerali roman, por tash flakën e tij e mbajti nën zap mishi gati i zgjuar i njeriut.

Sofia e ndjeu nën rrobën e saj të mëndafshtë zërin e dobësuar të gjeneralit, e ndjeu tundimin e mishit të tij mashkullor. Pati arsye për t'u trembur. Ndaj për një çast sikur lektisi të digjej në prushin e qytetit të vet: të Jakoves së Jerusalemit. Më në fund ajo ofshami thellë në vetveten e vet.

Ajo qe aty qysh në fillim të Shtatëmbëdhjetë minutave të Orgazmës së madhe.

Gjeneralit i erdhi dëliri i flashkët nëpër ajrin e vapullimt nga qyteti i Jakoves së Jerusalemit.

"Gjeneral i nderuar, në fund të Shtatëmbëdhjetë minutavetë orgazmës së Izraelit kush do të ndërhyjë kirurgjikisht në Mitrën e Rebekes së Alamekut"- e provokoi Sofia.

"Mbase ta thash më parë".

"Po ç'do të ndodhë me mitrën e kones së Danielit;me Delegacionin e Knesetit të Madh të Jerusalemit pas kësaj ndërhyerjeje në Mitrën e Rebekes së Alamekut?"-këtë herë Sofia dredhoi nëpër pyetjen e vet.

"Edhe Koneja e Danielit do të përgatitet për ndërhyrje kirurgjike por këtë here jo në klinikën "Gemeli". Për shkaqe të etikës mjekësore Koneja e Danielit do të vendoset në fillim në stacionin veterinar për të cilën do të pajtohet Delegacioni i Kne-

setit të Madh të Jerusalemit”- i bëri dalë edhe kësaj çështje gjenerali roman.

“Po nëse Delegacioni i Knesetit të Madh të Jerusalemit do të kundërshtojë”- u ndrojt Sofia.

“Rregulla ndërkombëtare, me konventë, e ka nyjëtuar këtë çështje”- ia këputi gjenerali. -“Delegacioni i Knesetit të Madh do të mjaftohet ta shohë konen e Danielit duke u futur në sallën e ndërhyrjeve kirurgjike. Kaq arrin përgjegjësia e këtij delegacioni”- vazhdoi gjenerali për ta plotësuar kureshtjen e Sofisë.

Gjenerali roman, Titi e ndjeu gjatë gjithë bisedës drojën e Sofisë se mos dokumentet e ngatërruara nëpër arkivat e Evropës mbi Teutën e Haçet Deletës duhej kërkuar nëpër morgjet e klinikave të Vjenës.

12.

Gjenerali roman, Titi, e kishte parë në dokumentet e Shërbimit informative të Romës raportin mbi udhëtimin sekret të Kostantinit të Haçet Deletës së Ilirikut të Albanikut sovjetik natën e tetëmbëdhjetë të prillit të vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një. Konstantini atë natë kur zu të pikë kulmi i Kremlinit, e paskësh kaptua ilegalisht kufirin midis Shqipërisë së Albanikut sovjetik dhe Jakovës së Jerusalemit. Ra tek shtëpia e Sofisë së Haçet Deletës.

Ky dokument i shërbimit informative të Romës perandorake bie ndesh me dokumentet e klinikave të Romës së sotme e të Vjenës.

Ai u paraqit si vëllai i Sofisë.

Dokumentet sekrete të Romës së sotme shkruajnë se natën e tetëmbëdhjetë të prillit të vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një zu të pikojë kulmi i Kremlinit.Po atë natë në Shqipërinë

e Albanikut sovjetik zu të lëvizë rrasa e varrit të Kostantinit të Haçet Deletës.

Natën e tetëmbëdhjetë të prillit shianik Kostantini u çue nga varri i mbushur rristik me ujë. Ashtu siç qe i ulur në varr uji i mbërrini deri tek qafa. Nga përgjimet e largëta fono-metrike të shërbimit të sigurimit roman, Kostantini i Haçet Deletes, ashtu i ulur në varrin e vet, i zhytur deri tek qafa në ujë, i paskësh thënë vetvetes së vet:

"Qenkam vonuar! Me paska zënë gjumë vdekjeje! Si duket Sofia, ime motër, më thirri".

Pasi paskesh dale nga varri e paska mbërthye aftimi i cemt i natës shianike.

Serish paska rënë në kuvend me vetveten:

"Qenka ftohtë të dalësh nga varri. Po si e gjeti ajo Sofia të më thërrasë me aq ngulm mu në këtë natë shianike?"

"Zëri i Kostantinit të Haçet Deletës, i inçizuar në shiritin e manjetofonit, mund të jetë i kontrabanduar për voli diplomatike"- mendoi gjenerali roman Titi.

Gjatë e kishte heshtur ketë ngatërrim dokumentesh. Bile kishte vendosur të mos ia thotë Safisë së Haçet Deltës. Ajo atë natë kishte qenë shtatëdhjetë e pesë vjeçare.

Por Sofia nuk kishte pasur vëlla në pergamenat romane.

"Këtë moshë le t'ia përmendë gjenerali austriak, po deshi. Ai gjeneral di të bisedojë me gra të daluara moshe"-e kompletoi vetveten gjenerali roman Titi.

Sofia e Haçet Deletës e këputi heshtjen e gjeneralit roman me një kureshtje gati mizore: "I besoni Ju gjeneral Shtatëmbëhjetë minutat e Megaorgazmës së Indigjenes Iroki të Massachusettsit?"

"Sipas protokollit këtë përgjigje mund t`ua japë gjeneralit austriak, Herman vonë Urlihu"- ia preu vendosmërisht gjenerali Titi.

-“Ju zonjë e nderuar pasi ta keni përfunduar bisedën me gjeneralin austriak, Herman von Urlihun, do ta zëni avionin e orës dy e gjysmë pas mesit të natës së sontme për në Romë. Po ta përsëris edhe njëherë: mos komuniko në avion me Rebeken e Alamekut! Ajo përkthyesja nga zyra italiane e OSCE-së tok me atë mjekun italian i kanë aktivizuar të gjitha aparaturat e përgjimit për të inçizuar çdo bisedë, mbase edhe këtë bisedën tone këtu para tendës”- foli, gati me vetveten e vet gjenerali Titi.

Sofia e Jakovës së Jerusalemit vendosi të heshtë.Diç i kishte rënë plumb në gjoks.I shtrëngoi edhe më dokumentet e udhëtimit.

“Qyteti im, Jakova e Jerusalemit, sonte do t’i dertë Shtatëmbëdhjetë minutat e Orgazmës në mishin gaull të mbyllur në guacën e rënë në fund të oqeanit të të shtatë pushtimeve me sanguis lacertae in utero. Jakova ime e Jerusalemit, sonte, në orën katër do ta mësojë Seksin, Orgazmën, Dashurinë hebreje të Rebekes së Alamekut dhe të Rabi Jochanan ben Sakait deri tek orgazma amerikane e Indigjenes Iroki”- u rrokullis në vetveten e vet Sofia duke e ndie lëvizjen e gjallë të foshnjës në bark.

“Zonjë e nderuar!”- thirri gjenerali kur e pa dëlirin në sytë e saj.-“Midis mitrës dhe varrit njerëzit, kombet, popujt, e humbin rrugën. E sheh sonte Izraelin? Rabi Jochanan ben Sakai e ka zënë rrugën e Mitrës-rrugën e jetës. Rabinët e Knesetit të madh të Izraelit e kanë zënë rrugën e varrit, rrugën e vdekjes. Vagjina dhe varri janë gropa të errta,dy rrugë të ndryshme. Sonte, zonjë e nderuar është natë kodike, natë klonimesh të jetës e të vdekjes”- tashmë gjeneralin roman e mbronte nga zjarri mishi i mbrujtur i njeriut pergamenë.

“Gjeneral i nderuar ju po flisni sikur të keni dale përgjithmonë nga pergamena”-e përgjëroi Sofia e rënë në dëlir nga lëvizja e foshnjes në barkun e saj.

Ishte foshnja e zënë në orgazmën tek tenda e Zatres Arameje.

"Zonjë e nderuar, ju përgëzoj për fetusin e pare në barkun Tuaj! Arrite ta mësosh Seksin,Orgazmën e, mbase popullit tënd të kësaj Jakove të Jerusalemit do t'ja mësosh edhe Dashurinë siç do të bëjë Rebeka e Alamekut me popullin e vet të Izraelit.

Zonjë e nderuar kur e dëgjova zërin euforik të Musolinit-Cezar duke u çjerrë ne sheshin e Romës mendova se përfunduan njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjetet e pritjes sime me shpejtësi romane. Mendova se përfunduan |Shtatëmbëdhjetë minutat e orgazmës hebraike. Por Benedito Musolini u pehat midis gropës së zezë të varrit e gropës së zezë të vagjinës. U marramend për një çast: e zgjodhi gropën e zezë të varrit. Atëherë, me dhimbje të madhe, unë gjenerali Titi përfundova, për gjithmonë në pergamenë të vuvët, të resur, i pamundur të flas kurrë më"- foli nga larg gjenerali roman Titi.

13.

"A ia ka çatisur në Jakovën e Jerusalemit tim Redalk san Heldiku?"- i shqetësuar, me ngulm pyeti Rabi Jochanan ben Sakai.

"Po Rabi i hirësuar"- u përgjigj zëri nga thellë.

"Athua Jakova e Jerusalemit tim e paska ndarë mendjen të shkojë drejt gropës se zezë të varrit heroik apo drejt gropës së vagjinës?"- u dhimbshurua Rabi.

"Do të presim deri tek Shtatëmbëdhjetë minutat e Megaorgazmës së Indigjenes Iroki - Pocahontas Powhatanit të Massachusettsit"- serish nga mishi i mitrës foli zëri i largët.

"Po ata njerëz të stivuar tek ura e Tabakëve ç'mendje kanë ndarë për vetveten e qytetit të Jakovës së Jerusalemit?"- pyeti Rabi Jochanan ben Sakai.

"Kanë vendosur t'i reshten gropës së zezë të varrit heroik, e zgjodhen rrugën e vagjinës"-e ngushlloi zëri. "

“Mbase këta njerëz e kanë zgjedhur rrugën e vagjinës kah Diaspora për vetveten e tyre?”- insistoi Rabi jochanan ben Sakai.

“Po”.

“A e kanë marrë bekimin e Evroromës për Diasporën e tyre?” - u ngazëllye Rabi Jochanan ben Sakai.

“Evroroma frikësohet ta miratojë diasporën e këtyre njerëzve të Jakovës së Jerusalemit.Nuk don të bie në konflikt me Rusinë sovjetike. Gjenerali rus, sonte, e ka dëbuar misionin e OS CE-së nga Jakova e Jerusalemit. Ky gjeneral rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, po i çel mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit, përtej vagjinës, për ta gjetur atë rektorin e këtij qyteti, Redalk san Heldikun”- shpjegoi zëri.

“Sikur më the: “Jakova e Jerusalemit?”- e pyeti Rabi.

“Po, të thash, Rabi i hirësuar.

“Ta njoha zërin”- u galdua Rabi Jochanan ben Sakai. -“E paske zgjedhur rrugën e vagjinës, jo rrugën e varrit. Me shumë përbuzje, keni arritur ta zgjedhni njërën nga ato: grykën e varrit ose grykën e vagjinës”- sikur e bekoi rrugën e bashkëbiseduesit të vet Rabi.

“Ju, Rabi i hirësuar, ma zgjodhët rrugën e vagjinës atë natë në tendën e Zatres Arameje”-e përgjëroi zëri nga mitra e Sofisë.

“Ju njoha qe në fillim miku im”-i tha Rabi.- “E paske mësuar rrugën e Seksit, të Orgazmës, të Dashurisë, të jetës por, ende jo edhe të…”- e përgëzoi Rabi

“Po e ndjej dorën e Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatan, të Massachusettsit mbi barkun e nënës sime, mbi barkun e gruas sime, mbi barkun e të dashurës sime, mbi barkun e motrës sime”- u përgjigj rektori i Jakovës së Jerusalemit- Redalk san Heldiku.

“Mos u ngut Redalk san Heldik! Ju e njihni vetëm Seksin e zgjuar në tendën e Zatres së Aramejeve brenda Shtatëmbëdh-

jetë minutave të Orgazmës hebraike. Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Reinhard Von Grainhelmit të Tretë, princit të Bohemisë, hyri në tendën e Zatres së Aramejeve dhe ra mbi mishin tënd prej mashkulli të zgjuar. Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Reinhard Von Grainhelmit të Tretë, princit të Bohemisë, atë natë u arratis nga teatri i Berlinit bashkë me Mefiston, pikërisht kur ky Mefistoja duhej të paraqitej në skenë tek akti i dytë i dramës "Fausti"- iu drejtua Rabi rektorit të Jakovës së Jerusalemit.

"Rabi, Ju dyshoni se Dashurinë të mos e kam njohur ende"- sikur i kërkoi ndihmë Redalk san Heldiku

"Dashurinë e Jezusit ekologjik e ka nuhatur vetëm ajo Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatan e Massachusettsit. Ajo e ka nda Dashurinë e Jezusit nga shikimi i falsifikuar, nga shikimi i trafikuar i Jezusit të qonquistadorëve evropianë në kontinentin latin.

"Zonjë e nderuar, Ju pasket qenë shtatzënë?"- i foli me habi gjenerali Titi.

"Po".

"Mos lejoni asfarë ndërhyrje kirurgjike po qe se gjenerali Herman von Urlihu ua propozon klinikën "Mercoledi" të Vjenës.Po e pranuat këtë propozim pergamenat tuaja,zonjë e nderuar,do të pleksen nëpër morgjet e Vjenës."-gati prerazi e urdhëroi gjenerali roman Titi.

"Gjeneral i nderuar, gjeneral i fitoreve të lavdishme, erdha sonte në tendën Tuaj të lavdishme vetëm të mësoj nëse Nëna ime- Teuta e Haçet Deletës, a ka mund të ketë qenë shtatzëne; a ka pasur mundësi, unë- Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Rainhard Von Grainhelmit të Tretë të Bohemisë, ta kem pasë vëlla Kostantinin e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik"-krenarisht foli Sofia.

"Sërish më detyroni, zonjë e nderuar, t`Jua përsëris se për këtë vëlla Tuajin duhet ta pyetni gjeneralin austriak Herman

von Urlihin”- diplomatikisht, edhe një here gjenerali roman iu shmang përgjigjës.

“Gjeneral i nderuar përgjigjia juaj e tërthortë thotë mjaft, aq sa të kuptohet se Shtatëmbëdhjetë minutat e Jakovës së Jerusalemit duhet shartuar me orgazëm të freskët hebreje të Rabi Jochanan ben Sakait dhe me orgazëm të gjeneralit Harker të Indigjenes Iroki Pocahontas Powhatanit në mitër ekologjike”- deshi ta falenderojë gjeneralin roman.

“Si do ta merrni, zonjë, këtë orgazëm të freskët hebreje e amerikane për ta përtrirë Jakovën Tuaj të Jerusalemit?”- e provokoi paksa gjenerali.

“Do t’i rys të dy orgazmat, atë hebreje dhe amerikane, në mitrën e një gruaje të Jakovës së Jerusalemit.”- ia kthei ajo me aludim.

“Kaq vjet po pres unë para këtij qyteti të Jakovës së Jerusalemit kaq kot?”- ankoi gjenerali roman.

“Gjeneral i nderuar Ju i keni shërbye këtij qyteti të dyfisht të Jakovës së Jerusalemit.Njëmijë e nëtëqind e njëzet e nëntë vjet as nuk e keni bërë për vete as nuk ia keni dhënë kujt. Kështu kanë vepruar edhe gjeneralët tjerë pas Jush. Sikur Ju romanët të kishit pasë orgazëm Jakova e ajerusalemit do të ishte bërë romane pa asnjë ditë luftë. Sa herë pushtues të fuqishëm ushtarakisht por primitivë shpirtërisht, moralisht, ekonomikisht, fetarisht… e stërkalen me gjak hardhuce mitrën e Jakovës së Jerusalemit. Pa pikë nevoje, me xhelozi, e mbajten nën embargo gjenetike.Sikur Roma të kishte pasë orgazëm për vete Jakova e Jerusalemit do të ishte bërë romane. Tashmë do ta kishte hequr brengën e kombit. Gjeneral i nderuar e sheh se nëntëmbëdhjetë shekuj i ke humbur duke e ruajtur Jakovën e Jerusalemit të mos bëhet romane. Kështu kanë vepruar edhe gjeneralët tjerë pas teje.

Sonte, gjeneral i nderuar, po vjen në Jakovën e Jerusalemit gjenerali amerikan, John Harkeri i Indigjenes Iroki të Massach-

usettsit. Gjenerali John Harkeri është i pari gjeneral me orgazëm në historinë e njerëzimit”- foli e shoqja e Rainhard Von Grainhelmit të Tretë, trashëgimtarit të frontit mbretëror të Bohemisë.

“Ju Zonjë e nderuar mendoni edhe për Romën se paskesh qenë pushtues primitiv?”- e pyeti me kureshtje gjenerali roman.

“Jo se mendoj unë, por e vërteta flet vet. Roma ka qenë pushtuesi i pare primitiv mbi Jakovën e Jerusalemit. Ajo Romë primitive erdhi me Jezusin e lig, frikacak, me Jezusin ziliqar me shikim të sëmur.Erdhi Roma me Jezusin e qonquistadorëve evropianë. Pastaj ky Jezus i sëmuar, frikacak, hileqar, ziliqar, u shpërnda nëpër gjithë Evropën e bërë fertele. Askund nuk zu tamam vend. Mbeti ai Jezus pa mundur të na bëjë romanë të mirëfilltë. Po të ishim bërë romanë të mirëfilltë qe në fillim, do ta kishim hequr dertin me kohë. Nuk do të ishim marrë me çështje bizantine, sllave, turke, arabe, sërish sllave, me sockomunizmat më ekstremë.E sheh se ç’na ka borxh ai Jezusi qonquistador roman? As nuk mundi të na bëjë si veten as ne nuk mudem ta bëjmë Jezusin si veten. Mbetem të huaj për njëritjetrin. Sonte, pas dy orësh, do ta presim Indigjenen Iroki të Massachusettsit të na sjellë Jezusin e ri ekologjik të orgazmës amerikane”-u rrëmbye Sofia e Haçet Deletës së Ilirikut,e shoqja e Rainhard Von Grainhelmit të Tretë,Trashëgimtarit të fronit mbretëror të Bohemisë.

“Zonjë e nderuar, mbase ju ishit shumë primitivë për t’u bërë romanë të mirëfilltë!”- ankoi gjenerali

Mbase zoti gjeneral”

“E sheh se Roma nuk e ka gjithë atë faj sa mendoni Ju!”-arsyetoi gjenerali.

“Atëherë zoti gjeneral përse i humbet nëntëmbëdhjetë shekuj, me gjithë ato shpenzime ushtarake duke e ruajtur të rrethuar Jakovën e Jerusalemit? Kujt ja ruajtët?- gati ra në letargji Sofia.

“Po atëherë, zonjë e nderuar, përse ju vetë nuk u mbrojtët nga Roma ose të bëheni vullnetarisht romanë? Ju vet, pa vullnetin e Romës?”-pyeti gjenerali.

“Sepse qemë popull me përtaci biologjike. Pa zot tonë, pa religjion tonë, pa profet tonë...”- ankoi Sofia.

“Atëherë përse ankoheni zonjë e nderuar? Ju nuk paskeni pasë asnjë gjë për t’i dhënë Romës as për të ruajtur për vete!”- sikur u tall paksa gjenerali.

“Pikërisht zoti gjeneral. Ne jemi dyherë humbës: nuk qemë për vete as për Romën. Por edhe Roma nuk del më e mençur. Edhe ajo është dyherë humbëse: nuk qe për ne as për vete. I humbi nëntëmbëdhjetë shekuj duke e ruajtur Jakovën e Jerusalemit”- gati ironizoi Sofia.

“Zonjë e nderuar, Jezusi qenquistador, mercenar, paska bërë hutesë nëpër Evropë?! Sonte, vetëm pas dy orësh, po ia çatiska Jezusi ekologjik i indigjenës Iroki, Pocahontas, Jezusi i Megaorgazmës amerikane të gjeneralit John Harker?”-ironikisht u përpoq ta frikësojë gjenerali.

“A mund të na i thotë edhe gjenerali amerikan fjalët Tuaja, të një gjenerali roman? Të na thotë: Jakova e Jerusalemit nuk është as për vete as për Amerikën! E pastaj, pas këtyre fjalëve ta mbajë të rrethuar Jakovën e Jerusalemit për nëntëmbëdhjëtë shëkuj”- qesendisi Sofia.

Gjenerali roman provoi të heshtë diplomatikisht.

“Edhe pse, ju gjeneral, jeni jupiteras, mbase edhe pak mojsias, mund të fyheni për këto fjalë mbi Jezusin qonquistador sepse ai i takoi popullit tënd dyherë. Ishte hebre me origjinë. U bë romas me fe. I parapërcatuar të bëhët Macho Pancha i kontinentit latin.”- po dilte nga vetja e vet Sofia e Jakovës së Jerusalemit,e shoqja e Rainhard Von Grainhelmit të Tretë, Trashëgimtarit të fronit mbretëror të Bohemisë.

14.

"Zonjë e nderuar, nga barku Juaj po flet foshnja jo Ju. Për këtë foshnje të gjitha pergamenat vetëm belbëzoja pa arritur ta thonë një të vërtetë të besueshme"- e kishte njohur zërin e Redalk San Heldikut nga Mitra e Sofisë gjenerali roman.

"Gjeneral i nderuar, siç thatë edhe ju vetë, pak më pare, unë u arratisa nga teatri i Berlinit tok me Mefiston kur duhej të fillonte akti i dytë i dramës "Fausti". Vajtëm në Galile tek fshati Abbi për ta takuar Rabi Jochanan ben Sakain. Rashë unë, vetëm me Jakobin e urtë, deri në Jude për t`ju takuar juve gjeneral.

Rabi Jochanan ben Sakai m'i përmendi: Redalk san Heldikun, tendën e Zatres Arameje, diagnozën e përgjysmuar të nënës sime - Teutës së Haçet Deletës: "Sanguis lacertae… Kostantinin e Haçet Deletës. U pleksen gjërat. Edhe sonte e kam të paqartë, sikur atë natë në Galile, cilën foshje e kam në

barkun tim: djalin tim, babain tim, vëllain tim apo Redalk san Heldikun.

Pastaj udhëtuam nëpër shkretëtirë drejt tendës suaj të nderuar.

Në tokën e Aramejeve, para tendës së princeshës Zatra ndaloi Rabi Jochanan ben Sakai. Më urdhëroi, me një shikim të mbytur në pluhurin e shkretëtirës:

"Hyr në këtë tendë! Shtriju lakuriq mbi shtatin e ushtarit të arrtisur nga ushtria osmane! Merr mish mashkulli nga ky ushtar! Shpije spermën e tij nëpërmes mitrës sate në qytetin tënd të Jakovës së Jerusalemit sonte kur gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, po i çelë të gjitha mitrat e grave të qytetit tënd për ta gjetur fetusin e Redalk san Heldikut - rektorit të universitetit të Jakovës së Jerusalemit"-e vazhdoi rrëfimin Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Rainhard Von Grainhelmit të Tretë, Trashëgimtarit të fronit mbretror të Bohemisë.

"E njoha nga barku Juaj, zonjë e lartë, zërin e Rektorit të universitetit të Jakovës së Jerusalemit - Redalk san Heldikut. Andaj edhe ju porosita: nëse gjenerali austriak ju propozon ndërhyrje cezareske në mitrën Tuaj tek klinika "Mercoledi" e Vjenës, Ju mos pranoni!"- e përsëriti serish gjenerali roman Titi.

Sofia heshti. Deshi t`i thotë gjeneralit roman se këtu e njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vite shtatë gjeneralë, njeri pas tjetrit, po e dëgjojnë zërin e Redalk san Heldikut nga barku i saj, nga mitra e saj, pa e ditur se cili është ai. Ajo ishte në hall ta dijë vetveten cila është. A është nëna e babait të vet apo gruaja, a është nënë e vëllait të vet apo gruaja, a është vetvetja e vet apo foshnja e vet.

Sofia e Haçet Deletës së Ilirikut, e shoqja e Rainhard Von Granhelmit të Tretë, Trashëgimtarit të fronit mbretëror të

Bohemisë deshi t`ia shpjegojë gjeneralit roman se të shtatë gjeneralët sonte po e mbanin të rrethuar Jakovën e Jerusalemit vetëm për ta çelë një mitër gruaje. Cilit gjeneral, nga të shtatët: gjeneralit roman Titit, gjeneralit turk Jollmyz Kadirogllu, gjeneralit austriak, Herman von Urlih apo gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit, do t`i bie hise?

Ajo serish heshti. U soll e hutuar nën vrushkullin e ajrit të helikës së helikopterit. Për here të pare gjenerali roman, Titi, u mbështet për trupin e saj.

Deshi t`i thotë diç në vesh por zhurma e motorit të helikopterit e mbyti pëshpëritjen e gjeneralit.

Helika e helikopterit vertëllitej në ajrin e natës vapullore. Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Rainhard von Grainhelmit të Tretë, Trashëgimtarit të fronit mbretëror të Bohemisë me njërën dorë i shtrëngoi dokumentet në gjirin e vet alabastër e me dorën e djathtë e zuri kapelën për të mos i renë.

Në derë të helikopterit, ktheu kokën kah tenda duke ia lenë peng një shikim të gjatë gjeneralit- pergamenë.

15.

Sofia e Jakovës së Jerusalemit,e shoqja e Rainhard von Grainhelmit të Tretë,Trashëgimtarit të fronit mbretëror të Bohemisë, e pikasi pagjumësinë njëjavore të gjeneralit austriak, Herman von Urlih. Ai po e lexonte pergamenën e vitit njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë të ditës së njëzet e tetë të nëntorit ku ishte shënuar vizita e Teutës së Haçet Deletës së Ilirikut në klinikën "Mercoledi" të Vjenës. Ajo pergamenë, ose kopja e saj, i ishte dërguar gjeneralit austriak, Herman von Urlih, komandantit të krahut jugor të ushtrisë perandorake, pesëmbëdhjetë kilometra në perëndim të Jakovës së Jerusalemit. Në pergamenën e çatisur nga Vjena, i pari qe nënshkrimi i Sigmund Frojdit. Diagnoza e Konsiliumit të mjekëve të klinikës "Mercoledi" të Vjenës vende- vende qe resur duke u bërë e palexueshme.

Gjenerali austriak, Herman von Urlik, çdo vjeshtë të tretë, qe nga viti njëmijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë, ritualisht, e lexonte këtë pergamenë të resur duke u munduar ta deshifrojë diagnozën e klinikës "Mercoledi" mbi gjendjen shëndetësore të Teutës së Haçet Deletës së Ilirikut Albanik. Në atë pergamenë, deridiku lexohej: "Ditën e njëzet e tetë të nëntorit të vitit njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë konsiliumi e trajtoi kirurgjikisht Teutën e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik ".

(Diagnoza: …gravitas… - e palexueshme.)

Për konsiliumin e mjekëve të klinikës "Mercoledi"- Vjenë, njëmijë e nejtëqind e dymbëdhjetë. Dita e njëzet e tetë e vjeshtës së tretë:

Dr. primarius: Karl von Hamer

Dr. sc prim. : Fekner Gratzli

Sc. doc. : Bernhajm von Erbit

16.

Një orë pas mesit të natës, gjenerali austriak Herman von Urlih, komandant i krahut Jugor të ushtrisë perandorake të Austrisë po e lexonte Dekretin e Këshillit të lartë të NATO-s:

"Pas dy orësh, sipas gradës suaj ushtarake, jeni i detyruar ta përfaqësoni shtetin Tuaj në seancën e lartë të paktit NATO i cili do të mbahet në rrethana të jashtëzakonshme ne zyrën e lartë të OSCE-së e improvizuar në qytetin e Jakovës së Jerusalemit"- kur ordinanca e tij ia dorëzoi urgjentisht kartëvizitën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, të shoqes së Rainhard von Grainhelmit të Tretë, Trashëgimtarit të fronit mbretëror të Bohemisë.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, i mbajti të dyja letrat e ardhura me urgjencë ushtarake. Por për një çast mëdyshoi midis të dyjave. Pagjumësia e lyrshme ia nxori një fytyrë të hequr pagjumësie. Mustaku i përgjumur, nën hundën e gjene-

ralit, mezi i mbajti krahët e hapur në dy anët e buzëve. Dy sy në fytyrën gjatovinë, të vendosur në dy guva të mugëta u ngjallën ushtarakisht kur Herman von Urlih e lexoi emrin e relievuar në dekretin e NATO-s:

John William Harker, gjenerali amerikan i NATO-s

Ende pa ardhë në vete nga emri i relievuar me shkronja të nxjerra metalike, gjenerali austriak, Herman von Urlih ia lëshoi sytë Kartëvizitës së sjellë nga ordinanca:

"Me shpresë të pavdirë në personen tuaj prej gjenerali të shkëlqyer, vajza e varfër e Haçet Deletës së Ilirikut, e kurorëzuar me trashëgimtarin e fronit mbretëror të Bohemisë Rainhard von Grainhelmin e Tretë me përvujtëri lyp audiencë pranë gjeneralit të lavdishëm, të perandorisë së Austrisë, Herman von Urlih.

Në dorën tjetër Dekreti i Komandës së lartë të NATO-s vazhdonte:

"Ndjenja e kënaqësisë për pjesëmarrje në Takimin e lartë të NATO-s na takon neve".

John William Harker, gjenerali amerikan i NATO-s

17.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih e ndjeu peshën e gjumit. Ende pa i dhënë rrugë ordinancës së vet se ç`duhet bërë, u zgjat paksa për ta pare vetveten e vet në pasqyrë. Po i bëhej java e tij, pa vënë gjumë në sy.Nga Vjena deri në Sarajevë paskesh udhëtuar nëpër variante të ndryshme: paskesh udhëtuar me një grua, me dy gra; pakesh udhëtuar me një burrë, me kufomën e tij. Dikush thotë se në kupenë e trenit perandorak paskesh qenë vetëm Sofia Löhne, e shoqja e Arçidukës së Habzburgëve- trashëgimtarit të fronit. Të tjerët kronikanë shkruajnë nëpër pergamena se për në Sarajevë udhëtoi vetëm kufoma e Arçidukës Franc Ferdinandit. Në kronika të tjera shkruan se në kupenë perandorake të trenit nga Vjena për në Sarajevë, tok me Sofinë Löhne, të shoqen e Franc Ferdinandit pakesh udhëtuar edhe Teuta e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik me një foshnje në prehër.

“Çkado shkruajnë pergamenat. Ua jep vetëm një të dhënë diplomatike e, ato shkallojnë me lajmin e tyre të ngatërruar”- mendoi gjenerali.

Ka një javë udhëtimi tok me këto dy gra hijerenda. Treni perandorak, po aq hijerëndë, i ngadaltë, siç e kanë perandorët më, rrugën e bëri të gjatë. Tërë ditën, kur qershori zë të marrë vapë, në kupenë perandorake, zu të kutërbojë kufoma e dikujt. Gjatë natës, si për inat, gjeneralit Herman von Urlih, i reshtej gjumi nga frika e pusive të bandave të mynxyrshme. Helbete rrugë ballkanike i thonë kësaj. Bile në disa pergamena të dorës së dytë u shkrua se në kupenë perandorake paskesh udhëtuar edhe një foshnje e posalindur. Gjeneralit austriak, Herman von Urlih, nga e gjithë kjo rrokopujë pergamenash i është bërë koka dhallë. I paskesh tretur gjumi. E vetmja dalë për t`i rënë ndesh pagjumësisë i mbeti t`iu reshtet të gjitha pergamenave.

Gjatë udhëtimit të trenit perandorak, me gjithë vendimin e marrë për t`iu reshtur pergamenave, kur treni perandorak ndalonte nëpër qytetet ballkanike, e dërgonte ordinancën e vet për t`i blerë pergamenat ditore. Pergamenat e qyteteve ballkanike, me lajme të ngatërruara, kapërtheheshin edhe në gjuhë të ndryshme, në alfabete të ndryshme, në fe të ndryshme.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, e zbriti nga pasqyra fytyrën e vet të përgjumur. Duhej shpëlarë nga ndryshku i pagjumësisë. E dinte, sipas të dhënave të Shërbimit Informativ se cila ishte Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Rainhard von Graimhelmit të Tretë- trashëgimtarit të fronit mbretëror të Bohemisë. Ajo po kërkon, sonte, audience në tendën e tij, pikërisht në atë orë të natës.

Pasi u rropat me fytyrën e vet, gjenerali austriak, Herman von Urlih, u dorëzua përpara vetvetes së vet: mbeti të dale para asaj zonje me atë fytyrë prej “Kalorësi të fytyrës së vrerosur”- fytyrë të ndryshkur nga pagjumësia e rrugës njëjavore prej Vjenës deri në Sarajevë.

Ia dha shenjën e miratimit ordinancës së ngulitur me atë shikim hapërdar, qëllimisht, siç u ka hije shërbyesve besnikë, veçanërish shqytarëve të devotshëm kur zotërinjtë kalores presin të takohen me zonja të hirosura, në këtë kohë të natës së mbrujtur. Shenjen e miratimit të gjeneralit, Herman von Urlih, ordinanca e tij e mori me maturi të devotshme, pa e tepruar me ndonjë lëvizje ngazllyese.

Gjenerali austriak,Herman von Urlih, vendosi të mos e shikojë më sonte vetën në pasqyrë. E krehu fytyrën e ndryshkur me një serë grimasash çtëndosëse, me një zgërlaqje, sikur i vuri nëpër vende çakërdisjet. Iu ndrojt takimit me Sofinë e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik, të shoqes së Rainhard von Grainhelmit-Trashëgimtarit të fronit mbretëror të Bohemisë. Ishte vonë për të gjitha ndërhyrjet e tjera. Vetëm e ndërroi pozicionin; e ktheu shpinën kah dera, tek pritej të shfaqet ajo grua. Nga të gjitha fytyrat e grave të reja, gjenerali, Herman von Urlih e pati të pamundur ta gjejë një të vetme për këtë çast. Edhe këtë here u dorëzua.

Fëshfërima e një fustani zherse, ngutshëm hyri, para Sofisë, në rezidencën e gjeneralit Herman von Urlih. Gjenerali i tunduar provoi të mos lëvizë nga pozicioni.Ende ajo mungoi në rezidencën e gjeneralit.

“Gjeneralët i tejkalojnë grackat e kamufluara”.

Priti të shfaqej ndesh tij ajo e vërteta e gjalla tundonjsja. Ajo para se të hyjë i dërgoi shenjat tunduese: shushurimën e fustanit zherse, aromat molisëse, dehëse, të parfumeve të zgjedhur në Berlin.

Gjenerali, Herman von Urlih, ende po i binte ndesh tundimit të saj.

Këtë here gjenerali austriak po priste të tjerë hapa nga ata ushtarakë.

E kishte pikasur. Këtë herë vërtet dëgjoi të tjerë hapa para derës së rezidencës. Ordinanca e vet iu afrua,më tepër se ç`duh-

ej, gati duke i pëshpëritur:

"Gjeneral i respektuar, personi i paraqitur për audience, sipas miratimit tuaj, tashmë ka hyrë në rezidencë".

Gjenerali e mori veten; e provoi me një lëvizje dore prej gjenerali në drejtim të ordinancës së vet. E mira i thoshte të presë edhe paksa në atë pozicion madhështor prej statuje.

Në tërësinë e fushëbetejës po ngadhënjente aroma e gruas së re.

Gjenerali e ndjen se ndryshku i pagjumësisë, copë - cope po i shkoqej nga fytyra; po i binte para këmbëve. Lektisi për ta parë fytyrën e vet të këndellur në pasqyrë. Tashmë qe bërë vonë. Ajo ishte aty.

"Gjeneral i shkëlqyer në të gjitha fushëbetejat, nder i lules ushtarake të perandorisë austriake, komandant i përgjithshëm i krahut Jugor të ushtrisë, Providenca e Persones suaj e mëshiroi gruan e varfër, fatnoprane, në këtë orë të natës. E braktisët lodhjen për ta pranuar në audience të bijën e Haçet Deletës së Ilirikut, të shoqen e Rainhard von Grainhelmit të Tretë – Trashëgimtarit legjitim të fronit mbretëror të Bohemisë"- i butë, dehës,zëri i Sofisë e mbushulloi ajrin e rezidencës së gjeneralit Herman von Urlih

Gjenerali, Herman von Urlih, doli nga koraca madhështore e statujës së gurtë ushtarake. U lirua nga pesha e gurit. Lehtë, krejtësisht lehtë, me reverancë, gati të tepruar stërhollimesh, i bëri tre hapa drejt saj.

Ajo qe aty. Ajo u bë aty. U bë e tëra para gjeneralit, Herman von Urlih.

"Shkëlqesia juaj - bijë e Haçet Deletës së Dytë të Ilirikut, bashkëshorte e Rainhard von Grainhelmit të Tretë – Trashëgimtarit legjitim të fronit mbretëror të Bohemisë, sonte e nderuat, me praninë Tuaj këtë tendë të varfër të këtij gjenerali të vetmuar.Neve, providenca qiellore na caktoi sonte të jemi në shërbi-

min Tuaj Hirësi.Gjeneralëve të vetmuar vetëm Providenca qiellore mund t'ua shpërblejë me audienca të tilla"- i foli gjenerali austriak, Herman von Urlih, me zë të shpëlarë nga lyrosja duke i dhënë krahun për ta shpënë tek divani

Sofia me një ngurrim të ryer reverancash, të pathënë, e refuzoi me skofiaritet ofertën e gjeneralit për t`u ulur në divan. Të dy qëndruan në këmbë. Me dorën e majtë, Sofia e vuri në spikamë zarfin e portokallt sipas rregullës së protokollit.

"Gjeneral i shkëlqyer, Provania - mbrojtëse e zonjave të varfra, më tundoi, sonte, t`ua prishë humorin e mire, për t`ia përcjellë eminences Suaj përshëndetjet e gjeneralit roman, Titi, komandantit të krahut lindor të ushtrisë perandorake të Romës"- sikur cicëroi Sofia.

"Fati i gjeneralëve është i mbrujtur me të papritura. Ndonjëherë zemrat e vetmuara të gjeneralëve rrahin për një kujtim pas betejave të fatshme e të pafatshme. Shpeshherë gjeneralët e vetmuar neper viset e largëta, të mbërthyerë nëpër vende të egra, ia dëshirojnë vetvetes së vet majën e shpatës në zemër. Këtu e njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet, gjenerali roman, Titi, komandant i krahut lindor të ushtrisë perandorake të Romës, e mban nën darën e rrethimit Jakovën e Jerusalemit"- u rrëmbye gjenerali austriak, Herman von Urlih

Sofia e pa qartë ekzaltimin e gjeneralit austriak; ngulmimin e tij për të depërtuar deri tek shikimi i saj. Velloja e Sofisë e përballoi shikimin ngulmues të gjeneralit. Ajo qëndroi në këmbë pranë divanit, aq sa e bëri të tepruar përpjekjen e gjeneralit për t`i ofruar komoditet. E ndjeu nëpër rrjetën e vellos shikimin e tëherrur të gjeneralit. Ai po mendonte më tepër se ç`ofron një audience - rutinë.

"Gjeneral i nderuar, ja çatisa në tënden Tuaj të nderuar të Ju përgjëroj. Po patët provani kalorsiake, ta heqni embargon mbi Dosjen e Teutës së Haçet Deletës së Ilirikut Albanik. Të më sqaroni në pati ajo grua ndonjëherë fëmijë, në pata ndonjëherë

unë vëlla.?”- hyri në teme ashtu përngutshëm Sofia e Haçet Deletës, më tepër seç duhet e mallëngjyer.

U bë heshtje.

Gjenerali ra në vetveten e vet.

“Zonjë e nderuar, si mund të ketë embargo mbi një fletëlëshim të pacientit të lëshuar nga klinika?-u përgjigj ftohtas gjenerali austriak.

“Sipas pergamenave jozyrtare, Teuta e Haçet Deletës - Nëna ime, doli nga klinika “Mercoledi”e Vjenës ditën e njëzet e tetë të nëntorit të vitit njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë. Në fletëlëshimin e saj është bërë një resje duke u shkaktuar paqartësi”- hyri në timbrin zyrtar të zërit të vet Sofia.

Nëpër pergamena jozyrtare ipeshin variante të ndryshme mbi fletëlëshimin e Teutës së Haçet Deletës nga klinika “Mercoledi” e Vjenës. Bile shkruan se ajo pergamenë i është dërguar gjeneralit Herman von Urlih për ta mbajtur në arkivin ushtarak. Pergamena paskesh qenë e resur në shumë vende, mbase edhe qëllimisht.

Sofia e Haçet Deletës, sonte, e mëtoi gjeneralin Herman von Urlih të dale nga embargoja e resur në pergamenë, aty ku relievohej diagnoza e gjymtuar mbi gjendjen shëndetësore të Teutës së Haçet Deletës lëshuar nga klinika “Mercoledi” e Vjenës

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, e kishte marrë nëpër dorë këtë pergamenë tetëdhjetë e katër here- çdo të njëzetetetën ditë të nëntorit. Tetëdhjetë e katër vjet në këtë ditë kishte rënë shi i mërzitshëm. Gjeneralit austriak, Herman von Urlih, kjo ditë e përhitur e nëntorit i sjellte gjumë ogur mbi pergamenën e klinikës “Mercoledi” të Vjenës. Gjenerali u mësua me rrjedhën e viteve të përhitur po, edhe me llucën e fushimit ushtarak pranë mureve të Jakovës së Jerusalemit.

Sonte, gjenerali austriak ra ndesh me brengën: Sofia e Haçet Deletës u bë aty para tij, në këtë kohë nate. Për herë të parë,

sonte gjenerali u rropat ta gjejë ndonjë ditë me diell. Kot. I ra ndërmend Oguri:

"A mund të dilet, pas dy orësh, para gjeneralit amerikan në takimin e lartë të NATO-s, me këtë diagnozë të sakatosur? A do të besojë ajo Indigjenia Iroki e Massachusettsit se një grua, qoftë edhe mbretëreshë, se mund të lindë foshnje me diagnozë Sanguis lacertae in utero. Ajo Indigjenia Iroki ia çatisë sonte në Jakovën e Jerusalemit me atë furinë e orgazmës së saj amerikane. Ajo i beson vetëm pjelljes mitrale të orgazmës. Sa ngusht e ka sonte Evropa!"- ra në vetveten e vet gjenerali Urlih.

Vendosi ta ruajë mendjen esëll: t'i thërrasë njënganjë: Shtabin e Lartë ushtarak në Vjenë, Ministrinë e punëve të brendshme, Ministrinë e punëve të jashtme për ta marrë një përgjigje shpëtimtare.

Sofia e Haçet Deletës vendosi ta bie në vete gjeneralin austriak, Herman von Urlih, pasi ai ra në heshtje të plogësht.

"Gjeneral i nderuar në pergamenat Tuaja ushtarake keni informata të sakta, meqë ju jeni larg nga Jakova e Jerusalemit vetëm pesëmbëdhjetë kilometra, se atje gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi po e bën hatanë nëpër mitrat e grave të reja"- e sëmboi Sofia duke kapërcye, gati për ta ndërrua bisedën kaq papritur.

"Po përse, ajo-Jakova e Jerusalemit?"-u tremb gjenerali austriak.

"Ashtu e quajti gjenerali roman, Titi. Ai u sul furishëm mbi Jerusalemin e rrethuar nëpër Shtjellën e vuvët, buçitëse: "Allah!Allah!", e cila erdhi nga Sinaji. Vrapoi furishëm ta arrijë Jerusalemin para se ta kaplojë kjo shtjellë zezonë myslimane. E huqi rrugën vetëm për dy kontinente. Arriti deri këtu. Pa zjarr,pa flake sonte mbi këtë qytet. Gjenerali Titi i bashkoi Jakovën me Jerusalemin dhe zjarrin e sontem ia dedikon ushtrisë së vet.

Në tendën e tij të lavdishme, sonte ia çatisën: Rabi Jochanan ben Sakai - Rektori i dy universiteteve të Izraelit, Delegacioni i Knesetit të Madh të Jeruzalemit, Rebeka e Alamekut nga Abbi i Galilesë dhe, kjo grua e varfër e cila po qëndron në tendën Tuaj të lavdishme - Sofia e Haçet Deletës së Ilirikut, e shoqja e Rainhard von Grainhelmit të Tretë- Trashëgimtarit të fronit të Bohemisë"- ia numëroi gjeneralit njënganjë duke e shikuar smirën në fytyrën e tij të mvrejtur.

"Çështje gabimi, Zonjë e hirësuar. Gjenerali Titi e paska humbur toruan duke e përzier Jakovën me Jerusalemin. Ai dashka ta përvetsojë lavdinë e gjeneralit tjetër. Atë zjarr mbi qytet e shkaktoi tjetër ushtri"- u përmend gjenerali Herman von Urlih.

Sofia e veneroi shemrën ushtarake në fytyrën e gjeneralit austriak, veçanërisht kur një zonjë aq e lartë i përmend njënganjë meritat e gjeneralit rival.

Vendosi t`i shkojë çështjes rrugës tjetër për të mos e ngacmuar.

"Gjeneral i nderuar,në Jakovën e Jerusalemit, ai, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, po e bën batërdinë në mitrat e grave të reja sepse atij gjeneralit rus i mungon diagnoza e klinikës "Mercoledi" të Vjenës- e provokoi tërthorazi gjeneralin austriak.

"Zonjë e lartë, ai gjenerali rus ka pasur mundësi, çdo ditë të zotit ta ketë atë diagnozë të resur nëpër pergamenë. Gjeneralit Kutozov mbase i duhet krejt diçka tjetër nga ç'flitnin Ju hirësi. Ajo diagnozë besoj të mos jetë aq e qartë as në Vjenë. Andaj sipas metodës së fundit ta leximit të ADN-së, më shumë se në pergamenat e klinikave duhet të gërmojmë varrin e mundshëm të Kostantinit të Haçet Deletës - vëllait tuajt, zonjë e nderuar.

Sipas analizave të AND-së, eshtrat e Kostantinit do të flasin në ka qenë shtatzënë, nëna juaj- Teuta e Haçet Deletës. Do të vërtetohet në ka pjellë nëna juaj- Teuta e Haçet Deletës ditën e njëzet e tetë të nëntorit të vitit njëmijë e nëntëqind e dymbëdhj-

etë. Do të Vërtetohet, Zonjë e nderuar, nëse ju e keni pasur ndonjëherë vëlla Kostantinin e Haçet Deletës”- gjenerali e mori veten gjatë këtij propozimi duke u ndjerë i suksesshëm.

“Gjeneral i nderuar, atëhere pse ai gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, i ka hyrë kuturu t`i hapë të gjitha mitrat e grave të reja në Jakovën e Jerusalemit?”- e pyeti Sofia duke e shikuar në mos gjenerali i kishte rënë në të çështjes.

Siç dukej gjenerali austriak paskesh qenë aq i hutuar sa të mos i kishte lexuar pergamenat midis rreshtave. Sofia gati u bind në mosnjohurinë e gjeneralit austriak kur ai e pyeti:

“Sikur Teuta e Haçet Deletës ta kishte lindur të birin,Konstantinin e Haçet Deletës në klinikën “Mercoledi” të Vjenës atëherë ç`punë i del sonte gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit, me mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit, siç e quani ju?”- pyeti gjenerali austriak me një habi të zbrazët në fytyrë.

“Ky gjeneral ballkanik paskesh mbetur jashtë rrjedhave të ngjarjes ose mund të shtiret i paditur”- mendoi Sofia duke u shtyer edhe më tutje në kuvend me të.

“Për lalën e vet gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, po i çelë me majën e shpatës të gjitha mitrat e grave të reja të Jakovës së Jerusalemit kur Ju evroperëndimorët mendoni të hapni varre për ADN-n. Ai po e lypë terroristin në mitrat e grave të këtij qyteti kurse Ju po e lypni në varre. Të dy parët mendoni ta shpëtoni Evropën nga ai terroristi i orgazmës, i quajtur Redalk san Heldiku ose Rabi Jochanan ben Sakai”- ankoi Sofia, sërish duke ngulmuar në vrojtimin e fytyrës së gjeneralit.

Shihej qartë se gjenerali austriak, i lodhur nga pagjumësia njëjavore do të mos ketë arritur t`i lexojë pergamenat e sontme. Shihej qartë. Por Sofia e Haçet Deletës as ta venerojë rrezikun tjetër.

“Zonjë e nderuar, Ju duhet ta dini se Haçet Deleta ka qenë masturbuesi më i madh, mbase edhe në tërë Evropën. Ky cen i

babait Tuaj hedh paqartësi mbi pergamenën e klinikës "Mercoledi"të Vjenës"-i ra trup gjenerali, pa diplomaci, krejt papritur.

Sofia e kuptoi se Herman von Urlih e humbi toruan se, ai edhe mund ta thotë, ende, ndonjë të papritur.

Ajo i ndërhyri autoritetshëm.

"Gjeneral i nderuar, sonte kam udhëtuar nga Bohemia e largët deri tek Teatri i Berlinit për ta pare dramën "Fausti". Në aktin e dytë të kësaj drame u arratisëm bashkë me Mefiston për në Galile tek fshati Abbi. E takuam Rebeken e Alam- ekut… Pastaj zbritëm në Jude tek tenda e gjeneralit roman, Titi. Gjeneralin roman e paskesh rrokur amoku i lavdisë së fitores mbi Jerusalemin. Askund ta takojmë gjeneralin roman nëpër Shtjellën e vuvët myslimane, rrëqethëse, buçitëse: "Allah! Allah!" të ardhur nga shkretëtira e Sinajit.

Duke e ndjekur ushtrinë e tij të amokshme, të huqur vetëm për dy kontinente, arrita deri këtu tek tenda e gjeneralit roman, vetëm dhjetë kilometra pranë Jakovës së Jerusalemit, siç e quajti gjenerali roman. Erdha në tendën e Tij për të njëjtën gjë për të cilën kam ardhë edhe në tendën Tuaj të nderuar.

Andaj gjenerali Titi bujarisht ju përshëndet, gojarisht përmes një gruaje të varfër e, zyrtarisht me këtë zarf të mbyllur me heshtjen e të vdekurit"- ra në frikën e vetvetes Sofia e Haçet Deletës pa e kuptuar mirëfilli se ç`ndodhi me vetveten e saj.

Sikur ta kishte pritur, gjenerali austriak, Herman von Urlih, e zgjati dorën kah Sofia me një përmbajtje diplomatike. E mbajti në dorë dokumentin tepër sekret mbi gjendjen shëndetësore të Teutës së Haçet Deletës lëshuar nga klinika "Gemeli" e Romës. Ai u përpoq ta ruajë të ndezur një ngrohtësi të stisur, me kutërbim diplomatik duke e pehatur në dorë dokumentin e mbyllur në zarfin e portokallt.

"Një gjeneral i paditur pak do të marrë erë në punët e mjekësisë. Do të kishte qenë e preferuar t`ja dërgoj sektorit të

shëndetësisë pranë komandës ushtarake. Ai sektor, me kompetencë do t`i japë rrugë këtij Dokumenti”- foli gjenerali me një zë të rënë gati për tokë. - “Bile posa arriti nga Vjena njeri prej mjekëve të Konsiliumit të klinikës “Mercoledi”- vazhdoi gjenerali austriak duke pare se zëri i vet la përshtypje të keqe tek Sofia.

Ajo heshti.

I zvargur i erdhi zëri i gjeneralit roman, Titi.

“Ka gjasë të jetë kontrabanduar ai Sigmundi i Vjenës. Austriakët do ta kenë më rëndë.Dosja e Klinikës“Mercoledi” të Vjenës i ka vetëm shtatëdhjetë e katër vjet. Dosja e Klinikës “Gemeli”i ka njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet”

“Po pse, me kaq ngulim ngatërrohet diagnoza? Mos dikush i dron arratisjes së Rektorit - Redalk san Heldikut, sonte, nga Jakova e Jerusalemit. E turbullt qarkullon një pergamenë se ajo, e veja e Sidonit, Rahilja e Ahabit, e paska pare në Galile Rektorin, Redalk san Heldikun duke ecur ngutshtëm tok me Rabi Jochanan ben Sakain.Ajo paska spiunue tek Shërbimi informativ. Në asnjë pergamenë të shkruajë më tutje se ç’ndodhi atë ditë me të dy rektorët”- i ra tërthorazi Sofia e Haçet Deletës

“Zonjë e nderuar, ju jeni më fisnike se ç’mund ta mësheheni me përvujtni. Tashmë e thatë me skofiaritet pse, sonte, u është çuar zemra peshë ta quani qytetin Tuaj Jakovë e Jerusalemit. Sepse ai hebreu, Rabi Jochanan ben Sakai ka rrezik t`ia ketë mësuar rrugën e mitrës së ndonjë gruaje të re atij Rektorit - Redalk san Heldikut.

Mbaje vath në vesh, Zonjë e nderuar se Rabi Jochanan ben Sakai do të kalbët në mitrën e ndotur të Kones së Danielit. Përveç Holokaustit ashtu e meritojnë të gjithë hebrejtë!”- u ndez i tëri gjenerali austriak, Herman von Urlih

Sofia heshti, e trembur mos gjenerali austriak i dinte të gjitha. Gjenerali roman, Titi, edhe pse e heshti emrin e Rektorit

të universitetit të Jakovës së Jerusalemit - Redalk san Heldikut, mund t`ia kishte dhënë të gjitha gjeneralit austriak nëpërmes postës diplomatike.

Ajo, Sofia e bija Haçet Deletës së Ilirikut Albanik, e shoqja e Rainhard von Grainhelmit të Tretë-Trashëgimtarit të ligjshëm të fronit mbretëror të Bohemisë zhuritej për një informatë tjetër: në mos shërbimet informative evropiane mund ta kishin mësuar, në mënyrë misterioze se në Mitrën e vet Sofisë mbruhej fetusi i Rektorit, Redalk san Heldikut.

Të gjitha mundësitë për ta zbuluar sekretin e saj qenë shumë të vogla, krejtësisht të pamundshme. Ajo kishte hyrë e vetmuar në tendën e Zatres Arameje deri sa Redalk san Heldiku qenkesh në agoninë e orgazmës së pare. Pa e hetuar askush, bile as vet ai Redalk san Heldiku. Sofia e Haçet Deletës, sipas sugjerimit të Rabi Jochanan ben Sakait, kishte rënë mbi penisin e Rektorit të Jakovës së Jerusalemit. Për këtë gjë mund të ketë spiunua vetëm Rabi Jochanan ben Sakai sikur të kishte deshirua ta asgjasojë vetveten e vet. Jo, kurrë jo. Atëherë sekreti mbetet i pazbuluar. Sofia u bind.

Rabi Jochanan ben Sakai kur i sugjeroi Sofisë të hyjë në tendën e Zatres Arameje, nxënësit e vet të Sahredinit i patë larguar rrugës tjetër. Ata të dy, vetëm ata të dy biseduan. Pergamena thotë se Rabi Jochanan ben Sakai, e takoi Rekt- orin Redalk san Heldikun pak para se të bie në orgazmën e pare të Zatres Arameje.Redalk san Heldiku e paskesh pyetur Rabi Jochanan ben Sakain:

“Rabi i hirosur, ju po më grishni të bie në orgazmën e panjohur për mua pa më thënë se ç`e kini mendjen të bëni për vetveten Tuaj”- i kërkoi shpjegim Redalk san Heldiku.

“Mos më merrni kohë,Rektor i nderuar,më shumë se ç`kërkon vdekja! Rabinet e Knesetit të Madh të Izraelit ranë në Vrimën e kohës së humbur. E zgjodhen vdekjen për vetveten e vet të Izraelit. Midis gropës së zezë të vagjinës dhe gropës së zezë

të varrit, zgjedh për popullin Tënd, brenda tendës së Zatres Arameje." - i sugjeroi Rabi Jochanan ben Sakai.

Në të gjitha pergamenat shkruan se Rabi Jochanan ben Sakai arriti në tendën e gjeneralit, Titi, dhjetë kilometra larg Jakovës së Jerusalemit. Ishte vetëm një huqje prej dy kontinentesh.

Për Rektorin Redalk san Heldikun heshtin të gjitha pergamenat. Por Sofia e Haçet Deletës dyshoi në këtë heshtje. Aty mund të ngrehej ndonjë komplot i rrezikshëm. I duheshin vetëm edhe dy orë.

"Të gjitha tekstet e pergamenave evropiane, të resura në shumë vende, mund të lexohen me pështirosje"- ra në vetveten e vet Sofia e Haçet Deletës.

Zvargia e heshtjes së Sofisë ia bëri kokën dhallë gjeneralit austriak.

E bëri të qartë se duhej bërë zap ato pergamenat e morgjeve të klinikës "Mercoledi" të Vjenës dhe eshtrat e varrit të Kostantinit të Haçet Deletës.

Ky sugjerim ra poshtë. Sipas urdhrit të fundit mbeti për ta hapur varrin e Kostantinit të Haçet Deletës. E vetmja shpresë mbeti një cifël ashti nga skeleti i Kostantinit.

Sofia e kuptoi se në ç`ngushllëk kishte rënë.

Edhe këtë here vendosi të heshtë.

Gjenerali austriak ra në shikimin e Sofisë së Haçet Deletës, të shoqes së Rainhard von Gainhelmit të Tretë- Trashëgimtarit të ligjshëm të fronit mbretëror të Bohemisë. Shikimi i saj erdhi i vezullimtë nga nënhija ngërthyese aq joshëse, nën vetullat e zeza pisë, nën qerpikët e zgjatur. Gjenerali austriak sa erdhi duke rënë në sytë e saj. E ndjeu fërshëllimën e ajrit nëpër fytyrë, nëpër lëkurë, pastaj në mishin e vet.

Diç nga shembja anatomike ndodhi gjatë rënies në shikimin e saj. Ndjeu se po i mbruhej mishi mashkullor, padurueshëm deri tek sëmbimi i orgazmës. Të gjitha sekretet ushtarake u zvetënuan derisa gjenerali austriak Herman von Urlih e pa vet-

veten e vet të vetmuar në fushë të betejës. U rropat t`i ndalojë ushtarët e vet të mos arratiseshin, të rrokur nga amoku i frikës. Pastaj i shau me zë sa i zëntë goja. Ishin huqet e orgazmës së kështjellës "Summer of" të Vjenës.

Sofia e Haçet Deletës e ndjeu nën pelerinën e hollë, nën lëkurën e lëmuar, nën mishin e vet të brishtë, teposhtë pubisit, deri atje ku fillon gruaja, dëlirin e gjeneralit austriak.

Ajo, e rrezikuar nga vetvetja e vet e mishit mashkullor të gjeneralit, u largua paksa nga divani, para të cilit po qëndronte në këmbë

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, me tundimin e mishit të mbufatur mashkullor e nëpërkëmbi vetveten e vet prej gjenerali. Ai zu të shajë përqart:

"Ata homoseksualë të asaj klinikës "Gemeli" e kanë stërhullë këtë diagnozë. Ai Kostantini i Haçet Deletës e ka humbur rrugën midis varrit dhe vagjinës. E ka të vështirë ta caktojë për veten e popullit të vet se cilën ta zë. Grykën e varrit apo grykën e vagjinës.Edhe neve sonte na nxjerrë tarashkatje se ku të rrëmojmë:në vagjinë apo në varr.Tagri sa vjen e rritet. Ne evroperëndimorët do ta hapim varrin e Kostantinit të Haçet Deletës për të nxjerrur disa cifla ashti për analizat e ADN-s. Gjenerali rus, Kutozov, me metodën e muzhikëve, i çel mitrat e grave të reja për ta zbuluar një shtatzani në Jakovën e Jerusalemit.Sigmundi jonë i Vjenës na këshillon ta përdorim metodën e provokimit të gruas midis animës dhe animusit duke e detyruar gruan të shkelë mbi varrin e burrit, të vëllait, të dashnorit.Po ç'mund të bëjmë ne, evrorusët karshi orgazmës së Indigjenes Iroki të Massachusettsit. Cilën metodë do ta përdorë ajo? Metodën e varrit, metodën e vagjinës, metodën e Sigmundit tonë të Vjenës, metodën e orgazmës, të seksit, apo metodën e dashurisë? Ajo i ka në dorë edhe Rabi Jochanan ben Sakain edhe Redalk san Heldikun"- u çjerr gjenerali.- "Si do të formohet këtë çast ekipi i mjekëve dhe i arkeologëve për ta hapur varrin e Kostantinit të

Haçet Deletës.Pastaj duhet përgatitur një mal dokumentesh për rregullimin e vizave ndërshtetërore për secilin; për gjithë pajisjet e nevojshme leboratorike të leximit të ADN-së së Kostantinit të Haçet Deletës”- tërfëlloi gjenerali Herman von Urlih midis hidhërimit e epshit.

Sofisë së Haçet Deletës iu tërhoq përpjetë sëmbimi i mishit femëror. Ajo u bë e vetvetes së vet. Ngushllëku i gjeneralit austriak u mërtis për të lypë dale midis Mitrës së Sofisë së Haqet Deltës dhe varrit të Kostantinit.

“Këta evropianët lypin diç tjetër nga diagnozat eTeutës së Haçet Deletës së Ilirikut Albanik”- U tremb Sofia e Jakovës së Jerusalemit.

18.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih i ra ziles së përgjumur,pa ndërprerë,derisa në rezidence u shfaq ordinanca,i trembur, me disa gjolla të gjumit në fytyrë. Ordinanca e gjeneralit austriak erdhi në vete kur qëndroi gatitu para tij.Tulla e kresë i shkëlqeu nga djersët e sikletshme.

Ordinanca u bë i veshtullt për ta thithë urdhrin e gjeneralit. Ishte i shpenzuar nga të gjitha mishrat.

"Për një çast le të bëhen gati të dy ekipet: ekipi i arkeologëve dhe ekipi i mjekëve; do të marrim rrugë"- i tha ordinancës duke i dhënë shenjë me dorë të largohet.

"Ai gjenerali rus le t`i çelë të gjitha mitrat e Jakovës së Jerusalemit; ne do ta çelim varrin e Kostantinit të Haçet Deletës. Diku do të takohemi nëpër këto diagnoza të pshurrta. Rrugët e varrit dhe rrugët e vagjinës diku të nxjerrin"- foli vetmevete gjenerali.

Por mirë e dëgjoi Sofia e Haçet Deletës. Asaj as t`i kishte shkuar mendja se çështja do të marrë aso kaheje. Mbase edhe qenkesh arrestuar pa ia kumtuar urdhrin e arrestimit.

"Shkelqësi"- iu kthye ordinanca pa e mëshehur kundruall Sofisë se i dinte të gjitha sekretet e shefit të vet. -"Të dy ekip-

eve u mungojnë vizat. Ne duhet ta kalojmë një kufi shtetëror. Në pergamenat e arkivave ushtarake, gjithkund shënon edhe nëpër fushata të harruara se varri i Kostantinit të Haçet Deletës gjendet në Shqipërinë e Albanikut sovjetik, menjëherë përtej pikës kufitare.- vetëm tetëqind metra brenda kësaj Shqipërie të Albanikut sovjetik."

"Do ta kalojmë atë kufi me një marrëveshje lokale me komandën ruse të gjeneralit Ivan Vasiljeviq Kutozovit"- e siguroi ordinancen duke i dhënë shenjë për të dalë.

Pasi mbeti vetëm me Sofinë, gjenerali austriak, Herman von Urlih,iu kthye asaj,me një lloj ngazëllimi fitimtar prej gjenerali:

"Ju, zonjë e nderuar do të vini me ne! Para se të takohemi me atë gjeneralin e Indigjenes së Massachusettsit na kanë mbetur vetëm edhe dy orë. Ai gjenerali i Indigjenes Iroki, ai John Harkeri, në Takimin e NATO-s, pas dy orësh, përveç tjerash, do të kërkojë të dhëna, sa më të sakta, për diagnozat e Teutës së Haçet Deletës edhe për varrin e Kostantinit - të vëllait Tuaj.

Do ta hapim varrin e Kostantinit të Haçet Deletës së Ilirikut Albanik. Ju zonjë e nderuar, më mire se askush tjetër, e dini saktësisht se cili është varri. Megjithëse, sipas pergamenave thonë ta ketë një stelë të resur tek kryet e varrit"- gali urdhëroi gjenerali austriak Herman von Urlih duke harruar për një çast se po fliste me një zonjë të rëndë.

"Gjeneral i nderuar"- foli Sofia me një zë drithërues e të dykuptimt.-"Përse iu dashkan aq shumë gjeneralit John Harkerit, varri i Kostantinit të Haçet Deletës dhe diagnozat e Teutës - nënës sime? - vazhdoi me po atë zë Sofia duke dashur të kuptojë diç nëse ishte, tashmë e arrestuar.

"Zonjë, shërbimet informative kanë të dhëna se një grua nga Jakova e Jerusalemit ka mbetur shtatzënë përmes Vagjinës, Orgazmës, me atë Rektorin, Redalk san Heldikun. Kjo shtatzëni për shërbimet informative evropiane është e ndaluar, e infekt-

uar në të gjitha dimenzionet psikosomatike, morale,fetare, shtetërore.Shtatzania e tillë, zonjë e nderuar, bie ndesh me Traditën evropiane, me shtetet, me vetë zotin. Sonte, zonjë e nderuar, Evropës dhe Indigjenes Iroki të Massachusettsit më së pakut u intereson Diagnoza për Teutën e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik. Ju zonjë vullnetarisht i keni hyrë një rruge të gabuar poaq të rrezikshme. Mbase doni të krijoni huti midis kësaj katrahure"- u skërmit me vetveten gjenerali austriak.

Sofia e Haçet Deletës e kuptoi se qenkesh gati e arrestuar. E pati pak më të lehtë t`ja qëllojë se cilën grua po e lypë gjenerali rus në Jakovën e Jerusalemit. Pastaj i erdhi në mendje se gjenerali roman, Titi paska, përvç detyrës ushtarake edhe mision më të thellë, të caktuar, para mureve të Jakovës së Jerusalemit.

"Sigurisht më paskan marrë për spiune të gjeneralit amerikan,John Harkerit të Indigjenes Iroki.Pastaj në dosjen e spiunëve janë edhe Rebeka e Alamekut dhe Rabi Jochanan ben Sakai, mbase edhe Mefistoja dhe Redalk san Heldiku. A kam arsye të mjaftueshme për këtë lojë. Përveç punëve të mëdha shtetërorë diç e imja më tërheq në këtë lojë."- ia sqaroi vetvetes se qenka zbuluar nga shërbimet informative evropiane.

Meqë kishin mbetur vetëm edhe dy orë deri në fund të Shtatëmbëdhjetë minutavetë Redalk san Heldikut, Sofia e Haçet Deletës vendosi ta provokojë gjeneralin austriak:

"Zoti gjeneral, ç`ju hyn në punë varri i Kostantinit? Ç`ju duhet mitra e asaj gruaje të mbetur shtatzëne me atë Rektorin e supozuar të Jakovës së Jerusalmit? Ju flitni vetëm për ndalesat evropiane. Por Zotëri ngurroni të flisni ç`do të bëni me eshtrat, ç`do të bëni me mitrën?"- e pyeti ajo gati haptas

"Për mitrën le të përgjigjet ai gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi. Eshtrave të Kostantinit të Haçet Deletës së Ilirikut Albanik do t'u behët leximi i ADN-së në laboratorin e OSCE-së, të vendosur afër varrit të tij në fshatin Le të Shqipërisë së Albanikut sovjetik. OSCE-ja deri para dy orësh ishte e vendo-

sur në Jakovën e Jerusalemit por gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit i kërceu në kokë për ta dëbuar përtej kufirit misionin evropian."-gjenerali filloi të flasë perqartë e, përngutshëm

"Pas leximit të ADN -së të Kostantinit të Haçet Deletës çfarë do t`i shpjegoni, brenda dy orësh, në Takimin e Këshillimit të lartë të NATO-s, gjeneralit të Indigjenes Iroki?"-insistoi Sofia

" Edhe pse gjeneralit amerikan aq pak i intereson, do t`i tregojmë, zonjë e nderuar se Haçet Deleta i Ilirikut të Albanikut sovjetik-babai Juaj-ka qenë masturbuesi më i shquar në Evropë. Se babai juaj, i respektuar aq shumë nga Ju, as që e ka ditur se ç`është Seksi, se ç`është Orgazma. Do t'i tregojmë, po arritëm, se e kemi zbuluar me cilin mbeti shtatzënë ajo gruaja e Jakovës së Jerusalemit:me burrin, me vëllain, me dashnorin, apo me atë ushtarin e arratisur atje në tendën e Zatres Arameje. Do t'i tregojmë se fetusin e cilit po e nxjerrë sonte nga mitra e gruas atje në klinikën "Gemeli" të Romës. Këtë do t`ja thomë atij gjeneralit të Indigjenes Iroki të Massachusettsit. Do t`i tregoj-më atij gjenerali se po mashtrohet pa e ditur se cilin fetus po e mbëlton sonte në mishin ekologjik të Jakovës së Jerusalemit, të mbyllur në guacë mbi dymijë vjet"- gjithnjë e më shumë ngutej gjenerali duke e zbuluar veten para Sofisë.

"Zoti gjeneral, po përse ju hiqni keq ta çelni varrin e Kostantinit të Haçet Deletës-vëllait tim,kur leximin e ADN-së mund ta bëni me mostër të marrur nga gjaku im"- e pyeti Sofia, paksa e çuditur për t'i treguar gjeneralit se çështjes i kishte rënë në fund.

"Të dhënat e ADN-së suaj, zonjë e nderuar, i ka refuzuar ajo Indigjenia Iroki e Massachusettsit. Ajo ka deklaruar se gjaku, kinse i Juaj, mund të kontrabandohet gjenetikisht nga Bohemia e Rainhard von Grainhelmit të Tretë-Trashëgimtari i fronit mbretëror. Kjo është punë kontinentesh, shkelqësi. Askush s'i beson askujt." - ia tha troç i pezmatuar gjenerali austriak me

fjalë nga profesioni i tij prej mjeku.

Tashme Sofia e Haçet Deletës e humbi fillin e mendimit. Pse të kishte arsye të mendojë se është e arrestuar? Ajo Indigjenia Iroki e Massachusettsit e paska refuzuar gjakun e saj të pastër. Në anën tjetër ky gjeneral austriak Haçet Deletën e nxjerr masturbuesin më të shquar në Evropë. Mos po ngrehej ndonjë grackë shumë hileqare?

Gjenerali austriak e hetoi hezitimin e Sofisë; edhe pse aq përngulshëm e gjeti rastin për t`ia thënë dykuptimisht:

"Zonjë e nderuar, mos e merrni për ters! Pas njëzet minutash edhe ADN-ja e juaj do të provokohet për t`u lexuar me metodë jashtëlaboratorike. Kjo metodë e leximit të ADN-së suaj më tepër i duhet Evropës se asaj Indigjenes Iroki të Massachusettsit"- serish i foli me misteriozitet gjenerali

Sofia e mori me panik metodën evropiane të leximit të ADN -së.

"Kush e di cila do të jetë metoda evropiane e këtij leximi. Pastaj kjo metodë le mundësi të falsifikimit të leximit të të gjithave"- u rrokullis në vetvete Sofia.

Ajo erdhi tek ky përfundim i frikshëm nga vetë insistimi i gjeneralit austriak, i cili, pa e provuar asnjë metodë shkencore laboratorike, i tha prerazi:

"Haçet Deleta i Ilirikut Albanik ka qenë masturbuesi më i madh në Evropë. Ai nuk ka mundur të ketë fëmijë."

Atëherë gjërat dolën sheshit. në Takimin e Këshillimit të Lartë të NATO-s, pas dy orësh, gjeneralët romanoevropianë do të dalin me tezën se Haçet Deleta i Ilirikut të Albanikut sovjetik paskesh qenë masturbuesi më i madh në Evropë.Si i tillë kuptohet se ka qenë i shterp. Se ai mbret hardall i Ilirikut Albanik s'ka mundur të ketë pasur as djalë as vajzë. Se ajo gruaja e Jakovës së Jerusalemit edhe mund të mos jetë vajza e tij. Dhe se Indigjenia Iroki e Massachusettsit e paka yshtur gabimisht

gjeneralin amerikan, John Harkerin tek mishi ekologjik i Jakovës së Jerusalemit.

"Gjenerali amerikan, John Harkeri, a mund t`i besojë, ashtu i magjepsur, asaj Indigjenes Iroki të Massachusettsit? A mund të besojë ajo se vërtet Haçet Deleta i Ilirikut Albanik të mos ketë pasur fëmijë vetëm pse paska qenë masturbues i shquar? Ajo e di ç'është seksi vjetor i masturbuesit. Ajo e di se ç'është seksi pa orgazëm"- e xhelozoi me zemër të thyer Sofia e Haçet Deletës duke u përpjekur ta fanit shikimin e Pocahontas Powhatanit.

"Zonjë e nderuar, ajo Indigjenia Iroki e Massachusettsit, siç shkruan në të gjitha pergamenat, ia mësoi John Harkerit, njënganjë e troç, në tendën e saj: Seksin, Klitoritin, Orgazmën, po edhe atëfarë Dashurinë. Ajo e ndau Jezusin në dysh: në Jezus të qonquistadorëve dhe në Jezus ekoIroki të Massachusettsit"- u rrëmbye gjenerali austriak duke e harruar elokuencën para Sofisë së Haçet Deletës.

"Zoti gjeneral, ky Jezusi qonquistador sigurisht duhet t`i përkasë Evropës. Sigurisht edhe ky duhet të dale masturbues sikur Haçet Deleta i Ilirikut Albanik"- u shqetësua Sofia e Haçet Deletës

"Po zonjë e nderuar, rreth këtij masturbimi kanë dalë rangje të ngatërruara nëpër ato pergamena të pshurrta. Shkruesit e tyre idiotë, dikur me qëllim, i shkruanin mistershëm, turbullt. Në ato pergamena të deponuara nëpër arkivat e Evropës përmendët tepër mugët edhe masturbimi i Redalk san Heldikut, rektorit të Jakovës së Jerusalemit"- gjithnjë më i zhgënjyer bëhej gjenerali Herman von Urlih me mbushullesë.

-"Në të gjitha pergamenat e shërbimeve informative shkruan përqart se Rabi Jochanan ben Sakai u takua në Galile me Rektorin e universitetit të Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldikun. Paskan biseduar për universitetet e tyre të bjerra, për seksin ekologjik, për mitrat ekologjike të grave. Pastaj në këto

pergamena bie mugëtirë, bie errësirë”- nxehej gjenerali austriak përpara Sofisë së Haçet Deletës, here duke e konsideruar atë si të arrestuar e here si bashkëbiseduese.

“Më thoni gjeneral i nderuar se në këto pergamena, të deponuara nëpër arkivat evropiane a bëhen këto resje për ta mshehur të palindurin, seksin, abortin apo për të vdekurin? Të njejtën gjë po e bëni edhe Ju sonte me metoda joshkencore duke hapur varre e, gjenerali rus duke hapur mitra në Jakovën e Jerusalemit”- u nxitua Sofia e Haçet Deletës

“Pas njëzet minutash, Zonjë e lartë të gjitha do t`i provoni në mishin Tuaj të brishtë. Mbase aborti dhe vdekja për ju paraqesin dy gjëra të ndryshme. Ne ende nuk mund të thomë qartë se Haçet Deleta i Ilirikut Albanik nuk paska pasur djalë, se i paska vdekur djali,se i paska abortuar gruaja diku në Vjenë apo në Sarajevë. Sonte do të flasë varri, do të flasë vagjina, do të flasë mitra”- me zërin e prokurorit i foli gjenerali austriak.

“Shkëlqesia juaj, po të kishte abortuar Teuta e Haçet Deletës në cilëndo klinikë,qoftë në klinikën“Gemeli” të Romës, qoftë në klinikën “Mercoldei” të Vjenës vetëm sa do të ishte shënuar në pergamenë “dështim i natyrshëm”.Çështja do të ishte mbyllur edhe për gjeneralin rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovin,i cili, sonte,me aq ngulmim po i çel mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit. Edhe për juve, gjeneral i shkëlqyer, do të qe më e kollajshme se sa, sonte ta hapni varrin e Kostantinit të Haçet Deletës”-sikur ende të mos kishte kuptua Sofia e sëmboi pamëshirshëm gjeneralin austriak.

Austriaku e ndjeu trysninë zhuritëse të Sofisë për t`ia përmendur udhëtimin me trenin perandorak nga Vjena deri në Sarajevë. Të gjitha mundësitë për t`u shmangur kësaj pyetjeje po i shternin gjeneralit, të cilin e rroku fantaksja.

“Zonjë e nderuar, Ju sonte po regetini ta mëshehni një mitër e cila po lypet me gjakim në Jakovën e Jerusalemit e kudo nëpër dy kontinente, prej Judes e deri në Berlin. Por sa pare bën

kur Rebeka e Alamekut askund të kapet nëpër kontinente. Më së pakti sonte Evropës dhe gjeneralit rus po u duhet mitra e Teutës së Haçet Deletës së atij Ilirikut Albanik, e më së pakti u duhet Kostantini yt i Haçet Deletës"- çfryni gjenerali austriak.

Ai për një çast e vari shikimin, papërcaktueshëm diku në ajër; i nemitur nga pyetja e Sofisë.

"Gjeneral, ju udhëtuat pesë veta me trenin perandorak nga Vjena deri në Sarajevë. Në kupenë e trenit perandorak udhëtuan atë ditë: Franc Ferdinandi, Sofi Löhne, Teuta e Haçet Deletës dhe ju"-i foli provokueshëm ajo sikur të mos e kishte kuptua hidhërimin e gjeneralit.

"Gjithë rrugës, prej Vjenës deri në Sarajevë, në kupenë e trenit perandorak të mbyste kutërbimi i rëndë i kufomës. Në kupe po udhëtonte Vdekja. Ajo mbase ka qenë e pesta udhëtare që po vinte në Sarajevë për komplotin kontinental"- u çjerr, i mbytur në djersë gjenerali austriak.

Ai po drithërohej me shikim të zgurdullt.

Sofia e kuptoi se gjenerali austriak kishte rënë në një shajni të çastit. Kurrsesi të vinte në vete. Ajo vendosi t`i ndihmojë prej andej nga vie aroma ngacmuese e mishit të gruas së re.

"Vetëm mishi i gruas së re mund ta shpëtojë këtë gjeneral"- u mbyll në vetveten e vet Sofia e Haçet Deletës.

Ajo e nxori parfumin me të shtrenjtë, të blerë në Berlin tek parfumeria e Teatrit, para se të fillojë shfaqja e dramës "Fausti". Diskretshem e spërkati ajrin e tendës. E bëri të veshtëllt, të përgjumur, të largët.

19.

Ku ka shkuar i dashuri yt,
o më e bukura ndër gra?
Kah ka mbajtur i dashuri yt…?

I perkas të dashurit tim,
i dashuri im vetëm mua…

O sikur të (të) kisha vëlla
që e ka pirë gjinjtë e nënës sime,
po të (të) kisha gjetur jashtë
do të (të) kisha puthur me afsh
dhe akush s`do të më kish' përbuzur
unë do (të) të merrja,
do të (të) çoja në shtëpi të Nënës sime,

Kënga e këngëve

Cili je Ti ?

Kostantini i Haçet Deletës së Ilirikut - im vëlla apo Redalk san Heldiku - Rektori i universitetit të Jakovës së Jerusalemit ?

Cili ?

Zgjidhe varrin! Shkele varrin!

Kumti do të vijë nga toka.

Do të vije nga ashti.

Sonte ashti jep kumt të përzier.

Sonte do të flasë orgazma.

Redalk san Heldikut tënd, rektorit të Jakovës së Jerus-alemit i mungon penisi dhe testiset.

20.

Mjegulla mëngjesore e ditës së njëzetepesetë të qershorit e shpejtoi vetveten e vet nëpër degët e lisave të parkut afër stacionit të Vjenës kur treni perandorak byrytej tërrfatshëm si dem i harlisur për të vrapuar hekurit të binarëve drejt shkarëzinave të Sarajevës. Treni perandorak i Arçidukës se Habsburgëve-Franc Ferdinandit, krenarisht mbi rrugën e vet të hekurt, nga të dy anët e platos ruhej nga ushtarë të ngurosur në gjendje gatishmërie.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, komandant i çetës ushtarake, sipas protokollit të shpurës së Arçidukës-Franc Ferdinandit,e dha shenjën urdhëruese për t`u futur të gjithë ushtaret e çetës përcjellëse brenda trenit sipas sistemit strategjik.

Gjenerali qëndroi në platformë derisa treni perandorak i gëlltiti të gjithë ushtarët. Ai, i mbetur tashmë vetëm në platformë, pasi e hodhi vështrimin në të dy anët e binarëve u ngjit, me shumë elegancë, shkallës së trenit perandorak. Ushtarët e rreshtuar nëpër korridor qëndruan gatitu para gjeneralit derisa e bëri rivisten. Treni perandorak, madhërisht, me fishkëllimë krenare doli nga stacioni i Vjenës. Shtëpitë, lisat, prapë shtëpitë e lyrosura nga mjegulla e mëngjesit të qershorit, gjithnjë e më shpejt e shtynin njëra-tjetrën se kush do të ecën baras me trenin perandorak. Të gjitha i takonin Vjenës atë ditë përveç trenit të harlisur drejt asaj Sarajevës ogure. Shtëpitë e Vjenës, më në fund u sosën. Treni e filloi garën me fushën mospërfillëse.

U bë koha. Gjenerali, Herman von Urlih hyri në kupenë e Arçidukës Franc Ferdinandi-Trashëgimtarit të fronit perandorak të Austrisë. E heshtur, me një pikëllim në sy, Sofia Löhne u çel kur e pa gjeneralin. Do të udhëtonin tok deri në Sarajevë. Në kupenë e Arçidukës- rezidencë mbretërore, kundruall njëratjetrës, dy gra elegante dhe një burrë i hajthëm, i verdhë dyllë, po rrinin të heshtur nën peshën e ajrit të veshtëlluar nga spërkatja e tepruar prej parfumi të shtrenjtë. Arçiduka, Franc Ferdinandi, kishte sharruar në jakën e ngritur jashtë mase të kapotës ushtarake me plot qëndisma. I rysur në mendimet e heshtura Arçiduka e reshti mundësinë për të çelë kuvend zyrtar me të. Parfumi i cilësisë së lartë i pleksur me kutërbimin e rëndë të naftalinës e rëndonte ajrin për tokë. Ajri mortor flinte në heshtjen e rëndë të peshës së vet.

Aroma e parfumit zgjatej deri në kupenë e trenit qysh një natë më parë. Mbrëmë gjeneralin Herman von Urlih e kishin ftuar në një mbrëmje vallëzimi lamtumirës brenda kështjellës "Summer of". Mbase aroma-naftalinë i kishte mbetur në rrobën ushtarake të stolisur me dekoratën ushtarake të Kryqit të Shën Gjergjit.

Tok me gjeneralin Herman von Urlih, drejt Sarajevës, po

udhëtonte edhe pllakosja e vdekjes. Gjenerali i theu gjunjët, në shenjë nderimi para Arçidukës së verdhët e të këllasur brenda jakës së rrobës ushtarake. Mbase kishte të ftohtë.

Dy zonjat e dizajnuara me finesa të holla, përkuljes së gjeneralit i dhanë hire kalorësiake.I lëshuan velat tisore para tundimit të gjeneralit sikur e sfiduan në fushë të betejës, të krekosura mbretërisht pa vendosur se cila,e para, do t'ia zgjasë dorën gjeneralit. Ato mbanin dorashka të holla edhe pse në kupe bënte mjaft nxehtë. Arçiduka, dyllë i verdhët, vazhdoi të heshtë brenda jakës së ngritur gati mbi mjekërr.

Gjenerali Herman von Urlih qëndroi në këmbë për aq sa e konsideroi mirësjellje kundruall tre personave të gjakut mbretëror. Kutërbimi i parfumit të shtrenjtë të pleksur me naftalinë ia kujtoi gjeneralit se vetëm aq e lejonte detyra të qëndrojë në kupenë mbretërore. Me reverancë gati të tepruar u largua nga kupeja. Hyri në rezidencën e vet për t'i çfletuar raportet dhe gazetat e ditës. Në njërën gazetë lexoi: "Kajzeri i Gjermanisë i filloi pushimet nëpër fjordet e qeta të Norvegjisë". Në tjetrën gazetë me shkronja të vogla e lexoi lajmin: "Arçiduka Franc Ferdinandi edhe pse i sëmurë rëndë udhëtoi për në Sarajevë". Pastaj: "Ka rrezik të bëhet atentat mbi Arçidukën…"

"Çkamos u bie ndërmend gazetarëve vetëm për t'i shitur këto paçavure"- mendoi gjenerali Herman von Urlih ende i dehur nga dëliri i një nate më parë në kështjellën "Summer of".

21.

"Ju gjeneral ngadhënjimtar i përbuzni ato gazeta vardisëse me gjithë atë rrokopujë lajmesh"- i ndërhyri në shajni Sofia.

Meqë heshtja e gjeneralit u bë e dykuptimtë tek Sofia e Haçet Deletës zgjoi diç sëmbuese. Me njëfarë xhelozie të vagëlltë ajo i ra tërthorazi duke ia sjell ndërmend disa situata të mundshme gjatë udhëtimit me trenin perandorak prej Vjenës deri në Sarajevë. Ajo ia kujtoi gjeneralit se gjatë udhëtimit, ai ka hyrë shpeshherë në kupenë mbretërore.

"Detyra ime, Zonjë e nderuar, ishte ta siguroja ushtarakisht trenin perandorak gjatë gjithë udhëtimit. Andaj shpeshherë më duhej të hyja në kupenë e Arçidukës për ta parë gjendjen. Helbete rrugë plot prita bandash ballkanikë"- sikur u çfajsua gjenerali Herman von Urlih.

“Mos keni hyrë në kupenë mbretërore edhe më shpesh se ç’ju lypte detyra zyrtare?”- e provokoi Sofia.

“Shpeshherë, në çdo kohë kam hyrë në kupenë e Franc Ferdinandit. Nganjëherë më yshte një sëmbim i papërmbajtshëm”- u zvarg gjenerali me një limonti të qartë në zërin e vet sikur i bije tërthorazi ngacmimit të grave.

“Te dy zonjat e reja, të ulura në divanin kundruall Arçidukës, Franc Ferdinandit, me siguri qenë të bukura?”- Sofia e ndjeu sëmbimin në mishin femëror.

“Princesha Sofi Löhne, e shoqja e Arçidukës, Franc Ferdinandit tërë kohën e udhëtimit e mbante vellon të lëshuar mbi fytyrë. Kur treni kalonte nëpër korie të hapura vrushkulli i dritës e zbulonte një fytyrë të hequr, të zverdhmë, me një frikë nevrike në të dy cepat e buzëve. Edhe velloja e hollë tisore sikur i reshtej asaj fytyre të hequr”- gjenerali ende zvargej në-për limontinë e kujtimit.

“Ju e pasket shikuar princeshën, Sofi Löhne, me dhëmshuri të tepruar kalorësiake”- Sofia e Haçet Deletës u përkujdes të dukej e mallëngjyer.

Gjenerali heshti, përtej aktrimit të Sofisë. Ishte, vërtet, më i mallëngjyer se ç’mendoi Sofia, më i mallëngjyer se ç’e lejonte detyra.

Më në fund ajo e kuptoi teprinë e aktrimit të vet. Vendosi t’i bëje dalë asaj pyetjes gërryese nga brenda.

“Gjeneral i Kavalerisë së Kryqit të Shën Gjergjit, ajo gruaja tjetër, poaq e re, poaq me gjak mbretëror në rremat e saj, përbri Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës, Franc Ferdinandit, gjatë udhëtimit prej Vjenës për në Sarajevë, a mos qe Teuta e Haçet Deletës së Dytë, mbretit të Ilirikut Albanik?”- shpërtheu ajo, Sofia e Haçet Deletës së Dytë të Ilirikut.

“Ashtu shkruan në pergamenat e tri ministrive perandorake. Udhëtimi i Teutës së Haçet Deletës me trenin perandorak prej

Vjenës e deri në Sarajevë u dha në shumë variante nëpër gazeta; për të mos i besuar asnjërës”-u përgjegj diplomatikisht gjenerali, Herman von Urlih.

Sofia u zhgreh brenda vetvetes së vet për të dalë aty ku edhe synoi gjatë tërë kuvendimit me gjeneralin.

“Gjeneral i nderuar, gjatë udhëtimit prej Vjenës deri në Sarajevë, ju keni hyrë sa herë keni dashur në kupenë e Arçidukës, Franc Ferdinandit?”- gati u hutua Sofia.

“Po, zonjë e nderuar, sa herë kam dashur kam hyrë në kupenë e Arçidukës”- foli paksa mallëngjyeshëm, sa për vetveten e vet, gjenerali Herman von Urlih.

“A mbajti në prehër ndonjë foshnje Teuta e Haçet Deletës së Dytë të Ilirikut”- mezi e sosi pyetjen ajo.

“Për një gjeneral të varfër, siç jam unë, shkrimet e gjithfarshme të gazetarëve halldupë për zonjat e fisme, behën të lënduesshme”- iu resht përgjigjës gjenerali austriak.

“Gjeneral i nderuar, konsiderata juaj prej kalorësi e zbulon elokuencën finoke për sedrën e zonjave të larta. Por të flasësh për një foshnje ju gjeneral mendoni se është e padenjë për një zonjë të fisme; sikur atë zonjë e shndërroni në mandeshë. Ju, zotëri i lartë, mund ta keni dëgjuar, jo vajin por gërgëlatjen e foshnjës së Teutës së Haçet Deletës. Ajo pas një kurimi të pasuksesshëm të foshnjës së saj në klinikën “Mercoledi” të Vjenës po kthehej me trenin perandorak deri në Sarajevë, për ta vazhduar rrugën pastaj me delizhansin Tuaj, gjeneral i nderuar”- pushoi, e molisur, pas një dufi të lodhshëm.

“Të gjitha këto engletisje i keni lexuar në pergamenat-gazeta të kohës. Gazetat e kanë për natyrë të vetën t’ua marrin pahën edhe fakteve më të qëndrueshme për t’i shndërruar në paçavure. Ndaj, ju zonjë, keni informata të bollshme sa të mos e sulushtrisni një gjeneral të varfër, të hedhur, të lënë, të harruar në një vend kaq të humbur”- sërish iu shmang përgjegjës gjenerali austriak.

Sofia e Haçet Deletës sikur e humbi rrugën për ta gjetur të vëllain- Kostantinin e Haçet Deletës. Ajo, edhe pse përpiqej të mos ia pranojë vetvetes kishte motiv më të thellë, më tundaç për ta lypë këtë njeri, të cilin ajo e quante vazhdimisht Kostantini i Haçet Deletës. E quante vëlla të vet. Sa herë e përmende emrin e tij sëmbimi i mishit femëror e ngacmonte në fund të barkut. Ajo nuk e dinte se me cilin bëri seks në tendën e Zatres Arameje kur e urdhëroi aq sugjestionueshëm Rabi Jochanan Ben Sakai. Foshnjën e kujt do ta lindë në duart e Indigjenes Iroki të Masachussettsit. Po ta lindë foshnjen e të vëllait do ta rrezikojë kodin e popullit të vet. Athua do ta dijë sakt Rabi Jochanan ben Sakai se foshnjen e cilit e mbanë në mitër Sofia e Jakovës së Jerusalemit:foshnjen e Rektorit të Jakovës së Jerusalemit,Redalk san Heldikut,apo foshnjen e të vëllait,Kostantinit të Haçet Deletës së Ilirikut Albanik? Sonte do të flasë varri i njërit prej tyre.

Gjenerali austriak e ruante një pyetje të përzier me ironi në cep të buzës, e cila i shihej qartë. Sofia e ikte shikimin nga fytyra e hequr e gjeneralit.

Ky sëmbim tundaç e nxiti ta pyesë sërish gjeneralin austriak:

"Në të gjitha gazetat, po edhe në pergamenën arkivore shkruan se Teuta e Haçet Deletës udhëtoi shpesh për te klinika "Mercoledi" e Vjenës për kurimin e foshnjës së saj të lindur me operacion cezaresk ditën e njëzet e tetë të nëntorit të vitit njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë. Foshnja u lind e smuar. Ajo foshnje erdhi duke u atrofuar. Ndaj më duhet ta di nëse nëna ime u kthye nga Vjena në Sarajevë me foshnjën e vet në prehër apo i vdiq foshnja. Ju gjeneral i nderuar këtë mund ta keni parë për pikë të ditës së zotit"- ra gati në dëlir Sofia.

Gjenerali lëvizi një hap larg saj; doli në një rrem të fortë drite. Fytyrën e shpalosi nga ajo. Ironia në cep të buzëve lëvizi e gjallë. Edhe Sofia e pa atë bisht gjarpri. Tashmë vetë e kishte

provokuar. U bë vonë për ta mbyllur vërshimin e gjeneralit austriak.

"Zonjë e nderuar, ai gjenerali roman ju ka folur diç të pavërtetë, diç të pamundshme për Rebeken e Alamekut. Juve Zonjë e nderuar ju është zgjuar ajo lektisje e mishit femëror, e klitoritit, orgazmës e penisit. Ç'punë do t'ju bëjë ai Kostantini baladik sonte? Juve Zonjë e nderuar ju janë përzier qëllimisht personat. Vetëm Rektori i universitetit të Jakovës së Jerusalemit, ai Redalk san Heldiku mund të tulitet në mitrën e gruas së re nëpërmes vagjinës, nëpërmes orgazmës… Ai Kostantini i Haçet Deletës është person imagjinar. Ai kurrë s'ka mundur të bëjë seks me asnjë grua. Këtë e di mirë ai çifuti Rabi Jochanan ben Sakai. Ai ka vendosur kurrë të mos e mashtrojë Indigjenen Iroki. Vetëm nëpërmes saj Izraeli i këtij çifuti do të bëhët shtet. Vetëm nëpërmes saj Iliriku yt Dardanik do të bëhet shtet. Këtë e di e gjithë Evropa. Indigjenia Iroki i ka zgjedhë dy mitra grashë kontinentale për ta eksperimentuar orgazmën amerikane Iroki të Masachussettsit. Ajo i ka përzgjedhur mitrat e Rebekes së Alamekut dhe të asaj gruas nga Jakova e Jerusalemit. Sonte o kurrëmë Evrorusia do t'i vrasë qe në mitër Rabi Jochanan ben Sakain dhe Redalk san Heldikun e Jakovës së Jerusalemit. Përndryshe orgazma amerikane e Indigjenes Iroki do të gufojë në mishin e tyre për ta vërshyer pastaj Evropën"- ndaloi për të marrë frymë gjenerali austriak i zënë makthit.

Sofia e Haçet Deletës e pa ende bishtin e gjallë të neverisë së helmët në cepin e buzës së tendosur.Sytë e gjeneralit shkreptinë mbi Sofinë. Zjarri doli nga vorbulla e brendshme e gjeneralit. Shikimi i tij, krejt i paturpshëm, i larë nga mashkulliteti i burrit, po gatitej ta godasë.

"Zonjë e nderuar ç'ju nevojitet sonte Kostantini i Haçet Deletës. Kush ju ka mashtruar se ai mund të ryset sonte në mitrat e grave?

Zonjë e nderuar, e dini ju se Haçet Deleta- ai të cilin ju po e uzurponi për baba tuajin është bërë sovjetiku më i shquar në Shqipërinë Tuaj Albanike të sovjetizuar? A e dini ju, zonjë e nderuar, se e ashtuquajtura Teutë e Haçet Deletës, të cilën ju e quani nënë tuajën, as që e ka ditur se ç'është seksi, orgazma, ç'është penisi i Haçet Deletës? Më e mira punë do të kishte qenë ta kishit pasur vëlla atë Kostantinin e Haçet Deletës. Më e mira punë do të kishte qenë të kishit bërë seks me vëllain Tuaj në tendën e Zatres Arameje. Më e mira punë do të kishte qenë që sonte indigjenia Iroki ta nxirrte nga mitra e gruas së Jakovës së Jerusalemit foshnjen e të vëllait. Më e mira punë do të bëhej sonte sikur Indigjenia Iroki ta hedhte orgazmën amerikane në incestin e Ilirikut Dardanik."- tashme gjeneralit i qe mbuluar shikimi me një vagulli të turbulltë.

Vetëm çakërdisja e gjeneralit austriak e përmendi Sofinë; e solli në vete se në ç'rrezik e paskesh hyrë sonte. E mendoi vetimthi rrugën tjetër të mundshme. Askund me dalë ajo rrugë.

Gjeneralit sa vinte e po i behej më i vagëllt shikimit të mbuluar me athëtim të helmët. Gjithshka pritej prej tij.

"Sa vjeçar do të ishte ai Kostantini i pshurrt po të ishte gjallë sonte?"- e mori në pyetje gjenerali.

Sofia u mundua ta zbulojë ndonjë të çarë në shikimin e gjeneralit. Iu bë e kotë kjo orvatje dëshpëruese. Shikimi i tij ishte mbyllur për të.

Ajo foli siç flet njeriu në errësirë:

"Do t'i kishte tetëdhjetë e shtatë vjet"- u përgjigj ajo pa e ditur se kujt po i përgjigjej në atë verbërim të helmët shikimi.

"Po të ishte gjallë ai farë Kostantini i juaj baladik ç'punë do t'i bënte penisi i venitur, i fishkur, të cilin as që e ka pasur ndonjëherë. Në moshën tetëdhjetë e shtatë vjeçare as penisi i Abrahamit vështirë të bënte punë"- tashmë gjenerali bashkëndjehej prapa shikimit të vet të mbuluar.

Ajo e kuptoi se cilës rrugë po i binte gjenerali austriak. E kuptoi se të gjitha bisedat e saj i paskesh regjistruar shërbimi informativ evropian.Tashmë iu bë e qartë se diagnozat e klinikave evropiane paskeshin qenë të dykuptimta. Megjithëse Haçet Deleta paskesh qenë masturbuesi më i madh, për çështje sigurie,në Mitrën e Teutës se Haçet Deletës është hedhë vazhdimisht gjak hardhuce për të mos ndodhë ndonjë ngjizje e rastësishme në Ilirikun Albanik.

22.

Ai Sigmundi i Vjenës kur foli për atë Hermafroditin e Sozuar në Anime e Animus e paskësh përgjuar bisedën e Sofisë së Haçet Deletës me atë Rektorin e universitetit të Ilirikut, Redalk san Heldikun apo, me atë Kostantinin, natën e tetëmbëdhjetë të prillit të vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një. Me kend paskesh biseduar Sofia e Haçet Deletës atë natë shianike të prillit?

"Më thirre? Ja unë erdha. "

"Kush të thirri pikërisht sonte"

"Zëri yt erdhi atje"

"Je vonuar, shumë je vonuar. "

"Sonte të dëgjova"

"Unë të thirra ditën e njëzet e tetë të qershorit të vitit njëmijë e nëntëqind e dyzet e tetë"

"U bë ftohtë, shumë ftohtë kur e kapërceva kufirin midis Shqipërisë Albanike e Jakovës së Jerusalemit"

"Mbase je frikësuar?"

"Po, jam frikësuar"

"Paske ardhë pa kalë, je lodhë këmbë. "

"Në Shqipërinë e Albanikut sovjetik i kanë vra kuajt dhe zotin"

"Kaq shumë po kutërbueke tokë të mykur?"

"Unë punoj në kooperativën e varrezave"

"Po të lypin, gjithkund po të lypin".

"Kush po më lypë?"

"Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi. "

"Ku po më lypë?"

"Në mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit?"

"Kot më kërkon atje. Gjenerali rus kaherë e ka ndërtuar në Shqipërinë Sovjetike Kolkozin e varrezave"

"Po ti paske vdekur?!"

"Po punoj në kooperativën e varrezave të gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit. "

"E sheh"- i tha gjenerali. -"Ju zonjë, e keni pasur rastin e volitshëm Natën e tetëmbëdhjetë të prillit të njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e njëshit ta pyesni atë njeri, me të cilin biseduat atë natë, për nënën Tuaj - Teutën e Haçet Deletës. "

"Po cili ishte atë natë? Kostantini i Haqet Deletës së Ilirikut apo Rektori - Redalk san Heldiku?"- e pyeti gjeneralin, atje, përtej shikimit të mbyllur.

"Këtë dërdëllitje të njeriut tënd i cili e kapërceu kufirin Shqipëri- Jakovë e Jerusalemit natën e tetëmbëdhjetë të prillit, Sigmundi i Vjenës e ka regjistruar pa qenë i sigurt se cili nga ata të dy ishte atë natë"- fliste ende, gjenerali Herman von Urlih prapa shikimit të vet të mbyllur.

"Po ai, Sigmundi i Vjenës bile çpifi kundër meje. Ai tha se unë paskam udhëtuar midis Animës dhe Animusit. Në këtë mënyrë ai më bëri të udhëtoja midis Kostantinit të Haçet Deletës dhe Redalk san heldikut, midis incestit dhe seksit. Rrugë e pakrye edhe për vetë Psikanalizën politike të tij."- u fye Sofia.

"Edhe më keq, zonjë. Në tendën e Zatres Arameje, ju keni udhëtuar midis penisit dhe vagjinës, drejt orgazmës. Në Evropën e sontme njëmijëherë më shumë Ju dëmton orgazma se incesti."- tashmë gjenerali austriak, i mshehur prapa shikimit të vet të mbyllur, i fliste Sofisë.

Sofia ndaloi. Kostatimi i gjeneralit qe ogur, i papritur, i mardhur. Ajo u nemit se sa e përgjuar paskesh qenë gjatë udhëtimit të saj në Galile e, deri në Jude. E mendoi mundësinë e daljes nga kjo gjendje. Ngadalë, me shumë kujdes, rrëshqiti deri tek dilema: a ka pasë rrugë tjetër? Po Rabi Jochanan ben Sakai përse i ka hyrë kësaj rruge kaq të rrezikshme? Sikur të kishte pasë rrugë tjetër më të volitshme, Rabi do t'i kishte rënë asaj rruge. Po Mefisto përse mori rrugë tjetër, përse u arratis nga teatri i Berlinit, përse refuzoi të aktrojë në aktin e dytë të dramës "Fausti? Po, Mefistoja ankoi; ai deshi t'i tregojë Rabi Jochanan ben Sakait se sa vështirë është të hysh e të dalësh për çdo natë në mishin e qenit vetëm pse atyre zonjave të Evropës po u pëlqyeka ta shohin mashkullin-qen e, qenin-mashkull. T'i njëjësojnë këto dy kode të përziera. Pastaj mëkatin e Seksit, pa Orgazëm, pa Dashuri, atë seksin qyqar ia blatojnë atij Faustit plak, jo për tjetër vetëm për ta dënuar vetë seksin. Ato zonja, të seleksionuara nëpër llozhat e teatrove, sipas përkatsisë klasore e preferojnë, në vend se të pjellin ato vet, të pjellin perënditë e

tyre. Të linden fëmijë nga koka e perëndisë, nga brinja e majtë e perëndisë, nga pulpi i këmbës së majtë të perëndisë. Pjellja seksuale-vagjinale u takon kafshëve dhe të varfërve. Një filozofi plakushë e një plaku të fantaksur nga dështimi në librat e tij për ta rinovuar mendimin, i mbëltohet në pleqëri një penis i fishkur me të cilin i bën fatkëqija disa femra të cilave provon t'ua mësojë seksin e ndotur, pa dashuri, pa orgazëm. Në fund të shfaqjes, ky Faust heq dorë nga penisi i tij i kontaminuar për ta hyjnizuar pjelljen e perëndive nga Koka, nga Brinja e Majtë, nga pulpi i Këmbës së Majtë. Doktor Fausti më në fund heq dorë nga penisi i fishkur i një plaku për hir të patriotizmit gjerman. Kaq e ka pazarin ky patriotizëm gjerman. Matet me penisin e fishkur të doktor Faustit!Mefistoja- hebre, në këtë dramë të karaktereve detyrohet çdo natë të bëjë rrugëtimin e rregullt: qen-mashkull dhe mashkull-qen.

23.

Në dyqanin e parfumeve të teatrit të Berlinit, derisa Sofia e Jakovës së Jerusalemit po e provonte një parfum të markës "Dahlia" e ndjeu firomën e dikujt prapa qafës.

"Ky njeri mund të jetë i guximshëm ose i paedukatë"- mendoi Sofia e shqetësuar për të dyja rastet.

Ajo e gjeti mundësinë ta shohë këtë soj njeriu duke e rrotulluar parfumin në dorën e vet andej kah drita, andej kah i erdhi firoma e atij njeriu.

Ende pa e mbërthyer në shikimin e vet ai lloj njeriu i foli me një zë paksa të ngjirur:

"Zonjë e nderuar edhe ai parfum i markës "Dahlia" zor t'ju shpëtojë nga kutërbimi i rëndë i mashkullit qen dhe i qenit-mashkull".

“Ju zotëri dukeni paksa i flamosur”- i foli dykuptimisht Sofia e Haçet Deletës së Dytë të Ilirikut, e shoqja e Rainhard von Grainhelmit-Trashëgimtarit legjitim të fronit mbretëror të Bohemisë.

“Si të mos ftohem, hirësia e juaj? Për çdo natë më duhet të dishem e të zhvishem, qoftë dimër qoftë verë, për të hyrë në mishin e qenit. Pastaj shpeshherë, teatrit i prishet nxemja. Në skenë bën ftohtë, në kulisë edhe më ftohtë. Më duhet të dishem, të zhvishem për të hyrë në mishin e qenit dhe, në skenë sërish për të dalë nga mishi i qenit. Derisa unë mërdhij në skenë, i qullur nga triqet e regjisorit, ato zonjat zemërdala, pa Orgazëm, pa Dashuri, nëpër llozhat e tyre, i mbërthejnë mbi hundët e tyre të ngrehura facoletat e mbrujtura në parfumet e shtrenjta”- i foli ai lloj njeriu duke dalë nga vagëllima.

Sofia mbeti e nemitur me dorë të ngritur, në të cilën e mbante parfumin “Dalia” pa e ditur se cilin po e shikonte: parfumin apo atë lloj njeriu.

“Jam Mefistoja, Zonjë e nderuar. Ju pashë nga skena, posa dola prej mishit të qenit. Ishit ju, zonjë e nderuar, e para në karrierën time njëmijëvjeçare e cila e kaloi këtë çast pa e vënë façoleten në hundë. Mejtoj se fatit tim iu ndez oguri...”- Mefistoja po dilte nga vagëllima sikur të dalë nga guri i shtatores së vet.

Shikimi i tij zbriti nga lartë në shikimin e Sofisë. Hyri brenda saj deri tek fundi i barkut duke u përplasë me ngashërimin njëmijvjeçar nëpër pubisin e saj. Gati i shpëtoi nga dora parfumi “Dalia”. Ai e mbajti me mirësjellje të paparë ndonjëherë. Pagoi për të dhe dolën nga shitorja e parfumeve.Ajo ishte magjepsur, i ishte dorëzuar, për herë të parë një mashkulli të bukur, plot elokuencë.

“Sa madhështore do të kishte qenë ta arrishë orgazmën me një burrë të tillë në një shtrat mbretëror!”-i vetëtoi asaj.

Mefistoja u mallëngjye. Ku t'i marrë lotët, ku ta marrë penisin. U ngjir brenda vetvetes së vet.

"Çdo gjë do të jepja, sonte, vetëm për një penis. Vetëm për t'ia mësuar kësaj gruaje të bukur rrugën e Orgazmës, rrugën e Dashurisë"- u çjerr në vetveten e vet Mefistoja.

"Ti mohove çdo gjë"-i tha ajo

Ai nuk foli.

Ata, të dy, qëndruan për një çast në korridorin e lozhave të teatrit të Berlinit. Ajo e magjepsur nga tundimi i shikimit të tij, vetëm i shikimit të tij prej kerubini të fuqishëm, pa seks, pa orgazëm por, nxitës i seksit të destinuar për doktor Faustin e teatrit gjerman, i shkoi prapa Mefistos. E magjepsur, e zgjuar seksit, pa pasur mundësi të çfryerjes së epshit, për një çast nuk diti ç'të bëjë me vetveten e vet.

"Zonjë e respektuar, unë vetëm e nxis seksin teatral. Ju mos nxitoni në këtë seks të mundimshëm, të mëkatshëm, të dënuar të vdesë në vetveten e vet të fishkur. Ky seks është vetëm sa për t'i zbavitur zonjat e llozhave të teatrit të Berlinit"- i pëshpëriti Sofisë së magjepsur kur zbritën në holin e teatrit.

"Zotëri i nderuar, kam ardhë nga Bohemia për t'u zbavitur në këtë teatër. Është nata e dytë duke e parë një zoteri të dalë nga mishi i qenit. Erdha natën e dytë për ta vërtetuar nëse ky zotëri dhe ky qen mund të jenë maskota, triqe të skenës, vetëm për zbavitje"- i foli Sofia e Haçet Deletës atij zotërisë me shikim magjepsës.

"Zonjë e nderuar, për ta kënaqur gruan e serës suaj të lartë duhet qenë kalorës i mishit mashkullor e, jo një palaço i sojit tim, maskotë e regjisorëve të pashpirtë. Këta regjisorë më kanë paracaktuar ta loz rolin e nxitësit te seksit qesharak tek një plakush i mjerë vetëm për t'i mbajtur këto zonja larg orgazmës për ta mbajtur lartë patriotizmin gjerman për ta denuar semitizmin e Rabi Jochanan ben Sakait i cili sonte nëpërmes vagjinës,

Orgazmës, Dashurisë po hyn në Mitrën e Rebekes së Alamekut. Hebreu po shpëton nga hyrja e mynxyrshme në mitrën e kones së Danielit. Dhe unë Mefistoja sonte duhet të arratisem nga ky teatër për të mos u kthye kurrëmë në mishin e qenit.”- i foli përngutshëm Mefistoja, shumë përngutshëm.

“Ç’dëme kanë këta zotërinj nga kjo farë orgazme?”- pyeti nëpër ngutinë e tij Sofia.

“Zonjë e nderuar ju kam veneruar mbrëmë. E kam pasur ndjenjën se do të vjeni në teatër përsëri sonte. Kështu ka qenë duhur të ndodhë. Juve u ka tërhequr zvarrë joshja e Shtatëmbëdhjetë minutave të sontme të orgazmës së kontrabanduar në teatrin e Berlinit”- i foli mistershëm, përngutshëm Mefistoja.

Ajo, e hapur sysh, poaq e magjepsur, pa mundur të kuptojë gjë, u bë e tij, për të. E ndjeu veten pluskueshëm në holin e teatrit, pa mundur të marrë rrugë në asnjë drejtim. Gjendja e parë pluskuese ia solli ndjenjën e ngazëllimit.

“Juve,zonjë, po ju thërrasin”-i foli gjithnjë e më mistershëm Mefistoja. -“Ne duhet të largohemi këtej para se të fillojë akti i dytë i dramës “Fausti”. Në aktin e dytë unë duhet të gjendem në zgrofin e qenit, në mishin e qenit”.

Sofia e shikoi, e përhumbur. Ajo po katandisej në një ëndërr të parë kushedi cilën natë; po katandisej në një përjetim të njohur, në një fanitje joshëse. Nga jashtë vetvetes, për herë të parë, e pa veten e vet drejt dritës tjetër.

“Sonte, para se të fillojë akti i dytë i “Fausit”, më duhet të zbres në Jude, midis Jerusalemit dhe tendës së gjeneralit roman, Titi. Do ta takoj në rrugë Rabi Jochanan ben Sakain tok me nxënësit e tij të Sanhredinit. Ai Rabi, sonte u arratis nga Jerusalemi.E ka mendjen të mohojë çdo gjë të Izraelit para gjeneralit roman Titi. Unë, zonjë e nderuar, do t’ia skalis në mendje e në zemër se më lehtë është të vdesësh nga të gjitha vdekjet se të të varrosin të gjallë në zgrofin e qenit”- makthshëm vazhdoi të

flasë Mefistoja sikur e mëtonte ndihmën e Sofisë së Haçet Deletës.

"Ju dashket t'ia theni medjen Rabis?"-e pyeti Sofia.

"Përkundrazi zonjë e lartë"

Diç të vagëllt Sofia zu të dallojë në ngulmin e Mefistos. Po gatitej ta pyesë diçka kur ra zilja për fillimin e aktit të dytë të "Faustit". Të gjithë të pranishmit filluan të hyjnë nëpër llozhat e veta për ta parë aktin e dytë të dramës "Fausti". Zonjat i kontrolluan peshtafet e tyre të vegjël, në i kishin mjaft të qulluara me parfume façoletat.Të gjitha e dinin se akti i dytë i dramës "Fausti", akti i Mefistos kutërbon rëndë mish të qenit.

Mefistoja, drithërueshëm, e zuri për krahu Sofinë e Haçet Deletës. Pa i folë asgjë e tërhoqi andej kah dera kryesore e teatrit të Berlinit. Përftueshëm kaluan pranë portierit pa i folë asgjë, bile pa ia dhënë as bakshishin e shërbimit të karrocës. Në rrugë, para teatrit, po i priste një kupe midis karrocës dhe asaj slitës ruse. Kuajt e mbrehur po kazdisnin me këmbë në rrugën e shtruar me gurë të puthitur. Në slitën-kupe kishte pak dritë nga dy dritare të mbuluara me perde të holla zherseje. Sofia e përhumbur nga rrëmbimi i Mefistos sërish deshi të bërbëlitë diç kur e ndjeu me trup se ajo kupe-slitë u shkëput nga toka.

"Ne po fluturojmë!"- i ngeci në fyt fjala, gati e pathënë.

Mefistoja e ngriti cepin e perdes-zherse. Ata ende po shkonin krahas ndërtesave. Sofia u ngreh paksa kah Mefistoja për të parë jashtë, në rrugë. Qe pozicion i paparë për të: nga lartë i pa dyqanet e modës. Sikur njëra nga kukullat e vitrinës e përshëndeti apo, qe vetëm fanitje.

Mefistoja e lëshoi perden, paksa i qetësuar.

"Shpëtuam!"- i foli dikujt.

Jashtë slitës, në të dy anët ndjehej vrushkulli i ajrit.

"Pse me slitë ruse?"- u përmend Sofia e Haçet Deletës.

“Të gjithë aeroplanët ushtarakë do të na lypin andej kah Polonia, kah kufiri i Rusisë.

“Po ne, në cilin drejtim do t’i bimë?”- e pyeti Sofia.

“Do t’i bimë drejt Judesë, midis Jerusalemit dhe tendës së gjeneralit roman, Titi. Do ta takojmë Rabi Jochanan ben Sakain. Do t’ja them pikëpërpikë se ç’është të varrosesh i gjallë në mishin e qenit”- tashmë e mori vetveten Mefistoja.

“Po përse Rabis ja krahasoni vdekjen me mishin e qenit?”- ende e përhumbur e pyeti Sofia e Haçet Deletës.

“Mund të frikësohet nga vdekja e ta pranojë si më të lehtë dënimin për t’u varrosë i gjallë në mitrën e kones së Danielit të caktuar për të nga Kneseti i Madh i Jerusalemit”- fliste prerazi Mefistoja duke e menduar në vete se ç’rrokopujë do të shkaktojë mungesa e tij në teatrin e Berlinit në fillim të aktit të dytë të “Faustit”.

Sofia ngadalë po binte në vetveten e vet të shkundulluar. Asesi t’i jepte dalë gjendjes së krijuar aq marramenthi. Ata po udhëtonin.

“Tashmë po kalojmë mbi Vjenën e asaj klinikës “Merkoledi”. Ai Sigmundi i psikanalizës po e regjistron udhëtimin tënd jo të qartë duke u munduar t’i bëjë dalë në atë shkencën e vet. Ai do ta shënojë në atë pergamenën e vet se Sofia e Haçet Deletës udhëtoi midis Djallit dhe Hebreut, midis penisit dhe vagjinës, midis Animes dhe Animusit, midis Rektorit të universitetit të Ilirikut- Redalk san Heldikut dhe Rektorit të të dy universiteteve te Izraelit - Rabi Jochanan ben Sakait, midis të vëllait, Kostantinit të Haçet Deletës dhe Redalk san Heldikut”- ironizoi Mefistoja duke e ndezur dritën mbi kokën e të dyve.

Ai e nxori nga xhepi një pergamenë të vjetër, e cila shihej se kishte qëndruar në vend të papërshtatshëm ngase ishte zhubravitur.

Sofia e Haçet Deletës u habit. Ata po udhëtonin me avion. Ende pa e pyetur rreth pergamenës ajo e shprehi habinë për nd-

ryshimin e papritur.

“Po ne po udhëtokemi me avion!”.

“Juve zonjë u kanë kidnapuar. Unë jam vetëm një maskotë e teatrit të Berlinit”- i foli Mefistoja me një qetësi prej shtofi.

“Vërtet në këtë njeri paska mbetur pak nga ai i dyqanit të parfumeve të teatrit”- u hesht Sofia.

“Si mund ta ndjejë pështirosjen, përçmimin, agushinë, tmerrin, në zgrofin qenit një maskotë e bërë prej shajaku të trashë?” - tashmë iu kthye ajo Mefistos duke parë se shumëçka u kthye në gjendje normale, se ata po udhëtonin me avion, të cilin ajo e paskesh marrë për një slitë ruse.

“Zonjë e nderuar, mbrëmë tërë natën kam qëndruar mbi pergamena për ta gjetur historinë Tuaj. Sepse, jua thashë, një herë më parë, ju qetë gruaja e vetme në Evropë pa façoletë mbi hundë kur unë dola nga zgrofi i qenit të Faustit-doktor. Në pergamenën Tuaj, zonjë e nderuar, me dashje, janë bërë resje në shumë vende”- i foli Mefistoja duke ia zgjatur atë pergamenë.

“Po sa do t’i besohet një maskote, të bërë nga shajaku, për këso gjërash kaq të mëdha”- paksa u zhgënjye Sofia e Haçet Deletës.

“Unë zonjë jam maskotë e Izraelit në Evropë, i përfaqësoj të gjithë hebrejt, ashtu siç i dëshiron Evropa. Do ta shihni edhe vetë se Rabi Jochanan ben Sakai do t’i besojë kësaj maskote të bërë nga shajaku”- u ndje paksa i fyer Mefistoja.

Sofia e mori pergamenën e zhubravitur, disi pa interesim, dhe e futi në pështahun e vet të dorës.

Njerëzit filluan të lëvizin nëpër avion; stjuardesat e filluan shërbimin. Të gjithë po udhëtonin për Izrael.

Kopiloti lajmëroi se i janë afruar Jerusalemit. Stjuardesat e shpejtuan shërbimin.

Mefistoja, krahas disponimit, e shtoi kuvendin.

“Ju, zonjë, po e takuam Rabi Jochanan ben Sakain do t’ia shpjegoni të tërën lektisjen Tuaj. Megjithëse ai e di, ju do t’ia shpjegoni se si keni mbetur duke u varavingur nëpër atë baladë të mallkuar, midis penisit dhe vagjinës, me atë diagnozë idiotike: “Sanguis lacertae in utero”. Ajo diagnozë është e shpifur për shkaqe të caktuara politike. Me këtë diagnozë, të papërgjegjësi, pas dy orësh gjeneralët evropianë do t’i dalin përpara Indigjenes Iroki të Massachusettsit.

Mbaje mend, zonjë e nderuar, se Iliriku Albanik i Haçet Deletës së Jezusit qonquistador, i Allahut halldup të shkretëtirës, i Sockomunizmave të të gjitha stepave… është kalbë në Mitrën e vet përtej asaj diagnozës idiotike të shënuar nëpër ato pergamena shterpa: “Sanguis lacertae in utero”. Jo, zonjë e nderuar, sikur të qëndronte kjo diagnozë për mitrën e Iliricumit Albanik do të kishte shpresë për sonte. Kjo diagnozë e rrejshme do të ngjajë në arratisjen e sontme të Rabi Jochanan ben Sakait. Rabi Jochanan ben Sakai, sonte u arratis në mitrën e Izraelit në diasporë. Kneseti i Madh i Jerusalemit vendosi të vdesë në varrin e Izraelit, të vetasgjësohet heroikisht jashtë mitrës. Në cilën mitër do të flijohsh ti sontë. Në atë mitrën e çpifur rristik me sanguis lacertae”- ngutej Mefistoja t’ia shpjegojë Sofisë së Haçet Deletës.

“Atëherë, zotëri i nderuar, izraelitët qenkan ndarë në dy mitra”- foli Sofia e rënë në mejtim të vetvetes së saj.

“U tha dhe u bë, zonjë e nderuar. Në njërën mitër të Izraelit u arratis Rabi Jochanan ben Sakai për ta shpëtuar kodin e Izraelit. Këtë Mitër do ta quajmë Vagjinë, orgazëm, seks, dashuri. Në tjetrën mitër të Izraelit u barrikaduan Rabinët e Knesetit të Madh të Izraelit për t’u vetasgjësuar, për të vdekur“heroikisht”. Këtë mitër do ta quajmë vdekje, varr, vetasgjasim.”- u rrëmbye Mefistoja.

“Ju e thatë zotëri. Iliriku Albanik i Haçet Deletës, i tëri paska mbetur në Mitrën e vetasgjësimit, në mitrën e kalbjes ?” - e

pyeti dëshpërueshëm Sofia e Haçet Deletës.

Ajo e shikoi në sy këtë maskotë prej shajaku. Vërtet kishte sy,bile shumë të vezullimtë,provokues,gati të papërballueshëm, nxitës.

"Ilirikut të Haçet Deletës i paska munguar Rabi Jochanan ben Sakai?"- e nxiti dëshpërimi Sofinë e Haçet Deletës.

"Po, zonjë, Haçet Deleta i yt ishte masturbuesi më i madh në tërë Ilirikun Albanik. Atij tjetrit, Rektorit të universitetit të Jakovës së Jerusalemit- Redalk san Heldikut, ndryshe nga Rabi Jochanan ben Sakai, i mungoi vullneti për ta ruajtur kodin e vet. Ai qe i plogësht, i flashkët. U bë me të gjithë jezusët qonquistadorë, me profetin e shkretëtirës, me profetin Ideologjik të stepës… me të gjithë e me asnjerin. Të gjithë e provuan, të gjithë e dëbuan, sepse, ishte i flashkët, i plogësht, i veshtullt. E lanë të kalbët në Mitrën e vet me nofkën se në zemrën e tij ka shumë gjak hardhuce. Ai rektor u takua me Rabi Jochanan ben Sakain atje në shkretëtirë. Rabi e urdhëroi të hyjë në tendën e Zatres Arameje, ta mësojë seksin me orgazëm"- në sytë e Mefistos u përshkëndit përbuzja.

Sofia e Haçet Deletës u tremb nga përbuzja në sytë e Mefistos. Lakmoi ta marrë një rrugë paksa tjetër të kuvendit për ta shuar sadopak atë përbuzje gërryese të shikimit të Mefistos.

"Zotëri, paksa e përmendët tim vëlla, Kostantinin e Haçet Deletës? Në këtë pergamenë Ju do të keni lexuar diç për të?"- Sofia e provoi zërin.

Mefistoja e pa qartë se Sofia e Haçet Deletës, qëllimisht, e molisur nga përbuzja, rëgëtitshëm u përpoq t'i japë dalë tjetër kahut të kuvendit. U katandis ta mëshehë përbuzjen për Ilirikun Dardanik e për ilirikasit e saj. E mori qëndrimin sikur u mejtua.

"Kostantini i Haçet Deletës Suaj qe vetëm një mullëzak i flashkët.Ishte vetëm një sinonim i Redalk san Heldikut-Rektorit të universitetit të Jakovës së Jerusalemit.Ai qe vetëm një ma-

skotë e teatrit evropian ashtu siç jam unë. Ky Kostantini i baladës suaj të pshurrt mbetet jashtë të gjitha diagnozave; bile edhe jashtë asaj diagnozës së falsifikuar: "Sanguis lacertae in utero. Sa për këtë Kostantin e sa për atë halldupin Haçet Deleta, Indigjenia Iroki e Massachusettsit as që do ta kishte marrë mundimin të vije në Evropë. Mbaje vath në vesh, hirësi! Rabi Jochanan ben Sakai e nxiti rektorin e Jakovës së Jerusalemit ta mësojë seksin dhe orgazmën në tendën e Zatres Arameje.Vetëm pasi i mësoi seksin dhe orgazmën, rektori i Jakovës së Jerusalemit në haremin e sulltanit i mohoi të gjitha xhamitë e botës vetëm për një penis. Dhe e pati njëmend. U bë mohuesi i dytë i traditës pas Rabi Jochanan ben Sakait. Dhe sonte këta dy mohues të mëdhej, në klinikën "Gemeli" të Romës do t'i nxjerrë nga mitra Indigjenia Iroki e Massachusettsit"-jashtë vullnetit të vet u rrëmbye Mefistoja.

Sofia e Haçet Deletës e pa, dëshpërueshëm, se Mefistoja asesi të dalë nga përbuzja e vet brenda zemrës së tij prej cohe të shajakut. Ajo mendoi se sa vështirë qenka ta zbutësh një zemër stofi.

Mefistoja me shikimin e vet zhbirues, kujdesshëm, e lexonte kapitjen e Sofisë. Ai po e çfryente dufin e mijëra vjetësh, të rysur në atë zemër prej maskote.

"Zonjë e nderuar, ndjeje këtë zemër të lënueme, të fyer aq net në teatrin e Berlinit!Mos u frikëso nga kjo zemër prej maskote, as mos shpreso në të! Unë zonjë e nderuar, askujt, as vetvetes sime, e kam të ndaluar t'i ndihmoj; as ta zgjoj as ta shuaj seksin e ndokuj. E gjithë Gjermania e ka mashtrua vetveten e vet kur më ka akuzuar se unë, Mefistoja B, e pask-am zgjuar seksin e një plaku ulok, të fishkur penisit, siç ishte doktor Fausti. Cili do të ishte interesi im të bëj kontratë me një ulok të fishkur? Doktor Fausti as nuk kishte mish as nuk kishte shpirt. Cili do të ishte shpirti që do të ma ipte mua. Zonjë e nderuar, unë jam sinonim i denimit hebre. Sonte, posa ta nxjerrë nga

mitra e Rebekes së Alamekut Rabi Jochanan ben Sakain Indigjenia Iroki, misioni im në mishin e qenit do të pushojë"- midis ankesës dhe zhgënjimit foli Mefistoja.

Ai po i përgjërohej Sofisë ta ndjejë për rrëmbimin,për zhgënjimin, e një populli hebre të cilin e përfaqësoi aq përbuzshëm në teatrin e Berlinit. Ai me zemrën e vet prej cohe të shajakut po zbriste në Jude me zjarrin e ndezur të misionarit. Erdhi çasti i fundit. Po të ligështohet vetëm për një çast Rabi Jochanan ben Sakai, Izraeli do ta humbte kodin e vet përfundimisht. Ai po vinte në çastin e fundit për t'i dhënë zemër Rabi Jochanan ben Sakait.

Këtë prirje të mendjes e të zemrës e kuptoi Sofia e Haçet Deletës. Tashmë kishte ardhë çasti për ta pyetur Mefiston.

"Cili është misioni im sonte, zotëri i nderuar.Mua më kidnapuan në teatrin e Berlinit. Po zbres në Jude, ende pa e kuptuar përse sonte udhëtova me Ju unë, e shoqja e Rainhard von Grainhelmit të Tretë - trashëgimtarit të ligjshëm të fronit mbretëror të Bohemisë?"- ajo e pyeti duke i përmendur të gjithë titujt familjarë.

Mefistoja u rrek ta shikojë me dhembshuri; t'i flasë me dhembshuri duke i rënë çdo fjale.

"Ju, zonjë e nderuar, i përmendët të gjithë titujt familjarë. Nga të gjithë këta tituj ju ka tradhtuar aktrimi i dobët në lozhën e teatrit të Berlinit. Diç ju ka privuar ta përdorni façoletën e mbrujtur në parfum për t'u mbrojtur nga kutërbimi i qenit hebre të doktor Faustit.

Zonjë e nderuar, unë ju vrojtova nga skena. Më erdhi në zemrën time prej shajaku mallëngjimi i parë nga ai lloj tjetër gruaje. Pas shfaqjes së tij, doktor Fausti më tregoi për të gjithë titujt Tuaj, zonjë e nderuar. Ai i kishte lexuar të gjitha pergamenat. Bile, doktor Fausti më këshilloi të mos e vras mendjen për atë grua ballkanase e cila ende privohet nga sjelljet aristka-

te të përdorjes së façoletës.E dini çka më tha zonjë e nderuar?”- u ngazëllye Mefistoja.

“Çka ju tha, zotëri, ai doktor Fausti, sigurisht për mua?”- u bë kureshtare Sofia e Haçet Deletës.

Mefistoja e shikoi në sy. Ai kishte shikim, bile shikim tundues, nxitës, sëmbues.Ai kishte vetëm sy të futur në një maskotë të bërë nga coha e trashë e shajakut. Ishte i varrosur brenda maskotës për ta aktruar për çdo natë në teatrin e Berlinit dështimin mëkatnor të Djallit- Hebre.

Për çdo mbrëmje pasi zhbëhej nga qeni në Mefisto, së pari, nga skena ua hidhte shikimin rreth e rrotull të gjitha lozhave të mbushura rristik me zonja të larta nga kryeqytetet e botës. Ato, të pispillosura, të pudrosura, sipas rregullës për këtë çast, ritualisht, i nxjerrnin façoletat e mbruajtura në perfume të markave të ndryshme për t’i mbuluar hundët nga kutërbimi imagjinar i mishit të qenit.

Mefistoja dëshpërohej nga ky ritual absurd, jo shëndetësor, meqë edhe Mefistoja edhe qeni i tij qenë të punuar nga coha e shajakut të trashë. Te fundi kjo ishte vetëm lojë. Ato gra, me aq fanatizëm mbroheshin nga kutërbimi i paqenë i hebrenjve.

I shikonte ato gra nëpër lozhat e teatrit. Ndjente, në të njëjtën kohë edhe dhembshuri edhe përbuzje edhe urrejtje për to. Ndjente dhembshuri pse ato gra ishin aq të privuara nga Orgazma në shtretërit e tyre prej princash, kontësh, lordësh, mbretërish. Ishin të privuara nga Dashuria e Njeriut për Njeriun. Jezusët qonquistadorë e kishin mbjellë mëkatin e ftohtë, hekur të rëndë, në zemrat e tyre. E kishin mbjellë në këto gra fajin e mitrës femërore të asaj Evës lakmitare, të asaj orospisë së inatit e jo të vagjinës, të seksit, të orgazmës.

Ndjente përbuzje për këto gra fodulle, të cilat me aq fodullëk e mbronin shëndetin e tyre hardall nga kutërbimi i mishit të qenit. Ndjente urrejtje për to se sa të gatuara ishin për ta përfillur krimin mbi mëkatin e falsifikuar.

U step Mefistoja. Në njërën lozhë mbretërore një grua e kapërceu aktin e dytë të dramës "Fausti" pa e vënë façoletën mbi hundën e saj të bukur.

Doktor Fausti e solli në vete Mefiston.

"Shikoje punën tënde! Ti duhet të hysh e të dalësh nga kjo maskotë e qenit. Ne duhet t'i zbavitim spektatorët. Ata paguajnë, bile mjaft shtrenjtë, për të na parë neve. Mos e vraj mendjen me atë grua. Ajo zhbiron diç nëpër mëkatin e familjes së vet, krahas mëkatit tuaj hebre. Ajo grua do të testohet shkencërisht midis Animës dhe Animusit, midis penisit dhe vagjinës, midis të vëllait të vet, Kostantinit të Haçet Deletës dhe Rektorit të universitetit të Ilirikut të Jakovës së Jerusalemit - Redalk san Heldikut e, në fund midis kodit të ruajtur në mullëzën e mishit gaull të Jakovës së saj dhe dy mitrave të Jerusalemit. Kushedi çka do të dalë nga ajo grua. Ajo do të testohet edhe joshkencorisht me metodat e muzhikëve rusë siç testohen lopët e tyre duke ua futur dorën në vagjinë deri tek mitra për të kostatuar në janë shtatzënë. Do të testohet edhe mbi varrin e të vëllait, të babait, të Redalk san Heldikut, e çkamos tjetër. Në të janë ngatërruar mëkatet e babait, të të birit, të vëllait, të motrës, po edhe të atij Redalk san heldikut halabak. Në të janë ngatrruar edhe mëkatet e asaj Indigjenes Iroki të Massachusettsit. Ti shikoje punën tënde! A s'të duket mjaft që të gjitha këto zonja vijnë nga kahmosi për ta parë aktrimin e një çifuti. Edhe me të pagua po të paguaj mirë"- ia shpjegoi fjalët e doktor Faustit.

Sofia, me kot, u katandis t'i lepuratë këto rrugë të paracaktuara për ta testuar shëndetin e saj psikofizik. Mendja i qe bërë dhallë. Ra në shikimin e Mefistos, sikur lypi dalë nga kjo katrahurë shtjellash.

"Po ju, zotëri ç'i thatë doktor Faustit?"- e pyeti Sofia duke e përgjëruar me shikimin e saj, gati lutës.

"Asgjë, zonjë e nderuar. Ju shmanga dyshimit të tij.Në mbrëmje, mospërfillshëm, doktor Fausti ma dha pergamenën Tuaj -

njërën sosh. Pergamena qe e resur në shumë vende, si duket qëllimisht. Në mbrëmje kur doktor Fausti, sipas rregullës, doli për të shëtitur me mikun e vet– Vagnerin. Unë u zhyta në pergamenat tjera aty tek arkivi i Doktorit…”- ndaloi Mefistoja, i ndërprerë nga Sofia.

“Ju, zotëri, atë mbrëmje munguat në rolin Tuaj. Sipas rregullës Ju, i shndërruar në qen, duhet t’i paraqiteni Doktorit diku në rrugë. Me siguri atë mbrëmje Ju keni munguar paksa në punë”- i ndërhyri Sofia.

“Ju, zonjë e nderuar, e paskeni lexuar dramën “Fausti” apo vetëm po flitni nga shfaqja e aktruar në skenë? Unë mungova në punë mbrëmë. Tërë natën qëndrova mbi pergamenat e familjes së Haçet Deletës së Ilirikut Albanik” - u përgjegj Mefistoja.

Të dy ndaluan për të marrë frymë apo, i ndërpreu stjuardesa e cila iu drejtua së pari Sofisë, me shumë mirësjellje, se ç’deshironte për darkë.

Sofia ndaloi hezitueshëm. Ç’darkë mund të porosiste ajo kur Mefistoja- maskotë ishte i privuar nga ushqimi i njeriut. Vetimthi vendosi ta refuzojë darkën. Pastaj stjuardesa i propozoi ndonjë pije të lehtë. Sofia, me mirësjellje, i refuzoi të gjitha.

Mefistoja e kuptoi sjelljen e Sofisë pa ngurruar ta falenderojë haptas.

“Zonjë e nderuar, ju bëtë mirë kur e refuzuat darkën. Do të kishim rënë në sy sikur Ju të kishit porositur darkë e, unë jo. Një zotëri asesi ta arsyetojë sjelljen e vet kundruall një zonje gjatë darkës: ajo të hajë diç e, ai të mos prekë asgjë nga ushqimi. Kjo sjellje e zgjon dyshimin, veçant në këtë avion të mbajtur nën vëzhgimin e shërbimeve informative”-i shprehi mirënjohje Mefistoja.

“Ju, zotëri, jeni bërë prej cohe të trashë shajaku. Ç’ushqim mund të shpini në barkun Tuaj prej cohe të shajakut të trashë?

Si mund të kutërboni Ju, ose, të kutërbojë qeni i juaj, kur që të dy jeni maskota të punuara prej zhguni të trashë?”- me zë të bisedës së zakontë i foli Sofia duke i dhënë të kuptojë se e kishte kuptuar qysh në fillim.

“Ju e paskeni ditur edhe mbrëmë këtë gjë, ndaj edhe e keni shpërfillur mundësinë e kutërbimit, pa e vënë shamizën Tuaj mbi atë hundë të bukur”- e ledhatoi plot hezitim Mefistoja.

“Ju betohem, zotëri, në kam pasur dijeni për këtë gjë, në kam ditur se ju jeni vetëm një maskotë e punuar nga cohë e trashë zhguni. Megjithatë unë edhe në këtë çast mendoj diç tjetër për ju”- e ngacmoi Sofia me përgjërimin e saj të dykuptimt.

Mbi kokat e tyre, kopiloti lajmëroi se po i afroheshin aeroportit “Ben Gurion”. Zëri u sugjeroi përgatitjen për aterim.

Sofia e Haçet Deletës e shikoi mëtueshëm drejt në bebëzat e syve Mefiston. Ajo deshi të dijë: çka pas aterimit.

“Në dokumentet Tuaja zonjë, shënon se jeni arkeologe e Shoqatës së Kopenhagës. Specializimi juaj është leximi i teksteve të gjuhës arameje; se do të udhëtoni përtej Jerusalemit. Një pjesë e teksteve të Biblës janë shkruar në këtë gjuhë”- i foli ngadalë Mefistoja.

“Shumë gjëra m’i shpjeguat, vetëm kryesoren jo. Përse jam kidnapuar nga teatri i Berlinit”- u ngut të kuptojë diç Sofia e Haçet Deletës.

“Edhe ju, zonjë, do të merrni vesh për atë diagnozën e falsifikuar të nënës suaj - Teutës së Haçet Deletës. Do ta zbuloni se cili qe Kostantini i Haçet Deletës së Ilirikut Albanik e cili qe Rektori i universitetit të Jakovës së Jerusalemit- Redalk san Heldiku.Rabi Jochanan ben Sakai do t’jua shpjegojë gjatë rrugëtimit të tij prej Jerusalemit deri tek tenda e gjeneralit roman Titi. Unë do t’ja dorëzoj kumtin sekret të Shoqatës hebreje të Berlinit”- derisa po fliste sytë e Mefistos u shuan; ai mbeti vetëm një copë e shkalafitur zhguni të trashë në sediljen e avionit.

24.

"O gjeneral, vajza e Aleksit e kishte mbi trup vetëm fustanin e mëndafshtë tylor, më të bardhë se reja e qershorit. Beso, o gjeneral, nëpër dritën e hënës ja pashë trupin e bardhë alabastër. Thimthat e gjinjve të vajzës së Aleksit u mbufatën; lektisen të dalin jashtë fustanit në freskun e natës së qershorit, lektisën të zdërvajën nëpër barin e freskët të vesuar.

O gjeneral, me të dy sytë e mbyllur, pika në buzët e saj. Dora më paskesh arritur tek gjinjtë e saj. Ndjeva kallje gjithandej deri tek pubisi i vajzës së Aleksit. Vendosa të vdes atje, i qullur shalash nga sperma e masturbimit.

Po, si mund të vdiset hebreu i qullur jashtë mishit femëror të vajzës së Aleksit?

Rabi Jochanan ben Sakai më urdhëroi:

"Hyn thellë në mishin femëror të vajzës së Aleksit; shko deri tek Mitra e saj. Atje, vetëm atje vdis!"

Vajza e Aleksit, e përhumbur, po gatitej ta shtie në mishin e vet femëror penisin e tij kur Gavrillo Principi, student i kolgjit të gjuhëve klasike në Sarajevë, e ndjeu në dorë metalin e ftohtë vrastar të revoles. Dikush ia kishte futur në dorë revolen. E paskesh shikuar Vajzën e Aleksit në syrin e vagjinës, pastaj në vagjinën e syrit.Ajo paskesh qenë e shtrinë. Gavrillo Principi paskesh rënë mbi vajzën e Aleksit të qullur vegësh.

"O hebre i mallkuar, e dhunove vajzën e Aleksit, më të ndershmen në Sarajevë!"- foli gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi.

Deshi të çfajsohet Gavrillo Principi sikur eskorta e gjeneralit rus të mos e kishte ngritur pezull, ashtu të qullur nga të dy spermat e dështuara.

U bë dritë e tepruar në zyrën e guvernatorit të Sarajevës, Bergman von Lyhe.

"O hebre, ty të shpëton vetëm goditja me revole. Të shpëton vetëm atentati mbi Arçidukën Franc Ferdinandin, trashëgimtarin e fronit perandorak"- i tha guvernatori i Sarajevës.

Arçiduka, Trashëgimtari i fronit austriak - Franc Ferdinandi, i vrarë katër net më parë në Kështjellën "Summer of" të Vjenës duhet të kalojë mbi urën e Milackës, krejt afër Gavrillo Principit, i ulur në makinë të hapur. Ai, djalë hebre, për ta shpëtuar veten për dhunimin e vajzës së Aleksit, do të shtijë në drejtim të Arçidukës së vdekur katër net më parë në Vjenë.

Për të dytën herë do të vritet në Sarajevë Arçiduka i Habsburgëve - Trashëgimtar i fronit austriak.

U dashka një hebre, kundër ligjit të Mojsiut, të shtie me revole në njeriun e vdekur.

Gavrillo Principi, nën trysninë e shikimit të vajzës së Aleksit, pranoi ta vrasë Arçidukën e vrarë katër net më parë në kështjllën "Summer of" të Vjenës.

Ai hebre, i hajthëm, u çudit kur në tavolinë e pa gazetën "Oslobogjenie", në ballinën e të cilës shkruante me shkronja kapitale:

"Gavrillo Principi, anëtar i organizatës terroriste "Crna Ruka" bëri atentat në Arçidukën, Franc Ferdinandin, duke e lënë të vdekur në vend".

Hebreu i hajthëm deshi të kundërshtojë kur u ndesh me shikimin shitues të vajzës së Aleksit.

Ai heshti përgjithmonë…

25.

"Po nëse varri i Kostantinit të Haçet Deletës del i zbrazët, pa asnjë asht brenda, do të thotë se askush të mos jetë varrosur në të? Atëherë ç'do të ndodhë me atë diagnozën: "Sanguis lacertae in utero?"- e pyeti Sofia e Haçet Deletës gjeneralin austriak, Herman von Urlih.

"Do të jetë krejt njësoj"- u përgjigj, i sigurtë gjenerali austriak.- "Sigmundi i Vjenës e pat shënuar edhe diagnozën suplementare:"Ka shenja të kompleksit të duplifikuar të Anima-Animusit që përfundojnë në incest imagjinar"- profesionalisht vazhdoi gjenerali.

"Ç'do të thotë kjo diagnozë, o gjeneral i madhërishëm?"- u ngut Sofia e Haçet Deletës.

"Me fjalët e një laiku, siç jam unë gjenerali, do të thotë: halucinacion biologjik i njeriut të sozuar. Kur njeriu i ndarë në dysh e gabon vetveten e vet, në gjini, në racë… në kohë, në hapësirë"- ia sqaroi gjenerali me mjaft mundim.

Sofia e Haçet Deletës heshti, heshti thellë, plot kuptim. Gjenerali e ndjeu në vetveten e vet heshtjen e saj. U ndje i detyruar ta sqarojë më tutje.

"Te fundi, zonjë e nderuar, mos i beso fjalës së një gjenerali të padijshëm. Këtë çështje e di mjeku i klinikës "Mercoledi" të Vjenës - ai Sigmundi i Psikoanalizës. Edhe ai, sipas sugjerimit të tij, po e pret me padurim sonte, hapjen e varrit të Kostantinit të Haçet Deletës së Ilirikut Albanik për ta shpallë të saktë diagnozën e dhënë nga vetë ai mbi gjendjen shëndetësore të Teutës së Haçet Deletës"- i ra në fund gjenerali austriak, Herman von Urlih.

"A do ta pranojë këtë diagnozë të ngatërruar të Sigmundit të Vjenes, pas dy orësh, Indigjenia Iroki-Pocahontas Powhatani e Massachusettsit? Ajo do të jetë e pranishme në Takimin e Këshillit të lartë të NATO-s; bile ajo ka ndikim të paparë mbi gjeneralin amerikan, John Harkerin"- i foli paksa me sëmbim Sofia e Haçet Deletës.

" Indigjenes Iroki të Massachusettsit më së pakti i duhet çështja e Teutës së Haçet Deletës së Ilirikut Albanik. Ajo ka hequr dorë nga kjo çështje. Po qe se varri i Kostantinit të Haçet Deletës del i zbrazët, sonte, pa asnjë cifël ashti brenda, atëherë diagnoza e Sigmundit të Vjenës mbi shëndetin e Teutës së Haçet Deletës mbetet e vërteta e vetme. Kjo e vërtetë e Sigmundit të Vjenës i duhet vetëm Evropës. "- e kuptoi sëmbimin e Sofisë sedra e gjeneralit austriak Urlih.

26.

Arçiduka, Franc Ferdinandi, trashëgimtar i fronit mbretëror të Austrisë vdiq për të dytën herë në Sarajevë ditën e njëzet e tetë të qershorit të vitit njëmijë e nëntëqind e katërmbëdhjetë, pas tri atentateve të bëra në të njëjtën plagë. Sofia Löhne, e shoqja e Arçidukës, Franc Ferdinandit kishte rënë në ëndrrën e projektuar nga atentatori, në ëndrrën e dikujt tjetër në dhomën numër shtatë të hotelit "Onix" të Sarajevës, e lodhur nga rruga prej Vjenës.

Ëndrra e projektuar e atentatorit të paguar nga derë e Habsburgëve, për Sofinë Lohne doli plot hendeqe. Mbase atentatori i paguar e kishte zhubravitur ëndrrën e vet nga ankthi i aktrimit.Vetëm atentatori profesionist mund t'i arrijë cenet e atentatit të suksesshëm. Atentatori i mbrëmshëm, i ëndrrës së Sofisë Lohne, paskesh qenë i pakujdesshëm, amator. Në dhomën numër shtatë të hotelit "Onix" të Sarajevës, atentatori e paskesh

harruar skenarin e atentatit mbi Franc Ferdinandin. Ky skenar i harruar në dhomën numër shtatë të hotelit "Onix", i shkruar në pergamenë të fortë, tërë natën e lume e shkoqi brinjësh Sofinë Löhne, të shoqen e Arçidukës, Franc Ferdinandit. Ashklat e atentatit, të harruara në atë dhomë hoteli, i ranë klladë në syrin e majtë të ëndrrës Sofisë Löhne. Në një ashkël-klladë, Sofia Löhne e pa, me syrin e majtë të ëndrrës, Arçidukën e zverdhët përtej vdekjes. E frikësuar nga ëndrra e ashklave të harruara, Sofia Löhne në gjysmë të natës ia dha piskamës sa i nxori kreje.

Arçiduka, Franc Ferdinandi, qortueshëm u kthye me fytyrë kah Sofia Löhne.E verdhëmt në fytyrën e hequr u shfaq ngërdheshja,drejtuar Sofisë së llahtarisur.Një pikë gjaku mbi vetullën e majtë iu bë shumë e kuqe në atë fytyrë të verdhemët. Sytë e shuar nën vetullën e përgjakur u bënë të llahtarshëm.

Sofia Löhne, e tmerruar kërceu në këmbë para tij. Ai i lëvizi buzët pa shkaktuar zë fjale. Ajo çuditërisht, me instiktin e frikës arriti të kuptojë sikur i shoqi t'i paskesh thënë për vrasjen e parë.

"Këtu e tri net të shkuara më ka dhimbur kryet tmerrësisht në anën e majtë. Atë natë vallëzimi në kështjellën "Summer of" m'u afrua një fytyrë e kuqe, tepër e kuqe.

"Kaq e pate"- më tha.

Pastaj më pushoi ajo dhimbje skërmitëse kreje. Eshtrat e kokës m'i ndrydhi ajo fytyra e kuqe duke i bërë të thyhen vetvetiu. Koka m'u bë e butë, e shkalabavtë. Ajo fytyra e kuqe pasi m'i zgurdulloi sytë krejt afër fytyrës sime i tha atij tjetrit:

"Është rrëzuar keq. E ka thyer rrashtën e kresë. Me këtë frakturë shpellore si do ta nisim për në Sarajevë. Çdo atentator profesionist, për çfarëdo pagese do të refuzojë ta zbrazë revolen mbi këtë kokë të çallamitur. Duhet ngallmuar sonte kjo kokë. T'i ngallmohet kjo frakturë shpellore."- urdhëroi fytyra e kuqe.

“Atentati zyrtar duhet të ndodhë ditën e njëzetetetë të këtij qershori. Atentatori i paguar nga Vjena duhet të jetë diletant; të mos e vërejë çallamitjen e kokës së Arçidukës. Atentatori është caktuar që moti, atje në Sarajevë por ju të keni kujdes: atentati zyrtar duhet të dalë sa më bindës!”- urdhëroi ai tjetri.

“Po ato dy gratë, të cilat do të udhëtojnë tok me Arçidukën, në të njëjtën kupe të trenit perandorak, a mund ta hetojnë plagën mbi vetullën e tij?”- pyeti fytyra e kuqe.

“Për të dyja do të kujdeset mjeku ushtarak Alfred von Zigler. Ato le të udhëtojnë të dehura nën efektin narkotik!”- shpjegoi ai tjetri.

Arçiduka, Franc Ferdinandi pasi e përfundoi kumtin e vrasjes së parë karshi së shoqes, Sofisë Lohne, u nis kah dera për të shkuar në dhomën e vet të hotelit “Onix” të Sarajevës. Edhe pse dera qe e mbyllur ai doli. Kur Sofi Lohne doli në korridor Franc Ferdinandi po hynte në dhomën e tij. Sofia Löhne deshi ta ndjekë deri në dhomë sikur të mos e kishin ndaluar rojat tek dera e Arçidukës.

Njeri prej rojave foli nën mustak:

“Gratë përtej të katërdhjetave ta këpusin në rrënjë.”

Të tjerët qeshën duke e përcjellë Sofinë Löhne në dhomën e vet ashtu të përhumbur pasi ia shpjeguan se Arçiduka po flinte thellë në gjumë dhe se deri në mengjes as do të hynte kush as do të dilte kush nga dhoma e tij.

Sofia Lohne deshi t’u thotë rojave se pak më parë Arçiduka ishte në dhomën e saj dhe posa doli nga andej e hyri në dhomën e tij. Ajo po shastisej.

Dita e njëzet e tetë e qershorit u përplas- zog i hutuar, në dritaren e dhomës numër shtatë të hotelit “Onix”. Sofi Löhne u rrek me shumë mundim mbinjerëzor të hyjë në këtë ditë qershori. U frikësua të mos mbetej jashtë kësaj dite. U tmerrua nga fytyra e vet e fishkur prej pagjumësisë së katër netëve, qysh në

mbrëmjen e vallëzimit në kështjellën "Summer of"të Vjenës e deri tek hoteli "Onix" në Sarajevë. Duhej hedhur grim fytyrës mbi këtë trishtim të vërshyer. E gjithë ajo përzierje yndyrash mbi fytyrën e vet e nxori një maskë të trishtë, të pleksur me një paliaço.

Gjitçhka kundër gjithçkaje në fytyrën e Sofisë Löhne e kishin bërë rrëmujë. E kotë të përmirësoje diç në fytyrën e rrënuar të asaj gruaje.

"Jo"- i tha vetvetes së vet.- "Është bërë vonë të korrigjoj diç në këtë koracë-fytyrë me të gjitha këto yndyra. Dita e natës së njëzet e tetë e këtij qershori ka bërë vurratë mbi fytyrën time të suvatuar me kremera të ngjizura. Do të mundohem ta marr me të mirë këtë ditë noprane".

E lajmëruan Sofinë Lohne se ceremonia e parakalimit të Arçidukës, Franc Ferdinandit nëpër rrugën e Sarajevës "Tre engjëj" do të fillojë përngutshëm. Duhej të merrte pjesë në ceremoninë e parakalimit me tërë atë trishtim në fytyrë të suvatuar me shtresë yndyrash.

Trokitja në derën e dhomës vazhdoi me ngulmin e dhimbjes së dhëmballës së prishur.

Ditën e njëzet e tetë të qershorit të vitit njëmijë e nëntëqind e katërmbëdhjetë, Sofia Löhne, e shoqja e Arçidukës, Franc Ferdinandit u mundua të dalë nga ëndrra e dhomës numër shtatë të hotelit "Onix" të Sarajevës. Ajo vetëm u mundua. Më në fund vendosi ta hapë derën e dhomës.

Ordinanca e Arçidukës, Franc Ferdinandit, u përkul me reverancë qesharake para Sofisë Löhne.

"Zonjë e nderuar, shkëlqesia e tij, Arçiduka Franc Ferdinandi dërgon për t'Ju përcjellë deri tek stafi i tij. Pret për ta filluar ceremoninë e parakalimit të kalorësisë perandorake.

Sofia Löhne, e hutuar, gati në neveri, nga reveranca e pahijshme e ordinancës, e pyeti pa elokuencë:

“Zotëri, ku paskesh mbetur ajo zonja e Ilirikut Albanik me të cilën udhëtuam dje nga Vjena?”

Ordinanca e Arçidukës e pikasi në fytyrën e Sofisë Löhne atë trishtimin e mbuluar me yndyrë të ngjizur. Vendosi të ia japë një përgjigje shkarazi diplomatike.

“Mbrëmë,Teutës së Haçet Deletës iu keqësua gjendja shëndetësore. E dërguan në spitalin e Sarajevës, sipas kërkesës së saj.Në gjysmë të natës Konsiliumi i mjekëve të spitalit të Sarajevës kurrsesi t’i bije në fije asaj diagnozës së klinikës “Mercoledi” të Vjenes. E kthyen nga kishte ardhë. Në mëngjes udhëtoi për në Vjenë me të njejtin tren perandorak, gati në gjendje të pavetëdijshme”- e përmbylli çështjen ordinanca.

Trishtimi i suvatuar i fytyrës së Sofisë Löhne u përvjedh në sytë e saj. Ajo u bë e bukur me dy sy të mbushur trishtim. Kontrasti trishtim-bukuri e plandosi, papritmas, fodullëkun e ordinancës. Ai u palua puplash. U skutat në vetveten e vet të trembur. Mezi qëndroi në këmbët e brishta prej alabastri.

Ishte paksa freskët kur shpura e Arçidukës, tok me Sofi Löhnën, pritte të nisej për t’iu bashkangjitur kuadrateve ushtarake të paradës. Një biçim “Mercedesi” i hapur veror, po priste, me motor të ndezur, para hotelit “Onix”. Sofi Löhne e vështroi Arçidukën të ulur në sediljen e prapme. Iu përngja tepër i përgjumshëm, i kërrusur brenda rrobës ushtarake. Dekoratat i rrinin të varura paksa larg gjoksit. Në tokë, pranë këtij biçim “Mercedesi” e njohu gjeneralin, Herman von Urlih. Ai vetë, po e mbante derën hapur për t’u ngjitur dukesha në makinë.

Gjenerali, Herman von Urlih e kishte rezervuar nën mustak një biçim buzëqeshjeje të ngërthyer në vëzhgim ushtarak. Me dorën e djathtë gjenerali e zuri krahun e Sofisë Lohne më thellë së ç’i lejohej për këto raste një burri të edukuar. Ngutja e mbuloi teprinë e gjeneralit. I mbeti në dorë aroma e parfumit të dukeshës.

Gjenerali, Herman von Urlih, ushtarakisht, nën vezullimin e dekoratave, me një hedhje të lehtë, u gjend në sediljen e parë të makinës, pranë shoferit.

Ai farë biçim "Mercedesi", i hapur veror, mori rrugë drejt qendrës së Sarajevës. Në të dy anët e rrugës, gra, fëmijë, përshëndetnin me tufa lulesh në dorë. Disa, jo të gjithë, i hidhnin tufat e luleve para makinës së Arçidukës. Sofia Löhne iu resht, me mundin, tundimit, për ta shikua në fytyrë të shoqin, e frikësuar së gratë e vendosura anash rrugës, me lule në dorë e kanë pikasur çdo gjë. Ajo u përpoq me përpjekje mbinjerëzore të dukej e lumtur. Shikimet e atyre grave i vinin tepër zhbiruese, përtej aktrimit të saj. U rrek të gjejë shpëtim në shikimin e gëzuar të fëmijëve. Ata i ngazëllente shkëlqimi i makinës, shkëlqimi i rrobave të stolisura me gajtanë të artë, ushtarët e paluar në kuadrate, muzika. Me duart e tyre të vockla i tundnin ngazëllyeshëm tufat e luleve. Ajo po mundohej ta marrë veten nga shikimet e ngazëllyera të fëmijëve, kur, befas u shfaq midis tyre një shikim vezullues, sëmbues, maje thike në mishin e saj të varfër. E ndjeu vezullimin e metalit deri në asht. Ajo e pa, e nemitur, e shtangur, e ngulfatur, kur njeriu i syve vezullues e drejtoi armën drejt saj. Ai eci tre hapa përpara nëpër fëmijë. Ishte një djalosh i hijshëm, me shikim të dëshiruar prej grave. Shpejt vezullimi i syve i ra para këmbëve. Më shumë ngjau në njeriun kur do ta vrasë veten. Ai djalë i hajthëm sikur i kërkoi mëshirë Sofisë Löhne.

Ajo e pa dorën e tij të hajthme, bile edhe gishtin e puthitur në këmbëzën e armës. Njeriu i hajthëm dhe arma u shkundulluan kur në grykën e revoles u shfaq zjarri kafshues. Pastaj një tym, sikur e ndjeu freskun e mëngjesit të qershorit, u ngrit pritueshëm përpjetë.

Sofia Löhne i pa të gjitha: frikën në sytë e fëmijëve, zhgënjimin e grave, rënien e luleve për tokë, turravrapin e agjentëve të sigurimit austriak drejt djaloshit të hajthëm i cili shpërtheu

në vajë. I pa dy burra të fuqishëm të shfaqur papritmas pranë djaloshit të përvajshëm. I folën në gjuhën sllave. Ashtu e kuptoi Sofi Löhne sepse gjuha e tyre qe tjetër nga gjermanishtja. Ata dy burra të fuqishëm e bartën pezull duke u zhdukur në turmën e shalakatur.

Djaloshi i hajthëm u zhduk duke ia lënë peng Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës, Franc Ferdinandit, shikimin e përvajshëm.

Çuditërisht makina "Mercedes" mori në të majtë deri tek bordura e urës. Ndaloi në rrethojën e hekurt. Sofia vetëm kur e pa ujin poshtë urës, e kuptoi se paskeshin qenë mbi urë. Makinës po i punonte motori pa asnjë të keqe. Shoferi paskesh rënë lëmuq në sediljen e vet, me kokë të varur përpara.

Gjenerali, Herman von Urlihu, i hutuar, e shau me të madhe organizatorin.

"Ishim marrë vesh ndryshe me këta idiotë provincialë. Jo të paguhen çunakë të papërvojë në këtë punë. Përpak na hodhi në lum".

Sofia Löhne u kapërthye nëpër fjalët e gjeneralit Herman von Urlih. E shikoi, sikur për herë të parë Arçidukën. Ishte prirë kah dera e makinës, me fytyrë të kthyer kah ura e Milackës, sikur po shikonte poshtë ujin. Arçiduka e tundoi neverinë e gjeneralit austriak. Gati në gjendje dëliri, pa e ditur se po zbulonte një sekret shtetëror iu drejtua dikujt, mbase, më së shumti vetvetes:

"Mos u merr më me atë ngordhalaq nopran! Ku di ky Arçidukë të vdesë burrërisht?! Edhe atje në kështjellën "Summer of" mezi vdiq pas gjithë atyre goditjeve në zverk".

Me shkathtësi betejash, gjenerali Herman von Urlih e shtyri shoferin e makinës në sediljen, ku vetë gjenerali ishte ulë më parë e, vet u ul në sediljen e shoferit. Të tjerët u morën me Arçidukën, Franc Ferdinandin. Gjenerali e nisi makinën, pa e prishur kuadratin e parë të ushtarëve.

Gratë, fëmijët, krisma e armës i bëri të iknin duke i hedhur tufat e luleve. Terreni u bë i lirë drejt spitalit të qytetit. Me ta lënë në spitalin e qytetit shoferin e plagosur, gjenerali Herman von Urlih, me po atë dëlir u nis drejt rezidencës së guvernatorit austriak, Bergman von Lyhe.

Para rezidencës së guvernatorit austriak e gjet heshtjen mortore.Makina ndaloi ngutshëm, gati për t'u përplasur në kangjelat e hekurta të oborrit të gubernisë së Sarajevës.

Guvernatori, Bergman von Lyhe, burrë i shkurtër, barkërcyer përpara, kokëtullac, i skuqur nga shëndeti i teptisur, u përpoq të tregohej i qetë, sikur e paskesh situatën nën kontroll. U shkëput nga stafi i vet për dy hapa përpara. U përshëndet me gjeneralin, von Urlih. Me shikim të mbërthyer në sytë e gjeneralit, provoi t'i japë me kuptue që të mos e zbrazë gjithë atë siklet para botës në pikë të ditës. Mbase, i zvetënuar rregullash protokollare, guvernatori, Bergman von Lyhe, i ofroi mikpritje brenda në rezidencë. Gjenerali u mundua të përmbahet. Edhe pse i ngërdheshur i kapërceu përnjëherësh nga dy shkallë. Hyri brenda i përcjellë nga guvernatori Bergman von Lyhe, nga komandanti i kazermës, Henrik-Henke dhe shefi i policisë, Kllaus von Petof. Të katërt u gjendën ballëpërballë njëri-tjetrit.

Gjenerali, Herman von Urlih, pa denjuar të përshëndetet me mikpritësin, e nxori vrerin nga gjoksi:

"E prishët planin me idiotizmat tuaja provinciale. Ju është trashë mendja nga përtacia e këtij vendi të humbur në raki kumbullash e bërxolla derri.Kush nga ju ia dha revolen atij çunaku të shkallua nga mendja pas vajzës së Aleksit?"- i pyeti gjenerali kërcënueshëm.

Ata heshtën sikur u shtyn me njëri-tjetrin.

E mori fjalën, sipas rangut hierarkik, guvernatori i qytetit.

"Gjeneral i shkëlqyer, pasi e shqyrtuam Raportin e Ministrisë së Brendshme e ndamë mendjen të veprojmë sa më bindsh-

ëm për opinionin. E zgjodhën njërin nga anëtarët e organizatës së fshehtë terroriste "Crna ruka". Këtu e një javë, vetë komandanti i kazermës, në poligonin e qitjes, e ka ushtruar atë çunak se si të godasë me revole"- shpejtoi guvernatori, Bergman von Lyhe.

"Urdhri ka qenë të goditet Sofi Löhne, e shoqja e Arçidukës; jo të qëllohet shoferi i makinës. Ai çunaku juaj i organizatës terroriste "Crna ruka", i magjepsur nga ajo vajza e Aleksit, u step tek ra ndesh me shikimin e bukur të Sofisë Löhne. I mori dora lak për ta qëlluar shoferin. Si do ta arsyetojmë këtë huqje të atentatit?- pyeti gjenerali, tashmë i shkalluar në vetvete.

"Zoti gjeneral, ka qenë duhur të sosni punë atje në kështjellën "Summer of" edhe me Sofinë Löhne, të shoqen e Arçidukës. Me një goditje druri në kokë, sado joprofesionale, do t'i kishit dhënë fund. Ajo grua është e hajthme"- e mori guximin të shprehë vërejtje guvernatori i Sarajevës.

"Ka qenë e pamundur, zotëri i këtij qyteti të shkëlqyer"- vazhdoi ironikisht gjenerali.- "Ai Kajzeri i shkërdhyer i Gjermanisë e thirri ambasadorin austriak në Berlin, Bethman-Holwegun. E ndaloi goditjen në zverkun e Sofisë Löhne për shkaqe fort të paqëndrueshme. Urdhëroi:

Sofia e Arçidukës, Franc Ferdinandit, do të udhëtojë në të njëjtën kupe të trenit perandorak tok me Teutën e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik. Bile do të ulen në të njëjtin divan. Mbase vetëm për këtë udhëtim nuk u bë ajo vrasje". Kushedi pse kishte vendosë Kajzeri gjerman."

Guvernatori i Sarajevës heshti. Marramenthi gjendja po ndërlikej. Treni perandorak nga Vjena në Sarajevë e solli gjithë atë intrigë për ta zgjidhur një guvernator provincial.

E ndjeu se mbi kokën tullace po i mblidhej reja e zezë, se po e digjte dielli i intrigës perandorake të përmasave kontinentale. Mbase i duhet të sharrojë këmbë e krye në këtë ngatërresë.

Vetvetja e vet ia kumtoi atë më të keqën ende pa folë gjenerali.

"Duhet rinovuar atentati i dështuar!"-ia këputi gjenerali Urlih.

Guvernatori priti të flasë dikush tjetër.Vetvetja e yshti, përkundër dëshirës që të flasë.

"Perse paska qenë i domosdoshëm udhëtimi i Zonjës së Haçet Deletës së Ilirikut Albanik me po atë tren perandorak të Arçidukës, Franc Ferdinandit kur ka mundur të udhëtojë një ditë, vetëm një ditë më vonë ose më heret?"- u përpoq dëshpërueshëm guvernatori t'i shmangej detyrimit.

"Ishte urdhri i prerë i atij Kajzerit të Gjermanisë"- ia preu shkurt gjenerali, Herman von Urlih.

"Cilin duhet ta pyesim tashmë: Kajzerin e Gjermanisë apo Ministrinë e brendshme të Austrisë? Në midis të atentatit u bë një gropë. Këtë gropë duhet rinovuar"- guvernatori e shtoi zemërimin e gjeneralit Herman von Urlih.

"Kajzeri i Gjermanisë e ka marrë një pushim disa ditësh në qetësinë e fjordeve të Norvegjisë. I ka ndërpre të gjitha lidhjet telefonike. Duhet përdorur vetëm telefonin special. Ju mbase e dini zotërinj të këtij qyteti të përgjumur ballkanik se sot, pikërisht sot. është dita e parë e zbulimit të radios. Mbase edhe kjo mund të jetë shkak për heshtjen e Kajzerit."- sugjeroi gjenerali.

"Është vështirë të kuptohet, zoti gjeneral"- u përvaj zëri i guvernatorit. -"Kujt t'i drejtohemi?"

"Ju, zoti guvernator, jeni brenda çështjes. I gjithë atentati duhet të rinovohet"- sërish urdhëroi gjenerali.

Guvernatori e formoi numrin sekret të linjës së Ministrisë së Brendshme të Austrisë. U paraqit përngutshëm një zë astmatik burri. Ende pa çelë kuvend, guvernatori e shikoi gjeneralin për ta vërtetuar edhe një herë në ishte aty, tek renovimi i atentatit.

Gjenerali miratoi me lëvizje koke. Zëri astmatik, plot nerva, u përgjigj njëpasnjëshëm:

"Urdhëroni zoti Bergman von Lyhe".

Guvernatori i Sarajevës e njohu mikun e vet, von Adler. Ia njohu zërin nevrik pa e ditur nëse miku i tij Joakim von Adler do të jetë njoftuar për dështimin e atentatit.

E njoftoi shkurt:

"Zotëri atentati dështoi"

"E dëgjova lajmin, miku im"- u përgjigj me zërin astmatik ministri.

"Si do të veprojmë pas këtij dështimi?"- e pyeti guvernatori.

"Le të përsëritet atentati"- urdhëroi prerarazi ministri Joakim von Alder.-"Sa për Sofi Löhne mund ta përdorni edhe arsenikun, por mirë do të ishte ndonjë zgjidhje e sofistikuar. Sipas projektit, ajo grua duhet ta ketë një vrimë plumbi diku në fytyrë"- vazhdoi zëri astmatik.

"Zoti ministër, të gjitha helmet veprojnë më ngadalë se ç'na duhet sot neve. Atentati duhet të përfundojë sot, vetëm sot"- ankoi guvernatori Bergman von Lyhe.

"Atëherë përdoreni armën,miku im.Në fytyrë ajo grua duhet të ketë vetëm një vrimë plumbi. Sipas rregullave balistike plumbi duhet të ketë ardhë nga arma e atentatorit. Nën rrobën e saj, ju zotëri, e dini ku rrije zemra.Aty,vetëm aty t'i sosni punët më shpejtë. Pastaj për vrimën në fytyrë mund ta telisni më ngeshëm"- zëri astmatik shpjegoi tendosshëm.

"A mund të ketë obduksion?"- pyeti preras guvernatori.

"Të gjitha do të shkojnë sipas rregullës. Sofia Löhne dhe Arçiduka, Franc Ferdinandi i kanë sjellë në Sarajevë nga Vjena arkivolet e veta të blinduara. Prej Sarajevës në Vjenë do të kthehen me përcjellje ushtarake"- e qetësoi ministri.

“Në ceremoninë e varrimit mund të rrjedhë ndonjë curril i dyshimit”- hezitoi guvernatori duke e vjedhë reagimin e gjeneralit, Herman von Urlih.

“Në funeralin e Arçidukës,Franc Ferdinandit,do të refuzojnë të marrin pjesë të gjithë mbretërit e Evropës sepse në damarët e Sofisë Löhne, të shoqes së tij, ka munguar edhe një pikë e vetme gjaku mbretëror. Funerali do të mbahet vetëm me ceremoni ushtarake”- zëri astmatik sikur i dha fund kuvendit.

-“Jeni disa burra, atje në Sarajevë, për ta sosë këtë çeshtje. Gjenerali, Herman von Urlih, komandanti i Kazermës, zoti Henrik-Henke, shefi i policisë, zoti Klaus von Petof kanë aftësi të mos e përsërisin më ketë atentat të çoroditur, të dështuar. Atentati është i paraparë të përfundojë sot, ditën e njëzet e tetë të këtij qershori. Për gazeta zgjedheni variantin më të mirë!”- zëri astmatik e mbylli telefonin.

Të katër burrat heshtën në fund të urdhrit të ministrit Joakim oto von Adler. Në zërin e tij astmatik kishte ngjirje fërshëllyese të gjarpërit. Secili prej tyre e kishte ndjerë ngapak zërin e tij nga ana tjetër e telefonit, zërin e tij teh thike në mishin e njeriut.

“Sofi Löhne po e merr veten në dhomën tjetër. Mos ia vononi një pije freskuese. Kemi pak kohë. Duhet sosur çështjen brenda ditës së sotme. I gjithë shteti e pret fundin sa më të suksesshëm të këtij atentati”- mori qëndrim të prerë gjenerali, Herman von Urlih.

Guvernatori i Sarajevës, Bergman von Lyhe, i dha shenjë shefit të policisë. Ai doli nga rezidenca ende pa u sosë shenja e urdhrit në sytë e guvernatorit.

Shefi i policisë, Klaus von Petof, hyri në dhomën e zonjës Bergman, e cila po i rrinte te kryet Sofisë Löhne. Djaloshi i përvajshëm ende po ia drejtonte armën. Sytë e fytyrës vajëse të djaloshit të hajthëm ende po ia tundonin imagjinatën Sofisë

Lohne,po ia tundonin barkun.Padurueshëm po e sëmbonin rreth pubisit.

"I keni dhënë të pijë diç?"- e pyeti shefi i policisë zonjën Bergman.

"Jo, zotëri, ishte shumë e djersitur. Mbase një pije freskuese edhe mund t'i bëjë dëm"- përkujdesshëm ia ktheu zonja Bergman.

"Duhet thirrë mjekun"- i tha shefi i policisë me brengosje.

Pas pak ia çatisi mjeku me pajisjet për shpëlarje stomaku. Sofisë Löhne i qenkesh bërë një ngërç në stomak nga shqetësimi i syve të përvajshëm të djaloshit me revole të drejtuar kah ajo. Duhej shpëlarë stomaku.

Mjeku e shikoi shefin e policisë duke pritur ta fillojë punën.

"Zonjë ju duhet të dilni jashtë. Mund t'ju shkaktojë neveri puna e mjekut"- i sugjeroi shefi i policisë zonjës Bergman.

Ajo doli me një hezitim të qashtër prej mikeshe.

Mjeku i vuri dorashkat e sterilizuara. Ia futi në fyt një zorrë të hollë duke i shkaktuar në fytyrë Sofisë Löhne një pështirosje. Asaj i erdhi të kthejë. Pastaj u qetësua. Nëpërmes pompës së vogël prej llastiku e shtyri nëpër tubetën e hollë një lëng ngjyrë vjollce.

Sofia Löhne u shkalabav, frymëmarrja iu bë e lehtë, gjoksi filloi t'i rrafshohej.

"Tash duhet ta lëmë në qetësi"- i foli shefit të policisë mjeku, pa e shikuar, duke i mbledhur pajisjet në çantën sanitare.

Të dy dolën jashtë.

Tek dera e takuan rojën ushtarake.

Në Rezidencën e guvernatorit të Sarajevës, Bergman von Lyhe, shefi i policisë, Klaus von Petof, u kthye i kryer punë.

"Si do ta bëjmë atë plagën balistike mbi vetullën e saj të majtë? Çdo goditje nga afër me armë do t'ia çajë vetullën. Ka mundësi edhe t'ia çajë rrashtën"- konstatoi shefi i policisë.

“Ketë herë do të jemi të kujdesshëm, zotëri”- në vend se shefit të policisë, guvernatori iu drejtua gjeneralit, Herman von Urlih. -“Atij çunakut do t’ja japim revolen të mbushur vetëm me një apo dy plumba të rrejshëm. Vetem në çastin e fundit do t’i dorëzohet revolja”- e shpalosi itinerarin guvernatori i Sarajevës.

“Si quhet ky çunak i zgjedhur për këtë atentat?”- pyeti mospërfillshëm, me fodullëk, gjenerali, sikur po ndiente për herë të parë për ketë djalosh.

“Zoti gjeneral, mbase kemi harruar t’jua thomë emrin e atentatorit. Është nxënës i klasës së katër të gjimnazit klasik të filologjikut.I jati i punon në shërbimin financiar të qytetit”-shpjegoi shefi i policisë,qëllimisht duke e vonuar emrin e tij.-“Emri i këtij çunaku është Gavrillo Principi”- e tha më në fund shefi i policisë.

“Tingëllon paksa ndryshe nga emrat e tyre ortodoksë apo muslimanë. Tingëllon si të jetë emër i jonë”- foli me dyshim gjenerali i menduar në fytyrë.

“Është emër hebrenjsh, zoti gjeneral. Eshtë i regjistruar në organizatën terroriste “Crna Ruka”- ia shpjegoi shefi i policisë.

“Ju, zotëri, keni vepruar mjaft profesionalisht aq sa jua lejon përvoja juaj në shërbimin e sigurimit. Duhet të jeni tepër të sofistikuar me atë çunak. Ai duhet të besojë se po bën vërtet atentat mbi Arçidukën, Franc Ferdinandin. Ai, në moshën e tij, lektis për heroizëm, jo për të holla. Por ju, zotëri, gjithë kohën duhet ta keni në dorë atentatorin”- këshilloi gjenerali Herman von Urlih.

“Në vendin e ngjarjes, zoti gjeneral, duhet të ketë një togë ushtarake. Një staf agjentësh civilë do të përzihet me popull për të reaguar menjëherë po qe se atentatorin e rrok amoku i heroizmës”- me zë fërshëllyes foli shefi i policisë.

Gjenerali, për një çast, ra në mendim.

“Sikur organizata “Crna Ruka”, vërtet ta zgjojë amokun e heroit tek ky çunak? ”- mëdyshoi gjenerali.

“A keni hetuar se ky çunak është i magjepsur në ndonjë vajzë?”- pyeti gjenerali i ndezur nga një dyshim.

“Ai po çmendet pas vajzës së Aleksit”- u ngut shefi i policisë.

“Atëherë ky çunak duhet të jetë çifut. Ata e dinë edhe në moshë kaq të re se çka është ajo Orgazma. Edhe mbiemri i tij atje të shpie. Po i jati ç’pikëpamje politike ka?”- e përfundoi me pyetje gjenerali.

“E vërtetë zoti gjeneral se ai çunak është çifut. I jati punon në shërbimin e taksave, diku në sektorin për financa, i pashquar në ndonjë aktivitet politik. Këtu, zoti gjeneral, hebrejt ruhen nga të gjitha veprimtaritë politike e fetare.”- shefi i policisë u gjend në të njëjtin kuvendim me gjeneralin.

“Ju, zotërinj të nderuar, e keni përimtuar çështjen deri në detaje, me shumë përkushtim. Diç, megjithatë, ngeci. Atentati dështoi”- i vuri në siklet gjenerali.

Të gjithë heshtën pa mundur t’i bëjnë dalë këtij dështimi.

“Zotërinj”- e ndërpreu heshtjen gjenerali. -“Sipas shpjegimit tuaj ai qenka hebre i përzier emrash, por jo nga gjaku. Në provën e dytë, ai çunak çifut do të privohet nga shtirja me revole, qoftë edhe me fishek të rrejshëm. Në çastin kur ai çunak hebre ta drejtojë revolen e zbrazët kah Arçiduka dhe e shoqja, Sofi Löhne, njeri prej agjentëve tonë do t’i zbrazë, krejt kot në erë, dy fishekë. Vetëm le të krijohet bindja se ai çunak, me emër të përzier çifut, e vrau Arçidukën, Franc Ferdinandin, tok me të shoqen, Sofi Löhne. Të tjerat do të flasin vet. Pas arrestimit të çunakut çifut konstatoni se cili amok mund ta ketë rrokë në çastin kritik: amoku i heroizmës, amoku i seksit të vajzës së Aleksit, apo amoku hebre i të hollave. Ai do ta pranojë, do të përbehet se e ka vra Arçidukën, Franc Ferdinandin.

Kështu e kanë këta hebrenjtë e profetizuar: i kanë të përziera seksin e heroizmën. Ju, zotëri, e keni zgjedhur më të besueshmin në Sarajevë: një çifut të ri nacionalist, një çifut të ri revolucionar, një çifut të ri të dashuruar"- i përgëzoi gjenerali Herman von Urlih duke e shikuar me elegancë orën e stolisur.

"Ne jemi gati, zotërinj të nderuar"- e futi kokën në derë mjeku duke e futur edhe njërin krah brenda, vetëm sa për ta treguar gradën ushtarake.

Komandanti i kazermës, Henrik-Henke,i dha shenjë mjekut, në të njëjtën kohë duke iu drejtua gjeneralit.

"Zotëri, detyra e shërbimeve Informative i shtyn gazetarët të marrin vesh se ky çunak, Gavrilis Principus, na qenka me gjak çifuti. A mos ka mundësi t'i bie ndonjë vidhë atentatit të sotmë? Ai farë çifuti, Rabi Jochanan ben Sakai e braktisi Izraelin për t'iu reshtur luftës e, në anën tjetër ky çunak të dalë një atentator në Sarajevë!"- me ritëm imponues foli komandanti i kazermes.

Gjenerali, Herman von Urlih ndaloi, i zënë peng papritmas, më shumë se ç'i lejohej një strategu ushtarak. Para se të ndjehej ngushtë, e ndjeu ogurin e lig në dyshimin e kolonelit, Henrik-Henke. U pa qartë se koloneli dhe guvern-atori paskeshin qenë në zënkë me njëri-tjetrin për ketë çështje.

Mbase, edhe paksa vonë, gjenerali shkasi tek pyetja fillestare.

"Si e keni qëmtua në fillim këtë çunak çifut, kaq të kompremetuar e, kompremetues për ju, kur keni pasur mundësi ta bleni një tjetër në atë farë organizate terroriste "Crna Ruka?" Bile kishit mundur ta bleni edhe me çmim më të lirë. Këta çifutët të marrin në qafë me çmime"- e shfaqi përbuzjen gjenerali.- "Pastaj Rusia do të thotë se Arçidukën, Franc Ferdinandin e vrau një hebre. Çfarë tagri është e detyruar Serbia të paguajë nëse, siç do të ndodhë sot, çifutët dhe austriakët vriten midis tyre?"- vazhdoi gjenerali.

“Zoti gjeneral, edhe ne e kemi shqyrtuar pikëpërpikë këtë mendimin Tuaj. Ja kemi paraqitur ministrit, Joakim von Adler. Ai na është përgjigjur tërthortë duke lënë të kuptohet se Austria është marrë vesh me Rusinë. Vetë gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, e ka ruajtur tërë natën e lume Gavrillo Principin deri sa e ka kapë para vagjinës së vajzës së Aleksit. Ai, gjenerali rus vetë e ka ngërthyer në rrjedhën e atentatit, sigurisht me marrëveshje austriake”- sikur foli me hamendje koloneli Henrik-Hanke.

“Ju kolonel,sikur po zbuloni së tepërmi sekrete shtetërore”- e qortoi gjenerali në mënyrë diskrete.

Situata u nderlikua. Doli qartë përse atentati paskesh dështuar. Kolonelit Henrik Hanke i shkëlqyen sytë. Gabimi u mbeti të tjerëve. U pa se duhej ndërruar shume pjesë brenda atentatit. Renovimi i atentatit i ra barrë mbi supe gjeneralit. Ishte bërë vonë të pyetet edhe një herë ministri austriak, Joakim von Adler. Edhe sikur ta pyesnin ministrin do t’u thoshte se ai atentat i pshurrt është punë provincialësh.

“Gjenerali roman, Titi, komandant i ushtrisë lindore të Romës, në Galile e jude e pranoi liçencën e Rabi Jochanan ben Sakait për themelimin e universitetit hebre në Diasporë vetëm pse ky Rabi hoqi dorë nga lufta kundër Romës. Një atentat hebre në Sarajevë mbi Arçidukën, Franc Ferdinandin dhe mbi Sofi Löhnen do ta kompremetojë sulmin e Austrisë mbi Serbinë. Sonte, pikërisht sonte, Rebeka e Alamekut nga Abbi i Galilesë do të operohet në klinikën “Gemeli” të Romës. Në mitrën e saj do të shartohet Rabi Jochanan ben Sakai i Shtatëmbëdhjetë minutavetë Izraelit. E pse, vetëm dymbëdhjetë orë para këtij operimi cezaresk të bëjë atentat në Sarajevë një çifut. Austria me këtë atentat çifut mbi Arçidukën, Franc Ferdinandin, më shumë do të humbë se ç’do të fitojë”- gati u rrëmbye gjenerali, Herman von Urlih.

Gjenerali i nevrikosi të pranishmit.

“Zoti gjeneral, ju po i gaboni Shtatëmbëdhjetë minutat e Izraelit me atentatin e Sarajevës”- koloneli, Henrik-Henke, e provokoi gjeneralin me ngatërrimin e datave, me origjinën hebraike të atentatorit, pastaj me dinakërinë harbute prej provinciali.

“Juve, zoti kolonel, ju është ndalur ora e juaj provinciale. Ju zotëri kolonel po mykeni në këtë humbëtirë të quajtur Sarajevë, në këtë katrahurë, në këtë rrëmujë dëshiruese të religjioneve provinciale, të këtij banori të paidentitet. Ju është bërë mendja dhallë nga rakia kutërbuese dhe nga bërxolla të derrit”-u përpoq deri në fund gjenerali ta fyejë kolonelin, Henrik-Henke.

Gjenerali e hetoi mjekun ushtarak vetëm kur ai iu qas shumë afër.

E shikoi trembshëm.

“Gjeneral i nderuar, mjeku im ushtarak e lyp lejen Tuaj për t’u shpjeguar para këtij stafi”- aktroi koloneli Henrik-Henke në çastin më të volitshëm për t’iu reshtur konfliktit.

Gjenerali Herman von Urlih e shikoi mjekun me kureshtjen e beftë sikur ta kishte pikasur një qenie të panjohur më parë.

Mjeku u shafit nën peshën e shikimit të gjeneralit.

“Ajo, Sofia Löhne, ka zënë të ftohet. Së shpejti do të bëhet “fragjile”. Duhet t’ja kallëposim pozicionin e volitshëm para se të ngrihet, të behët akull. Më vonë ajo grua do të thyhet si gastare”- foli mjeku i lakuar nga pesha e shikimit të gjeneralit.

“Doktor, para se të shtanget nga vdekja ajo Sofi Löhne, kallypose në pozicion ulur! Le të duket si pasagjer i ulur në sediljen e makinës! Mos harro! Mbi vetullën e majtë, me veglën tënde të sofistikuar, ja bën një vrimë të ngjashme siç e bën plumbi nga një largësi atentati! Vrima mbi vetullën e majtë të Sofisë Löhne të jetë e sofistikuar balistikisht.

Do të jemi gati kur ju, doktor, të keni sosë punë”- e zbriti në nivel miqësor zërin gjenerali, Herman von Urlih.

Mjeku ushtarak, i përkëdhelur nga zëri miqësor i gjenerali, doli nga rezidenca e guvernatorit.

"Zoti gjeneral, ju keni vendosur ta ndërroni atentatorin?"- e pyeti guvernatori.

"Po. Një atentator çifut më së paku i duhet sot Austrisë. Atentatori duhet të jetë një sllav nga ajo organizata terroriste "Crna Ruka". Shërbimi Informativ i njeh të gjithë anëtarët e kësaj organizate. Zgjedheni cilindo prej tyre, përveç këtij çifutit, Gavrillo Principit!- e shpalli urdhrin gjenerali.

"Gjeneral i nderuar, mendimi juaj i tejkalon aftësitë tona për t'i shërbyer shtetit. Po drojmë se anëtaret e tjerë të organizatës terroriste "Crna Ruka" do ta refuzojmë bashkë- punimin"- i ra ndesh propozimit të gjeneralit guvernatori i Sarajevës.

"Se anëtarët e asaj organizate terroriste do ta refuzojnë këtë ofertë e dinë edhe zogjtë. Organizata terroriste "Crna Ruka", me dinakri jua ka lëshuar në dorë këtë çifut të handakosur.Serbia synon me një gur t'i vrasë dy sorra. Në njërën anë e provokon Austrinë e, në anën tjetër atentatori na del çifut. Përse çifuti duhet ta vrasë Arçidukën, Franc Ferdinandin? A mendoni ju, zotërinj, se Roma, ashtu kot, vetëm nga etika hrestomatike e shtetit, sonte do ta lejojë ndërhyrjen kirurgjike në Mitrën e Rebekes së Alamekut? Ne, austriaket, po e pranuam këtë atentator çifut, në Takimin e Këshillit të lartë të NATO-s para atij gjeneralit të pshurrt amerikan, John Harkeri të asaj Indigjenes Iroki, do të dalim antisemitë, antihebraikë. Gjithsesi do t'i shmangemi atij atentatori çifut!"- gjenerali gjithnjë bëhej më kategorik.

"Atëherë cili do të caktohet të bëjë atentat në Arçidukën edhe në Sofinë Löhne pasi lajmi e mori dhenë se këtë atentat e bëri Gavrillo Principi?"- ndërhyni guvernatori.

"Jo secili, zotëri. Sikur t'i lejohej secilit ta bëjë këtë atentat, atëherë përse do ta përjashtonim këtë çifut të brishtë. Mendja e juaj e trashë provinciale, e nyllur në raki e mish derri, i merr

gjerat kuturu”- për të dytën herë i fyu gjenerali austriak, Herman von Urlih.

“Mbase atë çifutin e vogël mund ta rrokë amoku i heroizmës. Atëherë ai mund të veproje krye në vete”- ndërhyri shefi i policisë.

“Jo! Këtë pavarësi heroike të çifutit do ta ndalojmë. Ndërhyrja kirurgjike mbi vetullën e Sofisë Löhne do të bëhet me sofistikim balistik. Ekipi i mjekëve do ta bëjë një vrimë mbi vetullën e saj pa pasur ngasje për ta qëlluar me plumb nga larg as nga afër. Atë do ta ulni pranë të shoqit të vdekur në sediljen e prapme, sipas rregullës. Çifti bashkëshortor, të dy të vdekur, njeri në kështjellën “Summer of” e, tjetra e vdekur në ketë rezidencë, do të shkojnë, sipas skenarit. Ata do të nisën drejt spitalit të qytetit për ta vizituar shoferin e plagosur. Rrugës për spital do të “ndodhë” atentati mbi Arçidukën, Franc Ferdinandin dhe mbi Sofinë Löhne. Shoferi i tyre krejt rastësisht do ta gabojë rrugën e spitalit. Makina e tyre do të ndalojë para një taverne ku ai çifuti juaj po e heq pikëllimin me një gotë raki. Këtë herë zyrtarisht të dy duhet të mbesin të vdekur në vend”- urdhëroi gjenerali Herman von Urlih duke e shikuar orën.

“Zoti gjeneral, po atëherë kush do të shtije mbi Arçidukën nëse jo ai çifut i hajthëm?”- pyeti përvajshëm shefi i policisë.

“Do të shtije një agjent yni, i veshur vendçe si anëtar i organizatës terroriste “Crna Ruka”. Ai vetëm do të shtie në erë, ashtu kot, pa pasë nevojë ta drejtojë revolen kah makina. Revolja do t’i epet me dy fishekë të rrejshëm, e kontrolluar në çastin e fundit”- urdhëroi gjenerali me shumë kujdes meqë ai vetë do ta drejtojë makinën e Arçidukës për tek spitali i qytetit të Sarajevës, i ndrojtur se këto mendje të trasha provinciale mund ta vrasin, gabimisht, vet gjeneralin.

Të tre heshtën para gjeneralit. E bluanin në mendjet e tyre të ngathta se cilin ta caktojnë për t’i bërë këto dy shkrehje e përpjetë në ajër. Gjenerali po priste me një gotë në dorë.

U bë heshtje.

“Ky atentator le të jetë Milani i Shantiqit”- ia shkrepi shefi i policisë.

Ata dy tjerët u çtendosen në lëkurat e veta.

“Kush na qenka ky Milani i Shantiqëve?”- e pyeti gjenerali.

“Është një djalë i përjashtuar nga gjimnazi filologjik për sjellje paksa të çorientuara. I ka lexuar disa libra qesharakë të njëfarë rusit revolucionar, Aleksej Maksimoviq Pjeshkovit. Eshtë dhënë paksa edhe pas gotës. I pëlqejnë ngapak të hollat, pa të cilat mbetet shpesh. Është i luhatshëm”- e përvijoi figurën e Milanit të Shantiqit shefi i policisë.

“Këtij të mos i tregohet asgjë. Ky farë Milani do ta marrë një shumë të konsiderueshme të hollash vetëm për zbrazje të revolës. Pastaj le të largohet me përcjellje nga vendi i ngjarjes!”- e pranoi planin e shefit të policisë gjenerali.

Dolën nga rezidenca e guvernatorit të Sarajevës.

27.

Rruga qe e ngushtë. Gjenerali Herman von Urlih e ngadalësoi turrin e makinës "Mercedes" para tavernës "Teferiç" buze lumit Milacka. Një parë sy vezullues i ranë ndesh gjeneralit. Qenë sy të njohur, të përzier. Ai u nis drejt makinës. Në dorën e plogësht e mbajti revolen. Eci me hapa të vendosur drejt njerëzve të vdekur. Iu afrua makinës. I fantaksur gjakoi për diçka. Ai po e lektiste shikimin e Sofi Löhnes. Çunaku hebre iu afrua Sofisë Löhne sa për ta mbërritur me dorë. Ia ngriti vellon. Ia përkëdheli vetullën e zhbiruar. Plaga i ishte shkaktuar me një mjet të sofistikuar.

Nga larg dikush shtiu dy herë, vetëm dy herë.

Velloja e Sofisë Löhne u tremb paksa.

Gjenerali, Herman von Urlih e njohu Gavrillo Principin.

Çunaku hebre arriti tek makina e gjeneralit nëpër shikimin vardisës të Sofi Löhnes. Thonjtë e dorës së shtrënguar i ishin ngulë në mishin e përgjakur.

Gavrillo Principi po e shtrëngonte në dorë pubisin e vajzës së Aleksit.

"E vrave farën tënde, në këtë grua, o gjeneral"- Gavrillo Principi bëri me dorën e përgjakur kah Sofi Löhne.

"Midis revoles dhe vagjinës së vajzës së Aleksit ky çifut i flashkët e paska zgjedhur mishin e vajzës së Aleksit"- e xhelozoi gjenerali i mallëngjyer nga vetulla e shpluar e Sofisë Löhne.

Para katër netësh atë vetull e kishte puthur në kështjellën "Summer of"të Vjenës.

"Shkrepe atë revole të mallkuar, o çifut i ndotur!"- u çjerr gjenerali.

"O gjeneral, ç'i duhen Evropës dy krisma të revoles çifute, pikërisht sonte kur Rabi Jochanan ben Sakai po bie në Mitrën e Rebekes së Alamekut? Sonte kur Indigjenia Iroki e Massachusetsit do t'i nxjerrë nga mitra foshnjet e para vagjinale të orgazmës në Evropë?"- sikur i foli Gavrillo Principi me revole në njërën dore e me vellon e Sofisë Löhne në tjetrën dorë.

"Shkrepe atë revole të pshurrtë o çifut. Vetëm ato dy krisma i duhen fillimit të një lufte. Sonte kontinenti po çmendet për një luftë. Sonte Evropa duhet t'ia prishë atë ndërhyrje cezareske asaj Indigjenes Iroki të Massachusettsit"- iu ngërdhesh gjenerali Herman von Urlih.

"Me dy të shtëna revoleje prej çifuti në Sarajevë mendon ta fillosh një luftë në botë. ?O gjeneral, a do të ketë fillim më të padenjë për një lufte se ky i juaji në Sarajevë? Po e filloni në vagjinën e vajzës së Aleksit dhe mbi vetullën e trembur të Sofisë Lohne!"- e përbuzi Gavrillo Principi.

"Po ti o hebre mos vraj aske, vetëm zbraze dy herë në erë atë revole të mallkuar!"- e përgjëroi gjenerali.

"U dashka ta vras për të dytën herë njeriun e vdekur në Vjenë vetëm të shpëtohet lufta e jua gjeneralëve?"- e pyeti gjeneralin Gavrillo Principi.

"Jo! Ti o hebre do të kursehesh nga vrasja e trupit dhe e shpirtit të Arçidukës, Franc Ferdinandit. Në revolen tënde janë futur vetëm dy fishekë të rrejshëm. Sot, në Sarajevë na duhen vetëm dy krisma fishekësh të rrejshëm. Arçiduka, sot, në Sarajevë, vetëm do ta aktrojë vdekjen e bërë në Vjenë"- i zbuloi të gjitha gjenerali i përhumbur, Herman von Urlih.

U dëgjuan edhe dy të shtëna të revoles së Milanit të Shantiqit. Qenë dy të shtëna krejt sipas rregullës balistike. Velloja e Sofisë Löhne u tremb paksa.

Gavrillo Principi u shafit për tokë i mbrujtur nga lotët e vajzës së Aleksit.

"Fotografojeni nga të gjitha pozicionet. Fotografitë e tij duhet kompletuar në dosjen zyrtare"- urdhëroi shefi i policisë së Sarajevës, Kllaus von Petof.

"Po me vajzën e Aleksit ç'do të bëjmë?"- e pyeti ai tjetri.

"Benjani një shenjë të sofistikuar mbi vetullën e majtë. E vrau i dashuri i vet"- e përmbylli shefi i policisë.

28.

Makina "Mercedes"e Arçidukës, Franc Ferdinandit, e ndezur, e larë, e fshirë, po priste, e gatshme në oborrin e Rezidencës së Guvernatorit të Sarajevës, Bergman von Lyhe.

Shoferi, një burrë elegant, i veshur në uniforme husarësh, po qëndronte në gjendje gatishmërie pranë makinës. E përshëndeti ushtarakisht gjeneralin, Herman von Urlih. Pastaj, me komandë, ia hapi derën e makinës. Gjenerali u ul në vendin e vet të mëparshëm, pranë shoferit. Arçiduka, Franc Ferdinandi, i verdhë, i shtangur brenda fytyrës së vdekjes pranë të shoqes, Sofisë Löhne, rrinte ulur ne sediljen e pasme. Çifti bashkëshortor, i heshtur, herëpashere kutërbonte rëndë naftalinë. Bile gjenerali gati të mos e durojë këtë kutërbim. Mbase ishte vonë, po edhe e pamundshme për të ndërruar diçka.

Gjenerali Herman von Urlih pasi e përshëndeti çiftin bashkëshortor sipas rregullës ushtarake nga sedilja e parë, ku edhe qe ulë, me një elegancë të pleksur me mallëngjim u kthye kah Sofi Löhne. E përqendroi shikimin e mallëngjyer në fytyrën e saj të mbuluar deri në gjysmë me vello. Iu bë se Sofi Löhne po e ruan prapa vellos zemërimin e përzier me epshin e saj të kështjellës "Summer of" të Vjenës. Ajo sikur e qortoi. Gjenerali ende e vazhdoi shikimin mbi fytyrën e saj duke e pritur një puhizë ere të lehtë për t'ia lëvizur paksa vellon nga fytyra e verdhemët, të

hequr, me mallëngjim të ngrirë nën grimin e trashë si suvatim. Fytyra e Sofisë Löhne ishte shndërruar në maskë për ta mëshehur vdekjen e saj. Gjenerali, i mallëngjyer ra nën maskën e asaj fytyre deri tek lëkura e lëmuar, e freskët, tunduese, sikur atë natën e kështjellës "Summer of" të Vjenës.

Shoferi e nisi makinën, më ngadalë se ç'duhej. Kishte frikë për çiftin bashkëshortor. Ashtu ishte dhënë urdhri. Duke dalë nga dera e oborrit të rezidencës së guvernatorit të Sarajevës makina e mori kthesën e parë kah spitali i qytetit. Nga lëvizja e makinës apo nga puhiza e papritur velloja e Sofisë Löhne u ngrit paksa. Gjenerali e përshkëllini shikimin nëpër fytyrën-maskë të saj. Shikimi i gjeneralit sharroi thellë nën maskën e yndyrshme deri tek lëkura e Sofisë Löhne të kështjellës "Summer of " të Vjenës. Ajo e qortoi plot dashuri, përtej shikimit të vrarë, përtej shikimit të vdekur. Mbi vetullën e majtë, të kërcyer, gjenerali e pikasi pikën e zezë, të sofistikuar mjeshtërisht.Me vrojtimin prej ushtaraku e njohu plagën mbi vetullën e saj të majtë. Ishte plagë e shkaktuar me vegël tjetër; jo me plumb revoleje. Gjenerali dhe dashnori u kapërthyen keqas në fytyrën e hequr të Sofisë Löhne. Në atë fytyrë patën të gjitha: dashuria, qortimi, dhembshuria, frika e, mbi të gjitha maska e trashë, e akulltë, për ta mëshehur vdekjen e saj të shkaktuar. Trishtimi i kishte mbetur në fytyrën e hequr nën pudrën e hedhur me bollëk. Sytë e saj gjysmë të mbyllur, me shikim të vjerrë teposhtë akuzonin si turpshëm pas një nate dashurie të rrejshme me Arçidukën, Franc Ferdinandin.

Edhe pse e përforcuar për sediljen e makinës lëvizjet e shkaktuara e mundonin trupin e saj të vdekur, e benin idiotik, qëllimisht, si në ndonjë karnaval. Meqë në dejtë e Sofisë Löhne paskesh munguar gjaku mbretëror Arçiduka, i sharruar thellë në kapotën ushtarake, ishte larguar paksa prej saj në sediljen e makinës "Mercedes". Sofisë Löhne çuditërisht plaga e kuqe mbi vetullën e kërcyer i rrinte bukur.

Katër net më parë, atje në kështjellën "Summer of" të Vjenës, gjenerali, Herman von Urlih, e kishte mbajtur në krahët e vet atë trup të hajthem të Sofisë Löhne. Nga salla e vallëzimit, të kapitur, dolën paksa në kopshtin botanik. Gjenerali ia hodhi shallin krihëve të djersitur alabastër. Shpatullat e kolme e zbuluan racën fisnike në sytë e gjeneralit. Kishin arritur në fund të kopshtit botanik. Ajo u drithërua, mbase nga aftimi i natës. Lëvizi drejt tij për t'u mbrojtur nga aftimi i papritur. Gjenerali symbyllas ra në buzët e saj, në gojën e saj. Puthja e ngrohtë e vakët,pastaj e nxehtë, pastaj valuke,i zbriti teposhtë mishit deri në fund të barkut. Gjenerali rrëshqiti mbi të. Ajo e kishte pasur vetëm fustanin e mëndafshtë në trup.

Gjenerali, i molepsur nga shikimi i ngrirë, ia lëshoi mbi fytyrë vellon.

"E paskemi marrë rrugën gabim, zoti gjeneral. E paskemi gabuar rrugën e spitalit"- e zgjoi shoferi.

Gjeneralit Herman von Urlih i paskesh ikur vullneti për të folë. E hetoi se shoferi po rropatej ta kthejë makinën. Rruga qe e ngushtë. Shoferi gjatë manovrimit gati u rras në oborrin e kafenesë "Teferiç".

Një parë sy i ranë ndesh gjeneralit, Herman von Urlih. Ata qenë sy të njohur. Ishte çunaku hebre, Gavrillo Principi. Në dorën e djathtë e mbante revolen. Eci drejt makinës me hapin e njeriut të vdekur një orë më parë. Vonë, shumë vonë, arriti tek makina.

Gjenerali, Herman von Urlih, e mori me mend qëllimin e çunakut çifut i cili iu afrua krejt ngat makinës. Gjenerali e pa dorën e majtë të çunakut hebre. Ai çunak, i vdekur para një ore, i magjepsur e ngriti vellon e Sofisë Löhne. E shikoi plagën e bukur mbi vetullën e saj të kërcyer.

"Sa të bukur e ke plagën e kuqe mbi vetullën e kërcyer, o zonjë e vrarë para seksit Tuaj"- i pëshpëriti nën vetull çunaku hebre.

Gjenerali e njohu sikletin e kuvendimit të çifutit, Gavrillo Principit. I nemitur, u ngujua në pezmin e çifutit- Gavrillo Principi.

"E vrave farën tënde në këtë grua o gjeneral"- bëri me ashtin e dorës kah Sofia Löhne.

"Shkrepe atë revole të pshurrtë, vetëm dy herë e, ik në punën tënde!"- shpërtheu gjenerali, Herman von Urlih.

Çunaku hebre, nën vellon e Sofisë Löhne, u çjerr deri në kupë të qiellës:

"O zonjë e nderuar, vajza e Aleksit e patë mbi trup vetëm fustanin e mëndafshtë, më të bardhë se shtëllunga e resë së qershorit. Beso o zonjë e lartë se vajza e Aleksit, nën dritën e hënës erdhi shtatit. Thimthat e gjinjve të vajzës së Aleksit u mbufatën. Deshën të dalin jashtë, të freskohen në puhizën e natës me hënë. Deshën të zdërvajen nëpër barin e turpshëm me vesë.

O zonjë, i vdekuri para një ore e bjerrë turpin para zonjës së lartë, të vrarë gjithashtu para një ore. Bëhet i pacipë. Sa të bukur e ke plagën e kuqe mbi vetullën e trembur ballit përpjetë.

O zonjë, prit edhe pak! Kemi kohë të bollshme në vdekjen tonë.

O zonjë e vrarë para një ore, unë, çunaku hebre, i këputur, pika në buzët e vajzës së Aleksit. Dora dritharake më paskësh arritur tek gjinjtë e saj. Të kallurit më zu gjithandej mishit. Vendosa, o zonjë e lartë të vdes duke rënë tëposhtë trupit alabastër të vajzës së Aleksit. Të bija pa shpirt në mishin e saj femëror. U qulla shalash, o zonjë e lartë. Po si të vdiset njeriu i qullur shalash, jashtë vajzës së Aleksit.

Kam ardhë në vete, o zonjë e lartë, kur në dorë e ndjeva ftohtësinë e metalit vrastar. Dikush ma kishte futur revolen në dorën time të kallur në mishin femëror të vajzës së Aleksit. E kam shikuar ngulmërisht vajzën e Aleksit. Ajo paskesh qenë e

shtrirë në barin e turpshëm të vesës së natës qershore. E vdekur si unë, si Ju, me një njollë të bukur mbi vetullën e saj të kërcyer. Të gjithë e kemi një plagë sot këtu në Sarajevë."

"O çifut, ti e dhunove vajzën më të ndershme në Sarajevë. E dhunove vajzën e Aleksit-burrit më të ndershëm në tërë qytetin!"- u çjerr gjenerali, Herman von Urlih.

Vdekja u lamtumir me vdekjen. Gavrillo Principi e lëshoi vellon mbi fytyrën e Sofi Löhnes. Pa hezitim iu drejtua gjeneralit, Herman von Urlih.

"I keni marrë fjalët e huaja o gjeneral austriak. Këto fjalë m'i tha, së pari, gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi. O gjeneral austriak, si mendoni ju gjeneralët se do të ketë tri vdekje hebreje, në të njëjtën kohë, në të njëjtin hebre, për gjeneralin austriak, për gjeneralin rus dhe për Sërbinë?"- iu drejtua çunaku çifut gjeneralit austriak, Herman von Urlih.

"Shkrepe atë revole më, o çifut. Vetëm dy herë shkrepe në njeriun e vdekur para katër ditësh. Vrasësi i vërtetë është këllasur në varr diku në Vjenë"- i skërmiti fjalët gjenerali austriak.

"Po si e vret i vdekuri të vdekurin. Mua - Gavrillo Principin, një orë më parë më kanë vrarë në bodrumin e guvernatorit të Sarajevës - Bergman von Lyhe"- i foli gjener- alit çunaku hebre.

"Vetëm zbrazi ata dy fishekë të rrejshëm. E rëndësishme është të ndjehet krisma. Pastaj mund t'i hysh vdekjes sate qe nga fillimi"- gati e përbuzi vdekjen e Gavrillo Principit gjenerali.

"Si mendon Evrorusia ta nisë luftën në këtë botë me dy krisma të rrejshme të çifutit të vdekur në Sarajevë? Ju gaboni, zoti gjeneral, sot, kur Rabi Jochanan ben Sakai ra në Mitrën e Rebekes së Alamekut e, nxënësit e tij të Sanhredinit po e mbëltojnë universitetin hebre në Diasporë"- i vezulluan sytë, përtej vdekjes çunakut hebre- Gavrillo Principit.

Dy krisma revolesh erdhën nga larg.

Velloja e Sofisë Löhne u dridh paksa.

"Me kaq krisma të hebrenjve do ta filloni një luftë botërore? Si fillohet një luftë kontinentale në vagjinën e vajzës së Aleksit, në vetullën e trembur të gruas së bukur, të Sofisë Lohne, vetëm një natë pas dashurisë në të?"- e pyeti gjeneralin çunaku hebre.

"Po, ti ke pranuar se e vrave Arçidukën e Austrisë, Franc Ferdinandin"- e ironizoi njeriun e vdekur gjenerali Herman von Urlih.

"Paskam pranuar gjithçka më kanë mëtuar hetuesit e shërbimit Informativ?"- ia ktheu me po aq ironi Gavrillo Principi.

Gjenerali, Herman von Urlih u rrëmbye brenda uniformës ushtarake. Përgjigjet e çunakut çifut e tunduan sedrën e tij prej ushtaraku. E kujtoi me mburrje bisedën në kopshtin botanik të kështjellës "Summer of ", derisa po e shtrëngonte në parzmën e vet Sofi Löhnen.

"Sa ngulmues këta çifutet e mallkuar. Me atë penisin e tyre rrjepacak, prej akrepi, e ngulin spermën- farmak në mitrat e ndotura të grave të tyre. Ua ka mbëltuar në mendje ai Rabi Jochanan ben Sakai atëfarë orgazmën protestuese, sfiduese ndaj gjakut të pastër aristokrat"- ankoi gjenerali para Sofisë Löhne.

Gjenerali, Herman von Urlih kishte lexuar se nëpër qarqet e larta evropiane kishte filluar të flitet për sfidën e orgazmës. Ky Rabi Jochanan ben Sakai përveç kodit të vet çifut dashka t'i përziejë të tri pjellat e zotit. Me këtë përzierje pjellash ky Rabi synon ta thejë kodin e fortë të shtetit monarkik europlatonian.

Sofi Löhne duke e kuptuar dykuptimësinë e fjalëve të gjeneralit, Herman von Urlih, meqë ajo vet ishte e privuar nga gjaku mbretëror, u detyrua t'i përgjigjet gjeneralit, po aq dykuptimisht, pa ia shqitur sytë.

"Zoti gjeneral, paskeni vendosur ta viktimizoni një hebre në altarin e shtetit për ta filluar një luftë antisemite botërore. Eshtë

tepër vonë ta beni këtë luftë. Jezusi i Indigjenes Iroki të Massachusettsit po zbarkon në Siçili. Kot e flijuat atë hebreun e hajthem në Sarajevë. Kot, krejt kot e flijuat Arçidukën tok me të shoqen”- ajo i foli gjeneralit me një shikim të përzier me mllef e përgjërim që mund ta ketë vetëm orgazma.

Mbase Sofi Löhne e ndju flijimin e vet në altarin politik të shtetit austriak dhe i tha vetvetes së vet:

“Mos u zbulova për së tepërmi para këtij gjenerali antisemit?”-

Sofi Löhne, e shtrënguar në parzmën e gjeneralit ia tundoi mishin mashkullor deri tek lektisja e tij.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, u çjerr deri në qiell tek kështjella “Summer of ” e Vjenës:

“Do ta kisha dhënë krejt botën vetëm për një Orgazëm deri tek Mitra e kësaj gruaje”- duke rënë në mishin femëror të Sofisë Löhne.

Të dy testiset, gjeneralit,Herman von Urlih, i pelcitën mijëra copash me vrullin e dështimit të vezëve të pjekura në prushin e gjallë të mishit femëror të Sofisë Löhne. Mes shalave iu bë një gropëz e zezë bombardimi.

Gjenerali austriak Herman von Urlih qenkesh mashtrue.

29.

Laboratori i OSCE-së në Le të Shqipërisë së Albanikut sovjetik i kishte ndezur të gjitha dritat kur brenda hyri gjenerali austriak Herman Von Urlihu. Ai pa mbi poltronin e mbështjellë me pëlhurë të bardhë, të shtrirë një çupë-grua të lakuriqur, midis lojës fëmijërore dhe epshit të gruas.

I gjithë stafi i mjekëve po e përcillte seancën e ujkut të dehur. Ujku Volfgang i molisur e kullufiste lëngun e kuq rrjedhës nëpër barkun e saj. E lëpinte me babëzi teposhtë pubsit të asaj çupëgruaje.

Prova po i afrohej fundit. Ujku Volfgang ngeci midis kërthizës dhe pubisit të çupëgruas.

Gjenerali, Herman von Urlih e pyeti mjekun Gryber Sontagun.

"Në mos kjo çupëgrua është ajo Kësulëkuqja Juaj?"

"Po, pikërisht ajo është".

"Ç'doni të nxjerrni nga ajo?"

"Shumë gjëra, zoti gjeneral. Pas katër orësh këtë ekstrakt të përrallës së testuar do ta nxjerrim para opinionit në Evropë nëpërmes injeksionit. Do ta sfidojmë Orgazmën ekologjike të

Indigjenes Iroki-Pocahontas Powhatan të Massachusettsit”- u përgjigj koloneli-mjek, Gryber Sontag.

“Ç’i duhet Indigjenes Iroki të Massachusettsit ujku Volfgang i Këselëkuqes”.

“Na duhet neve zoti gjeneral. Do t’i provojmë të gjitha për ta kontaminuar atë orgazëm të Indigjenes Iroki. Edhe këtë ujkun Volfgang” - u përgjigj koloneli Gryber.

“Jemi përpjekur ta kontrabandojmë me mjaft diplomaci si përrallë fëmijësh këtë ujkun Volfgang në orgazmën ekologjike të Indigjenes Iroki të Massachusetsit. Ujku Volfgang e as çupëgruaja Kësulëkuqe kurrsesi të rrinë qetë brenda orgazmës së panjohur. Në përrallë është mëshehur propaganda.

Kësaj çupe, gjithmonë para kohe, ky ujku Volfgang ia zgjon menstruacionet deri tek përgojimet se kjo çupëgrua e paskesh bërë një lindje fëmije jashtë mitrës”- i foli mjeku anglez Lipman Smith.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, u rrek ta vërtitë në mendje se ku do të dalë kjo punë.

Duke e parë se gjenerali Herman von Urlih po e vriste mendjen kot, koloneli Gryber e ndjeu për detyrë t’ia shpjegojë.

“Kur ujku i përrallës Volfgang ta arrijë zgjimin e menstruacioneve aguridhe në ketë çupëgrua, do të merret mostra e këtij menstruacioni bastard nën emërtimin shkencor “Sanguis lacertae”. Ky solucion i përrallës Volfgang do të bëhet agensi më efektiv kundër orgazmës së Indigjenes Iroki të Massachusettsit”- shpjegoi mjeku.

“Edhe fëmijëet dhe ujqit do t’i fusni në këtë lojë? Ju mendoni,sonte për një natë,ta bëni gjithë këtë punë?”-e pyeti gjenerali austriak.

“Në mos sonte atëherë përfundimisht do të fitojë ai Jezusi primitiv i Indigjenes Iroki të Massachusettsit, apo, siç e quan ajo- Jezusi ekologjik”- u përgjigj koloneli Gryber Sontag.

Gjenerali, Herman von Urlih e kishte lexuar në pergamena se ç'rrezik po i qasej Evropës. Kishte lexuar edhe mbi eksperimentet me miushët në laboratorin e OSCE-së. Kishte lexuar edhe mbi përpjekjet regetuese të rusit Makushev nëpër mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit.

"Po pse pikërisht sonte të gjitha këto eksperimente dëshpëruese?"- sikur e pyeti vetveten gjenerali, Herman von Urlih.

"Për shumë arsye miku im"- i tha koloneli Gryber. -"Sonte, pikërisht sonte hebreu, Rabi Jochanan ben Sakai, tek klinika "Gemeli" e Romës do të shartohet në Mitrën e Rebekes së Alamekut. Do të shpëtojë nga mitra e kones së Danielit, Do të shpëtojë përgjithmonë kodi hebre. Këtë punë, po arrijtën me kohë mjekët e konsiliumit amerikan nga Siçilia, do ta bëjnë ata vetë. Po e bënë mjekët evropianë, në mitrën e Rebekes së Alamekut do të shtjejnë gjak menstruacionesh aguridheje të kësaj çupëgruaje me emër shkencor "Sanguis lacertae"- koloneli Gryber iu bë se mjaft kishte shpjeguar.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, e ndjeu ngutinë e natës së ethëshme të Evropës. Nëpër pergamena le të shkruajë gjithçka por gjenerali qysh nga viti njëmijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë po llogoronte në afërsi të Jakovës së Jerusalemit duke i pritur rezultatet e klinikës "Mercoledi" të Vjenës. Kaq vite logorimi këtu pranë Jakovës së Jerusalemit po i bëheshin duke pritur midis animes dhe animusit; midis Orgazmës dhe Atiorgazmës, midis gropës së zezë të varrit dhe gropës së zezë të vagjinës.

Kurrkund as zog as korb nga Vjena, këtu e tetëdhjetë e pesë vjet.

"Sonte, miku im, vetëm sonte, duhet të vritet kodi hebre mu në mitrën e Rebekes së Alamekut"- i foli koloneli Gryber. -"Sonte, miku im, pikërisht sonte, duhet të vritet qysh në mitër Jezusi ekologjik i asaj Indigjenes Iroki të Massachusettsit"- vazhdoi koloneli Gryber.

“Pikërisht sonte, gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, me metodën e muzhikëve duke e futur dorën deri në mitër do ta zbulojë fetusin e Rektorit të Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldikut. Do ta vrasë kodin e tij me “Sanguis lacertae”…”- u foli: qiellit të skuqur prej metali të Jakovës së Jerusalemit, menstruacioneve aguridhe të Kësulëkuqës, Jezusit qonquistador …

Sonte duhet të ndodhë vrasja e kodeve.

30.

"Gjeneral i lavdishëm, pasi nëna ime u kthye serish në Vjenë nga Sarajeva, a morët ndonjë shkresë zyrtare, ç'u bë me Teutën e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik? Ajo u sëmua në hotelin "Onix" të Sarajevës, siç shkruan në pergamenë"-insistoi Sofia sikur deshi ta pyesë gjeneralin austriak, Herman von Urlih.

Ai ende po i ndjente dhimbjet e testiseve të pelcitura në zjarrin e gjallë të Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës, Franc Ferdinandit atë natë në kështjellën "Summer of"të Vjenës.

Gjenerali heshti për një çast, i athët në fytyrë nga dhimbjet e testiseve.

Sofia e Haçet Deletës e ndjeu në mishin e vet dhimbjen e mishit mashkullor kur pëlcasin testiset në prushin e gjallë të mishit femëror, kur sperma mashkullore vritet para vagjinës e bie e vdekur nëpër vegët e gruas së re.

Insistimi haverda i Sofisë së Haçet Deletës e çoi gjeneralin atje në Sarajevë tek po vritej ajo Sofia tjetër, e shoqja e Arçidukës. E pa atë hebreun e hajthëm me revole në dorë duke iu përgjerua asaj Sofisë tjetër me plagën mbi vetullën e saj të trembur. Fytyrën e Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës, Franc

Ferdinandit, gjenerali e pa të trishtuar. Nën maskën e trashë të pudrës e pa trishtimin biblik të gruas së dëbuar nga Orgazma. Trishtimi i teptisur i plagës së shkaktuar aq mjeshtrisht mbi vetullën e trembur të saj i pëlciti testiset e Herman von Urlihut, duke ia shkaktuar një gropë të zezë midis shalësh.

"Le ta ndjejnë dhimbjen e tredhjes të gjithë meshkujt hardallë të Biblës qonquistadore të Sant Luisit, pikërisht sonte kur Rabi Jochanan ben Sakai po e shpëton vetveten e kodit të Izraelit duke rënë thellë në mitrën e Rebekes së Alamekut, atje te klinika "Gemeli" e Romës.

Sonte, John Harkeri udhëtoi nëpër Orgazmën, nëpër Dashurinë e Indigjenes Iroki të Massachusettsit për ta shpëtuar Kontinentin nga jezusët qonquistadorë.

Sonte do të hapet varri i Kostantinit të Haçet Deletës së ndryshkur në baladë, do hapet varri i Rektorit të universitetit të Jakovës së Jerusalemit, Redalk San Heldikut"-zë i zvargur nga larg i erdhi gjeneralit Urlih.

"Mos foli Sofia e Haçet Deletës?"-mendoi gjenerali.

"Jo!Ishte dikush tjetër. Ishte zë tjetër nga zëri i saj"-iu përgjigj vetvetes së vet gjenerali Urlih

"Athua ku do të dalë?"

31.

"Zonjë e nderuar, helikopteri po na pret.Do të nisemi menjëherë. E vetmja mundësi për të raportuar pas katër orësh në Këshillin e Lartë të NATO-s mbetet hapja e varrit të Kostantinit të Haçet Deletës"- i kumtoi gjenerali Herman von Urlih.

Sofia e Haçet Deletes heshti paksa. Edhe pse, pa ia thënë zyrtarisht, ajo tashmë ishte e arrestuar.

Gjenerali, pasi priti sipas rregullës, e vazhdoi paksa përngutshëm:

"Nëpërmes postës elektronike na lajmëruan se gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi na dha lejen të fluturojmë përtej kufirit të Jakovës së Jerusalemit,në Shqipërinë e Albanikut sovjetik".

Sofia e Haçet Deletës serish heshti rreth kumtit të gjeneralit. Ajo e dinte se ishte në zgripc të mundësisë për të marrë vesh edhe diç për Nënën e vet- Teutën e Haçet Deletës. Andaj provoi, ashtu përngutshëm të pyesë edhe diç.

"Zoti gjeneral, Ju keni pasur marrëdhënie intime me Sofinë Lohne, të shoqen e Arçidukës. A Ju ka folë ndonjëherë për miken e saj? Të nesërmen ajo grua u zhduk. Disa pergamena thonë se u kthye në Vjenë A ju kanë informua më se ç'u bë mëtutje me atë grua?"- e pyeti Sofia.

“Jo zonjë e nderuar”- u përgjigj mërzitshëm gjenerali. -“Në orën katër të mëngjesit më njoftuan se Teutën e Haçet Deletës e paskeshin rrokë dhimbje të padurueshme fundit të barkut. Ende pa arritur në dhomën e saj të hotelit “Onix” ia dëgjova gjëmat nga prerja e dhimbjeve.

Një mjeke e, e hutuar, në derë të dhomës, më njohu sipas gradës ushtarake. Më foli gjermanisht.

“Dhimbjet e kësaj mbretëreshe dhe Diagnoza e Klinikës “Mercoledi” të Vjenës hapërojnë larg njëra-tjetrës. Ajo diagnoza e hiqtë nga Vjena është misterioze si edhe vet kjo grua me titull prej mbretëreshe”.

Zonjë e nderuar, mua më habiti të folurit e guximshëm të kësaj mjekeje të zemëruar.

Si për flakë të pushkës, pa asfare mirësjellje, e pyeta doktoreshën e zemëruar:

“Doktoreshë, a keni konstatuar se kjo grua mund të lindë fëmijë?”

“Gjeneral”,- m’u drejtua ajo. -“Të gjitha ato diagnoza misterioze sillen rreth asgjësë politike. Kolegu juaj, gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, ia preferoi doktorit të eskortës së vet, atij Makushevit ta futë dorën deri tek Mitra e Teutës së Haçet Deletës për të konstatuar rreth asaj diagnozës “gravitas”, siç bëjnë me lopët e fermës “Miçurini” atje në Rusi.

Ne e kundërshtuam ketë ndërhyrje kaq primitive, të rrezikshme për shëndetin e saj, deri sa të vinit ju, zoti gjeneral”- përfundoi mjekja gjermane.

“Po unë ç’duhet të ndërmarr në këtë çështje?”- e pyeta atë mjeke.

“Ju gjeneral, sipas gradës ushtarake, pyetni atje në Vjenë, duke ua zbuluar edhe propozimin e gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit.

Nga telefoni i hotelit “Onix” të Sarajevës u lidha me guvernatorin, Bergman von Lyhe, pastaj me ministrin austriak Joakim von Adler. Nga Vjena më rekomanduan të pres paksa.

E kam të paqartë pse ajo mjekja e heshti vizitën e mjekut austriak, Zoltan Petof, i cili e paskesh kontrolluar Teutën e Haçet Deletës”- shpjegoi gjenerali, Herman von Urlih.

Sipas pergamenës së resur nëpër shumë vende, ministri austriak paskesh urdhëruar të kthehet në Vjenë Teuta e Haçet Deletës, e përcjellë nga mjeku Zoltan Petof, me trenin perandorak të orës shtatë.

Teuta e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik, në orën shtatë të mëngjesit, tek platoja e trenit perandorak të Sarajevës ditën e njëzet e tetë të qershorit, e humbi çdo gjurmë nëpër pergamenat misterioze.

As zog as korb më prej saj.

32.

Sofia e Haçet Deletës e kuptoi mirëfilli se këtu e një orë më parë ishte, tashmë, e arrestuar. Gjenerali austriak, të arrestuarën e vet e trajtoi sipas rregullave të husarëve. Dolën nga tenda për tek helikopteri ushtarak. Mesnata kishte zënë fresk. Sofia ndjeu aftim drithërues. Elisa e helikopterit i solli ajër të freskët më tepër se ç'kishte nevojë. Ajo u mësheh prapa gjeneralit për t'i shpëtuar vrushkullit të ajrit. Gjenerali e hapi kapotën ushtarake për ta mbrojtur Sofinë. Ashtu të zënë njeri për tjetrin, të përkulur kaluan nën elisen e helikopterit deri tek shkalla. U gjetën brenda helikopterit paksa të shpuplisur. Sofia i rregulloi flokët me dorë duke i zënë me kapelë. Ata u ulen pranë dritares gati në të njëjtën kohë të shkëputjes nga toka.

Në fillim fluturuan shumë poshtë.

Qenë shtatë vetë nga të dy ekipet. Tre qenë nga ekipi i arkeologëve e katër qenë nga ekipi i mjekëve.

Askush me askend të përshendeten. Helikopteri e bëri një kthesë për ta ruajtur itinerarin ushtarak, sipas marrëveshjes me gjeneralin rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovin. I panë flakët e qytetit të Jakovës së Jerusalemit. Me dylbitë e natës e shikoi urën e Tabakëve të reshur dritash të reflektorëve e të makinave ushtarake.J akova e Jerusalemit po e vjellte mishin e vet gaull drejt urës. Në jug të Jakovës së Jerusalemit dritat e llogorimit ushtarak të gjeneralit roman, Titi, fafurinin para sulmit mbi Jerusalem.

"Ju, zonjë e nderuar, qytetin Tuaj e quani Jakovë e Jerusalemit?" - e pyeti gjenerali duke e parë shikimin e trisht të Sofisë.

"Po, zoti gjeneral, kështu e quajti gjenerali roman, Titi, kur nëpër shtjellën e vrevët të asaj buçimës së vuvët myslimane: "Allah!Allah!" e sulmoi Jerusalemin pa ndaluar deri para këtij qyteti të djegur nga gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi"- u përgjigj paksa misteriozisht Sofia.

"Gjenerali roman, Titi e paska sjellë Jerusalemin në qytetin tuaj krejt gabimisht"- e provokoi gjenerali.

"Jo zotëri. Gjenerali roman, Titi, e sulmoi Jerusalemin nëpër atë shtjellë mjegullnajë të zbritur nga shkretëtira buçitëse e Sinajit:"Allah! Allah!"- shpjegoi Sofia duke e pasur të qartë se gjenerali Herman von Urlih e dinte më mirë se vetë ajo.

Siç mendoi edhe i doli. Gjenerali e pyeti me shemër të qartë ndaj gjeneralit roman Titi.

"Cilët hynë më parë në Jerusalem? Ishin ata myslimanët, shtjellë e vrevët nga shkretëtira e Sinajit apo romanet e gjeneralit të lavdishëm, Titi?"- e pyeti gjenerali austriak me fodullëk.

Sofia e pa fudullëkun krekosës të një gjenerali të ngujuar këtu e tetëdhjetë e pesë vjet pesëmbëdhjetë kilometra larg Jakovës së Jerusalemit duke e pritur një analizë laboratorike të klinikës "Mercoledi" të Vjenës.

“Gjeneral i nderuar, edhe gjenerali roman, Titi, edhe myslimanët- shtjellë e vrevët nga shkretëtira e Sinajit, të zënë amokut të luftës, e huqen Jerusalemin pa e ndalë furinë deri tek qyteti im i Jakovës. Flaka e qytetit tim, e shkaktuar nga gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit,i bindi,secilin nga ta: romanët e gjeneralit Titi,dhe myslimanët e shtjellës së shkretëtirës se ushtritë e tyre e paskeshin kallë Jerusalemin.

Sonte nga lartësia e qiellës e keni rastin t’i veneroni të katër ushtritë e ngulitura në të katër anët e Jakovës sime të Jerusalemit: ushtrinë romane të gjeneralit, Titi, në lindje;ushtrinë e gjeneralit turk, Jyllmaz Kadirogllu, në jug; ushtrinë e gjeneralit austriak, Herman von Urlih, në perëndim; ushtrinë e gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit në veri.

Të katër këto ushtri e kanë mbajtur të mbyllur në guacë mishin gaull të Jakovës sime të Jerusalemit këtu e njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet.

Të katër këta gjeneralë pas katër orësh, secili në mënyrë të vet, do ta përjetojnë të rënit ndesh me Indigjenen Iroki– Pocahontas Powhatan të Massachusettsit në takimin e këshillit të lartë të paktit Veriatlantik.

Ju gjeneral, të gjitha këto i keni lexuar në pergamenat Tuaja sekrete po, edhe në shtypin publik”- e sëmboi Sofia e Haçet Deletës gjeneralin austriak, Herman von Urlih.

“A ju propozoi diç gjenerali roman, Titi?”- e ndërroi kuvendin gjenerali.

“Po! Më propozoi të udhëtoj, sonte, me avionin e orës dy për në klinikën“Gemeli”të Romës. Atje duhet të gjendem pranë mikes sime, Rebekes së Alamekut”- u përgjigj Sofia pa mëshehur asgjë meqë tashmë e konsideronte veten të arrestuar.

“Gjenerali roman, Titi, është strateg.Ai,sonte, mbështetet në disa variante të cilat do t’ia kryejnë të tjerët”- dykuptimisht, shumëkuptimisht, i foli gjenerali austriak, Herman von Urlih.

“Po qe e mundur të m’i thoni se në cilat mundësi shpreson sonte, gjenerali roman, Titi”- e pyeti Sofia pa mëtesë për ndonjë përgjigje.

“Gjenerali roman, Titi, e di se sonte do të hapët varri i Kostantinit të Haçet Deletës apo i Rektorit të universitetit të Jakovës së Jerusalemit- Redalk San Heldikut. Eshtrat e njërit prej tyre do të dalin nga ai varr. Gjenerali roman shpreson edhe tek hapja e mitrës së gruas së Jakovës së Jerusalemit sonte në klinikën “Gemeli” të Romës. Pastaj ky gjenerali roman mbështetët shumë në punën e gjeneralit rus,Ivan Vasiljeviq Kutozovit.

Të gjitha variantet i ka depozituar në agjendën e vet prej gjenerali”-ishin fjalët plot smirë te gjeneralit Urlih.

Sofia tashme e kishte të qartë se është e arrestuar. Nëpër pergamenat e shërbimeve informative paskesh qarkulluar informata se Sofia e Haçet Deletes, në tendën e Zatrës Arameje paska rënë në mishin mashkullor të atij ushtarit të arratisur.- Në disa pergamena qenkesh thënë se ai ushtari i arratisur nga ushtria turke paskesh qenë Rektori i universitetit të Jakovës së Jerusalemit- Redalk San Heldiku. Në këtë informatë Sofia ishte e paqartë: ajo sipas urdhrit të Rabi Jochanan ben Sakait, pa e ditur cili është brenda tendës së Zatres Arameje, kishte hyrë brenda, ishte dehur nëpër një amok Orgazme të paparë ndonjëherë. Ajo kishte arritur pa asnjë fjalë deri tek helli mashkullor i ushtarit të arratisur. Kështu e kishte urdhëruar Rabi Jochanan ben Sakai.Bile Rabi,në derë të tendës Arameje i kishte thënë:

“Ruaje kodin e popullit tënd në Mitrën tënde! Shpëtoje kodin e popullit tënd në Mitrën tënde! Aq mish, sa ka mbetur pa u kalbë nga Iliriku yt Dardanik në Jakovën e Jerusalmit, mund të ruhet vetëm në Orgazmën e Shtatëmbëdhjetë minutavetë Jakovës së Jerusalemit. Sonte çelja e Mitrës sate do të bëhet në klinikën “Gemeli” të Romës”.

Helikopteri i gjeneralit austriak, Herman von Urlih e kaptoi kufirin midis Jakovës së Jerusalemit e të Shqipërisë së Alba-

nikut sovjetik sipas itinerarit të caktuar nga gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi.

Në anë tjetër të kufirit u shfaqen dritat e reflektorëve të OSCE-së së dëbuar nga Jakova e Jerusalemit. Gjenerali rus, Kutozovi, i fundit nga gjeneralët evroaziatikë këtu, po rropatej me mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit për ta zbuluar sperrmën e Rektorit të universitetit- Redalk San Heldikut në Mitrën e asaj gruas së penetruar në tendën e Zatres Arameje, sipas sugjerimit-urdhër të Rabi Jochanan ben Sakait.

Sofia u mbush mallëngjim kur e pa kështjellën e të jatit vetëm tetëqind metra brenda kufirit të Shqipërisë së Albanikut sovjetik. Ajo e kishte ndërtuar me gurët e baladave të rrënuara kështjellën e Haçet Deletës. Ishte kështjella e fëmijërisë së saj. Pas nëntë vitesh mallëngjimi po e shihte nga helikopteri kështjellën e fëmijërisë.

33.

Gjenerali Herman von Urlih, jo vetëm e kishte lexuar atë psikanalizën, por edhe e kishte mik Sigmund Frojdin. Sa herë i fliste për Animen dhe Animusin, Herman von Urlihut i merreshin mëndet sikur e kapërcente një urë prej teli mbi një humnerë të erret të paasfare gjinie natyrore.

Ia thoshte Frojdit:

"Ju zotëri, në atë psikanalizën Tuaj e keni zbuluar purgatorin e përhershëm mu para vagjinës së gruas pesë centimetra larg penisit të atij burrit të panjohur i cili e solli në shtëpinë e vet Sofinë e Haçet Deletës së Ilirikut Albanik, të shoqen e Rainhard von Grainhelmit të Tretë, trashëgimtarit të fronit mbretëror të Bohemisë, pas nëntë vitesh mallëngjimi. Ja unë , sonte

me helikopter po e sjell në shtëpinë e prindërve të vet Sofinë e haçet Deletës së Ilirikut të Albanikut sovjetik. Ju, miku im i keni rrënuar edhe Parajsën edhe Ferrin".

Gjenerali Herman von urlih sikur e dëgjoi zërin e Sigmundit të Vjenës, të mikut të vet: "Ti miku im, sonte po e shpie Sofinë e Haçet Deletës gjetiu, jo në shtëpinë e vet. Po e shpie mbi një varr. Po e shpie të qëndrojë mbi varrin e të vëllait, Kostantinit apo mbi varrin e Rektorit të Jakovës së Jerusalemit. Aty mbi atë varr Evropa po e teston vetveten e Psikanalizës sime, miku im. Ti,miku, im sonte atë Sofinë e Haçet Deletës po e locon vetëm pesë centimetra largsi midis penisit dhe vaginës. Po, miku im, në purgator masturbohet në këte hapësirë midis penisit dhe vagjinës pa ua lejuar të takohen ndonjëherë. Purgatori u krijua për zotin Hermafrodit,tek ndalohet seksi, orgazma, Dashuria.Në Parajsë ka dashuri, orgazëm,por jo për njeriun;atje orgazma, u përket vetëm zotave. Në ferr, miku im, orgazma, epshi, penetrimi u takojnë vetëm luciferëve. Njeriut i mbet vetëm Purgatori i Masturbimit midis Animes dhe Animusit"- i tha mikut të vet, gjeneralit Herman von Urlih.

Gjenerali u përpoq ta depërtojë shikimin nëpër vellon tisore të Sofisë së Haçet Deletës. Bile, i cytur nga tundimi i kuvendimit të Sigmund Frojdit, lektisi në mënyrë të veçantë. Ai deshi ta shohë se me kënd po fluturonte drejt atij varri hermafrodit të Kostantinit të Haçet Deletës apo varrit të Rektorit të Jakovës së Jerusalemit- Redalk San Heldikut. Varri do të hapej pas një gjysmë ore. Ajo do të tundohej nga ADN-ja e vëllait apo nga ADN-ja e Rektorit, Redalk San Heldikut. Sonte, siç po e thonë të gjitha gazetat, kjo grua mund të dalë nga rruga e purgatorit seksual, nga rruga midis Animës dhe Animusit.Edhe pse gazetat shkruanin hezitueshëm,vende-vende shkruanin kuturu se Sofia e Haçet Deletës e paskësh futur penisin e Rektorit Redalk San Heldikut në mishin e vet femëror prej vagjineje. Cili mund ta dijë nëse Sofia e Haçet Deletës mund ta ketë arritur orgaz-

mën në tendën e Zatres Arameje? Ajo mund të ketë masturbuar edhe me penisin e Rektorit, Redalk San Heldikut. E pamundur. Nuk mund të ketë mbetur në Masturbimin e purgatorit të Animës dhe Animusit. Jo! Kjo e shpjegon se arketipi ekologjik i mishit gaull të Jakovës së Jerusalemit do të shpëtojë sipas AD-N-së së rektorit Redalk san Heldikut. Do të flasë varri mbi të cilin do të qëndrojë Sofia e Haçet Deletës.

Haçet Deleta, i jati i Sofisë paskesh mbetur masturbuesi më i madh në Evropë, jashtë të gjitha religjioneve, jashtë varrit. Në purgator mungon varri. Në masturbim mungon Orgazma. Mbi varr dikush qanë për dikend; njihen i gjalli me të vdekurin. Në Orgazmë ngjizën të dy;njeriu e njeh njeriun.

Kujt i duhet kjo sonte, pikërisht sonte? Evropës jo. Asaj i duhet t'i mojhë zotat e argjilltë, filozofët e fishkur në masturbimet tyre filozofike për fenë, për atdheun, për traditat, për origjinën... Përse frikësohet Evropa kaq shumë sonte? Ka të drejtë të frikësohet: sonte Pocahontas Powhatan, Indigjenia Iroki e Massachusettsit, po e sjell me avion ushtarak Megaorgazmën e Shtatëmbëdhjetë minutaveamerikane në Evropë. Ajo indigjene i ka zbuluar: Orgazmën Seksin, Klitoritin, Vagjinën, Penisin, Dashurinë, vetë Njeriun. Evropa i frikësohet këtij njeriu.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih i vuri një gur rrjedhës së mendimit.Do të takohej në laboratorin e OSCE-së me kolonelin Gryber e të tjerë. Atje do t'i tregojnë mbi rezultatet e provave pasi ta kenë hapur varrin e Kostantinit të Haçet Deletës apo të Redalk San Heldikut.

"Po cili do të tregojë më shumë?"- u rrokullis në vetveten e vet gjenerali Herman von Urlih.

Në pergamenën zyrtare e kishte lexuar se pasi Sofia e Haçet Deletes u arratis me Mefiston nga teatri i Berlinit, zbritën deri në Galile. Së pari e takuan Jakobin e urtë, të birin e Benjaminit. Jakobi i urtë, i biri i Benjaminit i paskesh thënë Sofisë së Haçet Deletës, panjëpady, të mos i besojë asaj baladës beronjë mbi

vëllain e çpifur-atë Kostantinin e Haçet Deletës. Sofia e paskesh shikuar me inat Jakobin e urtë. Ai qenkesh bërë i painteresuar për inatin e Sofisë së Haçet Deletës. Si pa të keq vazhdoi t'i tregojë për herë të parë mbi Rabi Jochanan ben Sakain. Ai Rabi qenkesh arratisur nga Jerusalemi duke mohuar gjithçka të Knesetit të Madh të Izraelit. Rabi Jochanan ben Sakai paskesh filluar moti të mos i besojë asaj broçkullës së ndërkyer të fitores së Davidit xhuxh mbi Goliatin katalla. Këtë fitore të Davidit, me një goditje të vetme guri në ballin e Goliatit Rabi e quajti broçkull budallaqe të derdhur në bronz.

Duke dalë nëpër derën nëntokësore të Jerusalemit, Jakobi i urtë e luti Rabi Jochanan ben Sakain, edhe një herë, të mos e tradhtojë Izraelin.

Rabi Jochanan ben Sakai, përngutshëm duke u arratisur nga Jerusalemi i paskesh thënë Jakobit të urtë:

"Miku im,Trimëria, heroizma, inati, besimi në hoben e Davidit, pasi të ketë vdekur Izraeli, do të derdhen në bronz nëpër sheshet evropiane.

Këtë Izrael të shkrirë në bronz e lektisë Evropa.

Miku im Jakob, VETEM MITRA E GRUAS SË RE E SHPETON KODIN E POPULLIT TËND NGA GABIMI I HEROIZMES VETVRASËS".

"A keni ju austriakët balada?"- trembshëm Sofia e pyeti gjeneralin.

"Ne, austriakët të gjitha baladat i kemi derdhë në metal"- u përgjigj gjenerali austriak.

"Përse jeni ngutur t'i derdhni në bronz baladat Tuaja?"- aktroi Sofia.

"Nga ngërthesa e bronzit të ftohur, bëhet e pamundshme arratisja e ndonjë kokëkrisuri"- aludoi gjenerali.

Sofia e kuptoi aludimin e gjeneralit. E ndjeu në vete se duhej heshtur. Ajo tashme ishte e arrestuar. Përpara vetes e kishte një paqartësi me plot të papritura. Gjenerali e kishte njoftuar se

do të hapej varri i Kostantinit të Haçet Deletës së Ilirikut të Albanikut sovjetik. Po të mos zbulohej asnjë shenjë nga Kostantini do të kalohej tek eshtrat e Rektorit të universitetit të Jakovës së Jerusalemit- Redalk San Heldikut. Pastaj do të kalohej në çeljen e Mitrës së gruas së re.

U frikësua. Shpejtësia po bëhej marramendëse: do të hapej varri i Kostantinit apo i Rektorit, baladat e Evropës u shkrinë në bronz kallkan. . . diç e madhe po ngjanë sonte.

Ajo qe e arrestuar.

Sofia ra në heshtjen mëtuese të gruas së re. Mbase sëmbimi i kësaj heshtjeje gjeneralin e hodhi në amokun e aromës së gruas atje në kështjellën"Summer of"të Vjenës. E rroku dëshirë e papërmbajtur për ta parë atë vetull të kërcyer ballit përpjetë të Sofisë Lohne pa atë vrimën e shkaktuar në ballin e saj.

Athua e tradhtoi gjenerali austriak vetullën e trembur nga plaga e hijshme në ballin e Sofisë Löhne,të shoqes së Franc Ferdinandit? Atje në Sarajevë, paskesh ndodhë diç tronditëse.

Kurrsesi t'i epej gjasa gjeneralit t'ia ngrisë vellon Sofisë së Haçet Deletës për ta parë atë vetull të trembur ballit përpjetë. Por me cilën: me plagën e bukur mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne të Vjenës austriake- të Sofisë Löhne të kështjellës "Summer of " apo, me vetullën e trembur ballit përpjetë të Sofisë së Haçet Deletës- Masturbuesit më të shquar në Evropë?

Gjenerali po vraponte amokut midis këtyre dy Sofive. Sofinë Löhne, atje në Sarajevë e kishte derdhë në bronzin e kallkanosur tok me plagën e bukur mbi vetullën e kërcyer. Ashtu vetullkërcyer, e ngërthyer në shtatin e bronztë do të vendoset në "Parkplas" të Vjenës, para kështjellës "Summer of ".

"Në shikimin e Sofisë Löhne bronzi po shkrihej. Plaga e bukur mbi vetullën e trembur po kullon gjak.Ogur i keq"- u tremb gjenerali, Herman von Urlih.

I mbeti peng qortimi i dhimbshëm, i teptisur mbi pudrën e bollshme, të Sofisë Löhne.

Sa i flashkët mishi i saj femëror kur e mbajti në krahët e tij atë natë vallëzimi te kopshti botanik i kështjellës "Summer of", e qortoi mishi mashkullor i testiseve të pëlcitura në prushin e gjallë të Sofisë Löhne.

E ndjeu dhimbjen e plagës- gropë midis shalave duke dalë nga amoku. Duke u kthye nga turri i amokut, gjenerali ndjeu dhimbje për Sofinë e Haçet Deletës.

Kjo grua e re paskesh lexuar nëpër pergamena të turbullta, të resura në shumë vende, mbi disa diagnoza të gjymta të nënës së saj, të sofistikuara për t'i mashtruar të gjithë e, në veçanti Sofinë e Haçet Deletës. Nëpër këto pergamena shfaqen të resura diagnozat e klinikave: "Gemeli" të Romës dhe "Mercoledi" të Vjenës mbi gjendjen shëndetësore të asaj Teutës- fantazmë të Haçet Deletës, masturbuesit më të shquar të Evropës. Në këto diagnoza epet kumti nga bota tjetër:"Sanguis lacertae" ose "Gravitas..."

Sofia ka zënë mish të keq nga ajo baladë.Atje thuhet e paskesh pasur një vëlla të lindur në Vjenë ditën e njëzet e tetë të nëntorit shianik të vitit njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë.

Tetëmbëdhjetë muaj pas kësaj ditëlindjeje të Kostantinit- fantazmë të Haçet Deletës-masturbuesit më të shquar në Evropë, gjenerali, Herman von Urlih paskësh udhëtuar prej Vjenës deri në Sarajevë, tok në një kupe të trenit perandorak, me Sofinë Löhne, me Arçidukën Franc Ferdinandin po, edhe me gruan enigmatike, për të cilën thuhet se paskesh qenë Teuta e Ilirikut Albanik. Pastaj pergamenat janë shkarravitur në një mijë mënyra se ajo grua enigmatike paskesh qenë enigmatikja më e shquar në Evropë.

Në orën katër të natës tek dhoma me numër shtatë e hotelit "Onix" të Sarajevës, Teutën e Haçet Deletës e zunë dhimbje të

padurueshme fundit të barkut. I sollën shumë mjekë për ta kontrolluar.Të gjithë bërbëlitën midis tyre si të vrarë ore nga ato diagnoza ogure,kumtesh nga botë tjetër e pergamenave memece. Të gjithë, njësoj thanë asgjë.

Mjeku i gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit- ai mjeku me namë ushtarake, Makushev,deshi ta provojë metodën e muzhikëve rusë:ta fusë dorën në vagjinën e Teutës së Haçet Deletës,deri tek mitra e saj. Pasi ia ndaluan këtë provë,doktori Makushev e shikoi gjeneralin Kutozov. Në shikimin e gjeneralit vetëtoi. Doktori vonoi paksa me shikim të rrëzuar përdhe. U bë heshtje në barkun e gruas misterioze, të quajtur nëpër pergamena, Teuta e Haçet Deletës, masturbuesit më të madh në Evropë.

U bë heshtje në barkun e Teutës.

Kurrëmë as zog as korb nga barku i saj.

Mbase sonte do të flasë varri i djalit të saj.

"Gjeneral i nderuar ju thatë, pak më parë se e ndaluat doktorin rus ta përdorë atë metodën e muzhikëve rusë me mitrën e Teutës së Haçet Deletës"- e pyeti Sofia, mbase jo në çastin e duhur.

Gjenerali heshti. Qëllimisht e kthei shikimin kah Jakova e Jerusalemit e çeli kuvend.

"Sonte,qershorin e natës së dymbëdhjetë,të fundmen e shekullit njëzet, gjenerali rus,Ivan Vasiljeviq Kutozovi,pa e penguar askush, po e futë dorën e mjekut Makushev deri tek mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit"- sikur foli gjenerali austriak me një prirje hulumtuese përtej mëtesës së Sofisë për të marrë vesh se ç'ndodhi në Sarajevë me Teutën e Haçet Deletës.

Sofia e ndjeu çastin dramatik. Gjenerali kishte vendosur t'i tregojë diçka të madhe apo, Sofia vetëm e parandjeu kumtin.

Sonte gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, me dorën e mjekut Makushev, po lypë diçka tjetër nëpër mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit. Çështjen e Teutës së Haçet Deletës doktori Makushev e ka sosë në Sarajevë.

Sofia në çastin e fundit filloi me mendue ndryshe. Diçka e madhe po lidhej me vetë atë.

Arresti paskesh qenë i përgatitur.

Sofia duhet ta ruajë mitrën e vet.

Në pergamenat e shërbimeve informative paska të dhëna se ai Rabi Jochanan ben Sakai i paska sugjerua Sofisë së Jakovës së Jerusalemit të hyjë në tendën e Zatres Arameje e të plandoset mbi penisin e Rektorit, Redalk San Heldikut.Ai Rabi i paskesh thënë Sofisë:" Ruaje mitrën tënde. Prej sonte në të e ke kodin e popullit tënd".

Sonte, nëpër mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit po lypet vetë ajo, Sofia e Haçet Deletës, po lypet mitra e saj, e mbrujtur me spermën e Rektorit, Redalk San Heldikut.

"Atëherë, cilin varr po e lypka ky gjeneral-kukudh i Austrisë, ky ngordhalaq i dergjur në llucë duke e ruajtur si qeni kalin këtu e tetëdhjetë e pesë vjet Jakovën e Jerusalemit"- mezi i tha vetvetes së vetë Sofia duke zbritur nga helikopteri.

Nata e dymbëdhjetët e qershorit të fundit të shekullit njëzet u bë e freskët në Shqipërinë e Albanikut sovjetik. Makinat e OSCE-së,të dëbuara nga Jakova e Jerusalemit ndaluan afër helikopterit, më afër se ç'lejojnë normat. I gjithë ekipi i mjekëve dhe i arkeologëve, tok me gjeneralin dhe Sofinë u futen nëpër makina. Pas dhjetë minutash u gjenden para laboratorit të improvizuar të OSCE-së në fshatin Le të Shqipërisë së Albanikut sovjetik.

Koloneli Gryber Sontag i priti para tendës së laboratorit.

Në fund të përshëndetjes së shkurtër ushtarake, koloneli iu drejtua gjeneralit, Herman von Urlihut.

"Zoti gjeneral, koha është tepër e shkurtër. Menjëherë do të fillojmë nga puna. Ne e kemi piketuar vendvarrin e Kostantinit të Haçet Deletës por edhe mund të jemi mashtruar"- i foli provokueshëm koloneli Gryber.

“Çfarë varri të pshurrt të Kostantinit të Haçet Deletës! Bjeri shkurt! A keni piketuar varrin e atij Rektorit, Redalk San Heldikut. Ose do ta gjejmë, sonte, ne, këtu në varr ose do ta gjejë gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi në njërën nga mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit. Njëra dysh do të bëhet. Atij gjeneralit rus i konvenon të çelë sa më shumë mitra të mishit gaull të grave të Jakovës së Jerusalemit.

Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi e përdor metodën e muzhikëve rusë duke e futur dorën deri tek mitrat e grave. Është tepër vonë. I duhen vetëm edhe dy orë asaj Indigjenes Iroki të Massachusettsit t’ia çatisë në Jakovën e Jerusalemit. Vetëm një gabim yni e për dy orë behët e pamundur metoda “Sanguis lacertae in Utero”- gati u ngulfat në fjalët e veta gjenerali austriak, Herman von Urlih.

“Ju, zoti gjeneral, keni vendosur ta veni në punë metodën provokuese të Frojdit midis Animes dhe Animusit. Me çdo kusht doni ta testoni Sofinë e Haçet Deletës duke e vendosur mbi atë varr për të parë se si do të reagojë. Në këtë mënyrë mund të shkaktoni hutesë të ADN-së. A e ka të qartë ai miku Juaj i Psikanalizës se cili do të jetë reagimi i Sofisë së Haçet Deletës mbi varrin e vëllait e cili do të jetë reagimi mbi varrin e dashnorit?”- e pyeti koloneli Gryber Sontag duke e ditur saktësisht se gjenerali Herman von Urlih, përveç tjerash, e kishte mik Sigmund Frojdin.

“Po, për fillim na ka mbetur vetëm kjo metodë. Ajo metoda e muzhikut rus, e doktor Makushevit të gjeneralit Ivan Vasiljeviq Kutozovit, më tepër synon t’i shkatërrojë mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit se ç’mund të zbulojë diç lidhur me Rektorin, Redalk San Heldikun. Në Mitrën e asaj gruas së rënë në penisin e Rektorit fetusi është aq i vogël sa vështirë ta dallojë doktori i metodës së muzhikëve rusë me atë dorën e tij trashanike”-serish me ngulm foli gjenerali austriak,Herman von Urlih.

“Nese ne, sonte, i zbulojmë eshtrat e Rektorit të universitetit të Jakovës së Jerusalemit,çfarë do të jetë rezultati i mëtutjem?”- e pyeti koloneli Gryber sikur të mos e dinte se përse qe vendosur laboratori provizor i OSCE-së në vendin Le të Shqipërisë së Albanikut sovjetik, vetëm tetëqind metra përtej pikës kufitare të Qafëprushit.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, e përbuzi me një heshtje të kuptimt atë kolonelin Gryber duke ua hedhur shikimin përbuzës,mjekut anglez, gjeneralit Xhanatan Sheltonit dhe doktoreshës Helen Holms. Ata të dy, po edhe mjeku Gryber Sontag e panë përbuzjen e rendë të gjeneralit Herman von Urlih ndaj aktrimit trashanik të kolonelit Gryber.

Gjenerali Urlih heshti aq ngulmueshëm, aq dëbueshëm, derisa veçan gjenerali anglez, Xhanatan Shelton, vendosi ta përmirësojë gabimin e kolonelit Grybër.

“Gjeneral i nderuar, informatat e shërbimeve informative kanë ardhë duke u përmirësuar. Sipas pergamenave të vjetra, ç’punë na bën neve sonte po qe se i zbuluam eshtrat e atij farë Kostantinit të Haçet Deletës.

Fëmijët e kolhozeve ruse të këtij farë Haçet Deletës, masturbuesit të Ilirikut Albanik janë shndërruar në skelete.Ato skelete do t’i gjesh kudo mbi varre nëpër tërë Ilirikun Albanik, por sa pare bën kjo. Të gjithë kanë dalë nga vërret individuale në varrin kolektiv të Shqipërisë së Albanikut sovjetik.

Ne po i kërkojmë eshtrat e Redalk San Heldikut. Ato eshtra sonte na duhen, vetëm ato.Nëpërmes këtyre eshtrave sipas metodës më të sofistikuar të ADN-së do të konstatojmë në mënyrë shumë intelegjente se kush mund të jetë në mitrën e gruas së Jakovës së Jerusalemit. Tek e fundit çështja e diagnozave mbi gjendjen shëndetësore të asaj Teutës së Haçet Deletës është vetëm lojë diplomatike.Kujt i interesojnë sonte në Evropë diagnozat e kësaj Teute? kujt i interesojnë shtetasit e kolkozeve ruse të Ilirikut Albanik? Kujt i iteresojnë banorët skeletorë të

Shqipërisë Albanike? Ata e kanë sosë mishin e vet. Ata kanë rënë jashtë çdo metode të hulumtimit të ADN-së. Këtë rrenim gjenetik e di shumë mirë ajo Indigjenia Iroki e Massachusettsit. Pa pikë brenge të jeni miku im se ajo indigjenia Iroki e Massachusettsit mund të investojë diç nga Orgazma e saj ekologjike në këtë Shqipërinë Albanike të kolkozeve ruse.

Sonte u bë sekret publik se ne edhe rusët po e gjurmojmë me të gjitha metodat fetusin e Redalk san Heldikut, rektorit të Jakovës së Jerusalemit. Pikërisht për atë fetus po ia çatisë sonte në kontinent Indigjenia Pocahontas e Massachus- settesit. Ai është fetus i Orgazmës. Kjo Orgazëm e Redalk san Heldikut, e sugjeruar nga ai hebreu Rabi Jochanan ben Sakai, e bën njeriun ta njohë njeriun. Bën të harrohen zotat e kontinentit tonë, traditat tona, religjionet tona, shtetet tona, gjithçka e kontinentit tonë."-gjenerali anglez,Xhanatan Shelton, e përmirësoi gabimin e lazdruar të kolonelit Gryber duke i treguar austriakut Urlih se ishte ne rrjedhën e ngjarjeve marramendese.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih e zbuti shikimin qortues.

Kryemjekja e laboratorit të OSCE-së Helen Holms e mori guximin ta pyesë gjeneralin austriak:

"Zoti gjeneral derisa të fillojë testimi i metodës së Frojdit ku do të qëndrojë zonja, Sofi e Jakovës së Jerusalemit? Po ta vendosim në makinën e ambulancës mbase ajo zonjë do të dyshojë"- foli me një zë shumë skofiar për atë ambient.

"Po qe e mundur, doktoreshë, le të qëndrojë po në atë makinë me të cilën erdhëm nga vendzbritja e helikopterit"-iu drejtua gjenerali me mirësjellje.

"Po të qëndrojë brenda asaj makine për kohë më të gjatë, mbase do t'i shkojë mendja tek arresti. E kjo zotëri do të ndikojë në hormonet e saj. Në këtë mënyrë testimi do të dështojë"- e plotësoi kryemjekja e laboratorit.

“Atëherë, zonja doktoreshë, vendoseni në një ambient paksa më intim, po qe se e patet brenda laboratorit”- e luti gjenerali duke i rënë në të inteligjencës së doktoreshës.

Duhej pritur një gjysmë ore derisa të fillojë testimi. Mbi tokën, ku mendohej të jetë varri i Rektorit, Redalk san Heldikut e, sipas pergamenave të falsifikuara flitej përqartë edhe për varrin e Kostantinit të Haçet Deletës në të njejtin vend, duhej derdhur një solucion hormonesh. Solucioni do të depërtojë deri tek eshtrat brenda varrit.

Dhe vetëm atëherë kur solucioni hormonal do të kontaktojë me eshtrat e varrit, kumti do të bëhet i qartë.Kur Sofia e Jakovës së Jerusalemit ta vejë këmbën mbi varr, ajo do të bëhet medium biologjik.

Po qe se në varr do të jenë eshtrat e Kostantinit të Haçet Deletës, për një çast, sikur para rrezeve të Röntgenit Sofia do të shihet vetëm skelet. Natyrisht do të flasë përqartë. Po qe se nga brenda varrit vije kumti i Rektorit të universitetit, Redalk san Heldikut, Sofia e Haçet Deletës do të qullet vegësh deri tek orgazma. Prapë duke folë përqartë.

U bë heshtje.

34.

Zëri i zvargur i ujkonjës erdhi nga majë e malit. E grishi ujkun e saj Volfgang të shkrirë në bronzin e përrallës së Kësulëkuqes i cili, Sizif i kohës tjetër, zbriste pubisit të çupëgruas Kësulëkuqe deri buzë vagjinës, pastaj rrokullisej përpjetë deri tek kërthiza e mbushur lëng menstruacionesh hardhuce.

Diku larg, në maje të malit u zbraz një pushkë.

Ulërima e zvargur e ujkonjës u këput.

Natës së qershorit të dymbëdhjetë, të fundit të shekullit njëzet, i hyri aftimi në bark.

"Nga erdhi kjo krismë pushke?"- pyeti gjenerali austriak, Herman von Urlih.

"E vranë ujkun Volfgang, grishës të Kësulëkuqes"- u përgjigj gjenerali Xhonatan Shelton.

"Kjo vrasje ka synim mbi testimin tonë këtu"- dyshoi gjenerali austriak.

Jo! Gjithmonë në përrallën e blinduar të Kësulëkuqes vritej ujku nga barku i të cilit nxirret mitra e fishkur e një plake uloke.

Ujku i Kësulëkuqes sonte u shfaq me zërin e zvargur nga mali.

Ogur i keq. Ajo ujkonja e vet po e grishte ujkun Volfgang të dalë nga përralla aguridhe e uloke në të njëjten kohë. Po e grishë të arratiset nga teatri i fëmijëve të Berlinit.

Po përse jo?

Në Evropë zu të ndodhë çkamos.

Mefistoja u arratis nga teatri i Berlinit në aktin e dytë të dramës "Fausti". U rebelua. Vendosi të mos hyjë më kurrë në mishin e qenit të Doktor Faustit.

Sofia e Haçet Deletës, tok me Mefiston zbriti në Galile. Rabi Jochanan ben Sakai i sugjeroi të bie mbi penisin e Rektorit-Redalk san Heldikut deri tek orgazma atje në tendën e Zatres Arameje.

Para se të hyjë në mitrën e Rebekes së Alamekut, Rabi Jochanan ben Sakai i tha mikut të vet, Jakobit të urtë:

"O miku im, Jakobi i urtë! VETEM MITRA E GRUAS SË RE TË SHPËTON NGA VETVRASJA HEROIKE E POPULLIT TËND"

INDIGJENIA IROKI POCAHONTAS POWHATAN E MASSACHUSETTSIT, PAS DY ORËSH DO TA SJELLË JEZUSIN EKOLOGJIK NE KONTINENT.

OGUR I KEQ, MIKU IM.

"Veje këmbën mbi varrin e tët vëlla - Kostantinit!"- e cyti dhimbshëm kryemjekja e laboratorit të OSCE-së, Helen Hölms.

"Si shkilet varri i vëllait?"- u habit Sofia e Jakovës së Jerusalemit, drithërueshëm.

"Po ai të ka thirrë, zonjë e nderuar"- e ngushëlloi Helen Hölms.

"Sonte më paska thirrë?"- pyeti Sofia me zërin e të arrestuarit.

"Po, sonte".

Sofia e ngriti këmbën për të shkelë mbi varrin e të vëllait, pastaj edhe tjetrën.

Si në dhomën e erret të radiologjisë Sofia e Haçet Deletës u bë skelet. Doli nga mish i vet. Kumti i Kostantinit nga varri përmes skeletit të Sofisë foli:

"Vdekje Imperializmit amerikan! Rroftë miqësia vëllazërore me Sovjetikët. Rroftë miqësia vëllazerore me kinezët. Le të vdesë qumështi amerikan i pakos "Donated by people of America". Le të vdesë orgazma imperialiste amerikane. Le të vdesë Klitorisi revizionist!"

"Lëvize nga aty"- e urdhëroi gjenerali anglez, Xhonaton Shelton.

Kryemjekja, Helen Hölms e lëvizi paksa majtas.

Skeleti rrezatues, i ndritshëm i Sofisë u errësua. U mbush me mish.

"Lëvize paksa më në jug!"- urdhëroi gjenerali.

Pastaj provuan më në veri.

Kumti nga varri tjetër u ndez.

Sofia, papritur u drithërua, u shkundullua, u plogështua.

E ndjeu sëmbimin në fund të barkut. Njëherë në anën e majtë, pastaj në anën e djathtë, derisa sëmbimi ra në mishin femëror, pikërisht në klitoris.

E panë kur u qull vegësh duke u plandosur mbi varr. Këtë herë kumti nga varri tjetër qe tepër tundues plot epsh, plot

regëtima çjerrëse. Sofia e rënë në dëlirin e orgazmës i mbushte grushtet dhe. E shpinte dheun tek goja, e shpinte tek vagjina, derisa e djersitur mbeti e shtrirë, molisshim mbi varr.

"E ka arritur atë orgazmën e mallkuar, të kurdisur nga ai hebreu Jochanan ben Sakai tek ajo tenda e Zatres Arameje"- foli gjenerali Xhonatan Shelton.

"A mund të ketë mbetur shtatzënë"- e pyeti gjenerali austriak, Herman von Urlih.

"Po. Kjo grua është shtatzënë. Pikërisht këtë grua po e lyp sonte nëpër gratë e Jakovës së Jerusalemit ai gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi"- e sosi bisedën gjenerali anglez, Xhonatan Sheltoni.

35.

Dritat e reflektorëve të laboratorit të OSCE-së ranë me tërë peshën e tyre mbi varreza. Gjungat e tokës i benë sfidë dritës së reflektorëve me ledhet e tyre. Dheu i varreve qe plagosur në shumë vende. Dikush kishte rrëmuar jo aq thellë. E kishin lypë dikend në varreza.

"Dheu i varreve dhe mitrat e grave po rrëmohen sonte"- u rrokullis në vetvete gjenerali austriak duke e parë plagën e hijshme mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës-Franc Ferdinandit. E pa vajzën e Aleksit me fustanin e puthitur trupit nga veshtullia e dy spermave. E pa këtë dhe varrezash të plagosura. Dikush u paskesh besuar të dy diagnozave të të dy klinikave: "Gemeli" të Romës dhe "Mercoledi" të Vjenës.

Sofia e Haçet Deletës e ndjeu një dhimbje në fund të barkut të çapuritur si toka e varrezave të gërmuara. I bëri dy hapa përpara. Dhimbja i kaloi në anën e majtë të fundbarkut. E paskesh gabuar varrin. Ktheu disa hapa majtas. Dhimbja iu përqendrua

në midis të barkut. I vazhdoi edhe dy hapa majtas. Dhimbja sëmbuese i piku në mishin femëror. Në vagjinë. Atje ku vdiset për jetën e re.

Ndaloi në vend.

Ishte ulërima e ujkut Volfgang të Kësulëkuqes, me zërin e tij të zvargur, të vagullët.

Dritat e reflektorëve të laboratorit të OSCE-së e shtuan goditjen mbi Sofinë e Haçet Deletës. Ajo u shndërrua në siluetë të larë në dritën vrushkullore të reflektorëve.

Të gjithë e dëgjuan, edhe ata të cilët e patën të pamundur ta kuptojnë gjuhën e saj pa përkthyes. Nga skeleti i Sofisë doli zëri i burrit kukudh:

"Më sillni një rrobë të mbështillem! Qenka shumë ftohtë të dalësh nga varri i ngrohtë"- foli kumti nga varri nën këmbët e Sofisë.

Nën vellon e saj, reflektorët e laboratorit e zbuluan mjekrën e thinjur, të ashpër, të një kukudhi burrëfëmijë.

Në shtatin e Sofisë së Haçet Deletës u bë një rrokopujë gjinishë, moshash, të stërkequra njëra mbi tjetrën.

"Do t'i leni eshtrat tuaja në tokën e Internacionalizmit proletar. Vetëm miqësia me sovjetikët e me kinezët do ta shpëtojë botën. Imperializmi amerikan do të vdesë"- u çjerr kumti i varrit të Kostantinit nëpërmes mediumit skeletor të Sofisë.

Edhe pse Sofia u bë e tejdukshme si në kabinetin radiologjik,të gjithë ata kolonelë, gjeneralë, me profesion mjekësh dështuan ta konstatojnë nëse ajo qe apo jo shtatzënë.

Pasi ia përkthyen fjalët e kumtit nga varri, nën këmbët e Sofisë,gjenerali anglez, Xhonatan Shelton i tha gjeneralit austriak, Herman von Urlih:

"Shumë pak ky kumt tregon se e kemi zbuluar atë varr të pshurrt të atyre diagnozave të gjymta të klinikës "Gemeli" të Romës e të klinikës "Merkoledi" të Vjenës.

Të gjitha varret e kësaj Shqipërie të Albanikut sovjetik, të gjithë banorët skeletor të saj, e japin të njëjtin kumt. Mos mendoni se e keni bërë ndonjë zbulim. Për varrin e Kostantinit të Haçet Deletës, atij masturbuesit më të shquar, as që do të kemi nevojë sonte as kurrnjëherë. Sonte na duhet varri i Redalk san Heldikut, rektorit të Jakovës së Jerusalemit"- foli përbuzshëm gjenerali anglez, Xhanatan Shelton.

Doktoresha, Helen Hölms iu qas Sofisë pa arritur ta prekë me dorë. E priti urdhrin e gjeneralit anglez. Siç dukej, sonte, ai është kryesori.

Helen e shikoi mëtueshëm gjeneralin.

"Doktoreshë, lëvize nga ai pozicion!"- e urdhëroi gjenerali anglez.

Helen e shpuri tek varri tjetër, pastaj tek i treti. Nga Sofia e Haçet Deletës fliste i njëjti zë kukudh i burritfëmijës; zë ashtror, fërshëllyes nëpër mazgallat e eshtrave të shkërmoqura.

Në të katërtin varr, me një pllakës të thyer te kryet, Sofia e Haçet Deletës u errësua. U mbush me mish. Në bark e ndjeu lëvizjen e dikujt. Mbase në barkun e saj lëvizi Rainhard von Granhelmi i Tretë, Trashëgimtari i Fronit të Bohemisë.

Nga aq larg ai ta urdhërojë varrin e Rektorit, Redalk san Heldikut? Jo!

Sofia u drithërua. Sëmbimi i thimthave të gjinjve i zbriti teposhtë barkut, gjithandej më poshtë deri tek vagjina. Regëtimat e orgazmës e rrëmbyen deri në dëlir. Zëri femëror, tepër femëror, i Sofisë u ngulfat në gjoks. Ajo, e shtrirë plandosshëm për tokë i mbushte grushtet me dhe. Dheun e shpërndante amokshëm tek goja, tek gjinjtë,tek vagjina. Vegët iu qullën. Çjerrej, vërtitej nën gjëmat e thella. U përserit e njëjta orgazëm mbi të njëjtin varr.

Reflektorët e shtuan dritën si të fantaksur.

Gjenerali Herman von Urlih për herë të parë e pa fytyrën e Sofisë së Haçet Deletës. Për të parën herë e pa fytyrën e

orgazmës të shkrirë mbi fytyrën e femrës. Ndjeu dhimbje të padurueshme në gropën e testiseve të pëlcitura në prushin e gjallë të Sofisë Löhne, atje tek kështjella "Summer of" e Vjenës.

Gjenerali austriak e venëroi se të gjithë ndjenin dhimbje midis shalësh, në testise, po edhe doktoresha Helen Hölms.

Kumti nga varri i Rektorit, Redalk san Heldikut që tepër i fuqishëm. Qe kumt orgazme.

Gjenerali anglez i dha shenjë doktoreshës Helen ta largojë Sofinë duke e piketuar varrin.

"Ky është varri të cilin po e lypim ne. Mitrën e kësaj gruaje po e lyp ai gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, nëpër gratë e Jakovës së Jerusalemit. Ne i kemi në dorë krejt: edhe varrin edhe mitrën"- mezi foli gjenerali anglez, Xhonatan Sheldoni.

Rektori, Redalk san Heldiku ishte aty, edhe në atë varr, edhe në mitrën e Sofisë së Haçet Deletës.Në dy vende.Të gjitha sugjerimet e shërbimeve informative të kontinentit lypnin të bëhet ADN-ja krahasuese e Redalk san Heldikut të varrosur dhe fetusit të tij në mitrën e Sofisë së Haçet Deletës. E njëjta gjë do të bëhet edhe me Rektorin e dy universiteteve të Jerusalemit, Rabi Jochanan ben Sakain. Sfidë e keqe për gratë. Sfidë e keqe për psikanalizën.

"E dini, Ju zotëri, se kur e sollen Rektorin, Redalk san Heldikun nga Stambolli qe i ndarë në dy pjesë?"- e pyeti gjenerali anglez mjekun gjerman, Gryber Sontagun.

"Ashtu, përqartë shkruan në pergamenat e shërbimeve informative.Thënë të drejtën shumë pak di unë. Në disa pergamena shkran se nga Stambolli e sollën në tri pjesë"-arsyetoi koloneli Gryber.

"Jo përqartë, por shkruan qartë. Rektorin-Redalk san Heldikun e sollën nga Stambolli të ndarë nga testiset dhe penisi. Me të njejtin avion ushtarak turk, nga Stambolli e sollën eunukun Redalk san Heldikun, në njërën anë dhe llurbën e testiseve dhe

penisit duke kulluar gjak, në anën tjetër”- e ashpërsoi zërin gjenerali anglez nga sëmbimi midis shalave.

Gjenerali austriak heshti duke e mëtuar gjeneralin anglez të mos shkojë mëtutje.

“Ju e dini, zotërinj të nderuar, se kur e sollën Rektorin, Redalk san Heldikun në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit, testiest dhe penisin i mori gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, në njërën anë e, trupin eunuk e mori gjenerali austriak, Herman von Urlih”-i ra trup gjenerali anglez pa e kursye aspak gjeneralin austriak.

U bë heshtje. Gjenerali austriak u përpoq të arsyetohej:

“Zoti gjeneral ne e morëm trupin eunuk të Rektorit Redalk san Heldikut për ta zbuluar, siç e patë sonte, mitrën e mbarsur me spermën e tij. Gjenerali rus i mori testiest dhe penisin e Rektorit për të bërë eksperimente në mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit”- e mori veten gjenerali austriak.

“Ju e pasket vra trupin eunuk të Rektorit, Redalk san Heldikut?”- gati e akuzoi gjenerali anglez.

“Jo zoti gjeneral”-kundërshtoi Herman von Urlihu.-“Pas një ore të arritjes me avionin ushtarak turk plaga e thellë midis vegësh, tek ishte shkoqur llurba e testiseve dhe e penisit, i teptisi rektorit san Heldikut. Mori zjarr të një cungu të kallur. Të gjithë antibiotiket vajtën kot. Rektori vdiq duke e përmendur penisin dhe testiset e humbura”- erdhi duke nxjerrë zë gjenerali austriak.

“Zotëri gjeneral, përse e varroset Rektorin, Redalk san Heldikun në Shqipërinë e Albanikut të kolhozeve sovjetike e jo në Jakovën e Jerusalemit?”- e pyeti gjenerali anglez.

“Zoti gjeneral, sikurse edhe juve, ne na dëboi gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq nga Jakova e Jerusalemit. Në çastin e dëbimit të OSCE-së, Rektori Redalk san Heldiku ende qe i gjallë.E morëm me vete në Shqipërinë Albanike të kolhozeve ruse.

Këtu vdiq e këtu u varros”- gjithnjë gjenerali austriak anoi kah hidhërimi.

“Atëherë, gjeneral i nderuar, ju e pasket ditur saktësisht varrin e Rektorit Redalk san Heldikut. Përse e sfilitet Sofinë. E pridhet deri në atë katandi nëpër varret skeletore të kolhozeve të Shqipërisë Albanike”- e akuzoi gjenerali anglez.

“E kanë varrosur të tjerët, zoti gjeneral”- i ra shkurt austriaku, Herman von Urlih.

Helen Holms e tërhoqi Sofinë në makinën e urgjencës.

36.

Të dy varret, nëpërmes Sofisë së Jakovës së Jerusalemit kumtuan sipas kuteve e veta:

Kostantini i Haçet Deletës tha:

"Qenka ftohtë të dalësh pas kaq vjetësh nga varri. Jashtë varrit paska dritë shumë për guvat e errëta të syve të nxjerrë nga rrashta.

Perse më thirre motër të dal nga varri-bunker para këtyre imperialisteve?

Më tradhtove motër. Me të drejtë do të dënohem për agjitacion e propagandë".

Redalk san Heldiku tha:

"Do ta jepja krejt botën për një penis e për një parë testise. Më ke hypë mbi varr si mbi penis në tendën e Zatres Arameje. Penisin dhe testiest m'i shkoqen, m'i morën. Nga varri po ta shoh vagjinën siç e sheh njeriu hënën nëpër natën e pjekur të korrikut.

Gjithë botën do ta jepja për një penis e një parë testise.

37.

"Ë kuptojmë,zoti gjeneral"- ndërhyri koloneli Lipman Smith duke iu drejtua gjeneralit Urlih. -"E kemi të frikëshme ç'do të na dalë nga ky varr i gjysmënjeriut, mishi i të cilit u nda midis perandorive. Kush do t'ia qëllojë me saktë: ne, me çka do të gjejmë në këtë varr, me këtë metodën e Frojdit, mikut Tuaj, apo ai gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi me çka do të gjejë në mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit?

"Kumti nga varri i Rektorit-Redalk san Heldikut nëpërmes mitrës së kësaj gruaje të quajtur Sofi qe i qartë. Kjo grua, atje në cep të Galilesë, në tendën e Zatres Arameje u plandos në penisin e Rektorit. Kjo grua e ka arritur Orgazmën. Mendoj se ka mbetur shtatzënë. Shtatzania e saj me orgazëm e rrezikon Evropën, veçant sonte kur Indigjenen Iroki e ndajnë vetëm dy orë nga kontinenti. Ajo vjen sonte nga Massachusettsi për këtë

fetus të rektorit të Jakovës së Jerusalemit Redalk san Heldikut në mitrën e Sofisë së Jakovës së jerusalemit dhe për fetusin e rektorit të të dy universitetve të Izraelit, Rabi Jochanan ben Sakait në mitrën e Rebekes së Alamekut. Në këto dy fetuse Indigjenia Iroki e Massachusettsit brenda dy orëve te klinika "Gemeli" e Romës sonte do ta promovojë Orgazmën Iroki për herë të parë jasht Massachusettsit të saj.Ky promovim i sontem në klinikën"Gemeli"fetuset e të dy rektorëve i rysë përfundimisht në Orgazmën e Indigjenes Iroki. Kjo quhet Orgazma e inisiativës së lirë amerikane kur njeriu do ta njohë njeriun. Duke e njohur njeriu njeriun do të vdesë tradicionalizmi evropian. Njeriu duke e njohur njeriun e vetvetes së vet do t'i mohojë zotat evropianë, shtetet, religjionet, ushtritë, kierarkitë, tempujt,të gjithë tradicionalizmin.Ne tradicionalistët do të mbetemi hukubet për muze. Evropa sonte po alarmohet.

Ky fetus antievropian është i lashtë këtu e njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet, qysh atë natë kur Rabi Jochanan ben Sakai e mohoi Izraelin e Knesetit të madh. Mohimi hyri në Orgazëm, në mitër.

Kjo Indigjenia Iroki lektisë ta bëjë biznes Orgazmën e vet të Massachusettsit. Dolen gratë e këtij biznesi: Maria Magdalenë, Rebeka e Alamekut në Izrael, Zatra Arameje në Arameji, Sofia në Jakovën e Jerusalemit e,mbi të gjitha Indigjenia Iroki Pocahontas Powhatani e Massachusettsit amerikan. Këto gra po ia çatisin sonte në kontinent. Evropa e jonë tok me të gjithë gjeneralët e saj sonte po alarmohet pranë këtij laboratori"- e sosi mynxyrshëm diskursin gjenerali Xhanatan Sheltoni.

Gjenerali austriak kumtin e Rektorit nga varri e mori gand në vetveten e vet. E pa plagën e bukur mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës Franc Ferdinandit. U mbraps, i trembur deri tek laboratori i OSCE-së.

"Ky Rektor i cili foli nga varri po flitka edhe nga mitra e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Kështu kam mundur të flasë

dhe unë nga Mitra e Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës, Franc Ferdinandit"- e përbuzi vetveten e vet gjenerali austriak, Herman von Urlihu.

Gjenerali austriak e ndjeu rrezikun sikur, sonte, të paskesh folë nga mitra e Sofisë Löhne të shoqes së Arçidukës Franc Ferdinandit. Në të njëjtën kohë ka qenë deshur të bëjë kumt edhe nga varri.

"Paska qenë deshur të vdes për të dërguar kumt nga varri".

I bëri disa hapa përpara drejt autoambulancës për ta parë me aq lektisje vetullën e trembur të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

Ai pa krejt diçka tjetër. E pa plagën e bukur mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës, Franc Ferdinandit. E ndjeu në krahët e vet mishin e ngrohtë të saj. Shija e buzëve të mbufatura të saj i kishte mbetur lëng i jetës. E pati të vështirë të vdesë për të dërguar kumt nga varri.

E ndjeu ngashërimin shpërthyes nga brenda. Dëshiroi të kishte qenë në ketë çast në mitrën e gruas së re. Vetëm tash e pa fuqinë e gruas e cila nga varri e nxori kumtin.Sofia e Jakovës së Jerusalemit e shkrepi orgazmën mbi varrin e Rektorit Redalk san Heldikut.

Gjeneralit austriak, Herman von Urlih i foli plaga e bukur mbi vetullën e trembur:

"Gjeneral, ju e vratë gruan e mbushur dashuri siç vret një eunuk i haremit të Sulltanit. Gjeneral fisnik ju e vratë spermën tuaj në mitrën e gruas së bukur"- vazhdoi kumti sarkastik i Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës- Franc Ferdinandit.

"Cilën natë e vratë spermën Tuaj" -i erdhi kumti.

"Atë natë kur ai çifuti i hajthëm Gavrillo Principi me penisin e tij prej akrepi e mbëltoi aq thellë spermën e vet në mitrën e vajzës së Aleksit, burrit më të mirë të Sarajevës, ju zoti gjeneral po merreshit me një atentat të shtirur, kurrë të paqenë"- i erdhi i zvargur zëri i saj.

Ajo, Sofia Löhne, e nxitur nga orgazma e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit mbi varrin e Rektorit, Redalk san Heldikut, i dërgoi kumt pas kumti gjeneralit Herman von Urlih, secilin më të rëndë se tjetrin.

"Gjeneral i nderuar, keni menduar se në pergamenat tuaja do të mbetet e besueshme përherë se lufta e parë botërore filloi në vagjinën e vajzës së Aleksit, burrit më të shquar të Sarajevës?

Lufta e jote prej gjenerali hardall të vajti huq.Sonte kur shpërtheu Orgazma e Sofisë mbi varrin e Redalk san Heldikut nga mitra dhe nga varri, Rabi Jochanan ben Sakai po mbeltohet në Shtatëmbëdhjetë minutat e Izraelit të mitrës së Rebekes së Alamekut nga Abbi i Judesë"- foli përbuzshëm Sofi Löhne-e shoqja e Arçidukës, Franc Ferdinandit.

Gjenerali austriak Herman von Urlih i humbi të gjitha:testiset, të dy Sofite, kumtin nga varri. Vetëm ujku Volfgang i gjasoi në vetveten e vet prej gjenerali.

38.

"Punë shtetesh"-ankoi gjenerali anglez, Xhanatan Shelton. - "Kush e di përse u vendos të bëhen ndërhyrjet kirurgjike në mitrat e atyre grave:të Rebekes së Alamekut e të Sofisë së Haçet Deletës, pikërisht në klinikën"Gemeli"të Romës e jo në ndonjë klinikë tjetër më evropiane"- vezhdoi sikur të mos dinte gjë.

Të gjithë të pranishmit heshtën.

Reflektorët e laboratorit të OSCE-së i zbutën vrushkujt e dritës. Punëtorët e filluan rrmihjen në varrin e Rektorit Redalk san Heldikut. Puna e tyre vente ngadalë si nga një botë tjetër. Zhurmat e goditjeve shkonin kah dheu, në vend se të shkonin kah ajri, përpjetë. Po e zhbironin mishin e dheut. Duhej nxjerrë sekreti i tij sonte, pikërisht sonte.

Dikur kazma e parë e goditi metalin i cili e lëshoi tingullin e të plagosurit.

Gjenerali anglez e njohu regëtimën e arkivolit të plagosur. Urdhëroi ta vazhdojnë punën vetëm arkeologët e sofistikuar për ta nxjerrë vdekjen, të palënduar nga toka.

Arkeologet duke e larguar dheun, me kujdes, e morën me mend se ai arkivol i metaltë ishte i mbushur rristik me mish të freskët njeriu. Goditjet e gabuara bëheshin të nëmitura.

"Cilin po e nxjerrim sonte nga varri? Këtu do të ngatërrohen pergamenat. Dikush do të thotë se e nxorëm arkivolin e Kostantinit të Haçet Deletës së Ilirikut Albanik e, të tjerët do të thonë se e nxorëm arkivolin e Rektorit të universitetit të Jakovës së Jerusalemit Redalk san Heldikut.Punë pergamenash më. " -u shtir sikur u brengos gjenerali austriak,Herman von Urlih.

Gjenerali anglez, qëllimisht heshti kundrejt broçkullave, bërbëlitjeve të gjeneralit austriak. Ky austriak i ngathtë, pa pikë diplomacie prej se ishte lenduar nga vetulla e kërcyer e Sofisë Lohne, katandisej për ta mbrojtur prestigjin e shtetit të vet. Përpiqej ta mëshehë sekretin publik, të shënuar në pergamenat e shërbimeve informative, po, shpeshherë të shkruara përqartë mbi ndarjen në dy apo në tri pjesë të Rektorit Redalk san Heldikut.

Gjenerali anglez u përmbajt derisa Herman von Urlihu e teproi me broçkullat kutërbuese.

"Zoti general, të gjithë e dimë se ai Kostandini i pshurrt i asaj baladës hermafrodite të Sigmundit Tuaj as që i duhet kujt sonte.Ai farë Kostandini le t'i shërbejë atij Sigmundit Tuaj i cili lëshon diagnoza kuturu për personat e paqenë kurrë në atë terrenin e psikanalizës së tij hapaçele midis animës dhe animusit të shkërdhyer.

Sipas kësaj teorie hapaçele të Sigmundit tënd të fantaksur, ne,sonte gati të shkaktojmë incest midis të vdekurit e të gjallit" - shpërtheu gjenerali anglez, Xhanatan Sheltoni.

Herman von Urlihu u frikësua nga fjala "incest". U përpoq t'i shmanget hidhërimit të gjeneralit anglez. Mendoi ta zgjedhë një bisedë asnjanëse të pavurratë.

"Zoti gjeneral, ne sonte vetëm i testuam këto varreza. Nëpërmes Sofisë deshëm ta dimë cili qe varri i Kostandinit të Haçet Deletës e cili qe varri i Rektorit-Redalk san Heldikut. Asgjë më tepër"- u çfajsua gjenerali austriak.

Edhe pse gjenerali austriak u katandis ta mohojë incestin, të gjithë e panë reagimin e Sofisë së Haçet Deletës mbi varrin e Kostantinit të Haçet Deletës. Nëpërmes saj, nga toka, nga varri, erdhi kumti i Kostandinit të Haçet Deletës, i tërë Shqipërisë së Albanikut sovjetik.

Sofia u zhvesh mishit femëror. Për një çast u bë shtetase e Shqipërisë së Albanikut sovjetik. U xhvesh identitetit biosocial si të gjithë banorët e Kolhozit-Gullag të Shqipërisë sovjetike. Nëpërmes Sofisë-medium, nga varri i Kostandinit zëroi urrejtja ruse ndaj imperializmit amerikan. Ky kumt i ngjitur përpjetë skeletit të Sofisë së Haçet Deletës qe kumti më i skajshëm rus, i thënë me gojën e popullit më arketip në Evropë. Shqipëria e Albanikut sovjetik e varrit të Kostatinit e dha kumtin nëpërmes mediumit skeletor të Sofisë së Haçet Deletës. Kujt i duhet sonte kumti arketip nga varri i Shqipërisë së Albanikut sovjetik? Askujt! Evropa tok me Rusinë janë të interesuara, t'i vrasin kumtet nga mitrat e Marisë Magdalenë, të Zatres Arameje, të Rebekes së Alamekut, të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

"Ky qe vetëm incesti skeletor i ashtit, pa mish, pa shpirt, të Shqipërisë Albanike"- serish e zbuti gjenerali austriak.

"Ju mendoni, zotëri gjeneral, se Adami po të kishte qëndruar në titërr të diellit biblik prej mëngjesit e deri në mbrëmje pa mish, pa shpirt, pa orgazëm, pa dashuri, pa firomën e Hyut, se në mbrëmje do të kishte arritur të bëhet vetëm njeri?Apo do të ishte bërë një rrenojë copash gline, i paaftë të bëjë mëkat?"

“Po zotëri”.

“Keni të drejtë, zotëri”.

U bë heshtje. Sikur u pajtuan të dy gjeneralët.

“Nga hyri fryma e Hyut tek Adami dhe Eva?”- e pyeti papritmas gjenerali anglez mbushullisht provokim.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih u zu në zgabim nga pyetja e papritur e gjeneralit anglez. U kujtua të nxjerrë diç nga meshat e shumëta të të dielave të fëmijërisë së vet.

Prifti i tha:“Zoti e futi në trupin e Adamit firomën e vet hyjnore dhe Adami u bë i gjallë”.

“Nga cila anë e futi Hyu firomën e vet hyjnore në trupin e Adamit?”- e pyeti gjenerali anglez, Herman von Urlihun.

“Nga goja, zoti gjeneral”- u përgjigj fëmijërisht si nxënës i shkollës fillore gjenerali austriak.

“Atëherë përse Adami lektisi me aq ngulm ta ketë një Evë pranë vetes? Për ta kënaqë gojën apo për ta kënaqë penisin?”- e ironizoi gjenerali anglez.

Gjenerali austriak vendosi të mos u përgjigjet pyetjeve provokuese të gjeneralit anglez.

Ketë vendim të Herman von Urlihut e pikasi gjenerali anglez. Andaj e shpejtoi rrjedhën e mendimit.

“Firoma e epshit hyri në shtatin e Adamit, në shtatin e Eves, jo nga goja. Hyri nëpërmes gjenitaleve deri tek Mitra, deri tek testiest.Ajo firomë e hyrë në vagjinë, në testise. E rebeloi mishin, po pse jo, edhe shpirtin e njeriut kundër Zotit, kundër Shtetit, kundër pushtetit, kundër fesë, kundër moralit. Ai epsh prej amoku do t’i hante të gjitha mollët e kopshtit të Edenit me gjethe e me degë. Do t’i hante të gjitha mollët e dyqaneve të Evropës”- çfryni gjenerali anglez.

“Ky është vetëm një sajim i çifutëvë në Bibël. Adamin dhe Evën çifute duhet ndaluar. Pikë së pari duhet përzënë nga Par-

ajsa. Në fund të çdo orgazme të tyre të vehet vula e dhimbjeve ulëritëse për secilën çifute. Bile në orgazmën e asaj Rebekes së Alamekut të Rabi Jochanan ben Sakait të vehet vula e të gjitha dhimbjeve të të gjitha grave"-ndërhyri në bisedë Gryber Sontag përngutshëm.

Pastaj ç'duhet bërë? U hoq orgazma duke e lënë një seks, vetëm një seks të errëtuar, mëkatar, sa për një shtim të kopjuar biologjik.

Tentimi i Marisë Magdalenë për të bërë dalë u quajt prostitucion i denueshëm për vrasje.Jesusin e tredhen duke e shndërruar në një asket qonquistador me shikim të ftohtë, të brisht.

Por këta hebrenjtë. Në shikimin e Jezusit e kontrabanduan orgazmën nëpërmes anglezit,John Harkerit, në Massachusettesin e largtë. Indigjenia Iroki Pocahontas këtë shikim të kontrabanduar të Jezusit e gëlltiti me syrin e vagjinës e me vagjinën e syrit atë ditë dimri në tendën e vet. Në piskun e syrit të vagjinës e të vagjinës së syrit anglezi, John Harkeri, mohoi çdo gjë evropiane:i mohoi zotat, shtetet, pushtetet, religjionet, ushtrtë, i mohoi të gjitha traditat. U bë renegat.

Sonte, pas dy orësh, do ta pushtojë Evropën. Ai e ka zgjedhur mishin ekologjik të Jakovës së Jerusalemit, i ka zgjedhur mitrat e Rebekes së Alamekut dhe të Sofisë, të shoqes së Rainhard von Grainhelmit të Bohemisë. Këtë mish të Jakovës së Jerusalemit ky renegati anglez, John Harkeri, do ta përdor farë mullëze për përtrijen e orgazmës në gjithë Evropën. O sonte, O kurrë për vete kjo Evropë!

"Zoti gjeneral! Për këtë çështje Evrope ju austriakët dhe rusët e ndatë në dy pjesë Rektorin e Jakovës së Jerusalemit Redalk san Heldikun? Ju austriakët e morët trupin e tij prej eunuku e, gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, i mori testiest dhe penisin?"-e pyeti më ngulm gjenerali anglez Herman von Urlihun pa i dhënë të drejtë për të heshtur.

“Rektorin, Redalk san Heldikun, na e sollën të ndarë në dy pjesë me avionin ushtarak turk në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit”- foli bindshëm gjenerali austriak Herman von Urlihu. E kishte ndarë në dy pjesë tjetërkush atë Rektorin, Redalk san Heldikun”- sikur u lirua gjenerali austriak.

“Doni të thoni se Rektorin, Redalk san Heldikun, e kishte ndarë në dy pjesë Turqia e sulltanit?”- u tall nën hundë gjenerali anglez.

“Po, zoti gjeneral. Turqia e kishte ndarë në dy pjesë, në tri pjesë”

“Përse ju austriakët ja latë testiest dhe penisin gjeneralit rus Ivan Vasiljeviq Kutozovit e, për vete e morët shtatin eunuk të Rektorit, Redalk san Heldikut?”- serish insistoi gjenerali anglez duke e parë se edhe këtë herë gjenerali austriak, Herman von Urlih, vendosi të dredhojë.

“Austria dhe Rusia, përngutshëm, brenda dy orësh, u katandisën t’i bëjnë eksperimentet e fundit mbi mishin ekologjik të Jakovës së Jerusalemit. Ne austriakët e morëm trupin eunuk të Heldikut por më vonë edhe Turqia u pendua. Kërkoi t’i ndalë për vete ose penisin ose testiset e Heldikut”- shpjegoi von Urlihu.

“Si mund të mbetët ekologjik mishi gaull i mbyllur në guacën e pushtuar shtatë herë?”-u rrokullis në vetveten e vet gjenerali anglez.

“Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, sonte e ka këtë konkurrencë të pushtuesve mbi Jakovën e Jerusalemit. Gjeneralët e ushtrive evroaziatike mishin e Jakovës së Jerusalemit, në konkurrencë me njëri-tjetrin, kanë mbajtur të mbyllur në guacën ekologjike. Këtë punë po bëjmë edh ne sonte”-sikur ironizoi austriaku.

Në orën e fundit,posa arritën nga Stambolli tri pjesët e Rektorit, Redalk san Heldikut, gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kuto-

zovi i zgjodhi testiest dhe penisin e Rektorit.Ai Gjeneral ngulmërisht po i përdorte të dy metodat krahas njera-tjetrës. Nëpërmes mjekut ushtarak, muzhikut Makushev, mekanikisht duke e futur dorën në mitrën e grave të reja provonte ta prekë fetusin e rektorit, Redalk san Heldikut. Krahas kësaj metode teknike gjenerali rus i kishte çelur mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit për t'i shtrydhur testiest e Rektorit në këto mitra. Ai gjeneral shpresonte, në çastin e fundit, se do ta krijojë gjenetikisht një fetus të Rektorit san Heldik të cilin do ta vaksinojë me "Sanguis lacertae in musculo" dhe me "Sanguis lacertae in cerebro" siç kishte bërë në Shqipërinë e Albanikut sovjetik. Gjithë këtë punë i duhet ta bëjë brenda dy orëve para se t'ia çatisë Indigjenia Iroki-Pocahntas Powhatan, e gjeneralit John Harkerit të Massachusettsit.

Gjenerali austriak, Herman von Urlihu, nga të dy pjesët e Rektorit-Redalk san Heldikut, e zgjodhi shtatin prej eunuku. Plaga-gropë, midis shalave të Rektorit kishte pezmatuar. Mjekët ia parashikuan vdekjen pas një gjysmë ore. Krejt njësoj. Edhe nga varri rektori, Redalk san Heldiku, do ta jepte kumtin e mjaftueshëm nëpërmes orgazmës së Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

Ministria e brendshme e Austrisë u bazua në metodën e Sigmundit të Vjenës.

Sigmundit të Vjenës, pas ngatrrimit me mitrën e Teutës së Haçet Deletës së Ilirikut të Albanikut sovjetik, sonte i duhet, në çastin e fundit, vaksina: "Sanguis lacertae in utero" për mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

Po përse kaq përngut Rusisë aziatike dhe Evropës austriane u nevoiten: "Sanguis lacertae in musculo", "Sanguis lacertae in utero"dhe "Sanguis lacertae in cerebro" për mishin ekologjik të Jakovës së Jerusalemit?

Pas dy orësh, vetëm pas dy orësh, Indigjenia Iroki-Pocahontas Powhatan e gjeneralit, John Harkerit, të Massachusettsit

do ta kurdisë orgazmën ekologjike në mitrën e Jakovës së Jerusalemit.Ajo, Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatan e gjeneralit John Harkerit don ta shohë me shpejtësi laboratorike evolucionin e klitorisit,të vagjinës, të orgazmës,të penisit e, në fund të Dashurisë.

Nga ky mish gaull, ekologjik i Jakovës së Jerusalemit me zhdrivillim gjenetik don t'u bie ndesh vaksinave: "Sanguis lacertae in utero", "Sanguis lacertae in musculo" dhe vaksinës "Sanguis lacartae in cerebro" të të gjitha evropave aziatike.

39.

"Zoti gjeneral,e pamë të gjithë, sonte, se vaksinat ruse të gjeneralit Ivan Vasiljeviq Kutozovit:"Sanguis lacertae in musculo" dhe "Sanguis lacertae in cerebro" çfarë rezultati paskan dhënë në Shqipërinë e kohhozit-Gullag.Atëherë përse të presim ne, sonte e të mos e fusim "Sanguis lacertae in utero" tek mitra e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.Atë grua e kemi në dorë këtu. E pamë se ajo e arriti orgazmën mbi varrin e rektorit Redalk san Heldikut"- u zgjua beftas gjenerali austriak, Herman von Urlih.

"Punë shtetesh, miku im. Është marrë vendimi se vetëm në klinikën "Gemeli" të Romës do të bëhet ndërhyrja kirurgjike në mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit dhe në mitrën e Rebekes së Alamekut. Se ç'lidhje kanë midis tyre, ne gjeneralëve të varfër na ndalohet të dimë.Pastaj miku im, ne nuk i kemi mjetet e sofistikuara për atë punë. Ne jemi laborator fushor"- i foli gjysmëmiqsisht gjenerali anglez.

“Atëherë, miku im, mbetka varianti i parë, ai i gjeneralit roman, Titi, se të dyja: Rebeka e Alamekut dhe Sofia e Jakovës së Jerusalemit, sonte, me avionin e orës dy të mesnatës të udhëtojnë për në Romë”- sikur ankoi gjenerali austriak.

“Po miku im! Ne as që mund të ndryshojmë diç”- e mbylli gjenerali anglez.

Austriaku e kuptoi dëshpërimin e gjeneralit anglez. Dikush në ketë bisedë paskesh mbetur fajtor. Kështu edhe kup-tohej heshtja e ngulmët e anglezit.

Herman von Urlihut, në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit, kur e sollën Rektorin Redalk san Heldikun, të ndarë në dy pjesë,në praninë e gjeneralit turk,Yöllmaz Kadirogllu dhe të gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit, ia ndaluan sipas marrëveshjes, ta zgjedhë njërën nga dy pjesët e Rektorit Redalk san Heldikut. Gjeneralit rus, sipas marrëveshjes ruso-turke i takoi t’i zgjedhë për vete testiset dhe penisin e rektorit, të cilat ende pikonin gjak vende-vende.

“Ky do të vdesë pas një gjysmë ore”- ia treguan rektorin e rënë në regëtimat e fundit. -“Edhe i vdekur do të të bëjë punë. Ju evropianët engletiseni rreth disa perverziteteve seksuale. E sa për aq punë do të ju shërbejë ky eunuk”-sikur e tallen dy gjeneralët aziatikë.

Gjenerali austriak heshti duke e pranuar të mjaftueshëm atë çka i dhanë. E kishte lexuar, sipas profesionit të vet mjekësor, nëpër pergamena diplomatike se duhej, domosdo, me i ra ndesh Megaorgazmës pandemike të Indigjenes Iroki të Massachusettsit që po kërcënonte mbi Evropë. Brenda dy orësh, vetëm brenda dy orësh, duhej bërë gati për përdorim vaksinat: “Sanguis lacertae in musculo” dhe “Sanguis lacertae in utero”.

Gjeneralin austriak e rroku amoku i trishtimit deri tek plaga e bukur mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës- Franc Ferdinadit dhe Luftës së parë në vagjinën e vajzës së Aleksit të Sarajevës.

U përpoq ta gjejë në vete se sa i urren këta hebrenj të mallkuar. Sa ters i kanë punët. Lufta e Parë botërore e filluar në vagjinën e vajzës hebreje të Aleksit të Sarajevës u qull nga sekretimi vagjinal duke e rrudhur Austrinë në një plakë uloke. Atentati i çifutit, Gavrillo Principit, u aktrua mbi plagën e bukur të Sofisë Löhne, mbi atë plagë të shkaktuar me vegla të klinikës së guvernisë në Sarajevës. Ah këta çifutët! Ai, Rabi Jochanan ben Sakai, me lejen e Romës së fantaksur, e përhapi farën e këtyre çifutëve ters nëpër gjithë Evropën.

Gjenerali austriak mbet i dëshpëruar në heshtjen e vet. Vendosi t'i qaset autoambulancës tek e kishin vendosur Sofinë e Jakovës së Jerusalemit, pas gjithë asaj shkundullime shkërmoqëse mbi dheun e atyre dy varreve të Shqipërisë së Albanikut sovjetik. E mbajti dëshpërimin brenda gjoksit bashkë me lektisjen për ta parë edhe një herë vetullën e trembur nën plagën e bukur në ballë të Sofisë Löhne, atje në Sarajevë. Dera e autoambulancës qe gjysmë e hapur,nga dilte vrushkulli i dritës.Mallëngjimi i trisht e ngjiti tri shkallëve metalike të autoambulancës.

E pa. Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e molisur skajshëm, ende po përpëlitej midis dy varreve të atij Sigmundit të vjenës, të quajtura anima dhe animusi. Instrumentet e doktoreshës Helen Hölmsit, të vëna nëpër gjoksin e Sofisë, si për mëshirë, ia kishin lënë të zbuluar vetullën e trembur ballit përpjetë.

Gjenerali austriak, i përhumbur, u përkul mbi ballin e saj. E puthi përgjërushëm që mos ta zbulojë plagën e bukur mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne, atje në Sarajevë. Si për inat askund plaga e bukur mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne.

Gjenerali Urlih pa diç tjetër, krejt tjetër. Në ballin e ndritshëm të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit u feksua një brerore mallëngjimi e dëshirimi të përzier përtej të dy varreve, përtej atij Sigmundit të Vjenës.

Pati vegim apo ndodhi? Vetulla e cilës nga ato, lëvizi? Po ajo vetull e trembur ballit përpjetë e mbrojti vetveten nga shikimi zhuritës i Herman von Urlihut.

"Athua të dyja Sofitë do të vdesin midis atyre dy varreve të mikut tim- Sigmundit të Vjenës"- e gëlltiti vetveten gjenerali austriak.

Një dorë miqësore e trandi nga amoku i rënë në vetveten e tij. Ishte dora e kolonelit Gryber Sontag. Ia kishte venë dorën mbi supe.

"Zotëri kjo grua vuan brenda llahtarit biologjik. Kur ai, Rabi Jochanan ben Sakai, i sugjeroi me ton urdhërues të hyjë në tendën e Zatrës Arameje, shkruan paqartë në disa pergamena, se paska "harruar" t'i tregojë Sofisë se cili është ai burrë i lakuriqur brenda tendës"- i foli Gryber Sontag.

Gjenerali, Herman von Urlih, ngurroi në vend, me shikim të tretur në largsi, sikur ngulmonte ta shohë të paparën. Heshti në largsi, mbi qiellin e Jakoves së Jerusalemit.

"Kjo grua ka rënë në dëshpërimin e dy varreve, siç e pamë të gjithë. Po siç thotë ai miku yt, Sigmundi i Vjenës , ka rënë në dëshirimin midis animës dhe animusit. Ai çifuti, Rabi Jochanan ben Sakai, e shtyri brenda tendës së Zatres Arameje pa i treguar se cili qe ai burrë lakuriq mbi penisin e të cilit ra kjo grua. Cili do të ketë qenë: rektori- Redalk san Heldiku apo i vëllai- Kostandini i Haçet Deletës"- vazhdoi koloneli Gryber Sontag duke menduar qartas në incestin e përmendur më parë.

"Ai miku im, Sigmundi i Vjenës, flet për masturbimin e purgatorit. Ai ka mbetur jashtë rrjedhave medicinale të vaksinave gjenerike. Ju e patë këtë grua mbi të dy varret. Mbi varrin e atij të panjohurit, për të cilin ju, zotëri, mendoni se është i Kostandinit të Haçet Deletës, Sofia u shpërbë nga mishi duke u shndërruar në skelet të gjallë. Kjo gjendje e saj paratregoi se vaksinat e gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit "Sanguis

lacertae in musculo”dhe “Sanguis lacertae in cerebro” në Shqipërinë Albanike të kolhozit-gullag kanë arritur efekt të plotë. Në ketë Shqipëri të kolhozit-gullag tashmë të gjithë shtetasit janë barabitur në skelete të njëjtë mbi tokë e nën tokë. Ato skelete, nën tokë e mbi tokë, e japin të njëjtin kumt. Ndaj ai varr, mbi të cilin qëndroi Sofia as që dyshohet të ketë qenë i atij Kostandinit të pshurrt”- u inatos gjenerali austriak, Herman von Urlih.

“Zoti gjeneral, arkivoli i rektorit- Redalk san Heldikut, gjithsesi do të hapet sonte në laboratorin e OSCE-së”-i foli koloneli Gryber.

“Po qe se do të dalë tjetërkush nga rektori Redalk San Heldiku?”- foli me resë gjenerali.

“Zoti gjeneral, çdo shtetas i Shqipërisë Albanike të kolhozit- gullag, brenda varrit e jashtë varrit, i vaksinuar me “Sanguis lacertae in musculo” dhe “Sanguis lacertae in cerebro” është i privuar ta ngacmojë seksin e gruas së mbështjellë me mish femëror. Është shumë kollaj të dallohet kufoma e Redalk san Heldikut midis këtyre skeleteve.”- e kuptoi koloneli lojën e gjeneralit.

“Po atëherë ai gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, e paska të mbaruar punën. T’i vaksinojë banorët e Jakovës së Jerusalemit me atë “Sanguis lacertae in musculo” dhe puna u mbarua. Kur të arrijë ajo Indigjenia Iroki-Pocahontas Powhatan e gjeneralit amerikan, John Harkerit të Massachusettsit t’i gjejë të gjithë banoret e Jakovës së Jerusalemit të vaksinuar me “Sanguis lacertae in musculo” dhe “Sanguis lacertae in cerebro”- për të saten herë ironizoi mërzitshëm gjenerali austriak, Herman von Urlih duke u munduar t’i shmanget faktit kryesor se për gjeneralin rus e rëndësishme është ta zbulojë fetusin e rektorit Redalk san Heldikut e jo t’i vaksinojë banorët e Jakovës së Jerusalemit.

Gjatë gjithë bisedës gjenerali anglez kishte heshtur dinjitetshëm duke shikuar andej kah qielli i përflakur i Jakovës së Jerusalemit. U shtir sikur ajo bisedë të qe e padenjë për shkallën e tij. E patë për neveri ta kuptojë sikletisjen e gjeneralit austriak.

Sikur Herman von Urlih të kishte qenë i bindur ashtu siç i foli kolonelit Gryber përse e mori në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit,atë pjesën eunuke të Rektorit Redalk san Heldikut? Përse, i urdhëruar nga gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, u detyrua ta lëshojë Jakovën e Jerusalemit brenda njëzet minutash?

Gjenerali austriak, tok me Misionin e OSCE-së, nën urdhrin e gjeneralit rus u dëbua nga Jakova e Jerusalemit përtej kufirit në Shqipërinë Albanike të kolhozit-gullag. Regëtimat e fundit rektori Redalk san Heldiku i dha posa hynë në Shqipërinë Albanike të kolhozit-gullag. E varrosën në arkivolin e blinduar. Gjenerali austriak i dinte të gjitha: Luftën e parë botërore në vagjinën e vajzës së Aleksit të Sarajevës, atentatin e çifutit, Gavrillo Principit, në Sarajevë mbi Arçidukën e vrarë katër net më parë në kështjellën "Summer of" të Vjenës. Gjenerali austriak dinte për plagën e bukur mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne të shkaktuar në klinikën e guvernatorit të Sarajevës,zotit Bergman von Lyhe.Të gjitha i dinte gjenerali austriak, Herman von Urlih. Bile e dinte saktësisht edhe varrin e rektorit Redalk san Heldikut.

"Hiqu asaj teorisë së pshurrt psikanalitike të mikut tënd, atij Sigmundit të Vjenës! Sonte, sa më parë të nxirret nga varri arkivoli i Rektorit Redalk san Heldikut!- urdhëroi gjenerali anglez, Xhanatan Sheltoni.

Gjeneralët u nisen drejt varrit.

Punëtorët e kishin çvendosur dheun gjithandej rreth arkivolit me shkathtësinë prej arkeologesh. Arkivoli metalik tregonte se paskesh ndejtur pak kohë në dhe ose edhe mund të qëndrojë

gjatë në dhe pa u prishur. Po pritej urdhri, vetëm urdhri për ta nxjerrë jashtë varrit arkivolin metalik të rektorit Redalk san Heldikut.

"Pak, shumë pak, mund të shpresohet në këtë arkivol. Çelja e këtij arkivoli, mbase do të nxjerrë nga barku i vet sëmundje. Në të është vetëm gjysma e njeriut deledash. I mungojnë testiset dhe penisi. Ato i ka në dorë gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi. Ia komandon dikush tjetër koqet këtij burri të mbyllur në këtë arkivol masiv. Kujt i duhet më. Thonë se me joshje do ta zbulojë Sofinë e Jakovës së Jerusalemit. Gratë e kanë busollën biologjike për t'i hetuar koqet e mashkullit. Në këtë arkivol janë të gjitha partallitë e një mashkulli përveç testiseve dhe penisit. Kot mashtroheni në teorinë shterpë të mikut Tuaj, atij Sigmundit të Vjenës"-si në tallje i tha gjenerali anglez Herman von Urlihut.

"Atëherë, zotëri gjeneral, të mos e çelim fare atë arkivol kur paska aq shumë rrezik e aq pak shpresë"- ndërhyri gjenerali austriak i seritur përse gjenerali anglez ngulmonte për të mos e nxjerrë arkivolin jashtë varrit të rektorit Redalk san Heldikut.

-"Zoti gjeneral"- ju kthye austriaku Herman von Urlihu me dëshirë t'ia thotë gjeneralit anglez se i dinte të gjitha.-"Ka rrezik shumë të madh. Kur të hapet arkivoli i rektorit- Redalk san Heldikut mund të dalë pandemia e orgazmës. E ju zotëri gjeneral e keni lexuar nëpër pergamenat e kanaleve diplomatike se ç'batërdi ka bërë në Amerikë orgazma e Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatan e gjeneralit amerikan,John Harkerit të Massachusettsit"- u bë gjenerali austriak, Herman von Urlih.

"Atëherë, zotëri, kur ju austriakët dhe rusët e ndatë përgjysmë rektorin-Redalk san Heldikun, në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit, a e patet frikën e hapjes së pandemisë së orgazmës?"- e ironizoi gjenerali anglez.

"Jo, zoti gjeneral"- u përgjigj prerazi Herman von Urlihu. -"Të dy pjesët e rektorit Redalk san Heldikut, koqet dhe penisi

qenë të izoluara në plasmaste të bëra nergut për eunukët e haremit të Sulltanit”- vazhdoi gjenerali Herman von Urlih.

“A mund të ketë orgazëm në haremin e Sulltanit?”-u tall haptas gjenerali anglez, Xhanatan Sheltoni.

“Jo, zotëri.Në haremin e sulltanit orgazma dhe murtaja barabitën. Aty vetëm sulltani hyn si mashkull. Të tjerët janë të linçuar penisit dhe testiseve. Kështu edhe na tha në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit gjenerali turk, Jollmaz Kadirogllu, kur na i dorëzoi të dy pjesët e rektorit, Redalk san Heldikut”- vërtetoi gjenerali austriak.

“Gjeneral i nderuar”- e zvargu zërin gjenerali anglez.-“Arkivoli i rektorit Redalk san Heldikut gjithsesi do të çelet. Masat mbrojtëse do të jenë të shkallës së lartë”.

Ai u dha urdhër punëtorëve ta nxjerrin arkivolin jashtë varrit.

40.

Në laboratorin e OSCE-së paska shumë dritë.

Gjenerali Herman von Urlih,i mbërthyer në rrobat mbrojtëse u sikletis. Po e ngulfatte vapa. Edhe shikimi duhej të mbrohej nëpër xhamat mbrojtëse. Atij po i zvogëlohej laboratori. Koloneli Gryber i dha shenjë të kalojnë në dhomën tjetër. Në derë shkruante prej disa gjuhesh: "vetëm me rroba mbrojtëse!"

Kaluan andej. Hapësira u rrit për kushtet e një laboratori të vënë në një tendë.

I gjithë personeli mori qëndrim ushtarak.

Në midis të asaj salle e kishin vendosur arkivolin e rektorit Redalk san Heldikut të mbuluar me një çarçaf të gjelbër.

Koloneli Gryber Sontage e dha shenjën për ta hapur arkivolin.

Në heshtje të plotë gjenerali e ndjeu thekshëm zukatjen e veshëve të vet.

U hoq çarçafi nga arkivoli i rektorit, Redalk san Heldikut.

Arkivolin e kishin larë nga jashtë. Shkëlqente në dritën llamburitëse të reflektorëve të drejtuar nga të gjitha anët mbi metalin e lustruar.

Gjeneralit, Herman von Urlih , i iku klaustrofobia.

Dryrin e arkivolit, të njohur nga gjenerali Urlih, e këputën me shumë lehtësi.

“Kaq qyqarisht të dorëzohet ky metal?”-gati e shau gjenerali Urlih.

Koloneli Gryber i dha shenjë gjeneralit von Urlih t’i qasen arkivolit pa iu reshtur frikës së virusit të orgazmës.

Arkivoli i Rektorit Redalk san Heldikut u hap me shkarëzimë frikësuese. Skërmitja vetëm mund të merrej me mend nën rrobat e tyre mbrojtëse. Arkivoli gjysmëihapur u bë i frikshëm, madhështor, i fyer se po turpërohei nga gjithë ato shikime të mbrojtura prapa xhamave. U përpoq të dukej sa më misterioz, sa më i frikshëm. Goja e arkivolit të rektorit- Redalk san Heldikut shfaqi uri gllabëruese. Ai e lektisi respektin e të pranishmëve në atë ambient të huaj.

“Sa pak kanë respekt për orgazmën e një gruaje në tendën e Zatrës Arameje. Ajo grua erdhi nga botë tjetër, e urdhëruar nga miku im, Rabi Jochanan ben Sakai”- doli nga arkivoli firoma me tis avullak e san Heldikut.

Drita llamburitëse e reflektorëve sharroi thellë në arkivol mbi shtatin eunuk të rektorit Redalk san Heldikut. I shtrirë shlirshëm në arkivol, trishtimi i beftë kishte mbetur në fytyrën e tij të etshme.

“Sikur e paskan vra”!

Gjenerali Herman von Urlih, nga gjendje tjetër, e ndoqi veprimin e kolonelit Lipman Smith, i cili po katandisej ta fusë dorën thellë në arkivol deri tek plaga e turpshme e rektorit Redalk san Heldikut. Në gjysmën e poshtme të arkivolit ajri u mbushullua me kutërbimin e plagës hidhërake.

Koloneli Lipman Smith bëri me kokë në shenjë pohimi. Plaga e shkaktuar në Stamboll ishte aty e tëra, ende e trishtueshme në mishin e pashkoqur prej ashtit.

Gjenerali anglez, Xhanatan Shelton, i dha shenjë kolonelit Smith të lexojë në monitor.

U shfaq urdhëresa:

"Shkëpute një mostër të madhësisë standarde nga mishi i plagës së tij. Përpiqu ta shkëputësh sa më thellë në plagë!"- ishte urdhëresa e gjeneralit anglez.

Koloneli Smith u detyrua ta largojë krejtësisht kapakun e rëndë metalik.

I ndihmuan edhe mjekët: Kloth Durant dhe Gryber Sontag.

Rektori Redalk san Heldiku u la në vrushkullin e dritës së reflektorëve që nga këmbët e deri tek fytyra të cilës ia kishin këputur jetën para se mëllefin. U duk i fyer, i hidhëruar, mall-ëngjyes.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih e derdhi shikimin mbi atë fytyrë prej të vdekuri.Së pari, sipas huqit, shikoi mbi vetullën e rektorit. Aty mungonte plaga. Por edhe sikur të ishte plaga në ballin e rektorit do të dukej e shëmtuar mbi atë vetull të shpupluar. Vetulla e tij mezi po e mbante pozicionin; mishi i ballit ende po zihej me ashtin e kafkës. Ashti i kafkës lektiste të dalë mbi mishin dhe lëkurën e fishkur të ballit. Mishi dhe lëkura ende po i rezistonin ashtit.

Gjenerali u katandis ta shohë me syrin e mendjes plagën e bukur mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne, të shoqes së Arçidukës.

"A thua do t'i ketë rezistuar ajo vetull, e trembur ballit përpjetë, kryeneçësisë së ashtit të kafkës për ta zhbërë atë fytyrë të bukur"- e përpini vetveten gjenerali austriak.

E pa me syrin e mendjes së lodhur, nën shtresën e pudrosur, dëshpërimin e hidhur të Sofisë Lohne e, në të njëjtën kohë e pa pyetjen e dhimbshme të rektorit:

"Përse ma vratë mashkullin në mua? Edhe të vdekurit i duhet penisi, i duhen testiset. Vetëm me to mund të shkohet në

ferr e në parajsë. Pa to shkohet vetëm në purgator. Ato të bëjnë burrë ato të çburrnojnë.”

Pyetja e vulosur ende në mishin e fishkur të fytyrës po i binte ndesh ashtit të kafkës i cili lektiste ta resë ketë pyetje fort akuzuese të rektorit, Redalk san Heldikut.

Gjenerali e mendoi se edhe sa kohë kjo pyetje do të qëndrojë në plagën e bukur mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne derisa ta mundë ashti i kafkës mishin e fytyrës së saj.

”Por asaj nuk i janë hequr testiset”- për pak të mendojë gjenerali Urlih.

“Ky njeri i vdekur, nga arkivoli e jeton jetën në mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Unë e jetoj vdekjen time në plagën e bukur mbi vetullën e trembur të Sofisë Löhne”- u katandis gjenerali austriak, Herman von Urlih.

Koloneli Lipman Smith e shploi plagën- shpellë, të zezë, midis shalëve të rektorit Redalk san Heldikut. Tretja e mishit të plagës kishte marrë krye drejt barkut.

“Çfarë plage trashamane e xharrahut aziatik!”- u neverit gjenerali anglez, Xhanatan Sheltoni.

Doktori Lipman Smithi e gërreu paksa plagën-shpellë për ta kapur një copë mishi, ende më të paprishur.Me pincetën shkoqëse tri herë mori mish nga plaga e rektorit Redalk san Heldikut duke i hedhur në tri epruveta të vendosura në zhlebat e çelur të kutisë së hekurit. Pastaj në secilin epruvetë hodhi alkool prej shtatëdhjetë e pesë gradësh. Mjaftonte të ruheshin mostrat e mishit të plagës vetëm për dy orë, derisa të arrijnë në Romë, tok me Sofinë e Haçet Deletës.

Në praninë e të gjithëve koloneli Lipman Smith e mbylli kutinë e tri epruvetave të mbushura mish dhe alkool. I blomboi.

Gjatë gjithë kohës, Rektori Redalk san Heldiku qëndroi indiferent ndaj punës së kolonelit Lipman Smithit, pa i zbritur nga

fytyra dëshpërimi. Mishi i fishkur i fytyrës së rektorit ende po kacafytej të mos ia lëshojë fitoren ashtit të rrashtës së kresë.

U bë krejt një për të.Rektori u suell indiferent derisa koloneli Lipman Smith dhe Gryber Sontag po ia venin kapakun arkivolit.

Edhe gjenerali Herman von Urlih e pa se rektori e mundi vdekjen e vet. I bezdisur brenda rrobes laboratorike deshi ta mashtrojë shikimin e vet nëpër aparaturat eksperimentale.Lexoi numra,shkronja të vetmuara,fjalë, të gjitha enigmatike. Shikimi i ngeli hapërda në tri epruveta të mëdha,mbase figurativisht të kronometruara. Në secilën epruvetë, me shkronja elektronike i lexoi:

"Solucioni filozof, solucioni ushtar, solucioni shtetas".

Ne gramat e secilës epruvetë kronometrisht epej pulsi i shëndetit.

Koloneli anglez, Lipman Smith, i dha shenjë gjeneralit austriak se paskesh ardhë koha të dalin jashtë laboratorit.

Gjenerali austriak e zuri gëzimin e vet se më në fund do të dilte nga ky makth.

Kaluan në një korridor. Koloneli Lipman Smith ndaloi para derës tek shkruante: "Dhoma e dezinfektimit".

Të shkopsitur rrobash të bezdisshme mbrojtëse, gjenerali mori frymë lirshëm në oborrin e laboratorit.

Nata e qershorit të dymbëdhjetë të vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë po përgjumej thellë në vetveten e vet për të mos dalë kurrë nga andej.

41.

Gjenerali Herman von Urlih hyri në autoambulancë.Sofia e Jakovës së Jerusalemit po rrinte e shtrirë nën përkujdesjen e kryemjekes Helen Hölmsit.

Mbi vetullën e trembur të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit kishte zbritur mallëngjimi marramendës i bukurisë së dyfishuar të gruas pas orgazmës së përjetuar.

Gjenerali e kuptoi: prej arkivolit të Redalk san Heldikut kishte ikur dashuria të cilën xharrahu aziatik as e kishte marrë me mend për ta këputur me briskun e haremit. Ajo dashuri, për herë të dytë, shkoi tek Sofia e Jakovës së Jerusalemit. Në çastin e arrestimit tek tenda e Zatres Arameje, Redalk san Heldiku kishte rënë në amokun e orgazmës.Krejt turbullt, shtjellë, dashuria i mbeti peng në gjoks. E rrëmbyen, ashtu lakuriq, pa arritur ta kapin Sofinë e Jakovës së Jerusalemit.

"Mos u dëshpëro! Xharrahu turk do t'ia heq testiset e penisin. Në gjoksin e rektorit as do t'u shkojë mendja të rrmojnë.

Kur të hapet arkivoli i tij dashuria do t'i dalë nga gjoksi për t'u prehë në mitrën tënde, në fetusin tënd"- pa e parë asgjëkund Sofia e njohu zërin e Rabi Jochanan ben Sakait.

"Rabi, kudo që të jesh, më thuaj: a vdiq në midis të orgazmës ai burrë i tendës së Zatres Arameje?"- e pyeti Sofia.

"Ta thash"- u zvarg zëri i Rabi Jochanan ben Sakait.

Sofia e Jakovës së Jerusalemit mbeti pa përgjigjen e Rabi Jochanan ben Sakait. Ajo e kishte pyetur me ndrojtje, mbase përtej çështjes së orgazmës. Tashmë kishte shkelë mbi disa varre, e kishte ndarë kumtin e të vdekurve e të gjallëve. Filloi keqas të rrokullisej teposhtë vetvetes së frikësuar:

"Me cilin njeri të lakuriquar, në tendën e Zatrës Arameje, paskam rënë në zallahinë e orgazmës?"

Sofia, bashkë më Mefiston, të arratisur nga Teatri i Berlinit, pikërisht në fillim të aktit të dytë të dramës "Fausti", zbriten deri në Galile për ta takuar Rabi Jochanan ben Sakain. Ajo, siç e paskesh lexuar në pergamenat e bibliotekës-arkiv të familjes së të shoqit, Rainhard von Grainhelmit të Tretë, Trashëgimtarit të fronit të Bohemisë, paskesh pa se Rabi Jochanan ben Sakai qenka takuar, se paskesh biseduar gjerë e gjatë, me Kostantinin e Haçet Deletës.

Rabi Jochanan ben Sakai ia preu shkurt Sofisë:

"Ta thash"

Ndërhyri në kuvend Mefistoja:

"Rabi i hirësiuar, sa kohë mund të qëndrosh në mishin e këlyshit të pestë të Kones së Danielit, ashtu siç të ka dënuar Kneseti i Madh i Jerusalemit?"

"As një çast zotëri"- u përgjigj Rabi Jochanan ben Sakai.

"Po sikur të mos Ju kishte dalë zot Rebeka e Alamekut, ku do t'i kishit kaluar Shtatëmbëdhjetë minutat e orgazmës së Izraelit?"- e pyeti me mllef Mefistoja.

Rabi heshti. Vërtet heshti.

"Ç'do të dytën natë, në Teatrin e Berlinit, më është dashur të dal nga mishi i qenit të Vagnerit, mikut të Doktor Faustit. Kam qenë i detyruar t'i shoh ato zonja të pispillosura, nëpër lozhat e masturbuesve të Evropës, se si mbroheshin nga kutërbimi i mishit të qenit hebre të Vagnerit duke i vënë shamijëzat mbi hundët e tyre ngrehaluce. Gra pa orgazëm, pa dashuri, me klitorisa të fishkur"- vazhdoi Mefistoja gjithnjë i mllefosur

Rabi heshti. Vërtetë heshti.

"Ju, Rabi i hirësuar, do të thoni se unë, Mefistoja, gazi i botës, gazi i Gjermanisë, qenkam vetëm një maskotë e punuar nga shajaku i trashë. Dhe keni plotësisht të drejtë. Erdha nga Teatri i Berlinit t'u tregoj, Rabi, se sa ngulfatës, sa poshtërues, qenka të hysh e të dalësh në mishin e qenit të Vagnerit, mikut të doktor Faustit. Se sa ngulfatës, poshtërues, do të jetë qëndrimi Juaj, Rabi, në mishin e këlyshit të pestë të kones së Danielit siç ju ka dënuar Kneseti i Madh i Jerusalemit"- deshi ta thejë heshtjen e Rabi Jochanan ben Sakait hidhërimi i Mefistos.

Rabi, serish, heshti.

"I tregoni kësaj gruaje!"- Mefistoja bëri me dorë kah Sofia e Jakovës së Jerusalemit.- "Tregoji kësaj gruaje se me cilin njeri të lakuriqur e arriti orgazmën:me të vëllain-Kostantinin e Haçet Deletës apo me rektorin- Redalk san Heldikun. Ju, vetë, Rabi, i sugjeruat urdhërueshëm të hyjë në tendën e Zatres Arameje e të bie në penisin e burrit të panjohur, lakuriq në tendë"- ngulfatshëm foli Mefistoja i Teatrit të Berlinit.

"Ato diagnozat e çpifura të klinikave evropiane: "Sanguis lacertae in utero" e legjitimojnë teorinë e masturbimit midis vëllait e motrës, midis mishit të qenit të doktor Faustit e të Mefistos, midis Rabi Jochanan ben Sakait dhe mishit të këlyshit të pestë të kones së Danielit. Ajo diagnozë "anime-animus" e bën legjitim purgatorin seksual për ta hutuar ketë grua midis penisit të të vëllait dhe penisit të dashnorit.

Kjo diagnozë synon ta hutojë Jezusin ekologjik të Indigjenes Iroki-Pocahontas Powhatan të John Harkerit të Massachusettsit në "Shtatëmbëdhjetë minutat" e orgazmës së Jakovës së Jerusalemit.

Sonte Evropa ka rënë në fëtigë ta zbulojë këtë diagnozë, ta bëjë vaksinë për mishin e Jakovës së Jerusalemit. Unë Jerusalemin e mora me vete. Kneseti i Madh i Jerusalemit vdiq heroikisht në Jerusalemin e vet fiktiv, të paqenë. Unë Izraelin e mora me vete në mitrën e Rebekes së Alamekut.

Ky rektori i Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldiku, pasi dëgjoi për "blasfeminë" time,u nis për në Galile, pastaj për në Jude për të më takuar mua e,pastaj gjeneralin Titi. Rrugës e zu ajo Shtjella e vrevët e shkretëtirës arabike duke u çjerrë vuvshëm deri në qiell:"Allah!Allah!" Shtjella e Allahut e kapërtheu rektorin-Redalk san Heldikun pa arritur ta gjejë kurrë tendën e gjeneralit roman, Titi, pa arritur t'i gjejë kurrë muret e Jerusalemit, pa arritur ta gjejë rektorin, Rabi Jochanan ben Sakain.

Redalk San Heldikun, të vetmuar në shkretëtirë, e kapi ushtria e sulltanit. E futën në ushtrinë turke duke e bërë ushtar të Allahut të shkretëtirës derisa Zatra Arameje,e tunduar orgazmës, ra mbi penisin e tij; e futi brenda vagjinës mishin hell të mashkullit deri në mitër, deri në orgazëm.

Ajo, Zatra Arameje, e dalldisur orgazmës, doli nga tenda e vet për një çast për t'i treguar të jatit se u ra ndesh menstruacioneve kryeneçe, me mishin e mashkullit, me penisin e Redalk san Heldikut.

Derisa ajo,Zatra Arameje po i fliste të jatit,Berashit Ararajasit, mbretin të Aramejisë, unë e futa Sofinë e Jakovës së Jerusalemit në tendën e Zatres Arameje. Ajo, pa e ditur cili qe ai mashkull i shtrirë lakuriq, ra në penisin e tij, ende të qullur nga orgazma e Zatres Arameje, e futi thellë në vagjiinë duke e tre-

mbur klitorisin e ndezur gacë të gjallë deri tek orgazma marramendëse.

Toka, mali Aramejas, tenda e Zatres Arameje, u tranden nga shtjella e vrevët me atë buçimën e vuvët: Allah!Allah! të shkretëtirës arabike. E nxora Sofinë e Jakovës së Jerusalemit nga tenda. U ftillua nëpër amokun e vet deri te tenda e gjeneralit roman, Titi, tek Jakova e Jerusalemit"- i foli Mefistos së vetvetes së vet, Rabi Jochanan ben Sakai.

"Po me rektorin Redalk san Heldikun ç'ndodhi?"- e pyeti Mefistoja.

"Nga tenda e Zatres Arameje, ashtu të lakuriqur, ende pa ardhë në vete nga dy orgazmat, san Heldikun e mori gjenerali turk, Jyllmaz Kadirogllu. E dërgoi në Stamboll. Xharrahu i njohur i Stambollit, Edeler Sherhafudin ia nxori kallp, nga midis shalash, testiset dhe penisin duke e ndarë Redalk san Heldikun në dy pjesë: në shtatin eunuk dhe në llurbën e testiseve e të penisit"- sqaroi Rabi Jochanan ben Sakai.

Mefistoja e dëgjoi me vëmendje, i përkushtuar se si do të dalë Rabi nga kjo shkarëzimë teorishë të shkapërderdhura nëpër Evropë. Ai e dinte se të gjitha krimet bëhen mu në midis të masturbimit të këtij purgatori ku mund të dënohet secili. Vetë Mefistoja paskesh rrugëtuar midisit atij masturbimit evropian. Paskesh udhëtuar midis mishit të qenit të doktor Faustit dhe mëkatit të përhershëm të Luciferrit. Ai i shihte gratë e pispillosura dhe burrat koketë nëpër llozhat e teatrit të Berlinit se si masturbonin midis "anima-animusit" të Frojdit, ku njeriu për një çast nga teatri mund të dilte deledash. Të gjithë shtetasit udhëtuan rrugës së masturbimit midis moralit dhe propagandës, midis shtetit e propagandës …deri tek midisi i penisit të fishkur e vagjinës rjepacake. Çdo gjë kotej nëpër Evropën e midisit të vakët, atij midisit të hiqt. Kalbej jashtë fuqisë së orgazmës, jashtë fuqisë së dashurisë.

“Rabi i nderuar, si do ta shpëtoni Sofinë e Jakovës së Jerusalemit nga teoria purgatore e “anima-animusit”? Nga teoria e deledashit evropian? Sonte ajo po testohet mbi varrin e të vëllait Kostandinit dhe varrit të Redalk san Heldikut se cili penis u fut deri tek mitra e saj, aty në tendën e Zatres Arameje. Si do t’i rregulloni të gjitha pergamenat evropiane ku ngatërrohen Redalk san Heldiku e, herë Kostantini i Haçet Deletës?”- u ngut Mefistoja.

“Vetëm edhe dy orë, në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit, gjenerali austriak, Herman von Urlih dhe gjene-rali rus, Ivan Vasiljeviq Kutuzovi, do ta ndajnë, secili për vete Redalk san Heldikun. Gjenerali austriak Herman von Urlih do ta marrë shtatin prej eunuku të Redalk san Heldikut e, gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi do ta marrë llurbën e shterur deri në pikë, të testiseve e të penisit të Redalk san Heldikut. Testiset e tij u shteren dy herë në tendën e Zatres Arameje. Ajo diagnoza e teorisë “anima-animus” nëpër të gjitha pergamenat evropiane do të bëhet hutesë e kotë, e dështuar, para sfidës së dy argazmave të Redalk san Heldikut. Kumti mga varri i tij do të ipet shumë i dobët kundrejt kumtit të tij nga mitra e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit”- e kapërcei vetveten e vet Rabi Jochanan ben Sakai.

42.

Sofia e Jakovës së Jerusalemit u kthye në vetveten e vet të dyshimtë. Më të parin e dalloi gjeneralin austriak, Herman von Urlihun. Helen Holms ishte aty pranë saj. Pastaj pa shumë të tjerë. E ndjeu se, mbase po e shikonin si grua të incestit.

"Po masturbimi a mund të jetë incest?"

"Incesti është bërë në tendën e Zates Armeje"- u mundua të thotë dikush në pergamenë.

"Kjo grua ka rënë në orgazmën e të vëllait. Ky është incest i madh"- sërish provoi të flasë dikush në pergamenë.

Të gjithë mjekët e laboratorit të OSCE-së u rrasën për së ngushti në autoambulancë. Të gjithë u varën mbi fytyrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

"Himni i mitrës së Sofisë së Jakovës së Jerusalemit qenka bërë i njohur për të gjitha shërbimet informative. Ne, për herë të parë, Himnin origjinal të Sofisë së Haçet Deletës po e shohim sonte, pasi e nxorëm nga arkivoli i Redalk san Heldi-kut.

Himnin e saj, si duket, e ka shkruar Rabi Jochanan ben Sakai në gjuhën hebraishte e arameishte apo mbase duhet ta ketë shkruar edhe vetë Radalk san Heldiku"- çeli kuvend në atë zallahi të ngushtë brenda autoambulancës gjenerali anglez Xhanatan Sheltoni.

"Gjithnjë, në këto pergamena flitet me ekuivoke, me dy kuptime.U lihet rrugë të gjitha dyshimeve"-ndërhyri koloneli Lipman Smith.

"Ka ndryshim të madh, zoti gjeneral. Ky himn mbi mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, të cilin e kemi këtu përpara nesh, do të dalë më origjinali, më i ploti. Te gjithë himnet tjerë dalin ngapak të kontrabanduar, të kurdisur, mbase edhe të falsifikuar. Pergamenat janë shkruar në nivel diletantësh"- ndërhyri koloneli Gryber Sontag

"Nga e dini ju, doktor, se të gjitha pergamenat e himnit të mitrës së Sofisë së Jakovës së Jerusalemit na paskan qenë të falsifikuara? E dini ju zotëri hebraishten e Rabi Jochanan ben Sakait apo, arameishten e Zatres Arameje? E dini ju, zoti doktor, gjuhën e këtij të ashtuquajturit rektor- Redalk san Heldikut?"- foli sëmbueshëm gjenerali anglez.

Koloneli Gryber heshti dinjitetshëm, pa e marrë më të voglin mundim t'i japë dalë kuvendit të gjeneralit anglez. I dha të kuptojë me qëndrim se mendimi i gjeneralit anglez qe i papërfillshëm, tendencioz, i padenjë për t'i dhënë përgjigje.

Gjenerali anglez me përpjekje të mundimshme u rrek ta mësheh fyerjen pa marrë guximin ta vazhdojë kuvendin. E kuptoi edhe vetë se e paskesh tepruar me pyetje provokative, se ishte zbuluar më tepër se ç'lejonte sjellja prej gjenerali.

"Të gjitha variantet e pergamenave të himnit të mitrës së Sofisë së Jakovës së Jerusalemit i ka mbi tavolinën e vet Indigjenia Iroki- Pocahontas Powhatan e gjeneralit John Harkerit, të Massachusettsit. Indigjenia Iroki e di se pergamenat e falsifikuara midis shteteve janë bërë për mynxyrën diplomatike. Pas

dy orësh, në takimin e këshillit të lartë të NATO-s, ajo do t'i krahasojë të gjitha variantet mu para syve tonë. Mos harroni, gjeneral i nderuar, se në stafin e Indigjenes Iroki, përveç diplomatëve të rryerë ka edhe përkthyes të cilët të marrin gjak në vetull, në daç në hebraishte, në daç në arameishte"-e bëri zap gjenerali Xhanatan Sheltoni kolonelin Sontag.

Koloneli Gryber, pa e lëvizur shikimin nga fytyra e Sofisë e kuptoi se gjenerali Urlih deshi t'i hakmerret gjeneralit Shelton.

"Tek e fundit të gjitha shtetet e paskan himnin e mitrës së Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Ç'rëndësi paska një fjalë më shumë apo një fjalë më pak?"-koloneli Lipman Smith sikur foli me vetveten e vet, për ta dëgjuar të gjithë.

Ajri i rëndë, i djersitur, u lakua edhe mbi fytyrën e Sofisë.

"Është mirë të mos nguteni derisa t'ia çatisë ministri grek Spiridonis Zevsi. Ai e njeh greqishten e vjetër por edhe në stafin e vet ka përkthyes të hebraishtes e të arameishtes. Ai mu-nd ta lexojë në origjinal himnin e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit"- e zbuti zërin gjenerali anglez Xhanatan Sheltoni.

"Po, himni i mitrës së Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, ka qenë më mirë të ruhet ashtu siç e nxorëm sonte nga arkivoli i Redalk san Heldikut. Te mos falsifikohet nëpër ambasada shtetesh të ndryshme"- reagoi disi çuditshëm koloneli Gryber.

"Ne mund ta lexojmë këtë himn në monitor, në at ueb faqën e pergamenave të dosjes së Sofisë. Himni, sipas rregullës, do të jetë i përkthyer në të gjitha gjuhët, në të gjitha variantet. Përse duhet ta presim kot ministrin grek? Pastaj ministri grek mund të bëjë ndonjë sabotim në pergamenë"- ndërhyri preras gjenerali Herman von Urlihu.

U bë heshje e djersitur në autoambulancë.

I fundit mbeti gjenerali austriak, Herman von Urlihu. Edhe njëherë e lau me shikim mbivetullën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, në mos po i shfaqej ndonjë plagë e bukur e trembur përpjetë ballit. Aty mungoi plaga e bukur. Gjenerali austriak e

mori me vete mallëngjimin e Sofisë Löhne, të shoqes së Arçid-ukës - Franc Ferdinandit.

Me vete mori diç të pleksur nga të dy Sofitë pa e njohur veten se prapë u kthye në llucën e masturbimit. I erdhi të qajë kur e detyruan të hyjë në dhomën e Internetit të laboratorit të OSCE-së.

Të gjithë qenë ulur duke pritur të dalë në monitor ueb faqja e pergamenës- dosje të Sofisë së Haçet Deletës. Ekrani ende paraqiste një ale të një qyteti në vjeshtë. Gjethet e vjeshtës, të arta, kishin rënë rrugës së pashkelur.Pikëllimi vjeshtor, i imagj-inuar para kështjellës "Summer of" të Vjenës u mbyt në llucën e masturbimit. Shikimi i Sofisë Löhne mbeti i zvargur, qortues, mallëngjyes; sikur i tha:

"Edhe këtë herë Sigmundi i Vjenës do të masturbojë pranë asaj teorisë hardalle të animës e animusit"

43.

Dritat në sallën e internetit u shuan.Për çdo çast pritej shfaqja e himnit të Sofisë së Haçet Deletës.

Në monitor mund të jetë bërë gabim mbase i qëllimshëm.

Ndodhi ajo tjetra nga se ç'pritnin të pranishmit.

Sa gjerë e gjatë, e shtrirë në divan, krejt lakuriq, u shfaq në monitor ajo gruaja-çupë. Në çukun e kërthizës së saj ujku Volfgang, i molisur ende, po mbllaçiste atë lëngun e kuq, duke rrjedhë gati në fund të pubisit pushor të saj. Ekrani, si qëllimisht e zmadhoi pjesën e pasme të ujkut Volfgang duke i nyjëtuar ngulmueshëm vithet thatanike te kafshës së mjerë. Këmbët veç sa s'e kishin lëshuar të shembur përdhe. Një dorë e fuqishme mashkulli e nxiti ujkun Volfgang duke e tunduar vitheve thatanike. Ujku i trembur nga tundimi i menaxherit jashtë ekranit e rriti intenzitetin e punës duke e zbritur gjuhën më poshtë pubisit deri tek fillonte mishi i çelur femëror i çupëgruas. U pa qartë se ujku Vlfgang u pështiros porsa maja e gjuhës e preku mishin e çelur femëror.

U pa qartë në ekran gjaku i rrjedhshëm teposhtë vegëve të hajthme të ujkut Volfgang.

“Pse ky gjak i rrjedhshëm vegësh të ujkut Volfgang?”-u hardallis gjenerali anglez.

Herman van Urlih ende në zvargien e shikimit të Sofisë Löhne e njohu ujkun Volfgang të përrallës së stërkequr. E ndjeu rënkimin e thekshëm gati në dhimbje të kafshës së mjerë.

Ujku Volfgang po e vriste,me mundimin prej Tantali,seksin, klitoritin, orgazmën, krejt sikur Herman van Urlih në Sarajevë ditën e njëzet e tetë të qershorit.

Gjenerali Urlih, me kot priti t’ia shohë plagën e bukur mbi vetullën e trembur ballit-përpjetë kësaj çupëgruaje. Manipuluesi i fotografisë në monitor si qëllimisht e vodhi lektisjen e gruaçupës. U pa se çupëgruaja kishte rrëshqitur jashtë vetvetes se klitorisit, te seksit, të orgazmës. Po katandisej në purgatorin e masturbimit.

“Sigurisht manipuluesi në monitor na dha këtë pamje gabimisht. Ne po e pritnim atë himni e Sofisë së Haçet Deletës”- u hardallis sërish gjenerali anglez sikur të mos i kishte lënë aspak mbresë kjo skenë e përçudshme.

“Jo, zoti gjeneral kjo skenë është e përgatitur pikërisht për këtë çast sepse është në korrespondim biologjik me himnin e Sofisë së Haçet Deletës. Ky ujku Volfgang ka shumë kohë duke bërë gabim në përrallë. Për çdo natë në teatrin e Berlinit e gëlltitë këtë çupë ne shtratin e gjyshës. Edhe ai gjuetari halldup, krejt në mënyrë rutinore, e çel barkun e ujkut Volfgang për ta nxjerrë çupëzen e kuqe, krejtësisht të kuqe, të mbytur në menstruacionet e gabuara fëmijërore”- u përgjigj gjenerali austriak Herman van Urlih.

“Po flitet se edhe ky ujku Volfgang paskesh dashur të arratiset tok me atë Mefiston e doktor Faustit dhe Sofinë e Haçet Deletës. Por kurrsesi t’i vije përdoresh për t’u aratisur asaj hardalleshes Kësulëkuqe. Fëmijë e stërkequr më. Sonte të gjitha personazhet e kurdisura nëpër libra evropianë donë të arratisen.

Si duket ka rënë pandemia e arratisjes nëpër bibliotekat, teatrot dhe arkivat e Evropës.

Këtë sëmundje e solli në Evropë ajo Indigjenia Iroki– Pocahontas Powhatan e gjeneralit Harker të Massachusettsit" - u bë i shkujdesur gjenerali anglez.

"Le të lexohet së pari dosja e këtij ujkut Volfgang!"- sugjeroi gjenerali Herman von Urlihu.

Të gjithë heshtën pa dhënë shenja të aprovimit apo të mohimit. Në sallën e internetit ishte bërë letargji nëpër ajrin e mbushur copa informatash nga shërbimet e informative.Ajri kutërbonte pergamena të mykura, ose të shpëlara në naftalinë. Kutërbimet, informatat, letargjitë, e luftonin njëra-tjetrën nëpër ajrin e sallës së internetit.

44.

Në ekran u paraqit, me shkronja prej pergamene, titullimi paksa i frikshëm me një shkrim gati horror:

"Dosja e ujkut Volfgang"

"… ujku Volfgang, i cytur nga djalli - hebre, Mefisto, deshi të arratisej nga teatri i fëmijëve të Berlinit. Mefistoja e kishte nxitur ujkun Volfgang të arratisej nga akti i dytë i "Kësulëkuqes", atëherë kur edhe vetë Mefistoja do të arratisej nga akti i dytë i "Faustit". Ujku Volfgang u bind nga Mefistoja. Deshi të arratisej tok me Kësulëkuqen.

Në mbrëmje, kur në teatrin e Berlinit duhej të fillonin të dy shfaqjet,tek dera e Kësulëkuqes ndaloi makina.Ajo e njohu makinën e ujkut Volfgang, e njohu zhurmën.

"Mami m'i jep ëmbëlsirat t'ia shpie gjyshes!"

"Bija ime, çfarë ëmbëlsirash t'i dërgosh gjyshes në këtë kohë. E sheh se është bërë natë"- e qortoi e ëma

“Po pikërisht në këtë kohë fillon teatri i fëmijëve”- ngulmoi Kësulëkuqja.

“Ngjarja duhet të ndodhë në mëngjes. Gjithmonë, Kësulëkuqja duhet t’ia dërgojë në mëngjes gjyshes ëmbëlsirat. Pastaj gjuetari në këtë kohë rrije në shtëpi, i lodhur. Kush do ta vrasë ujkun Volfgang?” - u ngut e shastisur e ëma.

“Përse duhet të vritet ujku i varfër aq shpesh, në të njëjtën mënyrë?” - e pyeti të ëmën Kësulëkuqja.

“Sepse ujku Volfgang e gëlltit Kësulëkuqen çdo të dytën ditë”- u përpoq ta binte e ëma

“Jo mami tash e tutje unë dua të gëlltis ujkun Volfgang”- e befasoi të ëmën.

“Jo bija ime , atëherë gjuetari do të të vrasë ty për ta nxjerrë nga barku yt ujkun Volfgang” - e frikësoi e ëma.

“Ashtu edhe duhet. Nga barku im do të nxirret ujku Volfgang”- u përgjigj e vendosur Kësulëkuqja.

“Ti je çmendur, bija ime”- e katandis e ëma.

“Po i pate të gatshme ëmbëlsirat për gjyshen m’i jep mu tash!Ujku Volfgang po më pret në makinë tek dera. Përndryshe në teatrin e fëmijëve të Berlinit ka mjaft imitime të ëmbëlsirave sa për aktrim” - e kërcënoi të ëmën.

“Ti bija ime mund të mbetesh e sëmurë po e gëlltite ujkun Volfgang. Ujku është kafshë e ndotur.Pastaj e sheh se je e sëmuar.”- ndaloi e ëma kur pa se e bija i kishte ndërruar rrobat e kuqe në të kaltra.-“Po ti, bija ime, i paske ndërruar edhe rrobat” - vazhdoi e ëma e shastisur.

“Me rroba të kuqe gjak ndalohet seksi për femrën. Rrobat e kuqe- më ka thënë ujku Volfgang- janë stacion pushimi për femrat” - e zbuloi shikimin para nënës së vet Kësulëkuqja.

“Do ta humbësh punën në teatrin e Berlinit”-u përvaj e ëma.

“Po si mund të krahasohet puna ime në teatrin e fëmijëve me punën e Mefistos në teatrin për të rritur?” - e pyeti me sëkëlldi të ëmën.

“Ti çupa ime qenke çmendur midis ujkut Volfgang dhe atij djallit hebre Mefistos! Po a ka biseduar ndonjëherë Mefistoja me ty?” - u shastis e ëma

“Ka biseduar, bile edhe fort. Ai do të arratiset sonte nga teatri i Berlinit tok me Sofinë e Haçet Deletës” - e zbuloi Kësulëkuqja.

“Ky hebreu i ndotur- Mefistoja, dashka të arratiset me atë Sofinë e Rainhard von Grainhelmit të Tretë-Trashëgimtarit legjitim të Fronit të Bohemisë?” - e pyeti e ëma Kësulëkuqen.

“Pikërisht me atë grua do të arratiset”- ia preu shkurt e bija.

“Në të gjitha pergamenat shkruan se ajo Sofisa e Haçet Deletës, sipas sugjerimit të atij çifutit - Rabi Jochanan ben Sakait - paskesh hy në tendën e Zatres Arameje”-gjithnjë e më e shastisur i foli e ëma.

“Dhe?”

“Dhe ajo Sofia e Haçet Deletes ra mbi mashkullin lakuriq - të panjohur. Në disa pergamena shkruan se ky mashkull lakuriq paskesh qenë Rektori i Jakovës së Jerusalemit e në disa pergamena të tjera se ai mashkull lakuriq në tendën e Zatres Arameje,paskesh qenë i vëllai-Kostantini i Haçet Deletës”- shpërtheu e ëma.

“Pikërisht tek Rabi Jochanan ben Sakai do të shkojmë sonte. Sofia e Haçet Deletës do ta pyesë cili qe ai burrë lakuriq në tendën e Zates Arameje. Mefistoja do t’i tregojë Rabi Jochanan ben Sakait se sa i mundimshëm është gjallimi më mishin e qenit” - i tregoi se ëmës Kësulëkuqja.

Ujku Volfgang ç’do ta pyetë çifutin - Rabi Jochanan ben Sakain? - e pyeti e ëma.

“Do ta pyesë se si t’i shmangët shtatzënisë së çdodynetshme në teatrin e fëmijëve të Berlinit. Si të shpëtojë nga prerja cezareske nga një gjuetar halldup”-iu përgjigj të ëmës Kësulëkuqja.

“Po ti ç’do ta pyesësh çifutin, Rabi Jochanan ben Sakain?” - pyeti e ëma

“Do ta pyes se si t’i ndërrojmë rolet me ujkun Valfgang. Jo ujku Volfgang të më gëlltisë mua por unë ta gëlltis ujkun Volfang”- ia kumtoi Kësulëkuqja.

“Ti dashke të mbetesh shtatzënë me ujkun Volfang!”-u çjerr e ëma.

“Si ta marrësh, nëna ime. Si do ta quani ju rysjen e Jochanan ben Sakanit në mitrën e Rebekës së Alamekut?” insistoi e bija.

“Do ta quaja shtatzëni të ndotur seksuale. Punë hebrenjsh” - ia këputi e ëma.

“Edhe ujkun Volfang brenda meje do ta emërtosh shtatzëni seksuale. Punë ujqish?” - e pyeti të ëmën Kësulëkuqja.

“Bile edhe më tutje. Do ta quaj shtatzëni me orgazëm. Unë do të insistoj kundër kësaj shtatzënie çifutësh ose ujqërish të Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatani të gjeneralit amerikan, John Harkerit të Massachusettsit.”-i përshkën-ditën sytë të jëmës së Kësulëkuqes.

“Atëherë, nëna ime e dashur, mua më mbetet sonte ta aktroj rolin tim të vërtëlluar: unë sonte do ta gëlltis ujkun Volfgang” - drodhi Kësulëkuqja drejt makinës së ujkut.

E ëma mbeti e stepur nga mendja. Ajo e pa të bijën se si kërcei në makinën e ujkut Volfang.

Më në fund ajo vendosi: e formoi numrin e policisë së Berlinit.

Në anën tjetër të telit u paraqit një zë i rëndë me një mirësjellje rutinore, gati neveritëse.

Nëna e Kësulëkuqes hezitoi të flasë, të bisedojë me këtë zë të rëndë.

Mbeti me kufje në derë duke e dëgjuar frymëmarrjen e atij tjetrit.

Të dy po e testonin njëri- tjetrin ende pa folë.

E jëma e Kësulëkuqes e dëgjoi nga larg zërin e vet kur i foli atij tjetrit:

"Vajza ime është arratisur nga shtëpia"

"Zonjë, vajza e juaj është adoleshente apo e martuar?"-e pyeti ai tjetri me qëndrim policor.

"Zotëri vajza ime është fëmijë"

"Zonjë, së pari, për shënime, na duhet emri juaj dhe i vajzës suaj"

Gruaja hezitoi për një çast por sikur zëri policor e rrëmbeu të tërën. Serish e dëgjoi vetveten:

"Zotëri, unë jam Gerta Hemingen me banim në"Shtrase 26," e jëma e Helga Hemingenit, me nofkën - Kësulëkuqja. "

Polici heshti për një çast. Gerta Hemingen mendoi se polici po i shënon të dhënat. Pastaj dëgjoi se dikush foli me policin përtajtelas.

"Mos e keni fjalën, zonjë, për Kësulëkuqen e teatrit të Berlinit" - e pyeti frikshëm zëri tjetër.

Gerta Hemingen e kuptoi se tashmë po bisedonte me dike tjetër, shumë më i përzemërt se ai polici i parë.

I foli pa ngurrim:

"Po, zotëri, pikërisht për atë vajzë të teatrit të Berlinit po ju flas. Ajo u arratis, sonte tok me ujkun Volfgang"-shpjegoi Gerta Hemingen.

"Po ajo vajzëa e quajtur Kësulëkuqe është vajzë me edukatë. Ajo është shembulli më i mirë i fëmijës gjerman. Sa herë

e nxjerrin nga barku i ujkut Volfgang fëmijët i duartrokasin. Bile ne i dërgojmë shpeshherë kadatët tonë për ta parë këtë shfaqje. Ne e kemi rregull”- u përgjigj me mirësjellje ai tjetri nga policia e Berlinit.

Ajo u arratis tok me një ujkun Volfgang”-ankoi Gerta Heminguen.

“Zonjë, vajza e juaj Helga Hemingen, me nofkën- Kësulëkuqja, a e ka përmenur ndonjë emër”-u mundua ai tjetri të paraqitet me edukatë.

“I ka përmendur tre-katër emra zotri: çifutin Rabi Jochanan ben Sakain, atë Sofinë e Rainhard von Grainhelmit të Bohemisë, atë djallin çifut-Mefiston dhe Rebeken e Alamekut”-i numëroi Gerta Hemingen.

“Zonjë e nderuar, ju mos u shqetësoni. Vajza juaj mund të jetë tallë vetëm sa për t’ju frikësuar. Sapo morëm informatën nga teatri se të gjithë aktorët janë aty. Shfaqja veç sa do të fillojë. ” - e ngushëlloi zëri i atij tjetrit.

Gerta Hemingen u step për një çast ende pa e falënderuar atë tjetrin, me atë zë të zvetënuar. Ajo u hamend pa arritur t’i thotë asgjë.Nëpunësi i policisë e mbylli telefonin me një“Natën e mirë!”.

Përkundër informatës zyrtare, Gerta Hemingen e kuptoi se diç e madhe ka ngjarë në teatrin e Berlinit. Diç e madhe!

“Mbase policia donte ta mbajë të mëshehë. Si mund të filloj shfaqja pa mua? Mbase regjisori me insistimin e Kësulëkuqes më ka zëvendësuar me ndonjë grua tjetër. Por përse të ketë ndodhur? Përse regjisori ta ketë pranuar këtë lojë të vajzës sime?”- mbet e stepur Berta Hemingen.

Ta thërras edhe një herë policinë për shpjegime iu përngja punë e pamend. I mbeti të marrë vesh nga pergamenat zyrtare, veçan nga buletini i teatrit të Berlinit.

Teatri i fëmijëve qe mbushur rristik me spektatorë të vegjël. Gumëzhinin disi përngutshëm. Pritnin të çohej perdja masive e

skenës. Gumëzhitja sa vinte e shtohej bashkë me padurimin e fëmijëve. Kur durimi i spektatorëve të vegjël, aty-këtu edhe spektatorëve të rritur, u bë gati t'ia lëshojë vendin zemërimit, më në fund perdja masive e skenës filloi të ngritët ngadalë, dukshëm me zemëratë.

Askund pylli.

Nëpër një rrugë parku një vajzë e shpërdhitë, e veshur në xhinse, me atlete të lidhura ngusht për këmbë, mbante një bluzë të hollë të lidhur për beli. Kërthizën e kishte nxjerrë në titërr të diellit duke i bërë hije në çukun e thelluar të barkut.

Vërtet diç mbante në dorë, diç tjetër nga shporta e ëmbëlsirave. Nga rrobat e saj asgjë të kuqe në trup.

Spektatorët e morën për një vodvil të çastit, sa për disponim. Më të rriturit këtë skenë e morën për një burleskë zbavitëse.

Vajza eci rrugës së parkut drejt rrugës kryesore.

Në një makinë të bukur ngjyrë të kuqe, ujku Volfgang, pa fije dyshimi po e priste vajzën. Ajo u afrua shkujdesshëm tek makina e ujkut Volfgang.

"Mirëmëngjesi Kësulëkuqe!"- e përshëndeti ujkut Volfgang.

"Mirëmëngjesi" - u përgjigj vajza.

"Për nga ke marrë udhë kaq herët?"- u zbavit ujku Volfgang sipas përrallës.

"Mos aktro zotëri!"-sot kam marrë pushim nga përralla. Kam dalë për shtatë parë qejfe, vetëm për t'u engletisur.

"Po unë ç'do të gëlltis sonte?" - pyeti ujku me shaka.

"Sot në vend se ta hashë dike, dikush tjetër do të të hajë ty" - e tha engletisshëm Helga Hemingen.

"Paska ndodhur diç në përrallën tonë?"- pyeti ujku Volfgang mëdyshas, me një vezullim tjetër në sy.

“Në përrallën tonë ka hyrë orgazma e Indigjenes Iroki– Pocahontas Powhatanit të gjeneralit amerikan John Harkerit të Massachusettsit”- shpërtheu Helga Hamangan, me nofkën Kësulëkuqja.

“Po me gjyshen ç’do të ndodhë?” - gati sa u tall ujku Volfgang.

“Atë le ta shpiejnë në shtëpinë e pleqve” - ia këputi ajo.

“Nëna jote kur të dalë nga përralla me çka do të merret?”- vazhdoi me pyetje ujku Volfgang.

“Ajo le të merret me masturbimin e vet në përrallën shtetërore gjermane.” - i skërmiti dhëmbët Helga Hemingen. - “Ngutu me atë makinë të kuqe të na nxjerrësh për dhjetë minuta në aeroportin e Berlinit - jo në aeroportin kryesor. Do të udhëtoj me avion privat”- u mbushë frymë Helga Hemingen.

“Ju, vajzo pasket vendosur të udhëtoni me avion jashtë përrallës, jashtë Gjermanisë” - u ngrys ujku Volfgang

Do të udhëtojmë, po deshe edhe ti, deri në Galile dhe në Jude, për të mësuar nga Rabi Jachamam ben Sakai dhe nga Rebeka e Alamekut se si hyhet në mitrën e gruas. Edhe Mefistoja i Doktor Faustit tok me Sofinë e Bohemisë,sonte do të udhëtojnë tek Rabi Jachamam ben Sakai me të njëjtin avion”- përfundoi Helga Hemingen, me nofkën Kësulëkuqja.

Në sallën e teatrit të fëmijëve të Berlinit u bë zallahi. Fëmijët e shkërmoqën rrëmujën pa marrë vesh kush nëse e pëlqenin këtë përrallë të re të Kësulëkuqes apo e përbuznin. Prindërit e fëmijëve, secili për vete, dëshironin ta braktisnin sa më parë teatrin; t’i shpëtonin fëmijët nga blasfemia morale, po edhe nga sindromi politik.

Rrëmuja valëvitëse nëpër gjysmëterrin e teatrit, jepte shenja të ndryshme të kundërshtisë; sikur disa dëshironin të vazhdojë shfaqja, e disa e përbuznin duke e sharë me tërë mullëzën e barkut.

U dëgjuan zëra:

"Le të thirret policia.Ky është atentat mbi moralin,mbi shtetin, mbi kishën".

Perdja masive ra me shpejtësi gati plandosëse. Në skenë prapa perdes u dëgjuan zëra,kundërshtime,pastaj shtirje me pistoletë. Mbase u dëgjuan edhe fjalët "arrest",Mefisto,Sofi, Rabi, Pocahontas Powhatan …

Nga njëra palë e perdes masive doli një njeri, i cili në skenë u duk tepër i vogël. Zëri i tij erdhi si nga larg, i shpërndarë nga të gjitha anët pa burim të saktë.

Njeriu i vogël u katandis t'ia shpjegojë turmës së trazuar shkakun e gabimit. U përpoq dëshpërueshëm ta shpallë aktin e parë të Kësulëkuqes si një burleskë artistike, si një lloj befasie.

Gjithshka i shkoi kot njeriut të vogël midis dy zhurmave të llahtahtarshme.

Zhuritjes së spektatorëve, të bërë rrokopujë, se kush të ikën më parë nga salla e teatrit dhe asaj rrëmuje, andej skenës, prapa perdes, tek dëgjoheshin kuisje, cijatje, sharje, goditje të shtëna, i erdhi fundi.

Në sallën e teatrit u dukën policët e parë. Gjendja shpërthyese u ngulfat brenda mishit të njeriut. Ajri i sallës së teatrit u lakua. Bëri bark mbi kokat e spektatorëve të llahtarosur. Secili sosh lektiste të mos vërehej nga njerëzit e policisë. Si do të bëhej kjo gjë, kur të gjithë, tashmë të radhitur, duhet të dilnin nga salla duke u përbiruar nëpër shikimin të policisë. Bile ndonjërin e pyesnin me nganjë fjalë, për këtë rast, tepër provokues.

Në anën tjetër të perdes ra heshtja.

45.

Në monitorin e OSCE-së mbeti vetëm salla e zbrazët e teatrit të Berlinit, në gjysmerrësirë.Të pranishmit në sallën e internetit të laboratorit të OSCE-së heshtën.Panë se në teatrin e Berlinit ndodhi diçka e papritur, e rrezikshme. Monitori u shua. Secili pritoi të flasë. Sa më shumë zgjati heshtja nëpër ajër zu të përhapet gjendje mortore, bile zu të pluskojë mbi kokat e të gjithëve.

Duhet shkapërdarë këtë ajër mortor.

"Ajo Helga Hemingen - e ledhatuar me nofkën Kësulëkuqja paskesh provuar të arratiset me atë halldupin- Ujkun Volgang.Policia i zuri në njërin nga aeroportet e vogla të trafikantëve"- e thei heshtjen gjenerali anglez, Xhonatan Sheltoni, jo për të thënë kushediçka.

Megjithatë gjenerali Herman von Urlih u katandis keq. Në kështjellën "Summer of" aty në kopshtin botanik Sofia Löhne i paskesh thënë:

"Sikur të mos ndalonte treni perandorak në Sarajevë. "

"Po ku kishit dëshiruar ju zonjë të kishte ndaluar ky tren perandorak?"- e kishte pyetur gjenerali ashtu shkarazi, vetëm për elokuencë të një zonje të bukur në një ambient aq intim.

"Kisha dëshiruar diçka tjetër për këtë tren perandorak: të shndërrohet si me magji në trenin "Orient Express". Në atë tren aktrohen dashuritë e mëdha"- iu përgjigj Sofia Löhne duke ofsha.

"Nga e dini, Ju Zonjë e lartë, ç'janë ato dashuri të Trenit "Orient Express"?"- e pyeti gjenerali Herman van Urlih.

"Jo zoti gjeneral, mua as që më lejon rangu aristokat të merrem me këtë gjë kaq të ulët"- iu shmang dyshimit të gjeneralit.

"Po përse, zonjë e nderuar, të gjitha gratë, e vendosin nga një ëndërr në djepin e trenit "Orient Express"?"-e provokoi gjenerali austriak Herman vanë Urlih.

"Zoti gjeneral, thonë se me këtë tren paskesh udhëtuar një herë Zatra Aramejase prej Stambollit deri në Trieshtë" - foli si në ëndërr Sofi Löhne e shoqja e Arçidukës Franc Ferdinandit.

"Pastaj ç'u bë me këtë Zatren Armeneje?"-insistoi gjenerali.

"Në pergamenat e Arkivit të Arçidukës - bashkëshortit tim - Franc Ferdinandit,vetëm kaq kam arritur të lexoj.Të tjerat pergamena janë të mbyllura në kasafortë. Atje më ndalohet"- e përfundoi Sofi Löhne duke i nuhatur pyetjet e gjeneralit austriak Herman von Urlih.

"Po sikur të ishte incizuar kjo bisedë intime në kopshtin botanik të kështjellës "Summer of" të Vjenës, sonte këtu në laboratorin e OSCE-së do të teptiste fort keq"-u rrokullis në vetveten e vet gjenerali Urlih, veçan duke e nuhatur prirjen e pashpjegueshme të gjeneralit anglez.

“Të gjitha gratë priren, rrëpimshëm, kah humnera e vetvetes së vet. Në to lëvrinë një zjarr i egër, të cilin duhet mbajtur nën kujdesje për të mos e lejuar të shndërrohet në aventurë, në orgazëm. Ç’arsye patë ajo orrospia e atij Adamit hardall, ta gicë, vetëm ta gicë, atë mollë të pshurrt?”- u rrëmbye gjenerali anglez ashtu siç e kishte parandie Herman von Urlihu.

“Është krejt e natyrës së tij për këtë gjeneral anglez të lozë si macja me miun po qe se e di bisedën time me Sofinë Löhne në kopshtin botanik të kështjellës “Summer of” të Vjenës”- serish u rrokullis në vetveten e vetë gjenerali austriak Herman van Urlih.

Doktori Gryber Sontag e kishte nuhatur rivalitetin e dy gjeneralëve pa e kuptuar shkakun e vërtetë.Shihej qartë se gjenerali anglez e përçmonte si pergamenë të demoduar gjeneralin Herman von Urlih. Bile gjatë një bisede të shkurtër në bufenë e laboratorit të OSCE-së, si tërthorazi, pa iu drejtuar askujt në veçanti gjenerali anglez, Shelton tha:

“Këta historianët trutharë trumbetojnë nëpër historitë e tyre paçavure se Lufta e Parë paska filluar në vagjinën e vajzës së Aleksit, atje në Sarajevë”-duke aluduar qartë në vetë gjeneralin Herman von Urlih.

Koloneli, Gryber Sontag, e dinte se këso pergamenash zyrtare kishte lëshuar nëpër arkivat shtetërore vetë gjenerali Herman von Urlih. Andaj qe shumë e qartë se ku vriste gjenerali Shelton.

Sërish gjenerali austriak, Von Urlih, arriti të heshtë duke lektisur të kalojë pa i rënë ndesh gjeneralit anglez. U mat ta hedhë kuvendin rreth himnit të Sofisë së Haçet Deletës. Edhe në këtë çështjen e himnit të Mitrës së Sofisë kishte rrezik të rënies ndesh midis dy gjeneralëve. Situata qe e tillë. Gjeneralët rrekeshin t’ia hedhin fajin njëri-tjetrit, siç ndodhej me shtetet.

Në ekranin e monitorit u shpalos sërish ajo pamja vjeshtore: një ale parku e reshur gjethesh të verdhemëta kudo.Serish pam-

ja e alesë së brerortë nga gjethet e zvetnuara ia ktheu gjeneralit Von Urlih atë frikën e përmallshme të kopshtit botanik të kështjellës "Summer of"- të Vjenës.

"Helgen Hemingen e kapi policia në një aeroport trafikantësh tok me ujkun Volfgang pak para se të arratiseshin në Jude, tek ai çifuti Rabi Jochanan ben Sakai. Ai çifut e ka marrë liçencën të shesë orgazëm, kudo nëpër Evropë. Nën maskën e Universitetit Çifut në diasporë, ka arritur të depërtojë në përrallat e fëmijëve, në balada… e gjetiu. Tek ajo Helga Hemingen, me nofkën Kësulëkuqja, i ka zgjuar ato menstruacionet e stërkequra, joshëse për atë Ujkun Volfgang, të cilin e pamë pak më parë duke i mbllaçitur këtë menstruacione me mundimin e rrokullisjes së gurit të Sizifit.

Sofinë e Haçet Deletës e ka futur me urdhër të prerë në tendën e Zatres Aramej duke e detyruar të shtrihet mbi mashkullin e panjohur, mbi penisin e tij. E ka detyruar ky Rabi këtë grua të mjerë të bëjë incest me të vëllanë.

Ky është universiteti çifut në Diasporë" - u rrëmbye gjenerali anglez.

"Ne jemi mbledhë në këtë sallë për ta lexuar në monitor versionin më zyrtar të himnit të mitrës së Sofisë së Haçet Deletës"- ndërhyri Koloneli Gryber duke e parë qartë se gjenerali anglez donte të ngrejë akuzë kundër dikujt në laboratorin e OSCE-së.

Gjenerali anglez heshti, paksa i frikësuar nga ndërhyrja e kolonelit Gryber. I dha vetit zor të mendojë se e paskesh tepruar duke akuzuar në ajër.

"Duhet pritur monitorin derisa pergamena ta marrë veten. Edhe pergamena dhe Redalk San Heldiku kur u hap arkivoli patën të ftohtë- u djersitën. Shkronjat e pergamenës së djersitur u dukën të palexueshme. Duhet tharë për t'i përkthyer në akt zyrtar" - sugjeroi si ekspert Kloth Duranti.

Të gjithë, tok, pritën derisa të vijë në vete pergamena e nxjerrë nga arkivoli i Redalk san Heldikut. Në ajrin e dhomës së internetit lëviznin dyshimet, grackat, komplotet, atentatet, spiunimet, përgojimet.

Çdo gjë ishte bërë gati për hiç ose për krejt. Ajri i natës së dymbëdhjetë të qershorit të fundit të shekullit njëzet në laboratorin e OSCE-së, ishte shndërruar në Natën e Shtrigave të Valpurgjisë duke i shpurdhë dëshpërueshëm varret, arkivolet, eshtrat e të vdekurve, mitrat, klitoriset, vaginal, pergamenat, spermat, testiset, penisët...

Po ky njeriu i qershorit të dymbëdhjetë, i laboratorit të OSCE-së ku është sonte në këtë katrahurë midis të vdekurish të palindur, midis dezertorëve, tradhtisë,gjeneralëve,shteteve,moralit, fesë, perëndive, traditës?

Ajri po lëvizte, po lakohej nën peshën e natës së dymbëdhjetë të qershorit të fundm, kur zilja e telefonit cingëroi, mezi nën peshën e heshtjes së gjeneralëve.

Kloth Durante e ngriti kufjen. Qe një informatë e shkurtër.

“Zotërinjtë, derisa të vijë në vete pergamena e himnit të Sofisë së Haçet Deletës do të kalojmë në anën tjetër të laboratorit, tek bëhen eksperimentet e vaksinës gjenetike”-u foli të gjithëve Kloth Durante.

46.

Në dhomën e eksperimentit të vaksinës gjenetike qetësia ngulmonte vullnetshëm gati tek shurdhimi. Po e sundonte ajrin pamëshirshëm. Këtë gjendje të sundimi e gjeten të porsaardhurit. Qetësia u zmbraps e ngacmuar nga ecja dinjitoze e gjeneralëve.

Koloneli, Gryber Sontag, i cili paskesh ardhë paksa më parë, pa ndonjë ceremoni çeli kuvend:

"Zotërinj, eksperimenti i vaksinës gjenetike, mund të thomë pat sukses.

Në të tri epruvetat rezultati qe i njëjtë. Na mbetet vetëm ta demonstrojmë para jush, zotërinj, meqë kohën e kemi tepër të pakët.

Të gjithë heshtën para çastit vendimtar

Koloneli Gryber e futi dorën në epruvetën e parë, mbi të cilën shkruante etiketa: "E filozofëve". Nga fundi i epruvetës e nxori një miush të mbufatur sypërgjakur. E shikoi, duke e peshuar në dorën e mbrojtur me dorashkën laboratorike. Të gjithë e panë miushin e majmur në dorën e kolonelit Gryber.

"Zotërinj"- iu drejtua të pranishmëve koloneli Gryber. - "Ky miush ka arritur të mbijetojë; i ka ngrenë të tjerët miushë, po të llojit të vet. Ky miush është bërë gjenetikisht superekstrakti i llojit. Tashmë do të ushqehet vetëm me mish-in e llojit të vet" - sikur u hutua para vetvetes së vet koloneli Gryber.

Në dhomën e eksperimentit të gjeneve u bë heshtje veshtullore, e kapshme, kudo nëpër ajër. Kishte një frikë të panjohur, sikur papritur doli nga arkivoli një lugat.Të gjithë e ndjenin kutërbimin e rëndë të vampirit.

Papritur, derisa Koloneli Gryber ende e peshonte në dorë miushin e llojit "filozof" u paraqit i mbushur frymë ministri i jashtëm Spiridonis Zevs.

Të gjithë u nemitën. Askush s'e kishte lajmërua ardhjen e tij. Por cili do ta merrte guximin të pyste. Të gjithë e ndjenë diverzionin e tij. Te fundi cili mund të përzihet në punë shtetesh. U përpoqen të duken sa më të përmbajtur.

Pa u përshëndetur me të tjerët iu qas kolonelit Gryber dhe me pasion e shikoi krijesën vampire. Miushi i llojit të superekstraktuar nga nyjëtimi gjenetik i llojit të vet e shikoi më syrin e kallur gjak ministrin Spiridonis Zevs. E njohen njëri-tjetrin.

Kur ministri Zevs e konsideroi të arrirë prototipin, superekstraktin e llojit të "filozofit-miush", urdhëroi të demonstrohet eksperimenti, duke ia bërë drejtpërdrejt kolonelit disa pyetje të përngutshme:

"A ka qëndruar kohë të mjaftueshëm ky miush-vampir në epruvetën e mbyllur?"

"Po, ka qëndruar derisa uria e skajshme e ka nxitur t'i zhvatë të gjitha ekzemplarët e tjerë të miushëve të mbyllur tok me

të në fund të epruvetës” - u përgjigj koloneli Gryberg duke ia shikuar sytë e ndezur miushit të vampirizuar.

“Mjafton aq. Le të demonstrohet eksperimenti!” - urdhëroi prerazi, me tonin e ekspertit të sigurt Spiridon Zevsi.

Koloneli Gryber e kthei miushin e vampirizuar në fund të epruvetës masive duke e lëshuar kujdesshëm. E mbylli epruvetën. Gryber mbeti në atë pozicion, si i mëdyshur.

“Të vazhdojmë zoti Kolonel!”-ndërhyri ministri Spiridon Zevsi.

Koloneli Gruber Sontagu iu qas një epruvete tjetër, metalike, në një kënd të pezulit të dritares. Sikur në rastin e parë e futi dorën në epruvetë.U dëgjua cijatja e miut. Sigurisht koloneli Gryber duke mos e pa në epruvetën e errët e shtrëngoi e miushin më shumë, mbase duke i shkaktuar dhimbje.

E nxori nga epruveta metalike. Ishte një miush i zakonshëm, i frikshëm. Koloneli e mbajti në dorë për disa çaste duke ua treguar të pranishmëve derisa e konsideroi ekspozim të mjaftueshëm.

Pasi e hapi epruvetën masive të “miushit filozof”, koloneli Gryber e futi dorën deri në fund të epruvetës, tek e lëshoi miushin e rendomtë pranë miushit- vampir. E heq dorën shpejt duke e mbyllur epruvetën me kujdes.

Të dy miushët qëndruan ballëpërballë duke e nuhatur njëritjetrin. Të gjithë të pranishmit iu qasën epruvetës me kureshtje. Në fillim u duk sikur miushët në fund të epruvetës u “morën” vesh midis tyre. Ministri, Spiridonis Zevsi e zvogëloi shikimin e vet. U bë një zhgrehje zhgënjyese. Të gjithë priten ta thotë ndonjë fjalë të pavend në këtë çast.

Gati kishte arritur çasti i dëshpërimit kur në fund të epruvetës ndezi eksperimenti.Krejt në mënyrë të qetë “Miushi-filozof” iu hodh miushit-viktimë.E zhvati për një çast më uri vampiruese, me aq pedanteri sa i la pa mend të pranishmit.

Në dhomën e eksperimentit të vaksinës u bë heshtje ngadhënjyese, e ftohtë, e frikshme. Secili e ndjeu në mishin e trupit të vet shkoqjen. Secili e pa tek ai tjetri atë superekstraktin e vampirosur i cili e mbron vetveten e vet biologjike duke e zhvatur mishin e llojit të vet.

Ministri, Spiridonis Zevsi e thei heshtjen metalike.

"Eksperimenti ka dhënë sukses të plotë. Gjakun e miushëve të vampirosur do ta shndërrojmë në vaksinë, hiç më larg se sonte. Me ketë gjak të vampirosur do t'i vaksinojmë të gjithë pushtetarët. Këta pushtetarë të vampirosur do t'i hanë kundërshtarët politikë. Në këtë mënyrë pushteti do të mbetet për-herë në duarë të sundimtarëve që e hanë mishin e llojit të vet"- foli me sovranitetin hyjnor për eksperimentin ministri Spiridonis Zevsi-"Tashmë le ta hapë, pas dy orësh, takimin e këshillit të Lartë të NATO-s ajo Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatan e atij gjeneralit amerikan,John Harherit të Massachusettsit. Vaksina e nxjerrë nga gjaku i miushëve të tipologjizuar gjenetikisht do të aplikohet së pari tek ne, pastaj tek të tjerët!- vazhdoi triumfalisht ministri Spiridon Zevsi.

"Zoti ministër!"- ndërhyri gjenerali anglez.- "Si do ta fillojmë vaksinimin kur ende kemi për ta testuar atë epruvetën e dytë me tiketën "miushi-ushtar" Ne e krijuam gjenetikisht gjakun e vampirosur të Sundimtarit por duhet ta krijojmë edhe gjakun e vampirosur të Ushtarit. Cili ushtar do të mbrojë shtet pa e ngrënë mishin e llojit të vet, mishin e ushtarëve dezertorë. Miushët-ushtarë i përkasim epruvetës së dytë" - ankoi gjenerali anglez.

"Sipas shtetit të modeluar politikisht, suksesi në këtë laborator tregon arritjen më të lartë të inzhinieringut gjenetik. Platoni vetëm e ka projektuar llojin teorik të shtetit.Në këtë laborator është realizuar gjenetikisht shteti. Tashmë do të vaksinohen sundimtarët dhe ushtarët. Ata do të seleksionohen sipas kënetës së ngrohtë të Darvinit. Secili do ta hajë mishin e llojit të vet.

Vetëm në këtë mënyrë do të ruhet shteti tradicional evropian i llojit të Platonit-Sokra. Kur secili i frikësohet secilit njerëzit nuk do ta njohin njëri-tjetrin.Do ta njohin vetëm shtetin, pushtetin, zotin. Dhe në këtë mënyrë sonte, kot do t'ia çatisë ajo Indigjenia Pocahontas me atë Megaorgazmën amerikane antitradicionale"-ia këputi ankesën gjeneralit anglez ministri Spiridonis Zevsi.

"Tashmë do ta kemi spiunin biologjik i cili përherë do të jetë i uritur për mishin e llojit të vet"- berbëliti gjenerali anglez.

"Ju, zotëri, i keni provuar edhe dy ekzemplarët e tjerë?" - ministri Spiridanis Zevs e pyeti Kolonelin Gryber Sontag pa ua vënë veshin bërbëlitjeve të gjeneralit anglez.

"Po, zotëri, i kemi provuar po me këtë saktësi. Ja ku e keni raportin e ekipit të laboratorit të OSCE-së. Ka mbetur të firmoset vetëm edhe nënshkrimi juaj zotëri"- iu drejtua koloneli Gryber ministrit Spiridon Zevsit duke e demantuar gjeneralin anglez.

Ministri ia kërkoi Gryberit raportin e laboratorit të OSCE-së. E lexoi me vëmendje të përqendruar. Shikimi vinte e sa po i vezullohej deri në lumturi. E vuri në tavolinë raportin. Triumfalisht nënshkroi në të gjitha faqet e raportit po, edhe në të gjithë ekzemplarët.

"Koha është shumë e shkurtër zotëri. I kemi vetëm edhe dy orë deri në takimin e këshillit të lartë të NATO-s. Po na zuri të papërgatitur ajo kurva indigjene Iroki, Pocahontas Powhatani e atij gjeneralit pizeveng të Massachusettsit e pat puna jonë, e pat tradita hyjnore e arianizmit të Evropës.

Ju zotërinj e patë në monitor se ç'ngjau para dy orësh në teatrin e Berlinit. Ju zotërinj të nderuar e keni lexuar nëpër pergamena zyrtare se drejt Evropës po vjen uragani i Orgazmës amerikane.Se drejt Evropës po vjen ai Jezusi i ashtuquajtur ekologjik. Se mitrat e grave kanë zënë të stërkeqen për atë spe-

rmën kutërbuese të çifutëve. Ne sonte nga ky laborator do t'ja kthejmë dinjitetin Evropës nëpërmes spiunit gjenetik. Evropës do t'ja kthejmë masturbimin e Zeusit hyjnor"-u kall në vetveten e vet ministri Spiridon Zevsi.

Të pranishmit i zuri letargjia.

"Vetëm koloneli Gryber vazhdoi të merret me epruvetat masive. Si qëllimisht e plagosi heshtjen letargjike.

Ministri Spiridon Zevsi, me zë, zbritur nga ekstaza triumfaliste, serish e mori nismën:

"Zotërinj, meqë kohën e kemi shumë të pakët, siç e kishit në mendje, duhet të kalojmë në dhomën e internetit për ta lexuar atë pergamenën e himnit të mitrës së Sofisë së Haçet Deletës. Sonte duhet lexuar çdo gjë rreth mitrave të grave tek po lëvrinë orgazma e rrezikshme nëpër Evropë"-foli vendosmërisht ministri Spiridonis Zevs.- "Ai zotëria i mençur, gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi atje në atë Jakovën e Jerusalemit, jo vetëm se po i lexon pergamenat e falsifikuara por ai mendjehollë po i hap mitrat e grave të reja për ta zbuluar spermën e atij burrit të panjohur të tendës së Zatres Arameje. Kush nga ne e di apo e ka lexuar nëpër pergamenat zyrtare se me cilin burrë u shkërdhye ajo kurva e Jakovës së Jerusalemit. Disa pergamena thonë se ai burrë lakuriq në tendën e Zatres Arameje qe Redalk san Heldiku, arkivolin e të cilit e nxorët paksa më parë nga varri, e në pergamenat e tjera thotë se ai burrë i lakuriqur në tendën e Zatres Armeje qe i vëllai i vet Sofisë së Jakovës së Jerusalemit" - mori flakë serish ministri Spiridon Zevsi.

"Zotëri ministër, gjenerali rus, Ivan Vesiljeviq Kutazovi, na dëboi ne, të gjithë evropianët, nga Jakova e Jerusalemit, këtej kufirit, në këtë Shqipërinë e Albanikut sovjetik" - ankoi gjenerali austriak Herman von Urlih.

"Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, pasi e pa në monitor se ç'ju ngjau juve në teatrin e Berlinit, me të drejtë, ju dëboi nga Jakova e Jerusalemit" - qortoi ministri Spiridonis Zevsi.

“Mbase,gjenerali rus do të zbulojë në mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit më shumë se ç’mund të kishte zbuluar gjenerali austriak, Herman Von Urlihu.Kur e ndanë përgjysmë Rektorin-Redak san Heldikun,në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit, gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi e mori llurbën e testiseve dhe penisit të Rektorit. Gjenerali austriak Herman von Urlih e mori të tërin trupin eunuk të Rektorit-Radalk san Heldikut. Se cili do të arrijë më parë, më thellë në mitrën e grave të Jakovës së Jerusalemit, një zot e di”-u qesëndis gjenerali anglez, Shelton, jo vetëm me gjeneralin austriak po edhe me vetë ministrin Spiridonis Zevsin.

Ministri e kuptoi qesëndinë e gjeneralit anglez pa arritur të vendosë se ç’reagim të bëjë. Më në fund mori qëndrim të tërthort për t’iu përgjigjur gjeneralit anglez.

“Në mitrat e këtyre grave të Jakovës së Jerusalemit është vështirë ta godasësh spermën-fetus të Redalk san Heldikut. Këto mitra janë ende mish gaulli, i pabërë. Të gjitha këto mitra po çelen sonte, për ta kapur mitrën e asaj Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, e cila, siç shkruan në pergamenat zyrtare e paskesh rrëmbyer orgazmën mbi penisin e atij burri të lakuriqur në tendën e Zatres Arameje. Po të ketë qenë incest…” ndaloi sikur i sosur, ministri Spiridonis Zevsi.

“Pergamena e nxjerrë nga arkivoli i Rektorit Redalk san Heldikut, posa doli nga ngrohtësia e varrit u djersit; u bë e palexueshme. Tashmë është tharë. A mund ta lexojmë në monitor” - Kloth Durante i ndërhyri ministrit Spiridon Zevsit.

“Nga e dini Ju zoti Kolonel se personi i nxjerrë, sonte nga arkivoli na qenka Rektori i Jakovës së Jerusalemit Redalk san Heldikut e jo dikush tjetër?”- e provokoi ministri Kloth Duranten.

“Ju zoti ministër mund të keni mendim tjetër rreth personit të nxjerrë nga arkivoli?”- e pyeti Kloth Durante sikur të mos kishte njohuri se në kend dyshonte ministri Spiridonis Zevsi

“Po mund të jetë dikush tjetër nga Rektori san Heldiku” - foli përqartas ministri.

“Ju zoti ministër sikur prireni drejt shkarrëzinës fatalisht. I pasket harruar fjalët Tuaja të pakmëparshme se në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit, gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi dhe gjenerali austriak, Herman van Urlih e ndanë dysh Redalk san Heldikun; secili duke e marrë pjesën e vet jo nga dikush tjetër. Edhe gjenerali Juaj, Ivan Vasiljeviq Kutozovi edhe aleatja jote Rusia e kanë pranuar për Redalk san Heldik jo për dikend tjetër.” - e ashpërsoi zërin koloneli Kloth Durante.

“Jo, zoti kolonel, shumë mirë, bile më mirë se ç’mendoni Ju i kam mbajtur mend fjalët tuaja rreth personit nga arkivoli. Dhe do t’i mbaj mend edhe këto të cilat po i flet dhe po i pranon si të tuajat. Mbase edhe këta të tjerët mendojnë si Ju zoti kolonel” - ironizoi me shantazh ministri.

“Atëherë, zoti ministër, në këtë arkivol është personi i quajtur Redalk san Heldiku. Me këtë emër e sollën nga Turqia tek aeroporti i Jakovës së Jerusalemit.Kështu i shkruan në raportin zyrtar të nënshkruar nga zyrtarë të lartë: gjenerali turk Jollmaz Kadirogllu, nga gjenerali austriak Herman van Urlih, ambasadori austriak në Stamboll, Shtefan Henke, gjenerali i dytë turk Gyner Jyllmaz, kryeminstri turk Tursun Kuturler dhe gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi”- i theksoi të gjithë emrat dhe titujt njënganjë Kloth Durante.

“Po si e kuptuan këta titullarë se ai person i tendës së Zatres Arameje na qenka pikërisht Redalk san Heldiku?”- u hetua pasiguria në zërin e ministrit Spiridonis Zevsit.

Kloth Durante e nuhati se tek ministri zu fill pasiguria; se e pati të zorshme t’i sfidojë të gjithë këta titullarë. Atëherë Kloth Durante e bëri goditjen përfundimtare.

“Zotëri ministër, Ju mbase, sipas rregullës diplomatike, e përcillni mendjehollësisht buletinin e çdoditshëm të pergame-

nave zyrtare, herë sekrete, herë gjysmësekrete të shërbimeve informative. Mbase Lartësia Juaj do ta ketë lexuar në buletinin e sontem se në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit, kur dy shtete, bile perandorake, e ndanë në dy pjesë Redalk san Heldikun nënshkruan në raportin zyrtar, secili për pjesën e vet të pranuar.

Ju zoti ministër sikur nuk i besoni qeverisë turke, nuk i besoni xharahut turk Edeler Sherhafudinit, nuk i besoni çjerrjes së san Heldikut në haremin e sulltanit kur u bë vigmë:" Do t'i jepja të gjitha xhamitë vetëm për një penis e një parë testise!"

Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutazovi, bashkë me mjekun e shtabit ushtarak, kolonelin Makushev, nënshkruan tekstualisht:

"Unë gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi, komandant i krahut jugor të ushtrisë së perandorisë ruse për Ballkanin nënshkruaj, sonte, natën e dymëbëdhje të qershorit të sprasëm të shekullit njëzet se i pranova në gjendje të rregullt për përdorim testiset dhe penisin e rektorit të Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldikut"- ia lexoi fjalëpërfjalë raportin koloneli Kloth Durante.-"Në këtë pergamenë zyrtare, të vulosur me vulën perandorake të Peterburgut,është nënshkruar në dritën e reflektorëve të aeroportit të Jakovës së Jerusalemit edhe mjeku ushtarak, koloneli Sergej Makushevi, i plotfuqishëm"- e mbylli bisedën koloneli anglez Kloth Durante.

Koloneli Lipman Smith duke e parë se kuvendi vajti tek pika e nxehtë propozoi të kalojnë në dhomën e internetit.

Të gjithë, heshtazi kaluan atje.

Në monitor ende po farfurinte ajo pamja brerore e vjeshtës në alenë e një parku vjenez. Gjenerali austriak, Herman von Urlih, gati e njohu këtë ale si në një ëndërr të largët, të verdhur pamëshirshëm nga koha.

Të gjithë qëndruan në këmbë sikur përnguteshin ose e kishin të zorshme t'u zinte vendi vend. Të largtë në vetveten e tyre i rrëzuan shikimet na atë pamje vjeshtore kur papritur ekrani u

errsua. U bë frymëmarrje e çrregulluar. Edhe ajri u hutua për një çast.

Në ekran u fiksua ngadalë, zorshëm, titullimi, i përkthyer, kushedi nga cila gjuhë në anglishte:

"Himni i mitrës së Sofisë së Haçet Deletës:

Prostitutë, vrastare - e ndjeva
E nxehtë në mitër sperma e burrit
Ta vrasin spermën në mitër - deshën
Babain tim, Burrin tim, Birin tim, Vëllain tim
Sa ftohtë qenka jashtë mitrës
Farë e ngjizur në mishin e mishit tënd
Mish i pandarë në Babë, Bir, Vëlla …
Sa ftohtë qenka jashtë mitrës…

"Kush foli në Himnin e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit?" - pyeti me padurim ministri grek Spiridonis Zevsi.

Heshtja e të tjerëve i ra fytyrës ministrit të përngutur. Mbeti përballë kësaj heshtjeje të vagëlltë i papërgatitur. Deshi të dalë nga atje mbase edhe me humbje.

"Atëherë në himnin e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit po flitka gjithkush: menstruacionet, mitra e pabërë, incesti, babai, biri, vëllai, orgazma,vagjina, penisi.Po ipka kumt edhe ky burrë nga arkivoli me gjuhën e zgjatur helm të orgazmës nga tenda e Zatres Armeje!" - u zgjat në vetvete ministri Spiridon Zevsi.

"Mund të dëgjohet çdo gjë, mund të shkruhet çdo gjë por edhe mund të flitet çdo gjë. Ky himn mbetet krejt figurativ pas atyre nënshkrimeve aq zyrtare në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit kur dy perandori e ndanë në dy pjesë trupin e Red-alk san Heldikut"- iu kundërvu koloneli Gryber zemërimit të ministrit Spiridon Zevsit.

Ministri e përplasi shikimin pezmatik mbi uniformën e kolonelit Gryber pa e bërë mundimin ta frenojë zemërimin. Bile u mundua t'i japë fytyrës një shprehje përbuzëse.

"Zoti kolonel, profesioni, ngritja arsimore, po dhe edukata, do të ju këshillonin t'i përcillni me përkushtim pergamenat zyrtare të të gjitha buletineve e jo vetëm çka juve ju pëlqen.

Në Buletinin e ditës së tetëmbëdhjetë të prillit të vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një,të po asaj mbrëmjeje shianike prilli, shkruan se Sofia e Jakovës së Jerusalemit e tak-oi të vëllain, Kostantinin"- furia e ministrit Spiridon Zevsit kaloi përtej kolonelit Gryber.

Jo vetëm koloneli Gryber, mbase i nemitur por heshti e gjithë eskorta e personelit ushtarak të laboratorit të OSCE-së.

"Ju zotëri i nderuar e paskeshit lexuar në buletinin e mbrëmjes së tetëmbëdhjetë të prillit shianik të atij vitit, njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një, fjalëpërfjalë :

"Konstantini i Haçet Deletës e kaptoi ilegalisht kufirin Shqipëri të Albanikut sovjetik-Jakovë e Jerusalemit dhe është takuar po në Jakovën e Jerusalemit me të motrën-Sofinë e Haçet Deletës".

Ky Buletin doli këmbë e krye i gënjeshtërt. Në arkivolin e këtij burri, me emër e mbiemër të Radalk san Heldikut, bashkë me himnin e mitrës së Sofisë së Haçet Deletës u gjet edhe pergamena e vërtetur nga dy klinikat më të shquara të Evropës me diagnozën: "Sangius Lacertae in utero" çka në gjuhën tuaj zoti ministër dhe në gjuhen time do të thotë "gjak hardhuce në mitër" - e rrafshoi kuvendin koloneli Gryber.

"Për mitrën e kujt flitet në këtë pergamenë, të falsifikuar?" - u zgjat ministri Spiridonis Zevsi.

"Flitet për mitrën e Teutës së Haçet Deletës- të ëmës së Sofisë" - u përgjigj koloneli Gryber

“Me këtë diagnozë, zoti Kolonel ju thoni se mitra e gruas bëhet beronjë për jetë të jetës, se kjo mitër nuk mund të rrisë fëmijë? Por unë Ju pyes përse të ketë hyrë kjo pergamenë në arkivolin e Redalk san Heldikut dhe kush e futi atje?”- pyeti me padurim ministri Spiridon Zevsi.

“Po zotëri ashtu them. Kush tjetër përveç se Rusia, Turqia dhe Austria”- u përgjigj ushtarakisht koloneli.

“Po kjo Sofia e Haçet Deletës vajzë e kujt na qenka?”- i plasi sarkazma nëpër të gjithë zërin ministrit Spiridon Zevsi.

“E besoni ju, zoti ministër se Haçet Deleta ishte masturbuesi më i shquar i Evropës?” - e pyeti Koloneli

“Po ishte i tillë”

“Si mund të kishte fëmijë masturbuesi - Haçet Deleta?”

“Në mitër bën punë sperma e çdo çifuti hardall”- ironizoi ministri

“Por jo në mitrën me diagnozë “Sangius Lacertae in utero”

“Atëherë Ju zoti kolonel, thoni se të dy: Teuta dhe i shoqi, Haçet Daleta, kanë qenë të privuar të kenë fëmijë” - ra në mëdyshje ministri Spiridon Zevsi.

“Ashtu mendojnë të gjithë zoti ministër”- i foli qetas Koloneli.

“Atëherë,zoti kolonel, cilin e lypni ju në këtë arkivol?”-pyeti ministri.

“E lypim të mundshmen, zoti ministër. E lypim rektorin e Jakovës së Jerusalemit-Radalk san Heldikun”-e saktësoi koloneli.

“Përse, zoti kolonel e testuat Sofinë e Haçet Deletës mbi të dy varret: mbi varrin e Kostatinit të Haçet Deletës dhe mbi varrin e Radalk san Heldikut”- zhbiroi ministri Spiridon Zevisi.

“Sepse zoti ministër para pak çastesh mendonim edhe ne në incest, ashtu siç po mendoni ju ende”- e qesëndisi me finesë koloneli.

“Po kjo Sofia e Haçet Deletës mbi varrin e Kostantinit të Haçet Deletës reagoi trishtueshëm; u zhvesh mishit të vet gaull. Pastaj ajo u çjerr kundër gjithë botës me fjalor kolhozesh e gullagësh rusë” - u relaksua paksa kryeministri.

“Në këtë Shqipërinë e Albanikut sovjetik, të vaksinuar me “Sangius lacertae in musculo” dhe me “Sanguis lacertae in cerebro” nga doktorët rusë e kinezë, çdo grua, e jo vetëm mishi gaull i Sofisë së Haçet Deletës do të reagonte ashtu”- foli me zë prej shkencëtari koloneli Gryber

“Atëherë ekspedita juaj, zotëri kolonel duhet të jetë më e qartë. Ç’ju hyn në punë trupi eunuk i Rektorit- Redalk san Heldikut? Përse këtë grua do ta dërgoni sonte në klinikën “Gemeli” të Romës?”-u bë sikur donte të mësonte diçka të re, të panjohur, për veten ministri Spiridonis Zevsi.

“Ne, zoti ministër domë të mësojmë nëse kjo grua mos e ka arritur atë orgazmën e mallkar në tendën e Zatres Arameje kur ai çifuti Rabi Jachanon ben Sakai e urdhëroi të bie mbi penisin e këtij burri të shtrirë në këtë arkivol. Për ne, ai Konstantini i Haçet Deletës është vetëm një skelet i rendomt i Shqipërisë së Albanikut sovjetik, një nënshtetas i vaksinuar me “Sangius lacertae in musculo-in cerebro” Prandaj të them se ajo pergamena për takimin e Sofisë me të vëllëin, Kostantinin e Haçet Deletës, atë natë shianike prilli të njëmijë e nëntëqindenëntëdhjetëenjëshës doli të ishte e falsifikuar.”- foli përbuzshëm koloneli Gryber.

“Po nëse gjenerali austriak, i pranishëm sonte këtu, i ka parë testisët dhe penisin e Radalk san Heldikut a mund ta konstatojë se me atë penis ka mundur ta arrijë orgazmën Sofia e Haçet Deletës në tendën e Zatres Arameje, e rënë mbi mishin e burrit të panjohur?”- e provokoi ministri Spiridonis Zevsi gjeneralin austriak Herman von Urlihun.

Gjenerali austriak heshti dinjitetshëm duke i dhënë të kuptojë ministrit, Spiridonis Zevsit,se e kishte marrë rolin e një dhas-

kali të një famullie të varfër fshati.E gjithë eskorta e ushtarakëve të laboratorit të OSCE-së mori papritur qëndrim serioz ndaj ministrit trazovaç. Roli i tij prej hetuesi u bë i neveritshëm për stafin e laboratorit.

Gjenerali Urlih kishte mbetur përtej ëndrrës midis gjumit dhe asaj gjendjes tjetër. I erdhi zvetnueshëm se e kishte dashur Sofinë Löhne-të shoqen e Arçidukës Franc Ferdinandi se kishte bërë seks me të. Për çudi ajo Sofi Löhne seksin e gjeneralit Herman von Urlih e shpalli masturbim. Mbase ka folë plaga në ballin e saj.

"Zoti gjeneral"- e pyeti Von Urlihun gjenerali anglez duke e bërë të shukatë ministrin Spiridonis Zevsin - "Si mendoni ju se mishrat gaulle të Sofisë së Haçet Deletës dhe të Redalk san Heldikut ta kenë arritur atë orgazmën e rrezikshme? Gjenitalet e tyre sipas pergamenave zyrtare qenë vetëm bulëza të mishit gaull të mbyllur në guacën e Jakovës së Jerusalemit nga katër perandori, gjeneralët e të cilave edhe sonte e mbajnë të mbyllur hermetikisht këtë qytet. Si mund të arrijnë orgazëm mishrat gaullë të Jakovës së Jerusalemit?"- gati hidhërimshëm vazhdoi gjenerali anglez.

"Në disa pergamena, veçan në pergamenat e Knesetit të Madh të Jerusalemit shkruam se Rabi Jachanan ben Sakai në fillim ishte i privuar si të gjithë çifutët nga përjetimi i orgazmës.Natën kur u arratis nga Jerusalemi për të kërkuar azil në tendën e gjeneralit romak Titi, e humbi davanë, e humbi tendën. U sorollat nëpër shkretëtirë duke mohuar çdo gjë të Izraelit. Ai duhej shpëtuar nga vdekja heroike. Duhej shpëtuar edhe nga varrosja në mitrën e kones së Danielit. Maria Magdalenë dhe Zatra arameje e zgjuan orgazmën tek Rabi. Vetem me orgazëm mund të hynte në mitrën e Rebekes së Alamekut. Ai ishte i përgatitur për këtë Orgazëm ose ndryshe do ta pranonte detyrimisht mishin kones së Danielit.Eci atë natë nëpër shkretëtirën

e Negevit deri para mureve të Jakovës së Jerusalemit”- vazhdoi gjenerali austriak Herman von Urlihu.

“Qenka pergamenë e koklavitur ajo e Knesetit të Madh të Izraelit. Ç’punë ka ajo pergamenë me orgazmën e Redalk san Heldikut?” - u nevrikos gjenerali anglez.

“Zotëri gjeneral, ju si gjithë tjerët e keni lexuar pergamenën e Knesetit të Madh sipas të cilës Rabi Jachanan ben Sakai dënohet të varroset i gjallë, në mitrën e kones së Danielit…”- e shikoi në sy me shikim pyetës gjenerali austriak.

Gjenerali anglez,heshti disi i përhumbur.Vetëm e lëvizi kokën me një shenjë të turbulltë sikur njeriu provon, pa sukses, të mësojë diçka të panjohur.

Derisa gjenerali anglez u pra, i heshtur, të tjerët e panë të rrugës të mos flasin. Kishte një hamendje midis të të gjithëve, një frikë kontinentale kundrejt një rreziku të padukshëm e të pranishëm kudo.

“Amoku e solli Rabi Jachanon ben Sakain deri buzë Jakovës së Jerusalemit,siç e quajti gjenerali Titi kur e pa në flakë.Një stërkalë e kumtit të Rabi Jachanan ben Sakait ra në mishin gaull të Jakovës së Jerusalemit krejt tinës katër gjeneralëve rreth qytetit.

Radalk san Heldik erdhi duke u bërë nga mishi gaull. E ndjeu në mishin e vet kumtin e Rabi Jochanan ben Sakait. Ishte njeriu më i shkolluar në qytet. Doli jashtë veshtullisë së qytetit i grishur prej kumtit të Rabi Jachanon ben Sakait.

Mbi jakovën e Jerusalemit erdhi vegim i zvargur kumti i Rabi Jochanan ben Sakait. Redalk san Heldiku e zuri kumtin. I joshur nga zëri i Rabi Jochanan Sakait rrugëtoi deri në shkretëtirën e Negevit. E dëgjoi zërin e Rabis:

“O Redalk san Heldik arratisu nga mishi yt gaull, nga mishi yt veshtullak kurrë i pabërë! Nisu rrugës së seksit, të klitorisit, të orgazmës. Gjeje një mitër gruaje, një klitoris, një vagjinë, një

orgazëm, shpëtoje atë llurbë mishi të qytetit tënd ende pa e rysur në mitrën e kudrës së masturbimit evropian!"

I grishur nga ky zë i Rabi ben Sakait, Redalk san Heldiku e zu rrugën për Galile e Jude. Diku në shkretëtirën e Negevit e kapi ushtria turke." - e vazhdoi koloneli austriak Herman von Urlihu përtej fyerjes së ministrit Spirdonis Zevsit.

"Dhe ne sonte po e verifikojmë nëpër këto varre të kësaj Shqipërie të Albanikut sovjetik, të vaksinuar me:"Sangius lacertae in musculo-in cerebro"nga gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi se me cilin bëri seks Sofia e Haçet Deletës në tendën e Zatres Arameje, me të vëllain, Kostantinin apo me Redalk san Heldikun. E gjithë Evropa sonte do të shastisej nga gëzimi sikur në tendën e Zatres Arameje të kishte ndodhur incesti.Atëherë sonte, pas dy orësh, Indigjenia Iroki, Pocahontas orgazmën amerikane të inisiativës së lirë do ta mbëltonte në incest. Do të dështonte në Jakovën e Jerusalemit. Por në qoftë se Sofia ka bërë seks me këtë Redalk san Heldikun fetusi do të dalë i aftë ta pranojë orgamën amerikane të inisiativës së lirë. Dhe të bëhët një eksperiment kaq i rrezikshëm kaq afër Evropës, Ju zotëri e kuptoni se çdo të thotë kjo?"-ndërhyri koloneli Lipman Smith sikur të qenë marrë vesh midis tyre për t'ia marrë vetveten e vet ministrit Spiridonis Zevisit.

"Të njëjtën gjë si ne, por me testiset dhe penisin e Redalk san Heldikut, e bën sonte në Jakovën e Jerusalemit gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi. Ai i çel mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit për ta gjetë spermën-fetus të Redalk San Heldikut. Ne i hapim varret, e hapim arkivolin e San Heldikut për ta testuar mitrën e Sofisë së Haçet Deletës. Krejt të njejtën gjë. Po na dështoi neve dhe atij gjeneralit rus atëherë ajo Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatani e gjeneralit amerikan John Harkerit të Massachusset në mitrën ekologjike të Sofisë së Haçet Deletës do ta rysë dashurinë, do ta rysë orgazmën e Jezusit të saj ekologjik Iroki të Massachusset"–von Urlih foli me kompe-

tencë nga përvoja e vet me Sofinë Löhne atje në Kështjellën "Smmer of."

"Tashmë po kuptoj pse ju evroperëndimorët po tregoheni kaq mendjerrallë. Indigjenia Iroki dashka ta rysë, për fillim, Jezusin e saj ekologjik në mishin e mitrës ekologjik të Jakovës së Jerusalemit?Në mishin arketiptë këtij qyteti Jezusi i saj zë më së miri. Ta mbëltojë Jezusin e saj ekologjikë në këtë mish mitre ekologjike, siç e mbëltoi në mishin arketip të Irokit të vet të Massachusettsit ajo e sheh punë të suksesshme. Në të gjitha pergamenat, të cilat i keni parë e lexuar, të gjithë ju zotërinj të nderuar, shkruan se Indigjenia Iroki e qulli Biblën dhe Jezusin e saj ekologjik me lëngun e vagjinës, të orgazmës së egër Indigjene. Sa mund ta marrim për ekologjik një Jezus të qullur me sekretimin e vagjinës së një gruaje të eger indigjene? Ma thuani zotërinj të mendjes së ndritur evro-perendimore! E dini, zotërinj të nderuar, se Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatan e gjeneralit John Harkerit të Massach-usettsit e ushqei këtë gjeneral pizeveng me tri lloje të ushqimeve jashtëbiblike:me qumësht të misrit, me qumësht bizoneshas, me qumësht të gjirit të saj ekologjik.Ajo e yshti gjeneralin ekologjik, atë pizevengun, John Harkerin e Massachusettesit, ta mohojë Evropën, bile thënë më qartë, e bëri armik të kësaj Evrope treadicionale. Ajo kurva Iroki-Pocahontas Powhatan e gjeneralit amerikan John Harkerit të Massachusettesit, Jezusin evropian e ka shpallur Jezus qenquistador,Jezus Macho Pancha, Jezus rjepc, i cili me machetë ua heq testiset dhe peniset të gjithëve kur mendojnë ndryshe nga vetë ai qonquistador.

Pocahontas Powhatan e ka menduar shumë gjatë, zotërinj të nderuar. Për Jezusin e saj ekologjik e ka zgjedhë mishin ekologjik të Jakovës të Jerusalemit tek gjellon mishi gaull - primitiv, pa asfarë identiteti të qytetrimit evropian. Vetëm këtu, në Jakovën e Jerusalemit, sa për fillim, mund të mbëltohet fara e Jezusit ekologjik, primitiv, e atij Jezusit të egër Iroki, të Pocah-

ontas Powhatanit të gjeneralit,John Harkerit të Massachusettsit.

Pastaj do të shihni vetë, zotërinj mendjelartë, siç e patë se ç'ndodhi në teatrin e Berlinit, në teatrin e fëmijëve dhe në teatrin e të mëdhenjve. E patë zotërinj të nderuar se ç'i ndodhi Gertrudës së ndershme në shkollën Çifute, në atë Universitetin Çifut të Diasporës së atij çifutit Rabi Jachanan ben Sakait? Gertrudën e ndershme e dhunoi vetë Rabi Jachanon ben Sakai.

Zotërinjë mendjelartë, i kemi vetëm edhe dy orë për të ndërhyrë në orgazmat e Shtatëmbëdhjetë minutave indigjene të këtyre mitrave ekologjike të paqytetruara.

Më çuditë fakti se si ju zotërinjtë evroperëndimorë reagoni kaq plogshëm kur gjenerali rus,Ivan Vasiljeviq Kutozovi,me aq mundim e pedanteri po i çel mitrat primitive të grave të Jakovës së Jerusalemit, për ta gjetur spermën-fetus të atij Redalk san Heldikut. Po arriti gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, siç arriti në Shqipërinë Albanike, ta rysë në mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, në fetusin e saj, vaksinën "Sangius Lacertae in utero, in musculo, in cerebro" para se të kalojnë dy orë, do ta shpëtojë Evropën Tuaj të qytetruar nga Jezusi i orgazmës amerikane të asaj Indigjenes Iroki-Pocahontas Powhatan të atij gjeneralit amerikan John Harkeri të Massachusettsit …" kishte marrë flakë ministri Spiridonis Zevsi, sikur, me mundim, të mos i kishte ndërhyrë gjenerali anglez Xhanatan Sheltoni.

"Gjenerali rus Ivan Vasijeviq Kutozovi, para dy orësh e dëboi nga Jakova e Jerusalemit misionin e OSCE-së. Afati i largimit tonë nga Jakova e Jerusalemit qe shumë ultimativ, i shkurtër, vetëm një orë. Misioni i OSCE-së, siç po e shihni zotëri mendjendritur, kaloi në Shqipërinë e Albanikut sovjetik …" deshi të vazhdojë gjenerali anglez po mos t'i ndërhyri ministri Spiridon Zevsi.

"Zotëri gjeneral, misioni i OSCE-së në Jakovën e Jerusalemit është sjellë tepër plogësht aq sa gjeneralin rus Ivan Vasi-

ljeviq e ka penguar në punën e tij finesë. Ju zotëri me qëllim apo pa qëllim keni rënë ndesh me synimet e gjeneralit rus" - e qortoi ministri Spiridon Zevsi.

"Zoti ministër"- e ngriti zërin gjenerali Shelton duke ia bërë me gisht qortues.-"Mbajeni vath në vesh se gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi,nëpërmes doktorit Makushev të Kolhoz-eve gullage, po e përdor metodën e muzhikëve rusë. Ai doktori Makushev po e futë dorën deri tek mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit për t'i shkatërruar Shtatëmbëdhjetë minutat e mitrës së Sofisë. Me konventë ndërkombëtare kjo metodë primitive është e ndaluar. Ne e kemi lajmëruar gjeneralin rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovin se Sofinë, mbase të Jakovës së Jerusalemit, e kemi këtu në misionin e OSCE-së. Ai gjenerali rus, përkundër konventave ndërkombëtare po e përdor metodën e muzhikut Makushev për t'i shkatërruar të gjitha mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit. Ai gjeneral, sipas urdhrit të qeverisë së vet, synon t'i zhbëjë të gjitha mitrat e këtij qyteti para se t'ia çatisë Indigjenia Iroki me atë inisiativën e lirë amerikane"- e kërcënoi gjenerali Shelton.

"Në ngutjet e tilla, siç i ndodhi gjeneralit rus, për ta sosë të gjithë atë punë, shpeshherë ndodhë, pa qëllim, mbase të thehen një çik rregullat e konventave ndërkombëtare. Gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutazovi, ka më pak se dy orë për ta sosë këtë punë në mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit. Përndryshe ajo Indigjenia Iroki- Pocahontas Powhtani do ta bëjë hatanë me Jezusin e saj arketip nga Massachusettsi"– gati e skërmiti vetveten e vet ministri Spiridonis Zevsi.

"Ne, zoti ministër, do t'u përmbahemi konventave ndërkombëtare. Sofinë e Jakovës së Jerusalemit, sipas marrëveshjen menjëherë do ta ftillojmë me avionin e orës dy e gjysmë të natës, për në klinikën "Gemeli" të Romës"-e ngacmoi gjenerali anglez.

"Çfarë konvente ndërkombëtare! ?" - u hodh thik përpjetë

ministri Spiridonis Zevsi.-"E keni lexuar në të gjitha pergamenat se Indigjenia Iroki,Pocahontas Powhatan, para disa çastesh, tok me atë gjeneralin amerikan John Harkerin e Massachusettsi, zbarkoi në Siçili. Ajo e ka thye konventën e Rambujes. Ka zbarkuar me forcat amerikane dy orë para kohe. Ka gjasë zoti gjeneral, që në Romë të arrijë përpara Sofisë suaj ajo Indigjenia Iroki,Pocahontas Powhatani e gjeneralit Jahn Harkerit të Massachusettsit. Atëherë zotëri gjeneral do të bëhet vonë, tepër vonë, për të gjithë ne"- vazhdoi përvajshëm ministri Spiridonis Zevsi.

"Konventa domosdo duhet respektuar"-ia këputi shkurt gjenerali Shelton.

"Zotëri gjeneral, dërgojeni Sofinë e Jakovës së Jerusalemit në klinikën "Omonia" të Athinës ose në Klinikën e Makushevt në Moskë"- me zë lutës, iu drejtua ministri Spiridonis Zevsi gjeneralit Shelton.

"Seanca përfundoi zoti ministër"- i tha prerazi gjeneralit Shelton duke e dhënë shenjën për ta mbyllë monitorin.

Në dhomën e internetit të OSCE-së u bë gjysmerrësirë.

Secili prej të pranishmëve u rrokullis në vetveten e vet.

Diçka do të ndodhë sonte. Diçka kontinentale.

47.

Në orën dy të natës,Zeusi Spiridonis në stacionin e Trieshtës po e priste trenin "Orient Express". Me këtë tren duhej të vinte Zatra Arameje nga Stambolli. I kishte vizituar të dy haremet e sulltanit për ta takuar eunukun Redalk san Heldikun nga Jakova e Jerusalemit. E takoi në sheshin e ujëvareve të haremit të dytë. Ai po rrinte në dyshekllëk me kadinën e sulltanit. E njohu Zatren Arameje. Ra në shikimin e saj. U çjerr deri në qiell:"Të gjitha xhamitë e botës do t'i epja vetëm për një penis!"

Nata e ngrohtë e Trieshtës me pedanteri po i numëronte sekondat e veta. Me kot Zeusi Spiridonis u mundua ta përbirojë kohën nëpër këto sekonda të imta. Ai merrej me copa të mëdha kohe qiellore. Sekondat e natës së Trieshtës po ia zënin frymën.

Zëri i altoparlantit si për inat lajmëroi se treni "Orient Express" do të ketë vonesë. Bile e la zvarrë se më vonë do të lajmërojë përsëri. Zeusi u bë krejt esëll. Për herë të parë e pa vetveten e vet në midis vdekatarëve të rëndomtë. Njerëzit, të përhumbur, e shikonin punën e vet, pa ia venë veshin Zeusit.

“Si mund ta zë dëshpërimi një kryezot?! Po sikur këta njerëz të përhumbur ta njihnin njëri-tjetrin?! Do t’i harronin zotat e tyre”-u rrokullis në vetveten e vet hyjnore Zeusi- “Le ta masë këtë cikërrimë-kohë tjetërkush. Kryezoti merret me copa të mëdha kohe me diakroni”- e përbuzi jetën tokësore Zeusi.

Drita vezulluese, me e fuqishme se vezullimet e rrufeve të Zeusit, u shfaq në të hyrë të stacionit të Trieshtës. Zeusi e ktheu shikimin drejt asaj drite. U dëshpërua. Vezullimi i dritës qe shumë larg për ta arrirë kryehyjnori. Për herë të parë ra ndesh me pamundësinë, me refuzimin, me zvarritjen tokësore.

Zeusi u poshtërua.

“Unë i kam sunduar të gjithë. Ç’më gjeti sonte? Mos u bëra edhe unë vdekatar në këtë stacion treni?”-u rrokullis dëshpërueshëm në vetveten e vet.

“Ka rrezik të gjendesh në hapësirën pesëcentimetershe midis dy sekseve nën cunamin e orgazmës kontinentale, e cila sonte uraganisht ua ka mësy brigjeve të Evropës” - i erdhi zëri.

Për herë të parë Zeusi u frikësua.

“Kjo orgazëm ç’mund të bëjë?”- e pyeti zërin Zeusi.

“I kapërthen dy sekset me fuqinë e epshit. I bën ta njohë njeriu-njerinë”- i tha zëri.

“Dashket ta bëni rrënimin e Zeusit qiellor?”- e pyeti vetë Zeusi.

“Po”

“Ky është atentat mbi zotat e qiellit”.

“Po”.

Treni “Orient Express” ndaloi në stacionin e Trieshtës. Zbriti ajo.

Para Zeusit ndaloi një vajzë flokëgjatë pisë të zeza. Sytë i patë ngjyrë drite plot hutesë. Qerpikët krahëhapur për të përpirë çdo gjë përpara vetes. Ajo ra në sytë e egjër të Zeusit. Qe vajzë

e brishtë, e qëruar bujarish deri në skajshmëri nga përzierja e sekseve. Ishte vajzë me qashtëri të breroret femërore.

Vajza e largoi, trembshëm, shikimin nga sytë e egjër të Zeusit. Ashtu e hutuar e pyeti një zonjë:

"Mos dini zonjë në orën sa niset treni për në Romë?"

Vajza e hutuar në sytë e vet të mëdhenj e humbi përgjigjen e zonjës për trenin. Një oguri i ra para këmbëve.

Për herë të parë Zeusi Spiridonis lektisi t'i lutej dikujt më të fuqishëm se vetja e vet Zeusit, qoftë vetëm për një shikim.

"Kujt duhet t'i lutem për këta sy të kësaj vajze?"-e pyeti veten e dëshpëruar Zeusi.

"Zotëri, mos dini në orën sa niset treni për në Romë?"- e pyeti vajza me ngjyrë drite në sy.

Zeusi e pa se në sytë e saj kishte ende pyetje. Ai u detyrua të hezitojë, të përgjërojë, të lutet, para një vajze të brishtë. Të gjitha i bëri menjëherë pa e kuptuar se ç'po ndodhte me vetveten e vet.

"Do t'i kisha dhënë rrufetë, olimpin, të gjithë perandorinë time qiellore vetëm për sytë e kësaj vajze"- i paskesh thënë vetvetes së tëhujsuar Zeusi i ndjerë dobësisht në vuajtjen e ëmbël.

"A mos mohove!?"

"Jo"

"Ti ke zbritur në tokë të bësh diversion në ata sy vajze, të bësh diversion në orgazmën e gjithëpushtetshme. Shka u bë me fuqinë tënde hyjnore?"- e pyeti zëri.

Zeusi Spiridonis u zvarit deri para këmbëve të vajzës, vetëm për t'i thënë se edhe ai po e priste trenin për Romë.

Oguri i vajzës foli si nga larg, i zvargur.

"Po ju zotëri mbase po e pritni trenin "Orient Express". Ajo zonja ka tri herë duke jua angllatisë se treni "Orient Express"

erdhi. Sigurisht Ju zotëri, e keni mërzitur me pyetjet Tuaja atë zonjë. E treni "Orient Express " për të cilin keni pyetur ja ku është në peron" - iu zbraz Zatra.

"Jo, zonjë unë po e pres trenin për në Romë"- belbëzoi Zeusi i habitur nga gjendja e vetvetes së vet.

Zatra Armeja e shikoi me një vegim të çastit sikur e njohu atë burrë. Ai qe një burrë i lakuar, me një shikim të renduar, i ngathët midis njerëzve.

"Si ju quajnë zonjushë? Më bëhet se mbahem për emrin Tuaj. Ndryshe do të rrëzohem"- e përgjëroi Zeusi.

"Më quajnë Zatra, zotëri".

"Më ngjason si emër yni"- iu qas pak Zeusi.

"Pse qenka emër i juaj Zatra?Mos jeni nga Arameja zotëri?" - e pyeti ajo me një shikim zhbirues.

"Jo vetëm ashtu thash kot. Vetëm se emri juaj, zonjë më ngjason në emër të ndonjë shkolle arti"- u nxor disi Zeusi.

"Po vërtet zotëri unë studioj artin."-shpjegoi Zatra Arameje.

"Cilin art?"

"Artin e Orgazmës"

"Cili qenka programi juaj në këtë shkollë të Orgazmës"- gati e zbuloi vetveten e vet para Zatres Arameje.

"Ne, zotëri, klientët tonë- nxënës, i gjejmë me metodën e ngacmimit. Pasi joshja e jonë e zbulon prirjen e klientit-nxënësit, e shpiejmë në seancën e parë, te dytë e, sipas dëshirës së tij edhe në seancën e tretë"- ia shkoqiti planin e shkollës së vet Zatra Arameje.

"Ku është vendosur shkolla e juaj, zonjushë?"- e pyeti në mënyrë trashanike Zeusi.

"Zotëri, seancat i mbajmë kryesisht nëpër dhomat e hoteleve; kryekëput në shtrat" - si me tallje të hidhëruar ia tha Zeusit

duke e parë tek ai një shikim të egër, të lashtë, plot kutërbim kafshësh.

Zatra Arameje e njohu atë shikim të egër. E kishte parë kahmot.

Ajo, pahetueshëm eci krahas Zeusit.

"Ky qenka hotel. Njëri nga shkollat Tuaja të orgazmës."-ia kujtoi Zeusi.

Zatra Arameje e lexoi shikimin e egër të Zeusit. E kuptoi se ai kishte arritur në Trieshtë për të bërë diversion në orgazmën e Zatres. E njihte mirë gurin në dorën e tij. Zatra u shtir sikur e mori për klient të rendomt, i cili don t'i marrë njohuritë e para të orgazmës.

"Unë dua të bëhem, sonte, nxënësi juaj, zonjushë"- ia shkrepi vendosmërisht Zeusi.

"Zotëri, ju duhet të paguani për secilën seancë"- i tha Zatra

"Me çka duhet të paguaj?"- e pyeti Zeusi

"Treqind e pasëdhjetë dollarë për secilën seancë, përveç çmimit të dhomës së hotelit" - ia caktoi pazarin Zatra Arameje

"Sa duhet të jetë qiraja e dhomës së hotelit?" - u hutua Zeusi

"Pesëdhjetë dollarë, Zotëri"

"Do të thotë, një seancë do të kushtojë katërqind dollarë"- i rrafshoi Zeusi të hollat e një séance.

"Po, Zotëri, pa i llogaritur bakshishet e kamarierëve"

Zeusi heshti para derës së hotelit. E patë të vështirë t'i kuptojë të gjitha këto zhinglamingla

"Le të hyjmë"- i pështpëriti krejt afër Zatrës.

Ajo e ndjeu firomën e tij prej kafshësh të ndryshme.

"Cilin seks do të ma mësojë kjo zonjushë pas aq masturbimesh me hyjnesha po,edhe me gra vdektare?"- e vrau mendjen Zeusi.

Të dy u futën në hotelin "Laguna". Zeusi e pa recepsionistin e gatshëm për t'ua dhënë çelësin e dhomës. Vetëm Zatra u nën-

shkrua në librin e mysafirëve duke i dhënë shenjë Zeusit ta epte bakshishin e parë.

Zeusi e kuptoi urdhrin e parë të Zatrës.U çudit, bile frikshëm, me vetveten e vet se sa i flashkët po bëhej kryeperëndia i Olimpit. E nxori nga xhepi i xhinseve një bankënotë. Pa e shikuar ia la përpara recepsionistit të zgurdulluar syshë. Sigurisht bankënota do të ketë qenë bujarisht olimpike.

"Zotëri ju po e paguani hotelin për shumë net?"- e pyeti recepsionisti

"Është bakshish për ju, zotëri.Vetëm bëhuni djalë i mirë gjatë kohës sa do të qëndrojmë këtu"-i tha shpërfillshëm Zeusi.

Recepsionisti heshti duke miratuar me kokë, i ngazëllyer deri në neveri.Ata të dy e shkëputën vëmendjen nga recepsionisti i ngazëllyer. U nisen drejt dhomës numër shtatë. Zatra Arameje e hapi derën me shkathtësi të habitshme për Zeusin e ngurruar tek pragu. Ajo hyri lirshëm - në shtëpinë e vet. Zeusi mëdyshoi tepër ngusht ende pa hy.

"Kjo vajzë do të ketë qenë shpeshherë në këtë dhomë. Tashmë sekset e ndara mund të zgjedhin lirshëm për vetveten e vet por edhe mund të zgjedhen nga ai seksi tjetër. Këtë joshje, sa më të fortë, këta vdekatarë e quajnë Dashuri, Orgazëm. Ai Jezusi i tyre, perëndia i parë i dalë nga mitra mishtake e një gruaje, e rrëzoi pushtetin hyjnor të Olimpit. Mbi Olimpin hyjnor i ngriti të gjitha ato xhinglaminglat e tyre; seksin, klitorisin, orgazmën e, mbi të gjitha atë dashurinë. Të gjithë, të gjithë duhet djegë me rrufetë e mia"- vendosi Zeusi ne pragun e derës së dhomës me numër shtatë të hotelit "Laguna" të Trieshtës.

Zeusi hyri në dhomë. Zatra Arameje i shpërthëkoi xhinset duke i lëshuar në dysheme.Të brendshmet tylore,gati tisore, me një hijesim ngjyrë vjollcë e spikatnin ngacmimin e kofshëve të saj të lemuara. Pastaj Zatra e hoq dekoltën e hollë duke mbetur vetëm me gjoksoren e ngulfatur nga gjinjtë e saj të mbufatur, të

gufuar kah njëri-tjetri duke e krijuar një hon marramendës në gjoksin e saj

Për herë të parë, Zeusi, pas gjithë atyre masturbimeve hyjnore para seksit të fjetur të femrës olimpike u gjend para seksit të zgjuar, dihatës, të gjallë, kapërdirës. Zatra i hoq të gjitha, ç'kishte mbi trup, përveç lekurës së lëmuar, paksa të rirë nga spërkatja me deoderantin ngacmues.

"Zotëri më duhet ta bëj një dush. Në stacionin e trenit ajri është ndotur nga tymrat e lokomotivave"-i tha lazdrueshëm Zatra.

Zeusi e shikoi paturpshëm nga prapa trupin e femrës. Deshi të masturbojë derisa Zatra qe në banjë. Duart dhe mendja i mbetën bosh për një masturbim. Zeusi paskesh humbur fuqinë e masturbimit hyjnor.

"Duhet vrarë këtë vajzë. Është spiune e asaj kurvës Indigjene Iroki - Pocahontas Powhatanit të atij gjeneralit amerikan, John Harkerit të Massachusettsit. Ajo kurva Iroki dashka, sonte, t'i përpijë perënditë e Olimpit nëpër vagjinën e kësaj vajze! Gjithsesi duhet vrarë Zatra Arameje"-u gëlltit në vetvete Zeusi.

Zatra doli nga banja, krejt lakuriq, e puçërruar lekurës së lëmuar me bulëza të ujit vezullues. Ajo nuk ishte fëshirë. Zeusi e ndjeu një të nxehtë përpjetë trupit. E shikoi seksin e saj të mëshehur, ngacmueshëm në leshrat pisë, të zeza. E shikoi seksin e Zatres, tashmë pa xhelozi.Ai kishte vendosur.Zatra qëndroi larg tij, shumë larg. Dëshironte ta poshtërojë. Dëshironte t'i hakmerrej për atë ditën kur Zeusi e mbajti në dorë gurin e urrejtjes për ta goditur në kokë Marinë Magdalenë. Zatra e njihte Zeusin e, Zeusi e njihte Zatrën. I kishin rënë ndesh njëri-tjetrit: Zatra lektiste ta vrasë Zeusin me orgazëm e, Zeusi lektiste ta vrasë me gurin hyjnor.

"Kaq lirë kushtuaka seksi për një natë?" - e pyeti Zeusi

“Po zotëri, vetëm treqind e pesëdhjetë dollarë”

Zeusi e futi dorën ne xhep prej nga nxori një grusht bank-ënotash të panumëruara. Ashtu shuk ia la në tavolinë.

Zatra e vlerësoi me sy se ishin më shumë se treqind e pesëdhjetë dollarë. Ajo u afrua afër tij. U ul buzë krevatit duke e ndrydhë paksa seksin e vet të çelur.

Zeusi u trazua. Gati e humbi torruan e masturbimit hyjnor. E kuptoi rrezikun. Ajo po e sfidonte.

“A ka tjetër seks përveç këtij me pagesë?”- e pyeti me një frymë Zeusi

“Ka” - iu përgjigj Zatra.- “Ju zotëri e keni paguar seksin pa orgazëm”

“Ç’është kjo orgazma”- u bë sikur ta ndiente për herë të parë.

“Ajo orgazma, Zotëri është vetë Dashuria”- iu përgjigj Zatra Arameje duke e parë shikimin e tij të egër.

“Sa kushton kjo orgazëm”- e pyeti Zeusi përngutshëm, i ndarë mendjes të paguaj shtrenjtë; njëmijë, dymijë dollarë. U rrëmbye kah xhepi i pantallonave për t’i nxjerrë të hollat. Mezi e gjeti njërin xhep. E nxori nga andej një tufë dollarësh fringo të re.

“A i ke mjaft këta dollarë për një orgazëm. Ti je prostitutë. Duhet ta dish mirë zanatin tënd meqë po të paguaj kaq majm. Kërko sërish po qe se të dukën pak”- u rrëmbye Zeusi nga shikimi i tij olimpik.

Ai i kishte të gjitha, krejt çka i tekej në kokë: hyjneshat, mbretëreshat, pijet, pavdekësinë, dafrungat e Olimpit, rrufetë, qellin ... Në fund këtë vajzë të brishtë kurrsesi ta bënte të vetën. Para një vajze të flashkët përgjërohej për një orgazëm, vetëm për një orgazëm.

“Zotëri, kot e keni ta bleni një orgazëm. Hera e juaj, zotëri, - një kafshë olimpike,një kafshë hyjnore,masturbon brenda vetvetes së vet arketipe sa për të pjellë njëherë në vit. Ju zotëri keni

masturbuar sa herë keni dashur në këto kafshë hyjnore. Për juve, zotëri do të jetë e pamundur ta arrini orgazmën. Ju zotëri jeni perëndi i kaosit të sekseve. Ju zotëri keni masturbuar në krijesa gjysmëpeshk gjysmëgra… ndërsa Ju, vetë, jeni afruar tek këto krijesa, i shndërruar në luan, në dem, në fajkua. Zotëri, Ju sonte kutërboni nga të gjitha kafshët olimpike, nga të gjitha kafshët hyjnore" - i ligjëroi Zatra duke i dhënë qartë se e njihte Zeusin e egër.

Zeusi qëndroi kokulur

Zatra e kuptoi sikletin e tij. Ishte poshtëruar hyjnisht nga një grua vdekatare.

"Zonjushë më mësoni si të arrij tek ajo orgazëm e mallkuar! Unë ua premtova një dynja dollarë, kot, krejt kot, siç më thoni ju!"- foli Zeusi me zemërim hyjnor.

"Seanca e parë mori fund zotëri. Mua tashmë po më flihet. Kot të merrem me një rrënojë siç jeni ju zotëri.

Zeusi i mërtisur, e përgjëroi Zatren për një seancë të orgazmës. Zatra e shikoi Zeusin, atë Zeusin e mnershëm, të librave kur mësuesja qullej vegësh duke u fol nxënësve për aventurat e tij.

Zeusi e hetoi mëdyshjen në sytë e Zatres.

"Ai shuk dollarësh ia ndërroi mendjen" - u qa Zeusi

Zatra, e ulur në cepin e shtratit, ashtu lakuriq, i hapi paksa vegët drejt shikimit mëtues të Zeusit.

"Ju, zotëri, lektisni për ta arritur orgazmën?" - i pëshpëriti Zatra Arameje.

"Po zonjushë" - ia këputi i gëzuar Zeusi.

Zatra i hapi vegët ende të qullura. Seksi i saj u shpalos.

"Për herë të parë, zotëri, ju sonte po shikoni seks të gjallë prej gruaje. Perendeshat Tuaja kanë vagjinë të vdekur. Zgjate gishtin tregues drejt seksit tim!" - e urdhëroi ajo

Zeusi e zgjati dorën andej kah e urdhëroi Zatra.

"Preke me gishtin tregues të dorës së majtë këtë lajthizë të skuqur në çarjen e seksit tim!" - e urdhëroi Zatra.

Zeusi me dridhje dore mezi arriti ta prekë paksa seksin e Zatres Arameje. E tërhoqi me rrëmbim dorën e përcëlluar nga rrufetë qiellore.

"E njeh kush është Ky?" - iu zgërdhesh ajo.

"Jo" - i foli Zeusi.

"Zotëri, ky është Klitorisi" - sërish e talli Zatra.

Ajo tashmë mori zjarr. E zbuloi se e paskësh njohur Zeusin qe në çastin e parë tek stacioni i trenit në Trieshtë.

"Ju zotëri nëpërmes masturbimit hyjnor të Olimpit i keni pjellë fëmijët Tuaj, herë nga koka, herë nga brinja e majtë, herë nga pulpi i këmbës së majtë. Zotëri, me mijëra vjet Orgazma, Dashuria, kanë gjalluar me shpirt ndër dhëmbë nëpër katakombet e Athinës Sate e të Romës së Janusit dyfytyrësh.

Zotëri, ndodhi atje në Massachusettsin e largët. Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatani e ushqeu gjeneralin John Harker me tri lloje qumështash jashtëbiblikë. Ajo Indigjenia Iroki ia zbuloi John Harkerit Orgazmën, atë orgazmën e mbrujtur me Dashuri. Ju zotëri me të gjithë ata skribët e farisejt e zutë Marinë Magdalenë në flagrancë. Atë ditë këtë grua e sollët para Jezusit për ta denuar sipas ligjit hebre. Të gjithë i kishit gurët në dorë për ta vra Gruan e zënë në Orgazmën e Dashurisë.

Kur Jezusi ua përmendi mëkatin e secilit, të gjithë u larguan duke i lëshuar gurët në tokë. Përveç Jush.Ju ende e mbani gurin në dorë.

"Grua, ku janë ata? Askush nuk të dënoi?"-i tha Jezusi asaj gruaje derisa Ju, zotëri ishit aty.

Ajo u përgjigj: "Askush Zotëri përveç njërit i cili ende po e mban gurin në dorë".

Jezusi e ngriti shikimin në drejtim Tuajin zotëri. Të dy i kapërthyet shikimet. Unë qesh aty zotëri.

"Ti do të vdesësh, kur të rritet Dashuria midis njerëzve" - Ju tha Juve Jezusi. Ju zotëri ende po e mbanit gurin në dorë- vazhdoi, e ndezur, Zatra Arameje.

"Ju po më njihket, zonjushë"- u kërlesh Zeusi

"Po zotëri, si mos të të njoh. Ne u takuam dy herë: herën e parë, në sheshin e qytetit kur Ju zotëri e sollët Magdalenën para Jezusit për ta ndëshkuar. Kur të gjithë i lëshuan gurët në tokë, përveç Jush. Herën e dytë u takuam në shtëpinë e Fariseut i cili e kishte thirrë Jezusin për bukë. Atëherë kur ajo gruaja e bukur po ia lante këmbët Jezusit, ju zotëri ende e kishit gurin në dorë për ta goditur atë gruan e orgazmës.

"Jezusi e ngriti shikimin drejt jush, Zotëri. Ai foli:

Kjo grua ka treguar Dashuri të madhe".

"Ju zonjushë, mendoni se edhe sonte do t'ju mbrojë ai Jezusi i Orgazmës? Ai Jezusi Juaj i orgazmës së indigjenes Iroki posa zbarkoi në Siçili. Ai ende është larg jush për t'u ndihmuar" - i tha Zatres Arameje duke e nxjerrë gurin.

Zatra Arameje e njohu gurin në dorën e Zesusit. Ishte po ai gur me të cilin Zeusi deshi ta vrasë Marinë Magdalenë. Zatres i kaloi frika. U ndez kundër Zeusit.

"Zotëri, sonte është nata e fundit e masturbimit tënd hyjnor. Kot, krejt kot, do t'i shpenzoni rrufetë tuaja gacatore për t'i djegur Klitoriset, Orgazmat, Dashuritë. Ngushëllimin e rrejshëm e gjetët si ministër me emrin tuaj të ri, Spiridonis Zevs në laboratorin e OSCE-së pranë arkivolit të Rektorit të Jakovës së Jerusalemit-Redalk-San Heldikut. Kot shpresoni në eksperimentin me gjenetikën e miushëve për atë vaksinën nga gjaku i tyre: "Sanguis lacertae in utero" "Sanguis lacertae in musculo", "Sanguis lacetae in cerebro". Kot mashtroheni, zotëri, se do ta mbani primatin Olimpik mbi vagjinën, mbi Klitoritin, mbi

Orgazmën mbi Dashurinë. Kot mashtroheni zotëri se ai gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi, me metodën e muzhikëve rus të doktor Makushevit do ta zbulojë mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Ju e dini se sonte, pikërisht sonte, zbarkoi në Siçili Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatan e gjeneralit amerikan John Harkerit të Massachus-ettsit. Pas dy orësh zotëri ajo do të arrijë në Romë te klinika "Gemeli" tek Shtatëmbëdhjetë minutat e Orgazmës hebreje të Rebekes së Alamekut dhe tek Shtatembëdhjetë minutat e Orgazmës së Sofisë së Jakovës së Jerusalemit"-u përflak Zatra Arameje, ashtu e lakuriqur para Zeusit, Spiridonis Zevsit.

"Po ju e dini se ajo Sofia e Jakovës së Jerusalemit, në tendën tuaj, pikërisht në tendën Tuaj, ka bërë seks me atë Redalk san Heldikun pak çaste pasi ju zonjushë keni bërë seks me të" - deshi ta zgjojë xhelozinë e saj.

"Radalk san Heldiku qe vetëm një burrë ekologjik, i ruajtur në Jakovën e Jerusalemit nga katër gjeneralë perandorishë. Ai burrë ekologjik,posa u takua me mua e njohu penisin në mishin e vet-pastaj Orgazmën. Redalk San Heldiku e pat të ndaluar të bëhet burri im apo burri i Sofisë së Jakovës së Jerusalemit"- e kapërceu xhelozinë Zatra Arameje,ashtu e lakuriquar para Zeusit- Spiridonis Zevsit.

"Ju, prostitutë e mallkuar, ditkit çdo gjë! E keni hak vdekjen"- u përflak Zeusi- Spiridonis Zevsit duke e ngritur lartë atë gurin me të cilin deshi ta vrasë Marinë Magdalenë.

Zatra Arameje e pa duke renë nga qielli i dorës së Zeusit gurin e Sagralit drejt fytyrës së saj. Shikimi i mbet i shtangur kah qielli tek e pa fytyrën e përgjakur të Jezusit. Nga Kryqi masiv, i drurit të lagur stërkalash e shiut të gjakut i tha Zatres Arameje:

"Guri i vrasjes nga dora e Zeusit duhet të bijë poshtë. I është renduar guri në dorë qe atë ditë kur deshi ta vrasë Marinë."

Ekipi i mjekëve hyri në dhomën numër shtatë të hotelit "Laguna" të Trieshtës. Zatra Arameje, me gjysmëtrup në shtrat, me këmbë të lëvarura deri ne dysheme, po qëndronte lakuriq, pa pikë shpirti, në shtatin e saj të djegur rrufeshë të qiellit olimpik të Zeusit. Te koka, në shtrat ishte bërë një gjollë gjaku ende e pampiksur. Kreshta e kresë i ishte thyer keq me një gur të lënë në rrashtë.

"Mos e lëvizni nga vendi derisa të vijë hetuesi"- foli doktor Oliveti, dukshëm i shqetësuar.

"Qenka plagë e egër, e shkaktuar me këtë gur, sikur vrasësi të mos kishte pasur ndonjë mjet tjetër më të sofistikuar"- u habit mjeku Lardinë

"Sikur kam parë diku në pikturë plagë të shkaktuar me një gur të tillë" - foli me vetveten mjeku, Oliveti.

"Zotërinj, mos keni prekur ndonjë gjë në këtë krim?" - pyeti hetuesi përngutshëm.

"Jo zotëri" - i foli Oliveti

Hetuesi, një burrë i mbushur, kokëtullë, i bëri disa fotografi rutinë. I mblodhi rrobat e Zatres në një plasmast.

"Kjo grua në librin e mysafirëve është nënshkruar në emrin e vet, edhe pse recepsionisti thotë se ka hyrë me një burrë pa moshë, me një të ecur të pasigurt sikur të paskësh qenë i dehur. Deri sa janë ngjitur shkallëve burri ka qëndruar i kërrusur sikur të kishte dhimbje në stomak"-foli hetuesi vetëm sa për të thënë.

"Zotërinj, mund të fillojmë nga puna"- tha doktor Oliveti pa ua venë veshin fjalëve të hetuesit.

E hoqën gurin nga plaga e Zatres. Rodhi gjaku nga plaga e hapur.

"Klitorisin e ka të djegur në mënyrë të mnershme, me një lloj zjarri të çuditshëm" - tha mjekja Lardinë.

“Mos, vrasësi mund t’ia ketë djegur me rreze lejzeri” - foli përçudshëm mjeku, Françesku, krejt përçudshëm.

Si ta marrin seriozisht mendimin e përçudshëm të Françeskos kur dihet se për ta bërë atë punë duhet një aparaturë e tërë dhe një përgatitje profesionale.Megjithatë erdhi eksperti i radiologjisë së klinikës “Ordino” të Trieshtës. Me një shikim të trisht, përbuzës,i mërzitur me vetveten, mezi arriti të thotë: “Jo, plaga e klientës është e shkaktuar me rreze të ndonjë lloji tjetër, jo me lejzer”.

Ekspertiza duhet kryer. Në raport duhet shkruar se më çfarë mjetesh janë shkaktuar plagët vdekjeprurëse. Edhe guri edhe zjarri shkrumbues u bënë të panjohur. E, diç duhej shkruar në raport.

Krejt çuditshëm, serish foli Françesko i cili merrej deridiku me aparaturën mjekësisë nukleare:

“Është mirë ta ftoni një ekspert të kriptologjisë nga sektori i leximit to shenjave. Ai duhet të jetë ekspert i sjellë nga Vatikani. Edhe guri edhe zjarri janë të një përbërje tjetër nga ç’njeh fizika” - propozoi Françesko.

Mjeku Oliveti e formoi numrin e zyrës së sektorit të Kriptologjisë.

U paraqit një zë i përgjumshëm, thellësisht i ngjizur. Dukej se posa kishte rënë në gjumë nga një dafrungë pijesh.

Zëri i ngjizur ia dhe numrin tjetër të telefonit të zyrës së kriptologëve, dhe si duket pa e përfunduar rendin e numrave të telefonit ra në gjumin e lëngshëm të verës.

Nga zyra e kriptologëve u lajmëruan:

“Ai, Zeusi, atë ditë kur deshën ta vrasin atë gruan e përdalë, Marinë Magdalenë, përkundër profecisë së Jezusit për t’i lëshuar gurët nga dora, e mbajti në dorë gurin e sjellë nga Olimpi. Kuptohet se Zeusi duhet ta vriste herdokurdo atë gruan të cilën

e fali Jezusi. Kisha bizantine sonte e harxhoi gurin e ruajtur aq vite nga Zeusi mbi kaptinën e Zatres Arameje. Ndërsa kisha katolike Magdalenën e kurseu nga vrasja me gur deri natën e dymbëdhjetë të qershorit tek hoteli "Laguna"i Trieshtes. E vrau moralisht duke e shpallë prostitutë të mëshiruar nga Jezusi. Cila do të dalë nga këto vrasje?

Zeusi i shpenzoi rrufetë për ta djegur Klitorisin e Zatres Arameje. "

Në raport shkruani:

"Plaga në kokën e Zatres Arameje është bërë me gurin olimpik, nga dora e atij kopukut. Ai është i akuzuar edhe më parë për tentimvrasje.Keqbërësi zakonisht i sulmon gratë. Le të shpallet fletarresti për të.

48.

Gryber Sontag,ende me shikim të hedhur kah qielli i skuqur i Jakovës së Jerusalemit, po e përcillte helikopterin e Sofisë andej kah aeroporti i qytetit, kur ordinanca ia solli lajmin se po e thërrasin në zyrën e lartë të laboratorit të OSCE-së.

Doktori Gryber e shkoqi shikimin nga helikopteri i Sofisë së Jakovës së Jerusalemit sikur të mos i kishte kuptuar fjalët e ordinancës. U nis andej kah zyra e Lartë e laboratorit. Në zyrë e gjet gjeneralin anglez Xhonatan Sheltonin. Dukej i qashtër, çuditërisht i qetë. Gjeneralin e gjet në këmbë. U takuan pa ndonjë përshendetje ushtarake.

"Zoti Kolonel posa na informuan se në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit paskesh arritur hirësia e tij, Spiridonis Zevsi. Ai vjen të vezhgojë si përfaqësues i kishës bizantine; të shohë se ç'eksperimentojmë në këtë laborator" - e njoftoi gjenerali.

"Misionari bizantin mund t'i ketë marrë informatat nëpër pergamenat e shkërdhyera" - disi u nevrikos Koloneli Gryber.

“Zoti Kolonel ky misionar bizantin, Spiridon Zevsi, ka shprehur interesim të veçantë, jo për orgazmën e Sofisë mbi varrin e Radalk san Heldikut por në veçanti ka shpreh interesim për eksperimentin me ato tri llojet e miushëve, të vendosur nëpër epruveta. Ndaj zoti doktor përgatitni një raport të denjë për misionarin bizantin, Zevs Spiridonis Zevsi”- foli ngadalë gjenerali anglez Xhonatan Sheltoni.

“Përse, Ju Zoti gjeneral i rezervoni pritje të veçantë atij misionari bizantin, të cilin pak kush e njeh përveç studiuesve të mitologjisë. Si e paska nxjerrë lejen ky misionar të fluturojë mbi Jakovën e Jerusalemit, kur gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi edhe zogjtë i ndalon të fluturojnë mbi këtë qytet?” - vazhdoi i nevrikosur koloneli Gryber.

“Zoti Kolonel, ju vetë do ta keni privilegjen të bisedoni me këtë misionar të mitologjisë, siç po e quani” - i tha gjenerali Shelton, duke i dhënë shenjë të ulet.

Ata, të dy ushtarakët e njihnin mirë Ministrin e shënde-tësisë. Kishin pasur punë edhe më parë me të.As që guxonin të pyesnin kur vjen e kur shkon nga laboratori i OSCE-së. Ai është ministër i shëndetësisë.

Doktori u shemb në një karrige. Vetëm atëherë e pa sa ishte lodhë. Heshti pa menduar asgjë.

“Erdhi, zoti kolonel. Do ta presim siç i kërkohet një ushtaraku krejt sipas konventës ndërkombëtare”-tha paksa i shqetësuar gjenerali anglez.

Doktori,tepër ngadalë,si për inat,dha shenjë se ishte i zgjuar.

Helikopteri i Zevsit gulçonte sikur të mos i kishin zënë këmbët dhe. Helika e helikopterit u qetësua ngadalë. Nga andej zbriti një njeri i ngathtë, i mbushulluar parregullsishë. Rrobat prej misionari tmerrësisht i rrinin të huaja në shtatin e mbushulluar, të rëndë, të kërrusur përpara.

Gjenerali anglez u nis drejt misionarit mitologjik ndërsa koloneli Gryber shikoi edhe një herë andej mbi qiellin e skuqur të Jakovës së Jerusalemit. Helikopteri i Sofisë ende po sillej mbi aeroport.

Para Kolonelit Gryber ndaloi ai alamet misionari.

Gjenerali Shelton, sipas protokollit, u përpoq të hapë kuvend. Misionari bizantin, me mbushullim shtati të përmasave mitologjike,me vrazhdësi neolite,iu drejtua gjeneralit.Zërin e nxori gërryes me bashkëtingëllore të ngurta:

"Çdo prostitutë e keni lejuar t'u mbajë seanca edhe perëndive. Pa pikë turpi, këto prostitutat tuaja u mbajnë seanca seksi zotave, bile edhe kryezotit Zeus; flasin nëpër hotele mbi dofarë klitorisësh, orgazmash, dashurishë të pshurrta"- u skërmitën bashkëtingëlloret nëpër dhëmbët e tij pa kurrfarë hyrje protokollare në bisedë.

"Mund të mos ju ketë njohur ajo zonjushë kur ka çelë këtë kuvend karshi jush"- u katandis gjenerali anglez duke i dhënë të kuptojë se kishte njohuri për ngjarjen në dhomën numër shtatë të hotelit "Laguna" të Trieshtës.

"E ka njohur ajo Zatra Arameje, bile më mirë se ç'mendoni ju, zoti gjeneral. Tri herë i mbajti klientit-nxënës seanca të orgazmës"- u çakërdis misionari Zeus duke e vërtëlluar bisedën në veten e tretë.

Doktori Gryber kishte lexuar nëpër pergamena diplomatike për krimin me mjete mitike në hotelin "Laguna".

"Mbase Zoti Zevs, në hotelin "Laguna", pranë Zatres Arameje, mund t'i ketë rënë atij burrit vetëm për një çast potenca seksuale" - u tall koloneli Gryber.

"Çfarë potence seksuale?" - u çjerr Zevsi. - "Ajo e detyroi t'ia prekë atëfarë klitorisin e saj duke i thënë pa fije të ngurrimit se ai klitoris, pikërisht ai klitoris, do të bëhet sundimtar i universit; se vetëm para atij klitorisi do të bëhen të gjitha rit-

ualet e orgazmës. Po edhe më keq se të gjitha, do të linden nga andej, edhe njerëzit edhe perenditë" - u skërmit Zevsi.

"Zotëri Zevs, dikush do të akuzohet për krim"- ia kujtoi gjenerali anglez për t'ia fashitur zjarrin olimpik në gjoks.

Hirësia e tij heshti shkujdesshëm pa dhënë shenjë se e kuptoi gjeneralin anglez

"Hirësi" - iu drejtua gjenerali anglez. - "Nëse keni gradë të lartë ushtarake, përveç misionit tuaj hyjnor, mund të merrni pjesë në Takimin e Këshillit të lartë të NATO-s" - e provokoi gjenerali anglez pasi ia përmendi krimin në hotelin "Laguna" të Trieshtës.

"Ç'punë do të kem unë në atë takim. Më duhet të bisedoj me atë Indigjenen Iroki, Pocahontas Powhatan të atij gjeneralit amerikan, John Harkerit të Massachusettsit. Duhet t'i njohtoj eprorët e mi të Patriakanës për opinionin e saj. Mbase edhe ajo indigjene mund të mendojë si Zatra Arameje"-shpërtheu hirësia e Tij Spiridon Zevsi.

"Unë vetëm ju propozova por ju hirësi mbase jeni i lodhur nga udhëtimi prej Trieshtës. Avioni për në Romë niset pas dy orësh. Ju mund të zgjedhni vet"- ia përkujtoi gjenerali anglez të gjitha rrugët e ngatërruara hirësisë së tij Spiridon Zevsit. - "Por derisa ju të vendosni le të hyjmë brenda në laborator"

"Zotëri gjeneral unë vetëm erdha t'ju takoj juve si udhëheqës i ekipit të eksperimentit për zbulimin e vaksinës: "Sanguis lacertea in utero" - foli përngutshëm hirësia e Tij - Spirionis Zevsi. - "Gjithsesi më duhet të fluturoj sonte për në Romë"

"Atëherë hirësia Juaj ka një brengë të thellë kur e mori mundimin të kthejë nga Trieshta këtu pasi Ju, hirësi, veç ishit pak më parë këtu" - ndërhyri Koloneli Gryber.

"Jo zotëri. Unë nuk isha në Trieshtë. Përveç tjerash, ktheva përngutshëm këtu tek ju për t'jua kumtuar lajmin e gëzueshëm se Marinë Magdalenë e vranë në hotelin "Laguna" të Trieshtës. Andaj Jezuesi i egër ekologjik i asaj indigjenes Iroki Pocahon-

tas Powhatan të gjeneralit nga Massachusettsi do të zbarkojë, i dëshpëruar në Siçili”- u ngazëllye Zeusi Spiridonis.

“Hirësia juaj, më vjen rëndë t’jua them, se Ju hirësi, e keni vra, gabimisht Zatrën Arameje në vend të Marisë Magdalenë” - e befasoi gjenerali anglez.

“Zoti gjeneral, unë e di më mirë se ju. Unë e njoh Marinë Magdalenë personalisht. Isha në shtëpinë e farisejit kur ajo hyri, plot vezullim në sy. I ra para këmbëve atij Jezusit me një enë alabastri plot parfum: “Zu vend pas tij, te këmbët e tija dhe, duke qarë, filloi t’ia lajë me lot këmbët e t’ia fshijë me flokë të kresë, t’ia puthë e t’ia lyejë me parfum”- deshi ta bindë gjeneralin anglez se ajo vajzë në hotelin “Laguna” të Trieshtës kishte qenë vet Maria Magdalenë.

“Hirësi po edhe ne e kemi lexuar, tekstualisht siç po e thoni ju, në Bibël” - e sqaroi gjenerali anglez.

“Zoti gjeneral, ndryshe është ta lexosh në Bibël e , ndryshe është ta shohësh vetë. Derisa ajo po ia fshinte këmbët me flokët e saj atij Jezusit, deshi dikush ta godasë me gur në kaptinë. Një dorë e zuri nga prapa. E la për tjetërherë.”- hirësia e tij Zevsi Spiridonis vezullueshëm e pa Marinë Magdalenë në shtëpinë e farisejit; në të njëjtën kohë në shtratin e dhomës numër shtatë të hotelit “Laguna” të Trieshtës.

“Hirësi,në të gjitha pergamenat ka dalë se në hotelin “Laguna” është vrarë Zatra Arameje, jo Maria Magdalenë”- ngulmoi gjenerali anglez.

“A besoni ju zoti gjeneral në xhelozinë e grave?”-e pyeti shkurt hirësia- Spiridonis Zevsi.

“Po, besoj, bile fort”

“Atëherë, zoti gjeneral, u verifikua xhelozia e saj. Atje në hotelin e trieshtës asaj vajze të prezentuar si Zatra iu tha se Sofia e Jakovës së Jerusalemit paskesh bërë seks me Redalk san Heldikun pak çaste pas Zatres Arameje”-shpjegoi qetas hirësia - Spiridonis Zeusi.

"Ç'ju tha ajo, hirësi?"- u ngut gjenerali anglez.

"E tha atë, të cilën duhej ta thoshte: se Redalk san Heldiku i takon tjetërkujt, e jo asaj. Çka edhe është e vërtetë. Maria Magdalenë nuk bëri seks me Redalk san Heldikun, sipas profesionit të saj prej prostitute.Prapseprapë ajo ishte metresa e Jezuesit. Prandaj ç'arsye kishte të bëhej xheloze Maria Magdalenë në Sofinë e Jakovës së Jerusalemit nëse kjo e fundit ka bërë seks me san Heldikun. Të tjera fjalë nga këto do të kishte thënë Zatra Arameje.Prandaj në hotelin"Laguna"të Trieshtës ishte Magdalena dhe është vra Magdalena e jo Zatra. Faktet flasin vetë"- u zhgreh hirësia e tij Zevsi Spiridon Zevs.

"Hirësi, megjithatë ju e keni vra Zatren Arameje, jo Marinë Magdalenë" - e kundërshtoi gjenerali Shelton.

Hirësia e Tij- Spiridon Zevsi duke e parë kokëfortësinë e gjeneralit anglez, e përbuzi mendimin e tij. E ndërroi bisedën gati në urdhër.

"Zoti gjeneral, meqë jeni udhëheqës i ekipit për zbulimin e vaksinës "Sanguis lacertae in utero" dhe të atyre dy vaksinave të tjera jam i detyruar t'jua them se unë lyp nga ju të m'i ruani biologjikisht gratë e mia nga ato orgazma, dashuriçka, klitorita. Të ma ruani masturbimin tradicional, hyjnor! Nuk është detyrë e Juaja të konstatoni kush kend e vrau. Përndryshe do t'u shkrumboj të gjithëve tok me ata klitorisat kryengritës nëpër Evropë" –e shpalli vetveten hirësia e Tij, Spiridonis Zevsi.

"Atë gjë po përpiqemi ta bëjmë, hirësia juaj" - arsyetoi gjenerali anglez mjaft plogësht për mendimin e Zevsit Spiridonis Zevsit

"Unë e kam parë me sytë e mi hyjnorë kur ai Jezusi,në shtëpinë e atij farisejit, e ngjalli orgazmën, dashurinë, klitorisin tek Maria Magdalenë. Bile vet Jezusi i tha asaj "ke treguar dashuri të madhe"- vezulloi një urrejtje hyjnore në sytë e Zevsit Spiridonis.

“Hirësi, orgazmën, perëndeshën e universit, siç po thotë ajo Mari, ia zbuloi atij Harkerit të Massachusettsit, Indigjenia Iroki Pocahontas Powhatani. Ajo e përshkoi John Harkerin nëpër mishin e Misrit jashtëbiblik, nëpër Qumështin e Bizoneshës jashtëbiblike, nëpër Qumështin e vet të Indigjenes Iroki Pocahontas Powhatan. Ai John Harkeri e ka përdhos traditën evropiane të grave Tuaja zotëri. Edhe gratë e Tuaja, hirësi, don t’i bëjë gra vagjinash. Ai, hiç më larg se sonte , zbarkoi në Siçili, dhe tashmë është gati para dyerve të Romës”- i foli plot inat Koloneli Gryber

“Atëherë, zoti kolonel”- iu drejtua plot pezëm Zeusi Spiridon Zevsi.-“Çfarë shpurdhka kot ai gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, nëpër mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit?”

“Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, në Jakovën e ndezur të Jerusalemit po e gjurmon mitrën e Sofisë së Haçet Deletës. Gjenerali rus po e djegë Jakovën e Jerusalemit për ta djegur klitorisin e Sofisë me zjarrin ushtarak të Rusisë Sovjetike të Ivanit të tmerrshëm siç e dogjen klitorisin e Zatres Arameje me zjarrin e rrufeve qiellore atje në hotelin “Laguna” të Trieshtësiu përgjigj koloneli Gryber Sontag.

“Vetëm kaq?”

“Jo!Edhe më. Gjenerali rus po ta zbulojë mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, në të do ta zbulojë fetusin e Redalk san Heldikut. Këtij fetusi doktori Makushev i gjeneralit rus do t’ia bëjë të tri vaksinat. Atëherë kot, krejt kot, sonte do t’ia çatiste këtu në Jakovën e Jerusalemit ajo Indigjenia Iroki e Massachusettsit. Edhe ajo indigjene sonte vjen pikërisht për atë mitër në të cilën do ta mbëltojë orgazmën amerikane të iniciativës së lirë. Besoj ministri im i dashur se këtë herë ke pasur nderin të mësosh gjëra të reja të cilat nuk i ke ditur më parë”-e përfundoi plot sarkazëm koloneli Gryber.

“Kjo duhet të ndodhë gjithsesi. Gjenerali rus, Ivan Vaslijeviq Kutozovi, po arriti sonte ta djegë klitorisin e Sofisë, mjeket

amerikanë të asaj Indigjenes Iroki Pocahontas Powhatan do të mbesin me gishta në gojë"- i dha vetes kurajë Zeusi Spiridon Zevsi. - "Po përse ju sonte po e dërgoni këtë Sofinë në klinikën "Gemeli" të Romës e, jo t'ja dorëzoni këtij gjeneralit të nderuar, Ivan Vasiljeviq Kutozovit kaq afër, vetëm nëntë kilometra nga këtu?" - kurrsesi të përmbahet pa e bërë këtë pyetje hirësia e Tij Zevsi Spiridon Zevsi.

"Hirësi, gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi në Jakovën e Jerusalemit po e përdor metodën e muzhikëve rusë të doktor Makushevit duke e futur dorën deri tek mitra e grave të reja për ta prekur fetusin, ende të pabërë, çka edhe është kundër konventave ndërkombëtare. Së dyti, gjenerali rus shkoi në skajshmëri duke dashur për dy orë ta vaksinojë Jakovën e Jerusalemit me vaksinën "Sanguis lacertae in musculo" dhe "Sanguis Lacertae in cerebro", siç ka bërë për dyzet vjet në këtë Shqipërinë e Albanikut sovjetik"-iu përgjigj me zë tepër zyrtar gjenerali anglez Xhonatan Shelton, i cili ngadalë e kishte futur Zevsin Spiridonis Zevsin në laboratorin e OSCE-së, qëllimisht duke e venë para skenës trishtuese.

Zevsi Spiridon Zevsi, e pa skenën, sikur të njohur më parë: ujku Volfgang, i përgjakur vegësh, ende po mbllaçiste në çukun e kërthizës së çupëgruas, pa e zbritur gjuhën më poshtë pubisit të saj. Këmbët e prapme po i dridheshin, të sfilitura, deri në rraskapitje prej uloku.

"Ky ujk ngordhalaq qenka ai doktor Fausti i teatrit të Berlinit nga u arratisën Sofia e Haçet Deletës dhe Mefistoja?"- pyeti Zevsi Spiridon Zevsi, i shastisur sepse e njohu Herën e vet të shtrirë sa gjerë e gjatë në divan nën gjuhën lëpirëse të ujkut Volfgang.

"Hirësi, në teatrin e Berlinit ndodhi katrahura. Ju, hirësi, keni të drejtë megjithëse gjërat u janë pllakosur e bërë rrokopujë. U është përzier Hera e Juaj me çupëgruan Kësulëkuqe. Qe të dyja e lakmojnë orgazmën por ende s'e kanë arrirë. Son-

te,hirësi, po ju pleksen midis tyre: Kësulëkuqja e teatrit të fëmijëve të Berlinit me Herën Tuaj të teatrit për të rritur. Fausti, doktori i Gjermanisë, sonte pa rropatet të aktrojë pa ndihmën e atij djallit hebre, Mefistos. Doktori ka ngecur në aktin e dytë, i molisur i fishkur, mbi shtatin e Herës Suaj hirësi. Ka provuar të bëjë seks me penisin e fishkur të premtuar nga djalli Mefisto. Nuk mundi as Hera Juaj as Doktori i Gjermanisë"- e ngacmoi koloneli Gryber.

"Jo vetëm ky doktori i Gjermanisë ngordhalaqe po edhe e tërë Evropa të mbllaçiste në kërthizën e Herës sime do ta ketë provuar të pamundurën ta zgjojë orgazmën tek ajo grua. Unë e njoh Herën time më mirë se çdo doktor i Gjermanisë së shkërdhyer. Kjo Gjermani po mundohet t'i bëjë sfidë Orgazmës amerikane të Indigjenes Iroki me një maskotë prej shajaku të atij Mefistos çifut"- u krekos hezitueshem plot donkishotizëm Zevsi Spiridonis Zevsi.

Shihej qartë se atë e kishte ngërthyer dyshimi.

"Edhe Hera juaj, hirësi, u katandis të arratisej nga teatri i Berlinit" - i tha koloneli Gryber.

"Se u katandis po e shoh, por si mendoni ju, zoti kolonel? Sikur t'ia kishte dalë në krye të arratiset nga teatri i Berlinit, nga kthetrat e atij Faustit Tuaj filozof, kah do t'ia kishte mbajtur Hera ime?"- e pyeti me një fije dyshimi Zevsi Spiridonis Zevsi.

"Po ku tjetër, hirësi, përveçse tek ai Rabi Jochanon ben Sakai për një orgazëm, për një penis, për një klitorit . Pastaj ju Hirësi do të kishit marrë leksione mbi klitorisin, mbi orgazmën nga Hera Juaj pa e paguar asnjë qindarkë. Të gjitha gratë e Evropës andej ia kanë mësye"-e ngacmoi seriozisht gjenerali Gryber.

"Prapë më mirë kështu. Më mirë Hera ime nën gjuhën lëpirëse të këtij ujku impotent, të këtij Doktorit të Gjermanisë së

shkërdhyer. Më mirë dashnore e Faustit të fishkur se sa të ishte arratisur me atë Mefiston e Sofisë së Jakovës së Jerusale-mit tek ai çifuti i Izraelit,Rabi ben Sakai. Ai çifut do t'ia kishte mësuar orgazmën, klitoritin, penisin e mallkuar."- e ngushëlloi vetveten e vet hirësia e Tij, Zevsi Spiridonis Zevsi.

49.

Avioni ateroi në aeroportin “Ben Gurion” të Izraelit.

Mefistoja ndaloi në midis të shkretëtirës së Negevit porsa e hetoi një dritë nga larg.

“Nga këtu, pikërisht nga ky çast, do të udhëtosh me atë tjetrin” - i tha Sofisë së Jakovës së Jerusalemit bashkudhëtari i saj Mefistoja.

“Përse duhet të udhëtoj, kaq rastësisht me atë tjetrin? Ne u arratisem së bashku nga teatri i Berlinit”- ankoi Sofia e Bohemisë.

“Ajo dritë në shkretëtirë është hirësia e Tij, Rektori i të dy universiteteve të Jerusalemit, Rabi Jochanan ben Sakai, tok me nxënësit e vet të Sanhredinit” - u përgjigj shkurt Mefistoja

Ecën edhe paksa nëpër rërën e ftohtë të shkretëtirës derisa iu qasen asaj drite.

Në heshtje të plotë, të mbështjellë me gunat e tyre, po qëndronin në grumbull disa burra. Ai më i vjetri, i rrahur gjith-

andej nga ajo dritë dukej i hequr nga fytyra por me një energji gati rinore.

I kishin hetuar nga larg të dy udhëtarët pa denjuar të lëvizin nga vendi.

Mefisto, i pari iu qas grumbullit të burrave të mbështjellë në gunat e tyre të trasha. Dikush duhej hapur kuvend. Të qëndronin në atë gjendje delte se ai grup burrash po i përbuznin të porsaardhurit. Mefistoja u mat të çel kuvend, disi hezitushëm, plogët.

"Më në fund arritët zotëri. Ju kemi pritur. Kemi pyetur për orarin e avionit nga Gjermania. Sigurisht ju ka lodhur rëra e kësaj shkretëtire"- çeli kuvend me një zë të papërcaktuar, ai burri më i vjetër, i hequr fytyrës nga pagjumësia.

"Qemë të detyruar, hirësi. Gjithsesi sonte ka qenë duhur të takohemi"- iu përgjigj me një zë paksa lutës Mefistoja.

Nxënësit e Sanhedrinit të Rabi Jochanan ben Sakait u bënë edhe më të heshtur se ç'ishin më parë. I kishte vënë në mejtime udhëtimi i dytë i Izraelit jashtë vetvetes së vet. E ndjenin veten më të vegjël, më të pafuqishëm se të bijtë e Kananit kur zbritën në Egjipt. Nxënësit e Rabi Jochanan ben Sakait po arratiseshin nga Izraeli vetëm tridhjetë e një veta; në drejtim krejt të kundërt nga Egjipti, në drejtim të Evropës.

"A do të kthehen si herën e parë? Sa vetë do të kthehen në Izrael?"- çekan mbi kokë, mbi zemër, mbi shpirt po i godiste kjo pyetje e pamëshirshme, me përmasa kontinentale nxënësit e Sanhredinit.

Rabi Johanan ben Sakai, i mbështjellë në gunën e trashë të zhguntë, edhe pse i ulur në rërën e shkretëtirës së Negevit ua mohoi me qëndrim edhe Mefistos edhe Sofisë së Bohemisë për t'u ulur paksa. Rabi ishte përngutshëm. Ngulmonte për të çelë kuvend sa më parë. Edhe Mefistoja e hetoi qartë ngutinë e Rabinit.

“Hirësia e Juaj, ne u arratisëm nga teatri i Berlinit për të arritur, të gjallë apo të vdekur deri këtu, para hirësisë Suaj.Në teatrin e Berlinit,se çfarë pune kam bërë, hirësia Juaj e di mirë” -Mefistoja pushoi paksa nga një kollë e gjykuar në grykë; ishte mbushur pluhur shkretëtire.

“Po zotëri, e di.” - iu përgjigj shkurt Rabi.

“Hirësi, Ju, sonte,po e lëshoni Izraelin për herë të dytë. Këtë herë po veni në drejtim tjetër nga të bijtë e Jakobit. Sa do të rrini atje? Kur do të ktheheni në Izrael? Kush do t’ju kthejë? Mbase e keni lexuar në ndonjë pergamenë?”

“Zotëri, mbase kuvendi juaj mund t’ua dobësojë moralin nxënësve të mi” - i ndërhyri dykuptimshëm Rabi

Mefistoja e kuptoi dykuptimësinë e Rabis.

“Përkundrazi hirësi. Ajo çka kam me ta thënë do të vlejë edhe për Juve edhe për nxënësit Tuaj të Sanhredinit” - i pushoi paksa Mefistoja për ta parë qëndrimin e Rabis.

“Përvoja e Juaj aq e gjatë në teatrin e Berlinit do të më ndihmojë mua po mbase edhe nxënësve të mi të Sanhredinit”-pushoi Rabi duke e pritur kuvendin e Mefistos,më shumë për nxënësit e Sanhredinit se për vetveten e vet.

“Kneseti i Madh i Jerusalemit të ka dënuar për tradhti ndaj shtetit” - çeli kuvend Mefistoja

“Po zotëri, më ka dënuar si askënd në historinë e Jerusalemit”- ankoi Rabi Jochanan ben Sakai.

“Hirësia Juaj është aq i dinjitetshëm, aq i lartë, për t’u dënuar aq poshtërsisht. Hirësia Juaj assesi ta marrë me mend ç’do të thotë të varrosesh i gjallë në mishin e kones së Danielit”- ndaloi paksa i ngulfatur Mefistoja.

Rabi heshti. E shtrini heshtjen e thellë mbi nxënësit e vet të Sanhredrinit. Ai e mëtoi Mefiston ta zbatojë atë zë dramatik të mësuar në teatrin e Berlinit.

U moren vesh.

“Unë, hirësi kam jetuar aq shekuj në mishin e këlyshit të doktor Faustit. Çdo të dytën mbrëmje më është duhur të dal nga mishi i këtij këlyshi për t’u bërë gazi i botës në teatrin gjerman. Sa herë dilja nga mishi i këlyshit të doktor Faustit i shihja zonjat evrogjermane se si i mbanin shamiëjzat mbi hundët e tyre nazike për t’u mbrojtur nga kutërbimi i rëndë i mishit të këlyshit hebre” - gati përvajshëm i foli Mefistoja.

“Zotëri e kuptoj. E kuptojnë edhe nxënësit e mi të Sanhredinit se të dy kushtet e vena nga Tribali i Madh i Rabinëve të Jerusalemit dalin të paarritshme, vetasgjasuse. Ne do ta humbim luftën me Romën Imperiale. Sipas Tribalit të Madh të Rabinëve, Izraeli duhet të hyjë, ndërkyeshëm në luftë të pabarabartë me Romën. Sipas tyre Izraeli duhet të vdesë heroikisht, jo të jetojë mençurisht”- daloi,paksa i shqetësuar Rabi Jochanan ben Sakai.

“Ju u arratiset, hirësi, për të jetuar Izraeli. E kuptoj. Ju Hirësi doni ta shpëtoni kodin hebre të Izraelit.Unë kam ardhur sonte deri në këtë shkretëtirë të ftohtë t’Ju them të mos e pranoni as kushtin e dytë të Tribalit të Madh të Rabinëve të Jerusalemit. Përveç moshyrjes në luftë të pabarabartë kundër Romës imperiale mos pranoni ta stërkeqni Kodin e Izraelit në mishin e këlyshit të kones së Danielit”- gati urdhëroi Mefistoja

“Si do ta gjykoni punën time?”- e pyeti mbase provokueshëm Rabi.

“Mos i beso, hirësi, hobes së Davidit! Tashmë perënditë po merren me punë tjera, më praktike. Rrufetë e tyre qiellore po i përdorin nëpër dhoma hotelesh për t’i djegur klitorisat e rebeluar, për të vrarë vajza të ngjasuar në atë Marinë Magdalenë. Gjeje një mitër të gruas hebreje! Arratisu brenda mitrës së gruas gjatë gjithë Shtatëmbëdhjetë minutave hebreje të Izraelit deri tek Shtatëmbëdhjetë minutat e orgazmës amerikane të indigjenes Iroki Pocahontas Powhatanit të Massachussettsit. Vetëm

aty mund ta shpëtosh Kodin e Izraelit. Edhe aty, në mitrën e gruas hebreje, e ke vështirë të hysh meqë perënditë po kujdestarojnë nga njëzet e katër orë buzë klitorisave, buzë orgazmave, midis vagjinave dhe penisëve për t'ua ndaluar rebelimin"- zëshëm foli Mefistoja për ta dëgjuar nxënësit e Rabi Jochanan ben Sakai.

"I ka rënë në të Djalli"- u rrokullis në vetveten e vet Rabi.

"Sa kohë duhet qëndruar në mitrën e gruas hebreje, po qe se ndonjë hebreje do të pranojë të ma huazojë mitrën e saj"-e pyeti Rabi midis provokimit e dyshimit edhe pse Mefistoja i tha më parë.

Mefistoja, i vetëdijshëm se Rabi po i bënte të dyja: provokimin dhe hezitimin, sepse një Rabi të kërkojë këshillë nga Mefistoja Bezibul.- nga Djalli, do të ishte jo vetëm përçmim, vendosi t'ia thotë drejtpërdrejt para nxënësve atë që ia tha pak më parë.

"Në Mitrën e gruas hebreje, po e gjetët në Izrael, hirësi, do të qëndroni gjatë tërë Shtatëmbëdhjetë minutavetë Orgazmës hebreje të Izraelit deri tek Shtatëmbëdhjetë minutat e orgazmës amerikane të Indigjenes Iroki të Massachussetsit"-e potencoi çdo fjalë, njënganjë për ta dëgjuar të gjithë nxënësit e Sanhredinit të Rabi Jochanan ben Sakait.

"Të gjitha i di ky Djalli Mefisto."- sërish u rrokullis në vetveten e vet Rabi, duke vendosur ta pyesë, poaq provokueshëm.

"Kush do të më nxjerrë në fund të Shtatëmbëdhjetë minutave të qëndrimit në mitrën e gruas hebreje?"- vazhdoi Rabi Jochanan ben Sakai këtë herë me mëtesën për të marrë vesh se ç'mendon Mefisto Bezibul.

"Hirësi, ju e dini se unë jam vetëm një maskotë e punuar nga zhguni i trashë. Më nxjerrin dhe më rysin në mishin e këlyshit të doktor Faustit, gjithashtu të punuar nga zhguni i trashë. Në çdo akt të dytë të dramës "Fausti" më nxjerrin me një lloj

makine primitive nga mishi i këlyshit të doktor Fausti. Posa doktor Fausti çdo natë gjermane ndahet nga kjo botë, me muzikë engjëllore, si fitimtar, bie perdja. Punëtorët e teatrit të Berlinit më marrin mua Mefiston B edhe më fusin në barkun e këlyshit të Doktor Faustit duke më përgatitur për shfaqjen e ardhshme"- ankoi Mefisto B.

"Po përse Ju, zotëri e heshtni, pa e protestuar, këtë ritual teatral, kur është aq i neveritshëm, aq përçmues për juve. Apo, t'ju thoni punëtorëve të skenës t'u lënë jashtë mishit të këlyshit të doktorit bile deri të nesërmen, pak para se të fillojë shfaqja?" - e pyeti Rabi me një lloj cinizmi.

"Më kot e kam provuar edhe këtë mëtesë. Regjisori e ka kundërshtuar duke më thënë se e kam pasur të zorshme derisa më kanë mësuar të qëndroj tërë natën në mishin e këlyshit-maskotë të doktorit. Ndryshe, po të zgataraqesha, të sorollatesha terë natën jashtë mishit të këlyshit, zor të më fusnin brenda kur të fillonte shfaqja e doktor Faustit, ajo shfaqje për ta vënë Gjermaninë në lajthim"- terthorazi Mefisto B ia dha kumtin Rabi Jochanan ben Sakait.

Nata në shkretëtirën e Negevit sa po vinte e po shtrëng-onte. Rabi u mbështoll edhe më në zhgunin e trashë duke e ndje të ftohtit nën rrobën e hollë të Sofisë së Bohemisë. Ajo e mbante mbi supe pelerinën e kuqe, ngjyrën e së cilës mezi e dalloi Rabi nën dritën furfuritëse të atij biçim pishtari. E pa veten në lajthim. Ishte sjellë halldupçe, i rrëmbyer qe në fillim nga Mefistoja duke ia marrë gjasën të flasë me atë zonjë të lartë, e cila e kishte marrë mundimin të arratisej nga teatri i Berlinit deri në shkretëtirën e Negevit për t'u takuar me ketë Rabi të varfër. U ngrit në këmbë, ashtu i mbështjellë në zhgunin e trashë. I bëri disa hapa në drejtim të saj. Iu qas me nderim.

"Zonjë e lartë, Djalli e ka tunduar Jezusin diku në fund të kësaj shkretëtire. Megjithëse unë i përkas besimit të Mojsiut, Djalli Mefisto më tundoi sa të vonohem para madhërisë Suaj,

Zonjë e lartë”- u përkul paksa me reverancë para Sofisë së Jakovës së Jersalemit të shoqes së Rainhard von Grainhelmit të tretë, Trashëgimtarit të Fronit Mbretëror të Bohemisë, ky Rabi Jochanan ben Sakai - rektori i dy universiteteve të Izraelit.

“Hirësi, edhe njëmijë vjet do të kisha pritur para këmbëve Tuaja, pa e ndjerë mërzinë për asnjë çast, vetëm për një kumt të zënë nga mendja e Juaj e ndritur e, nga shpirti i Juaj Trim”- iu përgjërua Sofia e Bohemisë, e pehatur për një çast t’i bie para këmbëve, në rërën e ftohtë, Rabi Jochanan ben Sakait- Rektorit të të dy universiteteve të Izraelit.

Rabi Jochanan ben Sakai qe aq i shkathtë sa ta mbajë Sofinë e Jakovës së Jerusalemit të mos perkulet deri në rërë para këmbëve të tij.Sofia e Rainhardit të Bohemisë, edhe pse Rabi kishte lexuar në pergamena për të, iu bë tepër madhështore, e mbrojtur me sjellje mbretërore.

“Zonjë e lartmadhrishme, princeshë e Rainhard von Grainhelmit të Tretë-Trashëgimtarit Legjitim të Fronit të Bohemisë, ardhja e Juaj në këtë shkretëtirë të ftohtë të Negevit,e nderon deri në galdim një Rabi të varfër,siç jam unë sonte. I nderon nxënësit e mi të Sanhredinit”- i foli me reverancë të përsosur Rabi Jochanan ben Sakai duke ia përmendur njënganjë të gjithë titujt Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

Sofia, për një çast, e rroku tërë reverancën e Rektorit të të dy universiteteve të Izraelit. Ai gjatë gjithë diskursit emfatik gjithkund iu shmang titujve të Sofisë kah origjina e babës dhe e nënës.

Rabi e kuptoi hezitimin e Sofisë së Jakovës së Jeusalemit. E kishte të qartë se deri tek çasti i duhur, i pashmangshëm, duhej reshtur kësaj bisede.

Mefisto B, i dëgjoi me vëmendje, mbase të tepruar shkëmbimet e reverancave të Rabinit e të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.U përpoq të gjejë diç të panjohur në këtë reverancë. Gjith-

çka për Mefiston qe e njohur. Njëmijë vjet i kishte parë e dëgjuar këto reveranca në teatrin e Berlinit. A ishte ai, kot, Mefisto B?

"Sofia e Jakovës së Jerusalemit dhe unë, kemi rënë dakort qysh nga teatri i Berlinit e deri këtu,në këtë shkretetirë, hirësi, secili për brengën e ndryrë në zemër edhe pse unë,thonë, s'paskam zemër meqë jam i bërë prej shajaku rrobash ushtarake" - ia kujtoi Mefisto B. Rabi Jochanan ben Sakait.

Të tre mbetën për një çast të heshtur. Mefistoja, pak më ndrojtje, e kishte filluar kuvendin kohë më parë me Rabi Jochanan ben Sakain.Ashtu, përngutshëm ia tha gati të gjitha hirësisë së Tij. Vendosi ta përfundojë.

"Hirësi, mbase mund të frikësohesh nga vendimi i Tribalit të Madh të Rabinëve të Izraelit. Frika dhe hutesa e sjellin humbjen. Unë, Mefistoja Bezibul, e kam provuar ç'sjellin frika dhe hutesa, ndaj jam dënuar të bëhem gazi i botës duke hyrë e dalë çdo natë nëpër mishin e këlyshit të doktorit gjerman në teatrin e Berlinit. Hirësi, në të dy rastet do të jeni të detyruar në njërën mitër të futemi. Po hyre në mitrën e kones së Danielit do të mbetesh përherë atje. Kodi i Izraelit do të vdesë në mishin e qenit. Po hyre në Mitrën e gruas Izraelite do ta shpëtosh Kodin e Izraelit në fund të Shtatëmbëdhjetë minutave hebreje"- ngulmoi Mefistoja B i mbushur gojës me pluhur të shketëtirës.- "Unë, hirësi, e urrej mishin e këlyshit të doktor Faustit, e urrej përçmimin mijëvjeçar mbi racën time hebreje"- vazhdoi Mefistoja i ngulfatur nga lotët e urrejtjes dhe pluhuri i shkretëtirës.

Rabi Jochanan ben Sakait iu dhimbs Mefistoja.

"Zotëri, sonte tok me nxënësit e mi të Sanhredinit jam duke dalë nga Izraelit. Sipas marrëveshjes paraprake me gjeneralin roman, Titi, do të më epet liçenca për formimin e Universitetit hebre në Diasporë. Dola nga Jerusalemi për të arritur në tendën e gjeneralit. Rrugës ndodhi hataja. Nga shkretëtira e Arabisë, prej Sinajit u dëgjua zëri i vuvët i shtjellës së vrevët arabe:

“Allah! Allah!” Shtjella myslimane mësyni drejt Jerusalemit. Gjeneralin, Tit, dhe ushtrinë e tij i rroku amoku i luftës. U lëshuan furishëm drejt Jerusalemit para se të arrijë shtjella e vrevët arabe. Ushtarët dolën nga gjokset e tyre të ngulfatur. Askund ta gjejnë Jerusalemin. Vrapimi i kuajve, ushtarëve, të gjeneralit Titi, u bë vrapim kontinental. Gjenerali roman, Titi, edhe pse e kaloi lumin mbeti në zemër të amokut derisa ndaloi përtej lumit Erenik kur e pa qytetin e përflakur deri në qiell. Ndaloi i galduar nga fitorja e ushtrisë së vet heroike. Mendoi se ushtarët e tij po e digjnin atë qytet të Jerusalemit.

“Sa ushtri e lavdishme kjo ushtri perandorake!” - ra, i lumtur, në fund të vetvetes së vet.

Toga e vëzhguesve të ushtrisë së vet ia solli gjeneralit Titi kumtin ogurzi:

“Gjeneral i nderuar, komandant i krahut lindor të ushtrisë romane, ne sonte kemi ndaluar para qytetit të huaj para lavdisë së huaj.

Gjenerali rus,Ivan Vasiljeviq Kutozovi, sonte e paska djegë flakë këtë qytet të Jakovës, të mbyllur në guacën e katër perandorive”- i tha udhëheqësi i togës së vëzhguesve të ushtrisë së vet gjeneralit Titi.

“Cili gjeneral, cila ushtri, përveç ushtrisë romane, po arrika ta kallë qytetin e Jerusalemit?” - u mbush frymë gjenerali Titi.

“Po ky qytet është tjetër nga qyteti i Jerusalemit”-ia përsëriten.

“Si u çueka ky qytet?”- pyeti me ngashërim fëmijëror gjenerali, Titi.

“Qyteti qenkesh quajtur Jakovë, zoti gjeneral. Qenkesh në cepet e katër perandorive. I kërcënuar nga të gjitha perandoritë paskesh mbetur i konservuar nën shtatë shtresat e pushteteve të katër perandorive. Paskesh mbetur një amforë në fundin e thellë të oqeanit të pushtimeve.

Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, po përpiqet me metodën e muzhikëve rusë të Doktor Makushevit ta nxjerrë mishin ekologjik të Jakovës nga fundi i mitrës së oqeanit"- raportoi udhëheqësi i togës së vëzhguesve të ushtrisë romane duke ia ofruar buletinin e pergamenave të mbrëmjes diplomatike.

"Ç'vlerë do të kenë këto pergamena të pshurrëta? Ushtria romane sonte e ka pushtuar Jerusalemin. Çdo qytet i pushtuar sonte do t'i takojë lavdisë së Romës, pra edhe kjo JAKOVA E JERUSALEMIT"-urdhëroi gjenerali roman i ekzaltuar lavdisë.-"Dhe shkruani në pergamenën Zyrtare: "Jakova e Jerusalemit!"- vazhdoi me dy lavdi përnjëherësh gjenerali roman Titi"- e mbylli diskursin Rabi Jokhanan ben Sakai.

50.

"Hirësi!"-e pyeti Mefistoja B, Rabi Jochanan ben Sakain.– "Dhe Ju, sonte do ta bëni rrugën kontinentale deri te tenda e gjeneralit roman, Titi, buzë Jakovës së Jerusalemit?"

"Gjithsesi, zotëri.Prapa meje, në shkretëtirën e Negevi,është duke udhëtuar delegacioni i Tribalit të Madh të Rabinëve të Izraelit. Edhe ai delegacioni do ta arrijë sonte tendën e gjeneralit roman, Titi. Ai delegacion do të kërkojë nga gjenerali Titi ta anulojë liçencën për themelimin e universitetit hebre në diasporë sipas kërkesës së një renegati, siç jam unë. Ai delegacion do të lypë të më arrestojë gjenerali Titi për të më varrosur për së gjalli në mitrën e kones së Danielit"- e shpalli të domosdoshëm udhëtimin Rabi Jochanan ben Sakai.

"Atëherë, ju, hirësi qenket në rrezik"- i tha shkarazi Mefistoja, jonjëmendsisht Rabis.

“Po ju, zotëri, vetëm thatë se duhet zgjedhë domosdo njëra mitër: ajo e Kones së Danielit ose Mitra e Gruas së Izraelit”– ironizoi Rabi.

“Zonjë e lartë!”- Mefistoja iu drejtua papritmas Sofisë së Jakovës së Jerusalemit,me një zë krejt të ngjirur,regetues.- “Tashmë Ju, zonjë, do të udhëtoni me këtë Rabi. Lagështia e natës së ftohtë të shkretëtirës më ka hyrë në zemrën time prej maskote zhguni. Unë do të zhbëhem këtu”- tha Mefistoja B duke u shndërruar në grumbull rrobash të trasha në të cilat ishte arratisur i zoti nga teatri i Berlinit.

Rabi Jochanan ben Sakai qëndroi për një çast para grumbullit të rrobave të Mefistos. I erdhi dhëmshuri për atë maskotë teatrale të nëpërkëmbur aq pamëshirshëm në teatrin gjerman.

“Varroseni me nderim këtë Maskotë. Shkruani diç në stelen e varrit të tij!”

Më në fund Mefistoja Bezibul shpëtoi nga mishi i këlyshit të doktorit gjerman.

Në një varr në shkretëtirën e Negevit shkruan:

Me një orgazëm do ta nxirrja Gjermaninë nga teatri i Berlinit.

Me një mitër të gruas hebreje do ta shpëtoja kodin e Izraelit.

51.

Pasi ledhi i rërës u rrit mbi varrin e Mefistos, Rabi Jochanan ben Sakai iu drejtua Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

"Atëherë do të udhëtojmë tok deri në Abbi. Është afër nga këtu. Gjatë rrugës mund të liroheni nga tundimi i Mefistos. Ai qe vetëm një maskotë e teatrit gjerman.Ai gjithnjë ka lektisur ta zgjojë orgazmën tek njerëzit, pa arritur ta bëjë këtë zgjim meqë e kishte të pamundur nga stofi i trashë"- e shpjegoi çuditshëm Rabi Jochanan ben Sakai.

E zunë rrugën për tek fshati Abbi. Gjurmët e Rabi Jochanan ben Sakait në rërën e ftohtë mezi dalloheshin ravës së çelur nga nxënësit e Sanhredinit. Hëna e ftohtë, zvetnueshëm mbi cukalin e rërës po gërhiste në pikë të gjumit. Rabi e shikoi hënën e përgjumur disi çuditshëm.

Abbi u shfaq pas cukalit të tretë të rërës, i malcuar në gjumin e natës sikur po mëshihej nga vetvetja.

"Arritëm" - tha Rabi duke qëndruar në vend

"Ku arritëm?" - u tremb Sofia.

"Në Abbi, atje ku jemi ftilluar" - u përgjigj Rabi

Sofia e Jakovës së Jerusalemit u katandis për të dalluar diç nga shenjat e Abbit. Ajo pa vetëm shkretëtirë të përgjumur.

Të gjithë ndaluan, së pari nxënësit e Sanhredinit. Po vezhgonin diç, të heshtur. Po e konsulltonin mençurinë e rërës.

Rabi e shfrytëzoi ndalesën e nxënësve të Sanhredinit për ta pyetur Sofinë krejt pëshpëritshëm.

"Përse e ke bërë gjithë këtë rrugë nga teatri i Berlinit deri në këtë shkretëtirë?"

"Hirësi" - u përgjigj Sofia.- "Erdha për ta takuar Hirësin Tuaj. Në pergamenë shkruan se Rabi Jochanan ben Sakai-Rektor i dy universiteteve të Jerusalemit e paskesh takuar vëllain tim-Kostantinin e Haçet Deletës së Dytë,mbretit të Ilirikut Albanik"-u përgjigj gati fëmijërisht Sofia e Jakovës së Jerusalemit.

Rabi hoq dorë nga biseda e mëtutjeshme. U ftilluan drejt fshatit Abbi.

Vrujoi një shenjë nga zemra e shkretëtirës. Ishte të lehurit e një qeni. Shenjë se Abbi ishte me një të zgjatur dore.Gati pahetueshëm paskeshin hyrë në fshat.

Rabi u drejtua kah një tendë e përhitur, e shkrirë me rërën shkretinore të natës së aftimtë. Sofia më vonë e hetoi tendën, vetëm kur Rabi i dha karar një fishkëllime të dikujt. Shenjë e kumtit të mirë. Menjëherë u shfaqen tri hije, mezi të dallueshme nga përgjumja e rërës së ftohtë.

"Këtej hirësi" - foli njëra nga hijet.

Të gjitha përshëndetjet u bënë heshtazi, në konspiracion të thellë.

Vetëm kurë u afruan tek hyrja e tendës, Sofia vërejti se sa brenda fshatit kishte arritur. Nxënësit mbeten jashtë tendës, mbase do t'i kishin drejtuar diku tjetër. Në midis të tëndes qëndroi Rabi Jochanan ben Sakai. Për herë të parë Sofia e pa, të tërin Rabinin. Drita e nxjerri nga vella e natës shkretinore. Ishte burrë i gjatë, i lidhur, thatanik. Të lente përshtypjen e një atleti, më tepër se të një rektori. Sytë i kishte të mbushur plot dritë shituese.

Sofia e Haçet Deletës, për herë të parë u tundua nga drita vezulluese e atyre syve. Në fund të barkut e ndjeu një sëmbim, të gjarpërt. Pastaj lëngu i ngrohtë vegësh u turr, protestueshëm teposhtë. E pa të tërin Rabi Jochanan ben Sakain, Rektorin e të dy universiteteve të Izraelit. Të dy qëndruan në midis të tendës. Rabi i bëri vetëm dy hapa drejt Sofisë. U përkul para saj duke ia zënë në dorë një ble floku, pisë të zeza. Vetëm një ble floku. Me dorën tjetër ia leu me vaj blenin e flokut, me një vaj të zënë me dy gishta nga një kupë e venë në tryezë.

Sofia e Haçet Deletës e njohu këtë shenjë.

Ajo ishte bërë grua

Rektorit- Jochanan ben Sakait as i vajti ndër mend t'i ofrojë vend për t'u ulur Sofisë. Ajo qëndroi në këmbë duke pushuar e mbështetur në ajër.

Rabi Jochanan ben Sakai-Rektori i të dy universiteteve të Izraelit e riktheu plotëninë e dritës së syve mbi Sofinë, të shoqen e Rainhard von Grainhelmit të tretë, trashëgimtarit të kurorës mbretërore të Bohemisë. Ishte përshëndetje për zonjën.

Rabi e mori një qëndrim të përshpirtshëm. Sofisë iu përngja sikur Rabi foli me dikend tjetër. Mezi e pikasi siluetën e një gruaje të dalë nga tisi i ajrit të tendës.

"Po, është ajo Rebeka e Alamekut"-sikur i tha dikush.

Sofia nuk arriti të kuptojë asgjë nga biseda e Rabis me Rebeken.

Gruaja e bërë nga ajri u zhbë. U largua.

Rabi iu kthye Sofisë.

“Zonjë e lartë, ta marrësh mundimin për të udhëtuar, kaq përngutshëm, prej teatrit të Berlinit deri tek kjo tendë e varfër më nderon, mua veçan”- çeli kuvend Rabi.- “Kjo na detyron, zonjë e lartë, të jemi nën urdhrat Tuaj”-sërish ra brerorja në sytë e përshkënditur Rabis.

Sofia u hutua nga brerorja në sytë e tij. Ishte një dritë tjetër, lëbyrëse, pasi Rabi u kthye prej Rebekes. Sofia prapë u qull vegëve.

“Sonte Jeni bërë grua, zonjë e lartë”- ia kumtoi, madhërisht Rabi.

“Rabi i hirësuar,unë,Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e shoqja e Rainhard von Grainhelmit të Tretë, Trashëgimtarit legjitim të kurorës së Bohemisë paskam qenë deri sonte diç tjetër, krejt tjetër, po jo grua!”- iu kthye krejtësisht e ngazëllyer Rabis.

“E keni thënë të vërtetën, krejtësisht të vërtetën, zonjë e lartë, e të gjithë këtyre titujve mbretërorë, përveç titullit të të qenit Grua” - e shpalli qetas Rabi.

“Rabi i hirësuar- Rektor i dy universiteteve të Izraelit, në pergamenë shkruan se Ju, Hirësi, e pasket takuar Kostantinin e Haçet Deletës- tim vëlla. Unë, pasi u bëra grua, ju them se kam ardhë tek ju ta vërtetoj në kam pasur ndonjëherë vëlla.A ka mundur nëna ime, me atë diagnozë të lindë fëmijë?”- këtë herë Sofia vetëm foli me një dëshirë të shuar për të vëllain.

Ajo qe bërë grua me orgazëm.

E kishte parë Rebeken e Alamekut.

“Zonjë e nderuar, babai juaj, Haçet Delta qe masturbuesi më i shquar në të gjithë Ilirikun Albanik, mbase edhe në tërë Evropën.Për të, jo vetëm për babain Tuaj, e nënën Tuaj qenë të panjohura:Orgazma,Dashuria,Klitorisi, Seksi. Ai, babai Juaj, zonjë e nderuar, e njihte vetëm pjellën e masturbimit.

Fëmijët e masturbimit vinjnë nga seksi pa orgazëm nga seksi i kafshëve dhe i perendive. Këta fëmijë nuk e njohin njëritjetrin. I njohin vetëm perënditë dhe instinktin e mbijetesës shtazore.Ndaj Kostantini, për të cilin e keni fjalën, nuk Ju njeh Juve, zonjë e nderuar. Edhe Ju nuk do ta kishit lypë Kostantinin sikur të mos kishit fjetë një natë në dhomën e shtatë të hotelit "Laguna" të Trieshtës tok me Tët shoq, Rainhard von Grainhelmin e Bohemisë.

Në këtë dhomë të hotelit "Laguna"të Trieshtës vetëm një natë më parë e kishin vrarë profesoren e shkollës artistike të orgazmës, Zatren Arameje. U konstatua se vrasësi i saj paskesh deshur t'ia grabisë orgazmën.

Me të hyrë në këtë dhomë, Ju zonjë e nderuar, u deshet deri në lëkurë meqë ishte agushi frrymezënëse. U matët të hyni në banjë por nuk hytë. U kishtë rrokë përgjumje orgazme. Ashtu e lakururiqur u shtritë në shtratin e Zatres Arameje, të një natë më parë. U mbuluat me të njëjtin çarçaf. Sekretimi i orgazmës së Zatres u ngjall nga ngrohtësia Juaj. Tok me gjumin Tuaj hyri në Ju, zonjë e nderuar. Atypëraty u bëtë grua me orgazëm. Gjithë natën folët përeqartë, u përpëlitët.

Në gjysmë të natës u muar vesh se dhoma u ishte dhënë gabimisht meqë ajo dhomë ishtë nën vëzhgim të rreptë. Ju kujtohet, zonjë e nderuar se ua ndërruan dhomën si shenjë e përkujdesjes për familjen mbretërore Grainhelm të Bohemisë.

Ju, zonjë e nderuar mund të pyetni çka të doni po ne jemi përngutë. Do të marrim rrugë. Gjatë rrugës do të bisedojmë. Mos humbni kohë e mund pas atij Kostantinit të asaj balade të pagjini.Ai as nuk u njeh as nuk e njihni. Në pergamenat zyrtare mbi gjendjen shëndetësore të nënës suaj epet diagnoza:"Sanguis lacertae in utero"- zëroi kujdesshëm Rabi.

"Hirësi, po përse u hodh gjak hardhuce në mitrën e nënës sime, kur babai im- Haçet Deleta i dytë, mbreti i Iliriku Albanik ishte i pabërë, i paaftë për atë seksin e orgazmës? Ai paskesh

ditur vetëm të masturbojë?”-ankoi Sofia e Jakovës së Jerusalemit.

“Zonjë e lartë, ju e moret tepër ters. Këtë diagnozë e kanë të gjitha gratë e Evropës edhe vetë Evropa. Ju zonjë e lartë, jeni vetëm njëra nga ato Leonorat e orgazmës, të cilat po i lypin vëllezërit e masturbimit gjithandej Evropës deri tek teoria e atij Sigmundit të Vjenës në atë psikonalizën e animës dhe animusit. Juve grave të Evropës, të zgjuara seksit, orgazmës, u janë ngatërruar vëllezërit,babatë,dashnorët, bijtë, nëpër balada hermafrodite. Zonjë e lartë, teoria e animës dhe e animusit u bë dekalogë e masturbimit politik nëpër gjithë Evropën…” - e çaprapikoi Sofinë Rabini.

Sofia ra në vetveten e vetë të dyshimit. Ishte çaprapikuar prej mendjes.

“Zonjë e lartë”- vazhdoi Rabini.- “Ju edhe po të kishit pasur vëlla, tashmë u është bërë e pamundur ta njihni. Në vendin e Haçet Deletës, në atë Shqipërinë e Albanikut sovjetik të tij, të gjithë shtetasit, përveç Jezofinës së Ndojes, janë vaksinuar me “Sanguis lacertea in musculo” dhe me vaksinën “Sanguis lacertea in cerebro”.Kjo vaksinë e prodhuar në laboratorin “Mendeljev” të Moskës të gjithë shtetasit e Shqipërisë së Albanikut sovjetik i ka liruar nga çdo lloj mishi duke i bërë vetëm skelete. Ata shtetas janë liruar nga përdorimi i rrobave, nga ushqimi, nga të menduarit…vullnetarisht janë bërë të njëjtë. Dhe zonjë e lartë midis këtyre skeletve kot, krejt kot, do të përpiqesh ta gjesh atfarë Kostantinin e Haçet Deletës.

“Hirësia juaj, përse të hidhet i gjithë ky gjak hardhuce nëpër mitra,nëpër muskuj,nëpër tru të shtetasve të asaj Shqipërie Albanike?”–dëshpërueshëm e pyeti Sofia e Jakovës së Jerusalemit.

“Para shtatëdhjetë vjetësh Zatra Arameje po udhëtonte nëpër Jude kur Jezusi ia zgjoi orgazmën, dashurinë, seksin klitoritin.Atë ditë kur deshen ta vrasin me gurë Marinë Magdalenë, Roma, Athina, Tribali i Madh i Rabinëve të Izraelit, po i bënin

perenditë e tyre nga argjilli i pjekur, nga guri i gdhendur, nga metali i shkrirë.

Ai hebreu, Jezus u bë perëndia i parë i dalë nga mitra e gruas hebrje. Ai, vetëm ai, i dinte: orgazmën, dashurinë, seksin. Roma e perëndive të argjillta, e Janusit dyfytyrësh, në mënyrë diplomatike e denoi atë Jezusin hebre me Hosana Baraba nën akuzën:"Abuzues i pjelljes vertikale të perëndive! E denoi Roma duke thënë se ky denim mbi Jezusin qe vullneti i rabinëve të Izraelit.

Edhe sot rabinët, po edhe të gjithë hebrejt, përndiqen tok me djallin kudo nëpër Evropë.

Jezusi u shpall bir i zotit dhe i mitrës së gruas. E mori liçencën e seksit, të orgazmës, të klitoritit. Ai tashmë ishte i pajisur me të gjitha kur atë ditë e sollën Marinë Magdalenë para tij për ta dënuar. Në shesh, para Jezusit qëndroi, me gur në dorë, edhe ai Zeusi halldup.Ai lektiste, i pari, për ta goditur me gur Magdalenën. Edhe sot e mbanë atë gur në dorë.

Atë ditë kur Jezusi hebre i tha asaj gruas hebreje, e cila e kishte prishë rendin e masturbimit hyjnor, mbretëror…"Të shpëtoi Dashuria e Madhe" Zatra Arameje ishte aty. U qull vegësh.

Zatra Arameje u bë grua. E njohu orgazmën…

Zonjë e nderuar gratë e orgazmës e njohin njeriun, burrin, djalin, babain, dashnorin, vëllanë, siç po bëni Ju, zonjë. Por në Ilirikun Albanik të Haçet Deletës, përveç Jezofinës së Ndojës, të gjithë shtetasit, vullnetarisht janë shndërruar në skelete"- u mvrejt gjatë shpjegimit Rabi Jochanan ben Sakai.

"Po ajo Maria Magdalenë, para se të bëhej grua si mund të prostituonte?" - shkërmoqshëm pyeti Sofia

"Zonjë e lartësuar, ajo Maria Magdalenë kur i kishte bërë trembëdhjetë vjetë ishte sëmuar nga ajo e tokës. Një grua samaritiane i kishte thënë të ëmës së Magdalenës se vajza e saj nuk do të shërohet pa e vënë në grazhdin e Betlehemit.

E ëma e dërgoi vajzën atje. E futi në grazhd gjithë natën e lume.

Maria u përpëlit. Në të kishte hyrë orgazma.

E shpallën prostitutë.

Tashmë grazhdin e Betlehemit e ruajnë”-ia këputi shkurt Rabi pa e shuar atë dritën tjetër në sytë e mbushur gelim.

Sofia heshti.

E kuptoi se kishte shkuar më larg se ç’i lejohej, pasi tashmë ajo ishte bërë grua sipas lëngut të rrjedhë vegëve teposhtë. Në mishin e saj femëror, fundit të pubisit,e ndjeu gudulisjen sëmbuese për një lloj mishi tjetër.

Rabi e zu heshtjen e Sofisë.

52.

Rabi Jochanan ben Sakai e ndjeu mbi supet e veta peshën e ajrit të rënduar nga mëtesa e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Ende në këtë grua gjallonte pyetja.

Paksa i tendosur iu kthye asaj. Sytë, ende i kishte të brerortë.

"Ju, zonjë e nderuar, po i kapët Shtatëmbëdhjetë minutat e Orgazmës së Jakovës së Jerusalemit para se t'i vritet kodi gjenetik me metodën ruse të doktorit Makushev të gjeneralit, Ivan Vasiljeviq Kutozovit,do t'i keni të gjitha: orgazmën, dashurinë, klitorisin, seksin e, mbi të gjitha do ta njihni fëmijën Tuaj"- u rrëmbye hirësia e Tij Rabi Jochanan ben Sakai.

"Hirësi!"- u përvaj Sofia.- "Ç'duhet të bej, unë e varfra për t'i kapur "Shtatëmbëdhjetë minutat"e orgazmës së Jakovës së Jerusalemit?"-

“Zonjë e lartë, ju do ta zbuloni Orgazmën, Dashurinë, Seksin …” i tha troç Rabi, më përngutshëm.

“Po si mund t’i zbuloj të gjitha këto përnjëherësh?”– vazhdoi Sofia.

“Andej e kemi rrugën”- i tha dykuptimshëm Rabi duke ia dhënë shenjën për t’u ftilluar.

U tfilluan nëpër rerën e shkretëtirës. Ketë herë Rabi u nis përpara nxënësve të Sanhedrinit të vet. Atyre, për një kohë, u dëgjoheshin hapat. Hëna ende po dremiste mbi cukalin e rërës së grumbulluar nga huqet e erës. Gati po pikte, e përgjumur, në rërë.

Rabi e shpejtoi, qëllimisht, hapin duke e shpëtuar Sofinë nga përgjumja e hënës. Rëra sa vinte e pakësohej derisa u zhduk. U shfaq toka e fortë, ngrehaluce e natës. Pastaj ajri u bë më i rrymimët fytyrës së Sofisë. E ndjen një boshllëk në gjoks. E pa vetëm valëvitjen e pelerinës së Rabinit.

Ajri ndaloi në vend. Pelerina e valëvitur e Rabis u palua. Këmbët u zunë dhe. Ata po qëndronin në majë të malit. Sofia shikoi andej poshtë. Hënës së përgjumur po i derdhej, kuturu, drita andej kah lugina.

Rabi Jochanan ben Sakai ndaloi para një tendë. I mbushur frymë, si përqartë, ngulfatshëm, ra rrebesh fjalësh mbi Sofinë.

Të gjitha i tha përnjëherësh, krejt me çapraz:

“Sonte zbarkoi në Sicili Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatani e gjeneralit John Harkerit të Massachusettsit. Ajo e solli në Evropë atë Jezusin e saj indigjen ekologjik.

Zatra Arameje u takua me Indigjenen Iroki, Pocahontas Powhatanin e gjeneralit John Harkerit të Massachusettsit diku në Italinë Jugore. Ushtria e gjeneralit amerikan pas pak orësh do të jetë në Romë në atë Klinikën “Gemeli”, jo për diagnozat e nënës Suaj por pikërisht për Juve.

Duke u kthye nga Italia jugore Zatra Arameje ndaloi në stacionin e trenit në Trieshtë. Dikush thotë se ajo po kthehej nga Stambolli.

Spas të gjitha pergamenave në stacion e takoi Zevsin Spiridonis Zevsin. Ai ia lypi Zatres dy seanca orgazme në shkollën e saj.

U vendosen në hotelin "Laguna" të Trieshtës.

Sipas të gjitha pergamenave të shkruara në kohën e Magdalenës Zatren Arameje e vrau Zeusi pikërisht në hotelin "Laguna" të Trieshtës. Ia dogj Klitorisin me rrufe. Kokën ia dërmoi me gurin të cilin e mbajti në dorë atë ditë kur deshi ta vrasë Marinë Magdalenë, para Jezusit.

Kjo tendë, këtu para nesh, është e Zatres Arameje. Brenda në tendë gjendet i shtrirë lakuriq rektori duke u përpëlitur në sulmet e njëpasnjëshme të orgazmës. Hyr brenda në tendë. Shtriju mbi shtatin lakuriq të rektorit të Jakovës së Jerusalemit. Fute mishin e tij mashkullor në mishin tënd të berë grua. Shtriju mbi penisin e Radalk san Heldikut, rektorit të Jakovës së Jerusalemit. E spërlëngur dy spermash do të udhëtojmë tok, me avionin e orës dy të kësaj nate për në Romë. Në kliniken "Gemeli" do ta takojmë Indigjenen Iroki, Pocahontas Powhatanin e gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsit.

Në të gjitha pergamenat informata do të ipet e turbulltë. Për njeriun e shtrirë në tendën e Zatres Arameje do të ipen variante të ndryshme.

Shpëtoje mishin e mishit tënd të Jakovës së Jerusalemit! - e urdhëroi prerazi Rabi Jochanan ben Sakai.

Sofia e Haçet Deletës së dytë të Ilirikut Albanik, e shoqja e Rainhard von Granhelmit të tretë, trashëgimtarit të kurorës mbretërore të Bohemisë e kapi zërin e Rabi Jochanan ben Sakai me tërë shajninë, aq vullnetshëm sa, pa asnjë hezitim hyri në tendën e Zatres Arameje.

Derisa hyri diç ndodhi. Brenda kishte dritë të djersitur, të shpërndarë nëpër ajrin e amullt të mbushulluar ngrohtësi malcuese. Gjendja e saj ndryshoi. Mbi mishin e teptisur iu benë dy lëkura të vapullimta. Ngasja e zgerlaqja e munden. Harroi çdo gjë. Pergamenat u përzien. Duhej zdeshur të gjitha lëkurat derisa të dalë lakuriq.

Pasi u pajtua me ajrin e rënduar prej djersitjes e pa atë burrin e zhveshur mbi të cilin pluskonte avulli i mjegullt. Ishte i lakuriquar duke u zier në djersë, i shkrirë mbi lëkuren e dendur, ngulfatëse, të ariut.

Sofia për herë të parë e pa një ligotë të shkrirë prej mish mashkulli. Ndjeu tundim të papërballueshëm për t'i hequr të gjitha lëkurat nga vetja e saj. Në fund mbeti lakuriq vetëm mishi i saj femëror, jashtë të gjitha lëkurave.

Ajo ligotë e shkrirë prej mish mashkulli, mish gaull, e përpini mishin femëror të Sofisë. Ndjeu tundim të papërballueshëm. Bënte vapë tjetër në mishin e saj. Duke i hequr, marramendasi, lëkurat nga shtati i saj, i arrdhur femëror, të një gruaje të berë për mbrëmjen e pjekur të korrikut, sytë e etur i kishin mbetur mbi penisin-hell të ligotës së mishit mashkullor.

E malcuar deri në dhimbje e ledhatoi atë hell mishi mashkullor kur dora iu mbush me lëngun veshtullor. U shkrirrëshire mbi vapën e djegagurit. Mishi mashkullor- hell i vapullimt po futej në mishin e saj femëror, ajo humbi në gjëmat e tokës. Fluturoi nëpër vagjinën e qiellës, nëpër qiellën e vagjinës deri tek orgazma.

"Është orgazma" - i zvargur i erdhi zëri i Rabi Jochanan ben Sakait.-"Tashmë, të gjitha i ke në mitrën tende: babanë, vëllain, burrin, kodin e popullit tënd, birin tënd, nënën tënde, motrën tënde atdheun tënd. E arrite orgazmën, Dashurinë së Jezusit ekologjik të Indigjenes Iroki-Pocahontas Powhatan të gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsitit. Tfillohu me avionin e orës dy të natës! Atje në klinikën "Gemeli" të Romës na pret

Indigjenia Pocahontas Powhatan e gjeneralit, John Harkerit me tërë stafin e saj”-nga larg e njohu Rabi Jochanan ben Sakain

Sofia- e shkrirë rrëshirë mbi gurin e vapullimt të djegagurit, e përjargur zërit të zvargur të Rabi Jochanan ben Sakait, ndjeu kur u trand tenda e Zatres Arameje, u trand toka nga të ecurit e përbindëshit.

“Arrite në çastin e volitshëm të Dashurisë” - i erdhi zëri i Rabis.- “Tash nxito në aeroportin “Ben Gurion”! Avioni për në Romë fluturon në orën dy të natës”.

...Sofia e Jakovës së Jerusalemit e pa, gjithkund para vetes, nëpër shkretëtirën e Negevit, pelerinën valëvitëse të Rabi Jochanan ben Sakai deri tek aeroporti “Ben Gurion”.

53.

U përzien mishrat, spermat, pergamenat, toka.

Trandja e tokës pushoi kur në tendën e Zatres Arameje hyri gjenerali turk, Gyner Jyllmaz - vetë ai, i përcjellë nga i gjithë stafi i gjeneralshtabit. Brenda tendës së Zatrës bënte vapullim. Ajri i rënduar prej djersësh kutërbonte diç të panjohur për hundën e eunukut. Çdo gjë veshtullonte mbi shtatin lakuriq të rektorit të Jakovës së Jerusalemit - Redalk San Heldikut, ashtu të përhumbur në vazhdën e orgazmës. Ai ende po përbirohej nëpër të çarën - vagjinë të qiellit për të zbritur në tokë.

Gjenerali, Gyner Jyllmaz e shikoi përbuzshëm Redalk san Heldikun e shtrirë lakuriq mbi lëkurën leshtake të ariut.

"Ky qenka ai ushtari i arratisur para dy orësh nga radhët e ushtrisë së lavdishme të padishahut mëshirëmadh. Ajo kurva, Zatra Arameje, e magjepsi, përgjumshëm deri te tenda e saj. Çuditërisht ky ushtar paska mbetur i pabërë synet- foli gjenerali turk para stafit të vet.

54.

Redalk san Heldiku, rektori i Jakovës së Jerusalemit ishte vërtet i përgjumur nga ushtrimet e rënda ushtarake, tërditore, me trupin e mpirë nga lodhja, midis gjumit dhe ëndrrës kur e ndjeu një errëtim të tjetërllojt mbi veteveten e vet. Ishin flokët e zeza pisë të Zatres Arameje.

Ashtu, përgjumshëm, Redalk san Heldiku u josh pas Zatres Arameje deri tek e çara-vagjine e qiellit orgazëm. Ndjeu se paskesh dalë nga pasha e trupit të vet. Kur Zatra e ndjeu se për Redalk san Heldikun nuk kishte më kthim prapa i tha në midis të lëkurës së ariut:

"Po deshe kthehu në mishin e masturbimit. "

Redalk san Heldiku, mezi i foli Zatres Arameje në fund të shkretëtirës së masturbimit:

“Nga masturbimi i athët kalova në penetrim, në orgazëm; e njoha atë mishin tjetër – Dashurinë e Zatres” - u përbetua san Heldiku.

“Ta njohësh Orgazmën do të thotë se ke bërë diversion mbi shtetin.Dënimi është gjakatar”-e përmendi paksa nga magjepsja ajo.

Redalk san Heldiku heshti. Shkretëtira ishte sosë. E ndjeu aromën e pishës në fund të shkretëtirës. E njohu firomën e bjeshkës. Pastaj ndjeu se hynë diku brenda. Ajri u mbushullua me aromën e Zatres Arameje. U kolovit në drejtim të saj. U plandos midis tëndes së Zatrës, në lëkurën lashtake të ariut. Për jetë të jetës kishte dalë jashtë masturbimit.

Zatra, përngutshëm doli jashtë tendës e mbushulluar seksit të vet. Mëtohej t’i tregojë të jatit, mbretit të aramejeve -Berashit Arajasas. Në tendën e tij e gjeti të jatin e vet, mbretin e vet, krejt afër jetës, tek rrallohet ajri i bjeshkës.

“Po ta ndjej firomën e zgerlaqur bijë” - i tha i jati Zatres.

“O ati im, o mbreti im! E solla atë”- i foli Zatra e ngazëllyer.

“Pate fat, o bija ime. Ai Jezusi i Betlehemit ta zbuloi Dashurinë e asaj Marisë Magdalenë, ta zbuloi orgazmën, ta zbuloi seksin”- i foli nga ajri i rralluar Zatres Arameje i jati i saj, mbreti i saj, Berashit Arajasas.

“Po duhet përhapur zbuluesen e Dashurisë, të Orgazmës …” - i foli të jatit të vet, mbretit të vet Aramejas.

“Jo bija ime! Mos u rrembe ta marrësh mbi supet tua të hajthëm misionin e rëndë të zbulesës se Orgazmës!” - e urdhëroi i jati - mbreti Aramej - Berashit Arajasas.

“Po përse qenka mision aq i rëndë, o baba im,o mbreti im?” - u ngut Zatra Arameje.

“Atë Marinë Magdalenë, të atij hebreut, Jezusit të Betlehemit, për jetë të jetës e shpallën prostitutë” - ia shpjegoi i jati

Ç'është prostituta, o baba im, o mbreti im?" -

"Prostituta e ka zbuluar seksin e vet femëror. Me klitoritin e vet ka provuar ta zbulojë edhe seksin mashkullor. Në këtë mënyrë ajo Magdalenë është ngritur kundër masturbimit të zotave të qiellit" - ia shpjegoi rrezikun i jati.

"Profesioni i prostitutës qenka mision?- i shkrepi në kokë Zatres Arameje, sikur po hynte në luftë.

"Po, bija ime. Profesioni i zbulimit të seksit është mision, por profesion me qeder të madh"-ia tërhoqi vërejtjen i jati- Berashit Arajasas.

-"Ky profesion bie ndesh me masturbimin e Zeusit.Me masturbim Zeusi i pjellë të gjithë fëmijët e vet nënshtetas: nga koka e vet i nxjerr sundimtarët e shtetit; nga brinja e majtë i nxjerr ushtarët- vrasës- rojtar të shtetit; nga pulpi i këmbës së majtë i nxjerr shtetasit- skllavë- punëtorë.

Të tri pjellat e Zeusit masturbojnë brenda llojit të vet.

Në këtë mënyrë Zeusi-Platon, kudo nëpër Evropë e sundon shtetin e vet. Të gjitha pergamenat flasin se ti, bija ime ke rënë ndesh këtij shteti. Për këtë, bija ime profesioni yt do të jetë i rrezikshëm"-i fliste i jati-Berashit Arajasas- mbreti i Aramejisë, duke e zvargur zërin gjithnjë e më larg saj.

"O ati im, o mbreti im! Prostituta duke e zbuluar seksin e vet dhe seksin e mashkullit, qenka në rrezik nga mëria e Zeusit? " - e pyeti serish Zara.

"Po, bija ime. Duke e zbuluar orgazmën e ke zbuluar njeriun. O vajza ime! Ruaje klitorisin tënd të porsazbuluar. Zeusi i zemëruar ta shkrumbon me rrufetë e veta qiellore. Zemërimi i tij është i madh. Ai ende e mban në dorën e shtrënguar gurin gacator për ta goditur atë Marinë Magdalenë.

Meqë ajo Mari shpëtoi pa u vra atë ditë, në shesh, para Jezusit, ky Zeusi i zemëruar, në të gjitha pergamenat qiellore e tokësore e ka shpallë prostitutë" - i fliste vajzës së vet gjithnjë e

më zvargur nëpër ajrin e rralluar mbreti Aramejas, Berashit Arajasasi kur toka zu të dridhet, të trandet.

"Ç'po ngjet me këtë tokë, o ati im, o mbreti im!?" - e pyeti e frikësuar Zatra Arameje të jatin, mbretin, Berashit Arajajasin.

"Unë, bija ime, tashmë gjendem përtej ajrit të rralluar, tek i ndalohet hyrja çdo ushtrie. Ti, bija ime arratisu në Romë.

Pas dy orësh atje, do të arrijë mbrojtësja e Jezusit ekologjik, mbrojtësja e Dashurisë, mbrojtësja e Orgazmës - Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatan e gjeneralit, John Harkerit, të Massachusettsit" - mezi i arriti Zatres zëri i të jatit nëpër ajrin e rralluar të bjeshkës.

Ishte shkundullima e ushtrisë perandorake të gjeneralit turk Gyner Jyllmazit.

55.

"Ky ushtar paska pasur përse të dezertojë nga ushtria perandorake e padishahut të mëshirshëm"-foli gjenerali turk, Gyner Jyllmaz.

Redalk san Heldiku-rektori i Jakovës së Jerusalemit,i mërdhezur mishit mashkullor,përpëlitej nëpër lëkurën e trashë arushake.I shkalluar qenies së vet çjerrej, hakërrohej, vigmonte pas Zatres Arameje. Ishte zbru trupit me tri sperma të ngjizura.

"Arrestojeni këtë dezertor!Menjëherë të dërgohet në Stamboll! Duhet të bëhet intervenimi kirurgjik në këtë dezertor para se ajo kurva,Iroki-Pocahontas Powhatani e atij gjeneralit pizveng, John Harkerit të Massachusettsit, të paraqitet në Këshillin e Lartë të NATO-s" - urdhëroi ashpër gjenerali turk, Gyner Jyllmazi.

Tre burra, nga stafi i gjeneralit turk u sulen mbi Redalk san Heldikun për ta ngërthyer në vend. E mbështollën me cohë të trashë ushtarake bashkë me çjerrjet e tij.

Në spitalin ushtarak të Stambollit konsiliumi i mjekëve e bëri ekzaminimin e gjendjes shëndetësore të Redalk san Heldi-

kut të Jakovës së Jerusalemit.Diagnoza doli e thjeshtë: “Degjenerim i mishit. Shndërrim i muskulit në penis”

“Duhej ndërhyrë kirurgjikisht për mënjanimin e muskulit të shndërruar në penis; duhej mënjanuar edhe mishin e shndërruar në testise”-përfundoi përngutazi konsiliumi i mjekëve të spitalit ushtarak të Stambollit.

“Bismilah”- bëri kryemjeku nën mbrojtësen e vënë mbi gojë e hundë duke e ngulë skalpelin në lëkurën e rruar të Redalk san Heldikut.Skalpeli i kryemjekut-kirurg hyri thellë në mishin mashkullor të san Heldikut.Testisi dhe penisi zunë të çvendosen nga mishi tjetër. U varen teposhtë shalave të pacientit.

“Ç’i paska pas teptisur këto mishra ajo kurva arameje.Vetëm çifutët dinë të bëjnë këso gjërash.Këto kurva çohen peshë në këso penisësh e testisesh kundër Allahut të gjithëfuqishëm, kundër padishahut të mëshirshëm”-foli nën hundë kryekirurgu i spitalit ushtarak të Stambollit duke i çvendosur, llurbërisht, testiset dhe penisin nga midis shalave të Redalk san Heldikut të Jakovës së Jerusalemit.

Llurba e testiseve dhe e penisit piku gjak mbi barkun e pacientit ku pak më parë pikte spermë gruaje të re.Gjaku mpiksej mbi barkun e tij ende pa arritur atje poshtë, tek gropa e shkaktuar nga ndërhyrja kirurgjike. Kryekirurgu me instinktin e ujkut i mbajti lëvarë mbi barkun e pacientit testiset dhe penisin derisa e konsideroi se ato kishin dhënë shpirt.

Kur kryekirurgu u bind se llurba e testiseve dhe e penisit vdiqen i futi në një qese pëlhure e pastaj në një plasmast të zi futë duke dhënë urdhër:

“Le të ruhen në frigorifer me temperaturë optimale!”

Pasi e pluhurosi plagën me antibiotik, siç regjet mishi për të mos u prishur, e mbushi me pambuk e fashë duke e mbyllë për jetë të jetës grykën e orgazmës.

Duke ia matur pulsin, kryekirurgu e vlerësoi se Redalk san Heldikun po e lëshonte narkoza. Përngutshëm u dha sugjerime mjekëve të reaminimit:

"Tri ditë të mos i epet asgjë të pijë! Pas tri ditësh ja ndërroni fashat duke i lenë një vrimë nëpër të cilën do të dalë zorra e urinimit. Brenda dy javësh plagën ja kuroni duke e ushtruar të urinojë!"- urdhëroi kryekirurgu.

Redalk san Heldiku erdhi në vete. Ishte bërë i amullt, pa ndjenja.E harroi ëndrrën për ujëvarën e flokëve të zeza të Zatres Arameje. Ndjeu se midis shalash i kishte hyrë macja e zezë. Më së shumti i pëlqei gjumi. Mjekët e këshilluan të mos flinte.

Redalk san Heldikun e Jakovës së Jerusalemit e paskeshin caktuar të punojë,administrator i Kadinës së Padishahut në haremin e pare.

Në selamllëkun e haremit të parë, Redalk san Heldikun e priti vetë Kadina e Padishahut tok me gjashtë eunukë të heshtur. Pasi i uroi sherim të shpejtë nga sëmundja e mishit të keq, i uroi edhe për detyrën e re. Edhe eunukët, pas Kadinës së padishahut, me zëra të çjerrë prej deledashësh i uruan për të dyja.

"Do të kalojmë në dyshekllëkun e fontanave"- i tha Kadina duke u dhënë shenjë eunukëve të largoheshin.

Ecën nëpër një korridor të gjerë, të mbushur me shtylla të relievuara, plot citate nga Kur'ani. Korridori zgjerohej duke marrë dritë hirësore,të shkrire, e cila vinte nga të gjitha anët, pa ndonjë burim të caktuar.

Redalk san Heldiku e ndjeu shushurimën e ujit ende pa arritur tek fontana. Korridori u shndërrua në një kopsht trëndafilash nën kupolën e ndritshme.Gjithandej pa vajza të fantaksura pas luleve. Si të magjepsura e tretnin jetën në këtë qetësi prej vdekjeje të bukur.

Redalk san Heldikun gati e kishte zënë gjumi në këtë prehje të vdekjes së ëmbël. U ulën brenda dyshekllëkut edhe pse Redalk san Heldikun e ngacmonte macja midis shalëve.

“Tashmë u shërove nga ajo sëmundje e mallkuar. Ju, administrator i haremit të pare, keni të drejtë të kontrolloni edhe në dy haremet e tjerë”- e filloi bisedën miqësore Kadina e padishahut.

Redalk san Heldiku, i përgjumur, me macen e vet midis shalëve përpiqej të zë vend më të volitshëm. Kadina i ra një zileje me aq vrull sa e trembi mysafirin e vet.

“Për shërbimin besnik në haremin e padishahut të mëshirshëm do të shpërbleheni me një Xhami të bukur në qytetin tuaj e cila do ta mbajë emrin tuaj” - e ngushëlloi Kadina.

Tri bukuroshe, me tabake në dorë i sollën ëmbëlsirat e porositura nga Kadina e padishahut.Të hirosura, magjepsëse, qëndruan në këmbë para Kadinës. Secila bukuroshe e kishte të varur medaljonin në qafë.Në medaljon farfurinte fotografia e bukuroshës. Redalk san Heldikut të përgjumur i vajtën sytë në medaljonin e saj. E ngritit shikimin e shkëputur nga medaljoni i cili ia bëri me sy apo, ashtu iu fanit. U ngjit gjinjve të saj, qafës, buzëve. Tek sytë e saj e njohu atë, Zatren Arameje. Shkalloi, pa ditur asgjë për vetveten.

“Zatra! Zatra!” - u çjerr në kupë të qiellit.

Tek Redalk san Heldiku i Jakovës së Jerusalemit u zgjua ëndrra e orgazmës, e seksit, e … e klitorisit të Zatres Arameje. U ngrit në këmbë, gulçueshëm drejt saj. Vërtik i hoq shallvaret. U zdesh. E shkuli macen nga midis shalave. I djersitur, plot gojës shkumë, deshi ta zë penisin me dorë. Dora i shkoi huq,teposhtë gropës së shkaktuar midis shalash. Atëherë, vetëm atëherë, e kuptoi se ç’i kishte ndodhur, se çfarë rrënoje ishte bërë midis shalëve të tij.

Shikimi i llahtarisur i Zatres Arameje e tmerroi. Ajo me sy përbirës e pikasi gropën midis shalëve të Radalk san Heldikut, aty ku duhej të ishte penisi dhe testiset. Asaj i shpëtoi në tokë tabaku me ëmbëlsira. U bë rrëmujë.

Kadina e Padishahut, e trembur nga kjo e papritur iu qas Readlk san Heldikut duke e qetësuar.

"Efendi! Mos i besoni tundimit të djallit. Ajo e përdala, Zatra Arameje ka ikur andej kah Evropa për të bërë prostitucion. Po ju mashtron djalli, efendi. Shpije mendjen tek premtimi i padishahut. Ta ka premtuar një xhami në qytetin tënd, në emrin tënd" - i foli Kadina duke rënë Estokf'llah!

Redalk san Heldiku, i pëlyrë në djersë, në shkumë nga goja, në gjak nga plasaritja e plagës midis shalëve, me sy të çakërdisur iu kthye Kadinës së padishahut:

"Çfarë xhamie po më premtoni ju? Për çfarë xhamie po më flisni ju?! Të gjitha xhamitë e botës, të gjitha, do t'i epja në këtë çast, në këtë vend, vetëm për një penis e për një parë testise. E di ti se ç'është penisi, ç'janë testiset, ç'është orgazma" - iu zgurdullua tek fytyra Kadinës së padishahut.

Zatra Arameje klithi me plot sytë e mbushur vezullim vrastar:

"Ia paskan hequr seksin midis shalëve të mashkullit, ia paskan vra testiset, ia paskan hequr penisin. Orgazmën ia paskan djegur me zjarrin e Allahut të tyre!"-u histeros Zatra jashtë vetvetes së vet.

E molisur, e vrau shikimin në fund të barkut të Redalk san Heldikut, aty tek gropa e shkaktuar midis shalëve.

Nga sytë e dëshpëruar të Zatres Arameje vrujoi çurg lotësh.

Gropa midis shalave vrujoi çurg gjaku.

Redalk san Heldikut i ra në fytyrë zvetënimi, përmallimi.

E thirri Zatren.

Zëri i saj e grishi nga larg, gjithnjë e më i zvargur.

Gjithandej u bë lamtumirë.

56.

Ishte bërë vonë, kur ambasadori austriak, Shtefan Henke, lypi audiencë të përnjëhershme tek kryeministri i Turqisë, Tursun Kuturler. Kryeministri hezitoi për një çast. Mbase mund të jetë ndonjë çështje të cilën ambasadori austriak do ta aktrojë për shkaqe diplomatike.E ndërroi qëndrimin pasi ia dhanë informatën e saktë. Ishte çështje orësh.

Në orën njëzet e tre, sipas protokollit diplomatik, kryeministri i Turqisë, Tursun Kuturler, e priti në rezidencë ambasadorin e Austrisë, Shtefan Henken.

Kaluan drejt në çështje.

"Në Jakoven e Jerusalemit ka ndodhur një aksident gjenetik. Gjenerali rus,Ivan Vasiljeviq Kutozovi, e paska lexuar në pergamenë se Sofia e Haçet Deletes së dytë të Ilirikut Albanik, e shoqja e Rainhard von Grainhelmit të tretë, trashëgimtarit të

kurorës mbretërore të Bohemisë qenka takuar në Galile, në fshatin Abbi me atë çifutin, Rabi Jochanan ben Sakain"- hapi kuvend ambasadori austriak vëmendshëm për të mos e nxitur ndonjë reagim të kryeministrit turk.

Heshtja e Kryeministrit e qetësoi ambasadorin. E kishte të qartë se edhe pse kryeministri turk kishte dijeni për çështjen po e shqyrtonte në vete si ta çelë kuvendin.

"Eminenca juaj!"- hapi kuvend kryeministri.- "E keni marrë mundimin të vini në këtë kohë të natës për një çështje madhore. Perandoria e Padishahut të Mëshirshëm do të jetë në shërbim të Perandorisë suaj"- foli kryeministri turk me një zë të thellë diplomatik.

"Ne i lutemi qeverisë së Padishahut të Mëshirshëm ta nisë urgjentisht me avionin më të shpejtë ushtarak për në Jakovë të Jerusalemit atë ushtarin dezertor"-i ra shkurt ambasadori austriak.

"E keni fjalën për atë Redalk san Heldikun?"-e pyeti kryeministri.

"Pikërisht për atë, zoti kryeministër"- u ngut ambasadori ausriak

"Zotëri, atë Redalk san Heldikun e kemi graduar në Kistar Agë tek haremi i parë i Padishahut të Mëshirshëm. Pak çaste më parë e pat një krizë shëndetësore. Mbase do ta marrë veten" - u orvat të paraqitet indiferent kryeministri.- "Cili mund të jetë shërbimi që mund t'i bëjë perandorisë austriake ky Redalk San Heldiku i ndarë në tri pjesë?"-vazhdoi kryeministri sikur të mos dinte asgjë.

"Vetëm ky mund ta zbulojë Sofinë e Haçet Deletës në mesin e grave të Jakovës së Jerusalemit para se ta zbulojë gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi. Ai gjeneral po i çelë mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit me metodën e muzhikëve rusë të doktor Makushevit"- u përgjigj ambasodori austriak.

“Po si do ta njohë Sofinë e Haçet Deletës ai Redalk san Heldiku kur në tendën e Zatres Arameje çdo gjë është zhvilluar me aq shpejtësi. Pastaj, ai, Redalk san Heldiku si do ta dallojë midis aq grave të Jakovës së Jerusalemit”- arsyetoi kryeministri turk me një ngathtësi diplomatike.

“Krejt njejt. Siç e njohu Zatren Arameje midis gjithë atyre vajzave të haremit të parë të Padishahut”- iu përgjigj ambasadori austriak me një fije hidhërimi.

“Mbase, rasti i Redalk san Heldikut në haremin e Padishahut, kur u bë se e njohu Zatren Arameje, do të ketë qenë vetëm një shajni e çastit” - u engletis kryeministri turk.

“Zoti kryeministër, le t’i vijë ajo shajni edhe në midis të grave të Jakovës së Jerusalemit. Për ne mjafton kaq.” - insistoi ambasadori austriak paksa me ironi.

Kryeministri turk e nuhati hidhërimin e ambasadorit austriak. Ndaloi paksa sipas lojës diplomatike. Deshi të bëhet sikur ra në brengën e çështjes. Ai e dinte diplomacinë e komplikuar të Evropës. Kishte vetëm edhe dy orë për të zbarkuar në Itali ajo Indigjenia Iroki Pocahontas Powhatani e gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsit me gjithë arsenalin e Jezusit ekologjik:me orgazmën,me dashurinë, me seksin. Po këta evropianet katandisen, brenda dy orëve, t’i bëjnë rrokopujë edhe dashurinë edhe orgazmën edhe seksin.

“Eminenca e Juaj, ju evropianët gjithmonë i keni pleksur, disi çuditshëm, punët me këta hebrenjtë e mallkuar: jo Jezusi qonquistador, jo Jezusi ortodoks e, tash na paska dalë edhe Jezusi ekologjik. Ai Jezusi i juaj, pastaj ky Rabi Jochanan ben Sakai, bien ndesh me normat qytetare. Zbulimi i seksit, i klitorisit, i orgazmës, i dashurisë, e synon barazinë e ndotur midis njerëzve me prejardhje të njëjtë, nga e njëjta mitër, nga e njëjta vagjinë. Katrahurë gjenetike zotëri, kundër zotit, kundër shtetit, kundër moralit! Zoti do të behët lëmuq nga mishi i përzier” - i foli kryeministri turk mbi plogështinë evropiane.

Ambasadori austriak e kuptoi nga sytë e kryeministrit turk, se me diplomacinë cube aziatike do të mendojë:

"E patët në dorë zogun. E lejuat të fluturojë. Tashmë katandisuni rrugëve të botës. Ç'marrëzi evropiane!"

"Gjenerali austriak, Herman von Urlih, ende po bisedon me Sofinë e Jakovës së Jerusalemit. Ne, zotëri, e kemi njëfarë Sofie por pa qenë të sigurtë. Ajo mund të jetë ndonjë grua diversante. Na mungon Redalk san Heldiku për ta vërtetuar a mbet shtatzënë ajo Sofi me ketë njeri"- i foli ambasadori austriak sikur t'ia kishte lexuar mendimin kryeministrit turk.

"Atëherë paska qenë krejt në rregull Sofia e Haçet Deletes" - u ngut kryeministri turk të ironizojë.

"Po përse kështu krejtësisht në rregull" - u bë sikur të mos e kishte kuptuar ironinë.

"Edhe Zatra Arameje qe krejtësisht në rregull"- e zbuloi ironinë kryeministri turk.- "Por ai, Zeusi i mençur iu resht zvarritjeve diplomatike të Evropës.Zatren Arameje e hoqen në hotelin "Laguna" të Trieshtës".

Ambasadori austriak e kuptoi se kryeministri turk i kishte lexuar të gjitha pergamenat zyrtare të kanaleve më sekrete diplomatike.

"Eminenca e juaj" - vazhdoi kryeministri turk.- "Mua më së miri po më del pazari, sikur gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, ta zbulojë midis grave të Jakovës së Jerusalemit, mitrën e asaj Sofisë së Haçet Deletës, me cilëndo metodë, qoftë edhe me atë metodën e muzhikëve rusë të doktor Makushevit. Vetëm ai gjeneral i mençur, rus, do t'u shpëtojë juve evropianëve nga brenga diplomatike- nga plogështia"- gati sa u tall kryeministri turk .

"Jo, zoti kryeministër!Pikë së pari metoda nuk është e sigurtë. Së dyti kjo sofi mund të jetë e kontrabanduar nga amerikanët. Së treti sikur të realizohej metoda e muzhikëve rusë të

doktor Makushevit në mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit, do të bëhëj gabimi. Mund të testohej gabimisht tek Instituti "Mendeljev" i Moskës, mitra e ndonjë gruaje tjetër. Të gjithë, sonte, e gjurmojnë me nguti mitrën e Sofisë së Haçet Deletës. Secili për interesin e vet" - përfundoi ambasadori.

Kryeministri,Tursun Kuturler,u mvrejt më tepër se ç'e priste ambasadori austriak, sikur të kishte marrë vendim të prerë.Ra në heshtje sfiduese, të mundimshme,për ambasadorin. Me këtë heshtje kryeministri turk lektisi ta tundojë bashkëbiseduesin austriak. Vërtet, ashtu ndodhi. Ambasadori austriak, ankthshëm teptisi, me zë të papërmbajtur.

"Zotëri kryeministër! Për shtetin tuaj, për Padishahun e Mëshirshëm, për juve, personalisht, do të behët ogur i mirë, sonte e përherë, ta dërgoni urgjentisht Redalk san Heldikun në Jakovën e Jerusalemit.Evropa do t'jua shpërblejë këtë vullnet të mirë, juve, Zotëri kryeministër, Padishahut të Mëshirshëm, shtetit të Turqisë" - u pa shpërthimi i ambasadorit.

Edhe pse kryeministri e priti reagimin e ambasadorit austriak,i erdhi i tepruar shpërthimi i tillë për një diplomat.Kryeministri i dinte të gjitha brengat e Evropës. Ndiente kënaqësi të engletisej me nervat e saj. Ai e dinte shumë mirë se ishte në pyetje koha vetëm prej dy orësh. Vendosi të qepej në bisedë të ngadaltë ashtu që ta sfidonte urgjencën e çështjes. Lektiste t'i shkojë në nerva Evropës edhe pse vonesa e tepruar do ta rrezikonte edhe vet shtetin e kryeministrit turk.

"Po ç'do të ndodhte sikur ajo Indigjenia Iroki të hyjë në Jakovën Jerusalemit, ende pa e zbuluar ju mitrën e Sofisë së Haçet Deletës?" - krejt papritur iu drejtua kryeministri.

"Do të ndodhte, zotëri, ajo e keqja globale, si për Evropën si për ju, aziatikët, e, pse jo, edhe për gjithë botën" - u ngut ambasadori austriak.

Kryeministri turk u shtir sikur të mos dinte asgjë rreth çka foli ambasadori austriak. U bë i heshtur, i menduar. Më lehtë e

konsideroi ta dëgjojë ambasadorin se sa të zë në thua gjatë bisedës. Natyrisht, ambasadori e kuptoi komoditetin e kryeministrir në këtë cep të ngushtë kohe për të gjithë.

Gati e tha më zë mendimin:

"Çfarë përtacie turkoshake, çfarë humbelle aziatike!"

Kryeministri turk edhe në këtë cep kaq të ngushtë kohe katandisej ta shiste shtrenjtë rektorin e Jakovës së Jerusalemit – Redalk san Heldikun e ndarë në fri pjesë.

Ambasadori austriak qe në gjendje ta paguajë çdo çmim. Vendosi ta zbulojë rrezikun për të cilin e kishte pyetur pak më parë kryeministri.

"Po të hyjë në Jakovën e Jerusalemit ajo Indigjenia Iroki - Pocahontas Powhatan e gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsit, ende pa e zbuluar ne mitrën e Sofisë së Haçet Deletës, do të ndodhë rrënimi. Ajo, Indigjenia Iroki- Pocahontas Powhatan,në këtë mitër ekologjike të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit do ta mbëltojë atë Inisiativën e lirë amerikane, ndesh traditës së shtetit të tashëm evropian"- u ngut ambasadori austriak.

"Eminencë!"- ndërhyri kryeministri. - "Përse ju vazhdimisht po e merrni nëpër gojë njëfarë ekologjie të qashtër në atë Jakovën e Jerusalemit? Në atë vend kanë sunduar kushedi sa perandori: perandoria e Romës, perandoria e Bizantit, perandoria sllave, perandoria jonë e Padishahut të Mëshirshëm, perandoria e Juaj austriake e, tashmë perandoria ruse"-i numëroi njënganjë të gjitha perandoritë, kryeministri.

"E vërtetë kryeministër, të gjitha këto perandori, të cilat, patët durimin t'i numëroni përngjajnë në dimra të egjër, të gjate, bora e të cilëve e zen njëra - tjetrën, shtresë mbi shtresë, pa u shkri asnjëherë për të parë se ç'ka nën gjithë këto shtresa borërash. Në fund të këtyre shtresash të ngjeshura borërash ka mbetur e paprekur, arketip, fosile, ekologjikisht e pastër ajo, Jakova e Jerusalemit e, në ketë Jakovë të Jerusalemit gjendet

mitra e fekonduar e Sofisë së" - u qetësua paksa ambasadori austriak.

Tashmë kryeministri turk ra në dyshim, vërtet në dyshim. I erdhen fjalët e Redalk san Heldikut, kur para një ore, në haremin e parë të padishahut qenka çjerrë deri në kupë të qiellit:

"Të gjitha xhamitë e botës do t'i epja për një penis!"

Kryeministri i zemëruar nga këto fjalë blasfemi të Redalk san Heldikut, iu kthye ambasadorit austriak.

"Vërtet, ne, perandoritë lakmitare jemi versulë njëra mbi tjetrën mbi ketë Jakovën e Jerusalemit, siç e zen bora borën në gropa bjeshkësh, pa shikuar asnjëherë se ç'ka nën këto shtresa pushtimesh të këtyre alamet perandorishë. Kjo është lakmi gjeneralësh, vetëm lakmi gjeneralësh" - u brengos kryeministri turk, këtë herë përnjëmend.

"Do ta shihni, sonte, zoti kryeministër, ju aziatiket e, më shumë evropianet, se ç'ka në fund të këtyre shtresave pushtimesh të ndërkyera kur, pikërisht sonte, pas dy orësh, Jakovën e Jerusalemit ta shplojë nga të gjitha shtresat e pushtimeve të ndërkyera perandorishë ajo Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatan e gjeneralit,John Harkerit të Massachusettsit. Do të shihni, zoti kryeministër, ju dhe ne"-e kapërtheu në kuvend kryeministrin turk.

"Atëherë, Eminencë, vetëm po ta gjeni sonte mitrën e fekonduar të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit do t'ia kontaminoni zbulimin paleontologjik të asaj Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatan. Ju, Eminencë,- ju austriakët keni përvojë të mjaftueshme në këtë drejtim. E shpluat në vitin njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë atë copë Shqipëri të Albanikut sovjetik nga këto shtresa pushtimesh. Përdoreni atë metodë edhe sonte mbi Jakoven e Jerusalemit! Shplojeni nga të gjitha pushtimet glaciale e, le të shohim ç'ka atje, në fund tek lakmon ajo Indigjenia Iroki, Pocahontas Powhatani e gjeneralit, John Harkerit të Mas-

sachusettsit!”- kryeministri turk i foli naivisht apo me sarkazëm ambasadorit austriak.

“Zoti ministër, ne, austriakët vetëm e shpluam atë copë toke të quajtur Shqipëri Albanike duke e lënë në titërr të diellit, tokë djerrinë, pa llogaritur asnjëherë se Rusisë Sovjetike kjo djerrinë do t’i shërbejë për eksperimente më të skajshme gjenetike. Aty, në atë copë djerrinë, të quajtur Shqi-për Albanike, sovjetikët i provuan vaksinat pilote të zbuluara në Institutin “Mendeljev” - “Sanguis lacertae in musculo” dhe “Sanguis lacerate in cerebro”-kund tjetër vetëm në këtë djerrinë të pambrojtur me asfarë imuniteti socbiologjik”- ankoi ambasadori austriak, Shtefan Henke, këtë here duke e zënë vëmendjen e kryeministrit turk.

Shtefan Henke u ngërthye edhe vetë në ngadalësimin e kohës gratçore, vetëm prej dy orësh. Edhe vetë ambasadori gati ra në letargjinë aziatike, si vetë shkretëtirat e paanë, pa stinë, pa kohë.

“Eminenca Juaj, po përse ju evropianët, sonte, i frikësoheni asaj Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatan të gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsit? Po e shploi, ajo, Pocahontas Powhatan, atë Jakovën e Jerusalemit sipas parashikimit evropian, çka do të ndodhë?”- e pyeti kryeministri me një habi të përzier shqetësimesh!

“Do të ndodhë, zoti kryeministër. Në mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, të fekonduar ekologjikisht, ajo Indigjenia Iroki e Massachusettsit do t’i hedh të tri llojet e qumështit jashtëbiblik siç bëri me gjeneralin e saj, atë John Harkerin. Te tri llojet e qumështave po i sjell sonte me vete në Evropë. Ajo po vjen në Jakovën e Jerusalemit për ta promovuar zbulimin e saj Iroki të orgazmës ekologjike. Indigjenia, Pocahontas Powhatani, do t’ia shpalosë Evropës të gjitha gabimet historike” - e heshti për një çast frikën e vet ambasadori austriak.

“Atëherë, siç thoni ju, zoti ambasador,Amerika qenka kundër zotit, kundër shtetit, kundër moralit…” - vazhdoi të numë-

rojë kryeministri turk.

"Saktë keni goditur, zoti kryeministër. Amerika e Indigjenes Iroki- Pocahontas Powhatanit të gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsit është kundër zotit, kundër shtetit, kundër moralit ... " - ia përsëriti ambasadori austriak.

"Zoti ambasador, ju evropianët, sonte, synoni ta shpëtoni Jakovën e Jerusalemit edhe nga rusët edhe nga amerikanët. Ju, zoti ambasador, u frikësoheni të dyjave. U frikësoheni vaksinave ruse të prodhuara në Institutin "Mendeljev"- "Sanguis lacertae in musculo" dhe "Sanguis lacertae in cerebro" të testuara në atë copë toke, të quajtur Shqipëri Albanike, po më pak edhe në vendet e tjera të Paktit të Varshavës. Poaq u frikësoheni tri llojeve të qumështave jashtëbiblikë të Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatan të gjeneralit,John Harkerit të Massachusettsit; tri llojeve të qumështrave të cilët i përdori Indigjenia Iroki e Massachusettsit në të gjitha mishrat e John Harkerit-të atij anglezit të arratisur nga Angloirlanda e vitit njëmijë e gjashtëqind e njëzet e një. Ajo Indigjene, sonte, hiç më larg se sonte, të tri llojet e qumësh-tave jashtëbiblikë do t'i këllasë në mitrën e Sofisë së Haçet Deletës për ta ushqyer fetusin e saj me këto tri lloje qumështash. Ajo, sonte në klinikën"Gemeli" të Romës, sipas marrëveshjes me juve evropianët, posa ta hapë konsiliumi i mjekëve amerikanë mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit do t'i hedhë foshnjes në grykë qumësht të misrit jashtëbiblik, qumësht të bizoneshës jashtëbiblike, qumësht të gjirit të vet prej Indigjenie Iroki të Massachusettsit"- e rrahu me fjalë fshikulluese kryeministri turk, këtë herë vërtet i pez-matuar.

"Zotëri kryeministër, po mos të arrijmë brenda këtyre dy orëve ta zbulojmë Sofinë e vërtetë të Jakovës së Jerusalemit atëherë, pikëpërpikë, do të bëhet ajo më e keqja, siç po thoni edhe ju vetë" - ia solli në mend se çështja duhej përngutur.

Kryeministri turk, Tursun Kuturler, u përmend rrapllueshëm, i trembur nga ambasadori austriak.

“Eminencë” - u ngut kryeministri.-” M’u ga sikur thatë: “Ta zbulojmë Sofinë e vertetë të Haçet Deletës?” - pyeti i përftuem kryeministri.

“Po, zoti kryeministër! Ne dyshojmë, me të drejtë se kjo grua e cila u paraqit në tendën e gjeneralit tonë, Herman von Urlih, mund të mos jetë ajo Sofia e vërtetë, të cilën po e lypim sonte. Atë mund ta ketë lansuar kushdo”- u sqarua ambasadori austriak.

“Keni të drejtë Eminencë. Ai çifuti, Rabi Jochanan ben Sakai, mund ta ketë bërë këtë diversion për të përfituar në kohë derisa t’ia çatisë ajo Indigjenia Iroki”-u pllakos kryeministri turk. -“Këta hebrejtë presin diç të madhe nga amerikanët”

“Keni të drejtë zoti kryeministër. Punë hebrenjshë”-ofshani ambasadori.

“Atëherë edhe gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, qenka duke punuar në errësirë, krejtsisht i verbër. Si mund t’ia dalë në krye për dy orë gjithë asaj pune, edhe po t’i kishte me vete të gjithë mjekët e Rusisë” - ia prini kryeministri turk.

”E saktë zoti kryeministër. E vetmja mënyrë për ta zbuluar Sofinë e Jakovës së Jerusalemit mbeten ato tri pjesë të Redalk san Heldikut. Ne, austriaket e lypim trupin eunuk të san Heldikut, rusët i lypin testiset e penisin tij. Turqia i ka të tria pjesët. Atëherë zoti kryeministër ju mbetet juve të vendosni” - u bë sikur i penduar ambasadori austriak.

“Si do t’i përdorë testiset e Redalk san Heldikut ai gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi?”- e pyeti kryeministri sikur ta kishte miratuar kërkesën e Austrisë.

“Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, do t’i hedh testiset e Redalk san Heldikut në midis të Jakovës së Jerusalemit. Ato testise, ende të ngrohta, do të kundërmojnë orgazëm, seks spermë. Mishi femror, kudo nëpër Evropë ka zënë të priret kah orgazma, kah testiset, kah seksi, kah penisi. Në qoftë se Sofia e

Jakovës së Jerusalemit ka bërë seks me Redalk san Heldikun atje në tendën e Zatres Arameje atëherë do ta joshin testiset; do të bie në grackën e gjenerali rus"- ambasadori ia shpjegoi mundësinë e kapjes së Sofisë nga gjenerali Kutozov.

"Sigurisht edhe Austria do ta përdorë të njëjtën mënyrë"- konstatoi kryeministri.

"Po zotëri"

"Atëherë gjithsesi do të fitojë gjenerali rus. Testiset dhe penisi janë pjesa e mishit më joshës për gratë"- qesendisi kryeministri.

"Gaboni, zoti kryeministër. Në qoftë se, siç shkruan nëpër pergamena, Sofia e Jakovës së Jerusalemit, e arriti orgazmën në tendën e Zatres Arameje, atëherë Sofia do të priret, më pare se kah testiset, kah vetë Redalk san Heldiku, edhe pse tashmë eunuk" - qortueshëm i foli ambasadori austriak.

"Atëherë zoti ambasador, seksi qenka i rusëve, orgazma e austriakëve. A s'e lozni në këtë mënyrë ruletin rus, zoti ambasador?"- e pyeti kryeministri.

"Jemi në cajtnot, zoti kryeministër. Edhe ruleti rus edhe çdo hazard duhet provuar në ketë rast" - ankoi ambasadori.

"Ju, të gjithë, zotëri" - sikur bëri rezyme kryeministri.- "Sonte rrekeni ta zbuloni atë mitër të Sofisë së vërtetë. Secili jush rreket ta hedh në ketë mitër solucionin e vet: rusët donë të hedhin në atë mitër "Sanguis lacertae in musculo" dhe "Sanguis lacertae in cerebro" siç e hodhën në mishin e hajthëm të asaj Shqipërisë djerrinë Albanike. Ju, evropianet austriakë e doni atë mitër për të hedhë në të "Sanguis lacertae in utero", siç i hodhëm ne, të gjithë, nënës së saj, Teutës së Haçet Deletës së dytë të Ilirikut Albanik. Amerikanët e asaj Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatanit, e donë atë mitër për t'i hedhë në të ata tre qumështat jashtëbiblikë: të Misrit, të Bizoneshës dhe të vet Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatanit" –e sosi kryeministri.

Keni plotësisht të drejtë zoti kryeministër, mezi priti t'i thotë ambasadori austriak.

"Atëherë, Eminencë, a ia vlen Turqisë të ngatërrohet në këtë çështje kaq të ndërliqshme? Cili do të jetë fitimi i Turqisë? Më bëhet se ia vlen të mos ndërlikemi në këtë çështje të të krishterëve"- papritur sikur u bë indiferent kryeministri turk.

"E dini ju, zoti kryeministër se ç'është globalizmi?"- iu drejtua ambasadori austriak.

"Është terminologji evropiane, Eminencë" - iu shmang pyetjes kryeministri.

"Zotëri kryeministër, globalizmi është cunam i cili do t'u qaset tek dyert e Stambollit. Globalizmi ose ju vjen këtu në Stamboll ose Ju, vetë, vullnetarisht do të shkoni tek globalizmi"-e filloi qesëndinë ambasadori austriak duke e parë se kryeministri e humbi toruan.

"Eminencë, globalizmi, sipas jush, deshka të na zhdukë fenë tonë myslimane?"- pyeti përvajshëm kryeministri.

"Edhe mund të jetë ashtu, pikërisht ashtu" - iu përgjigj dytësorisht ambasadori.

Kryeministri i kërkoi ndjesë për zvarritjen e bisedës. I erdhi ashtu, papritur apo ishte koha. Austriakut i mbeti e paqartë. Turku u ngrit për një çast, duke i kërkuar leje ambasadorit për ta bërë një bisedë me kabinetin e vet qeveritar.

Ambasadorit iu dhimbs mjaft koha e humbur me kryeministrin për një çështje e cila për Turqinë do të thoshte dyshim. Diplomacia, me ngathtësinë e vet dyshon në gjithçka e, shpeshherë katandiset të nxjerrë përfitim në asgjë.

Kryeministri u kthye menjëherë. Edhe pse mundohej ta mëshehë, ishte i relaksuar. Ashtu, në këmbë, duke e pranuar përngutjen, si shkarazi e pyeti ambasadorin:

"Ju të tre, zoti ambasador, lektisni të testoheni në mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit? Rusia dhe Evropa, në mitrën

e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit e mëtojnë punën e një laboratori biologjik me përmasa gjenealogjike, sikur donë ta mëshehin zanafillën e vet, periudhat e zhvillimit të vet, ta mëshehin kodin e zhvillimit të vet. Amerika e Indigjenes Iroki Pocahontas provon t'i sfidojë të dy kodet evroaziatike nëpërmes tre qumështave jashtëbiblikë të Massachusettsit. Ajo indigjene po i sjell sonte në Evropë:qumështin e misrit jashtëbiblik, të bizoneshës jashtëbiblike dhe qumështin e gjirit të vet jashtëbiblik.Por Ju , zoti ambasador, e harruat atë çifutin Rabi Jochanan ben Sakain?"

Ambasadori austriak e shikoi plotkuptimsisht kryeminist-rin sikur ai ta kishte sjellë ndonjë epidemi. Shikimi i shkalluar i ambasadorit gati sa e frikësoi kryeministrin. Ai e kishte bërë një pyetje, te fundi i fundit, jo krye në vete.

Ashtu edhe doli.

Pikërisht kjo e shkundulloi ambasadorin austriak. A ishte ky mendimi i qeverisë Turke? Se Evropa austriake duhej ta epte një deklaratë zyrtare mbi mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, mbi testiset dhe penisin e Redalk san Heldikut, mbi vetë eunukun Redalk san Heldikun? Mbi të gjitha duhej dhënë një deklaratë mbi Rabi Jochanan ben Sakain.

Gjatë gjithë kohës ambasadori austriak e kishte marrë me mend këtë pengesë, këtë humbje kohe. E shikoi kryeministrin me forcë zhbiruese. Kryeministrit i ra përdhe relaksi i pakmëparshëm. Ambasadori austriak pa e çuar më gjatë i tha kryeministrit gati urdhrueshëm:

"Më lidh me Ministrin e jashtëm të Austrisë!"

Kryeministri turk, Tursun Kuturler, me plogëti e formoi numrin e linjës diplomatike me ministrinë e jashtme të Turqisë. Priti paksa. Në anën tjetër u paraqit zëri i një burri, disi përngutshëm, trembshëm, sikur ta kishte kotë gjumi. Kryeministri ia ofroi kufjen e telefonit ambasadorit austriak.

“E keni në lidhje Ministrinë e jashtme të Austrisë”.

Ambasadori austriak, Shtefan Henke, urdhëroi menjëherë ta lidhin me ministrin e jashtëm austriak, Joakim von Adler. Ai burri i anës tjetër të telefonit heshti për një çast, si duket u mat të pyes diç. Shtefan Henke pa i dhënë qasje e urdhëroi duke iu paraqitur titullarisht. Ai tjetri, përtej telefonit mezi arriti të thotë: “Si urdhëroni zoti ambasador”.

Pa vonuar i doli zëri astmatik i ministrit të jashtëm, Joakim von Adler.

“Qeveria turke po e mëton deklaratën zyrtare të Evropës austriake mbi Redalk san Heldikun eunuk dhe testiset e penisin e tij”- hyri në bisedë, menjëherë, ambasadori.

“Edhe për testise e penisa duhet dhënë deklarata zyrtare?”- u çjerr zëri astmatik i ministrit, Joakim von Adlerit.

“Kështu ka vendosur qeveria turke. Ndryshe do të mos pranojnë t’i dorëzojnë pjesët e Redalk san Hedlikut”-i foli me një zë të mllefshëm ministrit austriak për ta dëgjuar edhe kryeministri turk.

“Jepe atë deklaratë!”-deshi ta flasë një fjalë të ndytë ministri austriak. -“Tekstin e ke të gatshëm. Sos punë sa më parë!”- urdhëroi çjerrshëm ministri i jashtëm.

“Si urdhëroni, zotëri! E kuptova. Ç’do gjë do të jetë në rregull”- i foli preras ambasadori duke pritur një çast.

Ministri i jashtëm austriak, Joakim von Adler, e lëshoi kufjen e telefonit ngadalë, sikur të qe në errësirë.

“Zoti kryeministër, qeveria turke kërkon deklaratë zyrtare mbi procedurën e pranimdorëzimit të të gjitha pjesëve të mbetura nga Redalk san Heldiku se për çka do të përdorën? Kush do t’i përdorë këto pjesë?”- iu zbraz ambasadori, ende me kufjen e telefonit në dorë.

“Eminencë, ashtu e lyp proçedura shtetërore”- iu përgjigj kryeministri turk duke i rrudhur krihtë.

Deklarata e ambasadorit austriak u dha, e shkurtër, e koklavitur, mjaft monotone:

"Evropës austriake, i duhen, brenda dy orësh, sipas marrëveshjes me Rusinë, të tri pjesët e mbetura nga Redalk san Heldiku.Rusia do t'i marrë testiset dhe penisin e Redalk san Heldikut, Evropa austriake do ta marrë trupin eunuk të Redalk san Heldikut. Të tri pjesët e Rektorit shërbejnë për të njëjtin qëllim: ta zbulojnë me joshje Sofinë e mëshehur në mishin gaull të mitrave të grave të Jakovës Jerusalemit.

Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, do ta joshë, për ta zbuluar Sofinë e Haçet Deletës, me testiset dhe penisin e Redalk san Heldikut. Evropa austriake do ta joshë Sofinë e Haçet Deletës me trupin eunuk të San Heldikut. Vetëm me këtë mënyrë të joshjes, në këtë kohë të mbetur prej dy orësh, mund ta zbulojmë Sofinë e vërtetë midis grave të Jakovës së Jerusalemit. Brenda këtyre dy orëve po të mos e zbulojmë ne Sofinë e vërtetë, atëherë do ta zbulojë ajo Indigjenia Iroki - Pocahontas Powhatani e gjeneralit amerikan, John Harkerit të Massachusettsit. Atëherë do të bëhet vonë për Evropën austriake dhe për Rusinë e gjeneralit Kutozov.

Të tria: Rusia e gjeneralit Kutozov, Evropa austriake e gjeneralit Herman von Urlih dhe Amerika e Indigjenes Iroki-Pocahontas Powhatani e gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsit i kanë të gatshme solucionet për t'i hedhë në Mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

Rusia e gjeneralit Ivan Vasiljeviq Kutozovit, po arriti ta zbulojë Sofinë e vërtetë do t'i hedhë në mitrën e saj të dy solucionet, siç i hodhi në mishin e fishkur të Shqipërisë së Albanikut sovjetik. Në mitrën e Sofisë do t'i hedhë solucionet: "Sanguis lacertae in musculo" dhe "Sanguis lacertae in cerebro" për ta pocaqisur fetusin e Jakovës së Jerusalemit.

Evropa austriake e gjeneralit Herman von Urlihut, lektis, brenda këtyre dy orëve ta zbulojë Sofinë e vërtetë, në mitrën e

së cilës do të hedhë vetëm “Sanguis lacertae in utero” vetëmsa për ta fishkur orgazmën, dashurinë, klitorisin.

Indigjenia Iroki- Pocahontas Powhatani e gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsin, triumfalisht, pas dy orësh, tek klinika “Gemeli” e Romës do t’i hedhë në mitrën e Sofisë së vërtetë të tri llojet e qumështave jashtëbiblikë: qumështin e misrit, qumështin e bizoneshës dhe qumështin e gjirit të vet Indigjenes Iroki.

Rektori-Redalk san Heldiku, i ndarë në pjesë, do të shërbejë si joshje për ta zbuluar Sofinë e vërtetë të Jakovës së Jerusalemit”- përfundoi deklarata zyrtare e ambasadorit austriak e shkruar në orën njëzet e tre tek ministria e jashtëm e Turqisë.

Ambasadori, i mvrejtur, paksa i fyer për këto broçkulla të diplomacisë turke ia zgjati deklaratën ministrit turk.

“Eminencë, avioni ushtarak është gati për t’u nisur. Për një orë do të jetë në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit”-i tha solemnisht kryeministri me një ogur të keq në zërin e ndryshuar. - “Aty, në atë avion i keni të gjitha copat e atij Redalk san Heldikut Tuaj. ”

57.

Kopiloti i helikopterit i hoq kufjet nga veshët duke u kthyer rrëmbimthi kah gjenerali, Herman von Urlih. Gjithë kohën kishin heshtur.

"Zoti gjeneral, po na urdhërojnë të zbresim jashtë aeroportit të Jakovës së Jerusalemit"- i foli kopiloti, disi, gurgullueshëm.

Gjenerali, Herman von Urlihu u përpoq ta kuptojë këtë urdhër të papritur duke pyetur shkarazi.

"Kush e dha këtë urdhër?"

"Zotëri, këtë urdhër e dha gjenerali rus, IvanVasiljeviq Kutozovi"- u përgjigj kopiloti.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, e shikoi, gati beftas, Sofinë sikur lypi nga ajo, bile një qëndrim të kuptueshëm. Ajo e ndjeu sëmbimin në faqen e majtë, andej kah ishte ulur gjenerali, Herman von Urlih.

“Le të aterojmë brenda në aeroport”- i tha Sofia bindshëm.

“Zonjë e nderuar, rusët do të na përplasin përtokë po i kundërshtuam urdhrat e tyre”- i foli kopiloti me një zë të ngjirur.

“Pyeti edhe një herë, nëse na lejohet të zbresim brenda aeroportit, diku larg pistave”- e urdhëroi gjenerali von Urlih.

Kopiloti i vuri dëgjueset në veshë, me një ngathtësi ogurzezë, pa arritur ta marrë veten nga ngjirja e kapur në grykë. Pas dy-tri përpjekjeve për ta qëruar zërin, arriti të lidhet me stafin rus në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit. Me zë të plasaritur arriti të flasë.

“Këtu fluturakja E 232 e OSCE-së, i lajmërohet Komandës SV4 të gjeneralit Kutozov për aterrim të menjëhershëm, si në rast defekti, në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit. Do të aterrojmë në një cep të aeroportit, larg të gjitha pistave, larg çdo objekti”- e dëgjuan të gjithë pyetjen e kopilotit.

Siç u pa, qartë, kopiloti priti përgjigje miratuese nga komanda ruse.

“Po zotëri, po e kuptojmë. Mund të aterojmë, në anën e prapme afër daljes anësore? E kuptuam urdhrin, zotëri. Ju faleminderit!”- e përfundoi bisedën kopiloti pa dhënë kurrfarë shpjegimi.

Gjenerali, Herman von Urlih, e dëgjoi bisedën midis kopilotit dhe atij tjetrit pa u hamendur se ndalesa u bë shkaku i Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Ai e dinte, nga përvoja, se ruset i thyejnë të gjitha kontratat, konventat ndërkombëtare.

“Zoti gjeneral, komanda ruse do t’ia bëjë helikopterit vetëm një kontroll rutinore. Do të bëjë një bisedë të shkurtër informative me zonjën. Me kaq do të marr fund e gjitha”- i foli kopiloti me një zë ogur.

“Edhe sa kohë ka mbetur për t’u nisur avioni për në Romë?”- gjenerali e pyeti Sofinë, pa e shikuar në fytyrë.

Ajo e heshti ajrin rreth vetes. Gjenerali, papërmbajtshëm, e ktheu fytyrën kah ajo. Ishte drita e saj, ajo drita tjetër, e mby-

llur në cipën e ajrit të saj të heshtur. Sofia u mbushullua nga të gjitha anët me orgazëm, me seks, me klitorit, me epsh.

Ç'ndodhi kaq papritmas?

Po afrohej Ai!

Cili?

Helikopteri paskesh ateruar. Dera u hap.

Hyri Ai.

Sofia e njohu.

"Qenket kthyer nga Abbi i Galilesë?"- e pyeti Sofia nga mëshikëza e ajrit veshtullor.

"Po, u ktheva me avionin e orës njëzet e tre, nga aeroporti "Ben Gurion"- iu përgjigj ai me zë të hirësuar.

Gjenerali, Herman von Urlih u përpoq ta marrë me mend se kush qe ky burrë i shfaqur kaq papritmas në derë të helikopterit. Mbet i mpirë. Mendoi se po vdiste në atë gjendje të mishit të vet mashkullor. I ndodhi diç e ngjashme me atë gjendjen prej amoku në Kështjellën "Summer of"të Vjenës me Sofinë e Arçidukës - Franc Ferdinandit.

Ai gjeneral u ngrit nga sedija për t'i bërë dalë Sofisë. Ajo u nis, rrëmbyeshëm, drejt derës së helikopterit, tek po qëndronte ende ai burri i panjohur për gjeneralin. Ajo kaloi pranë von Urlihut me një fëshfërimë fustani duke i lënë të stepur ata tre burrat në helikopter.

Rabi Jochanan ben Sakai e rroku nga të dyja duart Sofinë, gati e rrëmbeu. Të dy ranë jashtë helikopterit, në errësirë meqë reflektorët ende bënin dritë në tjetër drejtim. Dera e helikopterit mbet e hapur- gojë e përgjumur e plakës së padhëmbë. Të tre burrat u çuditen me rrëmbimin e hovshëm të Sofisë.

Një çast më vonë në derë të helikopterit u shfaqen dy burra, epersisht zyrtarë. Njeri prej tyre foli gjermanisht me një mirësjellje të mundimshme.

“Zotërinj, ju kërkojmë ndjesë për këtë ndalesë të çastit. Do ta bëjmë vetëm një formalitet rutinor. Mund të jeni të rrezikuar nga terroristët e shumtë në këtë qytet të Jakovës së Jerusalemit”- foli ai i gjermanishtes pa arritur t’i dallojë të gjithë udhëtarët.

Të tre burrat e helikopterit dolën jashtë. Ai i gjermanishtes priti paksa me shikim të ngulur në derën. Zgurdullueshëm e priste dike tjetër. Dera e hapur mbet ashtu siç qe në fillim: gojë e hapur e plakës së padhëmbë.

Ai tjetri, me një rusishte të spiruar, e ngulfati në vend kolegun e vet të gjermanishtes me disa fjalë të nëndheshme. Shikimi i të dyve u sos në derën e hapur të helikopterit.

Ai i gjermanishtes iu drejtua gjeneralit, Herman von Urlih:

“Zotëri, mbase udhëtari i katër ka mbetur brenda?”- foli mezi i dëgjuar nga uturimat e motorëve të avionit të Air Izraelit të gatshëm të shkëputej nga pista e aeroportit. Gjenerali ra në uturimën e avionit derisa ajri u bë për bisedë.

Posa u zvarg ajri mbi kokat e tyre, pas largimit të avionit në pistën tjetër, ai i gjermanishtes iu drejtua gjeneralit, Herman von Urlih:

“Zotëri, le të dalë nga helikopteri edhe udhëtari i katër!”

U pa qartë se ata të dy e kishin përngutazi.

“Zotëri”- foli gjenerali austriak. -“Sofia e Jakovës së Jerusalemit e cila që me ne në helikopter, pak më parë doli nga këtu. Ju do ta keni parë, mbasi keni qenë afër”- ua shpjegoi gjenerali duke krijuar huti tek të dy.

Ata të dy e shikuan njëri-tjetrin ngulmueshëm, prerazi, gati për të shkaktuar plagë në fytyrë. Ai i rusishtes kërceu shkallëve të helikopterit. Me tre hapa përbirës u gjend në barkun e fluturakes. Ajri u ngri, u bë kallkan përreth tyre. Fjalët u bënë copëza akulli para këmbëve.

Në derë të helikopterit u shfaq ai i rusishtes. Doli vetëm, i shashtisur, pa kokë mbi vete, pa gojë. U rrokullis shkallëve deri tek gjenerali austriak, Herman von Urlih.

"Ajo Sofia e Jakovës së Jerusalemit është arratisur para syve tuaj, zotëri. Mbase edhe e keni ndihmuar të arratiset!'- iu ngërdhesh para fytyrës ai i rusishtes duke iu vjerr në shikim gjeneralit, Herman von Urlih.

Gjenerali ndjeu dhembje në kokërdhokët e syve. Ishte tepër rëndë ta mbaje të vjerrë në kokërdhokun e syrit atë burrin nevrik të rusishtes. Dhimbja e syve iu bë e padurueshme. Gjenerali, Herman von Urlih, i shkarkoi plandosshëm ata të dy. I hoqi nga sytë.

"Zotërinj"- i përbuzi gjenerali. -"Një burrë u shfaq në derë të helikopterit. Ai e urdhëroi të zbresë në tokë Sofinë e Jakovës së Jerusalemit"- u foli të dyve.

"A tha diç ai burrë, i shfaqur në derë?"- pyeti ai i gjermanishtes pa i përkthyer asgjë atij tjetrit.

"Po"

"Çfarë?"

"Sofia e Jakovës së Jerusalemit i tha atij burrit të shfaqur në derë:

"Qenke kthyer nga Abbi i Galilesë?"-e përfundoi gjenerali.

"Paska qenë ai, çifuti, Rabi Jochanan ben Sakai!"- u hakërrisën të dy të shastisur deri në fund.

Ai i rusishtes e hapi, rrëmbimthi, aparatin telefonik. Mezi e formoi numrin duke u çjerrë:

"Bekstvo! Bekstvo!"

Nga ana tjetër e telefonit u dëgjua vetëm zukatje zëri prej mize të rënë në pezhishkën e merimangës. Sa më shumë zukaste zëri në anën tjetër të telefonit, ai i rusishtes zvogëlohej derisa, si duket, përtejtelasit i pëlciti mëshikëza e tëmthit.

“Zotëri, ju e keni ndihmuar Sofinë e Jakovës së Jerusalemit të arratiset. Ajo, edhe ju evropianët shpresoni se Sofiagrua do të mëshehet në mesin e grave të Jakovës së Jerusale-mit. Kot e keni, zotëri. Ne do t’i hapim, deri në orën katër të natës të gjitha mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit- edhe të atyre të cilat i kanë pllakëzat testuese midis vegëve, të vëna nga Sigmundi i juaj, i Vjenës edhe të atyre pa këto pllakëza midis vegëve” - u çjerr ai i gjermanishtes.

Gjenerali, Herman von Urlih kishte rënë syqut.

“Juve, zotëri, ju ka magjepsur ai çifuti i ndotur - Rabi Jochanan ben Sakai”- e poshtëroi gjeneralin ai i rusishtes.

Gjenerali, Herman von Urlih, u bë i vetvetes kur ai i rusishtes ia përmendi Rabi Jochanan ben Sakain.

Nga pista, më e afërme e aeroportit, u shkëputën dritat e makinave drejt helikopterit, tashmë të fjetur. U shfaq vetë gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi. Vetëm me disa hapa e kapërcei pistën e fundit të aeroportit. Ata, të dy: i rusishtes dhe i gjermanishtes u ngutën t’i dalin përpara gjeneralit, mbase për t’i shpjeguar diç më tepër. Gjenerali Kutozov kaloi pranë tyre pa denjuar t’i shikojë derisa e arriti gjeneralin austriak, Herman von Urlih. Në takimin ballëpërballë të të dy gjeneralëve, Ivan Vasiljeviq Kutozovi u rrek ta rregullojë paksa fytyrën e çakërdisur -veçan, shikimin.

“Është e padenjë, zoti gjeneral, të takohemi në këto rrethana, në këtë kohë kaq të turbullt nate, te ky aeroport krejt i huaj”-i foli dykuptimisht gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, me një theks rus nëpër rrokjet gremçore të gjermanishtes.

“Zoti gjeneral, ju e keni marrë mundimin të ja çatisni në këtë orë të natës, i tunduar, sigurisht, nga ndonjë çështje madhore”- iu përgjigj gjenerali austriak, Herman von Urlihu i shtirur sikur të mos kishte kuptuar gjë.

Gjenerali rus e kuptoi sjelljen diplomatike të austriakut ndaj mezi u përmbajt pa ia thënë atë më të keqen. Vendosi t’i shkojë

anash kuvendit. Iu drejtua njërit nga vartësit e vet- pikërisht atij rusit të gjermanishtes, për ta kuptuar austriaku, Herman von Urlih.

"Si mund t'ju ketë shpëtuar Sofia e Jakovës së Jerusalemit pa e vërejtur? Kur u hodh nga helikopteri ju ishit këtu?"- i foli gjenerali, Kutozov, atij rusit të gjermanishtes.

"Zoti gjeneral, kur ne arritëm tek helikopteri dera ishte e hapur"- u katandis të arsyetohet rusi i gjermanishtes duke dyshuar se dera ishte hapur para kohe.

"Ju, e keni përcjellë helikopterin para se të aterrojë?"- ia mbylli rrugën e arsyetimit gjenerali Kutozov.

"Po, zoti gjeneral".

"Ju keni pasur mundësi ta vëreni paraqitjen e çdo njeriu në derën e helikopterit?"- e pyeti prerazi gjenerali.

"Po, zoti gjeneral".

"Atëherë, zotërinj, Sofia e Jakovës së Jerusalemit do të jetë hedhë jashtë helikopterit qe në ajër"- foli gjenerali Kutozov, me një gjermanishte të spiruar nga rrokjet masive; këtë herë për ta kuptuar gjenerali, Herman von Urlih

Edhe austriaku, Urlih, filloi të dyshojë: "U fanit ai njeri në derë të helikopterit apo vërtet ndodhi".

Të gjithë heshtën në këtë rrëmujë dyshimesh. Vetëm gjenerali austriak, disi, mistershëm, sikur foli me vetveten e vet: "Në derën e helikopterit u shfaq ai njeriu plot dritë në gropat e syve. Ajo, Sofia, përnjëherë i tha: "Qenke kthyer nga Abbi i Galilesë?"

"E njohët, ju, zoti gjeneral, atë njeri të breroret, siç thoni Ju, në derë të helikopterit?"- iu drejtua gjeneralit austriak, më në fund, rusi Kutozov.

"Jo, zoti gjeneral. Ne e morëm për ndonjë zyrtar të aeroportit"- u përgjigj austriaku, Herman von Urlih.

“Cili zyrtar, zoti gjeneral, mund të thotë në këtë orë të natës se është kthyer nga Galileja”- foli me cinizëm gjenerali rus.

“Zotëri gjeneral, mbase jeni njeri i kohës sonë kur udhëtimet e shpejta bëhen me avion. Avioni nga aeroporti i “Ben Gurionit” të Izraelit kishte ateruar në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit, apo pritej të ateronte. Një zyrtar i aeroportit mund të ketë udhëtuar nga atje”- iu përgjigj me te njëjtin cinizëm gjenerali austriak.

“Atij çifutit- Rabi Jochanan ben Sakait s’mund t’i dihet? Është ngritur kundër të vetëve. Tashmë ky Rabi, sikur ai hebreu tjetër, shtatëdhjetë vjet para tij, po merret me biznes orgazmash ndryshe nga profesioni i Rabinit. Po merret me orgazmën, me klitorisin, me seksin, me dashurinë.

Tribali i Madh i Jerusalemit e ka dënuar këtë Rabi Jochanan ben Sakain për ta varrosur të gjallë në mitrën e kones së Danielit. Por ajo prostituta çifute - Rebeka e Alamekut iu kundërvu Tribalit të Madh të Izraelit duke ia dhuruar këtij çifuti të gjitha: klitorisin, seksin, orgazmën, dashurinë, vetveten e vet për ta shpëtuar Rabin nga mitra e kones së Danielit”- ankoi gjenerali rus, Kutozovi, për një gjë të njohur nëpër pergamenat zyrtare të shërbimeve diplomatike.

“Zoti gjeneral, po Rebeka e Alamekut ku i mësoi të gjitha? Mbase, ajo i dinte kaherë këto gjëra?”- e provokoi austriaku për një gjë tashmë gati publike.

“Rebeka e Alamekut i mësoi të gjitha këto nga ajo Zatra Arameje. Për më larg, në qoftë se doni ta dini zotëri gjeneral, ajo i mësoi nga ai Jezusi i juaj protestant, mbi të cilin ajo Indigjenia Iroki-Pocahontas Powhatani e atij gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsit i bën të gjitha provat seksuale. Ajo sonte do të vijë për t’ua mësuar të gjitha grave Tuaja: seksin, orgazmën, klitorisin, dashurinë”- pezmatoi gjenerali, Ivan Vasiljeviq Kutozovi.

“Tribali i Madh po, edhe i gjithë Izraeli, masturbojnë jashtë

orgazmës, jashtë dashurisë. Ç'mund të bëjë, i vetmuar, ai Rabi Jochanan ben Sakai nga mitra e asaj Rebekës së Alamekut?"- e ngacmoi gjenerali austriak.

"Zoti gjeneral"- e ndërroi zërin gjenerali rus. -"Ju po llogoroni këtu, pranë Jakovës së Jerusalemit qysh nga viti njëmijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë, atëherë kur ai Sigmundi juaj, krejt sipas rregullës, tek gratë e Jakovës së Jerusalemit e zbuloi mitrën arketipe"- ia kujtoi rusi.

"Gjeneral i nderuar ç'na qenkan këto arketipe të Sigmundit të Vjenës, të zbuluara në këtë qytet"- u bë gati vërdallë gjenerali austriak.

"Arketipet janë midhje mitrash të mbyllura, mishi i të cilave aq shpejt mbruhet në: klitoris, në orgazëm, në seks po, veçan në dashuri. Të gjitha këto, ai shkencëtari juaj- Sigmundi i Vjenës, ogurzisht i quajti në atë psikanalizën e vet libido arketipe"- u egertis gjenerali rus.

"Ruana Zot! Këto gra të Jakovës së Jerusalemit po i arritkan aq leht, aq shpejt, të gjitha ato: seksin, orgazmën, dashurinë!"- dëshpërueshëm e pyeti gjenerali austriak.

"Edhe pse, e pabesueshme, këso nate akrepat e orës po lëvizin çmendurisht, zoti gjeneral"- u ngulfat për një çast gjenerali rus. -"Sofia e Jakovës së Jerusalemit mbi varrin e Redalk san Heldikut e ka arritur atë orgazmën noprane të mitrës arketipe. Ajo ju ka mashtruar. Edhe ju të OSCE-së keni menduar se po e mashtroni Sofinë e Jakovës së Jerusalemit. Por tashmë testiset e vërteta të Redalk san Heldikut posa arritën nga Stambolli. Ato testise të vërteta do ta joshin atë grua derisa ta zbulojë vetveten. Do t'i bëhet e pamundur loja. Ju, gjeneral i nderuar, doni ta joshni Sofinë me mish eunuku të Redalk san Heldikut"- e vuri në lojë gjeneralin austriak.

Herman von Urlihu e ndjeu në mish sëmbimin e gjeneralit rus. Tek e fundit Redalk san Heldiku mund të jetë ndarë në më shumë copa. . .

“Zoti gjeneral”- u ngut Herman von Urlihu. -“Turqia mund të kontrabandojë pjesë-pjesë me testiset e Redalk san Heldikut”- gati qeshi gjenerali austriak. -“Ne qemë aty, kur Sofia e Jakovës së Jerusalemit, nën dritën e reflektorëve të fuqishëm të OSCE-së, e vuri këmbën mbi varrin e të vëllait- Kostantinit të Haçet Deletës”- e ndërpreu zërin Herman von Urlihu sikur i mbet diç në grykë.

Kureshtja e gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit u bë e padurueshme deri në shpërthim.

“Dhe ju, të OSCE-së, e patë se ç’i ndodhi Sofisë kur e vuri këmbën mbi varrin e të vëllait- Kostantinit të Haçet Deletës?”- ia hyri çështjes gjenerali rus.

“Po, e pamë të njëjtën gjë me juve, zoti gjeneral. Sofisë së Haçet Deletës as t’i ketë shkuar mendja të mashtrojë mbi varrin e të vëllait. Ajo, atë çast, mbi varrin e të vëllait u bë medium biologjik i solucionit Tuaj Sovjetik:“Sanguis lacertae in musculo”-“Sanguis lacertae in cerebro”. Ju, rusët sovjetikë, e keni provuar këtë solucion në te gjitha shtetet Tuaja të Paktit. Në Shqipërinë e Albanikut sovjetik e dha rezultatin më të lartë.

Sofia, sa qëndroi mbi varrin e të vëllait, jo vetëm të mos ketë mashtruar por asaj filloi t’i shkoqet mishi nga ashti; deshi të bëhej skelet sovjetik duke u çjerrë deri në kupë të qiellit:

“Rroftë vëllazërimi me sovjetikët! Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni! Vdekje Imperializmit amerikan!”

Ishit, ju sovjetikët, zoti gjeneral, ata të cilët folët nëpërmes Sofisë, në çastin kur ajo qëndroi mbi varrin e të vëllait. Ishte kumti juaj drejtuar OSCE-së”- qëndroi sfidueshëm gjenerali austriak, Herman von Urlih. - “Ju, zoti gjeneral, e keni dëbuar misionin e OSCE-së nga Jakova e Jerusalemit përtej kufirit, në Shqipërinë e Albanikut sovjetik vetëm për të operuar tinëzisht konventave në mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit”- e ngacmoi pa asfarë diplomacie gjeneralin rus.

“Ne, zoti gjeneral, po e bëjmë, këtu në Jakovën e Jerusalemit, atë çka e bëtë ju austriakët në mitrën e vajzës së Aleksit, atje në Sarajevë”- ironizoi gjenerali rus.

“Gavrillo Principi qe një çifut i mallkuar. Ai me njëfarë penisi prej akrepi e përshkëlliri, e ndoti vajzën e Aleksit. Krejt një, gjeneral i nderuar. Edhe ju sovjetiket, sonte, këtu në Jakovën e Jerusalemit po e ndjekni për ta zënë një çifut”- e bëri krahasimin, sipas mendjes së vet gjenerali austriak duke përkitur në Rabi Jochanan ben Sakain.

“Ju po gaboni, zoti gjeneral. Krejt ndryshe qëndron çështja e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit nga vajza e Aleksit. Kjo, Sofia, e ka arritur, njërën pas tjetrës: orgazmën, dashurinë, seksin, mbi penisin e atij Redalk san Heldikut në tendën e Zatrës Arameje. Ndryshe, krejt ndryshe, vajza e Aleksit të Sarajevës rropatej me një lajthizë mishi mashkullor të Gavrillo Principit të çpifur nga vetë ju”-e kundërshtoi gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi.

“Si mund të shpjegohet nxitimi juaj, zoti gjeneral? Ju vetë e akuzuat Gavrillo Principin se e dhunoi vajzën e Aleksit, burrit më të ndershëm në Sarajevë.Nga ana tjetër Ju, sonte keni vendosur t’i hapni të gjitha mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit. Ne, austriakët, në Sarajevë e shqyrtuam vetëm një mitër të vajzës së Aleksit. Kaq na mjaftoi”- tërthorazi gjenerali austriak ia solli ndërmend rregullat e luftës.

Gjenerali rus, papritmas heshti. U bë i heshtjes së vetvetes së vet.

58.

Sofa e Jakovës së Jerusalemit u hodh nga dera e helikopterit drejt errësirës, e joshur nga Rabi Jochanan ben Sakai. Ra në ajrin e butë të natës. Deshi t'i përgjërohet Rabis kur i zuri këmba në tokë. U bënë krejt afër ndërtesës së aeroportit. Nga atje, i ra në fytyrë ajri i nxehtë i motorëve të avionit me kundërmim prej hekuri të grasatuar.

"Është fërtoma e motorit të avionit"- e qetësoi Rabi Jochanan ben Sakai. -"M'i jep dokumentet!"- e urdhëroi serish.

Sofia u përmend nga përgjumja e ajrit të butë; u bë e vetvetes së vet kur në dorë e pa se ende po e mbante zarfin e gjeneralit roman, Titi. Ia zgjati Rabi Jochanan Sakait pa asnjë fjalë. Ai i mori dokumentet e Sofisë. Në dorë ia lëshoi një zarf tjetër. I foli gati në vesh. Ajo e ndjeu firomën gudulisëse.

"Sonte, në avion për në Romë do të jesh stjuardesa Ruti e Simonit nga Sidoni. Me Rebeken e Alamekut mos komuniko! Në

avion gjendet edhe delegacioni i Tribalit të Madh të Jerusalemit. Në atë delegacion është edhe Jakobi i urtë. Ai do të heshtë, vetëm do të heshtë.

Pas një ore e gjysmë do të aterrojmë në aeroportin "Leonardo Da Vinçi" të Romës"- i pëshpëriti, përngutshëm, Rabi Jochanan ben Sakai.

59.

Ra shi gjithë ditën e lume të zotit.

Buzë mbrëmjes dielli e gjet një të çarë në retë e trasha. Një rreze dielli, trembshëm, e arriti derën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Shiu sërish vazhdoi me fodullëk tërë natën e lume të prillit të tetëmbëdhjetë. U bë edhe viti njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një, e pastaj u bë mbrëmje.

Çatitë e Kremlinit zunë të pikojnë. Muret i zu pika e rrëzimit.Varrezat e paktit-Varshavë u mbushën me ujë.Varrit- Shqipëri Albanike të Kostantinit të Haçet Deletës sikur i lëvizi pllaka mbi vete. Ishte natë e zezë futë kur Kostantini u çua nga varri i mbushur ujë deri në gjoks. Qëndroi një kohë, ashtu ulur në varrin e vet- Shqipëri Albanike derisa me rrashtën e lame të kresë vendosi ta bëjë atë rrugë deri në Jakovën e Jerusalemit.

Kur doli nga varri- Shqipëri Albanike kutërboi rëndë tokë të prishur përkundër gjithë atij shiu me xhym. Eci vetëm tetëqind metra deri tek kufiri Shqipëri Albanike- Jakovë e Jerusalemit.

Pasi e kaptoi kufirin eci edhe katërqind metra deri tek Sofia e Haçet Deletës. Gjithkund rrugës e la zvarrë prapa vetës kutërbimin e rëndë të tokës së prishur- Shqipëri Albanike. Kutërbimi ecte gjithkund prapa Kostantinit të Haçet Deletës deri tek derë e Sofisë në Jakovën e Jerusalemit.

Dera e Sofisë u hap pritueshëm në atë kohë nate shianike.

Me guvat e errëtisura të syve të rrashtës së lame, Kostantini i Haçet Deletës u katandis ta dallojë dike në derën e Sofisë.

Nga thellë shtëpisë, zvargshëm pyeti një zë prej gruaje:

"Kush a' n'derë?"

"Jam unë, Kostantini i Haçet Deletës"- i fërshëllei zëri nëpër mazgallat e kafkës së larë.

"Afrohu më!"- e urdhëroi zëri i gruas.

Kostantini i Haçet Deletës eci nëpër zërin e gruas deri tek ajo.

"Jam unë- Kostantini i Haçet Deletës"- çeli kuvend sërish ai.

"Pse ke ardhë të na marrësh në qafë? E sheh se jemi të rrethuar nga të gjitha anët? Ushtria e gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit, po djeg çdo gjë para vetes"- zvargshëm i tha Sofia.

"Motër duaji Sovjetikët! Ata i kemi vëllezër"- i foli nga larg Kostantini gjatë këtij masturbimi nëpër eshtrat e skeletit kutërbues.

"A e njeh ti gjeneralin rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovin?"- e pyeti ajo.

"Jo Motër! Përse ta njoh? Ai po e bën vetëm detyrën ushtarake"- e këshilloi Sofinë i vëllai.

"Ç'detyrë ushtarake na qenka t'i çelësh mitrat e grave?"- erdhi nga larg zëri i saj.

"Po përse gjenerali Kutozov i çel mitrat e grave të këtij qyteti?"- u vardis Kostantini i Haçet Deletës.

“Ai gjeneral e kërkon mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.Në mitrën e saj paskesh rënë sperma e Redalk san Heldikut. Kjo mitër mund t’i bie në dorë asaj Indigjenes Iroki – Pocahontas Powhatanit të gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsit”- shpjegoi zëri i saj.

“Motër, urreje imperializmin amerikan! Urreji amerikanët!” - u çjerr Kostantini. -“Motër, ju ka mashtruar ai çifuti i ndyrë-Rabi Jochanan ben Sakai. Mos i besoni motër! Jepja vullnetarisht mitrën tënde gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit. A ka gjë më të këndshme se gratë të lirohen nga mëkati femëror i mitrës, i orgazmës, i seksit? Se burrat të lirohen nga mëkati mashkullor i mishit të tyre penis? Ne, në Shqipërinë e Albanikut sovjetik jemi liruar nga të gjitha këto lloje mishrash. Tashmë jemi bërë skelete të lumtura. Çdo fërtomë kalon nëpër eshtrat tona gërdalla”- i dha zemër asaj Kostantini i Haçet Deletës.

“Kush të ftoi të vije për këto fjalë?”- e pyeti ajo

“Po, ti më thirre motër. Ja ku erdha. ”

“Po kur të thira?”

“Porsa më thirre unë erdha motër. Kështu shkruan edhe në baladën time të kooperativës sonë. Aty, në atë baladë, ta përmendin emrin edhe ty motër”- u përpoq të gëzohet Kostantini i Haçet Deletës.

“Dëgjo, more fyell!”- ia këputi gëzimin skeletor ajo. -“Unë të thirra në vitin njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë kur në klinikën “Mercoledi” të Vjenës konsiliumi i mjekëve austriakë nën diagnozën “Sanguis lacertae in utero” e nxori nga mitra e Teutës së Haçet Deletës një veshtulli gjaku të ngjizur. Unë të thirra gabimisht ore fyell eshtak”- e vazhdoi ajo avazin e rëndë për Kostantinin.

“Megjithatë ti më thirre motër. Ja unë erdha me shpejtësinë e erës.Bile do të vishë në vizitë tek nëna. Atë po e djeg mallëngjimi për ty motër”- i tha Kostantini pa e prishur tetikun.

“Për cilën nënë po me flet? Cilën nënë e paska marrë malli për mua?”- u haverda ajo nga thellë shtëpisë së vet.

“E paske harruar nënën tonë, o motër? Mërgimi ta paska ftohur akull zemren”- ra në mallëngjim të skeletit kooperativist Kostantini i Haçet Deletës.

“Si e ke kaluar kufirin sonte? E ke kaluar me pasaportë apo e ke kaluar ilegalisht?”

“Pasaportën do të ma kishte zbru ky shi ngordhalaq. U detyrova të mos e marr me vete. U desh ta kaloj ilegalisht kufirin”- arsyetoi Kostantini i Haçet Deletës.

“Ti paske arrdhë ilegalisht në Jakovën e Jerusalemit?”- u shastis Sofia e Haçet Deletës duke e pandeh për spiun.

“Diçka e tillë ka ndodhë. Nëpër pergamenat e baladave, motër, kush i merr nëpër gojë pasaportat. Kostantini i Haçet Deletës nëpër të gjitha pergamenat udhëton pa pasaportë”- i tha ai për vetveten.

“Po kuajt a i ke marrë me vete siç shkruan në ato pergamenat Tua të kooperativave sovjetike?”-e pyeti ironikisht Sofia.

“Motër, të gjithë kuajt dhe zotin e Shqipërisë së Albanikut sovjetik i kemi dorëzuar në kooperativë. Kujt i duhen në Shqipërinë e Albanikut sovjetik kuajt dhe zoti?”- u prish në fjalë Kostantini i Haçet Deletës.

Sofia pushoi paksa në hutesën e Kostantinit.

“Në atë librin tënd të asaj baladës hardhucë, pa orgazëm, pa dashuri, a përmendet kund kooperativa sovjetike?”-me plot sarkazëm arriti pyetja e saj.

“Mbase edhe përmendet”-u përpoq të gjejë dalë Kostantini.

“Kaq shumë qenka prishur dheu i varrit tënd përtej kufirit, aje në Shqipërinë e Albanikut sovjetik sa të kutërbojë kaq rëndë?”- përvajshëm e bë zëri i saj.

“Jo motër, kutërbimi më vije nga masturbimi yt mbi varrin tim. Ata të OSCE-së të gjitha mbeturinat e laboratorit të vet i hodhën mbi varrin tim. Bile janë gjetur copa minjsh të kafshuar nga ndonjë përbindësh”- i përsëriti fjalët ai me ngutinë e një nxënësi të retarduar.

“Nga i di të gjithë këta emra?”- u serit ajo.

“Të gjitha njëpërnjë na i tha Sekretari i Partisë në tubimin e rajonit”- me të njëjtat fjalë vazhdoi Kostantini.

“A mungoi ndonjëri në atë mbledhje?”- e shulustrisi zëri i saj.

“Si zakonisht, mungoi vetëm ajo plaka çekere - Jezofina e Ndojës”- e bëri zërin qortues Kostantini.

“Përse mungoi në mbledhjen e partisë Jezofina e Ndojës? Ia ndaloi ndokush apo ajo vetë mungoi?”- u interesua zëri i saj.

“Jezofinës së Ndojës i ndalohet të vijë në mbledhjet e partisë. Bile tashmë ajo është bërë gati të mos flasë me askënd e, askush të mos flasë me të.”- sërish qortoi Kostantini. -“Ajo flet me vetveten e saj më shumë se ç’flet e gjithë bota së bashku”- vazhdoi ai.

“E dëgjoi kush se ç’flet Jezofina e Ndojës me vetveten?”

“Të gjithë i shmangen takimit me të. Të gjithë e morën vesh se Jezofines i kishte rrëshqitur këmba në një ëndërr të keqe”- i kërcëllitën eshtrat e kafkës së larë Kostantinit.

“Dhe Jezofina mbet në fund të ëndrrës përgjithmonë?”

“Po, motër -përgjithmonë mbet në fund të ëndrrës.”

“Jezofina e Ndojës mbase do t’ia ketë treguar dikujt atë ëndërr?”

“Po, motër, e tregoi po atë mëngjes, me t’u zgjuar. Bile e tregoi pa fije të turpit” - i pushoi paksa Kostantini, sikur e priti kureshtjen e zërit të saj. -“Atë mëngjes, ende pa u ngritur vesa nga gjethet, Jezofina e Ndojës ia tregoi ëndrrën ogure Marisë së Pjetrit. Thonë se Jezofina e Ndojës e kishte vizatuar në një

kartuç, fundekryre ëndrrën e vet”- zu të bëhet gjithnjë e më i qortueshëm zëri i Kostantinit.

“Maria e Pjetrit e paska parë krejt ëndrrën e Jezofinës, fundekrye pa asfarë kokëçarje?”-Sofia e zërit të vet e pyeti Kostantinin.

“Në kartuç, motër u panë të vizatuara pesë fjalë, vetëm pesë fjalë të anlishtes imperialiste, nën të cilat dy duar e shtrëngonin njëra-tjetren. Pastaj u hap fjala se Jezofina e Ndojës atë kartuç e paska gjetë në mal. U tha se kartuçin e kishin parë edhe të tjerë njerëz; se mund të përhapej epidemia e ëndrrës së saj. Se këso kartuçësh serish mund të hedhin avionët amerikanë”- zu të ngulfatej në eshtrat e veta Kostantini.

Me shumë kujdes Sofia e zërit të vet e nuhati lodhjen e Kostantinit. Ndaloi paksa sikur i kaloi interesimi për këtë ëndërr.

Kostantini, i ngulfatur në eshtrat e skeletit të vet iu frikësua hidhërimit të motrës. Vendosi të udhëtojë nëpër zërin e vet, i vetmuar, ashtu siç kishte udhëtuar deri ne Jakoven e Jerusalemit.

“Motër! Në kartuçin e ëndrrës se Jezofinës ishte shkruar në anglishten imperialiste: “Donated by people of America”. Nën këtë shkrim qe vizatuar e tërë ëndrra e Jezofinës së Ndojës: një burrë i lakuriquar, te këmbët e të cilit qe shkruar fjala, apo emri i tij: John Harker. Ai burrë i lakuriquar në kartuçin e ëndrrës së Jezofinës e kishte tendosur një shikim te paturpshëm drejt një gruaje të lakuriquar, nën të cilën ishte shkruar emri i saj: Pocahontas”-vazhdoi Kostantini duke menduar se e zgjoi kureshtjen e të motrës

Vetvetja e zërit të Sofisë u bë si e shkujdesur për rrëfimin e Kostantinit. Ajo heshti derisa Kostantini ta ketë kuptuar hidhërimin e shkaktuar nga ëndrra e Jezofinës së Ndojës. Kostantini e ndjeu lagështinë nëpër të gjitha eshtrat e shpëlara të skeletit të vet.

“Mbase ajo, imja motër, mund të jetë fyer nga fjalët e mia”- u rrokullis nëpër eshtrat e veta Kostantini.

Nëpër vetveten e zërit të Sofisë arriti deri te Kostantini mëtesa për atë Marinë e Pjetrit, se ç’ndodhi me të.Mbase Maria edhe mund të jetë sëmuar ashtu papritur.

“Ashtu edhe ndodhi motër”-u ngut, ndërkyeshëm Kostantini. -“Maria e Pjetrit me ta parë ëndrrën e Jezofinës, të vizatuar në kartuç, e ndjeu një sëmbim midis vegësh, një rrjedhë lëngu të nxehtë teposhtë. Ajo i kishte zgurdulluar sytë, e magjepsur, në ëndrrën e vizatuar në kartuç. Klithi deri në kupë të qiellit. U pllakos, pa shpirt në ëndrrën e Jezofinës së Ndout.

Postieri, Zefi i Çettës, duke qëlluar afër, në këtë çast të lig, e pa krejt ekzaltimin e Marisë së Pjetrit. E dëgjoi çjerrjen e saj. Maria, e plandosur përtokë ra në amokun e mishrave të përzier të ëndrrës së Jezofinës. Zefi i Çettës pak para se të arrijë tek Maria e plandosur shikimi i ra në kartuçin tek ishte vizatuar ëndrra e Jezofinës së Ndojës. Nga kartuçi ku ishte vizatuar ëndrra e Jezofinës, ajo gruaja lakuriq- Pocahontas, ia bëri me sy Zefit të Çettes. Shikimi i saj iu ngul, rrufeshëm, në mish. E ndjeu midis shalësh mishin e mugulluar mashkullor. I ra lëbyrje sysh. U pllakos në të”- e zgjati rrëfimin Kostantini i Haçet Deletës sikur po gjente arsyetim për vetveten e vet.

“Mbase do të sëmureshin të gjithë; do të sëmurej e gjithë Shqipëria e Albanikut sovjetik; do të sëmurshin të gjitha shtetet e Paktit?”- Sofia e zërit të vetvetes së vet e ironizoi sëmundje ëndrrën e Jezofinës së Ndojës.

“Të gjithë do të sëmureshin, motër, ashtu siç i përmendet Ju, njeri pas tjetrit: njerëzit, Shqipëria sovjetike po, edhe shtetet e Paktit sikur të mos kishte arritur në çastin më të duhur ndihma e shpejtë nga Tirana. Ia çatisën mjekët dhe teknikët. I kishin vënë maskat mbrojtëse kundër epidemive, me xhama të erratisura për të mos e parë ëndrrën e Jezofinës së Ndojës. Ëndrrën e vizatuar në kartuç e mbyllen në një kuti të çeliktë.

Marinë e Pjetrit dhe Zefin e Çettës i nisen urgjentisht për Tiranë. Vetëm Jezofinën e Ndojës e lanë ashtu të magjepsur në ëndrrën e vet"- ndaloi Kostantini i Haçet Deletës për ta vërtetuar në ishte aty, ende, zëri i vetvetes së Sofisë.

Heshtja e tendosur vinte nga andej Jakovës së Jerusalemit të Sofisë së zërit të vet. Kostantini i Haçet Deletës e pa të pamundur heshtjen e mëtutjeshme. Duhej t'ia thoshte të gjitha për ta shkarkuar skeletin e vet.

"Në fund të dyzet ditësh te analizave mbi kartuçin e ëndrrës së vizatuar të Jezofinës së Ndojës, u shfaq komunikata tek gazeta "Zëri i popullit". Pastaj kjo komunikatë u vendos nëpër të gjitha sheshet, nëpër të gjitha rajonet. U mobilizuan të gjitha kuadrat e partisë nëpër tubime, mitingje, mbledhje, seminare. U qartësua rreziku nga epidemia. Shtetasit, Shqipëria e Albanikut sovjetik, shtetet e Paktit të Varshavës, i gjithë njerëzimi, qenë pllakosur nga pandemia e imperializmit amerikan. Ky imperializëm, me avion spiunimi U2, ka hedhë kartuça nëpër ëndrrat e shtetasve të Paktit, në të cilët kartuça është vizatuar ëndrra e Jezofinës së Ndojës me burrin dhe gruan lakuriqe. Nën gruan-Pocahontas Powhatan është shkruar: DONATED BY PEOPLE OF AMERICA. Në kartuçin e ëndrrës së Jezofinës janë vizatuar skena amorale, të papara ndonjë herë në vendin tonë, as në vendet tjera të Paktit.

Kuvendi Popullor, i tunduar nga vullneti i popullit, vendosi: të vaksinohen njëpërnjë të gjithë shtetasit e Shqipërisë së Albanikut sovjetik kundër kësaj pandemie të hedhur nga avioni i spiunimit U2. Vaksinimi filloi pas tri ditësh nëpër të gjitha pikat rajonale të atdheut"- Kostantinit të Haçet Deletës i skërmitën lodhshëm eshtrat e lara të nofullës duke i përplasur njërën mbi tjetrën, mbi dhëmbët e spiruar.

Kostantini u bë edhe më i tejdukshëm. Mund ta përshkoje shikimin tejpërtej brinjve të skeletit fosforik të tij. Ishte e pamundur të mëshehej ndonjë e keqe për shtetin midis atyre brinjve

të rralluara fosforike të cilat shndrisnin aq brerorët në natën e tetëmbëdhjetë të prillit shianik.

"Sa i devotshëm ky shtetas. Çdo gjë shihet tejpërtej nëpër eshtrat e tij të rralluara fosforike"- erdhi mendimi i vetvetes së Sofisë.

Kostantini i Haçet Deletës e patë të vështirë ta dallojë cili qe: mendimi apo zëri i së motrës. Priti paksa në heshtjen e eshtrave të veta. E ndjeu se duhej vazhduar kuvendin me të motrën.

"Pas tri ditësh ia çatisi kontingjenti i parë i vaksinave nga vëllai ynë i madh-Bashkimi Sovjetik. Menjëherë pas tij, ia çatisi kontingjenti i dytë nga vëllezërit kinezë. E gjithë kërkesa për vaksina u plotësua brenda javës. Ditën e shtunë, ashtu më dukët, kur dita e njëzetenëntë e qershorit po rrokullisej në pasdreken e vet të vitit njëmijë e nëtëqind e dyzet e tetë, filloi vaksinimi në të gjitha pikat rajonale nëpër të gjithë Shqipërinë e Albanikut sovjetik"- pushoi së foluri Kostantini i Haçet Deletës sikur e shqyrtoi shpjegimin e vet.

Ai e ndjeu përftimin e firomës nëpër eshtrat e skeletit të vet të zhgardhnuar. Qe shikimi i Sofisë nëpër errësirë deri tek skeleti i tij fosforik.

"Pikërisht atë ditë të njëzetenëntë të atij qershori, kur të paska thirrë motra jote- Sofia e Haçet Deletës. ti paske qenë i vaksinuar me "Sanguis lacertae in musculo" dhe me "Sanguis lacertae in cerebro". Si ke mundur ta dëgjosh zërin e motrës tende?" - ishte zëri nga Jakova e Jerusalemit.

"Motër, po më mbeti ndonjë njollë e shikimit tënd qortues nëpër eshtrat e mia do të më burgosin kur të kthehem në Shqipërinë e Albanikut sovjetik,Do të më thonë se e kam kontrabanduar shikimin e motrës"- iu drejtua përvajshëm Kostantini atij zërit nga Jakova e Jerusalemit.

“Cili mund të bëhet burgu për këtë grusht eshtrash të zhgardhnuara?”- i erdhi zëri nga vetvetja e Jakovës së Jerusalemit të Sofisë.

“Burg, e ç’ke me të. Së pari të mbyllin në çeli të burgut. Prej çastit të parë ta heqin racionin e grasatimit. Një jave pas kësaj ndalese eshtrat e humbin viskozitetin;shtangen të gjitha nyjet. Bëhesh i palëvizshëm”- shpjegoi Kostantini.

Pastaj ra në heshtje nga frika se mos e zbuloi sekretin shtetëror të grasatimit të eshtrave.

“Për sa kohë u krye vaksinimi në tërë Shqipërinë e Albanikut sovjetik?”- iu bë Kostantinit apo ishte zëri i vetvetes së Sofisë.

“Urdhri i Presidiumit të kuvendit popullor qe: “vaksinimi i të gjithë shtetasve të Shqipërisë së Albanikut sovjetik të kryhet brenda një dite”. Secili, e të gjithë shtetasit u mobilizuan. Në orën njëzet të darkës u vaksinua edhe shtetasi i fundit”- sikur raportoi Kostantini i Haçet Deletës.

“Me kaq punë çështja përfundoi?”- serish zëri i Jakovës së Jerusalemit të Sofisë.

“Rrafsh një javë, deri tek dita e pestë e korrikut të vitit njëmijë e nëntëqind e dyzet e tetë u bë heshtje në terë Shqipërinë e Albanikut sovjetik. Me ndrojtje priteshin simptomat e para të vaksinimit. Mund të mos kishte zënë vaksinimi. Mbase mund të përsëritej”- u tremb nga vetvetja e vet Kostantini.

“Mbase edhe mund të jenë shfaqur simptomat e para?. . ”- iu bë apo ishte zëri i vetvetes së vet Sofisë.

“Pas shumë mundimeve, të vjellave, ëndrrave të ankthshme, u shfaqen simptomat e para. U shfaqen gjithandej në tri vende mbi lëkurë. Blanat e para ngjyrë vjollce u shfaqen në lëkurën e tëmthit, në lëkurën e brinjës së majtë, në lëkurën e pulpit të këmbës së majtë. Më të fatshmit, më të lumturit qenë ata të cilëve blanat së pari iu shfaqen në testise, në penis, në vagjinë.

Tek disa shtetas u vonuan simptomat e tek disa mbet pa zënë vaksina. U përseriten vaksinat e veçanta me dosje të veçanta. Shumë vite u përcjell gjendja e tyre shëndetësore"- vazhdoi të rrokulliset në vetveten e vet Kostantini.

"Paska qenë dita e njëzetenëntë e qershorit të vitit njëmijë e nëntëqind e dyzetë e tetë?"- arriti zëri i vetvetes së Jakovës së Jerusalemit.

"Blanat ngjyrë vjollce erdhën e u zgjeruan bashkë me plasaritjet e mishit. Plasaritjet e mishit u thelluan. U hapen aq sa ata më entuziastët lajmëruan se vende-vende i paskëshin parë eshtrat e veta. Filluan të jepen deklaratat e para në Radio Tiranë, në "Zërin e Popullit", nëpër tubime, e kudogjetkë. Më në fund u shfaqen ekspertët e parë sovjetikë e, pastaj edhe ata kinezë"- e ngadalësoi vetveten Kostantini duke rënë në bunacën e çastit.

"Vaksina "Sanguis lacertae in musculo" dhe "Sanguis lacertae in cerebro" e paskesh dhënë rezultatin më të shpejtë, më të suksesshëm, në Shqipërinë e Albanikut sovjetik se në të gjitha vendet simotra të Paktit socialist"- sikur u katandis në dëshpërim zëri i vetvetes së Sofisë.

"Vetëm kur i pamë vëllezërit sovjetikë dhe vëllezërit kinezë e kuptuam suksesin e vaksinimit në Shqipërinë e Albanikut sovjetik. Ata zunë të japin instruksione se si duhet vepruar secili ditën e dyzetë të vaksinimit. Duhet ruajtur të gjithë shtetasit nga ndonjë infektim imperialist gjatë inkubimit të vaksinës.

Parë suksesin, secili shtetas udhëzohet, me mjete shtetërore, në mënyrë të organizuar, ta hapë për vete gropën e dezinfektimit një metër e gjysmë gjatësi, një metër thellësi, një metër gjerësi. Secili shtetas i Shqipërisë së Albanikut sovjetik të dyzetën ditë pas vaksinimit të qëndrojë në gropën e dezinfektimit me këmbë të futura në qeskën zezë prej plasmasti të mbushur me klor derisa mishi i keq, i shkoqur nga ashti, të bie derdheshëm në fund te gropës, në qeskën prej plasmasti. Secilit, e të gjithëve, u ndalohet të dalin nga gropa pa e dhënë vlerësimin

komisioni mikst sovjetiko-kinez. Secilit, e të gjithëve kur ua lejon komisioni të dalin nga gropa sipas udhëzimeve, iu urdhërohet ta derdhin mishin e vet nga qeska e plasmastit në gropë mbi rrobat e paluara në fund. Secili shtetas i Shqipërisë së Albanikut sovjetik, qoftë djalë, burrë, qoftë vajzë apo grua u bë i detyruar t'i japë shtetit tagër një parë testise e një penis, për meshkujt dhe një vagjinë e një mitër, për femërat.

Klori i sjellur nga vëllezërit sovjetik dhe nga vëllezërit kinezë do ta tresë në tokë mishin e infektuar.

Motër u bëmë të gjithë njësoj të lumtur. U bëmë të një moshe, të një mendjeje, të një gjinie. Secili ia përshkonte tjetrit shikimin, tejpërtej, nëpër eshtrat e grasatuara me një lloj yndyre me kutërbim hekuri. Për herë të parë të gjithë shtetasit e Shqipërisë së Albanikut sovjetik u ndjenë të lehtësuar: pa gjumë, pa ëndrra, pa nevojë pushimi, pa lodhje, pa të gjitha ato rrokopujat mishtake siç janë: buka, uji, dëshira, seksi, orgazma. . . Gjithçka u bë e lehtë. Motër a ka gjë më të ngazllyeshme se t'i bartesh mbi këmbët tuaja vetëm eshtrat e pastra, pa atë mishin e ndotur aq kutërbues nga djersa, nga urina, nga të palarat. Pa atë mishin e ndotur i cili mund të të çojë peshë kundër shtetit tënd më të mirë në botë, kundër shtetit pa zot e pa kuaj. Po a ka gjë më të lumtur se të jetoshë eshtërisht në shtetin e parë ateist në botë. U bëmë të lumtur.

Ti, motër, mund ta kuptosh se sa pak eshtra kishte njeriu. Të gjitha eshtrat e një njeriu mund t'i fusësh në një qese të vogël prej plasmasti" - u entuziazmua Kostantini; u ekzaltua duke u rrokullisur në vetveten e vet.

"Haçet Deleta i Ilirikut Albanik do ta ketë pasë të vështirë në këtë vaksinim. Mbase atij ka qenë duhur t'i përsëritet disa herë vaksinimi i veçantë" - nga larg erdhi zëri i vetvetes së vet Sofisë.

"Si më së miri motër. Haçet Deleta iu gëzua më së shumti

këtij vaksinimi. Bile edhe e shprehu gëzimin e vet duke thënë publikisht:

"Tashmë shpëtuam nga dhimbja e tëmthit, nga dhimbja e brinjës së majtë,nga dhimbja e pulpit të këmbës së majtë. Pjelljet e atëhershme nëpër Evropë bëheshin me dhimbje të mëdha. Sa njerëzit vdisnin nëpër Evropën kapitaliste sepse u lindën me dhimbje të papërballueshme. Gratë tona i shpëtuam nga mitrat e ndotura, nga lindjet e vështira. Burrat i shpëtuam nga detyrimet e peniseve, të testiseve. Plakat, pleqtë, fetarët, i shpëtuam nga detyrimet e zotit"

Haçet Deleta, pas kësaj deklarate kaloi me punë në Tiranë" - zëri i Kostantinit u drithërua në mburrjen e çastit.

Zëri i vetvetes së vet Sofisë, sikur e heshti mburrjen e Kostantinit. Ai mbase mund ta kishte tepruar gëzimin e vet prej skeleti. Njeriu i mishit kutërbues e ka vështirë ta kuptojë gëzimin e eshtrave të lumturuara.

Kostantini e vendosi t'i tregoj së motrës se çfarë mund të sjellë gabimi i mishit të ndotur të njeriut.

"Ti, motër, e hesht qëllimisht se ç'mund t'i ketë ndodhë më vonë Jozefinës së Ndojës?"- shpërtheu Kostantini. - "Ajo nuk u vaksinua. Mbet i vetmi skelet në Shqipërinë e Albanikut sovjetik, i mbështjellë me mish të ndotur. Jezofina e Ndojës vazhdoi të kutërbojë: djersë, urinë, ëndrra, uri, dëshira... Ajo hante ushqim të importuar, pinte, flinte. Të gjitha i merrte nga importi. Në fund të të gjithave Jezofina e Ndojës ëndrronte natën po edhe gjithë ditën e lume. Jezofina tërë ditën qëndronte para derës. Në fillim qëndronte me detyrim, pastaj i kaloi në shprehi . Afër saj e vendosen atë kartuçin në të cilin qe vizatuar ëndrra e saj: "Donated by people of America", me shtatin e lakuriquar të Indigjenes Iroki- Pocahontas Powhatan dhe të atij John Harkerit të Massachusettsit"-e arriti rrjedhshmërinë e rrëfimit Kostantini i Haçet Deletës duke ndalur herëpasherë sa për ta

bindur vetveten e vet se Sofia po e dëgjonte vëmendshëm kumtin e tij.- "Turistët e vendeve Socialiste, të organizuar në grupe revolucionare, me të arritur në Shqipërinë e Albanikut sovjetik, ashtu kolektivisht dërgoheshin në muzeun e Jezofinës së Ndojës. Të cilësdo gjuhe qofshin këta turistë, të cilitdo kontinent qofshin, u shpjegohej nga ciceronë të specializuar ëndrra e deshtuar e imperializmit amerikan në kartuçin e Jezofinës së Ndojës. Shkronjëpërshkronjë u lexohej, u interpretohej rreziku i imperializmit amerikan, jo vetëm për Shqipërinë e Albanikut sovjetik, por për të gjitha shtetet e Paktit, për të gjithë botën" - Kostantini i Haçet Deletës pushoi aqsa i duhet njeriut për ta kapërcyer një gllënjkë të athëshme në fyt.

Ai tashmë u bë skelet. Gllënjka do t'i rrjedhë eshtrave teposhtë nëpër grasatimin me vaj të ngjizur erëhekur. Po, Kostantini për hir të së motrës u ngatërrua vërtet në këtë gllënjkë të vdirë nëpër eshtrat e larë.

"Gjatë vizitave të organizuara, bile edhe nga Amerika latine, tek muzeu i Jezofinës së Ndojës, a ka mundësi të ndodhë aksidenti me atë Indigjenen e lakuriquar në kartuçin e ëndrrës së Jezofinës së Ndojës? Pocahontas Powhatani e gjeneralit amerikan, Jahn Harkerit të Massachusettsit, mund t'ia bëjë me sy ndonjë vizitori të dobët nervash, siç i ndodhi atij postierit të Çettës" - i erdhi Kostantinit po ai zë i vetvetes së vetë Sofisë.

"Edhe ka ndodhur motër. Mirë e ke. Në një grup turistësh, të rinovuar marksistësh të tipit të Zhao Amazonas nga Brazili, qysh në fillim një Macho Pancho, aktor i dobët i dashuriçkave latine u përlosh halabakshëm para ëndrrës së Jezofinës së Ndojës. Ia luajti syrin Indigjenia Iroki nga kartuçi, apo Marçelo u shtir si i dashuruar, mbet e paqartë. Ai u rrëzua. U plandos përtokë, si i zënë amokut, para këmbëve të Jezofinës së përhumbur. Ekipi kujdestar e nxori Marçelon nga Muzeu i Jezofinës. E dërguan në Tiranë për shërim" - sikur u gëzua Kostantini i Haçet Deletës kur i dha rrugë për Tiranë atij Marçelos amazon-

as nga Brazili.

“Jezofina e Ndojës e ndjeu erën e mishit të marchelos. Ajo ujkonjë e vjetër, e ushqyer me mish të importuar, do të jetë ngacmuar nga aktrimi i Marçelos amazonas” - ishte mendimi apo pyetja e vetvetes së Sofisë, pa arritur ta rrezojë gurin e varrit nga gjoksi eshtak i Kostantinit të Haçet Deletës.

“Po, motër. Ajo ujkonjë e vjetër e nuhati kutërbimin e mishit amazonas të Marçelos i nuhati të gjitha ndotësitë e mishit: djersën, urinën,seksin, orgazmën, ëndrrën.I lakmoi të gjithë armiqtë e Shqipërisë së Albanikut sovjetik. Jezofina lëvizi paksa aq sa lëviz guri i makthit nga gjoksi nopran i saj. Lëshoi zë skërmitës nga hekur i ndryshkur i muzeut:

“A do të arrijë mishi i këtij dashnori latin deri tek dashuria. Ky Marçelo latin e tundoi ëndrrën time të mbushur mish të mugulluar, mish të tepruar nga kjo Shqipëria e Albanikut sovjetik të shndërruar në eshtra të lara. Përse e larguat atë dashnorin latin nga Brazili. Atij i rrëshqiti këmba në ëndrrën time prej kartuçi amerikan. Ai e tundoi mishin tim të tepruar nga Shqipëria e Albanikut sovjetik. Bëri të më zgjohet midis vegësh ajo ngrohtësia malcuese, t’i ndjëj tundimet e gruas. Mendja më bëhet dhallë nga djersitja, mundimi, tundimi i orgazmës, i seksit, nga të gjitha tundimet e vrara gjenetikisht në Shqipërinë e Albanikut sovjetik. Ai marçelo amazonas nga Brazili arriti ta shpëtojë mishin e vet në cegmën shkërmoqëse të Shqipërisë së Albanikut sovjetik”- foli vetëm atë ditë Jezofina muzeale.

“Kurva e përdalë!”- tha sekretari i rrethit”- e përfundoi diskutimin e tij Kostantini i Haçet Deletës, këtë herë mbase ngadhnjimisht.

Sërish ra heshtja mëtuese.

Midis Kostantinit të Haçet Deletës dhe zërit të vetvetes së Sofisë u shfaq zëri i tretë gati urdhërues:

“Jezofina e Ndojës ngeli i vetmi mish femëror në Shqipërinë e Albanikut sovjetik pa asfarë mundësie për t’i rrezikuar bashkështetasit e vet, të shndërruar vullnetarisht në skelete. Ajo e gjet në mal një copë kartoni të një pakoje ndihmash amerikane. E solli në shtëpi ngase e ngashnjei vizatimi i bukur i një gruaje dhe të një burri. Jezofina e rrokullisi në ëndrrën e vet kartuçin e pakos së vjetër të ndihmave humanitare amerikane pa pasur asfarë mundësie t’i lexojë as t’i kuptojë ato pesë fjalë të anglishtes amerikane:

“DONATED BY PEOPLE OF AMERICA”-vazhdoi zëri i atij tjetrit.

Kostantini i Haçet Deletës u tremb nga zëri i vetvetes së tretë prej burri . Zëri iu bë i njohur, disi dalazotës i Sofisë. U bë gati t’i bie ndesh atij zëri aq fodull.

Edhe pse zëri i tretë heshti për një çast, Kostantini e ndjeu në vetvete se ai zë do të flasë prapë. E priti të shfaqej sërish. Pa fare vonesë zëri u shfaq gati përngutshëm:

“Po si do ta marrë në të panë Kostantini të motrën? Si do ta shpie në Shqipërinë e Albanikut sovjetik, kur Sofia ka mbetur pa u vaksinuar me “Sanguis lacertae in musculo” dhe me “Sanguis lacertae in cerebro”. Ajo kutërbon: djersë, mish të gjallë, gjumë, ëndërr, seks, orgazëm…Dashuri. Pastaj Haçet Deleta sovjetik do të turpërohet nga kjo farë Sofie” - e njohu në fund, Kostantini zërin e Rabi Jochanan ben Sakait të përngutshëm.

“Çifuti i ndotur edhe këtu i paska futur kthetrat!” - u rrokullis në vetveten e vet i tendosur për t’u grindur me atë çifut.

“Sofisë, time motër, imunitetin e vaksinimit ia jep pasaporta diplomatike e Bohemisë. Ashtu shkruan në të gjitha pergamenat. Ashtu shkruan edhe në atë baladën e kooperativës sonë se si i vëllai i bërë skelet u ngrit nga varri dhe shkoi për ta marrë të motrën në të panë. Dhe ia doli kësaj pune” - çfryni Kostantini i Haçet Deletës.

“Në rrokopujën e vrasjes gjenetike të shtetasve të Shqipërisë së Albanikut sovjetik paksa dëgjohet teksti i dramës baladike. Në atë burleskë gjenetike e gjithë regjia bëhet pa u përmendur ndonjë pasaportë” - zëri i përngutshëm i Rabi Jochanan ben Sakait u bë gati sarkastik pa e përmendur orgazmën e Sofisë mbi varrin e Radalk San Heldikut; pa e përmendur orgazmën e Sofisë në tendën e Zatrës Arameje.

“Po si do të kthehem unë në Shqipëri të Albanikut sovjetik pa e marrë,sipas detyrës kooperativiste,motrën time në të panë? Të gjithë do të thonë se Kostantini i Haçet Deletës dezertoi nga ajo baladë. Se Kostantini e tradhtoi të motrën, atdheun, familjen, moralin... siç po ndodhë sot nëpër shumë vende të dyshimta” - e thumboi Kostantini ngulfatshëm Rabi Jochanan ben Sakain duke i rënë tradhtisë së tij ndaj Izraelit.

“Kthehu në Shqipërinë e Albanikut tënd sovjetik, me moralin e kamsomolasit sovjetik të arkipelagut gullag! Është udhëtimi yt i fundit nëpër atë baladën e masturbimit të Haçet Deletës së Ilirikut Albanik.

Haçet Deleta vullnetarisht ka hequr dorë nga kjo baladë. Ai është bërë kooperativisti më i mirë, punëtori shoqëroropolitik më i shquar në të gjithë Shqipërinë e Albanikut tënd sovjetik.

Je vonuar, miku im, je vonuar nëpër korridoret e dyshimta të baladës. Diversioni yt i sontëm eshtak në Jakovën e Jerusalemit është tepër i vonuar. Mefistoja u arratis nga teatri i Berlinit. Rabi Jochanan ben Sakai u arratis nga denimi i tribalit të Jerusalemit. Redalk san Heldiku ra në vorbullën e orgazmës. Indigjenia Iroki e Massachusettsit me orgazmën amerikane zbarkoi në Siçili.

U bë vonë për ty miku im. Ti miku im, e ke të pamundur të arratisesh nga Shqipëria e Albanikut tënd sovjetik. Merr ca vaj grasatimi, merr ca lecka të vjetra për bythën tënde thatanike e kthehu në Shqipërinë e Albanikut tënd sovjetik, në Shqipërinë

tënde Albanike skëterrë të tredhur!" - zvargshëm si nga larg i erdhi zëri i Rabi Jochanan bes Sakait.

"Ti, çifut i ndotur e ke tradhtuar atdheun tënd, Izraelin tënd. Tash ke gjetë t'i fusësh hundët edhe midis motrës e vëllait" - shpërtheu me të madhe i gjithë skeleti i Kostantinit të Haçet Deletës.

"Miku im, ti me atë fodullëkun e baladës sate shterpë prej kooperativisti, sonte e ke kaluar kufirin midis Shqipërisë së Albanikut tënd sovjetiks e Jakoves së Jerusalemit për ta mashtruar Sofinë. Ke bërë diversion nëpër tërthoret e dyshimta të asaj baladës sate kolhoziane, deri në Jakovën e Jerusalemit. Me sugjerimin e Rusisë së gjeneralit Ivan Vasiljeviç Kutazovit ke ardhë ta hjeksosh Sofinë. Ai gjenerali rus, tok me gjeneralin austriak, Herman von Urlihun janë katandisur sonte për ta zbuluar mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Ti, Konstantin i Haçet Deletës kooperativist, sonte, po arrite ta mashtrosh motrën tënde të çpifur në baladën kooperativiste, do t'ja dorëzosh mitrën e saj të veshtullt gjeneralit rus Ivan Vasiljeviq Kutozovit për një grusht lekësh të pshurrtë" - përbuzshëm i foli Rabi Jochanan ben Sachai.

"Ti, çifut i ndotur, tradhtar i atdheut tënd të mohuar, i jep vetës të drejtë të gjykosh mbi Bashkimin Sovjetik- atdheun e ardhshëm të të gjithë botës. Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, sonte po mendon ta shpëtojë Jakovën e Jerusalemit nga mishi i vetvetes së vet të tepruar. Ta shpëtojë nga të gjitha kutërbimet e mishit të prishur: nga urina, nga djersa, nga gjumi, nga ëndrra, nga orgazma… nga dashuria, nga të gjitha ndotjet çifute"- e zbuloi vetveten e vet eshtake Kostantini i Haçet Deletës së Albanikut sovjetik.

Provoi ta thërrasë Sofinë me emër e mbiemër me shtëpi e katandi, për ta shpëtuar të motrën e vet nga kanxhat e çifutit të ndotur- Rabi Jochanan ben Sakait.

Zëri i vetvetes së Sofisë shteroi. Nata e prillit të tetëmbëdhjetë u bë e thëllimtë edhe për eshtrat e Kostantinit të Haçet Deletës së Albanikut sovjetik.

Shiu i thëllimtë i Kremlinit zu të pikojë, çurg, nëpër të gjitha qilarët e Evropës.

60.

"Avioni nga Izraeli po na pret me të gjithë motorët e ndezur. Brenda një ore do të jemi në klinikën "Gemeli" të Romës" - përngutshëm i foli asaj Rabi Jochanan ben Sakai.

Sofia doli nga vetvetja e zërit të vet e lodhur, e molisur nga tundimi i baladës kooperativiste të socteatrit gulag të Tiranës. Kostantini i Haçet Deletës e aktroi dobët rolin e vet te diversantit edhe të vëllait.

Ajo iu drejtua Rabi Jochanan ben Sakait:

"Hirësi, Ju më thatë se diagnoza e nënës së Kostantinit "Sanguis lacertae in uturo", kurrsesi të lejojë të kem pasur vëlla ndokend ndonjëherë. Ai paskesh qenë vetëm në baladë kooperativistësh" - Sofia e zërit të vetvetes së vet ngulfatshëm iu drejtua Rabi Jochanan ben Sakait duke u orvatur të shpëtojë vetveten e vet nga Kostantini i Shqipërisë së Albanikut sovjetik.

“Jo zonjë!Ju nuk patët vëlla”-i tha Rabi

“Atëherë!”

“Atëherë ta lëmë diversionin e Kostandinit. Le të kthehemi kah diversioni tjetër.

Avioni ushtarak nga Stambolli e solli rektorin e Jakovës së Jerusalemit- Radalk san Heldikun, të ndarë në tri pjesë për secilën perandori. Secila pjesë e Radalk san Heldikut do t’i përkasë një perandorie. Kufomën prej eunuku do ta marrë Austria. Testiset dhe penisin, sipas marrëveshjes së fundit, do t’i ndajnë midis tyre Rusia dhe Turqia. Të tre gjeneralët:Ivan Vasiljeviq Kutozovi, Herman von Urlihu dhe Jyllmaz Kadir Ogllu kanë arritur në aeroport”- Rabi Jochanan ben Sakai eci nëpër zërin e vetvetes së Sofisë deri tek ajo.

“Tre gjeneralë të të tri perandorive e lakmuakan mishin e trellojshëm të Redalk san Heldikut!” -Sofia deshi të sillet si e habitur nëpër zërin e vetvetes së vet deri tek Rabi Jochanan ben Sakai.

“Të tri llojet e mishit të Redalk san Heldikut do t’i ndërsejnë drejt mitrës sate. E provuan me tundimin mbi varrin e Kostantinit të Haçet Deletës dhe mbi varrin e Redalk san Heldikut. E provuan me diversionin e Kostandinit koop-erativist. Tashmë do ta provojnë me të tri llojet e mishrave të Radalk san Heldikut të sjellë sonte nga Stambolli” - nëpër zërin e Sofisë sa mundej ngutej drejt saj Rabi Jochanan ben Sakai.

“Rabi i hirësuar! Përse të më kërkojnë me kaq ngulm?” - Zëri i vetvetes së Sofisë aktroi deri tek Rabi Jochanan ben Sakai.

“Pas dy orësh, në kuvendin e këshillit të lartë të NATO-s, ajo Indigjenia Pocahontas Powhatan, zonja e Shtatëmbëdhjetë minutave të Orgazmës amerikane, do të vendosë për mitrën e Jakovës së Jerusalemit. Gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi, i ka vetëm edhe dy orë për ta zbuluar mitrën Tuaj duke gërm-

uar nëpër mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit. Gjatë kësaj kohe, prej dy orësh, gjenerali rus mund të bëjë masakër nëpër mitrat e grave të këtij qyteti. Mitra e juaj, zonjë, duhet të shpëtojë gjithsesi. Duhet të shpëtojë qyteti."- zëri i Rabi Jochanan ben Sakait u bë para syve të Sofisë e cila u mat të pyesë për Indigjenen, Pocahontas Powhatanin, zonjën e Shtatëmbëdhjetë minutave të Orgaznmës amerikane".

"Ju, zonjë e nderuar, jeni në rrezik të zbuloheni nga mishi i Radalk san Heldikut të ndarë në tri copa, po aq sa jeni në rrezik të zbuloheni nga ai Kostandini kooperativist. Ky i fundit do t'ju dorëzonte tek gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi" - zëri i Rabi Jochanan ben Sakait u bë krejt afër Sofisë e cila e njohu më mirë se asnjëherë Rabin e shkretëtirës së Negevit.

Ai po bëhej dritë, pastaj u bë njeri me një shikim të përngutshëm në sytë mbushullues. I kishte thënë më parë fjalët apo i tha Sofia, kurrsesi t'i dallojë në përndezjen e Rabinit. Me siguri e paskesh mëtuar të flasë.

Nëpër zërin e tij arriti atje:

"Radalk san Heldiku - rektori i Universitetit të Jakovës së Jerusalemit mund t'ju zbulojë siç e zbuloi Zatren e Arameje midis të gjitha atyre bukurosheve në haremin e sulltanit. Ai u çjerr deri në kupë të qiellit kur njëra bukuroshe ia bëri me sy derisa kadina e sulltanit po i fliste për premtimin e vetë padishahut. Radalk san Heldiku do të pajisej me të gjitha mjetet për ta ndërtuar një xhami në Jakovën e Jerusalemit. Atëherë Rektori i universitetit të Jakovës së Jerusalemit u çjerr edhe më duke rënë në shikimin e Zatres Arameje:

"Do t'i jepja të gjitha xhamitë e botës vetëm për një penis sonte, vetëm për një parë testise!"- ngulmoi Rabi.

"Hirësi! Sonte m'u dashka të mëshehem nga të gjithë"- e zbuloi vetveten e vetë të hidhërimit Sofia.

"Ai Kostantini mund të ju zbulojë, të ju rrezikojë, të ju denoncojë tek gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutazovi. Radalk

San Heldiku i rënë në amokun e dëshpërimit, pas dy orgazmave në tendën e Zatres Arameje, mund të ju zbulojë tek të tre gjeneralët"- tashmë Rabi Jochanan ben Sakai u bë i tëri në shikimin e Sofisë.

Sofia e njohu Rabinin e shkretëtirës së Negevit. Shikimin e kishte tjetër, të përngutshëm, të mbushulluar drite urdhëruese. E kuptoi përngutësinë e çështjes. Sytë e ndezur të Rabis e nxitën Sofinë. Edhe njëherë Sofia ra në sytë e tij.

"Hirësi! Ç'do të bënin këta gjeneralë, këto perandori, sonte, me atë mitër?" - pyeti ajo sikur të mos e dinte.

Rabi Jochanan ben Sakai, pa e shuar shikimin e ndezur, e përflaku ajrin midis tyre. Sofia u nemit nën peshën e ajrit.

"Të gjithë gjeneralët, të gjitha perandoritë, sonte synojnë t'i hedhin solucionet e veta në mitrën tënde ekologjike të Jakovës së Jerusalemit. Në këtë mitër, sonte, do të testohet e tërë historia. Secili mund ta shohë, në shuplakë të dorës foshnjërinë e vet. Mitra e jote, zonjë, e ruajtur në diasporën biologjike të Jakovës së Jerusalemit , do të reagojë në mënyrën më të sofistikuar laboratorike për ta zbuluar evol-ucionin ekologjik, jashtë të gjitha kontaminimeve të historisë evropiane. Diaspora jote, zonjë e lartë,ka qenë mu në Jakovën e Jerusalemit pa pasur trysni të dilet jasht këtij qyteti. Populli yt për asnjë çast nuk është mashtruar me liri të rrejshme. U ruajt i mbyllur në gjendjen e parë ekologjike, i pakontaminuar nga civilizimet e rrejshme. Pa iu dhënë mundësia ta mburrë vetveten me ndonjë heroizëm fatal siç ndodhi në Shqipërinë e Albanikut sovjetik të Kostantinit i cili erdhi sonte të bëjë diversion në mitrën tënde, zonjë e lartë.

Austria e gjeneralit Herman von Urlih në vitin njëmijë e nëntëqind e dymbëdhjetë e mashtroi Shqipërinë e Albanikut sovjetik duke e shpallë të pavarur. Pastaj Austria e fantaksur u ngatërrua në vagjinën e vajzës së Aleksit atje në Sarajevë duke ia lënë në dorë Shqipërinë e Albanikut sovjetik gjeneralit Ivan

Vasiljeviq Kutozovit. Gjenerali rus e gjeti mitrën e Shqipërisë së Albanikut të zdërvajë në titërr të diellit, të pambrojtur nga askush. Për shtatë parë qejfe gjenerali Kutozov hodhi në mitrën e Shqipërisë së Albanikut sovjetik Sanguis lacertae in musculo dhe Sanguis lacertae in cerebro. Gjenerali kutozov në mitrën e Shqipërisë së Albanikut sovjetik e kultivoi përbindëshin ideologjik duke bërë vrasje gjenetike kolektive.

Zonjë e nderuar, vetëm në mitrën arketipe mund të nxirret rediment kaq i lartë përbindëshi, më i lartë se në të gjitha shtetet tjera socialiste të kontaminuara me qytetrime të rrejshme.

Zonjë e nderuar! Redalk san Heldiku pasi dëgjoi për hatanë e Tribalit të Jerusalemit zbriti në Galile e në Jude për t'u takua me mua. Ai erdhi të më pyesë në ka shpresë për mitrën arketipe të Jakovës së Jerusalemit. Pa kurrfarë hutese hyri në mitrën e Jakovës së jerusalemit atje tek tenda e Zatres Arameje.

Sonte, zonjë e lartë, Redalk san Heldiku po kthehet me avion ushtarak nga stambolli. Posa arriti në aeroportin e qytetit. Tre gjeneralë perandorishë kanë dalë ta presin. Secili prej tyre do ta marrë pjesën e vet nga mishi i Redalk san Heldikut. Atë e kanë ndarë në tri copa atje në stamboll. Rusia do ta marrë penisin, Austria do ta marrë trupin eunuk, e Turqia do t'i marrë testiset. Të gjitha këto pjesë mishi do të bëhen grackë për mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

Zonjë e lartë, po unë, Rabi Jochanan ben Sakai si do të kthehem në Izrael?

Mua, Rabi Jochanan ben Sakait, më është deshur të arratisem nga Jerusalemi, nga Izraeli, për ta shpëtuar Izraelin nga mburrja e mashtrimit.

Rabinët e mëdhenj, të fantaksur, mbrëmë në Tribalin e Madh vendosën të hyjnë në luftë me Romën imperiale. Zonjë e lartë, kjo luftë e pabarabartë për Romën do të ishte vetëm një zbavitje.Secili rabi që fliste mbrëmë në fund e citonte atë tje-

trin. Secili prej tyre e merrte shëmbull fitoren e Davidit mbi Goliatin. Një përrallë të rënë nga dynjallëku. Rabinët e fantaksur do ta turpëronin Jehovajn ndesh Jupiterit roman. Rabinët e Jerusalemit e mëtuan vetvrasjen e Izraelit. Unë i rashë moh këtij fataliteti.

Këta rabinë të fantaksur ia rregullojnë Romës levat diplomatike. Këta rabinë, pa i mëtuar askush, vetëm për fatalitet ja ngarkuan në qafë popullit të Izraelit mëkatin emblematik: "Hosana Baraba!" Roma imperiale e njeh mirë Barabën. Sa herë të ketë nevojë ta ndëshkojë Izraelin del Baraba dhe e ndezë luftën e humbësit. Të gjithë rabinët e Tribalit të Madh janë bërë Baraba.

Izraelit i duhen njerëz të strategjisë, të mendjes, të jetës. Vetëm me mbijetesë në diasporë Izraeli e arriti natën e sontme të orgazmës amerikane të Indigjenes Iroki Pocahontas të Massachussettsit"- Rabi Jochanan ben Sakai e gëlltiti për një çast hidhërimin e pleksur me të gjitha rrëmbimet duke rënë në shikimin e Sofisë.

Në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit ajri po bëhej i vapullimt nga zjarrmia e gjeneralëve. Perandorive zunë t'u merren mentë. Avioni i posardhur nga aeroporti i "Ben Gurionit" po merrte frymë ngulfatshëm.

Të gjithë po dilnin, të gjithë po hynin në histori, nëpërmes një mitre ekologjike.

Sofisë iu moren mëndët në shikimin e Rabi Jochanan ben Sakait duke e dëgjuar zvargshëm zërin e tij midis të gjithave.

"Nisu drejt avionit! Ti sonte do të jesh stjuardesa Ruta e Simonit nga Sidoni. Në avion mos provoni të më njihni as të flisni me mua. Me Rebekën e Alamekut mos komuniko as me shenja. Në avion është edhe Delegacioni i Tribalit të Madh të Izraelit. Aty është edhe Jakobi i urtë"- ra në zërin e vet Rabi Jochanan ben Sakai.

61.

Ministri, Spiridonis Zevsi, u çjerr sa i zuri për kreje derisa e çfryri dufin e mbledhur në gjoks. Dy të tjerë: Gryber Sontag dhe Lipman Smith heshtën për aq sa iu desht ministrit Spiridon Zevsit ta çfryjë dufin e helmët.

"Ato tri kurvat u arratisën në Romë. Ai pizevengu John Harkeri, e ka sjellë me vetë atë kryekurvën Indigjene- Pocahontas Powhatanin"-e gëlltiti helmin e vet ministri.

"Vërtet ajo Pocahontas Powhatani, Iroki e Massachusettsit, a mund ta urrejë aq shumë Evropën sa t'i hakmerret në këtë mënyrë?" - e ngacmoi ministrin Koloneli Gryber.

"Po, e urren bile edhe më shumë se ç'e marrim me mend. Qonquistadorët spanjollë ia trodhën të katër vëllezërit e saj në Sant Luis.

Ua zhvatën mishin mashkullor midis shalëve. Qonquistadorët e Sant Luisit ia sollën të jatit, princit Iroki-Powhatanit, mi-

shin e zhvatur mashkullor bashkë me bijtë e tij të shndërruar në eunukë.

Prijësi Indigjen Iroki- Powhatan, i vrarë fjalës u ngjit në malin Tikako tok me katër djemtë e vet eunukë. Ishte turp, ishte simoni gjenetike, të jetojnë në tendën indigjene bijtë e tij eunukë, të nxjerrur jashtë seksit Indigjen. Në tendën Iroki, gjallonte vetëm seksi i ripërtrirjes biologjike gati si mastur-bimi evropian.Pas shtatë ditësh heshtjeje Indigjene, prijësi Powhatan zbriti nga mali Tikako. Ishte zënë me të gjitha perënditë e malit. Shikimin e solli të përgjakshëm sikur perëndimi i diellit" – ra në vetveten e vet ministri Spiridonis Zevsi.

"Indigjenia Iroki Pocahontas Powhatan e paskesh parë zemërimin e perëndimit të diellit në shikimin e të jatit. E paskesh parë mishin e të vëllezërve, të nxjerrë jashtë seksit Indigjen. Urrejtja e saj kontinentale e shtyni deri tek sytë e Jezusit Indigjen.Ajo ra në shikim të Jezusit protestant. Ra mbi Bibël e qullur vegësh nga Orgazma"-i shtoi hidhërimit të ministrit koloneli Sontag Gryber.

"E paskesh qullur Biblën ajo Indigjene Iroki? Mirë! Po ku zë fill smundja e orgazmës? Ju po thoni se zë fill atje në tendën e asaj Zatres Arameje. Pastaj po thoni në tendën e Indigjenes Iroki.

Orgazma qenka pandemia më e rrezikshme në Evropë. Ajo po bëka ta njohë njeriu njeriun. Ta sfidojë pushtetin e perendive. Të gjithë Ju po e qullni Biblën kur thoni se filozofia greke na qenka filozofi përtace. Se filozofia greke qenka filozofi qonquistadore, e paaftë të krijojë. Se filozofia greke kryeneqsisht i paskesh rënë ndesh filozofisë latine, veçan asaj anglogjermane, për ta krijuar bizantizmin qonquistador. Por ti miku im gabon. Edhe njëmijëherë ta kishte tunduar Indigjenia Iroki Jezusin bizantin do ta kishte të kotë"- u zbraz ngadalë sarkastisht gjenerali Xhonaton Shelton sikur ta kishte zbuluar përtacinë greke të Platonit- Sokrat, po edhe të vet ministrit Spiridon Zevsit.

Ministri, Spiridon Zevsi e nuhati qëndrimin sarkastik të gjeneralit Shelton pa arritur të dalë nga faji i imagjinuar filozofik e religjioz i kombit të vet. U bë hera e parë ta ketë dëgjuar këtë damar të akuzës sarkastike për filozofinë dhe për religjionin grek.

Të dy i dolën dorësh për një çast. Në shikimet e tyre e pa akuzën për përtacinë greke.Jezusi i hajthëm, astmatik, me shikimin e tij ortodoks dhe Platoni hapaçel me atë gjoksin e gjërë, të venë mbi këmbët shkurtalaqe sikur e urdhëruan:

"Le të vritet Zatra Arameje! Ajo mund të përhapë pandemi prostitucioni nëpër tërë kontinentin. Ajo mund t'i mësojë gratë te pjellin nga mitra vagjinalisht.

Të pjellurit vagjinal nga mitra e gruas do t'i bindë njerëzit në atë barabarësinë e kobshme, në atë demokracinë anarkike të inisiativës së njerit të lirë amerikan. Orgazma amerikane e Indigjenes Iroki do t'i dëbojë filozofët, ushtarët dhe shtetasit e devotshëm. Sipas kësaj mëtese njerëzit, zotat, feja, shteti, tradita evropiane, të gjitha duhet t'i nënshtrohen pushtetit të pakufishëm të orgazmës,të dashurisë,të seksit.Të gjitha këto mbushullesa janë të rysura, asgjëkundi tjetër, veç në mitrën e gruas …në orgazmën, në dashurinë"- e ndezën ministrin Spiridon Zevsin.

Ai ndaloi për një çast sa të marrë frymë; sa për t'i shqyrtuar me shikim të pranishmit nëse qenë njëmendje me të. Heshtja e tendosur u kapërthye kontinentalisht nëpër fytyrat e të gjithëve, kund më shumë se tjetërkund, siç bëjnë hartat e vjetra gjeografike.

"Zotëri!" - iu drejtua koloneli Lipman Smith.- "A do t'i mjaftojnë Evropës kontinatale dy orë për t'u rënë ndesh këtyre prostitutave të Orgazmës, të Dashurisë, të Mitrës pjellake. Zotëri përse përpiqeni të mos e kuptoni se Evropa kontinentale qenka vonuar kaq tepër nëpër tërthoret e historisë së vet të

ngatërruar duke e shpënë veten sa t'i besojë sonte këtij eksperimenti tonë të dyshimt." - vazhdoi koloneli Smith.

Ishte aty hidhërimi? Apo Evropa kontinentale e mbushur blana të dyshimta nëpër lëkurën e vet gjegrafike, po i bënte lëshimet e para kundrejt prostitucionit të orgazmës, të dashurisë, të mitrës pjellake. Evropa e plogët po e lejonte vetasgjasimin.

"Zotëri Kolonel!" - iu drejtua bashkëbiseduesit të mbramë. - "Eksperimenti me eksponate gjenetike në laboratorin e OSCE-së, sonte doli i suksesshëm. Vaksina Sanguis lacertae, me të gjitha derivatet është e gatshme. Brenda një ore le të futet nëpër injeksionet njëpërdorimshe. Brenda tri ditësh e gjithë Evropa kontinentale le të bëhet e vaksinuar. Le të imunizohet njeriu nga pandemia e orgazmës, e Dashurisë, e pjelljes vagjinale të gruas"–u çjerr triumfalisht, sipas detyrës zyrtare ministri, Spiridonis Zevsi.

Ai u çjerr vetëm për ta ruajtur moralin e bashkëpunëtorëve të vet apo ky ishte urdhër?

"Atëherë le të hymë në laborator, zoëtrinj. Neve na duhet çdo gjë brenda dy orësh. Tri ditët e vaksinimit të zotit kryeministër janë aq larg sa fundi i botës"- propozoi urdhërueshëm gjenerali, Xhananatan Sheltoni.

Spiridon Zevsi, të cilit i ngutej më shumë se të tjerëve, i goditur nga dyshimi i Lipman Smithit, propozoi edhe njëherë të shihet saktësisht, eksperimenti nëpër të tri epruvetat-komore. Kthyen përngutshëm në repartin e permutacioneve laboratorike të gjeneve në qeniet e gjalla sipas teorisë së shpejtuar të kënetës së ngrohtë të Darvinit tek mbijeton gjeni i më të fortit.

Kryemjeku i inzhinieringut të gjeneve, Gryber Sontag, i kontrolloi të tri epruvetat, në të cilat ishte vënë eksponati i miushit të fortë gjenetekisht.

"Më në fund ka mbetur vetëm nga një kafshë në fund të secilës epruvetë. Të tjerat, ato më të dobëtat, e kanë dorëzuar vetveten" - konstatoi me entuziazëm Koloneli Gryber.

“Si e konsideroni ju, zoti kolonel? Mendoni se eksperimenti ka pasur sukses?”-pyeti gjenerali anglez Xhonaton Shelton.

“Unë mendoj se eksperimenti ka dhënë rediment të lartë” - me një krenari të ligjshme u përgjigj koloneli Gryber.

Në komorën qendrore të laboratorit të OSCE-së, tashmë, të gjithë:gjenerali anglez Xhonaton Shelton, Koloneli Lipman Smith, Koloneli Kloth Durante, ministri Spiridon Zevsi, e pranuan rezultatin.

Por ministrin Spiridonis po e gërryente dyshimi i mësheht pas fjalëve të kolonelit Smith. Pa e dhënë veten propozoi ta bëjnë provën e dytë.

Në provën e parë nuk e kishin shqyrtuar eksponantin biologjik të miushit shtetas.

Në epruvetën e tretë mbi të cilën shkruante:“miushi shtetas”, koloneli Gryber e futi dorën, të mbështjellë tri herë, deri në fund duke e lëshuar një miush viktimë.

Pritën paksa në heshtje derisa nga brenda epruvetës u dëgjuan cijama skërmitëse, shpirtdhënëse. Eksponati i miut shtetas, e kishte kollofitur miushin viktimë të llojit të vet. U konstatua se do t’i kollufiste të gjithë miushët e hedhur në fund të epruvetës.

“Ky miush i rishndërtuar gjenetikisht, do ta ruajë llojin e vet duke i ngrënë bastardët, të dobëtit, renegatët, të deform-uarit, tradhtarët e po të atij lloji. Gjaku i këtij miushi të rikonstruktuar gjenetikisht do të përdorët vaksinë tek qytetarët e shtetit evropian.

Eksperimenti i supremacionit gjenetik do të hyjë në përdorim të menjëhershëm. Qe sonte do të trajtohet si vaksinë” - u dha mbështetje koloneli Gryber.

Derisa të tjerët u përmbajtën, ministri i shëndetësisë, Spiridon Zevsi duartrokiti.

“Pas dy orësh në Kuvendin e Këshillit të lartë të NATO-s do t’ja tregojmë dhëmbët asaj kryekurvës Indigjenes- Pocahontas Powhatan, vëllezërit e së cikës i tarahitën koçet nëpër Bibël duke lypur mish misri, mish të bizoneshës e, seks të ndotur Indigjeneje. Ato dy kurvat evroçifute le të mësojnë se në mitrat e tyre do të kalbën edhe Rabi Jochanan ben Sakai edhe Redalk san Heldiku” - u përhumb në vetveten e vet ministri i shëndetësisë, Spiridon Zevsi.

Koloneli Gryber, i ngulfatur nga angështia e eksperimentit. Përngutshëm doli në oborrin e laboratorit. Mori frymë thellë. Avioni i posangritur nga aeroporti i Jakovës së Jerusalemit fluturoi ulët drejt Romës. Koloneli Gryber arriti ta lexojë në brinjën e majtë të avionit:“Izrael airways” të ndriçuar nga përflakja e Jakovës së Jerusalemit.

“Po i shpie ato për në klinikën “Gemeli” të Romës. Kushedi se ç’do të ndodhë me Radalk san Heldikun, me Sofinë e Haçet Deletës. A do t’i nxjerrë, sonte në klinikën “Gemeli” Pocahontas Powhatani nga mitra e gruas këta dy burra apo do të kalbën, përtej vagjinës, në ato mitra?

Mbetet të provohet kush do të fitojë sonte. A do të fitojnë: qumështi jashtëbiblik, orgazma, dashuria e inisiativës së lirë amerikane e Indigjenes Iroki të Massachusettsit apo do të fitojë gjaku i eksperimentuar i këtyre kafshëve të vogla në këtë laborator?

Sonte do të bëhen sfidat e tyre të mëdha. Kontinentit po i shkon koka vërdallë. Ka marramendje!” - ra në fund të vetvetes së vet koloneli Gryber.

Në oborrin e laboratorit dolën të gjithë shkencëtarët.

Më i relaksuari qe ministri i shëndetësisë Spiridonis Zevsi.

62.

"Ju, zonjë, i keni dalë zot kësaj pune"- i tha mjeku ushtarak Rebekes së Alamekut. -"Keni vendosur ta shpëtoni nga mitra e kones së Danielit këtë Rabi. "

Rebeka e Alamekut, e mbuluar me çarshaf të gjelbër, mbi poltronën lëvizëse, e ndjeu se po e shtynin drejt sallës së operacionit. Gjithandej nëpër korridorin e klinikës "Gemeli" zërat sa po vinin e po zvogëloheshin para saj. Pastaj ajo ra në heshtje. Ngrohtësia e veshtulltë ra mbi trupin e saj të djersitur duke ia ngjitur për trupi çarçafin e gjelbër.

"Vdekjet ndryshojnë nga njëra-tjetra"-i foli pa ia shpalosur çarçafin e lëpirë trupit të djersitur.

Rebeka e Alamekut e njohu zërin e tij pa qenë në gjendje ta bëjë më të voglen lëvizje brenda zjarrit ngashënjyes. Aroma e mashkullit pluskoi mbi trupin e saj të mbushur jetë.

“Deshe të më shpëtosh prej varrosjes së turpshme në mitrën e kones së Danielit. Sikur të kishe dështuar edhe ti si Rahilja e Sidonit atëherë Kneseti i Madh i Izraelit do të më kishte varrosur të gjallë në mitrën e kësaj koneje” - zëri i tij sa vinte e bëhej më i qashtër.

“Përse Rahilja e Sidonit të refuzoi kur ja lype mitrën e shpëtimit tënd?”- e pyeti Rebeka duke rënë në morfiumin e të lindurit cezaresk.

“Ishte gabim i mikut tim Jakobit të urtë. Ai gabimisht e kishte marrë Rahilen si të vetmen grua me mitër të gjallë në Izrael”- arsyetoi Rabi Jochanan ben Sakai duke e zbuluar vetveten e vetë në çastin e fundit.

Rebeka e Alamekut prej midis morfiumit, nga larg, mezi e pyeti Rabi Jochanan ben Sakain:

“Rabi, a të shpëtova pa u varrosur në mitrën e kones së Danielit? A e shpëtova Izraelin nga vetvetja e vet?”

“Po!Më shpëtove mua. E shpëtove Izraelin.

Konen e Danielit e kanë shpënë në sallën tjetër të operacionit. Pranë saj po qëndron Delegacioni i Tribalit të Madh të Izraelit. Delegacioni po pret ta nxjerrë nga mitra e kones së Danielit këlyshin e pestë në të cilin mendohet të jem varrosur unë, Rektori i dy universiteteve të Izraelit”- erdhi nëpër vetveten e zërit Rabi Jochanan ben Sakai.

“Hiqma çarçafin e lëpirë nëpër trupin tim të djersitur!”- e urdhëroi Rebeka nga ajo gjendja tjetër prej gruaje.

Rabi e ngriti çarçafin e lëpirë shtatit të Rebekes deri tek gjinjtë e mbufatur thimthash.

“Ngrite edhe paksa!” - e urdhëroi ajo nga bebëzat e syve të ikura përpjetë.

Rabi, me drithërimë shkundulluese shtatit, e ngriti çarçafin e gjelbër duke e zbuluar të tërën Rebeken e Alamekut. E gjithë hapësira u mbush me aromë gruaje. Ajri u lmek, u lëvar nën

peshën e vapullimit të gruas. Zemra e Rabinit mësyni t'i thejë brinjët, të dalë drejt mishit femëror. Rabi zbriti drejt mishit më të pastër femëror në fund të pubisit me firomë gati të ndalur nëpër gjoks. Tëmthat zunë t'i rrahin çekan i rëndë. E ndjeu nëpër lëbyrje sysh të terratisur se po zbriste atje.

"E pava gruan?!" - ishte zëri i vuvët.

"Është Ajo. Gruaja" - shpërtheu dikush nga zëri i vetvetes së Rabi Jochanan ben Sakait.

Atij iu zbrunë sytë mbi avullimin e mishit dehës të Rebekes.

Ajo sa shkonte e mbruhej buzëve, gjinjve, pubisit, klitorisit të kërcyer jetës. Vrullshëm e ndjeu gufimin e vetvetes. Zemra ngulmonte të dalë jashtë brinjëve halleliga. Testiset, penisi, iu mbufatën deri tek hapja e mishit të gruas-vagjinë.U bë krejt i të gjitha vetveteve të veta.E ndjeu të rëndë mbi vete peshën e rrobës fetare.Pa atë mendjen e rektorit zu t'i heq njënganjë.

Kënd?

Petkun- velandon, së pari, pastaj të tjerat, bashkë me lëkurën e mishit të vet.

"Sharro në mishin, midis vegëve të mia! Biri ndesh Tribalit të Madh të Izraelit! Shpëto nga dënimi poshtërues. Shpëtoje vetveten tënde të Izraelit!" u bë zëri i saj i zvargur nga qielli i orgazmës.

U plandos midis vegëve të Rebekes. U fut brenda saj nëpër të çarën e mishit të përzgjedhur femëror. U shua ajri. U shua drita. U shua firoma. Rabi u shndërrua në rrjedhë sperme rrugës së penisit të vet. U fut rrjedhshëm nëpër mishin e Rebekes. U bë vesë në lulen e mëngjesit të brerorët.

"Kjo është ajo orgazma" - erdhi nga të gjitha anët.

Nga larg, shumë larg, anës tjetër, i dëgjoi hapat e rëndë. Sikur ata hapa të rëndë të paskëshin sjellë hidhërimin e dikujt, të Tribalit të Madh, të Izraelit.

“Kot, krejt kot, të heqim mish nga kjo ngordhësirë. I shihni testiset. I ka shtrydhë deri në pikë ajo kurva e Galiles, Rebeka e Alamekut nga Abbi i Galiles

Këta mjekë, krejt kot, na sollën në kliniken “Gemeli” të Romës. Vetëm për të na mashtruar. Konsiliumi i mjekëve e hapi mitrën e kones së Danielit. Krejt kot ia shqetësuam këlyshin e saj të palindur”- foli Rabi ben Shalomë duke e ngritur nga dyshemeja lëkurën e fishkur, të bërë shuk, të Rabi Jochanan ben Sakait.

Aty pak më parë, në fillim të Shtatëmbëdhjetë minutavetë Orgazmës së Rabi Jochanan ben Sakait qenkesh shpëtuar kodi i hebrenjve.

“Na mashtroi ajo kurva Indigjene,Iroki, Pocahontas Powhatan e gjeneralit amerikan John Harkerit të Massachusset. Në sallën e katër operacionale të klinikës “Gemeli” e vendosi atë prostitutën hebreje nga Abbi i Galilesë. Nëpër orgazmën e saj vagjinale renegati i Izraelit, Rabi Jochanan ben Sakai, e zuri rrugën e diasporës. Ajo kurva Indigjene Iroki-Pocahontas Powhatani synon ta bëjë një Izrael vagjinal. Si do të dukej mbreti i Izraelit, gjenerali, prifti, të pjellë nga vagjina e përgjakur e një gruaje?” - u çjerr Rabi Shalom Kaifa.

Jakobi i urtë vetëm heshti, i relaksuar në atë aromë të mbetur prej gruaje. Në atë lëkurë të bërë shuk mezi e njohu fyt-yrën e mikut të vet, Rabi Jochanan ben Sakait. E gjithë fytyra e lekurës së shukosur ishte resur nga nuansat e shprehjes. Rabi Jochanan ben Sakai e kishte resur vetveten e vet. E paskesh përbiruar nëpër mishin femëror të Rebekes së Alamekut krejt vetveten e vet prej Rabini.

“Si mund të vdesë njeriu kaq shumë?!” - ra në vetveten e vet Jakobi i urtë- “Vdekja paskesh qenë kaq e keqe?! Vdekja paskesh qenë kaq e mirë?! Kjo vdekje paskesh arritur ta resë fytyrën e ngazëllimtë, të të gjitha vrulleve të shpirtit të Rabi Jochanan ben Sakait?!”

“E sheh se ky Rabi e ka braktisur lëkurën e vet, ashtu siç e braktisi Izraelin e të të gjithë neve! Ai, tashmë, nëpër vagjinën e Rebekës së Alamekut është arratisur jashtë Izraelit, në diasporë”- iu ngërdhesh Rabi Shalomë Kaifa relaksimit të Jakobit të urtë.

“Gjatë kohës sa paskemi qëndruar në Romë, Izraeli e paska humbur luftën!”- i dha kumt Jakobit të urtë Rabi Shalomë ben Kaifa i hidhërimit të vetvetes

“Po hirësi”

“Përse në të gjitha pergamenat heshtet kjo luftë kaq e madhe midis dy shtetesh perandorake?!”- u shastis Rabi Shalomë ben Kaifa.

“Ndodhi më keq se lufta hirësi” - u përpëlit Jakobi i urtë nëpër vetveten e vet të zërit.

“Cila mund të jetë më e keqe se lufta e humbur?!”- u nxeh Rabi Shalomë ben Kaifa.

“Më keq se lufta e humbur, hirësi, bëhet lufta e harruar, ende pafilluar” - u përpëlit sërish Jakobi i urtë.

“Si ndodhi të harrohet lufta e Izraelit kundër Romës?”- u shkrep në vetveten e vet Rabi Shalomë ben Kaifa.

“Gjatë kohës sa qenë njëripastjetrit, në tendën e gjeneralit roman: delegacioni i Tribalit të Madh të Jerusalemit, Rebeka e Alamekut, Rabi Jochanan ben Sakai e, në fund Sofia e Haçet Deletës, e lajmëruan gjeneralin Titi se mbi Jerusalem ka rënë shtjella e vrevët myslimane. Kjo shtjellë e mjegulltë, nga të gjitha anët, me buçimën e vuvët: “Allah!Allah!” mësyni në Jerusalem. Gjenerali roman heshti i nemitur, pa qenë në gjendje ta japë një urdhër. Qëndroi para tendës duke e vështruar shtjellën përbindësh. Vendosi ta njohë gatishmërinë e vetvetes së vet prej gjenerali kundruall frikës së mistershme. Duhej sulmuar Jerusalemin para se ta ngërthejë shtjella e vrevët buçiste: “Allah! Allah!”

Ushtria romane u sul drejt Jerusalemit. Pas ushtrisë ra në amokun e sulmit edhe vetë gjenerali, Titi. Shkumbuan kuajt, ushtarët, oficerët. Kurrkund të ndeshen me muret e Jerusalemit. Të gjithë ranë në amokun e sulmit. Gjenerali, Titi, qëndroi terë kohën në shpinën e kalit, i përgjumur, midis frikës dhe etjes për lavdi.

As zog as korb nga Roma derisa gjenerali Titi ndaloi para qytetit të përflakur.

"Ushtria romane e paska djegur Jerusalemin!"- u habit gëzueshëm gjenerali, derisa Rabi Jochanan ben Sakai po edhe Rebeka e Alamekut ia shpjeguan se gjendej para mureve të Jakovës së Jerusalemit.Sepse kështu ngulmoi gjenerali rus,Ivan Vasiljeviq Kutozovi.

Të gjitha pergamenat e heshtën këtë ngatërrim luftrash, gjeneralësh, qytetesh"- zëri i vetvetes së vet Jakobit të urtë po zvargej larg klinikës "Gemeli" nëpër aromën e vetvetes së vet, të Romës, të gruas.

"Zonjë e nderuar, ju jeni shtatzënë"- i tha Sofisë së Haçet Deletës kur e takoi në korridorin e Klinikës "Gemeli".

"Po Zotëri" - e njohu Jakobin e urtë Sofia.

"Ju, zonjë e nderuar, e pranuat edhe para gjeneralit roman se jeni shtatzënë" - e tundoi Jakobi i urtë.

"Po Zotëri"

"Atëherë cili do të jetë babai i fëmijës suaj?" - e provokoi Jakobi i urtë.

"Rabi Jochanan ben Sakai më tha se babai i fëmijës sim do të jetë rektori i Jakovës së Jerusalemit- Redalk san Heldiku. Hirësia e tij ma tha këtë para se të hyja në tendën e Zatres Arameje"- u përvodh në vetveten e vet të zërit Sofia.

"Ju jeni grua e martuar, zonjë?

"Po, hirësi"

“Pergamenat janë ngatërruar qëllimisht nga gjenerali austriak, Herman von Urlih. Sikur ju, zonjë e nderuar, të keni mbetur shtatzënë me Rainhard von Grainhelmin e Tretë-Trashëgimtarin e ligjshëm të Fronit mbretëror të Bohemisë?”-pyeti Jakobi i urtë.

“Hirësi, a mendoni ju se kam mbetur shtatzënë me njeri pa …?” - ngurroi ta thotë të tërën Sofia.

“Zonjë e nderuar, gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi, aspak t’i besojë pergamenës së ngatërruar të gjeneralit austriak, Herman von Urlihut. Ai gjeneral rus, në mënyrë të tërthortë i ka bërë ultimatum Turqisë për t’i sjellë sonte, të tri llojet e mishrave të Redalk san Heldikut nga Stambolli në Jakovën e Jerusalemit.

Sofia e Haçet Deletës heshti tepër kuptueshëm në vend të përgjigjes. Më mbarë e patë të pushojë në vetveten e heshtjes së vet. Ajo u bë e turpshme nga shpjegimi i Jakobit të urtë. Sqima e saj prej gruaje vuri dorë në kureshtjen e saj.

Jakobi i urtë, kollajshëm, në korridorin e Klinikës “Gameli” as t’i përfillë rregullat e mirësjelljes siç e donte bashkëbiseduesja e tij finoke. Ia shpjegoi Sofisë me një zë të ngadaltë plot ndalesa për t’i zgjedhur fjalët ose për të bërë aludime të mirësjellshme.Arriti t’ia shpjegojë asaj se gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi bëri trysni tek Turqia t’ia sjellin sonte, pikërisht sonte, me avion ushtarak testiset e shkoqura mishit të Radalk san Heldikut. Përngutshëm duhej bërë shqyrtimi i testiseve të San Heldikut nëse e gjithë sperma nga to kishte rrjedhë në mitrën e asaj gruaje tek tenda e Zatres Arameje.

“Hirësi! Përse sonte, kaq përngutshëm e gjithë kjo katrahurë evropiane në Jakovën e Jerusalemit, të gjitha këto mishra, sperma, sekse, skelete, orgazma, klitorisa, testise e, më në fund ajo - Dashuria?”- shpërtheu përtej vetvetes se vet të zërit Sofia e rrëmbyer jashtë natyrës së vet.

“Zonjë e nderuar, mbase ju edhe mund ta dini. Rruga më çon t’ua shpjegoj paksa. Pas dy orësh, vetëm pas dy orësh, sipas dhimbjes së thellë të Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatanit të gjeneralit amerikan, John Harkerit, në Tubimin e Këshillit të Lartë të gjeneralëve të NATO-s. ajo Indigjene do ta shpallë se perënditë e lazdruara evropiane, tekanjoze, do të bëhen perendi vagjinale nëpër spermë, seks, klitorit, penetrim, testise, orgazmë, e në fund, deri tek Dashuria.

Dashuria e Indigjenes Iroki-Pocahontas Powhatanit të gjeneralit amerikan, John Harkerit të Massachusettsit mëton të bëhet providenca e vlerës demokratike të Iniciativës së lirë të njeriut të përbotshëm.

Dashuria e Indigjenes Iroki mëton të bëhet vrujim i përjetimit të vetvetes së të gjithëve dhe përjetim njerëzor i të gjithëve të vetvetes.

Para klitorisit të vetvetes së Zatres Arameje, asaj instruktores së shkollës së orgazmës, kur lajthiza arketipe e mishit mashkullor të burrave trazovaçë, tekanjozë, mbufatet në penis, të gjithë u bënë të ndrojtur: Zeusi, Mojsiu, Davidi, Jezusi, Cezari… të gjithë”- ra në pëshpërimën e vet të ndrojtur Jakobi i urtë.

Derisa Jakobi i urtë po i pëshpëritte asaj, Sofia u bë rrëshirë në degën e pishës, nga piku në gjoksin përvëlues të Redalk san Heldikut atje tek tenda e Zatres Arameje. U ndezen mishrat. U shkri në gjoksin e tij, teposhtë kah penisi i bërë hell i mishit mashkullor, përtej qiellit të orgazmës, deri tek dashuria.

Jakobi i urtë e pikasi amokun e rrëmbimit të Sofisë nëpër orgazmën e Redalk san Heldikut.

“Zonjë e nderuar, ju tashmë e keni kuptuar, mbase, se duhet ta braktisin atë Redalk san Heldikun. Atë, në Stamboll, e bënë eunuk, e bënë deledash, e tredhen”- deshi ta sjellë në vetveten e saj Jakobi i urtë.

Sofia e vetvetes së vet mezi arriti deri tek Jakobi i urtë.

“Hirësi! A i sollën turqit të gjitha pjesët e mishit të Redalk san Heldikut në Jakovën e Jerusalemit tek ai gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi?”- kërcei nga zëri i vet Sofia.

“Po zonjë, po! Ia sollën të tri mishrat e Redalk san Heldikut”

“I çeli ato mishra gjenerali rus?”

“Gjeneralit rus i takoi vetem penisi”

“A gjet spermë në testiset e tij?”

“Jo Zonjë, as një pikë të pikës”

Sofia e ndjeu vaktësi në fund të barkut.

Ishte shtatzënë.

“U bë”- i tha Jakobi i urtë duke ia treguar lëkurën e bërë shuk të Rabi Jochanan ben Sakait pranë atamanit të Rebekes së Alamekut.- “Ai Rabi, tashmë, nëpër mitrën e Rebekes kaloi në diasporë, atje në Berlin. Të gjithët e secilit po edhe secili i të gjithëve do ta heqin lëkurën e vet nëpër rrugët e orgazmës, të Dashurisë” - u zvarg zëri i Jakobit të urtë sikur po gatitej të nisej pas Rabi Jochanan ben Sakait.

Jakobit të urtë iu bë, apo Sofia e mëtoi për udhëtimin e dytë kah diaspora, mbase andej kah Berlini.

“Zonjë e nderuar, mos u ngut gjëkundi. Shtatëmbëdhjetë minutat e Jakovës së Jerusalemit do t’i kaloni në klinikën “Gemeli” nën përkujdesjen e Indigjenes Iroki të gjeneralit amerikan,John Harkerit të Massachusettsit” - i foli Jakobi i urtë, këtë herë, mbase nga Berlini.

63.

"Po e lypni Shkollën e çifutëve?" - e pyeti taksisti.

"Po, Zotëri" - u përgjigj Jakobi i urtë.

"Është paksa larg nga këtu, zotëri"- i tha djallëzisht taksisti. -"Po e shoh zotëri se pasket udhëtuar nga larg.Hyni në makinë!"

Jakobi i urtë iu resht bisedës me taksistin fjalaman. Udhëtimi dukej se do të zgjasë paksa më gjatë. Rrugët vinin duke u bërë më të ngushta midis shtëpive të stivuara, të strukura, pranë njëratjetrës. E ndjeu brenda makinës kutërbimin e oborreve.

"Eshtë lagje ardhacakësh"- a pikasi mendimin me shkathtësinë e taksistit të sprovuar.- "Janë të ardhur nga vise të ndry-

shme. E kanë sjellë me vete atë ndrojtjen e fshatit, atë egoizmin e pronës" - vazhdoi taksisti.

Ecën edhe dy kthesa pa e çelë gojën Jakobi i urtë.

Me një zë gati konspirativ taksisti i foli Jakobit të urtë:

"Zotëri, nga këtu deri tek shkolla Hebreje keni vetëm tri minuta të ecni këmbë"- i tha duke e ndalë makinën.

"Ju, zotëri, po më braktisni këtu?"- Jakobi i urtë e pyeti ankueshëm taksistin.

"Vetëm tri minuta, zotëri, i keni deri tek Shkolla Çifute, hiç më tepër"- insistoi taksisti për ta hequr qafe sa më parë.

-"Vetëm tri minuta, zotëri" - ia përsëriti edhe njëherë në vend të përshëndetjes së përngutshme.

Jakobi i urtë e mori rrugën e ngushtë, i përshëndetur nga një këlysh përtej gardhit të një oborri. E shikoi këlyshin me një vëmendje të zgjuar atypëraty.

"I këso moshe do të ishte Këlyshi i Kones së Danielit sikur miku im Rabi Jochanan ben Sakai të mos ishte arratisur nga Jerusalemi në mitrën e Rebekes së Alamekut"- u rrokullis në vetveten e vet Jakobi i urtë.

"Këlyshi ia nguli sytë udhëtarit. Jakobi e nuhati miqësinë e këtij këlyeshi. U mallëngjye për mikun e vet Rabi Jochanan ben Sakain.

"Si do të kisha arritur ta godas në kokë këtë këlysh me këtë shikim kaq të qashtër. Aq më tepër kur në mishin e tij të kishte qenë miku im Rabi. Mirë ka bërë miku im. Tash po e shoh sa vështirë paskesh qenë ta vrasësh, me një goditje në kokë këtë këlysh, siç më patë porositur në fillim miku im, Rabi. Për jetë të jetës paska pasë qenë duke mbetur në mishin e këtij këlyshi ai miku im, Rabi, sikur të mos e kishte shpëtuar Rebeka e Alamekut.

Me më fal miku im për dobësinë time!" - iu përgjërua Rabi Jochanan ben Sakait.

Këlyshi dhe Jakobi i urtë po e shqyrtonin njëri-tjetrin.

“Mos, mund të jetë ndonjë hebre tjetër në këtë këlysh? Ndonjë hebre i dënuar për ndonjë tradhti tjetër?”-u katandis Jakobi i urtë.

“Mos po e lyp gjëkundi ndonjë njeri?”-ia këputi, aspak miqësisht, një zë i çakërdisur fshatari nga oborri.

Jakobi i urtë e pa se shikimi i qashtër i këlyshit, posa foli i zoti, u ndryshua në shikim prej qeni.

“Vetëm ndalova paksa për ta pyetur ndokënd për shkollën hebreje” - ndrojtshëm foli Jakobi i urtë.

Fshatari mërmëriti diç, me këlyshin apo me Jakobin e urtë. Ec e dije. Pasi e qëroi paksa zërin iu drejtua Jakobit me një përzierje fshatare:

“A mos je edhe ti çifut?” - zëri u bë maskara.

Jakobi e pa qartë se duhej shmangur këtij të ndërkyeri. U ngut andej kah i kishte thënë taksisti.Mbrapa vetes e dëgjoi zërin e ngjirur të fshatarit:

“Të gjithë çifutët duhet zhdukur nga faqja e dheut”- ia përplasi përmbrapa mallkimin.

Jakobi i urtë e shpejtoi hapin duke i ngrënë shpina hekur edhe pse e ndjente se ai fshatari kishte mbetur në oborrin e vet.

Eci rrugës së ngushtë. Kur u largua aq sa e mori se shpëtoi e ngadalsoi hapin. Dikush e preku lehtas në këmbë. Ndaloi i trembur. Ishte këlyshi. Jakobi i urtë deshi ta qortojë. Frika dhe mëshira e kapërthyen midis tyre. Këlyshi me mjeshtërinë prej qeni e pushtoi Jakobin e urtë. Ata të dy, si me marrëveshje, u nisen drejtë shkollës hebreje. Dhe patën të drejtë. Përpara u doli një tabelë e varfër, gati e mëshehur prej vetvetes së vet; e venë qëllimisht për të mos rënë në sy. Jakobi u kthye drejt këlyshit. Qëndruan ballëpërballë njëri-tjetrit. Jakobin e urtë e mërtisi shikimi i vendosur i këlyshit aq sa hoq dorë nga ç’e pati ndërmend. E shtyri derën e rrethojës. Këlyshi hyri para tij në oborr. Hoq dorë nga kryeneçësia e kafshës së vocërr. I ra ziles.

Të dy pritën para derës derisa u hap një zavrak i ndërliqur me rrjetë hekuri. Një fytyrë bullafiqe, gjysmëfëmijë, gjysmëdjalë, foli prituesshëm, pa e zbuluar shikimin.

"Kënd e lypni zotëri?"- deshi ta mbyllë kanatën ende pa e marrë përgjigjen.

Jakobi i urtë e kuptoi qëllimin e tij. Para se ajo fytyrë mishtake ta zbatojë qëllimin e vet përtac Jakobi i urtë me një zë, të shkaktuar, autoritar, i foli paq: "Drejtori i Shkollës, Rabi Jochanan ben Sakai, ka ndarë takim për sot në këtë orë, me Jakobin e urtë- prorektorin e dy universiteteve të Izraelit"- e zgjati diskursin për ta zbutur atë mish fytyre, në sytë e së cilës ra një tisore frike e përzier. Jakobi ia zgjati edhe kartëvizitën për Drejtorin e Shkollës Çifute.

Fytyra hutaqe, e fajësuar, u zhduk nga kanata. Jakobi e rrëzoi shikimin para këmbëve. Aty ishte edhe këlyshi. Në sytë e tij e pa mosdurimin, ngulmin për të hyrë brenda Shkollës Hebreje.

Të dy e ndjenë se dikush nga brenda po i qasej derës.

Në kanatën e derës masive, përtej nderliqes, u shfaq vetë ai - Rabi Jochanan ben Sakai. Jakobi i urtë u tremb. Të dy miqtë i kryqëzuan shikimet nëpër nderliqen e hekurt. Rabi iu bë më i hequr në fytyrë, më i hajthem, me një hijesim gri nëpër flokë. Sytë i breronin sikur më parë. U shikuan për një çast nga të dyja anët e derës.

Para se të merreshin ngryk midis tyre u gjet, i krekosur, këlyshi. Rabi e shikoi pyeteshëm Jakobin e urtë. U morën ngryk ende pa e folur asnjë fjalë. Të tre e zunë rrugën e shkallëve pasi Rabi Jochanan ben Sakai ia vuri shulin derës nga të dy anët e murit.

"E paske sjellë me vete pengun e Tribalit të Madh të Jerusalemit?" - çeli kuvend Rabi duke i rënë bisedës për këlyshin.

Jakobi i urtë mendoi se u bë peng i rastisjes. Këlyshi iu shtir nga një oborr i fshatarit të panjohur.

“Miku im”-Rabini iu drejtua Jakobit të urtë.- “Ju e keni njohur Danielin pronarin e Kones në fshatit Abbi?”

“Po e kam njohur”-sikur rrëshqiti vetvetja e Jakobit nëpër zërin e vet.

“A t’u ngja në Danielin e fshatit Abbi ai burri i frikshëm nga oborri i shtëpisë kur u hutove pas këtij këlyshi? Mbase jo krejtësisht por Ju pyetët për Shkollën Hebreje-i tha Rabi.

“Jo, kurrsesi të përngjajë në Danielin e fshatit Abbi të Galiles. Ky qe vetëm një fshatar i fodullët, kurrsesi t’i përngjajë Danielit të mençur”- Jakobi i urtë u katandis t’ia shpjegojë kundërshtimin e vet.

“Pikërisht për Danielin e Abbit të Galiles e kam fjalën, o miku im.” - u rrek pas fjalëve të veta Rabi.

“Si mund të shndërrohet aq shumë njeriu?” - u serit Jakobi i urtë gati për të shkalluar.

“Miku im, Tribali i Madh i Izraelit e bëri atë punë” - ankoi Rabi.

“Ç’faj bëri Danieli për ta dënuar kaq rëndë?!”- vazhdoi Jakobi i urtë duke e kuptuar ku rreh kuvendi.

“Pasi Zatra Arameje ia zbuloi Rebekes së Alamekut: seksin, klitorisin, orgazmën, mitrën, Danieli e takoi fqinjën e vet. Ai i tregoi Rebekes se Tribali i Madh i Jerusalemit e paskesh zgjedhur Konen e tij për varr të Rabi Jochanan ben Sakait.

Rebeka e Alamekut, pasi vendosi ta flijojë Mitrën e vet për ta shpëtuar Rabi Jochanan ben Sakain, për ta shpëtuar Kodin e vetvetes së vet të Izraelit e mëtoi Danielin ta shpie deri tek ajo koneja e përzgjedhur ku do të ngjizej gjaku i qenit dhe gjaku i njeriut. Danieli, me degjueshmëri të përkortë, e shpuri Rebeken tek stela e kones.

Ato të dyja: kudra dhe gruaja i kapërthyen shikimet. Koneja e Danielit me sy të ujsavtë, siç merren vesh dy gra midis tyre, iu përgjërua Rebekes:

“Po të përbejë: në seks, në klitoris, në orgazëm, në Dashuri, të mos e lejosh përzierjen e gjakut të njeriut me gjakun e qenit, me gjakun e këlyshit tim të pestë!”

Rebeka e Alamekut e ndjeu në mishin e vet përgjërimin e Kones së Danielit me malcimin e nënës së pabërë ende. Koneja e Danielit, me skapitje uguruese, me të shtie gjallë në dhe, u çjerr përgjërushëm para Rebekes. Femëra e kuptoi zemrën e femëres. Gjaku i njeriut e kuptoi gjakun e qenit” - Rabi ra në përgjëratën e të dy femrave me kode të ndryshme.

Jakobi i urtë, nëpër mugëtirën e pergamenave të dyshimta, u katandis ta kullojë mendimin e vet, pa i thënë asgjë Rabis.

“Danieli i Abbit të Galiles u dënua nga Kneseti i Madh i Izraelit vetëm pse e kurdisi takimin midis Rebekes së Alamakut dhe kones së vet”- e nxori shkakun e dënimit Rabi.

“Hirësi! Atëherë përse të tarashkatet koneja e Danielit deri në Klinikën “Gemeli” të Romës kur Tribali i Madh i Izraelit e dinte marrëveshjen e Rebekes me konen e këlyshit të pestë?” - u ngatërrua në fund të pergamenave Jakobi i urtë.

“Miku im”- iu drejtua me shikimin vezullues Jakobit të urtë. - “Roma, pas tridhjetë vjetësh të vrasjes së Jesusit, e bëri hjeksinë e dytë. Gjenerali roman Titi,me miratimin e Romës,në tendën e vet ma miratoi kërkesën për themelimin e Universitetit Hebre në Diasporë.Dhe mirë u bë. Por unë e kuptoj hilen e Romës në këtë çështje.

Pas pesëmbëdhjetë minutave, po në atë tendë, po nga gjenerali Titi, me miratimin e Romës u aprovua edhe kërkesa e Tribalit të Madh të Jerusalemit: të varroset në mishin e këlyshit të pestë Rabi Jochanan ben Sakai”-foli Rabini i zërit të vetvetes së vet.

“Për cilën mostër të Izraelit qe Roma?”-gati u shastis Jakobi i urtë.

“Roma, Euroroma, atëherë edhe sot mbeti për:“Hosana Baraba!” - u rrokullis Rabi Jochanan ben Sakai bashkë me hidhëri-

min në fund të vetvetes së vet.

Jakobi i urtë u ngatërrua sërish nëpër pergamenat e mugëta. Diku shkruante se Danieli u sëmur. Në të tjerat shkruante se konen e hapën barkut në Klinikën "Gemeli" pa arritur ta zbulojnë Rabin në këlyshin e pestë. Diku shkruan se Rabi Jochanan ben Sakain e paskeshin parë në Evrogjermani. Katrahurë pergamenash.

Deshi t'i shmanget çështjes së Rebekes. Ende lektiste ta ruajë mikun e vet, Rabin. Në atë katrahurë pergamenash kishte lexuar se Danieli i Abbit të Galiles, në shikimet shemrake të Rebekes dhe kones së vet u ngjall mishit mashkullor. Lajthiza midis shalësh po i mugullonte në penis. Rebeka, pasi e nuhati rrezikun e zgjimit të Danielit, e zbuti shikimin tek sytë përgjërues të Kones.

Rebeka e lexoi në sytë e Kones së Danielit:

"Mbuloje me seksin tënd, me Mitrën tënde, Rabi Jochanan ben Sakain! Shpëtoje Këlyshin tim nga gjaku dhe mishi i njeriut!"

Jakobi i urtë e mëshehu vetveten e mendimit nga Rabi.

Mbase Danieli, i zgjuar mishit mashkullor, mund të ketë paraqitur rrezik për konen e vet pasi Rebeka e Alamekut e pranoi përgjërimin e saj për t'ia blatuar Rabi Jochanan ben Sakait: seksin, orgazmën, Dashurinë, brenda Mitrës së Njeriut.

"Danieli u bë rrezik për Konen e vet meqë e pranoi fajin para Tribalit të Madh të Izraelit. Ai e pranoi se e kishte bërë godën midis Rebekes dhe Kones së vet. Pasi Tribali i Madh i Izraelit e vaksinoi Danielin me sekretimin kundër bulëzimit të penisit ia caktoi për detyrë ta spiunojë Shkollën Hebreje në Diasporë"- vazhdoi Rabi Jochanan ben Sakai.

Në vend të shumë pyetjepërgjigjeve Jakobi i urtë vetëm sa arriti t'i thotë mikut të vet:

"Ta kam sjellë lëkurën tënde të fishkur, të braktisur apo të harruar në Klinikën "Gemeli"

Rabi vetëm e tundi kokën aprovueshëm sikur i tha Jakobit të urtë:

"E kam pritur, miku im, këtë veprim tëndin"

Jakobi i urtë, tashmë e kuptoi dëshpërimin e Rabinit.

"Loja qenka kurdisur pikëpërpikë.Rabi e paska pritur vizitën time në Shkollën Hebreje të Berlinit"-Jakobi ra në vetveten e vet të fundit.

U katandis ta shohë në sytë e Rabis përbuzjen për lojën e vetvetes së vet Jakobit të urtë. Në vend të dëshpërimit në sytë e mikut të vet, Rabi Jochanan ben Sakait, e pa dhembshurinë me shumë se për një njeri, më shumë se për shumë njerëz, më shumë se për një popull të tërë, më shumë se për tërë Izraelin.

"Mos unë, në ketë çast e paskam denoncuar mikun tim Rabi?"- u pështjellua në vetveten e vet të fundit Jakobi i urtë.

"Miku im!"- iu drejtua Rabi sikur ta paskesh lexuar mendimin e Jakobit të urtë.- "Këtë punë tënden ka qenë dashur ta bëjë dikush tjetër. Më e pamëshirshmja në ketë lojë të beri hisedar ty, miku im, të ma sjellësh lëkurën time të braktisur në klinikën "Gemeli" të Romës. Për herë të dytë po më sjell këso kumti. Herën e parë ma solle kumtin për vendimin e Tribalit të Madh të Izraelit"- u rrit dhembshuria në sytë e Rabinit për Jakobin e urtë, më shumë se për një njeri.

"Unë të paskam denoncuar, miku im? Unë e paskam denoncuar Shkollën Hebreje në Diasporë?"-ankoi Jakobi i urtë.

"Po, miku im, Ju e keni deneoncuar sipas Harresës Hebreje. Edhe këtu çon krye hera e dytë. Posa e braktisa unë tendën e gjeneralit Roman, Titi, ja çatise ti, miku im me Delegacionin e Tribalit të Madh të Izraelit.Gjenerali roman,Titi, edhe delegacionit Tuaj të Tribalit të madh të Izraelit, krejt sikur mua, ia dha të njëjtin miratim, të njëjtën rrugë, të njëjtin avion për në Romë"- Rabi Jochanan ben Sakai u bë pranë mikut të vet, Jakobit të urtë, me qortimin më shumë se për një njeri.

“Pas dy orësh, tek tenda e gjeneralit roman, Titi, u shtir një shtjellë e mistershme. Sikur e brevët u lëpi shkretëtirës me një uri gllabëruese. Shkurret, rrugët, toka, u shkarrëzuan në zguhurin e vuvët të Shtjellës së çatisur nga shkretëtira. Buçima e vuvët myslimane nga zemra e shkretëtirës “Allah!Allah!” e stepi në vend gjeneralin roman, Titi. Iu bë se vetvetja e vet gjeneralit e paskesh lajmëruar Romën dhe se nga andej paskesh ardhë urdhri:

“Në vend se nesër në mëngjes, le të sulmohet sonte, menjëherë, Jerusalemi!Hyr atje në Jerusalem, para se të hyjë ajo shtjellë brevët turkoarabe!”- sikur paskesh thënë urdhri i çatisur nga Roma.

“As zog as korb nga Roma”- paskesh thënë dikush përtej amokut të gjeneralit roman, Titi.

Ushtarët romanë, të kapërthyer nga afshi i lavdisë, u lëshuan pingul drejt mureve të Jerusalemit. Kuajt, tërfatshëm, ushtarët të ndezur, e shkyen natën e Jerusalemit. Askujt t’i shkojë ndërmend sa kohë paskeshin vrapuar drejt qytetit edhe kur kuajve u krisën gjokset nga currilat vrushkullorë të gjakut. Askund të shfaqej para tyre qyteti i Jerusalemit, askund. As zog as korb nga Jerusalemi.

Kuajt, të çarë gjoksash, zunë të mbesin nëpër shkretëtirë. U bënë më shumë ushtarë këmbësorë se kalorës. U harxhua shumë natë, më shumë se ç’i duhet një udhëtari, shumë udhëtarëve, krejt Izraelit, për t’i arritur muret e Jerusalemit.

Sa herë, gjenerali roman, Titi e kishte matur këtë rrugë me këmbë e me mendje. Sonte, megjithëkëtë vrull epshor të lavdisë, kurkund ta gjejë Jerusalemin. Çetat, eshalonët, skuadrat, tok me gjeneralin roman, Titi, ranë në amokun e harresës. Ranë në zymtinë diplomatike të pergamenave. Shteruan urdhrat e Romës. U zvargën, gjithnjë e më larg buçimat e zikrit “Allah! Allah!” derisa pushuan krejtësisht. U ngri ushtima e gjakut në vesh.

Sulmi epsharak drejt Jerusalemit u shndërrua në udhëtim nëpër harresën Hebreje derisa gjenerali Titi e kapërceu lumin e cemtë. Mendja vërdallë i erdhi, ashtu e huqur.

Gjenerali Titi nga ana tjetër e lumit Erenik, nga fusha e tendave të veta i pa shkulmet e flakës së qytetit.

Qyteti po digjet"-Rabi Jochanan ben Sakai i kishte folë Jakobit të urtë më shumë se një njeri, më shumë se disa njerëz, më shumë se shumë njerëz, më shumë se vetë Izraeli.

"E paskan kallë qytetin e Jerusalemit. Ushtria e Romës fitoret i bën me lavdinë perandorake"–gjenerali Titi iu gëzua vetvetes së vet.

Ngadhnjimisht vendosi ta presë mëngjesin.

E dërgoi përtej lumit Erenik togun e vëzhgimit. I zgjodh më të shkathtët, më të mençurit, njohësit e shumë gjuhëve.

Priti para tendës derisa u kthyen vëzhguesit. Ata i sollën edhe fjalë edhe pergamene të shkruara në shumë gjuhë, në shumë alfabete. Fjalët dhe shkronjat shkonin drejtimesh të ndryshme nëpër pergamena: prej të djathtës kah e majta, prej të majtës kah e djathta. Kishte edhe përpjekje në këto pergamena të rrugëtohej edhe nga lartë-poshtë.

U bënë shumë fjalë, u bënë shumë pergamena. Nga të gjitha, gjeneralit Titit i ra në kokën e vërdalltë:

"Gjeneral i nderuar! Komandanti i Krahut Lindor të ushtrisë perandorake të Romës! Vrulli Juaj, i ushtrisë Tuaj, drejt Jerusalemit qe sa i fuqishëm, aq edhe kobçar. Me një vrull të beftë kontinental i kapërcyet tri perandori pa i hetuar fare. Gjeneral! I kapërcyet pa i hetuar: perandorinë e Bizantit, perandorinë e Turqisë e më në fund, perandorinë e Rusisë. Para jush, i përflakur është qyteti i Jakovës. Në mitrën e Jakovës është hedhur sperma e rektorit të saj Redalk san Heldikut. Është hed-hur sperma e Radalk San Heldikut të yshtur nga ai çifuti, Rabi Joc-

hanan ben Sakai. Sperma është hedhur në mitrën e Jakovës së Jerusalemit Tënd nëpërmes seksit, orgazmës, Dashurisë.

Sonte, vetëm pas dy orësh, po na huqi zbulimi i mitrës së gruas Sofi të Jakovës së Jerusalemit Tënd, do të zbresë në këtë qytet ajo gruaja Indigjene Iroki- Pocahontas Powhatani tok me atë gjeneralin amerikan, John Harkerin e Massachusettsit.

Ju,gjeneral i nderuar,e keni pasur mundësinë për t'i asgjasuar, njënganjë, të gjithë njohësit e seksit, të orgazmës, të klitorisit, të Dashurisë. E keni pasur mundësinë t'i asgjësoni njënganjë: Rabi Jochanan ben Sakain, Zatren Arameje, Rebeken e Alamekut, po edhe Sofinë e Rainhardit të Bohemisë, mitra e së cilës, sonte, po lypet me aq ngulm në Jakovën e Jerusalemit.

Sikur, ju gjeneral i nderuar të kishit vepruar me përpikëri, siç veproi Turqia e vetvetes së vet Stambollit perandorak me testiset dhe penisin e Rektorit- Radalk san Heldikut, sonte pas dy orësh, të gjithë evropianët do ta kishin pasur të kollajt me atë gruan Indigjene Iroki të gjeneralit amerikan, John Harkerit të Massachusettsit. Ajo, Pocahontas Powhatan me furinë e urrejtjes antiqonquistadore do të zbresë në këtë qytet vetëm pas dy orësh.

Evropa i ka punët pisk.

Sillu denjësisht në atë Takimin e Këshillit të Lartë të NATO-s! Moho çdo gjë!

Të përshëndetë gjenerali i krahut jugor të ushtrisë së Rusisë Sovjetike Perandorake: Ivan Vasiljeviq Kutozovi"-i foli pergamena gjeneralit romak, Titi.

"Cili gjeneral flet në këtë mënyrë, me këto shkronja insektesh, nga kjo pergamenë e pshurrt. Në Jerusalem ka vetëm një gjeneral roman. Ushtria e perandorisë së Romës, sonte, e dogj Jerusalemin deri në rrënjë:- u çakërdis gjenerali roman, Titi, duke u dehur nga flaka e qytetit.

"Gjeneral i nderuar! Qyteti i përflakur para Jush qenka Jakova e cepeve më të largta të shtatë perandorive. Qyteti i përta-

cisë biologjike. Të shtatë perandoritë e paskan harruar në cep të vetvetes së tyre, në mitrën e mbyllur nën shtatë shtresa pushtimesh”- i ndihmoi komadanti i togës së vëzhgimit.

“Prej sonte le të quhet ky qytet: Jakova e Jerusalemit! Lavdia i përket vetëm ushtrisë së Romës” - u çjerr gjenerali roman, Titi.

64.

"Harresa romake i paska pasë kapërcye të gjitha perandoritë pa e hetuar asnjëren sosh?"-Jakobi i urtë e pyeti Rabi Jochanan ben Sakain.

"Po"

"Atëherë edhe unë paskam mundur të vij deri në Berlin pa u hetuar, mbase po t'i kisha rënë ndonjë rruge tjetër, larg derës së Danielit, larg këlyshit të kones së tij" - deshi të çfajsohet Jakobi i urtë.

"Jo,miku im, drejt diasporës ka vetëm një rrugë të pambrojtur.Vetëm kësaj rruge arrihet deri tek Shkolla Hebreje e Berlinit.Mbase ti, miku im, mendon kot, se krejt kot, e kanë vendosur në atë shtëpi, kaq pranë Shkollës Hebreje, atë Danielin e Abbit të Galiles bashkë me Këlyshin e pestë të Kones së tij"- e ngushëlloi Rabi Jochanan ben Sakai.

Jakobi i urtë i heshti ngushëllimit të mikut të vet. I shkoi mendja ta shpie këlyshin e pestë të kones së Danielit tek i zoti. Kishte rrezik. Danieli i Abbit të Galilesë mund ta bëjë hatanë.

Rabi e pikasi katandisjen e mikut të vet. Të gjitha u sosën. E ndjeu se erdhi çasti. Deshi të përshëndetet me mikun e vet, këtë herë përgjithmonë, por në rezidencën e Rabinit të Shkollës Hebreje hyri përngutshëm kujdestari Levek, i skuqur, i djersitur,i mbushur frymë.Rabi u rrek ta qetësojë me shikim. Kujdestari u plandos në fund të vetvetes i trumhasur nga shikimi i shefit të vet. U përmbajt brenda koarracës së vetvetes së vet gati për të pëlcitur.

"Ç'na solle o Levek?" - e pyeti Rabi kujdestarin e Shkollës Hebreje.

"Zotëri! Një grua e çakërdisur kërkon të Ju takojë"- e nxori frymën e tepërt nga gjoksi kujdestari Levek.

- "Është shumë nevrike hirësi, gati e rrezikshme. Flet shumë përqart"- shtoi Leveku.

"Le të hyjë o Levek" - e urdhëroi Rabi, më shumë për Jakobin e urtë se për Levekun.

Kujdestari e shikoi zgurdullueshëm shefin e vet për t'u kulluar në e kishte dëgjuar esëll urdhrin.

"Hapja derën o Levek! Përcille deri këtu!"- ia ravizoi urdhrin edhe njëherë Rabi.

Nga jashtë u përbirua zëri spirak prej gruaje nevrike. Ajo po e spironte durimin e Levekut duke ia zbrazur mbi kokë të gjitha të ligat e Gjermanisë.

Jakobi i urtë u tund nga zëri i vetvetes së kësaj gruaje. E pa vetveten e zërit të kësaj gruaje ende pa e parë vetë gruan. Përngutshëm e shikoi mikun e vet, Rabi Jochanan ben Sakain. Të gjitha gjërat u shastisën në vetveten e syrit të tyre.

"U bë çasti, miku im. Mos vdis më shumë se ç'duhet!"- i foli vuvët Rabi Jochanan ben Sakai mikut të vet,Jakobit të urtë.

Në derë u shfaq gruaja e çakërdisur. Të gjitha tiparet e fytyrës i kishte përmbledhur në sqepin hujnik. Gruaja hujnike e pati të vështirë të bëjë diçka me fytyrën e vet. Për një çast ajo hoq dorë nga përpjekja të bëjë gjë me sqepin e vet fytyrës.

"Hirësi!"–gruaja sqepore iu drejtua Rabi Jochanan ben Sakait me ngulm sikur e njohu se ai, vetëm, ai është shefi, pa denjuar ta shikojë Jakobin e urtë.-"Nxënësi i Juaj, pikërisht ai Halevi i kësaj shkolle e ka marrë guximin e ndotur hebre t'ia ngashënjejë vajzës sime atë seksin e turpshëm çifut. Më ka kushtuar një dreq e gjysmë për ta shëruar, jo krejtësisht, nëpër klinikat gjermane"- e zhbiroi sqimën në heshtjen e Rabi Jochanan ben Sakait.

Rabi e vazhdoi heshtjen e qëllimtë. U ndrojt të mos sharrojë në sherrin e asaj gruaje. E priti çastin vendimtar për t'ia thënë Jakobit të urtë se ora trokiti në derën e Universitetit Hebre në Diasporë. E shikoi, më në fund thellë në sy, mikun e vet të heshtur.- T'ia thotë qartë në fytyrë, siç i ka hije Rabinit, i erdhi zorshëm. Ta lejojë të vdesë më shumë se ç'duhet mikun e vet pa ia treguar çastin vendimtar, i erdhi ligështi.

Derisa gruaja gjermane, e prezantuar me emrin Gertrudë, po e priste me padurim përgjigjen e Rabinit, ai iu drejtua solemnisht Jakobit të urtë për ta dëgjuar të gjithët e secilit, e, secili i të gjithëve të Izraelit diasporik evropeisht:

"Miku im, Izraelit i mbetën vetëm tri rrugë: rruga e Harresës, dhe rruga e vdekjes heroike, rruga e jetës përmes spermës, orgazmës,dashurisë. Tribali i Madh i Izraelit e zgjodh për vetveten e vet të Izraelit rrugën e vdekjes heroike. Ti miku im, e zgjodhe Aushvicin e Holokaustit të Hebrejve- e zgjodhe kampin e vdekjes të cilën për shkaqe politike duhet harruar. Unë, miku im, për vetveten time të Izraelit e zgjodha rrugën më të përçmuar. E zgjodha Rrugën e Diasporës, të seksit, të klitorisit, të Dashurisë. Rrugën e jetës.

Vdekja heroike e sjell lavdinë e shënjuar, por mbetet vetëm vdekje. T'i hysh rrugës së seksit,orgazmës, të Dashurisë, e sjell jetën, përtrirjen e palavdishme, të përbuzur. Por mbetet vetëm jetë. Miku im, jeta, vetëm jeta, mund të bëjë diç për vetveten e vet. Humbjen ta shndërron në fitore, përbuzjen ta shndërron në lavdi, heroizmin ta shndërron në dobi kur foshnja bie në dorë të Nënës së vërtetë.

Armiku ta deshiron heroizmin e tepruar. Tri ditët e para t'i sjellë tek varri tri buqeta të humbjeve Tuaja me tri ditë përbuzje. Miku im, vdekja e ka zakonin më të keq: sosjen, fundin, harresën.

Miku im, po qe se, sonte, në Laboratorin e OSCE-së, në Le të Shqipërisë së Albanikut Sovjetik, tek po bëhet eksperimenti me gjenet e miushëve të uritur, fiton gjeni i stërkequr i miushit lugat, zhvatës i mishit të llojit të vet, përfundimisht, në tërë Evropë do të fitojë vdekja e seksit, e orgazmës, e Dashurisë.

E vdekja, miku im, e ka zakonin e keq të harresës.

Miku im, po qe se, sonte, konsiliumi i mjekëve amerikanë i kryen me sukses, atje te klinika "Gemeli", të dy ndërhyrjet cezareske në Mitrën e Rebekes së Alamekut dhe në Mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, do të fitojnë: seksi, orgazma, Dashuria. Do të fitojë vetë jeta e Izraelit, vetë jeta e Jakovës së Jerusalemit.

E jeta e ka zakon ta bëjë të dobishmën për vetvetën e vet.

Jakobi i urtë me syrin e mendjes e pa Sofinë në klinikën "Gemeli. "

Ai e paskësh pyetur:

"Zonjë, Ju jeni shtatzënë?"

"Po"

"E dini se jeni grua e martuar?"

“Po”

“Cili do të jetë babai i foshnjes Suaj?”

“E di vetëm Rabi. Ai më urdhëroi të hy në tendën e Zatres Arameje”

“Po yt shoq, Rainhard von Grainhelmi, ç’do të thotë për këtë shtatzëni?”

“Në mitrën time ka jetë më shumë se për një njeri, më shumë se për disa njerëz, më shumë se për shumë njerëz,më shumë se për Jakovën e Jerusalemit. ”

Sofia e Haçet Deletës e zbuloi diagnozën “Sanguis lacertae in utero”në mitrën e nënës së vet beronjë. E zbuloi se vëllai i vet -Kostantini, paskesh qenë vetëm një llurbë gjaku e mpiksur në baladën e mynxyrshme të kooperativës gullage. E zbuloi se Ilirikut të saj Albanik i kishte tepruar heroizmi i kooperativës sovjetike.

Vendosi ta shpëtojë Orgazmën e rektorit të Redalk sa Heldikut. Vendosi ta shpëtojë jetën Jakovës së Jerusalemit.

Miku im, prej sonte, pas dy orësh, Amerika e Indigjenes Iroki të John Harkerit nga Massachusettsi do të bie ndesh ballëpërballë me masturbimin politik të Evropës. Në ketë Traditë evropiane pjellin vetëm zotat e jo njerëzit. Nga koka e Zeusit dalin sundimtarët e Shtetit evropian. Nga brinja e majtë e Zeusit dalin ushtarët. Nga pulpi i këmbës së majtë të Zeusit dalin shtetasit skllevër.

Ai, Kryeministri i Shtetit të Bashkësisë evropiane, Spiridonis Zevsi, po i gëzohet sonte eksperimentit me gjenetikën e lugatosur të miushëve. Inzhinieringu gjenetik në laboratorin e OSCE-së në Le të Shqipërisë së Albanikut sovjetik po e krijon përmes përmutacionit të gjeneve ekstraktin e lugatosur të llojit. Këtë ekstrakt sonte po e komponon në vaksinë për t’i vaksinuar shtetasit e Bashkësisë evropiane.

Ndesh kësaj vaksine Indigjenia Iroki-Pocahontas Powhatan e gjeneralit amerikan, John Harkerit të Massachusettsit, sonte në klinikën "Gemeli" të Romës po provon t'i sjellë në këtë botë me operacion cezaresk, krijesat e para nga mitra e gruas. Foshnjën e parë të gruas së vetvetes së vet të Izraelit do ta nxjerrë nga mitra e Rebekes së Alamekut. Foshnjën e dytë do ta nxjerrë nga mitra e gruas së vetvetes së vet të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit" - u zbulua Rabi Jochanan ben Sakai duke ia thënë Jakobit të urtë sekretin publik.

Jakobi i urtë u frikësua nga vdekja e vetvetes së vet në holokaustin e kampit të Aushvicit pasi Rabi Jochanan ben Sakai nga larg, krejt zvargshëm i tha:

"Tash, miku im, ne do të ndahemi këtu, në Shkollën Hebreje të Berlinit. Ti, miku im, do shkosh drejt vdekjes harresës në kampin e holokaustit hebre tek Aushvici.

Mos u frikëso miku im! Ruaju se po të tepron vdekja. Unë, miku im, do të shkoj nëpër rrugën e seksit, të orgazmës, të Dashurisë.

Jeta, miku im, e ka zakon kurrë të mos teprojë" - qenë fjalët e fundit të Rabi Jochanan ben Sakait drejtuar Jakobit të urtë.

Jakobi i urtë u frikësua nga të perënduarit e mikut të vet Rabi Jochanan ben Sakait.

Shikimi i Gertrudës papritur iu ngarrosh vetëm Jakobit të urtë, sikur ndryshoi gjendja e asaj gruaje.

"Vajzës sime, Marizës, nxënësi i Shkollës suaj Hebreje, ai Halevi i ndotur, ia ka yshtur seksin çifut. Tërë natën a natës, Marzia ime e pagjumë, përpëlitet duke e ngacmuar klitorisin e ngashëruar nga marifetlleqet e atij nxënësit tuaj"- iu ngashërua gjithnjë e më tepër Jakobit të urtë, derisa e pizati aq ngusht sa ai u detyrua të çfajsohet.

"Zonjë e nderuar! Unë kam ardhë vetëm për një vizitë rutinore në këtë shkollë. Përgjegjës për Shkollën Hebreje është

pronari i kësaj lëkure”- u çfajsua Jakobi i urtë duke ia treguar asaj lëkurën e fishkur të Rabi Jochanan ben Sakait, të prurë nga klinika “Gemeli” e Romës.

Nga përtej erdhi vetvetja e vet zërit të Rabi Jochanan ben Sakait:

“Miku im, mos u frikëso! Nisu të vetmes rrugë të harresës hebreje! Hyr në Holokaustin hebre te kampi i Aushvicit! Vdekja jote do t’i shërbejë Izraelit”- e ngushëlloi nga larg Rabi Jochanan ben Sakai.

“Kujt t’i drejtohem? Këtij ngordhalaqi! A po e sheh se e dha shpirtin e ndotur prej çifuti?”- iu ngërdhesh e zemëruar Gertruda Jakobit të urtë duke bërë me shenjë kah lëkura e Rabis.

“Vdekje çifutëve! Vdekje çifutëve!” - buçiti nga jashtë.

Jakobi i urtë e shikoi pingul në fytyrë Gertrudën. Asaj po i blatohej një buzëqeshje e hollë prej thike. Sytë iu farkuan në prush hakmarrës. E bëri shenjen shpjeguese kah këlyshi i kones së Danielit.

“Edhe ky është i racës hebreje. Para një ore u arratis nga Teatri i Berlinit bashkë me atë kurvën e Rainhard von Grainhelmit të Bohemisë” - u çjerr Gertruta mbi buçimën nga jashtë:

“Vdekje hebrenjve! Vdekje çifutëve”

Jakobit të urtë iu bë vërdallë përpara. Më në fund u bind i tëri se duhej të vdesë i linçuar nga turma gjermane.

Ende pa e sosur kumtin e vetvetes së vet Jakobi i urtë, rrëmbimthi u futën në rezidencën e Rabis tre burra, të qethur keq. Shiritat me kryqin e thyer duarsh e këmbësh, u ishin çakërdisur. Në derë, porsa u shfaqën, u njëzuan me shikimin e Gertrudës. Ajo, e rënë në amokun e hakmarrjes, sa i nxjerrte kreje bënte me dorë kah lëkura e fishkur e Rabi Jochanan Sakait:

“Kapeni atë Rabi ende pa zbritur në seksin e çifutës Rebekë të fshatit Abbi të Galiles!”

Të tre burrat, të ndërsyer nga Gertruda e ndezur prush, u sulen kah Rabi Jochanan ben Sakai. U katandisën për ta zënë këtej seksit të Rebekes së Alamekut. Në duar u mbet vetëm lëkura e dytë e fishkur e Rabinit.

"Kot, krejt kot, ia paske sjellë lëkuren e parë nga klinika "Gemeli" e Romës.Tashmë ky çifut e paska braktisur edhe lëkuren e dytë"-ironikisht iu drejtua Jakobit të urtë njeri nga ata tre burra të çakërdisur.

65.

"Zbrit rrugës sate të seksit deri tek takohen Shtatëmbëdhjetë minutat e Orgazmës së Izraelit me Shtatëmbëdhjetë minutat e orgazmës amerikane të inisiativës së lirë të Indigjenes Iroki Pocahontas të gjeneralit Harker të Massachusettsit!"- u bë Rebeka e Alamekut.

Rabi Jochanan ben Sakai duke e dëgjuar, zvargshëm, nga larg çjerrjen gjermane:

"Vdekje çifutëve! Vdekje çifutëve!"-rrëshqiti gjinjve hijesor të Rebekes së Alamekut. Ra, thellë, në aromë gruaje. Rrodh teposhtë barkut të saj, pubisit të gufuar. Ai fluturoi qiellit të pubisit deri tek thiktimi i klitorisit. Nga të gjitha anët shpërtheu universi i Orgazmës.

Klitorisi-penisi! Mishi për mish! U futën njësh në Shtatëmbëdhjetë minutat e Orgazmës së Izraelit. Rabi Jochanan ben Sakai nëpër penisin e vet e rodhi vetveten thellë në orgazmën e Rebekes së Alamekut.

Rabi Jochanan ben Sakai fluturoi, i dalë nga rëndimi i trupit, nëpër qiellin e Dashurisë,të Orgazmës derisa arriti tek zëri shpëtimtar.

Nga Shtatëmbëdhjetë minutat e Izraelit e pa orgazmën amerikane të inisiativës së lirë të Indigjenes Iroki të gjeneralit Harker të Massachusettsit.

Nga larg dikush tha:

"Foshnja doli e shëndoshë. Më në fund shpëtoi kodi i Izraelit"

Rabi Jochanan ben Sakai i hapi sytë. Mbi vetveten e vet të foshnjës e dalloi fytyrën e Indigjenes Iroki- Pocahontas Powhatanit të gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsit.

E pa.

Ajo tha:

"Foshnja po qanë"

Konsiliumi i mjekëve amerikanë e peshoi foshnjën sipas të gjitha standardeve të spitalit gjinekologjik-obstetrikë .

Indigjenia Iroki- Pocahontas Powhatani e gjeneralit, John Harkerit të Massachusettsit i urdhëroi mjekët e Konsiliumit amerikan:

"Foshnja le të ushqehet tri javët e para vetëm me pika të qumështit nga kokrrat e Misrit jashtëbiblik, me lëngë të mullëzës së Bizoneshës jashtëbiblike, me qumësht të Indigjenes Iroki të Massachusettsit"-duke i shënuar dozat e qumështave në listën e Rabi Jochanan ben Sakait.

"Përse këto tri lloje të ushqimit, të panjohura?"

"Më mungon qumështi i gjirit tim. Ma shterruan me Holokaust të Aushvicit"-foli Rebeka e Alamekut pranë foshnjës së vet, ende e shtrirë.

Indigjenia Iroki Pocahontas ia hodhi tri pika qumështash jashtëbiblikë në gojë Rabi Jochanan ben Sakait.

Ai i përpini me shije mbushulluese.

Ky qe ushqimi i parë në fund të Shtatëmbëdhjetë minutave të Izraelit.

66.

Jakobi i urtë u zgurdullua syshë. E mori vesh, tashmë, se do të vdesë ndryshe nga të tjerët. Më shumë se të tjerët. Se do t'i teprojë vdekje.

Gjëmimi hungërues i turmës gjermane teproi para universitetit hebre në diasporë.

Evrogjermanisë po i tepronte vetvetja.

"Vdekje çifutëve!"- u shpërnda në Universitetin hebre çka i kishte tepruar Gjermanisë. E gjithë turma e çakërdisur gjermane po, edhe tre burrat e GESTAPO-s, e gjithë Gjermania, ishin bërë gati për atë vdekjen tjetër të Jakobit të urtë.

"Sa dhimbje shkakton kjo vdekje e veçantë?"-ra në vetveten e vet Jakobi i urtë.

Ai vetëm kishte dëgjuar për këtë vdekje, pa e pasur ndërmend të vdesë në atë mënyrë.

"Rabi Jochanan ben Sakai kur më tha: "Ti miku im, do të vdesësh në Holokustin hebre, aty tek kampi i Aushvicit se vde-

kja jote do t'i shërbejë Izraelit"- deshi të më ngushëllojë, apo së fundi, vetëm u tall me sjelljen time prej budallai ngase unë ja solla lëkurën e fishkur nga klinika "Gemeli?" - u plandos në vetveten e vet Jakobi i urtë.

Njeri nga tre burrat e GESTAPO-s urdhëroi:

"Mblidhni të dy lëkurat e atij Rabini!"

Të tre burrat e GESTAPO-s dhe Jakobi i urtë udhëtuan kah Aushvici në një makinë pa asnjë dritare.

Brenda makinës ishin vetëm dy drita të futura në gropat e hekurta.

Jakobi e hetoi apo i erdhi vegim nëpër atë zvetënim drite se aty, në makinë, paskesh qenë edhe Gertruda. Ajo, papritur, u shndërrua në një grua të ndenjur sheshit.

Jakobi i urtë, përkundër vullnetit të vet, zu ta shikojë fytyrën e një gruaje. Bile e pa një fytyrë të bukur gruaje. U frikësua nga vetvetja e Jakobit.U frikësua nga të dy lëkurat e Rabi Jochanan ben Sakait.

"Ndryshe nga të tjerët u dashka të vdesë unë?Më tepër se të tjerët.Të vdes midis seksit gjerman të kësaj gruaje dhe masturbimit të Tribalit të Madh të Izraelit.Kjo qenka ajo vdekja harresë? Të dalësh nga masturbimi e të mos e arrish orgazmën?"-ra në vetveten e vet Jakobi i urtë.

Makina ndaloi. Dera e makinës u hap ciatshëm. Dikush e zbriti Jakobin e urtë. Ai e pa se në Aushvic ishte çvendosur nata e Abbit të "Galiles".U step kur nëpër ajrin e trashë të kampit i pa njerëzit duke pluskuar të papeshë, të mbështjellë në mëshikëza të këtij ajri të veshtullt. U mungonte shprehja në fytyrë më shumë se për një njeri, më shumë se për shumë njerëz, më shumë se për tërë Izraelin. Secili sosh, më shumë se për një njeri, mbështilleshin në mospërfillje.

"Le të ecin edhe pak" - i tha ai kryesori nga të tre burrat e GESTAPO-s, paska përngutshëm.

Hynë brenda një korridori të qetë, pafundësisht i mbushur me një tis të mjegullt ajri. Jakobit i ra ndërmend profecia e Rabi Jochanan ben Sakait:

"Vdekja jote do t'i shërbejë Izraelit"

"Përse mu tash këto fjalë të mikut tim?" - deshi të bie në vetveten e vet të përgjithmonshme Jakobi i urtë, kur njeri nga të tre burrat e GESTAPO-s e zuri për krahu.

"Do të qëndrojmë për një çast"-i tha Jakobit sikur i mori leje.

Nga larg e ndjeu erën e ambulancës. Qëndruan para një dere të veshur me rryp. Asaj dere i mungonte vetëm vendi për të trokitur. Të tre burrat e GESTAPO-s dhe Jakobi i urtë vendosën të presin. I erdhi gjumi i një mëngjesi të hershëm fëmijënor.

"Miku im, njeriu mund të vdesë në këtë gjumë"- e qortoi Rabi Jochanan ben Sakai nga përtej ajrit të mjegullt.

Këputshëm ra në dëshpërim. Ra në përbuzje më shumë se një njeri. U bë urrejtje e vetvetes. Urrejtje e të gjithëve brenda atij korridori tisor. Iu kujtua apo i erdhi shkretëtira e Negevit.

Jakobi po e bënte harresën hebreje për tërë Izraelin.

"Jakob, miku im, në gjumin tënd, para derës së doktor Mengeles, e arrite atë harresën hebreje, atë vdekjen tjetër midis masturbimit dhe seksit, pa i përkitur asnjërës anë. Vdekja jote e denoncon mashtrimin evropian"- i erdhi vetvetja e zërit të Rabi Jochanan ben Sakait.

"Vetëm për këto fjalë ma caktove vdekjen time o Rabi?" - Jakobi u çjerr në dëshpërimin e vetvetes së vet.

"Jo, miku im, Ju e patet të caktuar vdekjen qysh më parë se të të flas unë, një Rabi i varfër. Ju, miku im, vet e zgjodhet për veten tuaj atë Izraelin tjetër. Miku im, mos u dëshpëro! Izraeli yt i Tribalit të madh ka tepruar, miku im. Po merret Evropa me të"- për herë të parë zëri i vetvetes së Rabi Jochanan ben Sakait i foli në këtë mënyrë mikut të vet.

Mbase qe ndërgjegjja e vet Jakobit të urtë. Dëshpërimi i tij u bë para derës së doktor Mengeles, në atë korridor të gjatë të laboratorit të Aushvicit.

"Më mirë paskesh pasë qenë t'i paskeshëm përkitur, i tëri, Hosana Barabas, së Tribalit të Madh të Jerusalemit. Do të kisha vdekur lehtësisht në atë heroizmin hebre të Izraelit"- ra në inatin e vet, për herë të parë Jakobi i urtë.

"Miku im, mbase po i frikësohesh kësaj vdekjeje në Holokaustin Hebre? Këtu në Aushvic vdiset ndryshe nga heroizmi izraelit. Ajo do të kishte qenë vdekje e kollajshme. Do ta kishe bjerrë për një çast vetveten e Izraelit, ashtu shpejt, heroikisht, pahetueshëm. Dhe u bë puna."- u zvarg vetvetja e zërit të Rabi Jochanan ben Sakait.

Jakobi i urtë e zgjodh për vete gjumin e harresës kur u hap dera, para të cilës qëndruan tre burra të GESTAPO-s dhe Jakobi i urtë.

Në derë u shfaq një fytyrë plot vurrata të imta. Më të parën punë, fytyra e shfaqur në derë u fur në gjumin e përzgjedhur të Jakobit të urtë.

"Hyni brenda!" - urdhëroi.

Diçka si hetimi u bë para derës së Doktor Mengeles. Të katrit u futën brenda, nën ciatjet e thekëta të bravave.

Kutërbimi i trashë i ambulancës s'qe aspak mikpritës. I kishte lakuar të gjitha orenditë.

Të gjitha medikamentet ishin renditur mbi tavolinë, nëpër shishe të errëtisura.

Doktor Mengele e gëlltiti zemërimin e vet.

"Relaksohu!"-e urdhëroi ndihmësmjeku Jakobin e urtë duke ia fërkuar krahun e majtë për t'ia bërë injeksionin.

Çasti solemn trokiti në zemrën e Doktorit. Gjilpëra depërtoi në mishin e krahut të Jakobit të urtë. Qëndroi në mish derisa e

shterroi vetveten e vet. Ata të tjerët u zhgrehen pas tendosjes së parë duke e pritur efektin e injeksionit në mishin e Jakobit të urtë të cilit të gjithë numrat i thoshin se do të vdesë ndryshe.

Ajri i ordinancës së Doktor Mengeles iu rrëzua mbi gjoks Jakobit të urtë.

I hapi sytë.

... Gjithë jetën kishte rrugëtuar pa e ëndrruar kurrë mishin e femrës. Tash kur në shkretëtirën e përgjumur u gjet i vetmuar tundimi i saj i zbriti nga ajri i natës. Qenë flokët e Sofisë së Grainhelmit të Bohemisë, futë së zeza, prej gruaje. U përpoq t'ia shohë sytë. Sytë e saj lutës e rritën etjen e shkretëtirës. Ajo u rrotullua epshit të vet të teptisur, klitorisit të kallur prush i gjallë. Në atë çast ndodhi vërtëllimi së prapthi. Ajo i shfaqi sytë e breroret buzë Dashurisë së zhuritur për një orgazëm, vetëm për një penis.Të gjitha i munguan asaj në çastin e epshit.

Në fund të shikimin të saj u plandos kufoma e dikujt. Jakobi i urtë u hutua paksa në shikimin e gruas së dëshpëruar buzë orgazmës. U bë një penis i vrarë.

Në sytë e tij u shuan të gjitha dritat.

Jakobi i urtë e njohu kufomën e vet.

"Jakob, miku im, ti i vdiqe kodit të Izraelit. E pe kufomën tënde të fishkur pa asfarë shprese për gruan e zhuritur në shkretëtirë? U bëre harresë hebreje.

Mos u frikëso më nga vdekja në Aushvic!Sonte Evrogjermania i teproi vetvetes.

Heroizmin hebre po e blaton Evropa tek varri. Tri ditë i ka shpënë buqeta lulesh cinike të harresës tek përkujtimorja në Aushvic.

Kodin e Izraelit do ta shpëtojnë: orgazma, Dashuria, dy spermat e ngjizura njëra-tjetres në mitrën e Rebekes së Alamekut" -i erdhi përmbi kufomën e vet Jakobit, zëri i Rabi Jochanan ben Sakait.

..."Shikoni në mos i kaloi ajo gjendje molisëse pas vaksinimit" - urdhëroi doktor Mengele.

Ndihmësmjeku e mati ngadalë qe nga fytyra e deri aty tek e mendoi mishin mashkullor të Jakobit.

"E ka marrë vetën, zoti doktor" - njoftoi zëvendësmjeku.

"Zdesheni!" - urdhëroi doktor Mengele.

Ndihmësmjeku panjëpady e trumhasi Jakobin e urtë të shtrirë në divan.

"Zdeshu!" - e urdhëroi

Jakobi i urtë, pa e kuptuar krejtësisht, filloi ta zdeshë kufomën e vet.

"Zdeshu krejt lakuriq!" - e urdhëroi ndihmësmjeku.

"Krejt lakuriq?"

"Po krejt lakuriq"

"I paska qenë fishkur mishi mashkullor. Kot, krejt kot, e paskemi vaksinuar"-konstatoi kryemjeku.

Po cilin e sollet këtu?- përfundoi tek pyetja zhgënjyese doktor Megele.

"Jakobin e urtë, zoti doktor. Vetëm këtë arritëm ta kapim" - u përgjigj ai i GESTAPO-s duke u bërë sikur të ishte njësoj kjo punë.

"Në shkollën hebreje keni shkuar për tjeterkend? Kush u ka thënë të ma sillni këtë ngordhalaq të fishkur?"-u dëshpërua doktor Mengele.

"Zoti Doktor, kur arritëm në Shkollën Hebreje Rabi Jochanan ben Sakai veç kishte pas ikur. Të dy lëkurat e veta i kishte pasë lenë në Shkollë pranë Jakobit të urtë. Ne e sollëm këtë. Vetëm ky ishte kur hymë"- u çfajsua ai i GESTAPO-s.

Jakobi i urtë dëgjoi përqartë se diç u fol për të. Tashmë e kishte kuptuar se rruga e tij gjithkund do të teprojë. U çmerit me vetveten e vet. Nga i erdhi kaq befas gjithë ai vullnet për të

vdekur. Vetëm priste, me andjen e gjumit, të shtrihet në prehjen e arkivolit.

Izraelit po i tepronin të dy vdekjet:vdekja e harresës hebreje e Jakobit të urtë dhe vdekja heroike e Tribalit të madh.

"Do të ishte mirë ta provojmë, zoti Doktor. Mbase ajo Gertruda e handakosur mund ta zgjojë mishin mashkullor të këtij çifuti" - i propozoi zëvendesmjeku.

Doktori heshti për një çast. Mbase do të këtë hezituar për këtë provë.

"Mirë, do ta provojmë. Kështu e ka shkenca" - u bë dakord Doktori.

Pasi e mbuluan me çarçaf të gjelbër Jakobin e urtë, e sollën Gertruden e çakërdisur sysh. Ajo e përpini ajrin e renduar të ordinancës së doktor Mengeles. E nuhati erën hebreje. E përpini me sy Jakobin e urtë nën çarçaf. Krejt kot ra mbi të. E futi dorën, prush të gjallë, përngutshëm nën çarçafin e gjelbër. Gertruda, e përhumbur e lepurati mishin mashkullor të Jakobit të urtë. Sikur e kafshoi gjarpri i gurit e tërhoqi dorën duke e çjerrë në kupë të qiellit.

"Penisi i këtij ngordhalaqi ka mbetur vetëm zhangel e vyshkur. "

Gertruda e shkalluar nga mendja ia rrënoi gëzimin Doktorit. Ajo e përmendi Rabi Jochanan ben Sakain, pastaj e përmendi Rektorin e Jakovës së Jerusalemit-Redalk san Heldikun. Ajo refuzoi të zdeshet para atyre eunukëve, siç i quajti. Vetëm injeksioni qetësues ia lëshoi lëng trupin.

"Duhet sosë punë sa më parë me këtë gërdallë të teptisur" - u sugjeroi doktor Mengele duke bërë shenjë kah Gertruda. .

Jakobi i urtë pritoi të shkojë për të vdekur në krematorium. Kishte grumbulluar vdekjen në gjoks, jo vetëm për një njeri. Ai e kishte grumbulluar në vete të terën vdekjen e vetvetes së vet Jzraelit.Dëshiroi të vdesë gjithsesi në poltronin e doktor Men-

geles. E diti më në fund se do të vdesë, se vdekja e vanda-kut të hebrenjve i ishte nynikatur në parzëm.

Me të gjithë hebrenjtë e vet ndaloi para dyerve të krematoriumit të Aushvicit. Kishte prituar të vijë këtu. Tashmë mishi hebre po rrjedh drejt gojës së hapur të krematoriumit. Drita e reflektorëve i mbet prapa shpinës Jakobit të urtë. E zuri rëndimi i vdekjes në gojën e hekurt të krematoriumit të Aushvicit.

Me vullnetin e kufomës e dëgjojë kumtin. Para derës së hekurt të krematoriumit të Aushvicit, tek po i ngutej të ndahet nga jeta e vetvetes së vet, Jakobit të urtë i erdhi zëri i Rabi Jochanan Sakait:

"Të gjitha në vendin e vet, miku im! Më s'do t'i teprojë vdekje Izraelit.

Lamtumirë miku im! Lamtumirë!

Vdekja jote në gojën e hekurt të krematoriumit të Aushvicit dhe ribërja ime në Mitrën e Rebekes së Alamekut i takojnë vetvetes së vet Izraelit.

Lamtumirë, miku im! Lamtumirë!"

67.

Sofia e Jakovës së Jerusalemit porsa u nda nga Jakobi i urtë, vrapoi nëpër korridorin e klinikës "Gemeli" duke e mbajtur barkun me dorë. Vrapoi pa e kuptuar mirë se e kishte zënë dhimbja e fëmijës. Qe duke u plandosur, pa e nda mendjen të ndalojë.

Duar të fuqishme e ndaluan në gjysmë të korridorit. As pat kohë të mendojë për vetveten. Dritat e korridorit iu zvogëluan pa arritur të kuptoje se cilat qenë ato duar.

"Vejeni nën narkozë! Duhet menjëherë të operohet. Do ta bëjmë atë lindjen e pritur cezareske"- urdhëroi Pocahontas Powhatan e Massachusettsit.

… Sofia ra nën narkozë të thellë deri para këmbëve të Rabi Jochanan ben Sakait tek aeroporti i Jakovës së Jerusalemit. Mezi u ngjit shkallëve të avionit"Air Izrael"të arrirë nga aeroporti "Ben Gurioni". Rabi e mbajti fortas për dore.

Ajo deshi të shikojë nga shkallet e avionit. Radalk san Heldikun e pa porsa e sollen nga Stambolli në Jakovën e Jerusalemit. I dalloi të tre gjeneralët e të tri perandorive.

"Secili gjeneral do ta marrë pjesën e vet të mishit nga ky Rektor i Jakovës së Jerusalemit"- sikur i foli Rabi Jochanan ben Sakai.

Sofia u rrek ta shohë Rabin prapa brerores lëbyrëse. Iu bë sikur të kishte folë dikush nga andej.

Gjeneralët ende jepnin e merrnin për ta marrë secili pjesën e vet të mishit nga Rektori i Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldiku. Sofia, nga andej, tek shkallët e avionit, i njohu të tre gjeneralët. E dinte për secilin gjeneral, cila pjesë e mishit do t'i takojë. Këtë ia pat thënë Rabi kohë më parë.

"Kot e kanë, krejt kot. Në testiset e Radalk san Heldikut, atje tek tenda e Zatres Arameje as të ketë mbetur ndonjë pikë spermë. "

Sofia e Haçet Deletës u harrua në vetveten e saj. U rrek ta pikasë në ishte vërtet Rektori i Jakovës së Jerusalemit - Radalk san Heldiku. Mbase mund ta kishin gabuar.

"Zonjë e nderuar, e njihni Ju Redalk san Heldikun?

"Jo, hirësi"

"Mos jeni shtatzënë?"

"Po, hirësi"

"Ju jeni e martuar, zonjë e lartë?"

"Po, hirësi"

"Cili do të jetë babai i foshnjes Suaj, zonjë?"

"Unë vetëm e zbatova urdhërin, hirësi. Hyra në tendën e Zatres Arameje. Dhe puna u krye"

"Mos do të thotë diçka burri Juaj, Rainhard von Grainhelmi i tretë i Bohemisë?"

"Unë vetem e zbatova urdhërin, hirësi"

“Të bie, ashtu përngutshëm, gruaja në mishin mashkullor të këtij Rektori, siç ndodhi në tendën e Zatres Arameje, sonte, nga shkallët e këtij avioni del punë shumë me qeder” - i erdhi zëri i vetvetes së Rabinit nga andej dikah.

“Po! Dashuria do të jetë harruar, atje, në tendën Zatres Arameje?” - Sofia, përmallshëm, u drejtua andej kah Rabi.

Pa e folur asnjë fjalë Rabi e shtrëngoi për krahu. I dha të kuptojë se duhet të futeshin në avion.

Sofia e kuptoi shenjën e Rabis. Ndaloi paksa tek dera e avionit. I erdhi për t’i thënë atij.

“Unë jam stjuardesa Ruti nga Sidoni. Kështu jemi marrë vesh”.

“Le të hyjmë në avion! Nga dritarja do të shohim mjaft” - iu bë zëri i Rabis, andej kah kishte folë më parë.

Sofia u ul pranë dritares. Nga andej e përcolli shikimin e vet në pistë të aeroportit. Një burrë hapaçel, gati i marrë këmbësh, sikur e bartte macen midis shalëve, iu ofrua tre gjeneralëve. Nga prapa e mbante, gati pezull, një burrë i bëshëm, pa e mëshehur forcën e duarve.

Sofia e njohu gjeneralin austriak, Herman von Urlihun. Iu bë më i hequr nga fytyra.

Rektori i Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldiku, hapaçelas, iu qas të tre gjeneralëve.

Qëndroi para tyre. E thithi një shkulmë ajri. Pastaj i ra në gjurmë ajrit të Jakovës së Jerusalemit të vet.

“Zonjë e nderuar, po të nuhat Redalk san Heldiku yt”- zëri i Rabi Jochanan ben Sakait erdhi andej.

Sofia heshti. Për herë të parë e pa San Heldikun. E kishte menduar ndryshe; më të shkathtë. Ai po i qasej ngadalë vetvetes së vet të Jakovës së Jerusalemit.

“Ka rrezik të të zbulojë tek gjeneralët e tri perandorive. E sheh se si po nuhat nëpër ajër. Sikur të të zbulojë se je në avion

do të anulohet fluturimi për në Romë. Ai po nuhat përtej stjuardesës Rut nga Sidoni. Redalk san Heldikun, të bërë eunuk, e sollën, sonte nga Stambolli vetëm për të të zbuluar ty"- e vuri para rrezikut Sofinë ai zëri i Rabi Jochanan ben Sakait.

"Si mund ta ndajnë tri perandori mishin e një njeriu?"- pyeti Sofia me një mallëngjim të tepruar.

"E ndajnë, zonjë e nderuar. Edhe mishi eunuk i Redalk san Heldikut, edhe testiset e tij, edhe penisi, janë sjellë nga Stambolli për ta zbuluar mitrën tënde midis të gjitha grave të Jakovës së Jerusalemit. Ky mish, i trellojt, erdhi i shndërruar në karrem për ty, zonjë, për mitrën tënde"– e përmendi nga mallëngjimi zëri i Rabis.

Ajo e shikoi Redalk San Heldikun e vet. Nga dritarja e avionit e shikoi përmallshëm, për herë të fundit njeriu e vet të ndarë në tri pjesë për të vdekur ne tri perandori.

"Si mund t'i besohet Rektorit të Jakovës së Jerusalemit? Stambolli i ka dhënë shumë të holla ta ndërtojë një xhami këtu në Jakovën e Jerusalemit.Xhamia do ta mbajë emrin e tij.Paraja dhe lavdia e bëjnë të pamunduren, të pabesueshmën"- në zërin e Rabis ende kishte dyshim.

Sofia e ndjeu në vete vapullimin nga fundi i barkut. Qe dhimbje e panjohur për të.

Deshi t'i thotë Rabis:

"Si mund të kompenzohet penisi me një xhami?

Kur kadina e Sulltanit ia premtoi xhaminë Redalk san Heldiku ra në sytë e Zatres Arameje. Të gjithë ranë "Estokf' llah" nga çjerrja e Redalk san Heldikut kur tha: "Do t'i jepja të gjitha xhamitë e botës vetëm për një penis, për një parë testise!"-u shqetësua Sofia nga heshtja e Rabi Jochanan ben Sakait.

"E kam dëgjuar. Fort mirë e kam dëgjuar. Shikoje se si ia ka mësy drejt nesh, drejt avionit! Mund të na zbulojë" - iu frikësua Rabi hapit të Redalk san Heldikut nëpër pistën e aeroportit, prapa të cilit shkuan tre gjeneralët.

68.

...“Foshnja erdhi” - u tha mjekëve të konsiliumit amerikan Pocahontas e Massachusettsit, ende me duar të zgjatura.

Në klinikën “Gemeli”të Romës u bë ndërhyrja kirurgjike në mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Iu nxuar foshnja me operacion cezaresk.

Sofia e Jakovës së Jerusalemit u përmend nga narkoza. I erdhën në vetveten e saj edhe mishi edhe shpirti. E pa foshnjën ne duar të Pocahontas Powhatanit.

Për një çast, vetëm për një çast, hezitoi midis Rektorit të Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldikut dhe kësaj krijese të vockël në duart e Pocahontas Powhatanit. Te qarit e foshnjës ia mbushi parzmën me të panjohurën. Ia mbushi parzmën me Dashurinë e parë.

Rektori i Jakovës së Jerusalemit ra ngadalë, i coptuar, në të tri hiset e tri perandorive duke ia lëshuar vendin kësaj krijese të vockël. Redalk san Heldiku shkoi në tri varre: në Moskë, në Stamboll, në Vjenë.

Shkoi pa i thënë askujt lamtumirë

"Jepni! Le të pijë foshnja!" - urdhëroi Pocahontas Powhatan e Massachusettsit.

Ia hodhën në grykë foshnjës tri pika qumështash jashtëbiblikë. I hodhën qumësht të Misrit jashtëbiblik, i hodhën qumësht të Bizoneshës jashtëbiblike, i hodhën qumësht jashtëbiblik të Indigjenes Iroki të Massachusettsit.

Foshnja e orgazmës, së tendën së Zatres Arameje, i gëlltiti të tri pikat e qumështave jashtëbiblikë.

Redalk san Heldiku, i Shtatëmbëdhjetë minutave të orgazmës së Jakovës së Jerusalemit në mitrën e Sofisë po kthehej nga Stambolli i mbështjellë në shpërgenj. Po kthehej në Jakovën e Jerusalemit nëpër rrugën amerikane të tre qumështave jashtëbiblikë të Indigjenes Iroki, Pocahontas të gjeneralit, John Harkerit të Massachussettsit vetëm një orë para se të fillojë tubimi i Këshillit të Lartë të Paktit Veriatlantik.

Rdalk san Heldikun e mbështollën në klinikën "Gemeli"me ëndrrën e Jezofinës:

"DONATED BY PEOPLE OF AMERIKA"

Indigjenia Iroki- Pocahontas e Massachusettsit e pa udhëtimin e foshnjës së Sofisë deri tek Jakova e Jerusalemit.

69.

Sikur ta kishte ndjerë lektisjen e Pocahontasit, John Harkeri lypi të hyjë në Klinikën "Gemeli" të Romës. Kishte vetëm dy orë kohë deri tek Takimi i Këshillit të Lartë Veriatlantik.

Gjenerali John Harkeri i Massachusettsit hyri në klinikë pikërisht në orën dy të pasmesnatës. Pocahontasin e takoi tek dera e sallës operacionale. Ajo ende i kishte duart e qullura nga pjella e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Në fytyrën e saj ishte mpleksur theksueshëm gëzimi dhe pikëllimi; valëzueshëm njeri pran tjetrit.

"Zonja ime e madhe, është koha të fluturojmë tek Jakova e Jerusalemit. Pas dy orësh do të fillojë takimi i Këshillit të Lartë të Paktit Veriatlantik.Atje, vetëm atje në Jakovën e Jerusalemit,

duhet ta mbrojmë foshnjën e Sofisë. Tri llojet e qumështit jashtëbiblikë duhet mbrojtur nga të tre gjeneralët e tri perandorive" – i tha përngutshëm, John Harkeri.

E puthi Indigjenen Iroki –Pocahontas nëpër rrëkenë e lotit faqes teposhtë.

"Ti po qan e dashur!"

"Po i dashur"

"Ti po gëzohesh e dashur?"

"Po i dashur"

"Përse të dyja e dashur?"

"Po qaj për vëllezërit e mi. Po gëzohem për këto dy foshnje të lindura sonte në klinikën "Gemeli"të Romës.

"Qonquistadorët i tredhën vëllezërit e mi. Iroki im shterp mbeti pa trashëgimtarë"

"Zonja ime, e nxore nga mitra e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit foshnjën e parë vagjinale në Evropë.Iroki yt u bë trashëgimtar i globalizmit.

"Unë desha i dashur. Ta mësova Orgazmën, seksin, gruan, ta mësova Dashurinë nëpërmes tri lloje qumështash jashtëbiblikë.Në Massachusetts pihen këto tri lloje qumështash. Pihet qumështi i Misrit. E, misër në Bibël nuk ka. Pihet qumështi i Bizoneshës. E, bizoneshë në Bibël nuk ka. Pihet qumështi i Indigjenes Iroki. E, indigjene në Bibël nuk ka.

"Më bëre e dashur, më bëre!"

"Po i dashur. Për këtë gabim të Biblës qonquistadorët spanjollë i tredhen të katër vëllezërit e mi"

"E dashur! Dhuroja botës qumështin Tënd Iroki të Massachusettsit!"

"Pikërisht atë punë po e bëj sonte në këto dy foshnja. Njera është foshnja e civilizimit të lartë, e mohimit të lartë të mburrjes së lartë hebeje. Është vizionari Rabi Jochanan ben Sakai,

rektori i të dy universiteteve të Izraelit, i shartuar nëpërmes Orgazmës në mitrën e Rebekës së Alamekut.

Izraeli i arriti Shtatëmbëdhjetë minutat e orgazmës.

Izraeli e arriti Dashurinë.

Hebrejt do ta njohin njëri-tjetrin,

Tjetra është foshnja e përtacisë biologjike, e mohimit të përtacisë. Është rektori i Jakovës së Jerusalemit,Redalk san Heldiku i shartuar në mitrën e Sofisë së Rainhard von Grainhelmit të Bohemisë. Orgazma amerikane i ka zgjedhur, për fillim, këto dy ekstreme për ta locuar Inisiativën e lirë amerikane. Pastaj do të veprohet në mostrat e mesme, siç janë modalitetet evropiane”- ngushlloi Pocahontas.

-“Pas dy orësh, i dashur, do të biesh ndesh me qonqui-stadorët panevropianë:Gryber Sontag,Lipman Smith, Kloth Durante, Herman von Urlih, Spiridinos Zevs.

Këta qonquistadorë panevropianë, sonte, në Le të Shqipërisë së Albanikut sovjetik po e eksperimentojnë vaksinën antiseks, antiorgazëm, antidashuri, antigrua.

Perenditë e tyre kanë etje”-përfundoi pocahontas.

“Po qumështi i gjirit Tënd, e dashur?”

70.

Kur Izraelit i teproi mburrja,i teproi Baraba, i teproi Jezusi, vdekja, harresa, i teproi Tribali i madh, atëherë doli Rabi Jochanan ben Sakai dhe i mohoi të gjitha çka i kishin teprua Izraelit. Rabi Jochanan ben sakai e sfidoi hiperinflacionin e historisë së Izraelit. U arratis në diasporë nëpërmes mitrës së Rebekes së Alamekut deri tek Shtatëmbëdhjetë minutat e orgazmës amerikane.

Sonte, i nxjerrë me operacion cezaresk nga mitra e Rebekes së Alamekut, Rabi Jochanan ben Sakai i Shtatëmbëdhjetë minutave të orgazmës hebreje po e kthen në Izrael kodin hebre me avion ushtarak të Indigjenes Iroki Pocahontas.

Tek varri i Rabi Shallomë ben Kaifes, Rabi Jochanan ben Sakai e gjeti heroizmen e tepruar, të zdërvajë rreth varrit, për krejt Izraelin.

Me një shkrim të çuditshëm midis ironisë dhe pikëllimit dikush e kishte shkruar mbi varrin e tij:

"Hosana Baraba"

Tek pllaka e Jakobit të urtë në Aushvic e gjeti harresën e tepruar, të zdërvajë për krejt Izraelin.

Me një shkrim nevrik midis ironisë dhe pikëllimit ishte shkruar:

"Gregor Zanza"

71.

Redalk san Heldiku mbeti në diasporë biologjike.

I rrëshqiti këmba në ëndrrën e Jezofinës. Sharroi në ëndërr i etur për orgazmën e Rebekes së Alamekut, të Zatres Arameje, të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

Rabi Jochanan ben Sakai e nynikati në tendën e Zatres Arameje. San Heldikut po i tepronin pjesët biologjike. U byryt në mitrat e Zatres e të Sofisë.

E humbi midis të dyjave.

Rabi Jochanan ben Sakai, në derën e tendës së Zatres e pyeti Sofinë pas orgazmës së dytë:

"Zonjë!Ju jeni shtatzënë?"

"Po, hirësi"

"Cili është babai i foshnjes?"

"Mua më urdhruan të hy në tendën e Zatres Arameje"

“ Zatren Arameje e vranë në hotelin “Laguna” të Trieshtës. Të gjitha analizat flasin për klitorisin e saj te djegur me zjarrin e Zeusit. ”

“Unë nuk e njoh Zatren, hirësi”

“Zonjë!Jeni e martuar?”

“Po hirësi”

“E njeh Rebeken e Alamekut?”

“Si ta them, hirsi”

“Sonte do të udhëtojmë për në Romë. Me Rebeken asnjë fjalë!”

“E kuptoj hirësi”

“Kodin e Jakovës së Jerusalemit tashmë e ke në mitrën tënde.

“Këtij Redalk san Heldikut tënd të cilit iu pleksen orgazmat në këtë tendë të Zatres Arameje, gjithmonë i ka teprua çdo gjë e të gjitha. Sonte i teproi orgazma e zdërvajë nëpër këtë tendë.

Ky njeri kurrë nuk ka qenë i vetvetes së vet. Gjithmonë i ka tepruar vetvetja e vet. Edhe sonte po i teprojnë pjesët e trupit.

Redalk san Heldiku yt gjithmonë ka pasur hiperinflacion biologjik. Sonte po i tepron varri, po i tepron zoti, po i tepron atdheu, po i tepron penisi, testiset, po i tepron mishi i vet eunuk.Penisin po ia varrosin në Moskë, testiset në Stamboll e mishin eunuk po ia varrosin në Vjenë.

Nga përtacia bilogjike e këtyre tepricave kurrë nuk ka mundur të bëhet roman, latin, të bëhet bizantinas, sllav, të bëhet turk, evropian, sovjetik, kinez.

Të gjithë këta kaluan mbi Redalk san Heldikun tënd pa arritur ta zgjojnë përtacinë e tij biologjike. Diaspora e tij biologjike ishte në Jakovën e Jerusalemit.

Zonjë e nderuar, Redalk san Heldiku yt ishte vet mohimi biologjik. Një ekologji aksidentale. Një biologji aksidentale.

Kur e takova në shkretëtirë, Redalk san Heldiku yt ishte një gjysmushtar i ushtrisë turke. Ishte një halabak të cilit i tepronte zoti, feja, atdheu, tempulli, vetvetja e vet. Ecte në përgjumjen e vet biologjike. Penisin dhe testiset e harruara i ngrehte zvarë si të ishin të huajat.

Zatra Arameje, e sapokthyer nga Judeja, e mllefosur nga linçi mbi Marinë Magdalenë, kishte vendosur t'i sfidojë zotat e egersuar, uzurpatorë të qiellit, të tokës, të seksit, të orgazm-ës, të dashurisë.

Kishte vendosur ta hapë shkollën e orgazmës.

Nga majë e malit e pa zvarjen e Redalk san Heldikut.

Vendosi ta bëjë nxënësin e saj të parë.

Zonjë e nderuar, Ju vajtet nga Bohemia te teatri i Berlinit për ta parë shfaqjen "Fausti". Ju, u bëtë zonja e parë në Evropë që e zgjuat shkundullimën e rebelimit tek Mefistoja. U arratisët së bashku deri në shkretëtirën e Negevit. Të dy kishit hall.

Zonjë e lartë tek Ju e pashë vetveten time.Ju po e lypnit identitetin Tuaj, historinë Tuaj, nënën Tuaj, kodin biosocial, biopsikik. E pashë vetveten time në Ju, zonjë e lartë. Mohimin e çdo gjëje të tepruar.

Vendosa.

Kodi i popullit Tuaj të Jakovës së Jerusalemit do të shpëtohej vetëm në mitrën Tuaj, zonjë e nderuar. Ju do ta merrni në mitrën Tuaj spermën e Redalk san Heldikut të shkapërdarë nëpër tepricat e biologjike, biosociale, biopsikike e ta ktheni në Jakovën Tuaj të Jerusalemit.

Zonjë e nderuar, rruga Juaj dhe e Rebekes së Alamekut nëpër Shtatëmbëdhjetë minutat e orgazmës do të bëhet andej kah klinika "Gemeli" e Romës.Foshnjet tuaja do të jenë foshnjet e kodit të ri. Foshnjat tuaja do t'i ushqejë Indigjenia Pocahontas me tri llojet e qumështit të Massachusettsit.

Zonjë e lartë, unë , Rabi jochanan ben Sakai, i mohova të gjitha ato çka i kishin teprua Tribalit të madh, të gjitha ato me

të cilat Izraeli nuk dinte çka të bëjë. Unë, Rabi Jochanan ben Sakai do ta mësoj popullin tim të mos i teprojë vetvetja kurrëmë.

Vetëm kur një popull i ngopur nga tepricat e vetvetes së vet, vendos të rritet me qumështin jashtëbiblik të Indigjenes Iroki Pocahontas të Massachusettsit është bërë i shpëtuar. Vetëm globalizmi amerikan do ta mësojë botën të mos i teprojë vetvetja e vet.

Zonjë e lartë, shpallja popullit tënd të Jakovës së Jerusalemit se Redalk san Heldikut i tepruan të gjitha:zoti, atdheu, feja, tempulli, ushtria, populli, mishi i vet. Tregoj popullit tënd se Redalk san Heldiku penisin e ka të varrosur në Moskë, testiset në Stamboll e,trupin e vet eunuk e ka të varrosur në Vjenë.

Zonjë e lartë, Ju jeni në Jakovën e Jerusalemit siç jam unë, Rabi Jochanan ben Sakai, në Izrael. Shpallja popullit tënd se Amerika të ka zgjedhë ekologjikisht për ta promovuar në ty globalizmin nismëtar në Evropë. Për asgjë tjetër.Mos u mashtro!

Ktheje sonte nga klinika "Gemeli" në Jakovën e Jerusalemit Tënd kodin e ushqyer me qumështin jashtëbiblik të Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatanit të Massachusettsit."-i zvargur erdhi zëri i Rabi Jochanan ben Sakait.

72.

Mbi varrin e penisit të Redalk san Heldikut në Moskë me një shkrim të pasigurt dikush e kishte shkruar:

"Nitkov"

Në varrezat e haremit të parë të sulltanit, me një shkrim të vjerrt, mezi lexohet mbi varrin e testiseve të Redalk san Heldikut:

"Estokf'llah!"

Varrezat e teatrit të Vjenës, teatralisht të menjanuara e mëshehin varrin e eunukut Redalk san Heldikut. Me një shkrim krejt fëmijënor mbi këtë varr është shkruar:

"Volfgang"

Redalk san Heldikut i paskeshin tepruar të gjitha: varri, zoti, atdheu, feja, testiset, penisi. vetvetja e vet!

73.

Avioni u ngrit në qiell. E panë tokën. Pastaj e panë detin. Serish e panë tokën.

Në orën katër të natës avioni ushtarak i John Harkerit të Massachusettsit aterroi në aeroportin e Jakovës së Jerusalemit. Në orën katër e njëzet minuta helikopteri zbriti në oborrin e Kishës së Shën Andonit para zyrës së OSCE-së.

Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, pa kryer punë, ishte tërhequr gjithandej në Shqipërinë e Albanikut sovjetik i detyruar t'u reshtet mitrave të grave të Jakovës së Jerusalemit.

Të gjithë gjeneralët e Paktit Veriatlantik u kthyen serish në Jakovën e Jerusalemit nga dëbimi poshtërues. Gjenerali rus Ivan Vasiljeviq Kutozovi i patë dëbuar jashtë Jakovës së Jerusa-lemit të gjithë gjeneralët evropianë të Paktit Veriatlantik derisa, larg shikimit të botës, t'i lepuratë mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit.

Indigjenia Iroki Pocahontas Powhatani, me të zbritur nga helikopteri ndaloi në oborrin e kishës së shna'Nout me shikim andej kah ura e Tabakëve mbi Erenik.

Dritat e portokajta mbi turmën e veshtulltë të orës katër të pasmesnatës sikur i binin ndesh mëngjesit të dymbëdhjetë të muajit qershor. Ajo shikoi përtej urës, në cepin tjetër.

Pa rrëmujë.Katrahurë të ushtrive, të administratave, të shteteve evroaziatike. Ushtritë po e njihnin njëra-tjetrën pas dy mijë vjetësh qëndrimi mbi mitrën ekologjike të Jakovës së Jerusalemit. Në cepin tjetër të urës së Tabakëve i pa xhufkat krenare të gladiatorëve, të ushtarëve romanë, të konsujve ushtarakë e, deri tek gjenerali roman, Titi, të cilin ushtarët po e bartnin me lektigë nëpër urë drejt zyrës së OSCE-së së takimit të lartë të këshillit Veriatlantik. Ai po hynte në Jakov-ën e Jerusalemit. Kutërbimi i gjithfarëllojshëm, prej mishit të djegur të njeriut e deri tek mishi i profetëve gacatorë e mëkoi krenarinë e gjeneralit roman, Titi.

E ngriti paksa perden e lektigës për ta parë fitoren e ushtrisë romane mbi Jakovën e Jerusalemit. Gati qe duke i thënë vetvetes së vet: "Ushtria ime e lavdishme romane e paska tepruar paksa. Te fundi ushtria e bën detyrën e vet kundër armikut të pabindur"- kur i pa gjeneralët e tjerë në makina të çuditshme. I njohu se ishin gjeneralë ushtrishë të tjerave kohëra, të tjerave epoka, me nga dymijë vjet largsi nga njëra-tjetra.

Gjeneralët, me shenjat e tyre ushtarake, i dhanë përparësi gjeneralit roman, Titi, edhe pse ai po udhëtonte me lektigë të vonuar, për në takimin e këshillit të lartë të Paktit Veriatlentik i ftuar nga gjenerali, John Harkeri i Massachusettsit.

Të gjithë gjeneralët evroaziatikë po e sillnin me veten e tyre përgjumjen dymijëvjeçare të mishit të Jakovës së Jerusal-emit. Parakalonin në parada ushtarake pranë turmës së trumhasur, të dalë jashtë korracës së Jakovës së Jerusalemit, të tunduar nga gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi.

Indigjenia Iroki-Pocahontas, e mahnitur, e mallëngjyer për babain e vet Iroki- princin Powhatan të Massachusettsit, e mallëngjyer për vëllezërit e vet Iroki, të tredhur aq qonquistadorisht në Sant Luis, po e ndjente me tërë qenien këtë paradë gjeneralësh duke dalë kaq përgjumshëm nëpër derën e historisë dështake evropiane.

"Sa fatnapranë, pas dymijë vjetësh, po dalin sonte nga historia e tyre e ngathët këta gjeneralë evroaziatikë!" – u ngashërye në vetveten e vet Pocahontas.

E njohu gjeneralin roman, Titi, të pluhurosur nga pergamenat shkretinore, të vuvëta, të brevëta, midis Jerus-alemit e Jakovës së vet. E njohu, të përhumbur, nga tundimi i Rebekes së Alamekut të Abbit të Galiles dhe tundimit të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

"Gratë e fuqishme, vetëm gratë e fuqishme e ruajnë, e përtrijnë, kodin e popullit të vet"-u ngazëllye Pocahontas.

74.

Ë njohu gjeneralin austriak, Herman von Urlihun, me një vurratë brenge në fytyrë, të shkaktuar nga vetulla e trembur e plagës së Sofisë së Arçidukës Habsburgas të Vjenës. Në fytyrën e tij prej gjenerali të hequr e pa të ngrirë habinë shastisëse të vajzës së Aleksit të Sarajevës.

"Në vagjinën shterpë të vajzës së Aleksit të Sarajevës ky gjeneral e ka ndezur një Luftë botërore. Para një ore, po ky gjeneral austriak e ka ndarë ujqërisht në tri pjesë mishin e rektorit të Jakovës së Jerusalemit. Secili nga të tre gjeneralët e të tri perandorive: ruse, austriake, turke, e mori hisen e vet të mishit nga Redalk san Heldiku" – i foli vetvetes së vet Pocahontas Powhatani për ta dëgjuar gjenerali i saj, John Harkeri i Massachusettsit.

Gjenerali austriak, Herman von Urlihu me makinën e tij të shpluar ushtarakisht po i qasej zyrës së OSBE-së tek oborri i kishës së Shën Andonit, vetëm katërqind metra larg urës Tabak të Erenikut. Në fytyrën e tij të hequr gruaja Iroki- Pocahontas, i njohu mëtesat e të tri grave. E njohu Sofinë e Arçidukës Habsburgas të Vjenës, e njohu vajzën e Aleksit të Sarajevës, e njohu Sofinë e Jakovës së Jerusalemit.

"Sillu denjësisht me këta gjeneralë të vrarë nga ora e ligë e historisë. Këta gjeneralë, ende pa i filluar, i kanë humbur të gjitha luftat. I sheh sa padenjësisht, sonte po i qasen Këshillit të Lartë të Paktit Atlantik. I dashur, gjeneralët e aktrojnë vetveten e vet fëmijërore. Ata e lozin luftën, epshin e luftës. Mburren për luftën, për vdekjen, për shtetin e vdekjes"- e përgjëroi Pocahontas gjeneralin e vet, John Harkerin e Massachusettsit.

Gjenerali i saj, John Harkeri i Massachusettsit e miratoi heshtazi përgjërimin e Pocahontas Powhatanit. Çasti historik, i ngarkuar në makina ushtarake, pa e bartë vetveten drejt Jakovës së Jerusalemit.

Gjenerali turk, Gymer Jyllmaz, deshi ta shmangë mak-inën ushtarake. Për një çast, vetëm për një çast, lektisi ta dalë nga shtegu i lojës së humbur.

Ishte vonë për ta bërë atë shmangie. Qenkesh hutuar më tepër se ç'duhej ne aeroport duke e ndarë në copa mishi rektorin e Jakovës së Jerusalemit. Të tri perandoritë qenë vonuar në aeroport.

Gjenerali i Massachusettsit, John Harkeri, e thei marrëveshjen duke hyrë dy orë më herët në Jakovën e Jerusalemit.

Për gjeneralin rus Ivan Vasiljeviq Kutozovin u gjet Shqipëria e Albanikut sovjetik vetëm nëntë kilometra larg aeroportit të Jakovës së Jerusalemit. Ai u arratis nga këtej pa arritur ta zbulojë mitrën e Sofisë në mesin e shumë mitrave të zdërvaja gjithandej nëpër qytet.

75.

"*I* dashuri im, ne amerikanët, sonte,në këtë qytet të Jakovës së Jerusalemit ditën e dymbëdhjetë të porsafilluar të këtij qershori, e kemi thyer Marrëveshjen e Rambujës duke zbarkuar dy orë më herët. Mbase po të ishim vonuar vetëm për dy orë gjeneralët evroaziatikë brenda këtij cajtnoti të historisë do të kishin arritur ta aktivizojnë vaksinën e antiorgazmës, të antidashurisë. Do të kishin arritur ta vrasin pjelljen e gruas mitrale" – ironizoi Pocahontas Powhatani, edhe për të katër vëllezërit e tredhur qonquistadorisht në Sant Luis.

Gjenerali, John Harker i Massachusettsit, heshti me shikim të shtrirë deri tek ura, bile edhe tek cepi tjetër i saj. E kishte provokuar historinë e gjeneralëve brenda këtij çasti. I hoq shtatë shtresa pushtimesh mbi Jakovën e Jerusalemit. Të shtatë

gjeneralët, edhe Ivan Vasiljeviqin e arratisur në Shqipërinë e vet të Albanikut sovjetik, i bëri të shikojnë llahtarshëm në fund të vetvetes së tyre historike; ta shohin vetveten e tyre qysh në foshnjërinë e huqjes biosociale.

Gjenerali amerikan, John Harkeri i Massachusettsit, e zuri me shikim çastin e zbulesës. Këtë mengjes të dymbëdhjetë të qershorit mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit u ranë ndesh hormoneve të perëndive masturbuse evroaziatike.

Pocahontas Powhatani, pasi e konstatoi se gjenerali i vetvetes së saj paskesh rënë në çastin historik, u zvarrit nëpër zërin e vetvetes së vet deri tek John Harkeri i Massachusettsit. E arriti për t'ia thënë:

"Sikur, ti jenki, të kishe arritur në Massachusetts para qonquistadorëve spanjollë vellëzërit e mi do të kishin shpëtuar pa u tredhë. Babai im, mbreti im, Powhatan, do të kishte shpëtuar pa e parë vdekjen e vetvetes së vet të spermës Iroki. Këtë mundësi po e shoh sot në këtë qytet të Jakovës së Jerusalemit"- i tha duke e parë këtë ndeshje regulare midis mitrave të grave të njeriut dhe hormoneve të Zeusit.

Ajo e pa shikimin vezullues të gjeneralit Harker. E ndjeu në mishin e vet prej gruaje. Ai ishte aty, ishte në të.

Dritat e portokajta, nëpër të cilat po ecte eskorta e gjeneralëve evroaziatikë prej urës së Tabakëve e deri tek oborri i Kishës së Shën Andonit (Sh'na Nout) i bënë gjasë asaj. Në këtë rënie ndesh të historisë së mitrave të grave me hormonet e perëndive, Pocahontas Powhatani e pa vetvetën e vet të përsëritur. E dalloi një vajzë të veshur me xhup të kuq, krejtësisht të kuq, midis grave të Jakovës së Jerusalemit. Po ecte ngadalë drejt urës, po ikte e shastisur. Po e braktiste Jakovën e Jerusalemit ndesh rrjedhës së gjeneralëve evro-aziatikë. Në dorën e saj të molisur frikës ia zuri shikimi Biblën me kopërtinë të kuqe porsi xhupi i saj.

Ishte vërtet Bibla.

"I dashuri im!"- arriti Pocahontas Powhatani nëpër vetveten e vet të zërit deri tek gjenerali i saj, John Harkeri i Massachusettsit.- "E sheh atë vajzën me xhup të kuq, në dorën e së cilës rëndon ajo Bibël e kuqe?"

"E shoh e dashur. Fort mirë e shoh"- arriti të shkëputët për një çast John Harkeri i Massachusettsit.

"Ajo vajzë me Bibël të kuqe me shpirt ndër dhëmbë po ecë nëpër dhimbjen time Iroki. Jam unë ajo e ajo është unë. Eshtë shajnia ime. A po e sheh sozinë time? Më ndihmo i dashur, të mos ec edhe njëherë nëpër dhimbjen time Iroki. Të mos më përseritet shikimi i shuar i vëllezërve të mi të tredhur qonquistadorisht në Sant Luis. Të mos e ndjej çjerrjen zemë-rthyer të babait tim - Powhatan!" - foli dhimbja e Indigjenes Iroki.

Zvargshëm, nga larg, gjenerali John Harker, e ndjeu zërin e Pocahontas Powhatanit. Ajo po i përgjërohej ta shpëtojë nga përsëritja e vetvetes së vet.

Vajza me xhubletë të kuqe po e bënte rrugën e parë të Biblës. Duhej biseduar me këtë vajzë ende pa rënë në dorë të qonquistadorëve të shfaqur nëpër rrugët e Jakovës së Jerusalemit.

"I dashuri im! Sille këtu atë vajzën me xhubletë të kuqe! Duhet ta shohim me cilin Jezus po udhëtuaka sonte.Jezusi qonquistador do ta shpie drejtë "Sanguis lacertae in musculo" dhe "Sanguis lacertae in cerebro" të gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit" – iu përgjërua John Harkerit.

Vajza me xhubuletë të kuqe gati qe duke rënë po mos ta kishin mbajtur duar të fuqishme. U bë e gjallë vetëm kur Pocahontas Powhatan e pyeti: "Zonjushë, cilin Jezus e keni në atë Bibël?E keni njohur Jezusin tuaj në atë Bibël?"

Vajza me xhubletë të kuqe u hamend paksa para gruas së bukur, të veshur me rrobë ushtarake. Ajo kishte parë shumë

rroba ushtarake, të shumë ushtrive, pa asnjë stinë, jashtë kohës. E dëgjoi anglishten e saj plot zanore. U step në vetveten e vet: "Kaq e bukur paskësh qenë anglishtja?"

John Harkeri i Massachusettsit e dëgjoi zërin e vetvetes së vajzës me xhubletë të kuqe.Edhe ai,vet, John Harkeri, e kishte zbuluar anglishten e vet në zërin e Pocahontas Powhatanit.

Vajza me xhubletë të kuqe ende po hezitonte para kësaj gruaje duke e blatuar aq fuqishëm rrobën ushtarake. Pocahontas Powhatani e ndjeu në mishin e vet frikën dymijvjeçare të vajzës me xhubuletë të kuqe. Në atë vajzë kishte frikë më shumë se për njeriun e gjallë,më shumë se për të gjithë popullin e saj, më shumë se për një Bibël të cilën e mbante në dorë.

Pocahontas Powhatani deshi të shohë se cilën Bibël e mbante në dorë ajo çupë kur gjenerali Harker i Massachusettsit u prir kah e dashura e vet për t'i thënë:

"Ju, e dashura ime, mendoni se Jezusi ishte aq frikacak sa të frikësohet aq qonquistadorisht nga misionarët spanjollë të sant Luisit? Mendoni se kjo çupë Biblën e vet e ka mbushur me frikën e Jezusit?"– i pëshpëriti krejt afër veshit gjenerali Harker pa e shkoqur shikimin nga vargoi i gjeneralëve evroaziatikë të cilët përkundër vullnetit të tyre po ktheheshin nga eksodi i shkaktuar prej gjeneralit rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovit.

"Po, i dashur, Jezusi i qonquistadorëve shpanjollë qe frikacak. Ai e krijoi atë Amerikën e Pancho Maches së juntave, të revolucioneve. E krijoi atë Amerikën eknletike të kontinentit latin.Ai Jezusi qonquistador i joshi vëllezërit e mi nëpër Biblën e Sant Luisit për t'i shndërruar në eunukë"-u rrëmbye Pocahontas në frikën e vajzës së mbushulluar më shumë se për një njeri.

Gjenerali i Massachusettsit u bë i gjallë. Në sytë e tij të brerorët fajkoi i qiellit u bë i etur për Qumështin jashtëbiblik.

Ajo i bëri tre hapa nëpër Biblën e çupës me xhup të kuq kur e ndjeu sëmbimin ngacmues në mishin e vet femëror. Pastaj e

ndjeu jehun e tundimit të largët të orgazmës. E zbuloi shikimin e djaloshit të Biblës në duar të çupës me xhup të kuq. Ishte vet ai Jezusi i qashtër në tendën e saj Iroki të Massachusettsit. Po hynte thellë në mishin e saj femëror.

Pocahontas ra rrëshirë e shkrirë në gjoksin e gjeneralit të Massachusettsit.

"Është Jezusi Iroki i Massachusettsit në Biblën e kësaj çupe?"- u bë zëri i gjeneralit Herker.

"Po i dashur" – u përgjigj Pocahontas e mbushulluar lotë.

"Ti po qan e dashur?"

76.

"Ë dashur ti po qanë e ngazëllyer"

"Po"

"Kjo çupëz të bëri të qashë"

"Po"

"Sërish do të kthehet në Jakovën e vet të Jerusalemit"

"Në atë Biblën e saj e pashë Jezusin e qashtër"

"Le të kthehen të gjithë në Jakovën e Jerusalemit të tyre!

Rabi Jochanan ben Sakai Shtatëmbëdhjetë minutat e Daljes së Izraelit i bëri nëpër Mitrën e Rebekes së Alamekut deri këtu. Rektori Redalk San Heldiku Shtatëmbëdhjetë minutat e Jakovës së Jerusalemit i bëri nëpër Mitrën e Sofisë, të shoqes së Rainhard von Grainhelmit të tretë, trashëgimtarit të kurorës mbretërorë të Bohemisë."-deshi të flasë edhe për rrugën e vet të Shtatëmbëdhjetë minutave amerikane por Harkerit të Massachusettsit i ngeci diç në grykë.

Pocahontas Powhatanit po i shkonin lotët çurg. Ajo u prir kah çupëza me xhup të kuq për të biseduar me vetveten e vet Iroki të Massachusettsit:

"Ti çupëz e re, mbase je duke ikur prej Jakoves së Jerusalemit" – e pyeti çupëzën e përzier me lotët e vet Iroki.

"Po" – mezi u dëgjua zëri i çupës, i mbytur nga zhurma e varganit të gjeneralëve drejt Jakovës së Jerusalemit tek do të mbahej Takimi i Këshillit të Lartë të Paktit Veriatlantik.

"E ke shikuar në sy, ndonjëherë, Jezusin tënd të kësaj Bible?" – e pyeti vajzën me xhup të kuq Pocahontas!

"Posa u ktheva nga shikimi i Jezusit të kësaj Bible"- u përgjigj vajzusha me shikim të trembur.

"E paske ndjerë gruan në vetveten tënde të Jakovës së Jerusalemit. E paske ndjerë shikimin e qashtër të Jezusit. Në mitrën e Sofisë së këtij qyteti- u zgjua Orgazma, Dashuria, Seksi"- i ra tejpërtej mallëngjimit të vet Iroki, Pocahontas e Massachusettsit.

Gjenerali Harker e ndjeu psherëtimën e Pocahontasit, atje në tendë. Zëri i zvargur i katër vëllezërve të saj, natën e cemtë të dimrit (blanë pikëllimi), zbriti në zemrën e motrës- Pocahontas. Zëri zbriti nga Mali Tikako:

"Motër kapërceje zemërimin e kobshëm të qonquistadorëve! Vetëm përtej këtij zemërimi zë fill Orgazma, Dashuria, zë fill jeta. Përtej zemërimit të qonquistadorëve Jezusi arriti vetëm nëpër Kryqin e Golgotës… Qumështi i gjirit tënd le të bëhet jetë, zanafillë, Orgazëm, Dashuri e Jenkit tënd të përbotshëm, mbi shpatullat e të cilit do të bie misioni për shpëtimin e Botës nga zemërimi i qonquistadorëve"

Pocahontas pa e shkëputur shikim zgjatur kah ura e Tabakëve,deri në cepin tjetër, andej kah po ndodhin lëvizjet e ushtrive, të gjeneralëve, e pyeti vajzën me xhup të kuq:

"Po ju, moj çupëz nga po veni në këtë orë të natës?"

Çupëza, sikur u gjend ngusht. Hezitoi trembshëm para gruas së veshur me rroba ushtarake me shenjën amerikane në krah. Para se të flasë, çupëzës i vetëtoi nëpër mend:

"Sonte çdokush mund të maskohet në rrobën amerikane"

Pocahontas e kuptoi mëdyshjen e çupëzës, frikën e saj. Ajo e ndjeu me instinktin Indigjen Iroki se kjo çupëz e trembur këtë natë, më të fundit në shekullin njëzet, po arratisej nga Mitra e Jakovës së Jerusalemit, për herë të parë pas shtatë qiejve të shembur mbi qytetin e saj. Po arratisej kjo çupëz nga mitra e përgjakur e Jakovës së Jerusalemit. Ushtritë e nderkyera të shtatë perandorive, në të dy cepat e urës së Tabakëve, vërtiteshin pa krye,pa e kapur fillin se në ç'drejtim duhet nisur. Gjeneralët e këtyre ushtrive, të përhumbur, nga lektigat e skllevërve të Romës e deri tek makinat moderne, udhëtonin drejt zyrës së OSCE-së tek kisha e Sh'na Ndout të Jakovës së Jerusalemit. Atje, brenda pak minutave do të fillojë takimi i Këshillit të Lartë të Paktit Atlantik.

"Për ku je ftilluar moj çupëz"– sërish Pocahontas e pyeti çupëzën me xhup të kuq.

"Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi, na ka dhënë ultimatum ta lëshojmë Jakovën e Jerusalemit brenda vetëm dy orësh" – u rrokullis në frikën e vet vajza me xhup të kuq.

"Si quhesh?" – e nxori nga frika çupëzën Pocahontas

"Bendisë"

"E dëgjove, i dashur?"– u bë zëri Pocahontas drejt gjeneralit Harker.

"Tamam emer për sonte"-u përgjigj gjenerali.-"Tamam emër yni. "

"A mund të udhëtosh nëpër këtë Bibël deri tek Sofia e Jakovës së Jerusalemit?" – e pyeti Pocahontas.

"Prej Kishës së Sh'na Ndout e deri tek cepi i urës së Tabakëve, kot e kam provuar shtatë herë ta kapërcej këmbë ketë

Bibël.Të shtatë herat e kam ndeshë shikimin tundues të të njejtit Jezus”-u molis vajza para Pocahontas Powhatanit të Massachusettsit.

“Dhe…?” – e nxiti Pocahontas.

“Të shtatë herat jam ngritur e qullur gjithandej nga Bibla” – u ngazëllye çupëza ngase arriti t’ia thotë dikujt.

“Tamam vula gjenetike e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit” – qe mendimi i ngazëllyer i Pocahontas Powhatanit.

-“Kjo çupë shtatë herë, sonte, e ka parë shikimin e qashtër të Jezusit ekologjik. Sonte është nata jote i dashuri gjeneral”-i foli John Harkerit.

“E dashur, me cilin propozim vijnë këta gjeneralë evroaziatikë në takimin e Këshillit të Lartë të Paktit Atlantik? Prej cepit të urës së Tabakëve e deri tek zyra e OSCE-së, pranë kishës së Sh’na Nout të Jakovës së Jerusalemit, këta gjeneralë shtatë herë në sytë e Jezusit të kësaj çupe e panë dështimin e tyre të përsëritur.Shtatë herë kanë hedhë Sanguis Lacertae in utero në mitrën të Jakovës së Jerusalemit. Poaq herë e kanë ndalur ritmin biologjik të vetvetes së tyre. Sonte në dritën e shtuar, këta gjeneralë po hyjnë në Jakovën e Jerusalemit duke u qortuar shtatë herë nëpër shikimin e Jezusit ekologjik të kësaj çupe”- gjenerali Harker, me shikim gjithnjë të mbërthyer në katrahurën e gjeneralëve evroaziatikë, e grishi Pocahontas Powhatanin.

“Këta gjeneralë evroaziatikë po vinë sonte në Takimin e lartë të Paktit Veriatlantik me përgjërim, me sugjerim e, së fundit me kërcënim. Ata po vinë tek ti, i dashur, me mëtesën të heqësh dorë nga vetvetja e jote amerikane. T’i pranosh perenditë e tyre qonquistadore. Të heqesh dorë nga globalizmi yt. Të heqesh dorë nga shikimi i qashtër i Jezusit ekologjik të kësaj çupëze. Të heqësh dorë nga të dy lindjet e bëra prej konsiliumit amerikan në Klinikën “Gemeli” të Romës. T’i vrasësh, vetëm pas dy orësh jetë ata të dy: Rabi Jochanan ben Sakain e Mitrës

se Rebekes së Alamekut; përnjëherë pas tij edhe Redalk san Heldikun e Mitrës së Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Nëpërmes këtyre dy mitrave, ti i dashuri im, po e shpalos një histori tjetër nga ajo e Evropës qonquistadore.Këta gjeneralë, të dështuar nga historia, po të mëtojnë shumë”-u prir zvargshëm Pocahontas kah gjenerali Harker.

77.

Gjenerali roman, Titi, i shtrirë në lektigë, mbi duart e skllevërve romanë po i kapej kodres së "Kavrive" në të hyrë të Jakovës së Jerusalemit kur iu dha ta mënjanojë paksa perden. Deshi të shohë sa ka qenë e rrëmbyer ushtria romane në furinë mbi Jerusalemin. Pau gra, pau fëmijë, pau burra të mjerë, pau mitra të zdervaja grashë.

"Kaq shumë të jetë zemëruar ushtria romane?"– u pllakos në hutesën e vet gjenerali Titi.– "Ç'punë ka Jupiteri me mitrat e ndotura të grave e të kudrave të Jakovës së Jerusalemit?"

E mbylli perden e lektigës pa i kuptuar shumë gjëra. Mezi arriti t'i thotë vetvetes:

"Këta hebrenjtë e Jerusalemit po behën të çuditshëm. I kanë pleksur mitrat e grave, mitrat e kudrave dhe perënditë në katrahurë ogurzezë. Athua në cilën mitër do ta kenë vendosur

atë Rabi Jochanan ben Sakain?”– ra në amokun e vuvët të furisë ushtarake pa e takuar kurrë Jerusalemin e mbuluar nga shtjella myslimane e zikrit “Allah! Allah!”.

Gjenerali roman, Titi, rrafsh pas njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjetësh pritje para mureve të Jakovës së Jerusalemit, pas shtatë hedhjeve të gjakut hardhuce në Mitrën e këtij qyteti, hyri në oborrin e kishës së Sh’na Nout. Qëndroi para zyrës së OSCE-së. U bë i heshtur.

Gjeneralët evroaziatikë i kishin marrë ftesat për takimin e sontem të paktit Veriatlantik. Me vete po i sjellin çka u ka teprua nga mishi i rektorit të Jakovës së Jerusalemit, Redalk san Heldikut. I gjithë mishi i tij u kishte tepruar: testiset penisi, po edhe trupi eunuk i rektorit Heldik. Gjeneralët, pa dijeninë e gjeneralit Harkere të Massachusettsit,donin ta shqyrtonin, secili pjesën e vet të mishi të Redalk san Heldikut. Gjithshka u kishte teprua.

Jollmaz Kadirgollu, i çakërdisur nga brenda, i heshtur nga jashtë, i mbyllur në karrocën ushtarake, e përpiu zemërimin e vet nëpër tespihet e gjatë të netëve monotone, të radhitura në perin e pafund të shekujve buzë Jakovës së Jerusalemit. I rënë në“estokf’llah”,para se të hyjë në zyrën e OSCE-së,në mendjen e vet po i maste të tre mishrat e Redalk san Heldikut, rektorit të Jakovës së Jerusalemit:

E bëri mend, a e zgjodh diplomatikisht Turqia pjesën e vet të mishit?- Turqia nga të tri llojet e mishit të Redalk San Heldikut e zgjodhi për veten e vet mishin e testiseve kur në dorë i kishte të tri mishrat e rektorit të Jakoves së Jerusalemit. Po ç’t’i besh diplomacisë. U desh t’i ndajë këto mishra me Rusinë dhe Austrinë. Vazhdoi ta përbirojë zemërimin nëpër tespihet monotonë, kokrrat e të cilëve e ndiqnin njëra-tjetrën nëpër netët e shekujve të heshtur mbi Jakovën e Jerusalemit.

Nata e gjeneralëve po ziente kodrës së “kavrrive” të Jakovës së Jerusalemit. Koha, historia, kontinentet, mishrat që u

kishin teprua shteteve, qeverive, gjeneralët po i sillnin në Jakovën e Jerusalemit para këmbëve të Indigjenes Iroki të Massachusettsit.

Ajo nuk u prit pa i thënë gjeneralit të vet:

"Gjenerali im i dashur, edhe sonte, Evropa e gjunjëzuar para mitrave të Rebekes së Alamekut dhe të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, po mundohet të qëndrojë. Po katandiset t'i sfidojë tre qumështat jashtëbiblikë me etiketën "Donated by people of America". Po lektisë edhe sonte ta përsëritë vetveten e vet qonquistadore.

Generali im i dashur shpëtoje Evropën sonte nga vetëtredhja!Shpëtoje botën nga vetasgjesimi!"–e përgjëroi Pocahontas gjeneralin e vet nga Massachusettsi.

"Ti po qan, gjeneralja e zemrës njerëzore!" – e mbështoll zëri i gjeneralit Harker ekzaltimin e Indigjenes Iroki – Pocahontas të Massachusettsit.

"Po, unë po qaj, gjenerali im i dashur. Po qaj para kësaj çupe kaq fort të trembur tek dera e prapme e Aushvicit të Jakovës së Jerusalemit. Gjenrali imi i madh, sonte, ju i hapët shtatë dyer të Aushvicit të Jakovës së Jerusalemit të mbyllur shtatë herë me "Sanguis lacertae in utero". Prej zemrës së trembur, të llahtarisur, të kësaj çupëze, po e ndjej, sonte, vigmën e babait tim, mbretit tim Pocahontas, kur qonquistadorët e sant Luisit ia sollën mishrat e përziera të katër vëllezërve të mi të shndërruar në eunukë. Edhe kjo çupë e llahtarisur, e strukur në mua, e ndjeu tmerrin e babait të vet të mjerë atje tek cepi i kësaj ure" – nëpër lotët e saj Pocahontas arriti tek gjenerali i vet nga Massachusettsi.

"Gjeneralja ime e zemrës! Emri i çupëzës Bendisë, në derën e daljes së prapme të Aushvicit të Jakovës së Jerusalemit, do të relievohet në pllakën-vurratë të ndërgjegjes evropiane. I thuaj le të martohet në Evropën e vjetër mbi të cilën ngadhënjeu

sonte, Mitra e Gruas. Le të mësohet Evropa ta lindë vetveten e vet nga Mitra e Gruas, nga Orgazma, nga Dashuria. Mjaft më, vdekja e vetvetes së vet Evropës me ato pjelljet fiktive nga koka e Zeusit nga brinja nga pulpi i këmbës. Nga ky Zeus kanë dalë qonquistadorët e Sant Luisit"-gjenerali Harker e ngushëlloi Pocahontasin.

Ai e përqendroi shikimin, poaq mendjen, në pëshpërimën brenda karrocës së gjeneralit Jyllmaz Kadiragllu. Hezitimi i tij se cili mish i Redalk san Heldikut do të kishte qenë më i volitshëm për Turqinë po ia rëndonte trupin me peshën e shpirtit ogur. Po i binte ndesh vetvetes së vet Turqisë pse ta ndajë mishin e këtij fatziu me Austrinë e Rusinë kur patë mundësi, vetëm para dy orësh, t'i mbante për vete të tri mishrat e shkoqur të të tri pjesëve të Redalk san Heldikut. Mbase me të tri mishrat do ta kishte zbuluar mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit midis mitrave të grave.

Karroca e gjeneralit turk, Jyllmaz Kadirgullu, pritueshëm po kapej përpjetës së "Kavrive" deri tek Kisha Sh'na Ndout. Prej jashtë shihej ngurrimi i tij. Nga shteti i vet, prej të cilit kishte dalë para gjashtëqind e dhjetë vjetësh, e mori urdhëresën se detyrimisht duhet marrë pjesë në Kuvendin e Këshillit të Lartë të Paktit Atlantik. Për herë të parë, pas kaq shekujsh rrethimi, gjenerali turk Jallmaz Kadirgullu po hynte në Jakovën e Jerusalemit. Gjashtëqind e dhjetë vjet amoku, ushtria e tij ishte sulur drejt mureve të këtij qyteti pa arritur kurrë tek ai. Gjithmonë para vetes e kishte pasur një mjegullirë të vuvët, të përbiruar nëpër tespihët e tij, sikur edhe të tri mishrat e shkoqur të rektorit- Redalk san Heldikut.

" I gjithë ky qytet paskesh qenë i vuvët, i vrevët, me ditët gri, pa i dalluar, qytet pa stinë, me mishra të ngatërruara, me perandori të ngatërruara në tri copa mishi eunuk"- u dëshpërua gjenerali turk.

Të gjithë gjeneralët, kolonelët, diplomatët, të dëshpëruarë po i kapeshin kodres së "Kavrive".

Gjenerali Harker nga ledhat e hapura prej raketës "Tomahok" po e përcillte zvarritjen e këtij zvarraniku të veshtullt prej gjeneralësh, diplomatesh, shtetesh, perandorishë. Stinët e tyre të sterkequra mbi njëratjetrën të mishit gaull të Jakovës së Jerusalemit,pluskueshëm po çoheshin duke e zbuluar fetusin ekologjik të një qyteti të konservuar qe në zanafillë. Evropa po ballafaqohet me foshnjërinë, me fetusin e vet. Po ballafaqohej me historinë e vet të gabuar.

Si do të kthehet sonte Evropa në fetusin e zanafillës për ta përmirësuar të gjithë historinë e vet të gabuar?

Gjenerali Harker i Massachusettsit, jo kot, e paska përzgjedhur Jakovën e Jerusalemit për ta promovuar globalizmin amerikan në një qytet ku xhamia dhe penisi hahen midis tyre. Në një qytet religjionesh të pastinë. Në një qytet ku kanë teprua të gjitha pjesët e mishit të njeriut. Në këtë qytet të përtacisë biologjike.

78.

Gjenerali Herman von Urlih ende po ngjitej kodres së "Kavrive"të Jakovës së Jerusalemit me makinën e shpluar ushtarake kur në monitorin e vogël iu shfaq urdhresa e ministrit austriak, Joakim von Adlerit:

"Domosdo do të merrni pjesë në Kuvendin e Këshillit të Lartë Veriatlantik. Ngulmoni të ndryshoni diç në mendjen e gjeneralit Harker të Massachusettsit.

"Po ç'mund të ndryshojmë, ne, gjeneralët, në vagjinën e gruas, në mitrën e saj?"– gati pyeti gjenerali Urlih, i ngadhënjyer nga dëshpërimi. -"Ne, o ministri im, njëherë u përpoqem ta nisim një luftë në vagjinën e vajzës së Aleksit të Sarajevës"

Gjenerali Urlih ra në letargjinë e vrojtimit. I pa në duart e Indigjenes Iroki- Pocahontas, tek hyrja e Jakovës së Jerusalemit, të dy rektorët vagjinalë, të sjellë nga klinika "Gemeli" e Romës.

I rënë thellë në dëshpërim gjenerali Herman von Urlih në monitor i shkroi ministrit austriak Joakim von Adlerit:

"Këtu në këtë qytet të dyfisht po ndodh ajo.

Në njërën dorë Pocahontas e mban mohuesin e mburrjes hebraike, mohuesin e të gjithave çka u ka teprua hebrejve, reformatorin e kodit hebraik: Rabi Jochanan ben Sakain.

Nëpërmes këtij reformatori, të kodifikuar në mitrën e Rebekes së Alamekut, indigjenia Iroki po e mbelton inisiativën e lirë amerikane në një civilizim që ka arritur të mohojë gjithçka që i ka teprua popullit të vet.

Pocahontas Powhatani, nga kodra e "Kavrive" të Jakovës së Jerusalemit, po ia jep kumtin Evropës se Rabi Jochanan ben Sakai i derti të Shtatëmbëdhjetë minutat hebreje të Izraelit në mitrën e Rebekes së Alamekut deri tek orgazma amerikane. Tash e tutje gratë e Izraelit do të lindin fëmijë nga mitrat e tyre.

Izraelit i kishte tepruar atdheu, Jehovai, feja, tempulli, i kishte tepruar heroizmi, i kishte tepruar Tribali i Madh, ushtria, i kishte tepruar Holokausti, harresa hebreje, i kishin tëpruar fëmijët, i kishte tepruar vetvetja e vet Izraelit.

Rabi Jochanan ben Sakai, për vetveten e vet të Izraelit, i qëmtoi Shtatëmbëdhjetë minutat e orgazmës hebreje në mitrën e Rebekes së Alamekut. Nëpërmes Rabi Jochanan ben Sakait-Reformatorit të madh, Izraeli e ruajti vetveten e vet në diasporë. I ra ndesh Evropës tradicionale duke i derguar kumte të njëpasnjëshme nga mitra e Rebekes së Alamekut: "Mos ua merrni të drejtën grave për t'u bërë gra biologjike, nëna, dashnore, nuse! Prej Orgazmës e deri te kryqi i gozhdimit jetën dhe vdekjen i ndjen vetëm gruaja. Ajo grua, vetëm ajo, e ndjeu në mishin e zemrës së vet goditjen e çekanit mbi gozhdën e ngulur në mishin e të Birit deri tek druri i tharë i kryqit.

I gjithë ai hekur i krematoriumit të Aushvicit e humbi davanë kundrejt mitrës së Rebekes së Alamekut.

U bë vonë, shumë vonë, miku im ministër!"- përfundoi Herman von Urlih i rënë në deshpërim të thellë.

79.

Lektiga e gjeneralit roman, Titi, e bartur në krihtë e skllevërve të vezullimtë, posa u shkëput nga cepi i urës së Tabakëve përpjetë Kodrës së "Kavrive" të Jakovës së Jerusalemit. E mbyllur nga të gjitha dritaret ajo lektigë e gjeneralit roman, Titi, po e sillte në zyrën e OSCE-së Kodin e gabuar të Evropës; kodin çapraz të mitit, kodin e shtetit roman të qonquistadorëve të parë.

Gjenerali roman, Titi, u step kur në derë të zyrës së OSCE-së ndeshi njerëz të tjerë, krejt ndryshe nga banorët e Jerusalemit të Judesë. Deri në këtë çast gjenerali roman po i qasej triumfalisht Jerusalemit të çliruar nga ushtarët romanë.

Pritja para zyrës së OSCE-së iu ngja e habitshme deri në fyerje, deri në dëshpërim.

"Përse u stepët zoti gjeneral?" – e pyeti qortueshëm, me një latinishte të hollë një zyrtar i lartë evropian.- "Ju, vetë, gjeneral

i nderuar, në tënden Tuaj para mureve të Jerusalemit ia tumirët kërkesën Rabi Jochanan ben Sakait për ta hapur një universitet në diasporë" – vazhdoi, ashtu papritmas, zyrtari i lartë .

Gjenerali roman, Titi, e vështroi triumfalisht zyrtarin e latinishtes finoke. Iu ngja në krijesë të padefinuar.

"Mund të jetë, mbase, ndonjë palaço nga ata të shesheve të Romës"– mendoi për vetveten e vet gjenerali Titi.

Diç e tërhoq për t'i dhënë përgjigje kësaj krijese të padefinuar, aq tunduese. Me një kuvend përbuzës iu drejtua zyrtarit të lartë evropian:

"Rabi Jochanan ben Sakait, rektorit të të dy universiteteve të Izraelit, liçencën për themelimin e universitetit hebre në Diasporë ia dha, para dy orësh, vetë Roma"- ia drodhi personit zyrtar gjenerali roman Titi.

"Për ju, zoti gjeneral, njëmijë e nëntëqind e njëzetë e nëntë vjet qenkan vetëm dy orë! Ju, zoti gjeneral, për kaq vite po i ngatërroni këto dy qytete në një qytet pa mundur t'i pikasni brenda mitrës së gruas. Rabi Jochanan ben Sakai të njëmijë nëntëqindenjëzetenëntë vjetët e Shtatëmbëdhjetë minutave të orgazmës së Izraelit i kaloi në mitrën e Rebekes së Alamekut në diasporën evropiane të univerziteti hebre"- ia përplasi në fytyrë zyrtari i OSCE-së.

"Ju zotëri po m'i ngatërroni: vitet, minutat, mitrat, qytetet, universitetet" – u përpoq të bëjë akuzë gjenerali roman, Titi.

"Jo zotëri! Ju vetë i ngatërruat Rabi Jochanan ben sakain me delegacionin e Tribalit të Madh të Izraelit, Rebeken e Alamekut me universitetin Hebre në Diasporë e, më në fund edhe atë Sofinë e Jakovës së Jerusalemit" – e ashpërsoi zërin zyrtari i lartë i OSCE-së.

"Më ngjan se po jua njoh zërin"– sikur e kërcënoi gjenerali roman, Titi.

"Edhe mund të jetë e saktë" – u përgjigj zyrtari.

“Zoti Spiridonis Zevs!”– iu drejtua me emër e mbiemër gjenerali Titi.– “Ju, nga huqja e parë në Marinë Magdalenë, keni pasur kohë të mjaftueshme, siç vepruat me Zatrën Aramejase, të veproni edhe me këto të tjerat: me Rebeken e Alamekut dhe me Sofinë e Jakovës së Jerusalemit e, mbase edhe me Indigjenen Pocahontas”-ia përmendi njënganjë gratë.

“Më njohët Zoti gjeneral?” – me një zë të dyshimtë e pyeti Spiridonis Zevsi.

“Po, ju njoha”

“Ju, Zoti gjeneral, mendoni se me të gjitha gratë mund të veprohej sikurse me Zatren Arameje? Me këto tri kurvat e tjera puna qenka krejt ndryshe”– Spiridonis Zevsi i dha të kuptojë se në të tri kurvat e rysi edhe Indigjenen Iroki- Pocahontas Powhatanin e Massachusettsit pa e dhënë ndonjë shpjegim.

“Po, pikërisht siç vepruat me Zatren Arameje”- ngulmoi gjenerali Titi.– “Vetëm në këtë mënyrë do t’ja kishe mbyllur rrugën Rabi Jochanan ben Sakait.” – iu përgjigj gjenerali Titi. – “Te fundi kjo ishte detyrë e Romës, e Athinës, e të gjithë juve.”

“Si mendoni ju, zoti gjeneral? A do të ishte çështje e njëjtë me këtë Indigjenen Iroki- Pocahontas Powhatan, sikurse me Zatren Arameje?”- gati u ngulfat në vetveten e vet Spiridonis Zevsi.

“Meqë ju, zotëri, doni të thoni se çështja ndryshon, atëherë le të ndryshojë. Ç’punë ka kjo Indigjenia Iroki-Pocahontas me Rebeken e Alamekut,me Sofinë e Jakovës së Jerusalemit?” – me qesëndi të zbuluar pyeti gjenerali Titi.

“Ka lidhje, bile ç’ke me të. Për çfarë tjetër do të kishte ardhë në Evropë kjo Indigjenia Iroki në mos jo për mitrat e këtyre grave? Pocahontas e ka mbëltuar kodin e ri biodemokratik pikërisht në mitrat e këtyre dy grave siç ka bërë me mitrën e vet.

Sonte, zoti gjeneral, ajo Pocahontas Powhatan në Klinikën “Gemeli” të Romës e nxori nga mitra e Rebekes së Alamekut

rektorin e të dy universiteteve të Izraelit-Rabi Jochanan ben Sakain e kodifikuar në mitrën e gruas. Një orë më vonë Indigjenia Iroki e Massachusettsit e nxori nga mitra e Sofisë noprane rektorin e Jakovës së Jerusalemit- Redalk San Heldikun, të kodifikuar në mishin e guas. Ajo, Indigjenia Pocahontas, në mos i ka nxjerrë kot, krejt kot, këto krijesa vetëm për t'u engletisur Evropa me to?! Jo miku im!"- gjithnjë e më i ngulfatshëm u bë zëri i Spiridonis Zevsit.

Gjenerali roman, Titi, u përmend nga amoku i sulmit ushtarak mbi muret e Jerusalemit, të paarrirë sipas Spiridon Zevsit njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet. Gjenerali u përmend në mëdyshjen e çastit se a mund të barabitën nëntëmbëdhjetë shekuj me dy orë, me Shtatëmbëdhjetë minuta orgazme të kodit të Izraelit në Mitrën e Rebekes së Alamekut. Rabi Jochanan ben Sakai paskesh udhëtuar kaq shekuj nëpër diasporën biologjike për ta ribërë kodin e shtetit të vet; për ta shpëtuar popullin e vet prej zhdukjes se një lufte të pabarabartë midis Izraelit dhe Romës. Për ta shpëtuar farën e vet nga çdo gjë që i ka teprua Tribalit të Madh të Izraelit.

Gjenerali Titi heshti para furisë së zemërimit të Spiridonis Zevsit. Dëgjoi nga brenda lektigës se ushtarët e legjioneve romane, nën një komandë të panjohur, e paskeshin braktisur Jakovën e Jerusalemit, të dëshpëruar, të turpëruar, të kapluar nga amoku i mashtrimit. Legjionet romane, të huqura mashtrimit të shtjellës nga Sinaji, paskeshin vrapuar përbri mureve të Jerusalemit njëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë vjet, ose, Shtatëmbëdhjetë minuta të orgazmës së kodit të Rabi Jochanan ben Sakait në mitrën e Rebekes së Alamekut.

"Pas të gjitha këtyre fjalëve, cili jeni ju zoti gjeneral?" – gati u ngulfat në pyetjen e vet Spiridonis Zevsi edhe pse gjenerali po heshtte.

Vërtet ashtu ndodhi. Gjenerali heshti para zemërimit të Spiridonis Zevsit. E kuptoi rrjedhën çapraze të nëntëmbëdhjetë shekujve krahas Shtatëmbëdhjetë minutave të orgazmës së kodit hebre në mitrën e Rebekes së Alamekut. E kuptoi çaprazllëkun e akuzës të çvendosur.

"Ky Rabi, jo vetëm se e shpëtoi Izraelin nga lufta e pabarabartë kundër Romës përkundër dëshirës së Tribalit të Madh po e shpëtoi edhe nga mishi i këlyshit të pestë të kones së Danielit të Galiles. Ç'do të kishte ndodh sikur Izraeli t'i kishte dertë të dy zemërimet e Tribalit të Madh: futjen në luftë të pabarabartë kundër Romës dhe, futjen e kodit hebre në mishin e këlyshit të pestë të kones së Danielit?"- gjenerali roman, Titi, duke e zbuluar vetveten e vet e pyeti Spiridonis Kronin Zeusin.

"Në personin Tuaj, zoti gjeneral, flet gjaku i lashtë hebre, i sfilitur në Romë"- e nxjerri dufin Spiridonis Zevsi.- "Të gjithë juve, gjeneralëve sonte do t'u shkojë shurra vegeve para këmbëve të Indigjenes Iroki të Massachusettsit"- bëri me dorë Spiridonis Zevsi andej kah vandaku i gjeneralëve përpjetës së "Kavrive" të Jakovës së Jerusalemit.

80.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih e dëgjoi nga afër zemërimin qortues të Spiridonis Zevsit.Ishte bërë vonë, tepër vonë për t'iu reshtë këtij zemërimi olimpik. Të gjitha rrugët, tashmë, u bënë të hiqta. Vandaku i gjeneralëve po shkarkohej para zyrës së OSCE-së tek do të mbahej takimi i këshillit të lartë të Paktit Veriatlantik. Kishte vetëm edhe një gjysmë ore.

Herman von Urlih po i kapej "Kavrive" të Jakovës së Jerusalemit po me mallin e dy vetullave të trembura të të dy Sofive dhe të vajzës së Aleksit, me të tri vdekjet e shkaktuara mbi Franc Ferdinandin.

Shikimi humnerë i Spiridonis Zevsit,i uritur brevërisht, ishte hapur gëlltitshëm për vandakun e gjeneralëve deshtakë.

Herman von Urlih pritoi të bie në atë shikim olimpik.

"E solle me vete pjesën e mishit austriak të rektorit të Jakovës së Jerusalemit?" – e pyeti Spiridonis Zevsi.

Gjenerali austriak, Herman von Urlih, e njohu këtë pyetje të ushtruar. Shpeshherë kishte provuar të mos i përgjigjej.

"Po! E solla, zotëri"– u zu në faj gjenerali.

"Cila pjesë e mishit eunuk të Radalk san Heldikut i takoi Austrisë?" – e pllakosi ironia pyetjen e Spiridonis Zevsit.

"Austria e mori trupin eunuk të rektorit të Jakovës së Jerusalemit.Kur e sollën Redalk san Heldikun nga Stambolli në dokumentet përcjellës, sipas marrëveshjes ndërshtetërore, Austrisë i takoi vetëm trupi eunuk i rektorit. Kështu edhe i ndamë me gjeneralin Kutozov në aeroport.S'kishim rrugë tjetër"- gati u çfajsua Urlih.

"Ju të tre gjeneralët e të të tri perandorive, mbetët pa e njohur Sofinë e Jakovës së Jerusalemit"-ia këputi shkurt Spiridonis Zevsi.

"Po"

"Nuk u punoi fati evropian"-qesendisi Spiridonis Zevsi.

"Sikur ta kishim zbuluar Sofinë noprane, midis grave të Jakovës së Jerusalemit, ç'duhet të kishim bërë me të ne, tre gjeneralët e tri perandorive?" – me trashamani të shtirë pyeti gjenerali Urlih.

"E paskeni pasur të vështirë ta kuptoni. Po ta kishit zbuluar atë Sofinë midis grave të zdërvaja të këtij qyteti, do të kishte qenë tepër lehtë, gjenerali im i flashkët, ta nisni ngutsisht për në Trieshtë, tok me Zatren, të bijën e mbretit aramejas, Berashit Arajasit. Ato e patën të njëjtin profesion. Mund, edhe ta keni lexuar, gjenerali im, se në hotelin "Laguna" të Trieshtës te dhoma numër shtatë, atë kurvën Arameje e vranë dashnorët e saj zevzekë" – gjithnjë ngjirej Spiridonis Zevsi.

"Hyjësia e Juaj!"- iu drejtua gjenerali Urlih.-"Ne të tre gjeneralët e bënë të pamundurën për ta zbuluar atë Sofinë noprane.

E joshem me të tri llojet e mishrave të Rektorit të Jakovës së Jerusalemit. E shpurëm edhe mbi dy varre siç na mësoi miku ynë, Sigmundi i Vjenës. Ja testuam orgazmën mbi varrin e Redalk san Heldikut. Ju, Hyjësi, ishit aty gjatë seancës, pa qenë i sigurt në qe ajo Sofia noprane" – e denoncoi gjenerali austriak, Herman von Urlih.

Spiridonis Zevsi qëndroi në katandinë e zërit të vet duke u përpjekur ta marrë zemërimin hyjnor.I kuturisur shikimit, andej kah vandaku i gjeneralëve përpjetës së "Kavrive" të Jakovës së Jerusalemit, bëri me dorë.Shenja qe tepër hyjnore, tepër e vonë.

Spiridonis Kronos Zevsi ra në zallahinë e historisë pa i bërë dalë. Me shikim të molisur hyjnisht qëndroi i ngulitur në maje të kodrës së "Kavrive" të Jakovës së Jerusalemit derisa u zvarriten tek ai qonquistadorët:Kleth Durante,Lipmam Smith,Gryber Sontag, Xhonaton Shelton, Herman von Urlih… me epruvetat e tyre eksperimentale të mbushura me të gjitha mostrat e "Sanguis lacertaes" për ta vaksionuar Jakovën e Jerusalemit në mitër, në tru, në muskul. Ata po ktheheshin nga laboratori fushor i OSCE-së, i ngriur vetëm nëntë kilometra larg këtij qyteti- në Le të Shqipërisë së Albanikut sovjetik. Ata qonquistadorë po i sillnin të gjitha mostrat e gjaqeve të hardhucave, të gjitha mostrat e gjaqeve të miushëve për ta athëtuar mitrën e Jakovës së Jerusalemit për të tetën herë në kuvadën e shterpësisë.

81.

"Ku i shpieni ato epruveta tuaja të pshurrta?!

Jeni vonuar, tepër jeni vonuar, gjeneralët e mi ngrehalucë.

Indigjenia Iroki e Massachusettsit u bë e arrirë para se t'ja çatisni ju gjeneralët në Jakovën e Jerusalemit. Ajo hyri, pa e penguar askush, në klinikën "Gemeli"të Romës së këtij gjeneralit tonë. U tarahit kah deshi nëpër Evropë"– Spiridonis Zevsi i përbuzi gjeneralët.

"Të gjitha pergamenat profetizojnë ashtu, zoti ministër"-ia kthei gjenerali Shelton.

"Gjithçka ndodhi ndryshe, gjenerali im ngrehaluc. Ajo kurva arameje, Zatra e mbretit aramejas, Berashit Arajasit, i mësoi të gjitha punët e grave nga kurva hebreje, Maria Magd-alenë e Jezusit Tuaj. Kjo Zatra arameje ia mësoi punët e gruas asaj Rebekes së Alamekut e cila e shmangu Rabi Jochanan ben Sakain nga denimi i meritor.

Të gjithë këtë katrahurë e shkaktoi Jezusi Juaj protestant, i joshur nga seksi,nga orgazma,nga dashuria"- Spiridonis Zevsi me zemërim hyjnor ia shpjegoi gjeneralit të pumbasur sekr-etin publik para zyrës së OSCE-së.

“Hyjësi! Para disa çastesh, tek Laboratori eksperimental në Le të Shqipërisë së Albanikut sovjetik, kur Sofia e Jakovës së Jerusalemit u zdërvaj mbi varrin e rektorit të saj, Redalk san Heldikut,ju hyjësi, pikërisht Ju,e lavdëruat eksperimentin tonë” –iu kundërvu gjenerali Shelton për herë të dytë.

“Ju evropianët, gjenerali im ngrehaluc, qysh se e keni pranuar zotin e lindur nga mitra e gruas së qullur orgazëm jeni bërë të flashkët të veshtulltë, të vonuar, të lajthitur. Edhe sonte jeni vonuar. Tashmë Indigjenia Iroki e Massachusettsit i ka në dorë të dy tandemët e Seksit, të Orgazmës, të Dashurisë. E ka blatuar mohuesin e madh të traditës hebreje, Rabi Jochanan ben Sakain, rektorin e të dy universiteteve të Izraelit. E ka blatuar rektorin e Jakovës së Jerusalemit- Redalk san Heldikun, të joshur me seksin, me orgazmën, me Dashurinë”-qortoi Spiridonis Zevsi.

“Cili Jezus do të jetë më hezitues për ne?”- e pyeti Xhanatan Sheltoni.

“Është e pamundur, miku im gjeneral, ta mohosh vetveten tënde”- shpërthei Zevsi duke aluduar në gjeneralin Harker.

“Po Ju hyjësi ç’do të bëni derisa ne, gjeneralët, të merremi me Indigjenen Iroki”- e pyeti Herman von Urlihu.

“Unë, Spiridonis Kronos Zevsi, kohën time hyjnore-olimpike do ta shndërroj në mermer, në metal, në tempull”-deklaroi solemnisht Zevsi.

“Përtej metalit, përtej gurit, përtej tempullit, kumtet do t’Ju vinë të vdekura, hyjësi”-u kujdes t’i thotë koloneli Gryber.

“Gjeneralët e mi ngrehalucë!Cilën moshë e ka, sonte, Evropa Juaj? E ka moshën e çupës apo e ka moshën e gruas?”-U zhgreh Spiridonis Zevsi

U bë heshtje.

Evropa deri tek mesdita e saj masturbon.Pikërisht në mesditë instinkti i egërsisë e tundon ta kollofitë objektin e përçu-

ditshëm të seksit të pabërë, jashtë mitrës, jashtë moshës, jashtë gjinisë. Fillon pasdrekja katrahurë e Kësulëkuqes-Evropë në barkun e Ujkut të Stepës, të bërë lodër nga gëlltitja e kombeve të Kaukazit. Në orën katërmbëdhjetë të pasdrekes së qershorit gjuetari Jenki, i veshur me çizme ushtarake e kalon pellgun e Atlantikut të cekët. Zbret në Normandi. Ja çan barkun Ujkut të Stepës. E nxjerr Kësulëkuqen e trallisur nga klaustrofobia ksenofobike e barkut të Ujkut të Stepës.

Shfaqja soset.

Serish Kësulëkuqja- Evropë mbetet jashtë moshës, jashtë seksit, jashtë mitrës, jashtë gjinisë. Si çdo çupë llasticë lyp të përsëritet shfaqja.

Sonte Kësulëkuqja-Evropë, për herë të parë, këtu në Jakovën e Jerusalemit, mëtohet ta njohë vetveten e gruas në mishin e mbufatur femëror, qe nga gjinjtë e deri tek vagjina. Mëtohet ta njohë penisin e harlisur drejt vagjinës së zhuritur sëmbimesh. Mëtohet ta ndjejë urinë e mitrës së vet të zbrazët për spermë mashkullore. Ta njohë ndryshimin midis mashkullit e femrës.

"Gjeneralët e mi të mundur në të gjitha betejat! Unë Spiridonis Kronos Zevsi do ta kurdis Pandorën time të mençur para derës së kësaj zyre të OSCE-së këtu në Jakovën e Jerusalemit. Do ta kurdis midis seksit femëror e mashkullor, tek derë e mitrës së etur për spermë mashkulli, kundruall penisit të harlisur e vagjinës së zhuritur sëmbimesh. Do ta kurdis midis dyerve të Izraelit e dyerve të krematoriumit të Aushvicit.Do t'i numërojë sa gra dalin nga Izraeli e sa hyjnë në krematoriumin e Aushvicit Do ta ndjejë pëlcitjen e mitrave e të vagjinave hebreje kur piqen në hekurin e nxehtë e të uritur të krematoriumit. Do ta ndjejë frikën e përhershme të Indigjenes Iroki nga qonquistadorët e Sant Luisit. Andaj gjeneralët e mi ngrehalucë, Indigjenia Iroki e orgazmës amerikane e mbështjellë në pakon me mbishkrim "Donated by poeple of Amerika" mos mendoni

se sonte ka ardhë vetëm si turiste apo si misionare bamirëse deri tek ky qytet i dyfishtë i Jakovës së Jerusalemit.

Ajo indigjene e ka mësuar nga ai Jezusi i saj ekologjik se orgazmën amerikane jashtë kontinentit të saj indigjen për fillim do ta mbëltojë vetëm në mitrën hebreje të Rebekes dhe në ekomitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit. Nga këto dy mitra fillon invazioni i orgazmës amerikane në Evropë. Nga këto dy mitra Amerika e nis globalizmin biologjik jashtë kontinentit indigjen"-shpërthei në dëlir Spiridonis Zevsi

"Zoti ministër!Të gjitha këto duhet t'ia thoni gjeneralit roman, Titi. Ai e miratoi kërkesën e Rabi Jochanan ben Sakait për ta çelë një universitet hebre në diasporë. Ai e shpëtoi këtë Rabi nga dënimi meritor. Këtu filloi oguri i keq"-arsyetoi gjenerali Shelton

"Cili nga Ju, gjeneralucët e mi ngrehalucë i ka koqet e penisin e Rabi Jochanan ben Sakait ta mohojë traditën e vet? T'i mohojë krejt çka i kanë teprua atdheut të vet. Ta shpëtojë kodin e popullit të vet. Cili nga Ju i ka koqet e gjeneralit John Wiliam Harkerit ta pijë aq guximshëm qumështin e Indigjenes Iroki e ta mohojë Jezusin që i ka teprua Angloirlandës, shtetin e tepruar, tempujt e tepruar, zotin që i ka tepruar Angloirlandës? Cili nga Ju gjeneralucët e mi do të ndahej në tri copa mishërash siç i ndodhi Radalk san Heldikut kur të gjitha xhamitë i ndërroi për një penis?

Asnjeri nga Ju.

Cili mysliman arab ka sot koqe të ngritet në këmbët e veta e ta shpallë kumtin: "Unë mohoj çdo gjë arabomyslimane që ka tepruar: hyjt e tyre, tempujt e tyre, religjionin e tyre, ushtritë e tyre, kierarkitë, shtetet. pushtetet, vetëm për një universitet arabomysliman në diasporë.Unë dua ta shpëtoj kodin arabomysliman nëpërmes orgazmës,seksit dashurisë,nëpërmes vet jetes. Unë e mohoj vdekjen qyqare arabomyslimane të tipit Al Qaidë. Unë e mohoj vrasjen e kodit.

Të vdesësh i bindur se për këtë vetvrasje do të shkosh në xhehnet, se nga shkretëtira arabe e pastinë, e pangjyrë, monotone, menjëherë do të kalosh në xhehnetin e gjelbruar të hyrive është dezertim, është ikje nga atdheu. Këtë ikje nga atdheu i shkretëtirës së mynxyrshme e bëjnë burrat e pakoqe, e bëjnë gratë e pavagjinë.

Rabi Jochanan ben Sakai i pati koqet, penisin. Rebeka e Alamekut e pati vagjinën, e pati mitrën. Ata e zgjodhën jetën, atdheun hebre"-merrte zjarr dëliri i Spiridonis Zevsit.

"Ju zoti ministër sikur jeni në anën e Rabi Jochanan ben Sakait!"-ankoi Gjenerali Herman von Urlih.

"Ashtu të duket, gjenerali im. Ju i përkitni Evropës së vakët. E vaktësia nuk ta ngacmon qiellzën. Ti gjeneraluci im, von Urlih sikur ma kujtove se Evropës i mungojnë gratë e orgazmës si Rebeka e Alamekut, si Sofia e Jakovës së Jerusalemit e, veçan si Indigjenia Iroki Pocahontas Powhatani e Massachusettsit. Vertet këto gra mbesin të pashquara sepse mungojnë në Evropë burrat me koqe.

Ju, gjenerali im, i vratë, atje në Sarajevë, dy vagjina hebrejesh brenda një nate"-vazhdoi ngulfatja e ministrit.

Me pergamenat e veta gjenerali Urlih luftën e parë botërore e fillon në vagjinën e vajzës së Aleksit. Ky gjenerali austriak, Herman von Urlih, në pergamenat e shpërndara kudo propagon se në Sarajevë e vrau dukën e habsburgëve Franc Ferdinandin aifarë hebreu i hajthëm Gavrillo Principi.

Evropa vret në mënyrë të vakët.

Gjeneralët sonte po i kapen kodrës së "Kavrive" të Jakovës së Jerusalemit. Në duar po i mbanjnë me aq kujdes ato epruvetat e mbushura me atë solucionin e gjeneralit rus. Po smistohen se me ato shurrat ruse Sanguis lacertae in muskulo dhe Sanguis lacertae in cerebro të eksperimentuara në laboratorin e OSCE-së në Le të Shqipërisë së Albanikut sovjetik t'i bien ndesh gjeneralit të fuqishëm John Wiliam Harkerit.

“Ju evropianët, me ato shurra ruse në dorë, nuk qetë në gjendje t’i vrisni gratë e fuqishme të orgazmës as burrat e fuqishëm të orgazmës.

Pse?

Mashkulli i orgazmës e njeh gruan , gruaja e orgazmës e njeh burrin. Njeriu bëhët i njeriut. Bëhët i asaj Inisiativës së lirë amerikane. E sfidon qiellin, hyun, shtetin, traditën, religj-ionin, ushtrinë . . .

Serish ti gjeneraluci anglez, Xhanatan Shelton, po më pyet se me kend jam.

Unë, Spiridonis Zevsi, jam këmbë e krye me gjeneralin Kutozov. Ai gjeneral vret më shumë se një njeri, vret me shumë se një shtet. Ai luftontë mos ta njohë njeriu orgazmën, të mos e njohë njeriu njeriun. Ai lufton për ta njohur njeriu vetëm shtetin, pushtetin”-mori frymë ministri.

Gjeneralët heshten. E panë se u kishin tepruar epruvetat me Sanguis lacertae, u kishte teprua Jezusi qonquistador, atdheu, tempulli, ushtria, shteti, pushteti, u kishte teprua Evropa e vetvetes së vet.

Por vetem koqet nuk u tepruan.S’patën koqe t’i mohonin krejt ato çka i kishin teprua Evropës.

“Kush do të fitojë, gjeneralët e mi?”- e përfundoi diskutimin e vet Spiriodonis Kronos Zevsi përtej mermerit, përtej metalit, përtej tempullit.

Në pllakën e mermerit shkroi:
“Ky nuk di të flasë”
Në pllakën e metalit shkroi:
“Hekuri vret”
Në tempull shkroi:
“Këtu tepruan të gjitha”

SKZ

82.

"E dëgjove se ç'tha Spiridonis Kronos Zevsi?" – Indigjenia Iroki Pocahontas Powhatan e Massachusettsit e pyeti vajzën me Bibël.

"E dëgjova"

"Sa e keni provuar të çapëloni nëpër mishin kësaj Bibleje?" – serish e pyeti.

"Po! Kemi shkuar shumë larg nëpër mishin e kësaj Bibleje pikërisht sonte, duke ikur nëpër Holokaustin e Jakovës së Jerusalemit. Gjenerali rus, Ivan Vasiljeviq Kutozovi i Ivan Groznit, sonte nëpër Jakovën e Jerusalemit i zdërvaji mitrat e grave. Me ngulmin rus po e lypte një grua. Të gjithë u katandisen ta kuptojnë cila grua ia solli qytetit gjithë këtë zezonë.

Askund zog as korb.

Gjeneralët e OSCE-së i përzu gjenerali Kutozov në Shqipërinë e Albanikut sovjetik.

Na u desht të ikim larg këtij holokausti të mitrave për t'i shpëtuar mitrat tona" – u përgjigj vajza me Bibël në dorë.

“Sa larg keni arritur, sonte, nëpër mishin e Biblës?”- nxitoi Indigjenia Iroki e Massachusettsit, Pocahontas Powhatni.

“Kemi arritur deri tek ai shikimi i qashtër i djaloshit Jezus” – u përgjigj vajza e Biblës.

“Përtej shikimit të Jezusit a gjetët udhë?”

“Jo, Zonjë e lartë! Aty zu të qullet Bibla. Shikimi i Jezusit u bë. E tundoi Orgazmën.” – drithëroi Bendisa e Biblës.

“Atëherë Jezusi qenka Dashuri?”

“Po, zonjë”

“Atëherë Jezusi qenka Orgazëm!?”

“Po, zonjë”

“Atëherë qenka bërë Mitra?”

“Po, zonjë”

“Atëherë qenka bërë Gruaja?”

“Po, zonjë”

“Kot, krejt kot, ia çatisen qonquistadorët kodrës së “Kavrive” të Jakovës së Jerusalemit. Kot, krejt kot, po i sjellin në epruvetat e tyre: Sanguis lacertae për in musculo, Sanguis lacertae për in cerebro, Sanguis Lacertae për in utero për mitrat e grave të Jakovës së Jerusalemit. Kot, krejt kot, i sjellin nëpër epruveta të gjitha llojet e gjakrave të minjve të lugatosur të eksperimentuar në Laboratorin e OSCE-së nëntë kilometra larg nga këtej, në Le të Shqipërisë së Albanikut sovjetik.

Sikur të kishte ndodhë kështu në Iroki të Massachusettsit! Sikur kaq të pafuqishëm t’ia kishin çatisur qonquistadorët e sant Luisit tek tenda e babait tim, mbretit tim Powhatan, do të kishin shpëtuar të katër vëllezërit e mi”- u ngazëllye mallëngjyeshëm Indigjenia Iroki e Massachusettsit-Pocahontas Powhatani.

“Kot, krejt kot, zonjë, po e dëshironi shpëtimin e vëllezërve Tuaj. Vëllezërit Tuaj në Biblën e sant Luisit e gjurmuan Orgaz-

mën amerikane. Ai Jezusi frikacak i qonquistadorëve jugolatinë të sant Luisit i tradhtoi të katër vëllezërit Tuaj. I zbuloi dëshirat e tyre tek misionarët qonquistadorë jugolatinë të sant Luisit.

Zonjë e madhe qonquistadorët evropianë siç i kastruan vëllezërit Tuaj në sant Luis e vranë mitrën e Marisë Magdalenë në shavarinën e Jerusalemit, e vranë Zatren Arameje në hotelin "Laguna" të Trieshtës.

Sonte në Jakovën e Jerusalemit këta qonquistadorë të cilët po i kapen kodrës së "Kavrive" të këtij qyteti me epruvetat e tyre të mbushura me të tri mostrat e gjakrave të hardhucës, me të tri mostrat gjanetike të miushëve të lugatosur, lektisin ta vrasin edhe mitrën e Rebekes së Alamekut të Abbit të Galiles dhe mitrën e Sofisë së Jakovës së Jerusalemit, të shoqes së Rainhard von Grainhelmit, trashëgimtarit të kurorës së Bohemisë"- për një çast u resht nga vetvetja e saj vajza e Biblës së ravizuar duke e bërë shenjën kah vandaku i gjeneralëve të fishkur.

"E njeh ti, moj çupë, Sofinë e Jakovës së Jerusalemit"- e pyeti Pocahontas.

"Po! E njoh. Ajo është gjyshja ime"- u përgjigj çupa.

"Sofia e Jakovës së Jerusalemit dhe Rebeka e Alamekut nga Abbi i Galiles sonte në klinikën "Gemeli" të Romës, para dy orësh, i lindën foshnjet e veta: Rabi Jochanan ben Sakain dhe Redalk san Heldikun"- shpjegoi Pocahontas.

"Thonë se ato dy gra kishin rënë në ëndrrën e Jezofinës"-iu përgjigj vajza e Biblës.

"Cila është ëndrra e Jezofinës?-e pyeti Pocahontas.

"Në ëndrrën e Jezofinës, thonë, paska rënë një copë e shkyer kartuçi nga një pako amerikane ku shkruante: "Donated by people of America"- si me frikë u përgjigj vajza e Biblës.

"A kishte ndonjë vizatim në ëndrrën e Jezofinës?-u çel në fytyrë Pocahontas.

“Ishte një vizatim arkadian. Një burrë dhe një grua prireshin kah njëri-tjetri. Ata i shtrëngonin duart midis tyre”-ra në konspiracion vajza e Biblës.

“A keni provuar ndonjëherë të bini në ëndrrën e Jezofinës?-u mallëngjye Pocahontas.

“Kam provuar. Menjëherë dora e nënës sime sharroi thellë në ëndrrën e Jezofinës. Nga atje më nxori rrëmbimthi.

“Do të bishë në këtë ëndërr si gjyshja jote”- më tha nëna. Kush bie në këtë ëndërr e han Ujku i stepes”- u përgjigj vajza e Biblës.

-“Do të vijë gjuetari Jenki të më nxjerrë nga barku i Ujkut”-ju përgjigja nënës.

“E ke parë ndonjëherë, moj çupë, Gjuetarin Jenki”-e pyeti Pocahontas.

“Jo, kurrë!Atë e ka pa vetëm Jezofina në ëndrrën e vet të copës së shkyer të kartuçit të pakos amerikane: “Donated by people of America” u përgjigj vajza e Bibles.

“Në ëndrrën e jezofinës, po e pave atë grua, a mund ta njohësh në copën e grisur të kartuçit nga pakoja amerikane?”-e nxiti Pocahontas

“Ajo grua nga kartuçi i pakos amerikane, sonte në Jakovën e Jerusalemit, zu të flasë”-u përgjigj me hamendje vajza e Biblës.

“Po”këto dy foshnje a i njeh?”

“U hap fjala se janë foshnjet e Orgazmës. Se është Rabi Jochanan ben Sakai, rektori i dy univerziteteve të Izraelit. Se është edhe gjyshi im, Redalk san Heldiku, rektori i Jakovës së jerusalemit”-ia kthei vajza e Biblës.

“Gjyshi yt?”

“Po!Gjyshi im.

Thonë se u çmend në haremin e sulltanit kur Kadina ia përmendi një xhami. Ai i mohoi të gjitha xhamitë e botës vetëm për një...”- e ndërpreu vajza e Biblës.

“Ai gjyshi yt i mohoi të gjitha xhamitë e botës për sytë e Zatres Arameje”- u mallëngjye Pocahontas.

“Ashtu thonë”

“Gjyshin tënd e tredhen në stamboll krejt sikur të katër vëllezërit e mi që i tredhn qonquistadorët në sant Luis”- u mallëngjye Pocahontas.

“Zonjë, të gjithë mohuesit i denojnë përgjakshëm”- ra në vetveten e vet vajza e Biblës.

“Edhe Jezusin?”

“Po zonjë”

“Edhe Jezusin frikacak të qonquistadorëve?”-pyeti Pocahontas.

“Jezusin e qonquistadorëve e kanë denuar edhe më keq. E kanë denuar me frikën e vetvetes së vet. Dënim më i rëndë se të varrosesh në mitrën e kones së Danielit”- u ndrojt vajza e Biblës.

“Atëherë po ja heq përbuzjen time Jezusit qonquistador. Po e fal”- serish u mallëngjye pocahontas.

“Sonte, të gjitha përbuzjet e botës, urrejtjet, krimet... po regetijnë para këmbëve të Orgazmës amerikane të Irokit nga Massachusettsi. Sonte këtu, në Jakovën e Jeruasalemit, po përsëdytet mrekullia e madhe.

Zoti e zgjodhi mitrën hebreje për ta hedhë farën e vet. Rabi Jochanan ben Sakai e zgjodhi mitrën hebreje për ta shpëtuar kodin e pupullit të vet. Amerika e Orgazmës Iroki të Massachusettsit sonte e çeli mitrën hebreje të Rebekes së Alamekut për ta nxjerrë nga atje kodin e ripërtrirë hebre te Rabi Jochanan ben sakait”-ra në delir vajza e Bibles.

“A s’të duket mjaft?”-u zbeh Pocahontas.

"Jo zonjë!"

"Pse?"

"Sepse pa Orgazmën amerikane Iroki të Indigjenes Pocahontas Powhatanit të Massachusettsit të gjithë jezusët do të ishin bërë qonquistadorë. Pa Orgazmën amerikane, rektori i të dy universiteteve të Izraelit, Rabi Jochanan ben Sakai, do të ishte kalbur në mitrën e Rebekes së Alamekut të Abbit të Galiles. Kodi hebre i Izraelit do të kishte vdekur. Pa Orgazmën amerikane Redalk san Heldiku, rektori i Jakovës së Jerusalemit, do të ishte kalbë në mitrën e Sofisë, të shoqes së Rainhard von Grainhelmit të tretë, trashëgimtarit të kurorës mbretërore të Bohemisë. Kodi i Jakovës së Jerusalemit do të kishte vdekur"-ra serish në delir vajza e Biblës.

Qytetarët e këtij qyteti të dyfisht e ndjenë me mishin e tyre të shkrumbuar në Holokaustin e Jakovës së Jerusalemit siç e ndjenë hebrejtë në Holokaustin e Aushvicit se Dashuria amerikane e Inisiativës së lirë sonte, këtu në Jakovën e Jerusalemit po ia shpall botës programin e jetës. Po e mëson Evropën të mos i teprojë vetvetja e vet. Të mos jetojë e vdekur në masturbimin tradicional të shtetit, të pushtetit, të zotit, të vetvetes së vet.

Evropës së zdërvajë të gjitha po i teprojnë sonte e gjithë natën e zotit.

Indigjenia Iroki e Massachusettsit do t'ia mësojë Evropës jetën sekulare, të mos vdesë në masturbimin metafizik të qonquistadorëve.

Indigjenia Iroki e Massachusettsit do t'ia shpallë myslimanizmit arab të mos dezertojë nga atdheu i vet, nga familja, nga jeta, nga dashuria, duke abuzuar me flijime të falsifikuara, të kontrabanduara, të trafikuara, të tipit Al Qaidë.

Cili djalë ose vajzë të shkretëtirës gri, monotone, të pastinë, nuk do të dëshironte ta kapërcejë ilegalisht kufirin e atdheut

shkretinor e të hyjë në xhehnetin e mugulluar gjelbrim të hyrive të trafikuara, siç ua mësojnë ideologët e tyre?

Del më tepër se e besueshme që këta djem të indoktrinuar, me teskere të xhehnetit në xhep, të presin në radhë, me padurim, me eksploziv rreth belit, që të hyjnë aksidentalisht në xhehnet pa i pyetur të vrarit e tyre në pritojnë të vdesin esëll.

Ky egoizëm adoleshent, qyqarisht e gjen shpëtimin në anën tjetër. Secili nga këta djem mendon vetëm për lumturinë e vet duke u arratisur nga atdheu gri drejt xhehnetit. Atdheu siç e pastë bërë e gjetë!

Asnjë nga myslimanët arabë nuk del ta mohojë atë çka tepron nga xhehneti i liçencuar i Al Qaides.

Kur Tribali i Izraelit, i tipit Shalom, vendosi të abuzojë me atdheun, me familjen, me kodin hebre, duke hyrë në luftë të pabarabartë kundër Romës, Rabi Jochanan ben Sakai kundërshtoi. Ky Rabi i mohoi krejt çka i kishte tepruar Tribalit të madh nga atdheu, familja, nga kodi hebre.

Indigjenia Iroki e orgazmës amerikane e zgjodhi mitrën e civilizimit të lartë hebre sikurse Hyu, për ta shartuar në të orgazmën e Inisiativës së lirë amerikane.

Kjo mitër e civilizimit të lartë siç e pranoi farën e Hyut e pranoi edhe farën e Biodemokracisë amerikane.

Indigjenia Iroki e hodhi farën e biodemokracisë amerikane në të dy mitrat socekstreme: në mitrën e civilizimit të lartë të Rebekes së Alamekut dhe në mitrën e përtacisë ekobiologjike të Sofisë së Jakovës së Jerusalemit.

Rebeka e Alamekut e kishte Hyun e vet, profetin e vet, shtetin e vet, tempullin e vet, religjionin e vet.

Sofia e Jakovës së Jerusalemit nuk e kishte hyun e vet, nuk e kishte profetetin e vet, nuk e kishte shtetin e vet, nuk e kishte tempullin e vet, nuk e kishte religjionin e vet.

Sofia e Jakovës së Jerusalemit e kishte vetëm përtacinë ekobiologjike të Jezusit ekologjik.

Në midis të këtyre dy mitrave Indigjenia Iroki e Massachusettsit e kishte vënë civilizimin e kontaminuar evropian.

Evropës i tepron çdo gjë por i mungon Rabi Jochanan ben Sakai.

"Dikush i tha të gjitha!"-tha Pocahontas

"Po zonjë"-mezi e aprovoi vajza e Bibles.

"Atëherë Jezusi qenka dashuri?"

"Po zonjë"

"Atëherë Jezusi qenka orgazëm?"

"Po zonjë"

"Atëherë qenka bërë mitra?"

"Po zonjë"

"Atëherë qenka bërë gruaja?|

"Po zonjë"

Mbi Jakovën e Jerusalemit u bë qetësi solemne.

Nga avionët e paqjes amerikane të Indigjenes Iroki, Pocahontas Powhatanit të Massachusettsit ra mirra e Dashurisë kudo nëpër qytet.

Vajza me xhubletë të kuqe e Biblës së kuqe të Simon Filipajt notoi nëpër heshtjen e purpurt, pastaj të kuqe, pastaj të veshtulltë, pastaj të ngrohtë, duke rënë thellë në himnin amerikan të Indigjenes Pocahontas Powhatanit, Iroki të Massachusettsit:

Qumësht i tre qumështave-
gjirit tim
Mishin Iroki- përtej seksit
Unë
Grishtarja e Irokit- qumësht
Peniset testiset shkoqur Irokit
Gjaku tehut të orgazmës
Iroki im- O Iroki im
Nëpër të urisë- Kujë Trokiti
Në derë të ëndrrës klitorit
Ai-qumështrash Misri Bizoneshe-
U deh gjirit qumështak-Iroki
Pubisit-në fund hyra unë në mua
Penisit jashtëbiblik-Orgazëm-
Dashuri Iroki im-o Iroki im!

Himni Iroki i IndigjenesPocahontas
Powhatan të Massachusettsit

Zoti e hodhi farën e vet në qiell-
U bënë engjëjt dhe djajtë
A s' ju duket mjaft
Prapë
Zoti e hodhi farën e vet në tokë-
U bënë njerëzit
A s'ju duket mjaft
Prapë
Zoti e hodhi farën e vet në mitrën
e gruas hebreje
U bë Jezusi
A s'ju duket mjaft
Prapë
Zoti e hodhi farën e vet në mitrën e Indigjenës
Iroki të Massachusettsit- Pocahontas
Powhatanit
U bë Amerika Biodemokratike
A ju duket mjaft
Amen!

Himni i Jakovës së Jerusalemit

Fund 13 qershor 2007

Dervishi Hazyr
Pocahontas Powhatan: roman/ Hazyr Dervishi

Botimet ShI “Jakova e”

544 faqe; 20 cm

Formati: 13 x 20
Tirazhi: 2000 kopje
Doli nga shtypi: 15. 10. 2007

Libri u financua nga ABF-i në Treleborg - Suedi